



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar
nga Suedia



Sweden
Sverige

Barazia Gjinore dhe TI

Analiza gjinore e digjitalizimit në Kosovë ▶



Implementuar nga:



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

© Rrjeti i Grave të Kosovës, 2024

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Autorë: Valmira Rashiti, Nicole Farnsworth, Aurora Maxharraj dhe Majlinda Behrami për Rrjetin e Grave të Kosovës.

Dizajnuar nga Jeta Dobranja.

Botuar online në Prishtinë, Kosovë

Ky publikim është prodhuar me mbështetje financiare nga Bashkimi Evropian, me bashkë-financim nga Suedia. Përmajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo Suedisë.



Bashkëfinancuar nga
Bashkimi Evropian

Bashkëfinancuar
nga Suedia



Sweden
Sverige

Barazia Gjinore dhe TI

Analiza gjinore e digjitalizimit në Kosovë

Rrjeti i Grave të Kosovës,
2024

Implementuar nga:

REACH-OR
research in action



KVINNA
KVINNA



PRAVA
ZASV=

WOMEN'S RIGHTS CENTER
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA

Akronimet dhe shkurtesat

AAAPARr	Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve
AAP	Arsimi dhe aftësimi profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ACCESS	Qasja në Treg dhe Shërbimet e Digjitalizimit për Bizneset Kosovare
AD	Agjenda Digjitale
ADA	Agjencia Austriake për Zhvillim
ADC	Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
AKD	Aftësitë dhe kompetencat digjitale
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
AKRB	Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve
ALLED	Përafrimi i arsimit me nevojat e tregut të punës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
ARE	Agjenda për Reforma Evropiane
ARrKEP	Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia e Sigurisë Kibernetike
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
B2B	Business to business
BE	Bashkimi Evropian
CAPI	Intervistë personale me ndihmën e kompjuterit
CAWI	Intervistë në ueb me ndihmën e kompjuterit
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Evropën Qendrore
CLIP	Plani i Zbatimit në Nivel Vendi
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DPRA	Departamenti i PRA
DQPNM	Disponueshmëria, qasshmëria, përshtatshmëria, ndërgjegjësimi dhe mbrojtja
DSS	Departamenti i Skemave Sociale
eID	Identifikimi dhe autentifikimi elektronik
EQUAPRO	Koalicioni për Barazi Gjinore në procesin e anëtarësimit në BE
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FADN	Rrjeti i të dhënave të kontabilitetit të fermës
FAO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë
FET	Fondacioni Evropian i Trajnimit
FFP	Pika kontaktuese nacionale për armët e zjarrit
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
GHG	Gazra serë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit [Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar]
GPS	Gratë, Paqja dhe Siguria

IA	Inteligjenca Artificiale
IAAP	Institucioni i Arsimit dhe Aftësimit Profesional
IADK	Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës
IAL	Institucioni i Arsimit të Lartë
IAT	Institucionet Arsimore dhe Trajnuese
IEBGj	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IKD	Instituti Kombëtar Demokratik
IKShP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IPA III	Instrument për Para-Anëtarësim III
ITP	Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (Prizren)
KAA	Agjencia Kosovare për Akreditim
KAAPARr	Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin për të Rriturit
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Komisioni Evropian
KEC	Qendra për Arsim e Kosovës
KEEN	Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim
KGjK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KIPRED	Instituti Kosovar për Hulumtim dhe Zhvillim të Politikave
KODE	Projekti i Ekonomisë Digjitale në Kosovë
KPK	Kodi i Procedurës Penale
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPM	Komisioni i Pavarur për Media
KRrPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LGBTIQ+	Lezbike, gej, biseksualë, transgjnorë, interseks dhe persona të tjerë identifikues
LMDhP	Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MCC	Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit
MFK	Fondacioni i Mijëvjeçarit në Kosovë
MFPPGj	Menaxhimi i Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MP	Depute/e
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (tani MINT)
MV	Mbrojtësi i viktimave
NA	Nuk aplikohet
ND	Nuk ka datë
NMVM	Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OBT	Organizata Botërore e Tregtisë
OBZHE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
ODK	Open Data Kosovo

OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OShC	Organizata e Shoqërisë Civile
OShCG	Organizata e shoqërisë civile për të drejtat e grave
OZHQ	Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PATP	Programe aktive për tregun e punës
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PEFA	Shpenzimet Publike dhe Përgjegjësia Financiare
PK	Policia e Kosovës
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit
PMT	Proxy Means Test
PPZBA	Programi për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative
PRE	Programi i Reformave Ekonomike
PSK	Përgjegjësia Sociale e Korporatës
PSV	Procedura standarde e veprimit
PVGj III	Plani i Veprimit Gjiner i BE-së III
QIK	Qendra e Inovacionit në Kosovë
QKSGj	Qendra Kosovare për Studime Gjinore
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
RAP	Reforma në Administratën Publike
RAPEX	Sistemi i alarmit të shpejtë për produktet e rrezikshme jo ushqimore
RShV	Realiteti i shtuar dhe virtual
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
RrMDhP	Rregullore për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme
SEESAC	Zyra Qendrore e Evropës Lindore dhe Juglindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të. Lehta
SEMS	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve
Sida	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar
SIGMA	Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim
SIGTAS	Sistemi Standard i Integruar Qeveritar për Administratën Tatimore
SIIP	Sistemi Informativ i Inspektoratit të Punës
SIKK	Sistemit Informativ i Kosovës për Kërkime Shkencore
SIMBNj	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SIMR	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Rasteve
SISh	Sistemi Informativ Shëndetësor
SKZH	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit
SME	Ndërmarrje e vogël dhe e mesme
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SMIAL	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë
SMIP	Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Punësimit
SNS	Skema e Ndihmës Sociale
SRAP	Strategjia e Reformës së Administratës Publike
STEM	Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë
STIKK	Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës
TACSO	Asistencë Teknike e BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile
TI	Teknologjia e Informacionit
TIK	Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit
TPA	Vlerësimi i performancës së mësimdhënësit

TV	Televizioni
TVSh	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNCTAD	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
UNFCCC	Konventa Kornizë e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
UNFPA	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
UNIDO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODA	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Çarmatimit
UNODC	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin
UNSCR	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
VN(B)Gj	Vlerësimi i ndikimit në (barazi) gjinore
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VoIP	Protokolli i transmetimit të zërit në internet
VPN	Rrjeti privat virtual
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
VTC	Qendra e Aftësimin Profesional
WB	Ballkani Perëndimor
WOW	Gratë në punë online
YOU	Youth Online and Upward – programi për të rinjtë
ZBGj	Zyrtar/e për Barazi Gjinore
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Falënderimet

Ky raport është shkruar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE) dhe Suedisë në kuadër të nismës “Avancimi i barazisë gjinore përmes procesit të anëtarësimit në BE” së Koalicionit për Barazi Gjinore në Procesin e Anëtarësimit në BE (EQUAPRO). Bashkë-autoret e këtij raporti janë Valmira Rashiti, Nicole Farnsworth, Aurora Maxharraj dhe Majlinda Behrami. Lucy Maycox, Elirjeta Beka, Marseda Halilaj dhe Besarta Breznica kontribuan në mënyrë të konsiderueshme në hulumtimin dhe shkrimin e këtij raporti hulumtues. RrGK falënderon Lucy Maycox dhe Martine Robinson Beachboard për kontributin e tyre vullnetar dhe zemërgjerë në kontrollin e cilësisë, redaktimin në gjuhën angleze si dhe lektorimin. Ekipi hulumtues falënderon Igballe Rogovën, Drejtoren Ekzekutive të RrGK-së, dhe Stafin Menaxhues të RrGK-së (Adelina Berisha, Alba Loxha, Besa Shehu, Donjeta Berisha dhe Zana Rudi) për mbështetjen dhe këshillat e tyre të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të hulumtimit.

Metodologjia është zhvilluar në konsultim të ngushtë me Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, dhe RrGK-ja vlerëson partneritetin e tyre si dhe shkëmbimin e të dhënave të tyre. RrGK falënderon organizatat e saj anëtare për kontributin e tyre, si dhe zyrtarët qeveritarë, përfaqësuesit e BE-së dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) të cilët ndanë kohën e tyre për të marrë pjesë në këtë hulumtim.

RrGK vlerëson të gjithë ata që kontribuan me njohuri gjatë procesit të rishikimit kolegjial dhe kontrolleve të pjesëmarrësve, duke përfshirë Arthur Cox LLP; Katharina Miller dhe Sylvia Cleff nga Shoqata Evropiane e Grave Jurist; Vesa Reznqiçin Pallaska dhe Marta Gazidedën nga UNDP në Kosovë; Dr. Visare Mujko-Nimanin dhe Dea Pallaskan O’Shaughnessy nga Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) në Kosovë; Edi Gusia nga Agjencia për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit; Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit; Mentor Morinën nga Departamenti i Skemave të Ndihmës Sociale në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT); Efka Heder dhe Skënder Boshtrakaj nga Projekti ALLED - Përafrimi i arsimit dhe trajnimit me nevojat e tregut të punës (Projekti ALLED, Faza II) i Agjencisë Austriake për Zhvillim; Anna Jenderedjian dhe Donjeta Morinën nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (FAO); Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI); dhe Delvina Hana nga Divizioni i Analizave Ekonomike, Departamenti i Analizave Ekonomike dhe Statistikave Bujqësore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Përmbledhja ekzekutive

Digjitalizimi përfshin zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive digjitale në qeverisje, shërbime publike, arsim, të bërit biznes, shëndetësi dhe fusha të tjera të jetës. Ligji për Barazinë Gjinore obligon Qeverinë e Kosovës që të avancojë barazinë gjinore dhe bën thirrje për aplikim të analizës gjinore drejt informimit të të gjitha politikave publike, duke përfshirë ato që lidhen me digjitalizimin. Transformimi digjital është prioritet për Kosovën në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Komisioni Evropian (KE) ka theksuar se ky tranzicion duhet të jetë i drejtë, duke inkurajuar pjesëmarrjen e plotë të grave. Plani i Veprimt Gjitor i KE-së (PVGJ) III parashikon që teknologjitë digjitale mund të përshpejtojnë arritjen barazisë gjinore madje edhe duke shërbyer në adresimin e dhunës me bazë gjinore; Plani i Zbatimit të PVGJ III në nivel vendi, i Zyres së BE-së në Kosovë poashtu thërret për aplikimin e analizës gjinore kundrejt digjitalizimit. PVGJ III gjithashtu kërkon që të gjitha veprimet e jashtme të mbështetura nga BE-ja të informohen nga analizat gjinore. Kosovës i mungojnë analizat e tilla. RrGK shpreson që Modeli i Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës, të cilit i është shtuar analiza gjinore, mund të jetë i dobishëm edhe për vendet e tjera.

Prandaj, kjo analizë gjinore synon të shpalosë implikimet e mundshme të digjitalizimit tek gratë dhe burrat në Kosovë, të kaluara dhe të ardhme; të mbështesë Qeverinë drejt informimit të Vlerësimeve të Ndikimit për Barazinë Gjinore (VN(B)GJ) të kërkuara për politikat publike; të mbështesë BE-në me analizë gjinore për të informuar reformat digjitale, dialogun politik dhe programimin; dhe të informojë avokimin e shoqërisë civile drejt transformimit digjital nga perspektiva gjinore.

Për të realizuar këtë analizë, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka përshtatur Modelin e Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), i cili analizon nivelin e përfshirjes gjinore në punën e Kuvendit, Qeverisë, administratës publike, në fushat e sundimit të ligjit, shërbimeve sociale, arsimit, punësimit, tregtisë, bujqësisë, ndryshimeve klimatike, mjedisit dhe energjisë, shëndetit, dhe mediave. Metodatat e kërkimit përfshijnë analizën e politikave, analizën e përmbajtjes, analizën sasiore dhe intervistat. Si rezultat janë gjetjet e mëposhtme.

KORNIZA LIGJORE

Politikat publike që lidhen me digjitalizimin nuk u përgjigjen mjaftueshëm nevojave të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve, kryesisht për shkak se qeveria rrallëherë ka kryer VN(B)GJ-të e kërkuara. Politikatat e tilla neutrale ndaj gjinisë kanë të ngjarë të kontribuojnë në forcimin e pabarazive ekzistuese gjinore. RrGK nuk ka gjetur raporte të mjaftueshme zyrtare të monitorimit të ligjeve dhe strategjive përkatëse në raport me digjitalizimin, e aq më pak analiza ekzistuese të ndikimit gjitor ex-post të politikave publike.

Praktika të tilla, po të ishin aplikuar, kanë mundur të informojnë hartimin e ligjeve dhe strategjive të reja nga perspektiva gjinore.

QEVERISJA

Përveç në sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, gratë janë të nënpërfaqësuar në planifikim, koordinim, zbatim, monitorim dhe vlerësim të ligjeve, politikave dhe programeve që lidhen me digjitalizimin. Zyrtarëve përgjegjës për digjitalizimin i'u mungojnë aftësitë për politikëbërje të përgjegjshme gjinore, ndërsa zyrtarëve të barazisë gjinore u mungon ekspertiza në digjitalizim. Koordinimi i pamjaftueshëm ndër institucional rezulton me mungesë të integritit gjinor në politika publike. Institucionet ofrojnë shumicën e shërbimeve publike digjitale përmes eKosova. Shërbime digjitale publike janë minimale, dhe të njëjtat, nuk tregojnë vëmendje ndaj kategorive sic janë: gjinia, mosha, aftësia, apo etnia. Sistemet elektronike për gjurmimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për përdoruesit institucionalë janë të dobëta ose krejt të padisponueshme. Institucionet nuk e kanë zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në procesin e digjitalizimit, duke përfshirë financimin dhe prokurimin online, sipas Ligjit për Barazinë Gjinore.

INFRASTRUKTURA

Infrastruktura e lidhjes dhe mjeteve digjitale, si telefonat e mencur janë gjerësisht të disponueshme. Megjithatë, ekzistojnë kufizime në nivelin e qasjes së institucioneve, ofruesve të shërbimeve, grave dhe burrave të ndryshëm në harduerë dhe softuerë që lehtësojnë komunikimin elektronik. Softuerët ekzistues rrallë mundësojnë përpunimin adekuat të të dhënave të ndara sipas gjinisë. Mbledhja e pamjaftueshme e të dhënave të ndara sipas gjinisë pengon aftësinë e institucioneve për të përdorur të dhënat për të informuar reformat sociale, të punësimit, apo edukimit. Softuerët ekzistues nuk mbrojnë gjithmonë në mënyrë adekuate të dhënat personale, privatësinë dhe sigurinë kibernetike, nga një kënd që merr parasysh sigurinë e grave dhe vajzave, ndryshe nga ajo e burrave. Vlerësohet se ndërveprueshmëria e sistemeve digjitale mund të kursejë kohë dhe të rrisë sigurinë, si për shembull në trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore, po qe se aplikohen protokolle nga institucione përkatëse. Ekzistojnë ekosisteme inovative, por qasja e barabartë e grave dhe burrave në këto ekosisteme është e pamjaftueshme.

NJERËZIT

Gratë dhe burrat në përgjithësi kanë qasje në pajisje digjitale, por qytetarët romë, ashkali, egjiptiasë dhe kategoritë e varfëra kanë qasje të kufizuara. Gratë dhe burrat priren të përdorin pajisjet digjitale kryesisht për qëllime sociale; ndërkaq burrat i përdorin ato më shumë se gratë për të bërë biznes dhe rrjetëzim. Asnjëra palë nuk përdorë konsiderueshëm shërbimet publike online, madje gratë edhe më pak për shkak të normave gjinore sipas të cilave burrat priren të regjistrohen në institucione si kryefamiljarë. Edhe gratë edhe burrat kanë mungesë të aftësive për të lexuar dhe njohur informacionet elektronike, përfshirë mbi mirëqenien digjitale. Qasja e kufizuar në ngritjen e aftësive digjitale i kontribuon kësaj gjendje. Gratë mund të përballen me barrierë të theksuara drejt të qenurit në hap me transformimin digjital, për shkak të mungesës së kohës, financave, mbrojtjes dhe përgjegjësive të kujdesit, që i ndalojnë ato nga avancimi i njohurive digjitale. Ekziston një ekuilibër gjinor

midis grave dhe burrave me diploma universitare të lidhura me teknologjinë informative, por gratë janë të nënpërfaqësuar në mesin e pronarëve të bizneseve në këtë lëmi. Gratë dhe burrat nga radhët e minoriteteve përballen me barriera të shtuara për shkak të disponueshmërisë së dobët të shërbimeve digjitale në gjuhët e tyre. Personat me aftësi të kufizuara përballen me sfida të ngjashme. Ekzistojnë të dhëna minimale në lidhje me mirëqenien digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale, privatësinë dhe sigurinë kibernetike. Hulumtimet sugjerojnë se gratë janë në rrezik më të madh të ngacmimit kibernetik, ngacmimit seksual dhe dhunës me bazë gjinore nëpërmjet internetit. Mes përkufizimeve të paqarta ligjore, institucioneve u mungon njohuria dhe përvoja në trajtimin e rasteve të tilla dhe viktimave u mungon besimi në institucione.

Rekomandime

Analiza gjinore ofron rekomandime të detajuara për ligjet, politikat, programet dhe veprimet për secilin aktor përgjegjës, drejt integritit të perspektivës gjinore në procesin e digjitalizimit në Kosovë.

UNDP-ja e përkufizon digjitalizimin si “përdorimin e teknologjive digjitale për të ndryshuar modelin e biznesit të një organizate, duke përfshirë krijimin e mënyrave të reja ose të përmirësuara të ofrimit të shërbimeve dhe përmirësimin e cilësisë së asaj që ofrohet”.¹ UNDP e dallon digjitalizimin nga digjizimi, që është “procesi i konvertimit të informacionit fizik në formate digjitale”.² Përderisa “biznesi” shfaqet në disa përkufizime të digjitalizimit, transformimi digjital ndodh “në kryqëzimin e njerëzve, biznesit dhe teknologjisë”.³ Transformimi digjital përfshin krijimin e “aftësive thelbësisht të reja” në jetën e biznesit, qeverisë dhe njerëzve,⁴ duke u shtrirë në shërbimet publike, arsimin, kujdesin shëndetësor, drejtësinë, shërbimet sociale dhe punësimin. Sipas UNDP-së, “Teknologjitë digjitale në zhvillim dhe mundësitë që ato ofrojnë kanë potencialin për të përmirësuar thellësisht mënyrat në të cilat institucionet publike angazhohen, ofrojnë shërbime për njerëzit dhe u mundësojnë atyre të bëjnë jetë të shëndetshme dhe produktive”.⁵ Shërbimet publike online të ofruara gjatë pandemisë COVID-19 zbuluan nevojën për më shumë shërbime dhe theksuan mundësitë për të arritur personat e izoluar, siç janë gratë që përjetojnë dhunë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Disponueshmëria e internetit në Kosovë është e përhapur, një parakusht jetik për digjitalizim. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin 2022, 97.9% e familjeve kishin qasje në internet.⁶ Kosova ka ndër nivelet më të larta të abonimit të internetit me shpejtësi të lartë për familje në Evropë.⁷

Edhe pse nuk është nënshkruese e Agjendës 2030 dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (OKB) për shkak të statusit të saj politik, Kosova ka përqafuar OZHQ-të. Kuvendi i Republikës së Kosovës u zotua vullnetarisht të zbatoj Agjendën 2030 përmes një rezolute parlamentare,⁸ Marrëveshjen e Stabilizimit Asociimit (MSA),⁹ Agjendën e

1 UNDP, [E ardhmja përpara: Strategjia Digjitale e UNDP-së](#), 2019, f. 5.

2 Po aty.

3 SNS – Zgjidhjet analitike dhe softuerike, “[Transformimi Digjital: Çfarë është dhe pse ka rëndësi](#)”, 2019, qasur më 3 gusht 2023.

4 Allan Martin, cituar në S. Kraus, et al., “[Transformimi Digjital: Një përmbledhje e gjendjes aktuale të artit të kërkimit](#)”, *SAGE Open*, 11.3 2021, f. 4.

5 UNDP, “[UNDP piloton Vlerësimin e Gatishmërisë Digjitale në Kosovë](#)”, 2021, qasur më 3 gusht 2023.

6 Qeveria, ASK, [Rezultatet e Anketës për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në 2022](#), Seria 5: Statistika Sociale 2022, f. 9.

7 Banka Botërore, “[Infrastruktura digjitale rrit elasticitetin dhe përmirëson jetën në Kosovën rurale](#)”, 2023, qasur më 3 gusht 2023.

8 Republika e Kosovës, Kuvendi, Përkushtimi i Kosovës, [Rezoluta për miratimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm](#), 2018.

9 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, [Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit](#), 2016.

Reformës Evropiane (ARE),¹⁰ dhe Programin e Reformës Ekonomike (PRE).¹¹ Sipas OZHQ 5 për Barazinë Gjinore, Qeveria duhet të “rrisë përdorimin e teknologjisë mundësuese, në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, për të promovuar fuqizimin e grave”.¹²

Në “dekadën digjitale” të tanishme, një Evropë e përshtatshme për epokën digjitale është ndër gjashtë prioritetet kryesore të KE-së.¹³ Agjenda e BP-së për Inovacionin, Kërkimin, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin riafirmojnë këtë prioritet të KE-së, duke bërë thirrje për një transformim digjital që “funksionon për njerëzit” në modernizimin e ekonomive të BP-së, krijimin e vendeve të punës dhe adresimin e pabarazisë.¹⁴ Ndër prioritetet e kësaj Agjende është ulja e pabarazive gjinore dhe ndarja digjitale. Plani Ekonomik dhe Investiv për BP-në do të kontribuojnë në tranzicionin e gjelbër dhe digjital, i cili mund të ndikojë pozitivisht në konkurrencën e Kosovës. Mbështetja financiare për tranzicionin digjital është ndër prioritetet e KE-së për financimin e jashtëm të BP-së,¹⁵ dhe Qeveria e Kosovës mund ta shfrytëzojë këtë mbështetje për përpjekjet e digjitalizimit. Duke pasur parasysh se avancimi i digjitalizimit është një parakusht për anëtarësimin në BE,¹⁶ Kosova është duke hartuar, ndryshuar apo përditësuar ligje dhe politika të shumta lidhur me digjitalizimin.

Analiza gjinore duhet të informojë të gjitha ligjet, politikat dhe programet në lidhje me digjitalizimin. Përveç kërkesave të KE-së për analizën gjinore,¹⁷ ligji i Kosovës për Barazi Gjinore kërkon që institucionet të bëjnë analiza gjinore (duke analizuar statusin e grave dhe burrave) drejt parandalimit të diskriminimit në bazë gjinore dhe sigurimit të barazisë gjinore.¹⁸ Strategjia e Qeverisë për Rregullim më të Mirë 2.0 përpunoi këtë përgjegjësi, duke

10 Republika e Kosovës, Qeveria, [Agjenda e Reformës Evropiane](#), 2021.

11 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), “Nacionale Programi i Reformës Ekonomike”, qasur më 6 nëntor 2023.

12 OKB, Kosovë, “Puna jonë për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë”, QZHQ 5 – Barazia Gjinore, objektivi 5.B, qasur më 3 gusht 2023.

13 KE, “Një Evropë e përshtatshme për epokën digjitale, duke fuqizuar njerëzit me një brez të ri teknologjik”, qasur më 3 gusht 2023; Ursula Von der Leyen, Presidente e KE, “Një bashkim që përpiqet për më shumë; Agjenda ime për Evropën”, [Udhëzimet Politike për Komisionin e ardhshëm Evropian 2019-2024](#), 2019; Fondacioni Evropian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe Punës, Eurofound, “[Digjitalizimi](#)”, letra e pozicionit, 7 korrik 2023, qasur më 3 gusht 2023; Aleanca Evropiane e NVM-ve Digjitale, “[Digjitalizimi i qëndrueshëm: Forcimi i sovranitetit digjital të Evropës](#)”, 2020.

14 BE, [Agjenda e Ballkanit Perëndimor për Inovacionin, Kërkimin, Arsimin, Kulturën, Rininë dhe Sportin](#), 2020.

15 BE, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shtator 2021 që themelon [Instrumenti për asistencën e para-anëtarësimin \(IPA III\)](#).

16 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, [Marrëveshja e Stabilizim Asociimit](#), 2016, Neni 110, Shoqëria e informacionit.

17 [BE PVGJ III](#) thekson nevojën për analizë gjinore për të informuar angazhimin politik të BE-së dhe financimin e jashtëm, duke përfshirë si pjesë të IPA III. Analiza gjinore gjithashtu duhet të informojë caktimin e shënuesve gjinorë në veprime.

18 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore](#), Neni 5, 2015.

kërkuar Vlerësimet e Ndikimit në (Barazinë) Gjinore [VN(B)GJ] si pjesë e Vlerësimeve të Ndikimit Rregullator për të informuar të gjitha ligjet, politikat dhe programet e qeverisë.¹⁹ Strategjia thekson se VN(B)GJ mund të parandalojë pasojat e paqëllimta negative dhe të forcoj efektet e synuara pozitive të ligjeve dhe politikave, duke përfshirë kontributin në fuqizimin e grave.²⁰ Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ) në Zyrën e Kryeministrit (ZKM) dha udhëzime se si të kryhen VN(B)GJ.²¹ VN(B)GJ-ja *duhet të identifikojë efektet e ndryshme që një politikë e propozuar mund të ketë tek burrat dhe gratë, si dhe nëse ajo trajton në mënyrë adekuate pabarazitë, kontribuon në barazinë gjinore dhe përputhet me parimet e barazisë gjinore dhe agjendën kombëtare të Kosovës për barazi gjinore.*²² Qeveria duhet të kishte kryer VN(B)GJ për të informuar të gjitha ligjet dhe politikat në lidhje me digjitalizimin që nga viti 2017 kur u miratua Strategjia për Rregullim më të Mirë. Edhe pse Strategjia ka skaduar, legjislacioni i analizuar në këtë analizë gjinore është hartuar në kohën kur Strategjia ishte e zbatueshme. Angazhimet për analizën gjinore dhe ligjet dhe politikat e integritit gjinor mbeten të vlefshme bazuar në Ligjin për Barazi Gjinore. Udhëzimet dhe Manuali për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve kërkon kryerjen e 12 vlerësimeve si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, duke përfshirë VN(B)GJ.²³

Një analizë gjinore e digjitalizimit nevojitet urgjentisht në Kosovë për të informuar reformat. Politikëbërësit duhet të marrin në konsideratë dallimet e mundshme në disponueshmëri, akses, adoptim, ndërgjegjësim, mbrojtje dhe ndikim që digjitalizimi mund të ketë në gra, burra, vajza dhe djem të ndryshëm. Normat dhe marrëdhëniet gjinore paraekzistuese mund të ndikojnë në mundësitë dhe barrierat për pjesëmarrjen e grave dhe burrave të ndryshëm, aksesin në burime dhe pushtetin kur bëhet fjalë për digjitalizimin, një fenomen i referuar si “ndarja digjitale gjinore”.²⁴ Ndërkohë, “ndërsektorialiteti” i referohet mënyrës se si etnia, moshja, vendndodhja gjeografike, gjuha, (pa) aftësia, situata socio-ekonomike, orientimi seksual dhe identiteti gjinor mund të kryqëzohen në mënyrë që gra, burra, vajza, djem dhe persona të tjerë identifikues mund të përballen me barrierat shtesë për të përfituar nga digjitalizimi. Përgjatë këtij raporti, RrGK përdor termin “diversitet” për t’iu referuar konsideratave ndërsektoriale.²⁵

19 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia e Rregullimit më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021](#).

20 Po aty, f. 29.

21 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Manuali i Vlerësimit të Ndikimit të Barazisë Gjinore](#), 2019.

22 Po aty.

23 Republika e Kosovës, Qeveria, Qeveria, ZKM, [Udhëzime dhe Manual për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve](#), 2018.

24 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE) [Kapërcimi i ndarjes gjinore digjitale](#), 2018, f. 22.

25 Ky term përdoret gjithashtu në [EU PVGJ III](#), duke iu referuar grave dhe vajzave “në të gjithë diversitetin e tyre”.

Kur filloi ky hulumtim, pak analiza gjinore mbi digjitalizimin ekzistonin në nivel global,²⁶ dhe nuk mund të gjendeshin metodologji gjithëpërfshirëse. Prandaj, RrGK në bashkëpunim të ngushtë me EQUAPRO, UNDP, institucionet e Kosovës dhe palët e tjera të interesuara kanë krijuar një metodologji të re për kryerjen e analizave gjinore lidhur me digjitalizimin. Përmbledhja ndodhet në seksionet e mëposhtme.²⁷

Qëllimet e Hulumtimit

Ky hulumtim synon të rrisë njohuritë në lidhje me ndikimet e ndryshme potenciale dhe aktuale të digjitalizimit në gra, burra, djem dhe vajza të ndryshme në Kosovë, nga perspektiva gjinore. Së pari, synon të mbështes Qeverinë e Kosovës duke informuar VN(B)GJ të kërkuara për ligjet, strategjitë, politikat dhe programet mbi digjitalizimin, duke ofruar rekomandime se si Qeveria mund ta çojë më tej barazinë gjinore si pjesë e digjitalizimit. Së dyti, ai synon të mbështes BE-në dhe kontraktorët e saj me analiza gjinore për të informuar dialogun politik me Qeverinë në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE dhe hartimin e programimit IPA III. Së treti, ai synon t'i siguroj shoqërisë civile prova për të informuar avokimin dhe monitorimin për një proces më të përgjegjshëm ndaj gjinisë ose transformimit gjinor, të anëtarësimit në BE. Për më tepër, ky hulumtim krijoi dhe pilotoi një metodologji të re për analizën gjinore në lidhje me digjitalizimin që mund të informoj analizat diku tjetër, veçanërisht në BP dhe në kontekstin e anëtarësimit në BE.

Pyetjet e hulumtimit

Ky hulumtim synoi t'u përgjigjej pyetjeve dhe nënpyetjeve kërkimore të mëposhtme:

1. Deri në çfarë mase ligjet, politikat dhe strategjitë e Kosovës në lidhje me digjitalizimin u përgjigjen pozicioneve dhe nevojave potencialisht të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve në lidhje me: pjesëmarrjen, qasjen në burime, të drejtat, normat dhe vlerat?²⁸

26 Shih: UNDP, *Barazia Gjinore në Digjitalizim: Çështjet kryesore për Programim*, 2021; OBZHE, *Kapërcimi i ndarjes gjinore digjitale*, 2018; Shoqata e Komunikimeve Progressive, *Hulumtimi i hartës në Gjini dhe Teknologji Digjitale*, 2017; Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë (OUB), *Digjitalizimi i përgjegjshëm gjinor: Një komponent kritik i përgjigjes ndaj COVID-19 në Afrikë*, 2021; Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin Industrial (OKBZHI), *Ndikimi i teknologjive të reja digjitale në barazinë gjinore në vendet në zhvillim*, 2019.

27 RrGK është e përkushtuar për transparencën e metodës dhe informacione të mëtejshme rreth metodologjisë mund të merren duke kontaktuar info@womensnetwork.org.

28 Përveçse janë fusha kyçe të fokusit në analizat gjinore në përgjithësi, këto janë fushat kryesore që ABGJ udhëzon që VN(B)GJ duhet të shqyrtoj (ABGJ, [Manuali i Vlerësimit të Ndikimit të Barazisë Gjinore](#)). Udhëzimi i ABGJ-së informoi dizajnin dhe metodologjinë e kërkimit.


- 1.1. Çfarë objektivash, treguesish dhe buxhetesh kanë politikat, strategjitë, planet e veprimit dhe programet e qeverisë në lidhje me digjitalizimin në drejtim të avancimit të barazisë gjinore?
- 1.2. Si mund t'i përgjigjen më mirë ligjet dhe politikat pozitive dhe nevojave të ndryshme të grave dhe burrave, duke mundësuar ndryshime transformuese drejt barazisë gjinore?
2. Deri në çfarë mase gratë dhe burrat e ndryshëm kanë pasur akses të barabartë në digjitalizim, duke përfshirë pjesëmarrjen, burimet, të drejtat, normat dhe vlerat?
 - 2.1. Cilat mund të jenë shkaqet kryesore të identifikuara të ndonjë “ndarjeje gjinore digjitale”?
 - 2.2. Si mund të adresohet më mirë çdo pabarazi gjinore e identifikuar nga qeveria nëpërmjet ligjeve, politikave dhe/ose zbatimit të tyre drejt një qasjeje më transformuese gjinore?

Kuadri konceptual: Integrimi i analizës gjinore në kuadrin gjithëpërfshirës të transformimit digjital të UNDP-së

UNDP-ja ka krijuar një model konceptual drejt një “transformimi digjital gjithëpërfshirës të shoqërisë” (shih Figurën 1).²⁹ UNDP-ja identifikon disponueshmërinë, aksesueshmërinë, adoptimin, ndërgjegjësimin dhe mbrojtjen (DAANM) si “katalizatorë për përfshirjen digjitale” drejt një procesi digjitalizimi pa lënë “askënd pas”. Modeli përfshin pesë dimensionë që lidhen me Infrastrukturën (lidhshmëria, ekosistemi i inovacionit); Qeverinë (shërbimet publike digjitale, financimi dhe prokurimi, udhëheqja dhe koordinimi, monitorimi dhe aftësitë); Rregulloret (standardet dhe mbrojtja e të dhënave, tregtia elektronike, konkurrenca e drejtë në treg, siguria kibernetike dhe standardet etike); Biznesin (përshtatja e teknologjisë, stimujt financues, PSK dhe mjedisi fillestar); dhe Njerëzit (aftësitë e shkrim-leximit digjital, kultura, mirëqenia digjitale, përdorimi dhe pronësia). Katalizatorët për përfshirjen digjitale kanë implikime dhe duhet të konsiderohen të lidhura me secilin dimension. Siç ilustron Modeli, UNDP-ja merr parasysh mundësitë sektoriale për digjitalizim në kujdesin shëndetësor, mjedis, klimë dhe energji, qëndrueshmëri ndaj krizave, qytete të zgjuara dhe financa digjitale.

²⁹ UNDP, “Transformimi digjital gjithëpërfshirës i shoqërisë: Fleta e të dhënave për vlerësimin e gatishmërisë digjitale”, 2021.

Figura 1. Modeli Gjithpërfshirës i Transformimit Digjital i UNDP-së



Duke përdorur këtë Model, UNDP-ja zhvilloi një metodologji për vlerësimin e gatishmërisë digjitale të një vendi, e cila shqyrton të njëjtat pesë dimensionet dhe nën-dimensionet të ngjashme. Bazuar në këtë vlerësim, UNDP-ja i kategorizon vendet sipas një shkalle pesë-pikëshe.³⁰ UNDP-ja ka kryer Vlerësimin e Gatishmërisë Digjitale në Kosovë në vitin 2021.³¹ Ajo kreu gjithashtu një Anketë të Familjeve Digjitale në 2022, duke pyetur 2,400 familje mbi “qasshmërinë, përdorimin dhe përballueshmërinë e mjeteve digjitale” dhe shërbimeve.³² UNDP-ja arriti në përfundim se “Kosova po përparon sistematikisht në fushat kyçe të transformimit digjital”.³³ Gjetjet specifike të ndara sipas gjinisë janë referuar në këtë raport.

RrGK përdori Modelin e UNDP-së për të informuar kornizën konceptuale për këtë hulumtim, duke integruar analizën gjinore ndërsektoriale në të siç tregohet nga teksti blu në Figurën 2; RrGK gjithashtu ka përshtatur paksa paraqitjen e Modelit të UNDP-së. Në lidhje me dimensionet dhe katalizatorët për përfshirjen digjitale, RrGK shqyrtoi nënpyetjet që kanë të bëjnë me dallimet e mundshme në pjesëmarrjen e ndryshme të grave dhe burrave, qasjen në

30 Kjo përfshin: 1) bazë, 2) oportuniste, 3) sistematike, 4) diferencuese dhe 5) transformuese.


31 UNDP, “Digjital: Drejt Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës, Gjithë Shoqërisë”, qasur më 3 gusht 2023.

32 Po aty. Për më shumë, shih: UNDP, “Anketa digjitale e ekonomive familjare”, qasur më 31 gusht 2023.

33 Po aty.

burime, të drejta, norma dhe vlera. Modeli i RrGK-së u përpunua përmes një procesi kërkimor përsëritës me rregullime të bëra bazuar në gjetjet. RrGK përdor teorinë e bazuar, një metodë e bazuar në të dhëna empirike që synon të sfidoj pikëpamjet dominuese dhe të ofrojë interpretime të reja, duke hedhur dritë mbi atë që shpesh mbetet e errët.³⁴ Kjo qasje është në përputhje me praktikën e respektuar të kërkimit feminist, e cila kërkon të zhbëj dinamikat tradicionale të fuqisë midis “kërkuesit ekspert” dhe të hulumtuarit duke pranuar në mënyrë aktive ekspertizën e pjesëmarrësve në kërkim dhe duke i angazhuar ata në të gjitha fazat e kërkimit, duke përfshirë analizën. RrGK-ja e përshtati kështu Modelin bazuar në informacionin e mbledhur nga puna në terren, duke shtuar nën-dimensione për të pasqyruar më mirë gjetjet e nxjerra nga “themelimi”.

Figura 2. Modeli i transformimit digjital gjithëpërfshirës i RrGK-së i përgjegjshëm ndaj gjinisë



34 B. Ackerly dhe J. True, Bërja e Kërkimeve Feministe në Shkenca Politike dhe Sociale, botimi i dytë, Londër: Red Globe Press, 2020.

RrGK ka elaboruar pesë katalizatorët e UNDP-së për përfshirjen digjitale për të përfshirë analizën gjinore:

- **Disponueshmëria** përfshin nëse rrjetet digjitale, mjetet dhe programet kompjuterike ekzistojnë dhe u ofrohen grave dhe burrave të ndryshëm në të gjitha lokacionet.
- **Aksesueshmëria** merr parasysh se si rolet, normat dhe marrëdhëniet gjinore mund të mbështesin ose pengojnë digjitalizimin, duke përfshirë: kohën e disponueshme, arsimin, dijen, mjetet, pajisjet, financat dhe vendndodhjen. Këto aspekte mund të prekin më shumë gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike.
- **Adoptimi** lidhet nëse ligjet dhe politikat janë të përgjegjshme në aspekt gjinorë.
- **Mbrojtja** kujdeset për besimin e ndryshëm të burrave dhe grave tek operatorët; vëmendjën gjinore të standardeve etike; mbrojtjen e të dhënave; privatësinë në internet dhe në shtëpi në përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe sigurinë kibernetike për gra dhe burra të ndryshëm.

Modeli i RrGK-së integron gjininë në dimensionet e UNDP-së, duke i shqyrtuar ato në çdo kapitull. Për lexueshmëri, RrGK ka rirenditur dimensionet në kapituj dhe në Model. Së pari, çdo kapitull shqyrton dimensionin e **Rregullores**, duke vlerësuar reagimin gjinor të ligjeve, politikave dhe projektligjeve që kanë të bëjnë me digjitalizimin, **disponueshmërinë** dhe **miratimin** e tyre. Lidhur me **miratimin** në praktikë, seksionet e Rregullores vlerësojnë nëse ekzistojnë objektiva, tregues, baza dhe buxhete adekuate për strategjitë dhe planet e veprimit. RrGK do të mund të shqyrtonte zbatimin e zotimeve për barazi gjinore vetëm nëse ligjet dhe politikat synonin avancimin e barazisë gjinore; RrGK është e qartë se nuk mund të vlerësoj zbatimin e zotimeve joekzistente. Seksionet e rregullores trajtojnë nën-dimensionet e modelit të **mbrojtjes së të drejtave** gjinore, **standardet** e të dhënave, mbrojtjen (gjithashtu si katalizator), **standardet etike** dhe **sigurinë kibernetike**. Kapitujt mbi sundimin e ligjit dhe biznesin shtjellojnë nën-dimensionet e **e-commerce**, **konkurrencën e drejtë të tregut** dhe **sigurinë kibernetike** dhe reagimin e tyre gjinor. Në mënyrë të qartë, brenda seksioneve të Rregullores, **mbrojtja** është një katalizator i rëndësishëm për të shqyrtuar se deri në çfarë mase të dhënat dhe siguria e privatësisë së burrave dhe grave mbrohen nga kuadri ligjor. Ndërkohë, zbatimi gjinor i ligjeve dhe politikave mund të ndryshojë bazuar në **ndërgjegjësimin** dhe **aksesin** që kanë gratë dhe burrat të ndryshëm, megjithëse këto tema trajtohen më shumë në lidhje me njerëzit,

Së dyti, kapitujt shqyrtojnë dimensionin e **Qeverisjes**; RrGK përshtati konceptin e modelit të UNDP-së nga “Qeveria” për të marrë në konsideratë aktin më gjithëpërfshirës të qeverisjes. Kjo e zgjeroi përkufizimin, duke mundësuar analizën e institucioneve të tjera përgjegjëse për digjitalizim, si Kuvendi i Republikës së Kosovës, administrata publike, institucionet e drejtësisë dhe organet e pavarura. Brenda këtij dimensionit, RrGK së pari

shqyrton përgjegjshmërinë gjinore të nën-dimensioneve të udhëheqjes, **koordinimit, planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit**, si dhe balancën gjinore: shkallën në të cilën gratë dhe burrat të ndryshëm marrin pjesë në qeverisje dhe në institucionet përgjegjëse për digjitalizim. Nëse Qeveria ka mundësiuar **pjesëmarrjen e publikut** të diskutoj aty ku është e nevojshme. Së dyti, ai shqyrton **aftësitë** e qeverisë dhe të institucioneve përgjegjëse për të mbështetur digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor, i cili lidhet me katalizatorin e **ndërgjegjësimit**. Së treti, nëndimensioni i **shërbimeve publike digjitale** kujdeset për reagimin gjinor të shërbimeve të disponueshme digjitale të ofruara nga institucionet përgjegjëse. Përderisa kjo është e ndërlidhur ngushtë me infrastrukturën që institucionet kanë në dispozicion për të ofruar shërbime të tilla, RrGK konceptoi shërbimet publike digjitale që të përfshijnë shërbimet e ofruara nga institucionet për publikun dhe jo harduerin ose softuerin teknik në dispozicion brenda institucionit. Disponueshmëria e softuerit dhe harduerit trajtohen nën seksionin Infrastruktura të secilit kapitull. Nën-dimensioni i katërt i **financimit dhe prokurimit** vlerëson reagimin gjinorë të financimit të qeverisë, duke përfshirë përdorimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinorë dhe prokurimit elektronik. Katalizatorët e disponueshmërisë, aksesit, adoptimit, ndërgjegjësimit dhe mbrojtjes janë të gjithë të rëndësishëm për Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse, por diskutohen kryesisht në lidhje me dimensionet e tjera.

Dimensioni i tretë, **Infrastruktura**, shqyrton shkallën në të cilën nën-dimensionet e **lidhjes me internet, mjetet digjitale**, hardueri dhe **softueri** janë të **disponueshme në Kosovë**. Ekzistenca e infrastrukturës kushtëzon disponueshmërinë e shërbimeve publike. Kështu, RrGK e diferencoi infrastrukturën nga shërbimet publike (ajo që ofron qeveria) duke konceptuar infrastrukturën për t'iu referuar vetëm harduerit dhe softuerit teknik në dispozicion. Infrastruktura përfshin “një rrjet kompjuterash dhe sistemesh komunikimi që ofrojnë lehtësira për një shkëmbim mbarëbotëror të të dhënave midis sistemeve dhe përdoruesve”.³⁵ Infrastruktura lehtëson qeverisjen dijitale, por Qeveria është përgjegjëse për zhvillimin e shërbimeve digjitale. Në mënyrë të ngjashme, nëse këto janë të **disponueshme** për gra dhe burra të ndryshëm varet nga **aksesueshmëria**, ndërsa qasja trajtohet brenda dimensionit Njerëzit. Një nën-dimension tjetër i bazuar në Modelin e UNDP-së është **ekosistemi i inovacionit, disponueshmëria** e tij në Kosovë, **ndërgjegjësimi** i larmishëm i grave dhe burrave për të, dhe shkalla në të cilën ata mund t'i **qasen**, diskutuar në dimensionin Njerëzit. Një ekosistem inovativ përfshin aktorë, marrëdhënie dhe burime të ndryshme që kryqëzohen për të krijuar një ide të mrekullueshme dhe për ta rritur atë për ndikim transformues.³⁶ Aktorët mund të përfshijnë qeveritë, shoqërinë civile, sektorin privat, universitetet dhe sipërmarrësit individual.

35 J. Marijn, A.S. Chun, J. R. Gil-Garcia, “Ndërtimi i Gjeneratës së ardhshme të Infrastrukturave të Qeverisjes Digjitale”, Tremujori i Informacionit të Qeverisë, 26 (2), 2009.

36 Aleanca Ndërkombëtare e Inovacionit për Zhvillim, “Çfarë është një ekosistem Inovacioni?”, qasur më 6 nëntor 2023.

Dimensioni i katërt i “**Njerëzve**” merret me nën-dimensionin e **pjesëmarrjes**, i shtuar në Modelin e UNDP-së për të shqyrtuar shkallën në të cilën gratë dhe burrat e ndryshëm kanë **akses**, ndërgjegjësim dhe **mbrojtje** për **pjesëmarrjen** në proceset e digjitalizimit, duke përfshirë politikëbërjen. Një nën-dimension i dytë është **pronësia** dhe **përdorimi**, domethënë shkalla në të cilën gratë dhe burrat të ndryshëm kanë akses në mjetet digjitale dhe shkalla në të cilën ata i përdorin ato. Një nën-dimension i tretë shqyrton aftësitë e ndryshme të shkrim-leximit digjital të grave dhe burrave, të cilat lidhen me **katalizatorët e ndërgjegjësimin** dhe aksesit. Nën-dimensioni i katërt diskuton sesi digjitalizimi ka ndikuar në mirëqenien digjitale të grave dhe burrave. Për sa i përket katalizatorëve, ndërgjegjësimi për efektet e digjitalizimit, si dhe **ndërgjegjësimi** dhe **aksesi** ndaj mekanizmave mbrojtës mund të lidhen me **mirëqenien digjitale**. Katalizatori i **mbrojtjes** është veçanërisht i rëndësishëm në vlerësimin se sa të ndryshëm gratë dhe burrat kanë mbrojtjen e të dhënave, privatësinë dhe sigurinë kibernetike në praktikë.

RrGK e hoqi **kulturën** nga përshtatja e saj e **Njerëzve të UNDP-së**, sepse punonjëset feministe kanë kritikuar termin për përdorimin e neo-kolonialiste që mbështesin “tjetërin” duke e portretizuar kulturën si një pengesë për të drejtat e njeriut.³⁷ Kuptime të tilla injorojnë se kultura është produkt i proceseve të shoqërizimit të mbajtur në mënyrë aktive dhe se nuk ekziston një kulturë homogjene, statike. Kështu, atribrimi i normave në kulturë të përforcojë status quo-në.³⁸ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (KEFDG) dënon përdorimin e kulturës për të justifikuar sistemet ligjore të vjetruara që shkelin të drejtat e grave.³⁹

Në vend të kësaj, RrGK analizoi **normat, rolet, marrëdhëniet dhe vlerat** gjinore si ndërsektoriale përmes Modelit dhe analizës (shih figurat 2 dhe 3).


Dimensioni i **Biznesit** shqyrton reagimin gjinor të **adoptimit të teknologjisë, financimin e stimujve** për bizneset për të digjitalizuar operacionet e tyre, **PSK** dhe mjediset **fillestare**. Katalizatorët përfshijnë aksesin që lidhet me bizneset e digjitalizimit të aksesit të grave dhe burrave, ndërgjegjësimin e tyre për mundësitë që lidhen me digjitalizimin dhe shtrirjen për të cilat bizneset sigurojnë në mënyrë adekuate **mbrojtje** për gra dhe burra të ndryshëm në operacionet e tyre, standardet etike, mbrojtjen e të dhënave, privatësinë dhe sigurinë kibernetike. Figura 3 përmbledh Modelin e Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës të RrGK-së që i përgjigjet gjinisë.

37 S. E. Merry, “Ligji i të Drejtave të Njeriut dhe Demonizimi i Kulturës (Dhe Antropologjia Përgjatë Rrugës)”, *Rishikimi i Antropologjisë Politike dhe Juridike*, 26(1), 2003. See also R. Coomaraswamy, “Identiteti brenda: Relativizmi kulturor, të drejtat e pakicave dhe fuqizimi i grave”, *Rishikimi i Ligjit Ndërkombëtar të Xhorxh Uashingtonit* 34(3), 2002.

38 Për shembull, në Kosovë kultura është përdorur për të justifikuar mbajtjen e pronës së regjistruar në emra burrash, pavarësisht nga dëmi i bërë ndaj grave; dhe në anketimin statistikor të burrave të supozuar si “kryefamiljarë”, të cilët mund të injorojnë dhe të kontribuojnë në nënpërfaqësimin e grave në gjetjet statistikore.

39 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, **KEDNG**, 1979; S. E. Merry, “Ndërtimi i një Ligji Global-Dhuna ndaj Grave dhe Sistemi i të Drejtave të Njeriut”, *Ligji dhe Kërkimi Social*, 28(4), 2003, ff. 945-947.

Figura 3. Modeli i Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës i RrGK-së i përgjegjshëm ndaj gjinisë




Rregullore

I përgjegjshëm ndaj gjinisë: ▼

- ▶ Të drejtat
- ▶ Standardet e të dhënave
- ▶ Mbrojtja
- ▶ Siguria kibernetike
- ▶ Standardet etike
- ▶ E-commerce
- ▶ Konkurrenca e drejtë në treg
- ▶ Ndarjet buxhetore për digjitalizim

Qeverisja

E balancuar gjinore dhe e përgjegjshme për gjininë: ▼



▶ Udhëheqja & koordinimi



▶ Planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi



▶ Aftësitë/



▶ Shërbimet publike dixhitale



▶ Pjesëmarrja publike



▶ Financimi dhe prokurim

Infrastruktura

I përgjegjshëm ndaj gjinisë: ▼

- ▶ Infrastruktura e lidhjes
- ▶ Mjetet digjitale
- ▶ Softueri
- ▶ Ekosistemi i Inovacionit


Njerëzit



▶ Normat gjinore, rolet, marrëdhëniet, vlerat



▶ Pjesëmarrja



▶ Pronësia dhe përdorimi (për shembull qasja)



▶ Aftësitë e shkrim-leximit digjital (për shembull qasja)



▶ Mirëqenia digjitale (normat gjinore, koha, qasja)

Biznes


I përgjegjshëm ndaj gjinisë: ▼

- ▶ Adoptimi i teknologjisë (për shembull qasja)
- ▶ Stimujt financiarë (për shembull qasja)
- ▶ Mjedisi fillestar (për shembull qasja)
- ▶ PSK

DAANM mund të ndryshojnë për gra dhe burra të ndryshëm

DAANM mund të ndryshojnë për gra dhe burra të ndryshëm


Figura 3. Modeli i Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës i RrGK-së i përgjegjshëm ndaj gjinisë



Në informimin e Modelit të saj, RrGK u bazua nga korniza e analizës gjinore e paraqitur nga Jhpiego, një degë e Universitetit Johns Hopkins. Ai ofroi një kornizë të përgjithshme për integrimin e analizës gjinore duke përdorur domenet e institucioneve, ligjeve dhe politikave; praktikat dhe pjesëmarrja; akses në asete; dhe besimet dhe perceptimet (shih Figurën 4). Veçanërisht, pushteti është ndërsektorial, siç shpjegon Jhpiego në lidhje me Kornizën e saj të Analizës Gjinore:

Fuqia: Përshkon të gjitha fushat - informon se kush ka, mund të blejë dhe mund të shpenzoj autoritetin për të blerë dhe shpenzuar asete. [...] Ajo përcakton nëse një individ mund të përfitoj nga mundësitë, mund të ushtroj të drejta, të lëvizë dhe të shoqërohet me të tjerët, të lidhë kontrata ligjore dhe të kandidoj dhe të mbajë poste. Pushteti përcakton gjithashtu mënyrën se si burrat dhe gratë trajtohen nga lloje të ndryshme institucionesh, politikash dhe ligjesh. Mënyra se si trajtohen njerëzit përbën një pjesë të rëndësishme të asaj që do të thotë të jesh i marginalizuar dhe i pafuqishëm nga ana sociale. Qëndrimet diskriminuese të ofruesve, për shembull, përforcojnë dhe thellojnë pabarazitë. Ofruesit, veçanërisht ofruesit e nivelit më të ulët, mund të përjetojnë diskriminim dhe keqtrajtim në vendet e tyre të punës, si rezultat i hierarkive gjinore.⁴⁰

KORNIZA PËR ANALIZËN GJINORE



Qasja në asete

- ▶ Burimet natyrore
- ▶ Asetet prodhuese
- ▶ Të ardhurat
- ▶ Informatat
- ▶ Njohuritë
- ▶ Rrjetet sociale

Besimet dhe perceptimet

- Ndikimi:
- ▶ Qasja në mundësi
 - ▶ Lëvizshmëria dhe vendimmarrja
 - ▶ Pritjet nga sjelljet e duhura

Praktikat dhe pjesëmarrja

- ▶ Koha, hapësira dhe lëvizshmëria
- ▶ Ndarja e punëve në familje dhe komunitete
- ▶ Normat e pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme
- ▶ Rolet

Institucionet, ligjet dhe politikat

- ▶ Proces i rregullt dhe i drejtë
- ▶ Arsimi
- ▶ Mundësi punësimi
- ▶ Shërbimet e kujdesit shëndetësor
- ▶ Infrastrukturas
- ▶ Të drejtat pronësore dhe trashëgimori

Kështu, marrëdhëniet dhe strukturat e pushtetit diskutohen gjatë gjithë raportit, si vendimtare për të kuptuar dinamikën e socializuar të pushtetit që mund të ndikoj në aksesin dhe angazhimin e grave dhe burrave të ndryshëm në transformimin digjital.

Megjithatë, intervistat dhe analizat e përmbajtjes së ligjeve dhe politikave të hartuara që nga miratimi i kësaj Strategjie sugjerojnë se pak zyrtarë e kanë zbatuar VN(B)GJ-n. Asnjë vlerësim nuk e ka shqyrtuar zbatimin e VN(B)GJ-së në politikëbërje. Ndërkohë, ky hulumtim sugjeron se arsyet për aplikimin minimal të tij përfshijnë ndërgjegjësimin e dobët të zyrtarëve rreth kësaj kërkesë, njohuritë e pamjaftueshme se si të kryhen VN(B)GJ-të pavarësisht udhëzimeve të ABGJ,⁷⁶ kapacitetet e kufizuara për të kryer analiza gjinore, kufizimet financiare, kohë të alokuar të pamjaftueshme, përgjegjshmëri të dobët në mesin e zyrtarëve përgjegjës dhe mungesë të zbatimit të detyrimeve ligjore.⁷⁷ Përveç kësaj, normat e socializuara gjinore midis grave dhe burrave

⁷³ Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 për Kosovën 2017-2021, fq. 12-13.

⁷⁴ Po aty, f. 61, Figura 1.

⁷⁵ Po aty, f. 13.

⁷⁶ Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Manuali për Vlerësimin e Ndikimit në Barazi Gjinore](#), 2019. ABGJ ka theksuar se nga viti 2018 deri në vitin 2020, më shumë se 700 nëpunës civil kanë kaluar trajnime për këtë, gjë që sugjeron vetëdijesim adekuat (komenti i draft raportit, 2023). Megjithatë, intervistat e RrGK sugjeruan mungesë të vetëdijes dhe njohurive.

⁷⁷ Dy çështjet e fundit janë identifikuar nga ABGJ në komentet e draft raportit. ABGJ vuri në dukje se këto çështje janë jashtë autoritetit të ABGJ. Midis 2018 dhe 2020, ABGJ komentoi më shumë se 70 koncept dokumente, duke përfshirë përtej temave të lidhura me digjitalizimin, dhe vlerësoi shkallën në të cilën këto komente ishin adresuar (komenti i ABGJ për draft raportin, 2023).

në Qeveri kontribuojnë në besimin se dallimet gjinore nuk ekzistojnë, se të gjithë njerëzit janë “të njëjtë”, dhe se analiza gjinore është e panevojshme për të informuar politikëbërjen. Këto çështje kanë ndikuar negativisht në zbatimin e VN(B)GJ në politikëbërjen në përgjithësi, duke minuar përdorimin e VN(B)GJ për të informuar në mënyrë specifike politikat e digjitalizimit. Njohuritë e kufizuara të zyrtarëve mbi digjitalizimin kontribuojnë në politikëbërjen **neutrale dhe negative gjinore**, siç shtjellohet në këtë raport.

Kjo strategji nuk është më në fuqi. Megjithatë, siç u përmend në hyrje, Ligji për Barazinë Gjinore vendos bazën ligjore për zyrtarët që të përdorin VN(B)GJ në politikëbërje dhe në Udhëzimet dhe Manualin për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve.⁷⁸ Përveç kësaj, që nga viti 2015, Qeveria ka pasur udhëzime për kryerjen e vlerësimeve të ndikimit ex-post të legjislacionit primar, megjithëse jo të dokumenteve strategjike.⁷⁹ Udhëzimi nuk përfshinte një perspektivë gjinore, siç është kërkesa për analizë të ndikimit gjinor ex-post. Megjithatë, manuali i ri për vlerësimin ex-post të legjislacionit përfshin pyetje që lidhen me ndikimin e politikave publike në barazinë gjinore.⁸⁰

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021

Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021 (SKZH) ofrojnë strukturën për Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (QZHQ) dhe aktivitetet e Këshillit për Zhvillim të Qëndrueshëm. E miratuar në vitin 2016, SKZH përfshinte aktivitete për ndërtimin e infrastrukturës së teknologjisë informative dhe komunikuese (TIK).⁸¹ Sfidat që lidhen me TIK-un, aktivitetet e planifikuara dhe ndikimi nuk kanë perspektivë gjinore. Nëpërmjet Fondit të Investimeve dhe Punësimit, SKZH planifikoi të nis Skemën e Konkurrueshmërisë së Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) ose një skemë tematike për Rritjen e Inovacionit në Sektorin e IT. Asnjë masë afirmative nuk u përmend, si p.sh. prioritizimi i granteve apo asistencës teknike për bizneset në pronësi të grave. SKZH diskutoi barrierat me të cilat përballen gratë në ekonominë informale dhe pronësinë e pronave, duke synuar t'i adresojë këto.⁸² Megjithatë, asnjë masë e SKZH-së lidhur me digjitalizimin nuk synon veçanërisht gratë. Kështu, SKZH 2016-2021 është përgjithësisht e **ndjeshme gjinore**, pasi merr parasysh disa pabarazi gjinore. Megjithatë, nuk i adreson ato dhe si rrjedhim dhe nuk i përgjigjet gjinisë. Për më tepër, nuk përmban asnjë perspektivë gjinore në lidhje me masat e digjitalizimit, duke e bërë këtë seksion SKZH neutral gjinor. SKZH-ja e re mbeti draft në

⁷⁸ Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Udhëzimet dhe Manuali për Zhvillimin e Koncept Dokumenteve](#), 2018.

⁷⁹ Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, [Udhëzues për Vlerësimin Ex-Post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës \[në shqip\]](#), 2015.

⁸⁰ Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, [Doracak për Vlerësimin Ex Post të Akteve Juridike](#), 2023.

⁸¹ Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia Zhvillimore Kombëtare 2016-2021 \(SKZH\)](#), 2016, Masa 30.

⁸² Po aty, Masa 7, Aktiviteti 3 dhe Masa 13, Aktiviteti 4

mesin e vitit 2023. Ndërkohë, në vitin 2018, Kuvendi miratoi një Rezolutë për miratimin e OQHQ-ve.⁸³

Udhërrëfyesi për zbatimin e SKZH-së u **miratua** në prill 2017, duke përcaktuar objektivat, kostot, treguesit e performancës dhe sistemin e monitorimit të SKZH-së. Ai parashikoi monitorimin vjetor dhe raportimin mbi planin operativ. Udhërrëfyesi nuk është më i disponueshëm publikisht, kështu që RrGK nuk mund të vlerësoj përgjegjshmërinë gjinore të shpenzimeve të planifikuara. Raporti i parë dhe i vetëm i disponueshëm publikisht i monitorimit të SKZH-së u publikua në tetor 2018,⁸⁴ por ai nuk pasqyron një perspektivë gjinore. Instituti GAP dhe Kosova 2.0, organizata joqeveritare (OJQ), monitoruan zbatimin e masës 2.2.3 të SKZH-së “Pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore” në vitin 2021, e synuar të rritet nga 12% në 27%.⁸⁵ Duke marrë parasysh tendencat në 2015-2019, autorët vërejtën se një rritje kaq e konsiderueshme nga 12% “do të ishte pothuajse e pamundur edhe në rastin e një periudhe jopandemike” dhe rritja mesatare vjetore në 2020 dhe 2021 ishte vetëm 0.75%.⁸⁶ Kështu, ky synim tepër ambicioz lidhur me barazinë gjinore nuk u arrit. Asnjë vlerësim i SKZH-së dhe udhërrëfyesit të tij, duke përfshirë një vlerësim ex-post të ndikimit gjinor, nuk është i disponueshëm publikisht, megjithëse një vlerësim i tillë mund të informojë SKZH-në e re.

Ndërkohë, Këshilli vendosi objektiva për çdo komision parlamentar dhe thuhet se bashkëpunon me parlamentarët, institucionet, organizata ndërkombëtare dhe OSHC për zbatimin dhe monitorimin e QZHQ-ve.⁸⁷ Kuvendi do të duhet të raportoj për progresin në QZHQ 5 për Barazinë Gjinore, i cili kërkon përpjekje për t'i dhënë fund të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave, qasje në arsim cilësor, pjesëmarrje në punësim, paga të barabarta dhe përfaqësim të balancuar në pozita udhëheqëse.⁸⁸ Zbatimi i treguesit të QZHQ 5.c.1. do të kërkonte sigurimin e informacionit të disponueshëm në mënyrë digjitale në lidhje me përpjekjet e qeverisë për të institucionalizuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Ata gjithashtu do të duhet të raportojnë për QZHQ 4 mbi Arsimin cilësor, i cili kërkon përpjekje për arsimin bazë, arsimin terciar, mësimin e të rriturve dhe aftësitë digjitale. RrGK nuk mundi të gjente informacion të disponueshëm publikisht për progresin në këto ose OZHQ të tjera ose mbi punën e Këshillit. Në vitin 2020, Këshilli u mblodh dhe diskutoi

83 Republika e Kosovës, Kuvendi, Nr. 06-R-001, [Rezoluta për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), 2018. Shih gjithashtu: Përkushtimi i Kosovës drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

84 Republika e Kosovës, Qeveria, Raporti i Parë për Zbatimin dhe Rezultatet e Strategjisë Zhvillimore Kombëtare 2016-2021; theksohet gjithashtu në Kosova 2.0, Instituti GAP, [Strategjia Kombëtare për Zhvillim: progresi, pengesat dhe pritjet e ardhshme](#), 2021, f. 3.

85 Kosova 2.0, Instituti PVGJ, [Strategjia Kombëtare e Zhvillimit: progresi, pengesat dhe pritjet e ardhshme](#), 2021, f. 6.

86 Po aty, f. 6.

87 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia Zhvillimore Kombëtare 2016-2021 \(SKZH\)](#), 2016.

88 BE, [Zhvillimi i qëndrueshëm në Bashkimin Evropian Raporti i monitorimit mbi progresin drejt SDGs në kontekstin e BE-së, botimi 2023](#), Luksemburg: Zyra e Publikimeve të Bashkimit Evropian, 2023.

hartimin e një Plani Veprimi për draftin e SKZH-së.⁸⁹ Megjithatë, sipas faqes së internetit të Kuvendit, që atëherë nuk është mbajtur asnjë mbledhje e Këshillit. Vendorsja e zotimeve, treguesve dhe kornizave kohore të qarta për progresin në synimet e QZHQ në lidhje me gjininë dhe digjitalizimin do të ishte e rëndësishme për raportimin transparent të progresit.

Plani Qeveritar

Ky Program është dokumenti kryesor përmes të cilit Qeveria ua komunikon qytetarëve vizionin e saj. Programi 2021-2025 ka dy prioritete: minimizimin e ndikimit në shëndetin publik dhe adresimin e pasojave ekonomike dhe sociale të pandemisë COVID-19.⁹⁰ Ai thekson se Qeveria do të fokusohet në luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe në transformimin ekonomik dhe social të Kosovës, drejt përfshirjes sociale për të gjithë qytetarët. Digjitalizimi përmendet për sa i përket digjitalizimit të administratës publike dhe shërbimeve elektronike, arsimit, sistemit të drejtësisë, bizneseve (duke i dhënë përparësi bizneseve në pronësi të grave) dhe përmirësimit të infrastrukturës së TIK-ut. Programi nuk deklaron se si mund të përdoret transformimi digjital për të përmirësuar barazinë gjinore. Megjithatë, nën të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, angazhohet për avancimin e politikave buxhetore gjinore dhe kryerjen e vlerësimeve të ndikimit gjinor për të informuar politikat e reja të qeverisë. Kjo duhet të ishte zbatuar në politikat e qeverisë në lidhje me digjitalizimin. Mirëpo, siç tregon ky hulumtim, ky zotim nuk është përmbushur. Programi është i ndjeshëm ndaj gjinisë në atë që përmend gratë dhe barazinë gjinore, por nuk përmban objektiva specifike drejt barazisë gjinore.

Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024

ABGJ ka krijuar Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 bazuar në Ligjin për kërkesat e Barazisë Gjinore.⁹¹ Ai synon të siguroj që barazia gjinore të jetë në qendër të proceseve transformuese në të gjitha strukturat, institucionet, politikat, procedurat, praktikat dhe programet e qeverisë, agjencive, shoqërisë civile, sektorit privat dhe donatorëve.⁹² Dokumenti përmend vetëm digjitalizimin në lidhje me ndarjen profesionale, duke deklaruar se vetëm 22% e punonjësve në sektorin e TIK janë gra. Ai vëren se “vajzat janë më pak të interesuara për sektorin [TIK], megjithëse ky sektor ofron mundësi shumë të mira punësimi, ofron të ardhura mbi mesataren e vendit [dhe ka] më shumë potencial për eksportimin e shërbimeve dhe punësim në shtëpi”.⁹³ Programi nuk ka asnjë objektiv apo aktivitet drejt barazisë gjinore në digjitalizim.

89 Republika e Kosovës, Kuvendi, “Këshilli për Zhvillim të Qëndrueshëm mblidhet në seancë”, 19 nëntor 2020, qasur më 16 gusht 2023.

90 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, *Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025*, 2021, f. 5.

91 Republika e Kosovës, Kuvendi, *Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore*, 2015, neni 11.

92 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, *Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024*, 2020, f. 9.

93 Po aty, f. 25.

Në përgjithësi, Programi është transformues gjinor, pasi synon të adresoj shkaqet rrënjësore të pabarazive gjinore. Ai ka objektiva dhe tregues të qartë drejt avancimit të barazisë gjinore. Ka një plan veprimi dhe buxhet me disa shpenzime të mbuluara nga donatorët dhe të tjera nga buxheti i Kosovës. Shumica e objektivave deklarohen se nuk kanë kosto shtesë ose se kostot janë llogaritur në kuadër të strategjive sektoriale të ministrive të tjera. Kjo mund të paraqes rrezik për zbatimin nëse ministritë e tjera nuk i integrojnë objektivat, treguesit dhe buxhetet drejt barazisë gjinore në strategjitë dhe planet e tyre të veprimit. Nëse strategjitë e tjera nuk i përafrojnë qartë qëllimet e tyre me Programin dhe nuk i ndajnë treguesit dhe buxhetet sipas gjinisë, atëherë monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve dhe shpenzimeve drejt arritjes së qëllimeve të Programit do të jetë i vështirë.

Në maj 2023, ABGJ publikoi një raport monitorimi dhe vlerësimi për zbatimin e Planit të Veprimit të Programit për 2020-2022 në 2020-2021. Raporti nuk përfshinte informacion gjithëpërfshirës, duke pasur parasysh se jo të gjithë zbatuesit raportuan për punën e tyre, pavarësisht kërkesës së ABGJ.⁹⁴ Lidhur me digjitalizimin, raporti përmend vetëm se “UN Women mbështeti zhvillimin e platformës dhe raportit të hartës digjitale për të identifikuar komunitet në rrezik të lartë të braktisjes së shkollës nga gratë dhe vajzat e reja nga komunitetet pakicë.”⁹⁵ Plani i Veprimit i Programit thuhet se ka marrë më shumë financime sesa ishte planifikuar fillimisht, veçanërisht duke pasur parasysh financime shtesë për të trajtuar pandeminë COVID-19.⁹⁶

Agjenda e Reformës Evropiane II

Plani i Veprimit ARE II, i miratuar në vitin 2021, parashikon rritjen e shkallës së punësimit, veçanërisht të grupeve që kanë “më pak gjasa për t’u punësuar” duke mbështetur mundësitë e punësimit në IT, punësimin e grave, skemat e punësimit për të rinjtë dhe profilet e reja të trajnimit.⁹⁷ Institucionet përgjegjëse për zbatimin e ARE II duhet të ndajnë një buxhet adekuat për zbatimin e masave të parashikuara për 2022 dhe 2023.⁹⁸ Ai përfshin aktivitetet e TI-së të RAP-it, kryesisht në drejtim të zvogëlimit të barrës administrative. ARE II bën thirrje për miratimin e një Strategjie të re për Reformën e Administratës Publike (SRAP) 2021-2026, e cila u përfundua.⁹⁹ Në lidhje me digjitalizimin, ARE II nuk i referohet në mënyrë eksplicite gjinisë. Për shembull, nuk diskuton se si reduktimi i barrës së administratës publike duke digjitalizuar shërbimet

94 ABGJ, komenti për draft raportin, nëntor 2023. Këtu përfshihet KE-ja si ndër financuesit më të mëdhenj, deklaroi ABGJ.

95 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Raporti i monitorimit dhe vlerësimit për arritjen e objektivave për treguesit dhe zbatimin e aktiviteteve të Planit të Veprimit të PKBGJ 2020-2022](#), Periudha raportuese: 2020 dhe 2021, 2023, f. 127.

96 ABGJ, koment për draft raportin, nëntor 2023.

97 Republika e Kosovës, Qeveria, Faza e Dytë e Prioriteteve Politike BE-Kosovë: [Agjenda e Reformës Evropiane \(ARE\) II, 2021, Shtylla 3, Punësimi, Arsimi dhe Shëndetësia](#), treguesit: 3.1.c.1.1., 3.1.c.1.4., dhe 3.2.b.2.1.

98 Po aty, f. 6.

99 Treguesi 1.2.a.1.6., Plani i Veprimit ARE II.

në platformën eKosova mund të ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm. Megjithëse ARE II përfshin nën-prioritete specifike, aktivitete dhe disa tregues për barazinë gjinore, plani i saj i veprimit është **neutral gjinor** në lidhje me digjitalizimin; ai nuk përfshin objektiva, tregues apo buxhete që kanë të bëjnë me barazinë gjinore. Ajo mund të kishte kujtuar kërkesën për një VN(B)GJ për të informuar SRAP-in e ri, duke përfshirë aspektet e TI-së.

RrGK gjeti vetëm një raport të publikuar për monitorimin e ARE II, i cili mbulon periudhën korrik-shtator 2021. Raporti përmend gjininë një herë, lidhur me miratimin e “Udhëzimit Administrativ për detyrat, përgjegjësitë, procedurat dhe kriteret për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucioni arsimor dhe trajnues parauniversitar, duke përfshirë aspektet gjinore”.¹⁰⁰ Kështu, monitorimi përmbante analiza të kufizuara gjinore.

Strategjia e Kosovës për TI

E miratuar në vitin 2016, Strategjia synon të promovoj zhvillimin e industrisë së Teknologjisë Informativë (TI) të Kosovës, të konsideruar si “motor kryesor për rritjen ekonomike, punësimin dhe inovacionin”.¹⁰¹ Ajo synonte të rriste konkurrencën ndërkombëtare të sektorit bazuar në përsosmërinë digjitale. Nëntë shtyllat e saj strategjike u fokusuan në IT, Përsosmërinë dhe Cilësinë e Kompanisë, Promovimin e Eksportit, Zhvillimin e Tregut të Brendshëm, Edukimin e IT, Grupimin dhe Bashkëpunimin e IT, Sipërmarrjen, Inovacionin dhe Kërkimin dhe Zhvillimin e Aplikuar, dhe Promovimin e Investimeve. Të gjitha masat ishin parashikuar të përfundonin deri në vitin 2018. Pavarësisht objektivave të saj të detajuara, Strategjia nuk përmend barazinë gjinore, gratë dhe burrat. Analiza e problemit dhe objektivat nuk përfshijnë të dhëna, programe ose masa afirmative të përshtatura për nevojat, nivelet e njohurive dhe situatat potencialisht të ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm. Strategjia nuk merr parasysh barrierat me të cilat mund të përballen gratë dhe burrat për sa i përket qasjes, kohës për përdorimin e mjeteve të TIK-ut, posedimit të pajisjeve, vendndodhjes gjeografike, statusit social, aftësisë, moshës dhe roleve dhe stereotipeve gjinore. Kështu, Strategjia e TI-së e Kosovës ishte **neutrale gjinore**.

Skenarët për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë janë propozuar nga grupi i punës përgjegjës për caktimin e një institucioni për monitorimin e zbatimit të saj. Nuk ekziston asnjë informacion i disponueshëm publikisht për të treguar se ekziston një organ monitorues ose se janë konsultuar ekspertët të barazisë gjinore si ABGJ. RrGK nuk gjeti dëshmi të raporteve të monitorimit mbi zbatimin e Strategjisë së TI-së në Kosovë, megjithëse një vlerësim ex-post i ndikimit gjinor mund të kishte ndihmuar në informimin e agjendës së re digjitale.

100 ZKM, [Raport për zbatimin e Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës](#) - Agjenda për Reformat Evropiane (ARE II) gjatë periudhës korrik - shtator 2021, f. . 33.

101 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Asociacioni i Kosovës për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (AKTIK), [Strategjia e TI-së e Kosovës](#), 2016, f. 9.

Strategjia e Komunikimit dhe Informimit 2018-2021

E miratuar në vitin 2018, kjo Strategji kishte për qëllim që të kuptoj më tej qytetarët për procesin e anëtarësimit në BE “për t’u mundësuar qytetarëve të bëjnë një zgjedhje të informuar dhe të marrin pjesë aktivisht në formësimin e së ardhmes evropiane të Kosovës”.¹⁰² Strategjia synonte të përdorte komunikimet digjitale, duke shfrytëzuar ndikimin e “ndikuesve digjital, të tillë si video influencerëve dhe shkruesve, për të ndërtuar besimin dhe arritjen; si dhe për të forcuar përdorimin e platformave të mediave sociale digjitale dhe për të inkurajuar në mënyrë aktive pjesëmarrjen dhe angazhimin nga shoqëria civile dhe shumëzuesit e opinionit”.¹⁰³ Ajo thekson se komunikimet duhet të synojnë të arrijnë të gjithë kosovarët, pavarësisht nga përkatësia etnike, feja, gjinia, klasa, pasuria, arsimi apo moshë. Ajo synonte të siguronte që në përfshirjen gjinore dhe sociale të përfshiheshin aktivitetet e komunikimit dhe të forconte komunikimin përmes bashkëpunimit të zgjeruar me ZBGJ.¹⁰⁴ Megjithatë, Plani i Veprimit nuk përfshinte asnjë objektiv apo tregues që lidhet posaçërisht me barazinë gjinore, si p.sh. në fushatat elektronike të ndërgjegjësimit. As nuk ishte parashikuar ndonjë buxhet për barazinë gjinore. RrGK nuk gjeti dëshmi se ishte informuar nga një VN(B)GJ. Kështu, Strategjia ishte **neutrale gjinore**.

Politika e Sektorit të Komunikimit Elektronik – Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020

Miratuar në vitin 2013, kjo politikë synonte të “përcaktonte prioritetet, objektivat dhe detyrat e zhvillimit të TIK-ut për të maksimizuar avantazhet sociale dhe ekonomike”.¹⁰⁵ Objektivat kryesore të politikës ishin: “1. zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut; 2. Të zhvillojnë dhe promovojnë përdorimin e përmbajtjes dhe shërbimeve elektronike; dhe 3. rrisin aftësinë e banorëve kosovar për të përdorur TIK-un”.¹⁰⁶¹⁰⁷ Kjo politikë nuk mori në konsideratë pozicionin e grave apo burrave në lidhje me agjendën digjitale. Për shembull, objektivi për të rritur aftësinë e njerëzve për të përdorur TIK-un nuk përmbante stimuj apo qasje të përshtatura për gratë dhe vajzat për të rritur përdorimin e tyre të TIK-ut.¹⁰⁸¹⁰⁹ Qasjes së tyre në TIK, adresimin e nevojave të tyre të ndryshme ose diskutimin e ndikimeve të mundshme të TIK-ut tek gratë dhe burrat. Kështu, politika nuk ka marrë parasysh dallimet gjinore në lidhje me TIK-un; ajo nuk mori parasysh nivelet e ndryshme të aftësive digjitale që gratë dhe burrat mund të kenë për shkak të normave dhe stereotipeve ekzistuese sociale. Prandaj, kjo politikë ishte **neutrale gjinore**. Ajo është zëvendësuar me Agjendën Digjitale 2030. RrGK nuk gjeti asnjë dëshmi për një vlerësim

102 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Integritimit Evropian, Strategjia e Komunikimit dhe Informimit në mbështetje të Procesit të Integritimit Evropian të Kosovës 2018 - 2021, 2018.

103 Po aty, Objektivi 4, f. 18.

104 Po aty, Objektivi 3, f. 16.

105 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Politika e Sektorit të Komunikimit Elektronik – [Agjenda Digjitale për Kosovën 2013-2020](#), 2013.

106 Po aty, f. 3.

107

108 Po aty, Objektivi 3.4.3.

109

ex-post të ndikimit gjinor të kësaj Agjende Digjitale 2013-2020, e cila mund të kishte informuar të renë.

Agjenda Digjitale e Kosovës 2030

Agjenda Digjitale (AD) 2030 është ndër politikat më të rëndësishme që i hap rrugën digjitalizimit në Kosovë. E miratuar në vitin 2023, kjo strategji ndërsektoriale përcakton prioritetet për “transformimin digjital të vazhdueshëm të ekonomisë dhe shoqërisë, të ndikuar nga teknologjitë inovative dhe tendencat digjitale globale”.¹¹⁰ Ajo ka pesë objektiva strategjike:

- 1) Infrastrukturë digjitale e avancuar e sigurt
- 2) Transformimi digjital i bizneseve
- 3) Digjitalizimi i shërbimeve publike
- 4) Popullsia me aftësi digjitale dhe ekosistemi inovativ i Kërkimit dhe Zhvillimit
- 5) Forcimi i ekosistemit të sigurisë kibernetike¹¹¹

Gjatë procesit të konsultimit, RrGK kërkoi të informoj draftin e AD-së me një draft të kësaj analize gjinore të digjitalizimit. Në gusht 2022, përmes platformës së konsultimit publik të Qeverisë, RrGK dha komente thelbësore mbi draftin e AD, bazuar në gjetjet fillestare nga kjo analizë. Ndër rekomandimet kryesore, RrGK theksoi mungesën e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe nevojën për të dhëna të tilla për të informuar të gjitha ndërhyrjet digjitale. RrGK gjithashtu vuri në dukje nevojën për të kryer VN(B)GJ para finalizimit të të gjitha politikave të planifikuara në draft AD. RrGK theksoi se nëse Qeveria nuk i merr parasysh dhe nuk adreson dallimet gjinore, ndërhyrjet mund të përfshijnë pa dashje paragjykimet gjinore dhe të mos adresojnë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave. Drafti i AD përfshinte një proces konsultativ.

AD synon qytetarët dhe bizneset në përgjithësi, pa marrë parasysh nevojat dhe pozicionet e ndryshme të grave dhe burrave të ndryshëm. Ai i kushton pak vëmendje avancimit të barazisë gjinore. Objektivat dhe veprimet nuk pasqyrojnë nevoja të ndryshme. As masat afirmative nuk planifikojnë të adresojnë dallimet gjinore. Ajo përfshin vetëm një tregues përkatës në objektivin strategjik 4: Popullsia e kualifikuar digjitale dhe Ekosistemi inovativ i K&ZH [Kërkim dhe Zhvillim]: “Rritja e numrit të specialistëve të TIK-ut të punësuar, me konvergencë midis grave dhe burrave”. Megjithatë, objektivat nuk janë të ndara sipas gjinisë.¹¹² Pavarësisht mundësive për

110 Qeveria, [Agjenda Digjitale e Kosovës 2030](#): Orientimi strategjik për transformimin e Kosovës në një vend të suksesshëm digjital, 2023, f. 3.

111 Po aty.

112 Po aty, f. 34.

të përfshirë masa afirmative për bizneset në pronësi të grave, objektivi strategjik 2, Transformimi Digjital i Bizneseve, nuk i ndanë objektivat sipas gjinisë.¹¹³ As objektivi specifik 2.2, Rritja e aftësive digjitale të punonjësve, nuk përfshin masa afirmative, të tilla si zberthimi sipas gjinisë së numrit të synuar të personave që do të punësohen ose trajnohen në aftësitë e TIK-ut.¹¹⁴ Në përgjithësi, AD është **neutrale gjinore** sepse gjurmon vetëm progresin në lidhje me njerëzit, individët, qytetarët, punonjësit, të trajnuarit, NVM-të dhe bizneset, në vend që të sigurojë objektiva ndërsektoriale të ndara sipas gjinisë për transformimin digjital për të arritur gra, burra dhe identifikimin e personave të tjerë.

Strategjia e E-Qeverisjes Kosova 2023-2027

Kjo Strategji fokusohet në digjitalizimin e sektorit publik drejt arritjes së vizionit të AD. Ajo ka gjashtë objektiva:

1. Të zbatohet koordinimi i E-Qeverisjes në nivele strategjike dhe operacionale
2. Kompetencat digjitale në sektorin publik janë të mjaftueshme për të zhvilluar, qeverisur dhe përdorur shërbimet digjitale publike
3. Të sigurohet arkitektura e sipërmarrjes “e gjithë qeveria”, e mbështetur nga standardet dhe korniza teknologjike
4. Shërbimet digjitale publike janë të përqendruara te përdoruesit, gjithëpërfshirëse dhe përdoren në mënyrë aktive
5. Organizatat dhe sistemet qeveritare janë elastike ndaj kërcënimeve kibernetike
6. Inovacioni i E-Government mbështetet nga partneritetet publiko-private në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar

Strategjia ka një plan veprimi përkatës me objektiva, veprime dhe tregues specifik. Asnjë nuk është i integruar gjinor, ndonëse disa tregues mund të kenë qenë, si p.sh. në lidhje me qarkullimin vullnetar të personelit të TI-së në sektorin publik dhe aplikimet për punë në TI. Sipas detyrimeve në Ligjin për Barazi Gjinore,¹¹⁵ ky objektivi (II.1) gjithashtu mund të kishte përfshirë masa të veçanta për të punësuar më shumë gra si personel të TI-së, duke pasur parasysh se ato janë të nënpërfaqësuar.¹¹⁶ Lidhur me rezultatin (IV) që “qytetarët u besojnë kanaleve digjitale dhe zgjedhin shërbimet digjitale”, është e paqartë se si do të masë qeveria “besimin” ose nëse do të marrë parasysh përgjigjet e ndryshme nga gratë dhe burrat të ndryshëm. Plani i Veprimit nuk përmend as nevojën për të mbledhur, mirëmbajtur dhe publikuar të dhëna

113 Po aty, f. 31.

114 Po aty, f. 31.

115 Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore](#), 2015, Neni 6, Masat e veçanta.

116 Informacioni i marrë në bazë të kërkesave për të dhëna të dërguara në të gjitha ministritë në Kosovë.

më të mira të ndara sipas gjinisë, megjithëse ai ka një objektiv (I.2) të vendosë politikën e informacionit dhe të dhënave në sektorin publik. Si e tillë, Strategjia e e-Qeverisjes është **neutrale gjinore**.

Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës

Kjo strategji për 2016-2020 synonte të arrinte një menaxhim të shëndoshë financiar duke përmirësuar sistemet që sigurojnë disiplinë fiskale, efikasitet operacional dhe shpërndarje efektive të burimeve publike.¹¹⁷ Ajo vuri në dukje rëndësinë e burimeve buxhetore për ofrimin e shërbimeve publike, duke shtuar

se përmirësimi i sistemit të menaxhimit të financave publike do të ndikoj në të gjitha shërbimet dhe do të përfitoj qytetarët. Metodologjia e Shpenzimeve Publike dhe Përgjegjësiwe Financiare (SHPPF) udhëhoqi hartimin e kësaj Strategjie. SHPPF është një metodologji e njohur ndërkombëtarisht për vlerësimin e performancës së menaxhimit financiar publik.¹¹⁸ Megjithatë, Strategjia është hartuar përpara se të ekzistonte Korniza Suplementare e SHPPF-s për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore (MFPPGJ).¹¹⁹ Është një grup prej nëntë treguesish që matin shkallën në të cilën sistemet e menaxhimit financiar publik të një vendi adresojnë nevojat e ndryshme të nëngrupeve të ndryshme të burrave dhe grave dhe promovojnë barazinë gjinore. Treguesi i OKB-së për QZHQ 5.c.1. gjithashtu identifikon praktikën më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor,¹²⁰ dhe

Kosova është zotuar për zbatimin e OZHQ-ve.¹²¹ Edhe pse këto nuk ekzistonin kur u hartua Strategjia dhe kështu treguesit për përmirësimin e buxhetit të përgjegjshëm gjinor nuk mund të përfshiheshin në këtë Strategji, Ligji për Barazinë Gjinore ka kërkuar buxhetim të përgjegjshëm gjinor që nga viti 2015.¹²²

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020 nuk përmbante asnjë analizë gjinore, perspektivë gjinore, objektiva apo tregues drejt barazisë gjinore apo të lidhura me digjitalizimin e sistemeve

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike 2016-2020 nuk përmbante asnjë analizë gjinore, perspektivë gjinore, objektiva apo tregues drejt barazisë gjinore.

117 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave, [Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës 2016-2020](#), 2018.

118 SHPPF, “Çfarë është SHPPF?”, qasur më 8 nëntor 2023. Duke përdorur 94 karakteristika (dimensione) në 31 komponentë kyç të menaxhimit financiar publik (treguesit) në shtatë fusha të gjera të veprimtarisë (shtylla).

119 [Korniza Suplementare](#) e SHPPF për Vlerësimin e Menaxhimit të Financave Publike të Përgjegjshme Gjinore, 2020

120 OKB, “[Metadata e treguesve të QZHQ](#)”, qasur më 8 nëntor 2023.

121 Kuvendi, [Nr. 06-R-001, Rezoluta për miratimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm](#), 2018.

122 Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore](#), 2015, Neni 5, Paragrafi 1.5

të menaxhimit të financave publike. Nuk përmendi kurrë gjininë, gratë, burrat, femrat, meshkujt apo terminologji të tjera të lidhura me barazinë gjinore. Ndërkohë, buxheti i përgjegjshëm gjinor mund të rris barazinë, transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin në menaxhimin e financave publike.¹²³ Kështu, buxheti i përgjegjshëm gjinor duhet të ishte integruar në sistemet digjitale të menaxhimit të financave publike. Strategjia është **neutrale gjinore** dhe potencialisht **negative gjinore**: duke injoruar nevojën për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, ajo mund të kontribuoj në ruajtjen e status quo-së dhe potencialisht në përforsim në vend që të adresojë pabarazinë gjinoreies.

Strategjia ka skaduar dhe RrGK nuk ka mundur të gjejë informacion në lidhje me statusin e një Strategjie të re. Procesi i krijimit të një strategjie të re ofron mundësinë për të çuar më tej barazinë gjinore duke përfshirë objektiva, tregues, veprime dhe buxhet të qartë drejt institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në sistemet e menaxhimit financiar digjital në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore. Strategjia e re duhet të bazohet në një VN(B)GJ ose në gjetjet nga një vlerësim ex-post i Strategjisë 2016-2020 duke përfshirë një vlerësim të ndikimit gjinor;¹²⁴ kjo nuk është kryer. ABGJ ka përgatitur komente për të informuar Strategjinë e re, duke përfshirë edhe ato të bazuara në SHPPF, por këto nuk janë marrë parasysh.¹²⁵

Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikimit të Integruar) 2017-2021

Kjo ishte një nga katër strategjitë kryesore lidhur me Kornizën Strategjike të Kosovës për Reformën e Administratës Publike, së bashku me Strategjinë e Rregullimit më të Mirë 2014-2020, Strategjinë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2018 dhe Strategjinë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike.¹²⁶ Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie ishte përmirësimi i sistemit të planifikimit për të shmangur fragmentimin dhe mbivendosjen në proceset e planifikimit politik dhe financiar, forcimin e administratës në përgatitjen e anëtarësimit në BE.¹²⁷ Planifikimi i integruar supozohej të përfshinte koordinimin elektronik dhe online. Pavarësisht kërkesave në Ligjin për Barazinë Gjinore për analiza gjinore për të informuar ligjet dhe politikat e reja, Strategjia dhe Plani i Veprimit, objektivat dhe treguesit e saj nuk i kushtojnë vëmendje as digjitalizimit dhe as barazisë gjinore. Strategjia është **neutrale gjinore**.

123 Për më shumë informacion, shih RrGK, [Një Udhëzues Praktik i Përdoruesit: Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Qendror](#), 2017 dhe RrGK, "Monitorimi i Implementimit të QZHQ Treguesi 5.c.1 në Kosovë", 2022.

124 Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, [Manual për Vlerësimin Ex Post të Akteve Ligjore](#), 2023.

125 Komenti i ABGJ për draft raportin, nëntor 2023.

126 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë \(Sistemi i Planifikimit të Integruar\) 2017-2021](#), 2016.

127 Po aty, f. 15.

Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike

Kjo Strategji për 2015-2020 e konsideroi prioritet rritjen e përdorimit të TIK-ut, drejt rritjes së aplikimit të qeverisjes elektronike si parakusht për modernizimin e administratës publike.¹²⁸ Ajo identifikoi sfidat kryesore në ofrimin e shërbimeve, siç është moszbatimi i mjaftueshëm i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nga ana e administratës publike; platformat elektronike nuk janë të integruara në kuadrin e ndërveprueshmërisë; shërbimet elektronike nuk janë zhvilluar mjaftueshëm; dhe mosinformimi i qytetarëve për mënyrën e realizimit të të drejtave të tyre në qasjen në shërbimet publike.¹²⁹ E analizoi qasjen dhe cilësinë e shërbimeve digjitale, por jo nga perspektiva gjinore. Strategjia theksoi rëndësinë e shërbimeve të qeverisjes elektronike dhe krijimit të “dyqan me një mori produktesh” dhe aplikacioneve online për shërbimet publike për çdo institucion në nivel qendror dhe lokal, duke rritur efikasitetin dhe duke lehtësuar qasjen për qytetarët dhe bizneset.¹³⁰ Ajo deklaroi se gjatë marrjes së shërbimeve, qytetarët do të mund të përdornin zgjidhjet e TI-së, përfshirë ato të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara, megjithëse nuk jepte tregues. Objektivi ishte që institucionet të aplikojnë një sistem elektronik për menaxhimin e burimeve njerëzore (MBNJSE) në të gjithë shërbimin civil.¹³¹

ABGJ ka dhënë komente për Strategjinë, por ato nuk janë integruar.¹³² Strategjia nuk diskutoi vështirësitë që mund të hasin gratë dhe burrat në qasjen në shërbimet digjitale dhe as nuk përmban ndonjë analizë gjinore se si dyqanet me një ndalesë do të arrijnë dhe përmirësonin shërbimet publike për gra dhe burra të ndryshëm në zonat urbane dhe rurale. Edhe pse kjo Strategji ishte pjesë e pakos së strategjive të PRA-së, e përfshirë si pjesë e kontratës IPA, e cila e konsideronte barazinë gjinore një objektivi të rëndësishëm. Kështu, kjo Strategji ishte **neutrale gjinore**, ndërsa mund të kishte përfshirë analizën gjinore dhe vëmendjen ndaj nevojave të ndryshme të grave dhe burrave në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve publike. MBNJSE mund të kishte marrë në konsideratë çështjet në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore si mbledhja, analiza dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, duke mundësuar analizën e tendencave të burimeve njerëzore; aplikimi i masave afirmative në menaxhimin e burimeve njerëzore drejt pjesëmarrjes së barabartë të grave në shërbimin civil; dhe informimi i politikave dhe programeve që mund të kontribuojnë në përmirësimin e barazisë gjinore në administratën publike. SHPPF 2022-2027 ka zëvendësuar këtë Strategji.

128 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Administratës Publike, Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020, 2015, f. 4.

129 Po aty, f. 22.

130 Po aty, f. 23.

131 Po aty, Objektivi specifik 2, f. 34.

132 Komenti i ABGJ për draft raportin, nëntor 2023.

Strategjia e Reformës së Administratës Publike 2022-2027

SPRA përcakton objektivat dhe udhëzimet për zhvillimin dhe modernizimin e administratës publike.¹³³ Ajo vëren se digjitalizimi i shërbimeve publike dhe administrative ka përparuar ngadal, mes mungesës së politikës së nivelit qendror për standardet e ofrimit të shërbimeve, koordinimit të pamjaftueshëm të qeverisë, zbatimit të dobët të legjislacionit për procedurat e përgjithshme administrative dhe harmonizimit të dobët të legjislacionit që rregullon shërbime specifike sektoriale. Strategjia i jep përparësi “rritjes së qasjes në shërbimet publike dhe shumëfishimit të kanaleve të ofrimit të shërbimeve drejt shërbimeve digjitale”.¹³⁴ Ajo planifikon standardizimin e shërbimeve publike dhe investime të mëtejshme në infrastrukturën e TIK-ut, duke përfshirë Platformën Qeveritare Gateway. Strategjia thekson se kjo do të çojë në ofrim më të mirë të shërbimeve, të mundësuar nga futja e nënshkrimit digjital dhe pagesave digjitale. Me këto plane korrespondon vetëm një tregues: “Numri i shërbimeve të sofistikuar të digjitalizuara në portalin digjital Kosovë”, i cili kishte një bazë prej 0 në 2022 dhe një objektiv prej 95% në 2027.¹³⁵ Treguesi është ambicioz, si dhe i paqartë: është e paqartë se çfarë janë “shërbimet e sofistikuar të digjitalizuara” dhe treguesi është një numër ndërsa objektivi është një përqindje. Programi i Kosovës për Reduktimin e Barrës Administrative (PRBA) planifikon një rishikim të ofrimit të shërbimeve për të informuar digjitalizimin e shërbimeve.¹³⁶ Si një program i ri qeveritar, PRBA duhet të adresojë barrierat rregullatore dhe administrative që pengojnë zhvillimin ekonomik dhe ndikojnë në kënaqësinë e përdoruesve të shërbimeve publike. PRBA parashikon krijimin e mekanizmave që parandalojnë barrierat dhe ngarkesat e reja në legjislacionin e ardhshëm bazuar në vlerësimet paraprake (ex-ante).

Çdo rishikim i ofrimit të shërbimit duhet të përfshijë një VN(B)GJ për të kuptuar barrierat që mund të hasin gra dhe burra të ndryshëm në përdorimin e shërbimeve publike digjitale. Edhe pse BE-ja kreu një analizë rajonale gjinore për të informuar RAP-in në BP disa vite më parë, ajo ende nuk është bërë publike. Ndërkohë, as PRBA dhe as Strategjia nuk përmendin në mënyrë eksplicite që vlerësimet ex-ante duhet të përfshijnë VN(B)GJ. SRAP nuk përmend gjininë, femrat, meshkujt, burra apo gra. Ajo nuk angazhohet për një qasje të përgjegjshme gjinore ndaj ofrimit të shërbimeve, të përshtatur me nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm. As nuk përfshin objektiva apo tregues për barazinë gjinore. Edhe pse e miratuar së fundmi, Strategjia me sa duket nuk iu nënshtrua një VN(B)GJ. ABGJ ka kryer analiza gjinore dhe ka dhënë rekomandime për integrimin gjinor të Strategjisë, por këto nuk janë përfshirë nga grupi punues.¹³⁷ Strategjia është **neutrale gjinore**.¹³⁸

133 Republika e Kosovës, Qeveria, MPB, [Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2022-2027](#), 2022, f. 9.

134 Po aty, Objektivi specifik 4, f. 46.

135 Po aty, f. 8.

136 Po aty, f. 46.

137 ABGJ, koment për draft raportin, nëntor 2023.

138 Po aty.

Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022

ZKM mbikëqyr statistikën përmes ASK-së, e cila e kryen punën e saj bazuar në metodologjitë e Eurostat-it. Ky Program përcakton prioritetet për Sistemin Statistikor bazuar në Ligjin për Statistikat Zyrtare.¹³⁹ Ajo kishte dy objektiva të lidhura me gjininë: të përdorte tregues shtesë socio-ekonomik për analizën gjinore dhe të rriste përdorimin e treguesve kyç si gjinia dhe mosha në vlerësimin e numrit të banorëve në Kosovë. Asnjë të dhënë brenda saj, përveç statistikave sociale, nuk kërkonte të dhëna të ndara sipas gjinisë. Programi ritheksoi se ASK ka disa sisteme të e-Qeverisjes, si për ndjekjen e punës, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e pagesave, evidentimin dhe kontrollin e mjeteve financiare, arkivimin elektronik të dokumenteve administrative dhe furnizimin me materiale zyre.¹⁴⁰ ASK ka qindra baza të të dhënave, regjistra elektronik, kopje rezervë në server të ndryshëm dhe aplikacione dhe sisteme të avancuara të TI-së. Në këtë program, ASK-ja i ka dhënë prioritet përmirësimit të kapaciteteve të infrastrukturës së TI-së për platformën PXWeb, e njohur edhe si Platforma e të Dhënave ASK. Ndërsa ASK Data ka nevojë për të dhëna në kohë, ndërseksionale, të ndara sipas gjinisë, Programi nuk e parashikoi këtë në mënyrë eksplicite.

Lidhur me Statistikat e Biznesit, ASK ka planifikuar të administroj një anketë të re për TI dhe TIK në biznese.¹⁴¹ Është e paqartë nëse anketa do të përfshij një perspektivë gjinore. Për Statistikat e Standardeve të Jetesës, ASK parashikoi zhvillimin e një ankete të TIK duke përdorur Intervistat Personale të Asistuar nga Kompjuteri (IPAK).¹⁴² Prezantimi i kësaj mund të ketë implikime të lidhura me gjininë, por këto nuk u morën parasysh në Program. Ndërsa referencat ndaj të dhënave të ndara sipas gjinisë ishin të **përgjegjshme gjinore**, ekzistonin vetëm disa referenca të tilla; pjesa më e madhe e programit ishte **neutrale gjinore**.

Përveç Raportit Vjetor të ASK-së 2021,¹⁴³ RrGK nuk mundi të gjente ndonjë vlerësim të zbatimit të Programit për të shqyrtuar nëse ai përfshinte analizën e ndikimit gjinor. Meqë ky Program ka skaduar, ekzistojnë mundësi për të kryer një vlerësim ex-post të ndikimit gjinor, veçanërisht në lidhje me prezantimin e IPAK, duke analizuar rezultatet e lidhura me gjininë dhe nevojat për të informuar Programin e ri.

PKZMSA 2022-2026

Ky është programi i gjashtë për zbatimin e MSA-së ndërmjet BE-së dhe Kosovës. Ai duhet të zbatohet në lidhje me Planin e Veprimit ARE II, i cili përmbledh prioritetet politike të dakorduara ndërmjet BE-së dhe Kosovës.¹⁴⁴ Prandaj,

139 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ASK, Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022, 2017, f. 6.

140 Po aty, p. 18.

141 Po aty., Nënobjektivi 1.3.

142 Po aty., Nënobjektivi 1.2.

143 Qeveria e Republikës së Kosovës, ZKM, ASK, [Raporti Vjetor 2021](#).

144 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit \(PKZMSA\) 2022-2026](#), 2022.

është në harmoni me Planin e Veprimit ARE II, Programin e Qeverisë 2021-2025 dhe Planet Strategjike dhe Operative të ZKM-së. Sa i përket digjitalizimit dhe qeverisjes, vëren se MPB me sukses themeloi Rrjetin Kombëtar (platforma eKosova), duke përfshirë të gjithë administratën qendrore dhe lokale dhe një Qendër të të dhënave shtetërore.¹⁴⁵ PKZMSA vë në dukje se po zhvillohen plane për futjen e moduleve të reja, si dhe për të siguruar modernizimin e vazhdueshëm të administratës publike përmes mirëmbajtjes së vazhdueshme, investimeve në shërbime, përafrimit me kërkesën në rritje për shërbime elektronike, avancimeve teknologjike dhe masave të shtuara të sigurisë. Bazuar në kërkesat e MSA-së dhe Raportit të KE-së për Kosovën 2022, Programi parasheh avancimin e qeverisjes elektronike për të rritur efektivitetin dhe transparencën e shërbimeve publike; zhvillimin e portalit shtetëror të shërbimeve online, ofrimin e këtyre shërbimeve për qytetarët, bizneset dhe nëpunësit publik dhe integrimin e shërbimeve të tjera të ofruara nga institucionet në portal; dhe rritjen e transparencës ndaj publikut duke publikuar të dhënat e institucioneve.¹⁴⁶ PKZMSA parashikon zhvillimin e një sistemi statistikor efektiv dhe të qëndrueshëm që mund të “sigurojë të dhëna të besueshme, objektive dhe të sakta, të cilat janë të krahasueshme me statistikat evropiane dhe që nevojiten për të planifikuar dhe monitoruar proceset e tranzicionit dhe reformës”.¹⁴⁷ Më tej, ai planifikon të “krijoj një sistem monitorimi për zbatimin e Ligjit për Barazinë Gjinore”, si dhe të miratojë një strategji të re kundër dhunës në familje dhe të zbatoj VN(B)GJ, të cilat mund të përfshijnë digjitalizimin e këtyre sistemeve edhe pse nuk është kështu. thuhet në mënyrë eksplicite.¹⁴⁸

PKZMSA nuk përmend se është bërë ndonjë analizë gjinore për të informuar dizajnin e saj. Ligji për Barazinë Gjinore nuk përmendet si pjesë e kornizës ligjore relevante për Administratën Publike. PKZMSA përdor shprehjen “zbatimi i parimeve të barazisë gjinore” por nuk përcakton se çfarë nënkupton kjo në kontekstin e PRA. PKZMSA nuk i referohet në mënyrë eksplicite nevojës që qeveria dhe administrata publike të mbledhin dhe raportojnë statistika të ndara sipas gjinisë dhe as përdorimit të infrastrukturës digjitale të përgjegjshme gjinore në mbledhjen dhe raportimin transparent të statistikave dhe të dhënave institucionale, pavarësisht kërkesave në Ligjin për Barazinë Gjinore. . Prandaj, veprimet e PKZMSA-së në lidhje me digjitalizimin, duke përfshirë qeverinë, administratën publike dhe statistikat, janë **neutrale gjinore**.

PKZMSA ka raporte monitorimi tremujore dhe vjetore. Raporti i PKZMSA 2021 përmendi aktivitete të lidhura me gjininë që i konsideronte të zbatuara, por asnjë nuk lidhej në mënyrë eksplicite me digjitalizimin.¹⁴⁹ Këto aktivitete

145 Po aty, f. 26.

146 Po aty, Objektivat prioritare afatmesme, f. 27.

147 Po aty, f. 158.

148 Po aty.

149 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Raport mbi zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit \(PKZMSA\) gjatë vitit 2021, 2022](#), f. 66.

mund të kishin integruar vëmendjen ndaj digjitalizimit, si për shembull duke përfshirë ndërtimin e kapaciteteve të mekanizmave institucional për dhunën kibernetike me bazë gjinore ose mbështetjen e fuqizimit ekonomik të grave përmes projekteve dhe pajisjeve të lidhura me TIK-un. Fushatat ndërgjegjësuere mund të kenë përfshirë vëmendjen se si stereotipet gjinore mund të lidhen me dhunën në internet. Raporti i monitorimit të PKZMSA 2022 përmend gjininë që lidhet me të njëjtat aktivitete si raporti i vitit 2021. Ai nuk raporton për asnjë veprim në lidhje me gjininë dhe digjitalizimin. Në raportin e vitit 2022 thuhej se janë zbatuar reforma në lidhje me “dokumentet procedurale për menaxhimin e burimeve njerëzore, digjitalizimin e menaxhimit të burimeve të tilla dhe uljen e barrës administrative nëpërmjet reduktimit dhe digjitalizimit të lejeve dhe licencave”. Reagimi gjinor i reformave të menaxhimit të burimeve njerëzore ishte i paqartë.

Në përgjithësi, duke pasur parasysh mungesën e objektivave, treguesve dhe objektivave të përgjegjshme gjinore të PKZMSA-së në lidhje me digjitalizimin e qeverisë, administratës publike dhe statistikave, është e vështirë të monitorohet progresi drejt avancimit të barazisë gjinore. Përsëritjet e ardhshme të PKZMSA-së mund ta trajtojnë këtë duke përfshirë më shumë objektiva dhe tregues të përgjegjshëm për gjininë, të identifikuar bazuar në VN(B)GJ ose një analizë gjinore të përditësuar çdo vit.

Programi i Reformës Ekonomike

Që nga viti 2015, të gjitha vendet kandidatë në BE dhe kandidatët potencial janë të detyruar të përgatisin PRE.¹⁵⁰ PRE 2023-2025 planifikon të digjitalizoj shërbimet administrative (lejet) në tetë ministri dhe ZKM-në drejt “përmirësimit të mjedisit për të bërë biznes duke ulur barrën administrative dhe duke reformuar inspektimet”.¹⁵¹ Masa planifikon të ndikoj në investime, duke stimuluar rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. PRE gjithashtu planifikon të zgjeroj “Infrastrukturën dhe shërbimet e TIK-ut për zhvillimin socio-ekonomik, shërbimet e avancuara publike, si dhe digjitalizimin e sistemit arsimor”, duke përfshirë ASHI që zhvillon më tej Platformën eKosova, aplikimin e pagesave elektronike, zgjerimin e Platformës Interaktive/ Interoperabilitetit.¹⁵² Këto aktivitete janë në vazhdimësi, por digjitalizimi i shërbimeve publike përmes eKosova nuk ka përfshirë deri më sot perspektivën gjinore.¹⁵³ PRE planifikon

RE 2023-2025
planifikon të
digjitalizoj shërbimet
administrative (lejet)
në tetë ministri .

150 KE, Politika Evropiane e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR), “Qeverisja ekonomike”, qasur më 8 nëntor 2023.

151 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike \(PRE\) 2023-2025](#), 2023, Masa e Reformës 6, Aktiviteti 2. Këtu përfshihen MPB, Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural (MBPZHR), Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, dhe Inspektimet (MMPHI), Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, MASHT, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ASHI. Synon digjitalizimin e 50 shërbimeve në 2023 dhe 250 në 2024.

152 Po aty, Masa e Reformës 10.

153 Bisedat e RrGK me ASHI, 2023.

që një Projekt për Forcimin e Qeverisjes Digjitale të financuar nga Banka Botërore do të mbështesë transformimin digjital, duke përfshirë përmirësimin e aftësisë së qeverisë për të adresuar rreziqet e mundshme digjitale, digjitalizimin e shërbimeve publike në lidhje me ciklin jetësor të qytetarëve për të reduktuar barrën administrative dhe zhvillimin e ndërtimit të kapaciteteve dhe një qendër inovacioni në AIP. Ndërsa një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social ishte kryer për të informuar Projektin, RrGK nuk gjeti dëshmi të një VN(B)GJ.¹⁵⁴ PRE planifikon të ndikoj pozitivisht në punësimin duke “zgjeruar mundësitë për punë digjitale, me fokus të veçant tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara”.¹⁵⁵ Është e paqartë se si masa do të arrijë tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara pasi që nuk ekzistojnë tregues përkatës. Në përgjithësi, në lidhje me qeverisjen digjitale, PRE përmend gjininë, por nuk adreson qartë pabarazitë gjinore dhe kështu është **i ndjeshëm gjinor**, por jo i përgjegjshëm gjinor.

Strategjia e Vetëqeverisjes Lokale 2016-2025

Kjo Strategji synon të ofroj shërbime më të mira komunale dhe të rris cilësinë e jetës së qytetarëve, duke përfshirë “rritje të kapaciteteve profesionale dhe infrastrukture” në TI dhe digjitalizimin e shërbimeve administrative.¹⁵⁶ Ajo vëren se vetëqeverisja lokale do të duhet të përshpejtoj reformat e shërbimeve elektronike në dekadën e ardhshme.¹⁵⁷ Strategjia nuk ofron baza, tregues apo objektiva drejt objektivave të saj. Gjinia nuk përmendet, dhe i mungon analiza gjinore, edhe pse kjo mund të ketë informuar Strategjinë, si për shembull se sa gra dhe burra të ndryshëm në nivel lokal mund të përballen me pengesa në qasjen e shërbimeve digjitale. Kështu, Strategjia është **neutrale gjinore**. Strategjia thekson se një ekip profesionistësh do të jen përgjegjës për monitorimin periodik dhe vjetor, vlerësimin dhe raportimin mbi zbatimin, përfshirë edhe ndikimin. Kjo mund të përfshijë analizën e ndikimit gjinor. Megjithatë, RrGK nuk gjeti ndonjë raport të tillë në internet për ta vlerësuar këtë.

Strategjia për Rininë 2019-2023

Kjo Strategji synon të përmirësoj situatën e të rinjve të moshave 15 deri në 24 vjeç.¹⁵⁸ Ajo gjithashtu synon të inkurajoj bashkëpunimin ndërmjet organizatave rinore, si dhe ndërmjet organeve qendrore dhe komunale për të forcuar politikat dhe programet rinore.¹⁵⁹ Strategjia përfshin disa referenca të pakta për TI. Ajo planifikon trajnime për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, kërcënimet nga interneti, terrorizmi dhe kërcënime të tjera që minojnë

154 Banka Botërore, “Forcimi i qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve”, “Dokumentet e projektit”, qasur më 7 nëntor 2023.



- a) Buxheti: kompanitë kanë dhënë më shumë projekte në bazë të vlerës totale
- b) Shoqëria: shoqëritë që kanë nënshkruar më shumë kontrata
- c) Institucioni/Kompania: kompanitë që kanë marrë më së shumti projekte bazuar në një kombinim të institucionit që siguron financimin dhe kompanisë.³⁵⁰

Këto komponente nuk ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë, megjithëse të dhëna të tilla do të lehtësonin kuptimin e masës në të cilën gratë dhe burrat kanë përfituar nga kontratat qeveritare ose se si kontratat mund të kenë kontribuar në barazinë gjinore.

Platforma të ndryshme joqeveritare online (ri)publikojnë tenderët dhe njoftimet e prokurimeve. Për shembull, Portali i Transparencës së Prokurimit të Hapur drejtohet nga OSHC Lëvizja FOL financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky portal i hapur prokurimi synon të rris transparencën e shpenzimeve publike.³⁵¹ Duke qenë se informacioni në lidhje me procedurat e prokurimit mund të jetë i kufizuar, palët e interesuara, qytetarët dhe bizneset mund të përdorin fjalë kyçe për të kërkuar njoftimet e prokurimit.

MPB ka publikuar online informacione minimale për financimin dhe prokurimin. Nën domenin e saj të internetit për Administratën Publike, OJQ-të

347 Instituti PVGJ, [Indeksi i Transparencës së Buxhetit të Komunës 2022](#), 2023.

348 UN, "[Meta të dhënat e treguesit të QZHQ](#)", qasur më 8 nëntor 2023.

349 *Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik* [uebfaqe](#), 2023, qasur më 10 nëntor 2023.

350 Po aty.

351 FOL, "[Prokurimi i hapur](#)", 2023, qasur më 10 nëntor 2023.

mund të aplikojnë për financim online nga qeveria që nga viti 2016.³⁵² OJQ-të mund të regjistrohen online, duke ngarkuar të dhëna dhe dokumente të kërkuara. Ndërkohë, kategoria e portalit të Open Data e menaxhuar nga ASHI për “Prokurim” nuk ka të dhëna të disponueshme.³⁵³ EKosova ofron mundësinë që bizneset të aplikojnë online për subvencione dhe grante, siç shtjellohet në kapitujt e mëvonshëm.³⁵⁴ Sipas zyrtarëve, procesi i aplikimeve është i lehtë, pasi portali përmban tashmë të dhëna personale të përdoruesve të regjistruar; bizneset thjesht ngarkojnë të dhëna dhe dokumente kur aplikojnë.³⁵⁵ Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë në MBPZHR ofron aplikime online për grante dhe subvencione për bujqësi për fermerët, bizneset dhe bizneset e reja.³⁵⁶ AKIN në MIST ofrojnë një platformë të quajtur “Biznesi Im” me shërbime digjitale që mbështesin sipërmarrjet, si për shkrimin e propozimeve të biznesit, projekt propozimeve dhe vetëvlerësimeve.³⁵⁷ Në fund të vitit 2023, Biznesi Im kishte 487 përdorues.³⁵⁸

Ligji për Prokurimin parasheh marrjen në konsideratë të kritereve që lidhen me barazinë gjinore në proceset e prokurimit. Autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që kontraktorët të “sigurojnë kushte të caktuara të punës, mbrojtjen e mjedisit dhe të marrin në konsideratë objektivat sociale, të tilla si detyrimi për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masa që synojnë të promovojnë barazinë ose diversitetin gjinor për arsye të tjera”.³⁵⁹ Megjithatë, bisedat e RrGK-së me zyrtarët sugjeruan se ato rrallëherë përfshijnë kritere të lidhura me gjininë në proceset e prokurimit qeveritar, me përjashtim të disa subvencioneve bujqësore.

Asnjë nga platformat e prokurimit elektronik të diskutuara këtu nuk duket se është përshtatur me nevojat e përdoruesve të ndryshëm gra dhe burra. Nuk kishte asnjë informacion se sa të **vetëdijshëm** janë gratë dhe burrat për këto platforma të prokurimit digjital ose nëse i kanë përdorur ato. As nuk u publikua ndonjë informacion që demonstronte shkallën në të cilën zyrtarët përdorën masa afirmative të përgjegjshme gjinore gjatë proceseve të prokurimit digjital. Që nga viti 2021, zyrtarët e financave në përgjithësi nuk kishin njohuri për dispozitat përkatëse në ligjet për barazinë gjinore dhe prokurimin dhe si rrjedhim u mungonin **aftësitë** për organizimin e proceseve të prokurimit digjital të përgjegjshëm ndaj gjinisë.³⁶⁰

352 MPB, “Sistemi Elektronik i Organizatave Joqeveritare”, 2023, qasur më 10 nëntor 2023.

353 Republika e Kosovës, “Open Data”, uebfaqe, 2018, qasur më 10 nëntor 2023.

354 Shihni kapitujt mbi Biznesin dhe Tregtinë dhe Bujqësinë.

355 Intervistë e RrGK, nëntor 2021.

356 Republika e Kosovës, MBPZHR, uebfaqe, “Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë”, 2023.

357 AKSES/AKIN, *Biznesi Im* [në shqip dhe serbisht], 2023.

358 Po aty, qasur më 10 nëntor 2023.

359 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës](#), 2016, neni 31.

360 RrGK, “Pandemia nuk njeh gjini?”, 2020.

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën është e disponueshme infrastruktura gjinore për digjitalizim dhe me mbrojtje adekuate në Kuvend, Qeveri, administratë publike dhe popullatë. Kjo përfshin infrastrukturën e lidhjes, mjetet digjitale, softuerin dhe një ekosistem që nxit inovacionin digjital.

Lidhshmëria

Pas luftës në Kosovë, infrastruktura e teknologjisë digjitale në Evropën Juglindore ishte “e pazhvilluar” dhe më pak se 5% e njerëzve kishin internet.³⁶¹ Tani sa i përket **infrastrukturës së lidhjes**, 99% e kosovarëve janë të kyçur në rrjetin elektrik dhe kanë internet.³⁶² E njëjta përqindje e grave dhe burrave, 97%, lidhen me Wi-Fi; 48% e grave dhe 50% e burrave, lidhen me LTE/3G/4G; dhe 41% e grave dhe 47% e burrave lidhen me internet kabllor.³⁶³

Mjete dhe sofuer digjital

Jo të gjitha gratë dhe burrat, përfshirë ata që punojnë në institucione publike, kanë **qasje** në kompjuter, tableta dhe telefona inteligjent, siç shtjellohet në seksionin vijues. Kuvendi dhe Qeveria kanë disa forma të **softuerit**, siç u përmend. Kuvendi ka zhvilluar platformën e-Parlament, e cila përfshin një sistem të brendshëm të menaxhimit të shërbimeve.³⁶⁴ Edhe pse kuadri ligjor parashikon votim elektronik, Kuvendi nuk ka një sistem të digjitalizuar votimi.³⁶⁵ Sistemi i votimit thuhet se ka dështuar të funksionoj për më shumë se tre vjet. Deputetëve u mungojnë kartat elektronike të identifikimit për gjurmimin e pranisë ose mungesës së tyre gjatë seancave parlamentare. Një sistem i digjitalizuar mund të lehtësoj analizën gjinore të frekuentimit të deputetëve dhe modeleve të votimit, duke mundësuar një transparencë të përmirësuar të punës së tyre. Edhe pse Kuvendi ka një faqe interneti që transmeton drejtpërdrejt seancat plenare dhe thotë se këto seanca zakonisht arkivohen,³⁶⁶ seancat nuk janë të disponueshme në faqen zyrtare të Kuvendit. Si të tilla, ato nuk mund të përdoren për të shqyrtuar angazhimet e deputetëve ose gjuhën e përdorur gjatë seancave plenare. Një nismë e pavarur ka publikuar transkriptet e sesioneve plenare të Kuvendit nga viti 2007 deri në mars 2023.³⁶⁷ Ndërveprimi me këto grupe të dhënash është i disponueshëm në çdo gjuhë, duke mundësuar qasje për njerëz të ndryshëm.

361 Këshilli i Evropës, “Strategjitë Teknologjike për Rindërtimin dhe Zhvillimin Ekonomik të Evropës Juglindore”, Komiteti për Shkencën dhe Teknologjinë, Këshilli i Evropës, 2000.

362 UNDP, *Anketa Digjitale e Familjeve*, 2022.

363 UNDP, *Anketa Digjitale e Familjeve*, 2022.

364 Korrespondenca e RrGK me IKD, 22 gusht 2023.

365 Gazeta Blic, “Nuk punon sistemi i digjitalizuar i Kuvendit, ankohen deputetët”, Qershor 2023, qasur më 2 shtator 2023.

366 Kuvendi i Republikës së Kosovës, “Rregullorja për rendin dhe qasjen e mediave dhe publikut në punën e Kuvendit”, rregulli 17, “Uebfaqja në internet”.

367 Kushtrim Visoka, “Dataset, Transkriptimet e Kuvendit të Kosovës”, 2020, qasur në gusht 2023.

Sistemet e qeverisjes elektronike ekzistojnë për ndjekjen e punës, menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e pagesave, evidentimin dhe kontrollin e mjeteve financiare, arkivimin elektronik të dokumenteve administrative dhe furnizimet e zyrës.³⁶⁸ Platforma eKosova ofron shërbime online. Sipas UNDP-së, Qeverisë i mungon “softueri për të regjistruar, manipuluar dhe krijuar raporte automatike mbi të dhënat, ku softueri dhe proceset e duhura për mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave pengojnë aftësinë e institucioneve për të digjitalizuar punën institucionale”.³⁶⁹ ASK nuk duket se ka infrastrukturën për portretizimin interaktiv, të qashtëm dhe të kuptueshëm të statistikave, megjithëse është bërë njëfarë progresi me Platformën ASK. Softueri i qeverisjes elektronike ka mundësi për përmirësim në lidhje me përgjegjshmërinë e tij gjinore dhe llojet e të dhënave që ai mbledh, ruan, analizon dhe prezanton vizualisht në mënyra kuptimplota për gratë dhe burrat e ndryshëm. Qeveria nuk i mirëmban në mënyrë aktive të gjitha faqet e internetit, duke kontribuar në të dhëna të padisponueshme për punën e institucioneve dhe humbje të mundshme të të dhënave.³⁷⁰ Qeverisë gjithashtu i mungon infrastruktura për ruajtjen e të dhënave dhe të dhënat ruhen në kompjuter personal, gjë që mund të shkaktojë humbje të të dhënave³⁷¹ dhe shqetësime për sigurinë.

ASHI vuri në dukje se mekanizmat e **mbrojtjes së të dhënave** të përfshira në këtë infrastrukturë janë në përputhje me politikat e BE-së dhe mbledhen vetëm informacionet personale që lidhen me ofrimin e shërbimeve publike.³⁷² Nevojiten kërkime të mëtejshme nëse infrastruktura harduerike dhe softuerike **ofrojnë mbrojtje** adekuate për sa i përket privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave të përshtatura me nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm.

Sa i përket administratës publike, qeverisja elektronike përfshin sisteme të TI-së që krijojnë mundësi për shërbime publike më të mira, më të shpejta dhe në kohë.³⁷³ Sistemi i telekomunikacionit të TI-së shtrihet në të gjithë Kosovën dhe lidh më shumë se 500 ndërtesa institucionale qendrore dhe lokale, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën publike.³⁷⁴

Infrastruktura e rrjetit shtetëror përbëhet nga një rrjet optik, Wi-Fi dhe RrPV.³⁷⁵ Në prill të vitit 2022, administrata publike publikoi Kornizën e Ndërveprueshmërisë së Republikës së Kosovës. Bazuar në Kornizën Evropiane të Ndërveprimit, termi “ndërveprim” nënkupton: “aftësinë e organizatave të ndryshme për të bashkëvepruar drejt qëllimeve të përbashkëta të dakorduara

368 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ASK, Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022, 2017, f. 18.

369 UNDP, [Mbledhja e hartave të të dhënave për zhvillim/Zgjerimi i kapaciteteve institucionale për përdorimin e të dhënave në Kosovë](#), f. 25.

370 Po aty.

371 Po aty.

372 Intervistë e RrGK, 2021.

373 Republika e Kosovës, Administrata Publike, “E-Qeverisja”, 2023, qasur më 10 nëntor 2023.

374 Po aty.

375 Po aty.

reciprokisht, duke përfshirë ndarjen e të dhënave, informacionit dhe njohurive, nëpërmjet proceseve të biznesit që ato mbështesin dhe përdorin sistemet e TIK-ut”. Kuadri synon të krijoj sisteme të reja informacioni shtetëror të orientuara drejt qytetarëve për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve.³⁷⁶ Sistemet e menaxhimit të informacionit janë planifikuar të integrohen në të gjithë administratën publike drejt pasurimit dhe thjeshtimit të ofrimit të shërbimeve.

Aktualisht, administrata publike ka disa shërbime, duke përfshirë Qendrën e Sistemeve, të krijuar nga ish-Ministria e Administratës Publike për komunikimin përmes postës elektronike zyrtare, internetit, domeneve dhe nën-domeneve institucionale, sigurinë e TI-së, komunikimet me Protokollin

“Kur flasim për gjininë, të gjithë e dinë se është e rëndësishme, por nuk është se po e bëjmë siç duhet. [...] Ndoshta është sepse ne po i bëjmë gjërat në mënyrën siç i kanë bërë të tjerët deri tani.”

- Përkrahës i digjitalizimit në Kosovë

Voice over të Internetit (PIVo) dhe video-konferenca, hostimi i faqeve zyrtare të internetit dhe menaxhimi i rrjetit shtetëror.³⁷⁷ Ndërkohë, MPQM raportoi progres të kufizuar në digjitalizimin e shërbimeve miqësore për përdoruesit.³⁷⁸ Mundësues të rëndësishëm si nënshkrimi digjital dhe zgjidhjet e pagesave elektronike nuk janë të disponueshme dhe planet për krijimin e dyqaneve me një ndalesë ishin prapa planit në 2021.³⁷⁹

Asnjë nga këto infrastruktura nuk duket se është shqyrtuar nga perspektiva gjinore. Korniza e Ndërveprueshmërisë nuk merr parasysh dallimet gjinore, siç janë masat për të reduktuar barrën administrative. Miqësia ndaj përdoruesve të platformave online nuk bazohet në të dhënat e ndara gjinore të përdoruesve. ASHI nuk ka ruajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë për përdoruesit.³⁸⁰ Në përgjithësi, intervistat sugjeruan se zhvillimi i infrastrukturës digjitale në

Kosovë duket se nuk e ka marrë parasysh gjininë ose nuk është bazuar në analizën gjinore. Një pjesëmarrës në hulumtim që kishte mbështetur Qeverinë në zhvillimin e sistemeve të digjitalizuara reflektoi:

[Qeveria] kishte tashmë sistemin bazë në vend, dhe ne thjesht përdorëm fjalët që ata kishin dhe shtuam fjalë për më shumë module. [...] Ne me të vërtetë nuk kishim kohë as të mendonim për këto elemente të rëndësishme pasi duhej t'i projektonim dhe funksionalizonim këto sisteme nën kufizimet kohore.

376 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Administratës Publike, Korniza e Ndëroperabilitetit të Republikës së Kosovës, p.d.

377 Po aty.

378 BE, MPQM dhe OBZHE, [Raporti i Monitorimit: Parimet e Administratës Publike: Kosovë, 2021](#), f. 115

379 Po aty. Për më shumë informacion rreth dyqaneve me një ndalesë, shihni Kapitullin Biznes dhe Tregti.

380 Intervistë e RrGK, 2021.

Fatkeqësisht, ne punojmë në bazë të projektit dhe nëse afati kalon dhe ne nuk e kemi dorëzuar, nuk është mirë për organizatën apo projektin. Pra, ne ndonjëherë i shtyjmë gjërat. Nuk është gjithmonë e mundur [të konsiderosh gjithçka], veçanërisht nëse ekziston një sistem ekzistues për të ndërtuar. Ajo që ju kërkoni është një ridizajnim i të gjithë sistemit për të cilin ne dhe ndoshta Ministria nuk kemi para. Në këto kushte bëjmë më të mirën. [...] Kur flasim për gjininë, të gjithë e dinë se është e rëndësishme, por nuk është se po e bëjmë siç duhet. [...] Ndoshta është sepse ne po i bëjmë gjërat në mënyrën që të gjithë i kanë bërë gjithmonë. Gjithashtu, mendoj se kuptimi i përgjithshëm është se ne kemi kaq shumë probleme të tjera sa kjo [vëmendja ndaj gjinisë] nuk arrin askund. Siç thashë, ligjet nuk vlerësohen [për ndikimin e tyre gjinor], aq më pak nisma të tjera.³⁸¹

Kufizimet kohore dhe sistemet e trashëgimisë duket se kanë kontribuar në forcimin e status quo-së, e cila mund të jetë neutrale gjinore apo edhe negative gjinore. Institucionet publike kanë tendencë të përdorin gjininë (grua/burrë) ose seksin (mashkull/femër) në modulet online dhe shërbimet digjitale.³⁸² Mbi faktin nëse “tjetri” duhet të shtohet si kategori për personat që nuk identifikohen si një nga këto kategori binare duket se nuk ka hyrë kurrë në diskutim. Gjinia duket se nuk është konsideruar si një prioritet, madje as si e rëndësishme, për zhvillimin e infrastrukturës digjitale.

Përdorimi i infrastrukturës digjitale për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore, duke përfshirë mjetet digjitale si IPNK dhe Intervistimi i Ueb-it me ndihmën e kompjuterit (UINK), është relativisht i ri në Kosovë. Në Raportin e saj Vjetor 2021, ASK-ja vuri në dukje përparime në teknologjitë dhe metodologjitë e reja për mbledhjen e të dhënave përmes metodave IPNK dhe UINK.³⁸³ ASK raportoi përdorimin e IPNK për herë të parë në Anketën e Fuqisë Punëtore 2021 dhe iu referua planeve për përdorimin e këtyre mjeteve digjitale në anketa të tjera statistikore. ASK vërejtë se adoptimi i metodave IPNK dhe UINK ka paraqitur sfida “duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara të ASK-së, më pas për shkak të shqetësimeve rreth kostos së pajisjeve dhe ekspertizës, riorganizimit të proceseve statistikore dhe trajnimeve, cilësisë së teknologjisë, mungesës së internetit, lidhja e pajisjeve të dorës, kapacitetet njerëzore dhe rezistenca ndaj ndryshimeve.”³⁸⁴ Megjithatë, ASK-ja vuri në dukje se “shumica e anketave janë kryer me sukses duke përdorur metodat IPNK dhe UINK, duke përfshirë një anketë mbi dhunën me bazë gjinore.”³⁸⁵ Një infrastrukturë e tillë

381 Intervistë e RrGK, 2023.

382 E njëjta gjë duket se ka ndodhur edhe me termin “nacionalitet”, i cili shfaqet, ndonëse i gabuar, në kuadrin ligjor dhe praktikat e institucioneve. Kombësia i referohet statusit kombëtar të njerëzve: vendi ku ata kanë shtetësinë. Shumica e njerëzve në Kosovë kanë shtetësi si kosovarë, përveç serbëve që jetojnë në veri të Kosovës, të cilët mund të kenë shtetësi serbe ose shtetësi të dyfishtë. Zakonisht në forma, institucionet duhet të kërkojnë të mbledhin të dhëna për “etnicitetin”, që i referohet grupit etnik me të cilin identifikohet një person.

383 Qeveria, ZKM, ASK, Raporti Vjetor 2021.

384 Po aty, f. 23.

385 Po aty.

mund të mbështes hapësira më të sigurt dhe konfidenciale për gratë dhe burrat që të raportojnë informacione të ndjeshme, si dhuna. Një infrastrukturë e tillë varet nga përdoruesit që kanë njohuri dhe kapacitete të mjaftueshme për të kuptuar pyetjet dhe për përdorimin e pajisjeve. Përndryshe, ato mund të kontribuojnë në të dhëna të pasakta.

Ekosistemi i inovacionit

Një **ekosistem inovativ** është një mjedis i favorshëm për kreativitetin dhe inovacionin në lidhje me digjitalizimin. Qeveria, sektori privat dhe OSHC-të kanë punuar për të zhvilluar ekosistemin e inovacionit në Kosovë, drejt mbështetjes dhe promovimit të ndërmarrësisë. AKTIK, QIK dhe AKIN kanë organizuar rrjetëzimin midis sektorit privat, OSHC-ve, dhomave ekonomike dhe investitorëve për të mbështetur zhvillimet bashkëpunuese dhe idetë inovative. Kosova ka parë një numër në rritje të startup-eve, inkubatorëve dhe përshpejtuesve, veçanërisht në sektorin e teknologjisë.³⁸⁶ QIK i konsideroi startup-et si akterët kryesorë në ekosistem të fokusuar në inovacion dhe metoda të reja, së bashku me Qeverinë, qendrat kërkimore, inkubatorët, përshpejtuesit, korporatat dhe investitorët.³⁸⁷ Edukimi që lehtëson kulturën e inovacionit gjithashtu u theksua nga pjesëmarrësit në hulumtim si thelbësor.³⁸⁸

Inkubatori QIK ofron një mjedis për komercializimin e ideve të qëndrueshme të biznesit, si dhe shikueshmëri në treg për kompanitë e reja dhe ekzistuese, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve të zonës sociale (p.sh., zona e ngjarjeve të QIK, prezantime biznesi, forume dhe konferenca).³⁸⁹ Parku i Inovacionit dhe Trajnimit (PIT) i lançuar së fundmi në Prizren premtan të jetë “lokacioni më unik në rajon, që nxit bashkëpunimin në një komunitet më të gjallë, duke synuar të bëhet qendër rajonale për inovacionin e sipërmarrjes, biznesin dhe zhvillimin e aftësive, dhe një burim i ideve novatore dhe të suksesshme”.³⁹⁰ PIT Prizren synon të krijoj stimuj për të nxitur ekosistemin inovativ të Kosovës duke lidhur njerëzit, duke përmirësuar performancën e tyre dhe duke krijuar profile të punësimit dhe grupe aftësish në përputhje me kërkesat e tregut.³⁹¹ PIT ka një shërbim autobusi udhëtarësh për vizitorët, studentët dhe punonjësit. Faqja e tyre e internetit ka pak informacion mbi përfshirjen e grave dhe burrave të ndryshëm në aktivitete, si studentë, të trajnuar ose vizitorë.

Kishte pak informacion në dispozicion për reagimin gjinor të ekosistemeve të inovacionit. Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë për përfituesit e ekosistemeve të inovacionit e bëri të vështirë vlerësimin e përfshirjes së tyre gjinore. QIK ka vërejtur dallime në **qasje** për shkak të boshllëqeve të aftësive, infrastrukturës së pamjaftueshme dhe kushteve më të gjera socio-

386 Intervistë e RrGK me QIK, 2022.

387 Korrespondenca e RrGK me QIK, 2022.

388 Intervistat e RrGK, 2023.

389 ICK, “Shërbimet e inkubatorit”, qasur më 10 nëntor 2023.

390 [Parku i Inovacionit dhe Trajnimit Prizren](#), qasur më 10 nëntor 2023.

391 Po aty.

ekonomike.³⁹² Në përgjithësi, gratë kanë më pak qasje në financim dhe kredi sesa burrat.³⁹³ Kapitali i kufizuar mund ta bëjë të vështirë për ndërmarrjet në pronësi të grave qasjen në kapitalin sipërmarrës dhe përfshirjen në ekosistemet inovative.

Njerëzit

Duke marrë parasysh normat sociale gjinore, rolet dhe marrëdhëniet, ky seksion shqyrton pjesëmarrjen dhe qasjen e grave dhe burrave të ndryshëm, pronësinë dhe përdorimin, aftësitë e shkrim-leximit dhe mirëqenien e lidhur me qeverisjen digjitale dhe shërbimet publike.

Qasja dhe pjesëmarrja

Disponueshmëria ndryshon nga qasja. Ndërsa infrastruktura e internetit dhe teknologjitë e reja mund të jenë gjerësisht të disponueshme, jo të gjithë njerëzit kanë qasje të barabartë në to. Barrierat kryesore me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë në qasjen në teknologjitë digjitale dhe pjesëmarrjen në jetën digjitale, sipas përgjigjeve të një pyetjeje dikotomike, janë përbalueshmëria (p.sh., të ardhura të pamjaftueshme për të paguar për të dhënat ose një pajisje) (71%) dhe disponueshmëria (d.m.th. , qasje me brez të gjerë) (29%); burrat përballen me të njëjtat sfida me ritme të ngjashme.³⁹⁴ Pengesa kryesore për qasjen në teknologjitë digjitale për gratë dhe burrat romë, ashkali dhe egjiptianë është përbalueshmëria (100%). Për gratë boshnjake pengesa kryesore është përbalueshmëria (100%), ndërsa burrave boshnjakë (86%) thanë se përbalueshmëria dhe disponueshmëria 14% ishin çështjet kryesore. Gratë serbe konsiderojnë se pengesa kryesore është përbalueshmëria (55%) ose disponueshmëria (45%). Përderisa 59% e burrave serbë e konsiderojnë përbalueshmërinë si pengesë kryesore, 41% e konsiderojnë disponueshmërinë. Individët me aftësi të kufizuara janë më të cenuarit ndaj përjashtimit digjital (32% e grave dhe 35% e burrave), të ndjekur nga familjet me të ardhura të ulëta (29% e grave dhe burrave nga këto familje).³⁹⁵ Gratë në zonat rurale në mënyrë disproporcionale kanë më pak qasje në teknologji dhe informacion.³⁹⁶

Faktorë të tillë si pronësia, koha, pozicioni ekonomik, vendndodhja gjeografike dhe nivelet e ndryshme të njohurive midis grave dhe burrave mund të ndikojnë në qasjen e tyre në pajisje, mjete dhe informacione të reja digjitale. Për shembull, telefonat me cilësi më të lartë me kapacitete më të mëdha digjitale mund të mos jenë njësoj të përbalueshëm për të gjithë dhe gratë mund të

392 Intervistë e RrGK.

393 RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, f. 41.

394 UNDP, [Anketa Digjitale e Familjeve](#), 2022.

395 Po aty.

396 UN Women, "Në Kosovë, buxheti i përgjegjshëm gjinor rrit shpresën për gratë rurale", UN Women – Evropë dhe Azi Qendrore (blog), 2021.

kenë më pak burime financiare të qasshme për to sesa burrat, duke pasur parasysh pozitën e tyre përgjithësisht më të dobët socio-ekonomike. Burrat (50%) kanë shkallë më të lartë punësimi se gratë (17%).³⁹⁷ Më tej, gratë e punësuar fitojnë paga 20% më të ulëta se burrat në sektorin privat dhe 8% më të ulëta në sektorin publik.³⁹⁸ Kështu, burrat kanë më shumë burime financiare për blerjen dhe përdorimin e mjeteve digjitale.

Ekziston një hulumtim i pamjaftueshëm në lidhje me mënyrën sesi **normat, stereotipet dhe marrëdhëniet e socializuara** gjinore mund të ndikojnë në qasjen e grave dhe burrave në shërbimet publike online, si p.sh. cilët anëtarë të familjes janë më të prirur për të bërë pagesa në internet. Konteksti sugjeron që normat gjinore që lidhen me arsimin (ndër brezat e vjetër), burimet financiare dhe koha mund të ndikojnë në qasjen në shërbimet publike, megjithëse nevojiten kërkime të mëtejshme. Duke pasur parasysh normat gjinore, prindërit ende priren të kufizojnë komunikimin online të vajzave.³⁹⁹ Përkatësia etnike dhe pengesat gjuhësore të ngjashme mund të paraqesin sfida për qasjen në shërbimet online. Për vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë, pandemia zbuloi një mungesë të përgjithshme të qasjes në mjetet digjitale. **Mosha** mund të pengojë qasjen. Gratë dhe burrat e moshuar priren të përballen me më shumë sfida në përdorimin e platformave dhe pajisjeve digjitale, siç ilustruhet nga betejat e tyre për të qasur shërbimet shëndetësore digjitale gjatë pandemisë,⁴⁰⁰ ose duke përdorur platforma arsimore online.⁴⁰¹ Ndërsa 67% e grave të moshës 18-25 vjeç e konsideruan përballueshmërinë si një pengesë kryesore dhe 33% thanë se disponueshmëria ishte një pengesë kryesore në qasjen në teknologjitë digjitale, 76% e grave të moshës 66-75 vjeç e konsideruan përballueshmërinë dhe 24% e konsideruan qasshmërinë si pengesa kryesore.⁴⁰² Diferenca të ngjashme në moshë ekzistonin midis burrave.

Personat **LGBTIQ+** mund të mos kenë mundësi të disponueshme në përputhje me identitetin e tyre gjinor ose shërbimet e nevojshme, të tilla si mundësia për të zgjedhur një gjini ose seks specifik, gjini ose seks “tjetër identifikues”, ose refuzimi i zgjedhjes. Intervistat sugjeruan se identiteti gjinor nuk u mor në konsideratë në reformat digjitale. “Kjo nuk është diskutuar apo debatuar kurrë,” vuri në dukje një pjesëmarrës në hulumtim.⁴⁰³ Një tjetër tha se diskutimi në rritje rreth personave transgjitor dhe personave të tjerë identifikues jashtë binarit mashkull-femër ka kontribuar në konfuzion në atë që përbën politikëbërjen dhe programim të përgjegjshëm gjinor. Pjesëmarrësi reflektoi:

397 ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore në Kosovë Q3 2021, 2022, f. 15.

398 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Hendeku i pagave gjinore në Kosovë](#), 2020, f. 15.

399 Intervistë e RrGK me QSGK, 2021.

400 Intervistë e RrGK, 2021.

401 Kosovo 2.0, “Perspektiva, Edukimi, Rimendimi i Mësimdhënies në Vazhdim të Pandemisë”, 2022.

402 UNDP, [Anketa Digjitale e Familjeve](#), 2022.

403 Intervistë e RrGK, 2023.

Për shkak të moshës, arsimimit dhe përvojave të mëparshme, [zyrtarët] nuk ishin në gjendje të përballeshin me paraqitjen e një gjinie të tretë, ose një grupi pa gjini. [Në] rajonin [BP], është si të flasësh për djallin. Kosova është më liberale dhe ne nuk i kemi këto probleme këtu, por ka disa gjëra të fshehura. Dhe kjo paraqitje e re [...] zuri pak hapësirë për sa i përket mbështetjes financiare, vëmendjes etj. [Gjithashtu zyrtarët] filluan të heshtnin sepse çështja u ndërlikua shumë.⁴⁰⁴

Kur zyrtarëve u mungon njohuria dhe mirëkuptimi për identitetet e ndryshme gjinore dhe orientimet seksuale, hezitojnë të diskutojnë barazinë gjinore në përgjithësi, duke përfshirë edhe gratë dhe burrat, të shqetësuar se mund të bëjnë një gabim, të përdorin një term të gabuar ose të keqinterpretojnë konceptet ose identitetet. Kështu, mungesa e njohurive dhe frika nga gabimet sociale kanë ndikuar që disa zyrtarë të shmangin çdo diskutim lidhur me gjininë. Disa pjesëmarrës në hulumtim vunë re gjithashtu se ardhja e identiteteve trans* dhe të tjera në diskutime publike “u hoqi hapësirë” veçanërisht grave.⁴⁰⁵ Lezbiket dhe biseksualët shpesh injorohen mes vëmendjes në rritje ndaj trans* dhe identiteteve të tjera, tha një aktivist. Diskutimet mbi këto çështje mezi kanë filluar të zhvillohen mes grupeve dhe personave LGBTIQ+; pra, ato ende nuk kanë arritur në diskutime për politikëbërjen, ku këto çështje janë pak të kuptuara dhe aq më pak të diskutuara. Si rezultat, nevojat e lezbikeve, homoseksualëve, trans biseksualëve*, interseksualëve, queer dhe personave të tjerë identifikues janë trajtuar rrallë në politikëbërje dhe programim, duke përfshirë digjitalizimin.

Një tjetër pjesëmarrës i hulumtimit reflektoi se çështje të ngjashme kanë ekzistuar me grupe të tjera:

Ne [në punën zhvillimore] mund të themi “RAE” [por] romët, ashkalitë dhe egjiptianët janë tre grupe etnike krejtësisht të ndara me histori, identitete dhe gjuhë të ndryshme [...] kështu që ndonjëherë ju i gruponi këto grupe në një program ose projekt, dhe pastaj mbetet aty si koncept. Më pas bëhet paradigmë.⁴⁰⁶

Pjesëmarrësi në hulumtim theksoi nevojën për programim dhe politikëbërje që bëjnë dallimin midis grupeve, përfshirë ato që lidhen me digjitalizimin. Lidhur me përfshirjen e një perspektive ndërsektoriale në digjitalizim, ABGJ

404 Intervistë e RrGK, Gusht 2023.

405 Intervistë e RrGK, Shtator 2023.

406 Intervistë e RrGK, Gusht 2023.

shprehu gjithashtu shqetësime, duke vënë në dukje se si një institucion i vetëm me burime të kufizuara, nuk ka kapacitete për integrimin gjinor me një perspektivë ndërsektoriale; nevojitet koordinim ndërinstitutional dhe përpjekje të përbashkëta.⁴⁰⁷

Potencialisht e lidhur me përkatësinë etnike, mungesa e shërbimeve digjitale në **gjuhë** të veçanta mund të jetë një pengesë për qasje. Shqipja dhe serbishtja janë gjuhë zyrtare në Kosovë me status të barabartë në institucione.⁴⁰⁸

Komunat mund të përdorin edhe gjuhë të tjera zyrtare si turqisht, boshnjakisht dhe gjuhën rome.⁴⁰⁹ Megjithatë, ndonjëherë dokumentet publike janë të disponueshme vetëm në një nga gjuhët zyrtare, zakonisht në gjuhën shqipe. Grupet etnike të pakicave kanë raportuar përdorim të paqëndrueshëm të gjuhëve zyrtare nga administrata publike, duke përfshirë në faqet e internetit të institucioneve.⁴¹⁰ Faqet e internetit të komunave me shumicë serbe priren të jenë të paqasshme dhe jofunksionale; kjo mund të nënkuptojë se folësit në gjuhën serbe mund të përballen me sfida në qasjen në informacion ose shërbime publike.⁴¹¹

Personat me **aftësi të kufizuara** dhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara (shpesh gratë si kujdestare) përballen me sfida të shtuara në qasjen e shërbimeve publike në përgjithësi, e lëre më në mënyrë digjitale. Transporti drejt shërbimeve personalisht paraqet sfida të shumta për sa i përket kostos, si dhe qasjes së ndërtimit dhe komunikimit.⁴¹² Kështu, nevoja e tyre për shërbime publike online të të gjitha formave është e theksuar pa dyshim. Gratë anëtare të OSHC Handikos vërejtën se nëse qeveria do t'i kishte marrë parasysh rekomandimet e tyre, platforma eKosova dhe procesi i vaksinimit kundër COVID-19 do t'i jepte prioritet vaksinimit të personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht atyre të klasifikuar me nivele më të ulëta të imunitetit.⁴¹³ Megjithatë, rekomandimi i tyre nuk u zbatua. Sipas korrespondencës së RrGK me personat me aftësi të kufizuara, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të përshtatur programet apo fushatat informuese për shërbimet publike digjitale për nevojat e grave dhe burrave me aftësi të kufizuara.

Gratë mund të mos kenë aq **kohë** sa burrat për të përdorur mjete digjitale ose për të avancuar njohuritë e tyre me aftësitë e shkrim-leximit digjital. Mesatarisht, gratë kanë 3.1 herë më shumë gjasa se burrat për të shpenzuar

407 Koment për draft raportin, nëntor 2023.

408 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-37 mbi përdorimin e gjuhëve](#), 2007, neni 2.

409 Po aty, neni 2, paragrafi 1.2.

410 Republika e Kosovës, Qeveria, MPB, [Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2022-2027](#), 2022, f. 29.

411 Nga 10 komuna me shumicë serbe, vetëm katër ([Shtërpçë/Štrpce](#), [Novobërdë/Novo Brdo](#), [Graçanicë/Gračanica](#), and [Partesh/Parteš](#)) kanë uebfaqe funksionale që përmbajnë informacion minimal, kryesisht vetëm në serbisht (qasur më 18 gusht 2023).

412 Bisedat e RrGK me OGSB-të anëtare të RrGK, 2020-2021.

413 Intervistat e RrGK, 2022.

kohë për kujdesin e shtëpisë dhe familjes, me burrat që i kushtojnë mesatarisht 2.5 orë në ditë kujdesit për fëmijët dhe pastrimit krahasuar me gratë që shpenzojnë 7.2 orë në këto përgjegjësi.⁴¹⁴ Burrat gjithashtu kanë më shumë gjasa të shpenzojnë kohë në hobi dhe informatikë (0,1 orë), konsum të mediave (2 orë) dhe udhëtime (0,7 orë) sesa gratë, të cilat raportojnë se nuk shpenzojnë kohë në hobi dhe informatikë dhe rreth 1,2 orë në media.⁴¹⁵ Kategoria kërkimore e AKTIK-ut e “gratë shtëpiake” përdori pajisjet dhe lidhjet e internetit më së paku (2.4 orë) çdo ditë, krahasuar me kategoritë e tjera të të anketuarve që janë identifikuar si “të punësuar” (3,5 orë), “të papunëve” (3,5 orë) dhe “studentëve” (5,0 orë).⁴¹⁶ Vetëm gjashtë përqind e “grave shtëpiake” të anketuara përdornin kompjuterë dhe 22% kishin abonime në internet në celular. Kjo dhe koha që gratë shpenzojnë për përgjegjësitë shtëpiake sugjerojnë se përgjegjësitë e kujdesit ka të ngjarë të pengojnë pjesëmarrjen digjitale të shumë grave. Pa pasur kohë për të hyrë në shërbimet publike digjitale, gratë mund të humbasin proceset e konsultimit publik, mundësitë e financimit dhe mënyrat se si mund të kontribuojnë në një administratë publike më të ndjeshme gjinore dhe miqësore për përdoruesit.

Pronësia dhe përdorimi

Kosova konsiderohet ndër vendet që lulëzon me teknologjinë digjitale me “pothuajse të gjithë” që përdorin internetin.⁴¹⁷ Sipas UNDP-së, në vitin 2022 **përdorimi** i internetit ishte i lartë me 99% të kosovarëve që përdornin internetin, duke përfshirë 99.3% të grave dhe 98.6% të burrave.⁴¹⁸ Sipas AKTIK, në vitin 2019, përdorimi i internetit ishte pothuajse i njëjtë midis njerëzve në zona të ndryshme gjeografike me 94% të banorëve urban dhe 91% të banorëve rural që përdorin internetin rregullisht.⁴¹⁹

Ndër pajisjet e përdorura, shumica e familjeve përdorën televizion kabllor digjital (99%), pasuar nga telefonat inteligjent (98%) dhe laptop privat (65%). Më se shpesht, njerëzit përdornin një telefon inteligjent për t’u lidhur me internetin në shtëpi (95% e grave dhe 96% e burrave), ndërsa 31% e grave dhe 39% e burrave përdornin tabletë.⁴²⁰

Nga koha e tyre totale e kaluar në internet në një ditë normale, të anketuarit shpenzuan 73% të asaj kohe në telefona celular, 14% në TV, 8% në kompjuter, 3% në tableta dhe 2% në pajisje të përdorura për të luajtur videoljëra.



94% të banorëve urban dhe 91% të banorëve rural që përdorin internetin rregullisht

414 KSM, “Platforma e provave”, Pragu i Kosovës ▣ Studimi i Fuqisë Punëtore dhe Përdorimit të Kohës, 2018, f. 96.

415 Po aty.

416 AKTIK, [Penetrimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë](#), 2019, f. 8. Ky hulumtim përfshiu një anketë sasiore ballë për ballë me një kampion të rastësishëm prej 1,100 të anketuarve të moshës 15+ vjeç, i kryer në 5-12 qershor 2019.

417 Forumi Ekonomik Botëror, “Si Kosova e bëri qasjen në internet me shpejtësi të lartë një realitet për të gjithë” qershor 2023, qasur më 10 nëntor 2023.

418 UNDP, [Anketa digjitale e familjeve](#), 2022.

419 AKTIK, [Penetrimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë](#), 2019, f. 7.

420 UNDP, [Anketa digjitale e familjeve](#), 2022.

(p.sh., Sony Play Station, Xbox, Nintendo).⁴²¹ Në përgjithësi, njerëzit përdorin internetin kryesisht për komunikim (87%); 88% e grave dhe 86% e burrave përdorin internetin për komunikim një-me-një.⁴²² Ndërkohë, 79% e grave dhe 77% e burrave e përdorin atë për komunikim social me disa persona njëkohësisht. Përdorimi i lartë i internetit lidhet kryesisht me rrjetet sociale. Vetëm 31% e njerëzve (30% e grave dhe 32% e burrave) thanë se përdorin internetin për të gjetur materiale për kërkime ose edukim. Platformat online prireshin të mos publikonin të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me përdoruesit e grave dhe burrave, kështu që ishte e vështirë të analizohej përdorimi sipas gjinisë.⁴²³ Aplikacionet dhe platformat e pa dizajnuara bazuar në analizën gjinore të nevojave të përdoruesve të fundit mund të mos jenë miqësore për përdoruesit, duke penguar përdorimin dhe pjesëmarrjen e grave dhe burrave. Për shembull, OSHC-të kanë shprehur shqetësimin se disa platforma qeveritare, si platforma e konsultimit publik, nuk janë të përshtatshme për përdoruesit,⁴²⁴ veçanërisht për personat me aftësi të kufizuara.⁴²⁵ Më tej, njohuritë e OSHC-ve për ekzistencën e platformës, e lëre më përdorimin e saj, kanë mbetur të ulëta.⁴²⁶

Matjet e fundit tregojnë se 60% e qytetarëve të Kosovës kanë kaluar në përdorimin e shërbimeve digjitale publike gjatë pandemisë dhe se 33% kanë përdorur shërbimet online për të marrë dokumente personale.⁴²⁷ Të dhënat nuk janë të ndara sipas gjinisë. Platforma eKosova gjurmon numrin e përdoruesve të secilit shërbim. Qeveria raporton se numri i përdoruesve të regjistruar është vazhdimisht në rritje, duke konfirmuar interesin e përdoruesve.⁴²⁸ Deri në gusht 2023, eKosova kishte 798,000 përdorues të regjistruar dhe 383 milionë vizita në platformë.⁴²⁹ Që nga nëntori 2021, sipas ASHI, platforma kishte më shumë gra (53%) sesa burra (47%) me profile, ndërsa 3000 profile nuk kishin një gjini të specifikuar (0.5%).⁴³⁰ Ndërkohë, 1.42 milionë përdorues ishin burra (60%) dhe 702.363 ishin gra (40%). Numri i përdoruesve dhe profileve ndryshon sepse krijimi i një profili kërkon ngarkimin e dokumenteve personale, ndërsa përdoruesit mund të hyjnë në platformë, por të mos përdorin shërbimet e saj. Kjo sugjeron që më shumë gra kanë krijuar profile për të përdorur platformën sesa burra. Platforma ofron të dhëna për përdorimin e shërbimeve specifike. Për shembull, 1.88 milionë

421 AKTIK, [Penetrimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë](#), 2019, f. 9.

422 UNDP, Anketa digjitale e familjeve 2022.

423 Intervistat e RrGK dhe ekzaminimi i platformave online.

424 Bisedat dhe përvojat e RrGK me OSHC-të, duke përfshirë OSHC-të anëtare të RrGK, dhe si pjesë e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

425 Shih seksionin mbi Qeverisjen.

426 Bisedat e RrGK me OSHC-të anëtare dhe OSHC-të në Këshillin për Bashkëpunim të Qeverisë dhe Shoqërisë Civile.

427 ASHI, të dhënat e ofruara për RrGK, 2021.

428 Republika e Kosovës, Qeveria, MPB, [Strategjia për Reformën e Administratës Publike 2022-2027](#), 2022.

429 [EKosova](#), qasur më 21 gusht 2022.

430 ASHI, të dhënat e ofruara për RrGK, 2021.

njerëz kanë përdorur shërbimin Tatimet, 2.3 milionë kanë përdorur shërbimet shëndetësore, 459.000 kanë përdorur shërbimet e gjendjes civile, 885.000 kanë përdorur shërbimet e policisë, 491.000 kanë përdorur shërbimet familjare, 846.000 kanë përdorur shërbimet e automjeteve dhe 179.000 kanë përdorur shërbimet e granteve.⁴³¹ Të dhënat e ndara sipas gjinisë gjurmohen, por nuk disponohen publikisht, dhe nuk kishte të dhëna për moshat, etnitë ose vendndodhjet gjeografike të përdoruesve.

Sipas Anketës Digjitale të Ekonomive Familjare të UNDP-së 2022, 69% e të anketuarve kishin përdorur portalin shtetëror eKosova, duke përfshirë 67% të grave dhe 70% të burrave.⁴³² Edhe pse nga një burim tjetër i të dhënave, kjo mund të sugjeroj një rritje që nga viti 2021. Ndërkohë, 10% e grave dhe 11% e burrave vunë në dukje se i gjenin shërbimet personale më komode. Edhe pse eKosova shtrihet në të gjithë Kosovën, shërbimet e platformës thuhet se përdoren më pak në komunat e veriut të Kosovës me shumicë serbe. UNDP zbuloi se 52% e serbëve të Kosovës raportuan se nuk e kishin përdorur kurrë platformën, 33% nuk kishin dëgjuar kurrë për të dhe vetëm 14% deklaruan se e kishin përdorur atë.⁴³³ Shumica e romëve (78%) treguan se platforma duhet të bëhet më e thjeshtë për t'u përdorur. Sipas ASHI, të rinjtë nuk kanë vështirësi në përdorimin e platformës, por gratë dhe burrat e moshuar kanë nevojë për ndihmë dhe udhëzime. Gratë dhe burrat në zonat rurale hasën vështirësi, megjithëse ASHI raportoi se i ndihmonte ata përmes qendrës së tyre të thirrjeve.

Të anketuarit në anketën e UNDP-së e kanë përdorur më së shumti këtë eKosova për të caktuar takime për marrjen e vaksinës COVID-19 (66%), me një normë të ngjashme midis grave dhe burrave. Rreth 91% e të anketuarve thanë se ishin të kënaqur me shërbimet e ofruara nga portali por 64% 44% thanë se shtimi i më shumë shërbimeve do të përmirësonte platformën. Kur u pyetën se cilat shërbime eKosova përdorëshin më shumë nga gratë dhe burrat, ASH tha se ata po planifikonin të nxirrnin këto të dhëna dhe se kishin mbajtur një modul të veçantë trajnimit për përcjelljen e të dhënave të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, përkundër kërkesave të RrGK-së për informacione dhe të dhëna më të fundit, ASHI nuk ka ofruar përditësime që nga nëntori 2021. Duke qenë se të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë të disponueshme online në lidhje me shërbimet individuale eKosova, nuk mund të kuptohet nëse gratë dhe burrat të ndryshëm përdorin aspekte të ndryshme të platformës në norma të ngjashme. Megjithatë, të dhëna më të gjera kontekstuale mund të hedhin dritë mbi tendencat e mundshme. Duke pasur parasysh se statistikisht, burrat zotërojnë më shumë prona se gratë,⁴³⁴ ata ka të ngjarë të përdorin më shumë shërbimet e platformës për pronën, regjistrimin e automjeteve dhe taksat. Gjithashtu duke marrë parasysh se 95% e të dhënave penale përfshijnë

431 EKosova, qasur më 20 gusht 2023.

432 UNDP, [Anketa digjitale e familjeve](#), 2022.

433 Po aty.

434 RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, f. 12.

burrat që dënohen ku dhe burrat janë më të angazhuar në kërkesa civile,⁴³⁵ ata me gjasë përbëjnë shumicën e përdoruesve eKosova të shërbimeve gjyqësore dhe policore.

Siç u përmend, përkufizimi i ngusht i sigurisë ka të ngjarë të thotë se çdo dhënie në internet për “siguri” në Kosovë do të kontribuoj në fushën dominuese të burrave të sigurisë së militarizuar dhe mund të mos kontribuojë në sigurinë për gra dhe burra të ndryshëm. Të vetmet shërbime nga të cilat përfitojnë qartazi gratë përdoruese dhe të cilat gratë mund t’i përdorin më shumë se burrat janë për aplikimin për leje lehonie dhe shtesa për fëmijë. Kështu, platforma duket se është përshtatur disi më shumë për shërbimet e përdorura nga burrat. Shërbime të tjera që mund të jenë të dobishme për gratë dhe burrat përfshijnë shërbime shtesë që lidhen me kujdesin shëndetësor, shërbimet sociale dhe strehimin social. Në përgjithësi, siç vuri në dukje ABGJ, nevojitet një analizë gjinore për të vlerësuar se sa gra dhe burra të ndryshëm po përdorin platformën, nëse janë të vetëdijshëm për të dhe se si mund t’u shërbej më mirë nevojave të tyre. Ndonëse për momentin nuk janë të disponueshme, të dhënat e ndara sipas gjinisë për ankesat dhe boshllëqet administrative në shërbimet e disponueshme eKosova mund të mbështesin një analizë të tillë gjinore ku nevojiten reforma në sistem.

Duke qenë se përdorimi lidhet me qasshmërinë, numri më i ulët i grave përdoruese aktive të platformës mund të tregoj se gratë hasin më shumë pengesa strukturore sesa burrat në përdorimin e shërbimeve publike digjitale. Grave mund t’u mungonte qasja në arsim, kohë, burime dhe mjete dhe pajisje të duhura digjitale për përdorimin e shërbimeve publike. Shërbimet publike digjitale mund të ofrojnë një mundësi për gratë dhe burrat që të kursejnë kohë duke qasur shërbimet në internet në vend që të kenë nevojë të vizitojnë fizikisht institucione të shumta. Duke qenë se gratë mund të kenë fëmijë për shkak të roleve të tyre të kujdesit, shërbimet digjitale potencialisht mund t’ua bëjnë jetën më të lehtë sesa të përpiqen të mbajnë fëmijë në transport publik ose të lundrojnë në vendkalime të varfra dhe të qasen në rampat për në ndërtesat publike ku ofrohen shërbime publike. Shërbimet publike digjitale mund të jenë potencialisht më të qasshme për gratë dhe burrat rurale, si dhe për personat me **aftësi të kufizuara**.

OSHC-të, duke përfshirë OGSHC-të, mund të përdorin digjitalizimin për të mbështetur punën e tyre, nga operacionet e brendshme të angazhimi i qytetarëve, komunikimi, mësimi elektronik, ndërjegjësimi përmes materialeve audiovizive dhe avokimit. Aktivistët kanë thënë se përdorimi i teknologjive digjitale ndihmon në lehtësimin e ndërjegjësimit të njerëzve në lidhje me ndryshimet e nevojshme në vendet e tyre.⁴³⁶ Pandemia e COVID-19 pa dyshim përshpejtoi përdorimin e teknologjisë digjitale nga OSHC-të

435 Po aty, f. 11.

436 Qendra Evropiane për të Drejtën Jofitimprurëse, “Asambletë Digjitale: Si Institucionet dhe Shoqëria Civile mund të punojnë së bashku për të mbrojtur të drejtën për tubim paqësor në hapësirën digjitale”, 27 mars 2023.

për punën e tyre. Përmirësimet në qeverisjen e hapur mund të krijojnë hapësira për angazhim të zgjeruar të OSHC-ve në proceset e politikëbërjes dhe vendimmarrjes. Megjithatë, jo të gjitha OSHC-të ishin të gatshme të “korrnin përfitimet” e tranzicionit digjital.⁴³⁷ Efektet pozitive kanë përfshirë përdorimin më efikas të burimeve të kufizuara si koha, transporti dhe kostot e printimit, të cilat kontribuan dyfish në uljen e ndikimeve mjedisore të projekteve përmes reduktimit të emetimeve të CO₂ nga transporti dhe më pak përdorimit të energjisë dhe materialeve nga printimi.⁴³⁸ Në të njëjtën kohë, sfidat përfshinin “luftën për hapësirë” ku OSHC-të e margjinalizuara nuk mund të konkurronin për vëmendjen online në krahasim me OSHC-të dhe akterët më të mëdhenj; lodhje nga takimet online dhe një luftë për të zgjedhur se cilën nga bollëku i ngjarjeve do të ndiqni; qasje të barabartë në softuer, veçanërisht për shkak të statusit politik të panjohur të Kosovës; algoritme jo-transparente, të njëanshme, të cilat shpesh kërkojnë investime financiare për të siguruar vëmendjen e publikut; informacione jo të besueshme, si p.sh. nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA); lajme të rreme dhe fushata online kundër gjinive, të shoqëruara nga rreziqet që ato paraqesin, veçanërisht për gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut; dhe njohuri dhe kapacitete të pamjaftueshme në mesin e shumicës së OSHC-ve për të siguruar masa mbrojtëse të përshtatshme, mbrojtje të të dhënave, siguri kibernetike dhe mirëqenie digjitale për stafin dhe përfituesit e tyre.⁴³⁹ Siç ka vërejtur Teuta Sahatqija nga Women in Tech:

Ndarja digjitale përfshin dilema etike [...] Cili është ndikimi social i IA? A jemi në gjendje të përballojmë dhe përshtatemi me epokën e re, të dallojmë dezinformatat, të gjejmë zgjidhje për paragjykimet? [...] IA qëndron në krye të dy shtyllave: të dhënave të mëdha⁴⁴⁰ dhe mësimit të makinerive. Në të dhënat e mëdha, të dhënat që mund të fshihen në të gjithë internetin janë [...] 85-90% janë të dhëna të burrave, [veçanërisht] burrave të bardhë. Prandaj, cdo aplikacion apo makineri do të mësojë nga ato të dhëna, ndërkaq algoritmet do të përsërisin paragjykimet. [Nëse] softueri i punësimit i mbështetur nga IA, bazuar në të dhënat e mëdha, parashikon që 9 nga 10 CEO [janë burra], softueri i punësimit do ta përsërisë këtë. Pra, ne duhet të [flasim se si të] luftojmë paragjykimet dhe si të vendosim të dhëna që do të përmirësojnë algoritmet. Duhet të kemi IA më gjithëpërfshirëse, të kemi programe më të mira që përmirësojnë proceset, të kemi më shumë gra atje dhe më shumë diversitet. [Procesi i krijimit të softuerit [...] duhet të jetë i vetëdijshëm për këto paragjykime ekzistuese, sa herë që përdoret për mbledhjen dhe analizën e të dhënave.⁴⁴¹

437 Mila Josifovska Danilovska, OSHC Metamorphosis, komenton në “Efektet e Tranzicionit Digjital në Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)”, Ngjarja Rajonale e organizuar nga Asistenca Teknike e BE-së për Organizatat e Shoqërisë Civile (TACSO), 3 gusht 2023.

438 Po aty dhe RrGK.

439 Po aty.

440 Nga anglishtja: Big data

441 Teuta Sahatqija, Gratë në Teknologji, komenton në ngjarjen rajonale “Efektet e Tranzicionit Digjital në Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)” organizuar nga TACSO, 3 gusht 2023.

OSHC-të vëzhguan sfidat e gjeneratave të lidhura me transformimin digjital dhe nevojën që stafi i OSHC-ve, veçanërisht lidhësi i OSHC-ve, të jenë të gatshëm për të mësuar, për të ndryshuar mënyrat e funksionimit dhe për t'u angazhuar në transformim. Kështu, OSHC-të po reflektojnë se si transformimi digjital ka përfitime, por edhe sfida për punën e tyre, duke përfshirë nga një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut me një perspektivë gjinore. Në lidhje me këtë, OSHC-të kanë vërejtur se personat që janë analfabet ose të cenueshëm do të kenë nevojë për mbështetje të vazhdueshme, duke përfshirë shoqërinë civile, pasi mund t'u mungojë qasja në mjetet digjitale.

Analfabetizmi dhe ndërgjegjësimi digjital

Për sa i përket shkrim-leximit digjital, 31% e grave dhe burrave deklaruan se priren të mos përdorin shërbimet e qeverisë online për shkak të mungesës së njohurive se si t'i përdorin ato. Kur u pyetën për përvojat e tyre duke përdorur shërbimet qeveritare në internet, 7% e grave thanë se informacioni rreth shërbimeve ishte i paqartë, krahasuar me 6% të burrave.⁴⁴² Intervistat e RrGK dhe zyrtarët sugjerojnë se gratë dhe burrat gjithashtu mund të mos jenë në dijeni të kërcënimeve të mundshme digjitale.⁴⁴³ Vëzhgimet e RrGK-së sugjerojnë se si gratë ashtu edhe burrat nuk kanë njohuri për statistikat dhe mënyrën e leximit të grafikëve, gjë që mund të pengoj qasjen në kuptimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë apo analizave ndërsektoriale.

Kur u pyetën të vlerësonin aftësitë e tyre digjitale, 70% e grave dhe 63% e burrave thanë se ndiheshin shumë kompetentë për të komunikuar në internet me të tjerët.⁴⁴⁴ Me ritme të ngjashme, gratë dhe burrat ndiheshin të arsimuar në përdorimin e mediave sociale. Gratë kanë më pak njohuri kur bëhet fjalë për përdorimin e HTML dhe kodimit bazë, me vetëm 7% të grave dhe gati 12% të burrave që deklarojnë se e zotërojnë këtë njohuri. Niveli i ulët i përdorimit të internetit për përmirësimin e aftësive digjitale personale dhe profesionale pengon pjesëmarrjen e shumëllojshme të grave dhe burrave në proceset e transformimit digjital, pasi pjesëmarrja varet nga interesi dhe niveli i tyre i njohurive digjitale. Ndërkohë, 56% e grave dhe 63% e burrave treguan interes për të përqafuar zgjidhjet e reja teknologjike. Kjo sugjeron mundësi për avancimin e shkrim-leximit digjital si te gratë ashtu edhe te burrat.

Normat gjinore, që mund të ndërthuren me burime të pamjaftueshme financiare, kohën, vendndodhjen gjeografike, aftësinë e kufizuar dhe përkatësinë etnike, mund të pengojnë **qasjen** e grave në arsim, **njohuritë** dhe kështu aftësitë e **shkrim-leximit digjital**.⁴⁴⁵ Statistikat e arsimit ⁴⁴⁶ Në

442 Po aty.

443 Intervistat e RrGK, 2022.

444 UNDP, [Anketa digjitale e familjeve](#), 2022.

445 Shihni kapitullin Edukimi.

446 ASK, [Karakteristikat Arsimore të Popullsisë së Kosovës](#), 2013, fq. 87-95, qasur më 5 dhjetor 2023.

Table 2. Percentage of Men and Women without a Secondary Education (9+years) by Ethnicity

Ethnicity	Albanian	Serbian	Turkish	Bosnian	Roma	Ashkali	Egyptian	Gorani
Women	22%	21%	15%	12%	67%	74%	62%	25%
Men	9%	11%	8%	12%	45%	45%	41%	10%

Në Kosovë, është e vështirë të vlerësohet nëse legjislacioni aktual është i mjaftueshëm, duke pasur parasysh të dhënat minimale se cilat krime kibernetike janë raportuar dhe se si ofruesit e drejtësisë po i trajtojnë këto raste.⁵⁵ Fakti që raste të tilla raportohen dhe trajtohen rrallë, megjithëse përvoja e RrGK-së sugjeron se ato ekzistojnë, mund të jetë dëshmi e nevojës për të përfshirë përkufizime të tilla. Në të vërtetë, hulumtimi i RrGK zbuloi se nevojiteshin përkufizime më të qarta në lidhje me ngacmimin seksual që njerëzit dhe ofruesit e drejtësisë ta konsideronin atë si krim dhe ta trajtonin atë; përndryshe, veprime të tilla prireshin të mos konsideroheshin krime.⁵⁶ Përkufizime më të qarta të formave të ndryshme të krimeve kibernetike me bazë gjinore u mundëson më shumë njerëzve të identifikojnë dhe raportojnë krime të tilla, duke përmirësuar trajtimin e tyre nga ofruesit e drejtësisë.

Aktualisht, lidhur me krimin kibernetik dhe dhunën kibernetike, Kodi Penal është **neutral gjinor**. Kodi Penal nuk i kushton vëmendje mënyrës sesi dhuna kibernetike mund të ndikoj ndryshe tek gratë dhe burrat dhe nuk parashikon mënyra për t'i mbrojtur ata ose për të parandaluar krime të tilla. Nuk i kushtohet vëmendje kërcënimeve seksuale me të cilat përballen gratë në internet, dhe Kodi Penal nuk është i harmonizuar mirë me RrPMDH.

Kodi i Procedurës Penale

Konventa e Stambollit, neni 56c, kërkon që viktimat të informohen për të drejtat e tyre dhe shërbimet në dispozicion të tyre. Autoritetet duhet të komunikojnë ankesat e viktimave, akuzat, përparimin në hetime ose procedime, rolin e viktimave në këto procese dhe rezultatet e rasteve. Dispozitat e KPP-së i transpozojnë pjesërisht këto kërkesa.⁵⁷ KPP 2022 nuk përmend dhunën kibernetike ose krimin kibernetik. Në lidhje me digjitalizimin, "Seancat e aplikueshme të dëshmisë në procedurë paraprake ose sesi i mundësive të posaçme hetimore, ose çdo ekzaminim apo interviste tjetër sipas nevojës,

53 N. Henry dhe A. Powell, "Dhuna seksuale në epokën digjitale: fushëveprimi dhe kufijtë e ligjit penal", Studime shoqërore dhe juridike, 25, 2016, 397, 398.

54 Ryan, David, "European remedial coherence in the regulation of non-consensual disclosures of sexual images [Koherenca përmirësuese evropiane në rregullimin e zbulimeve jo-konsensuale të imazheve seksuale]", Rishikimi i Ligjit dhe Sigurisë Kompjuterike, 34, 2018, 1053-1076, 1066.

55 Shihni seksionet Njerëzit dhe Qeverisja më poshtë.

56 Po aty, f. 58.

57 RrGK, [Nga Ligjet në Veprim](#), 2022. Për shembull, nenet 63.1.3.1, 63.1.9, 371.6.

do të regjistrohen me video ose audio”.⁵⁸ Në të njëjtin nen specifikohet se “Të dhënat personale të të pandehurit, të dëmtuarit apo dëshmitarit të regjistruara janë konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm gjatë procedurës penale” dhe se “Shkelja e këtij paragrafi do të konsiderohet shkelje e detyrave etike të praktikantit të përfshirë dhe mund të sanksionohet nga Gjykata.”⁵⁹ Shqyrtimi kryesor duhet të jetë ose audio ose video i regjistruar apo i regjistruar stenografikisht.⁶⁰ Shumica e referencave për mjetet “elektronike” të komunikimit i referohen aspekteve administrative të funksioneve të gjykatës, dëshmimeve, publikimit elektronik të vendimeve gjyqësore dhe/ose komunikimit me palët. Këto nuk merren me gjininë dhe nuk sigurojnë mbrojtje të përgjegjshme ndaj gjinisë.

Sipas nenit 56 të Konventës së Stambollit, KPP-ja thekson se “një viktime të dhunës me bazë gjinore duhet t’i mundësohet të shmangë kontaktin e drejtpërdrejtë me të pandehurin në çdo kohë kur kjo është e mundur gjatë procedimit në polici, prokurori ose gjykatë”.⁶¹ Përveç kësaj, “Dëshmia mund të merret përmes teknologjisë video-konferencës nëse dëshmitari nuk është brenda Kosovës dhe nuk ka gjasa të kthehet në Kosovë, ose në përputhje me një masë të mbrojtjes së dëshmitarit.”⁶²

KPP-ja është e **ndjeshme gjinore** ndaj digjitalizimit, pasi disa dispozita njohin çështje që kanë të bëjnë me gjininë dhe seksin që lidhen kryesisht me viktimat e dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, KPP-së i mungon një mbrojtje e qartë veçanërisht për dhunën kibernetike me bazë gjinore. Nuk ekziston asnjë provë që një VN(B)GJ ex-ante ose ex-post është kryer për të informuar amendamentet e KPP-së, të tilla si aftësia dhe vullneti i zyrtarëve për të njoftuar viktimat për të drejtat e tyre, për të ofruar “teknologji të përshtatshme komunikimi” ose dëshmi të regjistruara apo për të siguruar infrastrukturën që u mundëson viktimave të shmangin kontaktin e drejtpërdrejtë me autorët. Regjistrimi i dëshmimeve mund të zvogëlojë mundësinë e ri-traumatizimit që rezulton nga intervistat e shumta nga policia, prokurorët, shërbimet sociale dhe akterë të tjerë, si dhe nga përballja me autorët e dyshuar në gjykatë. Dëshmitë e regjistruara mund të jenë veçanërisht të rëndësishme për reduktimin e traumës dhe rritjen e mbrojtjes në rastet që përfshijnë dhunën me bazë gjinore.

58 Republika e Kosovës, Kuvendi, Kodi Nr. 08/L-032 [Kodi i Procedurës Penale të Kosovës](#), 2022, neni 205.

59 Po aty, Paragrafi 8.

60 Po aty, Neni 311, Paragrafi 2.

61 Po aty, Neni 63, Paragrafi 1.21.

62 Po aty, Neni 147, Paragrafi 6.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

LMDHP “përcakton të drejtat, parimet dhe masat ndëshkuese për mbrojtjen e të dhënave personale të individëve, si dhe përgjegjësitë e institucionit përgjegjës për monitorimin e legjitimitetit të përpunimit të të dhënave dhe qasjes në dokumente publike”.⁶³ Ligji është i zbatueshëm për organet publike dhe private, por jo “për përpunimin e të dhënave personale nëse bëhet për qëllime personale”.⁶⁴ I ndryshuar dhe miratuar në vitin 2019, LMDHP-ja transpozoi Rregulloren e BE-së të vitit 2016 për mbrojtjen e personave fizik në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të të dhënave të tilla, e njohur si RrPMDH.⁶⁵ Neni 8 pranon se:

Përpunimi i të dhënave personale që zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, besimet fetare ose filozofike, ose anëtarësimin në sindikata, dhe përpunimi i të dhënave gjenetike, të dhënave biometrike për qëllime të identifikimit unik të një personi fizik, të dhënave në lidhje me shëndetin ose të dhënave në lidhje me një person fizik, **jeta seksuale ose orientimi seksual** i personit [theksimi i shtuar] do të ndalohej.

LMDHP përkufizon “Të dhënat personale të ndjeshme” si “të dhëna personale që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësinë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo të dhënë që lidhet me gjendjen shëndetësore ose jetën seksuale, çdo përfshirje ose heqje nga regjistrat penal ose kundërvajtës”. Ai gjithashtu i konsideron të dhënat biometrike si të dhëna personale të ndjeshme nëse mundësojnë identifikimin e “një subjekti të të dhënave në lidhje me ndonjë nga rrethanat e lartpërmendura”.⁶⁶ LMDHP nuk përcakton në mënyrë eksplicite seksin dhe gjininë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave. As nuk trajton ngacmimin seksual në internet, ndërkohë që mund të ketë trajtuar ngacmimin në formën e teksteve seksuale; përdorimi i mjeteve elektronike për ngacmim seksual (p.sh. telefonat dhe aplikacionet e mediave sociale); shpërndarja dhe përdorimi i fotografive në internet pa pëlqimin e personit (personave) në foto; dhe/ose kërcënimet që rrjedhin nga përpunimi i të dhënave në lidhje me mbrojtjen, sigurinë dhe mirëqenien. Për shembull, RrGK gjeti raste të personave në sistemin arsimor që kanë qasje në

⁶³ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 06/1-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#), 2019, Neni 1.

⁶⁴ Po aty, Neni 2.

⁶⁵ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, I (aktet legjislativ), Rregulloret, Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 27 prill 2016 për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC ([Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave](#)) (shih gjithashtu: DLA PIPER, [Ligjet e Botës për Mbrojtjen e të Dhënave](#), 2021)

⁶⁶ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 06/1-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale](#), 2019, neni 3, paragrafi 1.25

të dhënat e studentëve duke përdorur informacionin e studentëve si numrat e telefonit dhe adresat për të përndjekur ose ngacmuar seksualisht studentët, veçanërisht gratë e reja.⁶⁷ Kjo sugjeron nevojën për rregullim të përmirësuar dhe më specifik.

RrPMDH e përkufizon “pëlqimin” si: “çdo tregues të dhënë, specifik, të informuar dhe të paqartë të dëshirave të subjektit të të dhënave, me anë të të cilit ai ose ajo, me një deklaratë ose me një veprim të qartë afirmativ, nënkupton marrëveshjen për përpunimin e të dhënave personale në lidhje me ata”.⁶⁸ LMDHP ka transpozuar të njëjtin përkufizim. Megjithatë, RrPMDH njeh aspekte të tjera të pëlqimit që nuk janë të specifikuara në LMDHP. RrPMDH përcakton “Kushtet për pëlqimin”. Ai vëren se në vlerësimin e pëlqimit të dhënë lirshëm “do të merret parasysh nëse, ndër të tjera, zbatimi i një kontrate, duke përfshirë ofrimin e një shërbimi, kushtëzohet nga pëlqimi për përpunimin e të dhënave personale që nuk janë të nevojshme për përmbushjen të asaj kontrate.”⁶⁹ Sipas Recitalit 42, “Pëlqimi nuk duhet të konsiderohet si i dhënë lirshëm nëse subjekti i të dhënave nuk ka zgjedhje të vërtetë ose të lirë ose nuk është në gjendje të refuzoj ose të tërheq pëlqimin pa dëmtuar.”⁷⁰ Recitali 42 thekson më tej se “masat mbrojtëse duhet të sigurojnë që subjekti i të dhënave është i vetëdijshëm për faktin dhe masën në të cilën është dhënë pëlqimi”. Recitali 43 vëren se pëlqimi në përgjithësi nuk duhet të siguroj një bazë ligjore të vlefshme për përpunimin e të dhënave personale në rastet kur ekziston një çekuilibër i qartë fuqie ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit, veçanërisht kur kontrolluesi është një autoritet publik.⁷¹ Së fundi, pëlqimi duhet të jetë i qartë.

Ligji i BE-së për mbrojtjen e të dhënave parashikon “të drejtën për t’u harruar”.⁷² Ai kërkon që kontrollorët që i nënshtrohen RrPMDH të fshijnë të dhënat për subjektet e të dhënave në përgjigje të një kërkesë në rrethana të caktuara; për shembull, motorëve të kërkimit mund t’u kërkohet të fshijnë të dhënat. Në shqyrtimin e kësaj të drejte sipas Direktivës së BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave, paraardhësi i RrPMDH, Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian vendosi se kjo e drejtë duhet të jetë në përputhje me shtrirjen territoriale të Direktivës (duke mos kërkuar çpreferencim të materialit në mbarë botën, por brenda BE-së).⁷³ LMDHP gjithashtu parasheh “të drejtën për të fshirë” apo për t’u harruar.⁷⁴ Megjithatë, bisedat e RrGK-së me institucionet përgjegjëse për monitorimin e LMDHP -së sugjerojnë se njerëzve u mungojnë njohuritë për heqjen e materialeve online dhe mund të mësojnë për politikën në fuqi

67 RrGK, [Ngacmimi Seksual në Kosovë](#), 2016, f. 36.

68 RrMDHP/EU, [“Cilat janë kërkesat e miratimit të RrMDHP?”](#), 2023, qasur më 15 nëntor 2023

69 Po aty.

70 Po aty, [Recitali 42](#).

71 RrMDHP, preambula, parathëniet 40 dhe 43.

72 Tani, “e drejta për fshirje” (RrMDHP, Neni 17).

73 Çështja C-507/17 Google kundër CNIL, 2019.

74 LMDHP, Neni 16, “E drejta për t’u fshirë” (“e drejta për t’u harruar”).

vetëm sipas gjykimit të kompanisë së cilës i është dorëzuar kërkesa.⁷⁵ Prandaj, mungesa e njohurive mund të pengoj zbatimin.

Në LMDHP, kontrollorët e të dhënave mund të përdorin të dhënat personale që i kanë marrë nga burime të qasshme publikisht ose në kuadër të kryerjes së ligjshme të aktiviteteve për qëllime të ofrimit të mallrave, shërbimeve, punësimit ose kryerjes së përkohshme të punës përmes shërbimeve postare, telefonatave, postës elektronike, apo telekomunikacioneve të tjera.⁷⁶ Sipas RrPMDH, kontrollorët janë të detyruar të japin informacion në lidhje me aktivitetet e tyre të përpunimit, si për subjektet e të dhënave nga të cilët ata mbledhin të dhëna personale direkte dhe indirekte (si p.sh. një anëtar i familjes që ofron informacion). Sipas LMDHP-së, subjekti i të dhënave duhet të ketë të drejtë të marr nga kontrolluesi konfirmim nëse të dhënat personale mund të përpunohen apo jo dhe, aty ku është rasti, të marrë informacionin e mëposhtëm: qëllimet e përpunimit të të dhënave; kategoritë e të dhënave personale; kujt i janë dhënë ose do t'i zbulohen të dhënat personale; periudhën e parashikuar për të cilën do të ruhen të dhënat personale ose kriteret e përdorura për të përcaktuar atë periudhë; të drejtën për të kërkuar që kontrolluesi të ifshijë të dhënat personale, të kufizoj përpunimin e tyre ose të kundërshtoj një përpunim të tillë; e drejta për të paraqitur ankesë në Agjenci; nëse të dhënat personale nuk mbledhen nga subjekti i të dhënave, çdo informacion në lidhje me burimin e tyre; ekzistenca e vendimmarrjes së automatizuar, duke përfshirë profilizimin dhe informacionin kuptimplotë në lidhje me logjikën e përfshirë, si dhe rëndësinë dhe pasojat e parashikuara të një përpunimi të tillë për subjektin e të dhënave.⁷⁷ RrGK u përpoq të identifikonte ankesat e paraqitura ose veprimet përmbartimore të ndërmarra në BE ose Kosovë për shkelje në përpunimin e të dhënave personale në lidhje me gjininë. Mungesa e praktikës gjyqësore ose e procedurave gjyqësore lidhur me gjininë e bën të vështirë vlerësimin se si mbrojtja e të dhënave mund të ndikoj ndryshe tek gratë, vajzat, burrat dhe djemtë e ndryshëm.

RrGK nuk gjeti raporte që monitoronin shkallën në të cilën LMDHP është zbatuar, duke përfshirë analizën ex-post të ndikimit gjinor, si për shembull se si gratë dhe burrat, si subjekte të të dhënave, mund të kenë përdorur ose janë prekur nga ky ligj. Shkalla në të cilën kontrollorët informojnë subjektet e të dhënave për arsyet pse të dhënat e tyre përpunohen është e paqartë. Duke marrë parasysh ndërgjegjësimin minimal të njerëzve për konceptin e pëlqimit të informuar, se si mund të keqpërdoren të dhënat personale ose cilët mekanizma ofrojnë mbrojtje,⁷⁸ gratë dhe burrat mund të jenë në rrezik që të dhënat e tyre të keqpërdoren. Duke pasur parasysh nivelet e tyre potencialisht më të ulëta arsimore dhe më pak kohë për t'u edukuar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave në internet, gratë mund të jenë në rrezik më të

75 RrGK, intervista, 2021.

76 LMDHP, Neni 59, Të drejtat dhe përgjegjësitë e kontrolluesve të të dhënave.

77 RrMDHP, Kapitulli IV mbi informacionin dhe qasjan në të dhënat personale, nenet 12, 13, 14; LPPD, neni 14 "E drejta e qasjes."

78 Intervistat e RrGK me ASHI, Njësinë e Sigurisë Kibernetike të Policisë së Kosovës dhe AIP, 2021

madh se burrat, megjithëse asnjë hulumtim nuk duket se e ka ekzaminuar këtë. Për më tepër, duke pasur parasysh pabarazitë e pushtetit, gratë dhe vajzat mund të mbështeten më shumë në shërbimet publike dhe kështu të jenë më të prekshme ndaj keqpërdorimit të të dhënave, si p.sh. duke dhënë pëlqim të painformuar për të qasur një shërbim. Meqenëse burrat prirën të jenë kryefamiljarë dhe kështu të regjistrohen për shërbimet publike, ata gjithashtu mund të ofrojnë të dhëna personale të anëtarëve të tjerë të familjes pa dijeninë ose pëlqimin e anëtarëve të familjes së tyre.⁷⁹ Gratë që varen nga anëtarët burra të familjes mund të jenë në rrezik më të madh që të dhënat e tyre personale të sigurohen në internet pa dijeninë ose pëlqimin e tyre. Gratë janë gjithashtu në një rrezik më të madh të dhunës me bazë gjinore dhe kërcënimeve të mundshme të lidhura me sigurinë e të dhënave personale, të tilla si kontrolli dhe monitorimi i telefonave celular ose kompjuterëve personal të grave.⁸⁰ Këto çështje nuk janë adresuar në LMDHP.

LMDHP mund të mos përfshij mjaftueshëm nevojat e ndryshme të grave dhe burrave për mbrojtjen e të dhënave personale. As nuk duket se kujdeset për nevojat specifike të mbrojtjes së viktimave të krimeve, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe nevojën për mbrojtje shtesë për të dhëna të tilla të ndjeshme. LMDHP mund të ofronte mbrojtje më të mirë duke përcaktuar gjininë dhe pëlqimin më qartë, veçanërisht në aspektin e “mbrojtjes së të dhënave të ndjeshme” (neni 3) dhe “mbrojtjes së kategorive të veçanta” të të dhënave personale (neni 8). Mund të vendosen procedura të veçanta për mbledhjen, mirëmbajtjen, koordinimin ndërmjet institucioneve dhe përdorimin e të dhënave për raportimin, monitorimin, vlerësimin dhe informimin e politikave të reja, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e viktimave. Duhet të sqarohet se cilat institucione kanë qasje në cilat të dhëna në cilin moment. Kjo mund të kontribuoj në zbatimin më të mirë të legjislacionit përkatës, siç është Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore.⁸¹ Pra, ky ligj është **neutral gjinor** dhe nuk duket të jetë i informuar nga një VN(B)GJ. Megjithëse RrPMDH përdor gjithashtu gjuhë neutrale gjinore, specifikimet e tij që rregullojnë pëlqimin ofrojnë mbrojtje më të mirë të të dhënave për kategoritë e cenueshme. LMDHP mund të parashikoj gjithashtu mbrojtje të përmirësuara.

79 Komentet në “Efektet e Tranzicionit Digjital në Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)” Ngjarja Rajonale e organizuar nga TACSO, 3 gusht 2023.

80 Të paktën tre raste të dhunës me bazë gjinore janë raportuar në Kosovë që përfshijnë kontrollin dhe detyrimin duke përdorur telefonat celularë, siç raportohet nga tre kanale të ndryshme lajmesh: Nacionale, “*Koci denoncon një rast të kontrollimit bizar që një burrë Kosovar i bën gruas së tij me telefon*”, Janar 2023; Veriu Info, “*Burri shkon në vendin e punës dhe ia kontrollon telefonin me dhunë një gruaje, arrestohet*”, 31 Mars 2023; Sinjali, “*Ma mori telefonin dhe po më kontrollon. Gruaja nga Gjakova denoncon burrin për dhunë fizike dhe psikike.*”, 11 Korrik 2022.

81 Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Bazë Gjinore, 2023.

Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit

I miratuar në vitin 2022, ky ligj përcakton përgjegjësitë e Agjencisë Kundër Korrupsionit (AKK).⁸² Ai nuk ka përgjegjësi që lidhen me avancimin e barazisë gjinore. Ligji thotë se “emrat e gjinisë mashkullore nënkuptojnë edhe gjininë femërore dhe anasjelltas”.⁸³ Përemrat mashkullor përdoren në të gjithë Ligjin. Përdorimi i këtyre përemrave nuk është as gramatikisht i saktë dhe as në përputhje me parimet për avancimin e barazisë gjinore. Në vend të kësaj, këta përemra përforcojnë stereotipet gjinore sipas të cilave burrat zënë pozicione të caktuara si: “Drejtori” (drejtor) dhe “Kryetari” (kryetar). Pra, ligji është **negativ gjinor**. Neni 28 për ruajtjen e të dhënave thotë se zyrtarët dhe personat e tjerë të punësuar në Agjenci ose që marrin dijëni për sekretet zyrtare në bashkëpunim me Agjencinë, duhet të sigurojnë që këto informacione të mbeten të klasifikuara dhe konfidenciale. Asnjë referencë për konfidencialitetin nuk lidhet me të dhënat elektronike, sistemet e menaxhimit të të dhënave ose mekanizmat e raportimit elektronik.

Drejtori

Kryetari

Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve

Ky ligj i vitit 2018 përcakton “rregullat për sinjalizimin, procedurën e sinjalizimit, të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve dhe detyrimet e institucioneve publike dhe subjekteve private në lidhje me sinjalizimin”.⁸⁴ Ligji e përkufizon sinjalizimin si aktin e raportimit ose zbulimit të “informacionit mbi kërcënimin ose dëmtimin e interesit publik në kontekstin e marrëdhënieve të punës në sektorin publik ose privat.”⁸⁵ Më konkretisht, sinjalizimi “i brendshëm” përfshin raportimin e informacionit tek punëdhënësi; Denoncim “i jashtëm” nënkupton raportimin e informacionit tek një autoritet kompetent,⁸⁶

dhe sinjalizimi “publik” përfshin zbulimin e informacionit për mediat, OJQ-të, përmes internetit, në një takim publik, ose me çdo mjet tjetër që e bën informacionin publik.⁸⁷ Neni 22 rendit disa veprime të dëmshme ndaj të cilave mund t’u nënshtrohen sinjalizuesit. Kjo listë nuk përfshin frikësimin me bazë gjinore, kërcënimin dhe pasoja të tjera ndaj të cilave mund të ekspozohen gratë sinjalizuese.

Në nivel global, gratë priren të dëshmojnë dhe të perceptojnë korrupsionin më shumë se burrat.⁸⁸ Duke pasur parasysh se gratë kanë më pak gjasa se burrat për të mbajtur poste pushteti, gratë mund të përballen me rreziqe dhe pasoja të ndryshme

Në nivel global, gratë priren të dëshmojnë dhe të perceptojnë korrupsionin më shumë se burrat.

⁸² Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit](#), 2022. Ligji i referohet këtij organi si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit. Megjithatë, raportet e tyre vjetore dhe faja e internetit përdorin akronimin “APK”, dhe për këtë arsye përdoret këtu.

⁸³ Po aty, Neni 3, 2022.

⁸⁴ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Denoncuesve](#), 2018, Neni 2.

⁸⁵ Po aty, Neni 3, Paragrafi 1.

⁸⁶ Po aty, Neni 13, Paragrafi 2, 3.

⁸⁷ Po aty, Neni 13, Paragrafi 5.

⁸⁸ Transparencia Internacional, [Gjetja e një Zëri, Kërkimi i Drejtësisë: Barrierat me të cilat përballen gratë për raportimin e korrupsionit në Bashkimin Evropian](#), 2021.

kur raportojnë korrupsionin.⁸⁹ Duke pasur parasysh se gratë kanë më shumë gjasa të nënpërfaqësohen dhe të diskriminohen në fuqinë punëtore,⁹⁰ gratë denoncuese mund të jenë më të ndjeshme ndaj rreziqeve të hakmarrjes dhe humbjes së punës. Ekzistojnë pak mekanizma që gratë të raportojnë diskriminimin me bazë gjinore në punë, duke përfshirë ngacmimin seksual, jashtë linje ose në internet.⁹¹ Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve nuk merr parasysh dallimet e tilla gjinore. Ligji është **neutral gjinor** dhe nuk duket të jetë informuar nga VN(B)GJ.

Ndërsa Instituti Demokratik i Kosovës ka hulumtuar zbatimin e Ligjit,⁹² analiza e tij nuk përmban të dhëna të ndara sipas gjinisë. Kosovës gjithashtu i mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me inspektimet dhe praktikën gjyqësore, gjë që e bën të vështirë vlerësimin e zbatimit të ligjit nga perspektiva gjinore. Ligji mund të pasqyroj më mirë LMDHP -në duke mbrojtur të dhënat personale të sinjalizuesve të grave dhe burrave, si dhe duke përcaktuar më mirë pasojat përkatëse gjinore për sinjalizuesit dhe mekanizmat për adresimin e këtyre rreziqeve.

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik

I zëvendësuar me Ligjin për Sigurinë Kibernetike në vitin 2023, ky ligj i vitit 2010 synonte të sanksionoj shkeljet, të respektoj të drejtat e njeriut dhe të mbroj informacionin personal.⁹³ Ligji e përkufizonte krimin kibernetik si: “aktivitet kriminal i kryer në një rrjet që ka si objektiv ose si mënyrë për të kryer krimin, keqpërdorimin e sistemeve kompjuterike dhe të të dhënave kompjuterike”. Ky përkufizim ishte i paqartë. Megjithatë, as BE-ja nuk ka ende një përkufizim të qartë ligjor të krimit kibernetik. Në përgjithësi, KE i është referuar krimit kibernetik si një çështje pa kufij që mund të përfshijë:

- **krime specifike për internetin**, të tilla si sulmet kundër sistemeve të informacionit (p.sh. faqet e rreme të bankave për të kërkuar fjalëkalime që mundësojnë qasje në llogaritë bankare të viktimave)
- **mashttrim dhe falsifikim në internet**: mashttrim në shkallë të gjerë [i cili] mund të kryhet në internet nëpërmjet instrumenteve të tilla si vjedhja e identitetit, posta e padëshiruar dhe kodi keqdashës
- **përmbajtje të paligjshme në internet**, duke përfshirë materialin e abuzimit seksual të fëmijëve, nxitjen e urrejtjes racore, nxitjen e akteve terroriste dhe glorifikimin e dhunës, terrorizmit, racizmit dhe ksenofobisë⁹⁴

⁸⁹ Po aty.

⁹⁰ RrGk, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë*, 2022.

⁹¹ Po aty, f. 74.

⁹² Instituti Demokratik i Kosovës, *Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve*, 2020. Për më shumë informacion, shih seksionin për Njerëzit.

⁹³ Republika për Kosovën, Kuvendi, *Ligji Nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik*, 2010.

⁹⁴ KE, *Migrimi dhe Punët e Brendshme*, [Krimi Kibernetik](#), qasur më 17 gusht 2023.

Kosova mund të zgjeroj përkufizimin e saj të krimit kibernetik në përputhje me praktikat më të mira të shteteve anëtare të BE-së dhe drejt një përkufizimi më gjithëpërfshirës.

Konventa e Budapestit për krimin kibernetik dhe protokollet e saj drejtojnë BE-në në koordinimin e përpjekjeve të shteteve anëtare për të trajtuar krimin kibernetik.⁹⁵ Ajo inkurajon shtetet nënshkruese të miratojnë ligje që kriminalizojnë krimet kibernetike duke përfshirë hakerimin, vjedhjen e identitetit dhe pornografinë e fëmijëve. Konventa rregullon bashkëpunimin ndërkombëtar në hetimet dhe procedurat që përfshijnë vepra penale që lidhen me sistemet kompjuterike dhe të dhënat.⁹⁶ Kosova nuk e ka nënshkruar dhe ratifikuar Konventën, edhe pse vendet joevropiane mund ta nënshkruajnë atë.

Ligji i Kosovës e njeh “Pornografinë e fëmijëve përmes sistemeve kompjuterike”, duke theksuar se kryesi i tentativës për këtë vepër penale dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.⁹⁷ Ndërkohë, Kodi Penal për “Abuzimin e fëmijëve në pornografi” jep përkufizime shtesë dhe parashikon sanksione më të forta.⁹⁸ Kështu, ligji nuk ishte në përputhje me Kodin Penal, duke kontribuar potencialisht në konfuzionin ligjor dhe zbatimin e dobët. Kodi Penal nuk i referohet në mënyrë specifike krimit kibernetik apo dhunës kibernetike, megjithëse ai u miratua në vitin 2019, nëntë vjet pas këtij ligji.

Ligji specifikonte se qeveria do të “krijoj një pikë kontakti të përhershme për të ofruar ndihmë dhe informacion të specializuar” për krimin kibernetik.⁹⁹ Në të thuhet se autoritetet dhe institucionet publike kompetente, në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve dhe shoqërinë civile, duhet të organizojnë fushata informuese mbi krimin kibernetik dhe rreziqet për përdoruesit e sistemeve kompjuterike.¹⁰⁰

Ndryshe nga LMDHP, i cili specifikon orientimin seksual si një kategori të rrezikuar nga kërcënimet e të dhënave personale, ky ligj nuk ka marrë parasysh në mënyrë specifike krimin kibernetik me bazë gjinore ose dhunën kibernetike ndaj grave ose personave LGBTIQ+. Kështu, ligji ishte **neutral gjinor**.

95 Këshilli i Evropës, Veprimi kundër krimit kibernetik, [Pse dhe si po punon Këshilli i Evropës kundër krimit kibernetik?](#), 2023, qasur më 15 nëntor 2023.

96 Këshilli i Evropës, [Konventa për krimin kibernetik](#), Budapest, 2001, neni 23.

97 Republika për Kosovën, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-166 për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik](#), neni 16, paragrafi 2.

98 [Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#), 2019, neni 232.

99 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Kodi Nr. 06/L-074 Kodi Penal i Republikës së Kosovës](#), 2019, neni 22.

100 Po aty, Neni 5.

Ligji për Sigurinë Kibernetike

I miratuar në vitin 2023, ky Ligj zëvendësoi Ligjin për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik.¹⁰¹ Ligji përkufizon “Incident kibernetik” si “çdo ngjarje që ka një efekt real negativ në sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit” dhe “sigurinë kibernetike” si “aktivitete për të mbrojtur rrjetet dhe sistemet e informacionit, përdoruesit e sistemeve të tilla dhe personat e tjerë të prekur nga incidentet kibernetike”.¹⁰² Ligji parasheh “parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik në Republikën e Kosovës kundër çdo kërcënimi apo sulmi”. Megjithatë, ai nuk përcakton krimin kibernetik. Ligji themelon institucionet përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin, bashkëpunimin dhe promovimin e politikës së sigurisë kibernetike, duke përfshirë Agjencinë e Sigurisë Kibernetike (ASK) për të “monitoruar, inspektuar dhe koordinuar aktivitetet e institucioneve përgjegjëse për sigurinë kibernetike” dhe për të adresuar dështimet.¹⁰³ ASK duhet të administroj regjistrin e incidenteve kibernetike dhe regjistrin e kërcënimeve kibernetike, si dhe të krijoj një platformë elektronike për shkëmbimin e informacionit në kohë reale ku përdoruesit do të jenë operatorë të shërbimeve thelbësore dhe ofrues të shërbimeve digjitale.¹⁰⁴ Ligji nuk specifikon se cilat lloje të të dhënave do të gjurmohen në platformë. As nuk kërkon të dhëna të ndara sipas gjinisë, përkatësisë etnike, moshës apo ndonjë kategorie tjetër. Sa i përket organizimit të brendshëm, personelit dhe emërimit të kreut të ASK-së, përmendet Ligji për Zyrtarët Publik. Ligji për Barazinë Gjimore nuk është i tillë, megjithëse ligji mund të kishte theksuar nevojën për aplikimin e masave afirmative në rekrutimin e grave dhe burrave në ASK, duke pasur parasysh numrin e ulët të grave që zakonisht përfshihen në këtë fushë. Si i tillë, ligji i ri është **neutral gjinor**.

Ligji për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendim të Gjykatës

I miratuar në vitin 2015, ky ligj synon të krijojë një mekanizëm për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.¹⁰⁵ Ligji ka masa mbrojtëse bashkëkohore në drejtësinë penale, bazuar në rekomandimin për monitorimin elektronik nga Komiteti i Ministrave, si organ vendimmarrës i Këshillit të Evropës.¹⁰⁶ Ligji rregullon përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, duke përfshirë pajisjet dhe etiketat elektronike. Mbikëqyrja elektronike mund të ndodh vetëm me pëlqimin e

101 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 08/L-173 për Sigurinë Kibernetike](#), 2023, Neni 1.

102 Po aty, Neni 3, paragrafet 1.3 dhe 1.5.

103 Po aty, Neni 15.

104 Po aty, Neni 15, paragrafet 5 and 7.

105 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendim të Gjykatës](#), 2015, Neni 1.

106 Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, [Rekomandimi CM/Rec\(2014\)4 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për monitorimin elektronik](#), 19 shkurt 2014, takimi 1192 i Zëvendës Ministrave; shih gjithashtu Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Problemet e Krimit, Këshilli për Bashkëpunimin Penologjik, [Draft Komentari i Rekomandimit për Monitorimin Elektronik](#), 2013.

personit nën mbikëqyrje.¹⁰⁷ Përjashtimisht, mbikëqyrja elektronike mund të vendoset pa pëlqim, nëse gjykata e çmon të nevojshme garantimin e të drejtave kushtetuese të palëve të treta dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi paraqet rrezik për shkeljen e këtyre të drejtave”.¹⁰⁸ Personi duhet t’u bindet kushteve në vendimin e gjykatës; t’i sigurojë gjykatës dhe autoritetit që ushtrojë mbikëqyrjen elektronike adresat e vendbanimit dhe të punës; të kthehet në zonën e lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e kufizuar brenda “15 minutave nga momenti kur ai ose ajo kontaktohet nga salla e operacionit”; të mos e dëmtojë ose heqë pajisjen; dhe të njoftojë organin që kryen mbikëqyrjen për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose mosfunksionimin e saj.¹⁰⁹ Nëse personi nën vëzhgim ose një kontakt i ngushtë nuk mund të arrihet, salla e operacionit duhet të njoftojë menjëherë policinë. Salla e operacionit brenda 24 orëve duhet të informojë gjykatën dhe prokurorinë për shkeljen.¹¹⁰ PK është përgjegjëse për instalimin, heqjen dhe funksionimin e pajisjeve elektronike.¹¹¹

Ligji nuk përfshin perspektivë gjinore dhe është **neutral gjinor**. Zbatimi i ligjit mund të kontribuojë në sigurinë e grave që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore duke lehtësuar monitorimin nga ana e policisë të autorëve, gjë që mund ta bëjë atë të përgjegjshëm gjinor në zbatimin e tij.

Lidhur me miratimin në praktikë, në mars të vitit 2021, bazuar në informatat e mbledhura nga PK, Prokuroritë Themelore dhe Gjykatat Themelore, Avokati i Popullit publikuan një raport ku theksonte se Kosova ka dështuar në zbatimin e këtij ligji dhe si rrjedhojë nuk e ka përmbushur obligimin e saj për mbrojtjen e viktimave të dhunës.¹¹² Në raport shtohet se zbatimi i këtij ligji do të mbështeste shtetin në ofrimin e mbrojtjes efektive të viktimave të dhunës në familje. Këto veprime mund të kontribuojnë në zbatimin e urdhrave ndalues të lëshuar nga gjykatat kundër autorëve të dhunës, parandalimin e dhunës së mëtejshme dhe zvogëlimin e rezultateve fatale në rastet e dhunës në familje. Sfidat për zbatimin e ligjit kanë përfshirë gjyqtarët që nuk përfshijnë sigurimin e mbikëqyrjes në urdhrat e mbrojtjes, kryesisht për shkak të infrastrukturës së pamjaftueshme.

107 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendimin e Gjykatës](#), 2015, Neni 6.

108 Po aty, Neni 6.

109 Po aty, Neni 17.

110 Po aty, Neni 11.

111 Po aty.

112 Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, Raporti i Ombudspersonit të Republikës së Kosovës, [Rasti Nr. 621/2018 Për masat parandaluese operative për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit Nr. 037L-005 për monitorimin elektronik të personave që i nënshtrohen kufizimeve të lëvizjes të vendosura nga gjykata](#), 2021.

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore

Në vitin 2023, Kuvendi e miratoi këtë ligj të ri,¹¹³ i cili zëvendësoi ligjin e mëparshëm.¹¹⁴ Bazuar në Konventën e Stambollit, ligji i ri përfshin përkufizime të dhunës me bazë gjinore përveç dhunës në familje, e cila ishte forma e vetme e dhunës e trajtuar në ligjin e mëparshëm. Ligji i ri përmend ngacmimin seksual në internet midis përkufizimeve,¹¹⁵ por ai nuk e trajton atë dhe nuk i jep përgjegjësi institucioneve për raste të tilla. As ligji i vjetër dhe as ligji i ri nuk përmendin apo adresojnë dhunën kibernetike, krimin kibernetik, ndjekjen në internet, abuzimin seksual të bazuar në imazhe ose forma të tjera të dhunës të lidhura me mënyrat digjitale.

Ligji u mundëson gjykatave të lëshojnë urdhra mbrojtjeje ose urdhra mbrojtje emergjente, “që synojnë parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimës dhe personave të tjerë të ekspozuar ndaj dhunës, shmangien e pasojave” të dhunës dhe shmangien e rrethanave që mund të kontribuojnë në dhunën përsëritëse.¹¹⁶ Ligji i ri parashikon urdhra mbrojtjeje për të gjithë personat që vuajnë dhunën, duke përfshirë edhe marrëdhëniet jashtë familjes. Pasi të jepet, urdhri i dërgohet menjëherë policisë dhe palëve të tjera përkatëse.¹¹⁷ Shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën vepër penale që ndiqet menjëherë.¹¹⁸ Megjithatë, autorët vazhdojnë të shkelin urdhrat e mbrojtjes,¹¹⁹ të cilat mund të parandalohen në masë të madhe përmes mbikëqyrjes elektronike.

E vetmja referencë e ligjit të mëparshëm për digjitalizimin ishte: “Gjykata mund të mbajë seancën dëgjimore dhe lëshimin e urdhrit të mbrojtjes në mungesë të autorit, kur është e nevojshme, duke aplikuar edhe masa të tjera alternative, përfshirë ato elektronike.”¹²⁰ Megjithatë, kjo u hoq nga ligji i ri. Ligji i ri përmend mbikëqyrjen elektronike, duke parashikuar monitorimin elektronik të caktuar nga gjykata të zbatuar nga PK.¹²¹ Ligji nuk kërkon mekanizma koordinues për të futur të dhëna në sistemin e përbashkët të menaxhimit të rasteve, edhe pse mund të ketë.

Ky ligj është i **përgjegjshëm gjinor** në lidhje me nevojat e grave për mbrojtje nga dhuna, duke pasur parasysh se gratë statistikisht kanë më shumë gjasa të vuajnë dhunën sesa burrat. Megjithatë, Ligji është **përgjithësisht i ndjeshëm**

113 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore](#), 2023.

114 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me bazë Gjinore](#), 2023.

115 Po aty, Neni 3, Përkufizimet, pika 1.11.

116 Po aty, Neni 28.

117 Gjykatat duhet të vendosin për lëshimin e një urdhri mbrojtjeje brenda 15 ditëve nga kërkesa dhe një urdhër mbrojtjeje emergjente brenda 24 orëve (Po aty, nenet 49 dhe 58).

118 Po aty, Neni 58.

119 RrGK, [Nga Ligjet në Veprim](#), 2021, f. 83.

120 Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, neni 16, paragrafi 3.

121 Po aty, neni 31.

ndaj gjinisë, pasi nuk merr parasysh rreziqet e sigurisë me të cilat përballen burrat dhe djemtë; ai nuk ofron mbrojtje për djemtë që kanë pësuar dhunë seksuale, për shembull. Ligji i ri mund të kishte përcaktuar në mënyrë eksplicite dhe trajtuar forma të tjera digjitale të dhunës, të tilla si dhuna kibernetike, krimi kibernetik, sulmi kibernetik dhe abuzimi seksual i bazuar në imazhe. Mund të kishte ofruar mbrojtje më të madhe ligjore nga autorët që përdorin mjete digjitale për të ngacmuar ose frikësuar viktimat. Ligji mund të kishte parashikuar bashkëpunim ndërkombëtar për rastet që përfshijnë dhunën kibernetike, duke pranuar që abuzimi digjital mund të kapërcej kufijtë kombëtar. Institucioneve mund t'u kërkohej të mbledhin, mirëmbajnë dhe përpunojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me dhunën dhe rastet e trajtuara, duke përdorur teknologji të sigurta digjitale.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026

Objektivat e kësaj Strategjie përfshijnë: “Identifikimin dhe parandalimin e dhunës, avancimin dhe harmonizimin e politikave publike me standardet ndërkombëtare, forcimin institucional në parandalimin dhe trajtimin e dhunës në familje dhe ofrimin e shërbimeve të përgjithshme dhe shërbimeve të specializuara mbështetëse për viktimat”.¹²² Ai parasheh krijimin e një sistemi monitorimi digjital për zbatimin adekuat të urdhrave të mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Mbikëqyrjen Elektronike dhe monitorimin e efektivitetit të këtij sistemi.¹²³ Qeveria angazhohet të ndajë 15,000 € në vitin 2023 dhe 10,000 € në 2024 me MPB-në dhe PK-në që shërbejnë si institucione udhëheqëse dhe mbështetëse.¹²⁴ Ky objektivi parashikon gjithashtu sigurimin e teknologjisë për intervistimin e viktimave dhe autorëve. Për këtë, Qeveria planifikoi të shpërndajë 25,000 € në 2022-2023 dhe 15,000 € në 2024 me KGJK-në, Gjykatat, PK-në dhe prokurorin përgjegjës.¹²⁵ Ky veprim parashikon sigurimin e të drejtës së viktimave për konfidencialitetin dhe privatësinë në të gjitha fazat e menaxhimit të çështjes, duke përfshirë procedurat gjyqësore civile dhe penale.¹²⁶

Më tej, Strategjia parashikon “bashkëpunimin me mediat dhe kompanitë e teknologjisë së informacionit për të shmangur dhunën, ngacmimin seksual ose ngacmimin e grave dhe vajzave përmes mediave sociale dhe internetit” si dhe edukimin e “fëmijëve dhe prindërve për përdorimin e sigurt të internetit, mediave sociale dhe komunikimet elektronike”. Rezultati është i paqartë kështu që do të jetë e vështirë të matet ndikimi i objektivit: “Vajzat dhe gratë janë më të sigurta dhe të mbrojtura nga format e dhunës që mund të durojnë gjatë

¹²² Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2022, f. 10.

¹²³ Po aty, f. 43.

¹²⁴ Po aty.

¹²⁵ Po aty, f. 75.

¹²⁶ Po aty.

përdorimit të internetit dhe mediave sociale”.¹²⁷ Plani i Veprimit parashikon “një numër të shtuar të grave profesioniste të medias (gazetare, drejtuese, analiste, etj.) si dhe trajnimin e tyre për të qasur, përgatitur dhe menaxhuar informacionin e medias përmes teknologjisë.”¹²⁸ Ky tregues nuk ka asnjë objektiv. Strategjia gjithashtu parasheh trajnimin e Njësisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike të PK-së për “dhunën në internet ndaj grave”.¹²⁹

Në përgjithësi, Strategjia dhe Plani e Veprimit i saj është **transformuese gjinore**, duke kërkuar të adresoj dhunën me bazë gjinore dhe normat dhe stereotipet gjinore. Plani i Veprimit identifikon kostot e aktiviteteve, por është e paqartë se cilat institucione duhet t’i ndajnë shpenzimet e planifikuara në buxhetet e tyre vjetore. Monitorimi paraprak i strategjive të lidhura me dhunën në familje nga RrGK zbuloi se kjo mund të nënkuptoj se asnjë institucion nuk merr përgjegjësi për ndarjen e burimeve, dhe kështu aktiviteti mund të mos zbatohet.¹³⁰ Plani i Veprimit parashikon monitorimin periodik të zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të saj, si dhe publikimin e rezultateve në faqen e Ministrisë së Drejtësisë.¹³¹ Ministria publikoi raportin e parë vjetor të Strategjisë në mars 2023. Raporti evidentoi se asnjë nga aktivitetet e parashikuara në lidhje me dhunën digjitale, dhunën kibernetike ose teknologjinë nuk është zbatuar.¹³² Në Planin e Veprimit thuhet se disa aktivitete ishin planifikuar të fillonin në vitin 2023 ose të shtyeshin për vitin 2024, siç është krijimi i një sistemi monitorimi digjital për urdhrat e mbrojtjes. Të tjerat nuk u zbatuan si krijimi i faqeve të internetit për të informuar fëmijët dhe prindërit për përdorimin e sigurt të internetit dhe bashkëpunimin me mediat dhe kompanitë e TI-së për të shmangur dhunën dhe ngacmimin seksual të grave dhe vajzave nëpërmjet mediave sociale dhe internetit.

Strategjia e Sundimit të Ligjit 2021-2026

E miratuar në vitin 2021, kjo Strategji ka katër shtylla: sistemin gjyqësor dhe prokurorial, drejtësinë penale, qasjan në drejtësi dhe shërbime jo-gjyqësore dhe anti-korrupsion.¹³³ Kërkon pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në sektorin e sundimit të ligjit në të gjitha nivelet drejt barazisë gjinore, forcimit të mekanizmave institucional dhe ndërgjegjësimit të njerëzve për qasjan në drejtësi.¹³⁴ Ajo thekson se qasja në drejtësi mbetet sfiduese për grupet më të cenueshme në shoqëri, si gratë, fëmijët, të moshuarit,

127 Po aty, f. 65.

128 Po aty, f. 64.

129 Po aty, Akcion II.2.16, f. 83.

130 RrGK, [Nga Ligjet në Veprim](#), 2021, f. 65.

131 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2022, f. 86, Veprimi III.1.5.

132 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Raporti Vjetor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2023.

133 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026](#), 2021, f. 9.

134 Po aty, f. 8.

personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI dhe pakicat etnike.¹³⁵ Palët përballen me vështirësi në marrjen e informacionit për të drejtat e tyre, gjë që përbën një sfidë për qasjan në drejtësi. Një sfidë tjetër e përmendur është mosgatishmëria e akterëve të drejtësisë për të përdorur teknologjitë moderne të komunikimit.¹³⁶ Kështu, Strategjia ka një objektiv specifik (4.1.2.) për “rritje të efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial”, duke përfshirë avancimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë moderne në këtë sektor. Ndërsa Strategjia i konsideron gratë një kategori “të cenueshme”, është e paqartë se si ky objektiv do t’i ndihmoj gratë të kenë qasje më të mirë në drejtësi. Strategjia përmend dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore, por nuk trajton dhunën me bazë gjinore në internet ose dhunën kibernetike ndaj grave. Ajo përfshin një masë specifike për “Përmirësimin e qasjat në drejtësi të kategorive të cenueshme” me 12 objektiva në planin e saj të veprimit, shoqëruar me vlerësime buxhetore.¹³⁷ Sipas kësaj mase, dy objektiva lidhen me digjitalizimin: “Raportimi dhe integrimi konsistent i të dhënave në bazën e integruar të të dhënave për dhunën në familje dhe analizën e SIMÇ për të parë nëse përfshihen të dhëna të nevojshme për monitorimin e krimeve kundër komunitetit LGBTIQ+”.¹³⁸ Objektivat parashikojnë gjithashtu trajnime të specializuara për institucionet përgjegjëse për trajtimin e dhunës me bazë gjinore. Strategjia mund të kishte përfshirë trajnime specifike për Njësinë e Hetimit të Krimin Kibernetik për të trajtuar dhunën kibernetike, por nuk e bëri. Ndërsa të gjitha veprimet kanë buxhete, nuk ekziston një buxhet i qartë në mënyrë eksplicite për digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor. As buxheti i përgjegjshëm gjinor nuk përdoret duke treguar se si fondet do të mbështesin gratë, burrat dhe barazinë gjinore.

Ka pasur mundësi që Strategjia të jetë më transformuese gjinore, si p.sh. duke specifikuar objektiva më të qarta drejt transformimit të roleve gjinore që mund të kontribuojnë në përmirësimin e qasjat të grave në drejtësi. Strategjia nuk synon të transformoj marrëdhëniet e pushtetit, rolet gjinore dhe stereotipet, të tilla si në lidhje me rehabilitimin dhe risocializimin e autorëve. Kështu, Strategjia është e **përgjegjshme gjinore** në atë që njeh dallimet gjinore dhe kërkon t’i adresoj ato përmes disa objektivave të fokusuar në dhunën me bazë gjinore. Objektivat që lidhen me digjitalizimin dhe qasjan në drejtësi mund të kishin qenë më të përgjegjshme gjinore.

Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale

Bazuar në standardet ndërkombëtare, ky Protokoll përcakton përgjegjësitë e institucioneve “për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e viktimave/të

135 Po aty, f. 22.

136 Po aty, f. 23.

137 Po aty, Plani i Veprimit, ofruar RrGK-së nga Ministria e Drejtësisë, 2022, Masa: “Përmirësimi i Qasjes në Drejtësi të Kategorive të Cënueshme”.

138 Po aty.

mbijetuarve të sulmit seksual dhe dhunës”.¹³⁹ Ai nuk trajton dhunën seksuale në internet, siç është ngacmimi seksual i bazuar në imazhe, pasi Protokolli bazohet në kuadrin ligjor ekzistues për dhunën me bazë gjinore. Korniza ligjore e Kosovës do të duhet të përfshij rregulloren e dhunës kibernetike me bazë gjinore, abuzimin seksual të bazuar në imazhe, “sexting” dhe ngacmimet seksuale në internet në mënyrë që Protokolli t’i trajtoj këto. Ndërkohë, Protokolli parashikon ofrimin e shërbimeve si këshillimi nëpërmjet telefonit dhe online.¹⁴⁰ Në përgjithësi, Protokolli është i **përgjegjshëm ndaj gjinisë**, duke kërkuar t’u përgjigjet nevojave të viktimave/të mbijetuarve.

Procedurat Standarde Operative për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë

PSF-të e vitit 2013 do të kërkojnë ndryshim në përputhje me Konventën e Stambollit dhe ligjin e ri për dhunën me bazë gjinore, ndër legjislacionet e tjera. PSF-të nuk trajtojnë dhunën kibernetike.¹⁴¹ Ndërsa ato ofrojnë udhëzime të qarta për institucionet përgjegjëse në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, ato nuk trajtojnë forma të tjera të dhunës me bazë gjinore në përputhje me Konventën e Stambollit, duke përfshirë dhunën digjitale, sepse ato janë hartuar përpara Konventës së Stambollit. Tërthorazi lidhur me digjitalizimin, PSF-të përmendin linjën falas të ndihmës në kuadër të Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, e cila mundëson identifikimin e viktimave dhe referimin në institucionet përkatëse. PSF-të shpjegojnë se si viktimat mund të telefonojnë policin me telefon. Në përgjithësi, PSF-të janë **të përgjegjshme ndaj gjinisë**, duke u kujdesur për nevojat e personave që kanë pësuar dhunë. Në ndryshimin e PSF-ve, ato mund të vendosin përgjegjësi të qarta për institucionet për trajtimin e dhunës digjitale, duke përfshirë raportimin, hetimin, sigurimin e masave mbrojtëse, rehabilitimin dhe riintegrimin. PSF-të gjithashtu mund të krijojnë tele-këshillim digjital dhe përgjegjësi të qarta institucionale për menaxhimin e sigurt elektronik të rasteve dhe të dhënave.

Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027

Kjo Strategji thekson se Qeveria “do të investoj në fushën e sigurisë kibernetike, infrastrukturës kritike, inovacionit dhe teknologjisë dhe ngritjes së kapaciteteve”.¹⁴² Ajo përmend transformimin digjital si një fushë kyçe të investimeve në lidhje me arsimin, planifikimin për të rishikuar arsimin dhe trajnimin profesional (AFP) në dispozicion dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit mbi aftësitë teknike të transferueshme, digjitale, sipërmarrëse dhe profesionale, sipas nevojave të tregut të punës, tendencat digjitale dhe

139 Republika e Kosovës, Qeveria, [Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#), Vendimi nr. 11/109, 2022, f. 6.

140 Po aty, f. 106.

141 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Procedurat Standarde të Operacionit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në Kosovë](#), 2013. PFS-të ekzistojnë gjithashtu për adresimin e trafikimit, por RrGK nuk mundi t’i gjejë ato online për analiza.

142 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia e Sigurisë së Kosovës 2022-2027](#), 2022, f. 12.

transformimi i gjelbër.¹⁴³ Përpjekjet drejt transformimit digjital do të fokusohen në “promovimin dhe investimin në: njerëzit, infrastrukturën, ekosistemin e inovacionit, partneritetet publiko-private, digjitalizimin e shërbimeve, sigurinë kibernetike dhe anëtarësimin në organizata ndërkombëtare”.¹⁴⁴ Strategjia planifikon të investoj në burime njerëzore, financiare dhe infrastrukturore për sistemet e paralajmërimit të hershëm për të parandaluar dhe menaxhuar krizat në shëndetësi, energji dhe mjedis.

Strategjia nuk i referohet formave të dhunës kibernetike apo gjinisë. Konceptimi i saj i sigurisë kombëtare nuk merr parasysh se si gratë dhe burrat e ndryshëm mund ta perceptojnë sigurinë ndryshe dhe të kenë nevoja të ndryshme për sigurinë njerëzore, duke përfshirë kërcënimet që rrjedhin nga transformimi digjital.¹⁴⁵ Ndërsa siguria kombëtare fokusohet në sigurinë e shtetit dhe kufijve të tij, siguria njerëzore thekson sigurinë e kërcënimeve individuale dhe joushtarake si siguria sociale, ekonomike dhe mjedisore.¹⁴⁶ Është e paqartë nëse Strategjia përfshinte konsultime adekuate publike, duke përfshirë ABGJ-në, ZBGJ-të dhe OGS HQ-të. As nuk duket se Strategjia i është nënshtruar një VN(B)GJ-je. Strategjia është **neutrale gjinore**.

Në Strategji thuhet se Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës ka përgjegjësi të hartoj një raport vjetor për zbatimin e Strategjisë. Sekretariati duhet të zhvilloj “një matricë të detajuar për monitorimin e zbatimit të kësaj strategjie tre muaj pas miratimit të saj”.¹⁴⁷ Derisa Strategjia u miratua në tetor 2022, RrGK nuk mundi të gjente një Plan Veprimi të publikuar ende. Prandaj, reagimi gjinor i rezultateve, treguesve, bazave, objektivave dhe buxhetit nuk mund të vlerësohej. Matrica, ose çdo plan veprimi i ardhshëm, mund të përfshij një perspektivë të përmirësuar gjinore në objektiva, tregues, baza, objektiva, masa dhe buxhet, duke përfshirë kapitullin mbi transformimin digjital dhe dhunën kibernetike.

Strategjia e Kosovës për Sigurinë Kibernetike 2023-2027

Mbikëqyrja elektronike mund të përfshijë mekanizma të tillë si etiketat që garantojnë zbatimin efektiv të vendimit të gjykatës për një urdhër mbrojtjeje duke përcaktuar në kohë reale vendndodhjen e një personi.⁴⁸³ Aktivistët e të drejtave të njeriut kanë bërë thirrje për përdorimin e byzylykëve elektronikë për të shmangur dhunën recidiviste dhe femicidin mes shkeljeve të vazhdueshme të urdhrave të mbrojtjes dhe mekanizmave të dobët për monitorimin e këtyre urdhrave.⁴⁸⁴ Ligji ka parashikuar masa të tilla që nga viti 2015.⁴⁸⁵ Megjithatë, Kosova nuk ka infrastrukturë në dispozicion,⁴⁸⁶ gjegjësisht byzylykë elektronikë, softuerë, salla operative për mbikëqyrje elektronike,⁴⁸⁷ dhe trajnimin e stafit.⁴⁸⁸ Avokati i Popullit ka rekomanduar që MPB-ja dhe PK-ja të zbatojnë detyrat e tyre ligjore për kryerjen e monitorimit elektronik, si dhe mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të marra nga

481 LMDHP, neni 14. PK-ja nuk ka ofruar informata për këtë në përgjigje të kërkesës së RrGK-së.

482 EULEX, “Donacion i pajisjeve të TI-së dhe mobilieve të zyrës për Qendrën për Punë Sociale në Mitrovicën e Jugut”, 2020.

483 Një “byzylyk” është një pajisje elektronike e vendosur në trupin e një personi (zakonisht kyçin e dorës ose kyçin e këmbës), i cili i mundëson policisë të përcaktojë vendndodhjen e tij/saj në kohë reale. Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, 19 shkurt 2014, takimi 1192 i Zëvendës Ministrave; shih gjithashtu Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Problemet e Krimit, [Këshilli për Bashkëpunimin Penologjik, Draft Komentari i Rekomandimit për Monitorimin Elektronik](#), 2013. [Rekomandimi CM/Rec\(2014\)4 i Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për monitorimin elektronik](#), 19 shkurt 2014, Mbledhja e 1192-të e Zëvendës Ministrave; shih gjithashtu Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Problemet e Krimit, [Këshilli për Bashkëpunimin Penologjik, Draft Komentari i Rekomandimit për Monitorimin Elektronik](#), 2013.

484 EULEX, “EULEX-i mbështet lansimin e raportit të FOL [Etiketat elektronike: fokusi në parandalimin e rasteve të dhunës në familje](#)”, 7 dhjetor 2021, qasur më 20 dhjetor 2023.

485 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendim të Gjykatës](#), 2015.

486 RrGK, Nga Ligjet në Veprim, 2021, f. 54.

487 Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, “Raporti i Ombudspersonit të Republikës së Kosovës, Lënda nr. 621/2018 [lidhur me masat parandaluese operative për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për elektronik monitorimi i personave që i nënshtrohen kufizimeve të lëvizjes të vendosura nga gjykata](#)”, 2021.

488 *Kosova Press*, “Byzylykë elektronikë; ekspertët: 600.000 euro nuk mjaftojnë, zbatimi i ligjit është i domosdoshëm”, 2023, qasur më 20 dhjetor 2023.

pajisjet.⁴⁸⁹ Byzylykët elektronikë mund të jenë të vështira për t'u përdorur në situata ku autorët dhe viktimat jetojnë së bashku, gjë që në përgjithësi është dëshmuar sfiduese për PK-në në sigurimin që autorët të mos shkelin urdhrat e mbrojtjes, pasi autorët shpesh banojnë me viktimat, duke pasur parasysh mungesën e pronësisë së grave dhe pavarësinë ekonomike.⁴⁹⁰ Në varësi të rastit, byzylykët elektronikë mund të kenë nevojë të kombinohen me masa të tjera të urdhrit të mbrojtjes për zbatimin e duhur, si p.sh. t'i kërkohet autorit të gjejë strehim alternativ ose të paguaj qiranë për viktimën për të jetuar diku tjetër. Në vitin 2023, Qeveria ndau 600,000 € për "Sistemin Elektronik të Monitorimit" për blerjen e byzylykëve elektronikë dhe fillimin e zbatimit të ligjit.⁴⁹¹ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave parashikon "Zbatimin e sistemit të monitorimit digjital për zbatimin e duhur të Urdhrave të Mbrojtjes në përputhje me Ligjin për Monitorimin Elektronik dhe monitorimin e efektivitetit të këtij sistemi", për të cilin Qeveria ka ndarë 15,000 € për vitin 2023 dhe 10,000 € për vitin 2024 nga Buxheti i Kosovës për MPB-në dhe policinë për të krijuar këtë sistem digjital dhe për ta monitoruar atë në mënyrën e duhur.⁴⁹²

Praktikat nga vendet që zbatojnë monitorimin elektronik tregojnë se ai ka një efekt të rëndësishëm në uljen e rasteve të dhunës në familje; provat tregojnë një shkallë më të madhe të pajtueshmërisë me urdhrat e gjykatës kur shkelësit monitorohen në mënyrë elektronike.⁴⁹³ Ka shumë përfitime nga monitorimi GPS: pakësimi i riviktimizimit, qetësi shtesë për viktimat dhe rritje e autonomisë së viktimës.⁴⁹⁴ Këto duhet të merren parasysh në përsheptimin e funksionalizimit të mbikëqyrjes elektronike të autorëve.

Instituti Mjekësor Ligjor

Ky institut është përgjegjës për shqyrtimin e rasteve, duke përfshirë dhunën seksuale me bazë gjinore. Ai i raporton Ministrisë së Drejtësisë.⁴⁹⁵ Sipas të dhënave të tij, kjo dhunë zakonisht ushtrohet ndaj grave dhe vajzave, dhe në

489 Kjo është në pajtim me Republikën e Kosovës, Kuvendin, [Ligjin nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave Lëvizja e të cilëve Kufizohet me Vendimin e Gjykatës](#), 2015, Neni 10 (Republika e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, "Report of the Ombudsperson of the Republic of Kosovo, Case No. 621/2018 Raporti i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, rasti nr. 621/2018 lidhur me masat parandaluese operative për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për monitorimin elektronik të personave që i nënshtrohen shqiptimit kufizimet e lëvizjes", 2021).

490 RrGK, [Nga Ligjet në Veprim](#), 2021, f. 86.

491 *Koha.Net*, "Projekti për mbikëqyrjen e personave të cilëve u kufizohet liria e lëvizjes nga gjykata", 2023.

492 Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2022, [Plani i Veprimit](#), Masa e Veprimit II.1.1 2., Masa Specifike 1.8, f. 80.

493 Blair Gilbert, "Praktika premtuese: Monitorimi GPS për shkelësit e urdhrave të mbrojtjes", [Projekti i drejtësisë së grave të dhunuara](#), 2014.

494 Po aty.

495 Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, [Instituti për Mjekësi Ligjore](#), qasur më 20 December 2023.

disa raste edhe djemve, ku 70% e rasteve përfshijnë të mitur.⁴⁹⁶ Megjithatë, Instituti nuk mban të dhëna dhe statistika të ndara sipas gjinisë.⁴⁹⁷ Zyrtarët thanë se “për Ekspertët e Mjekësisë Ligjore të TI-së, të dhënat/identiteti i personave janë të parëndësishme”; përkundrazi, ato fokusohen në “urdhrin e Prokurorit apo të Gjykatës” në lidhje me atë që duhet të shqyrtohen. Instituti ka të dhëna dhe dëshmi mjekësore. Një kopje e raporteve ruhet në kompjuterët lokal dhe arkivohet. Të dhënat e vetme që ruajnë janë një kopje elektronike e raportit të ekzaminimit. Është thelbësore të mbrohen këto të dhëna.

Prandaj, zjarri i fundit në Institut⁴⁹⁸ ishte shkak për shqetësim, duke demonstruar rëndësinë e sigurimit të ruajtjes së sigurt të të dhënave elektronike që kanë të bëjnë me rastet. Instituti nuk ka humbur asnjë dëshmi për shkak të masave parandaluese të marra.⁴⁹⁹ Aktualisht, të dhënat “ruhen vetëm në nivel lokal në kompjuterët e mjekësisë ligjore digjitale që janë shkëputur nga rrjeti, gjë që rriti nivelin e sigurisë së informacionit [...] sepse nuk janë subjekt i rreziqeve të sulmeve në internet”. Praktikant më të mira në sigurinë e të dhënave inkurajojnë që të gjitha të dhënat të ruhen dhe të kopjohen në tre vende të ndryshme, duke përfshirë ruajtjen kompjuterike dhe kopje të shtypura për të siguruar mbrojtje të përshtatshme. Në të vërtetë, humbja e të dhënave është përmendur si arsye pse Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), dhe më vonë EULEX, nuk mund të sillnin drejtësi për rastet e dhunës me bazë gjinore të kryera gjatë luftës.⁵⁰⁰ Ky mësim i nxjerrë është dëshmi e rëndësisë së sigurimit të ruajtjes dhe rezervimit të sigurt të dosjeve të rasteve që përfshijnë dhunën me bazë gjinore. Në të ardhmen, Instituti shpreson të siguroj mbështetje financiare për avancimin e teknologjisë aktuale, e cila do të mundësonte ruajtjen e të dhënave në një vend shtesë të sigurt jashtë objektit.⁵⁰¹

Prokuroria dhe MV

Prokuroria ka marrë pajisje IT nga donatorët. Është në “fazën tranzitore” të përdorimit të SMIR për menaxhimin e të dhënave.⁵⁰² Departamenti për Teknologji Informativë i KPK-së është përgjegjës për sigurimin e zbatimit të SMIR-it në të gjithë sistemin prokurorial. Ai ofron trajnime në vendin e punës për prokurorët dhe stafin administrativ. Informacioni publik nuk ishte i disponueshëm nëse trajnimi ndihmon stafin të përfshij ose analizoj të dhëna të ndara sipas gjinisë.

496 EULEX, “Sjellja e autorëve të dhunës seksuale para drejtësisë: Një diskutim mbi nevojën për një bashkëpunim më efektiv ndër-institucional”, 6 dhjetor 2021.

497 Korrespondenca e RrGK me Institutin e Mjekësisë Ligjore, Gusht 2023.

498 *Nacionale*, “Zjarri në Institutin e Mjekësisë Ligjore, policia: Rasti nën hetim”, Prill 2023.

499 Korrespondenca e RrGK me Institutin e Mjekësisë Ligjore, Gusht 2023.

500 RrGK, 1325 *Fakte & Fabula*, Botimi i Dytë, 2022, f. 138.

501 Korrespondenca e RrGK me Institutin e Mjekësisë Ligjore, Gusht 2023.

502 Po aty, f. 67. Projekti i Fazës Kalimtare QIK/SIMÇ për 2022-2024 financohet nga Ambasada Norvegjeze. Prokuroria ka 50,000 euro për finalizimin e SMIR-it nga të cilat thuhet se janë shpenzuar vetëm 9%.

MV-të kanë një bazë të dhënash të brendshme që përfshin se kush ka komunikuar me secilin rast, çfarë ka ndodhur dhe nëse rasti ka një urdhër mbrojtjeje. Ai ka të dhëna të ndara sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe komunës. Një sistem më gjithëpërfshirës i menaxhimit të rasteve nuk ekziston. Prokuroria ka iniciuar një sistem elektronik të menaxhimit të lëndëve për Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave.⁵⁰³ Qeveria ka planifikuar të forcoj

këtë zyrë me “kapacitete adekuate njerëzore, financiare dhe infrastrukturore”, duke përfshirë sigurimin e kompjuterëve me performancë të avancuar dhe qasje në sistemin elektronik të menaxhimit të rasteve për të gjitha MV-të.⁵⁰⁴ Ambasada e SHBA-së ka furnizuar drejtuesit e zyrave rajonale me laptop dhe KPK kërkon të siguroj që stafi të ketë infrastrukturën e nevojshme për punën e tyre për aq sa buxheti e lejon.⁵⁰⁵

“Të dhënat statistikore të bazuara në gjini kërkojnë shumë punë pasi nuk janë pjesë e raporteve standarde. Për informacionin tuaj, për të nxjerrë të dhënat në bazë të gjinisë, çdo subjekt duhet të analizohet veçmas. Pra, JO! Ne nuk mund të nxjerrim të dhëna të tilla!”

- KGJK

Këshilli gjyqësor i Kosovës dhe Gjykatat

Gjykatat përdorin SMIR për procedimin e të gjitha rasteve, përfshirë ato penale, civile, administrative, ekonomike dhe kundërvajtëse.⁵⁰⁶ Të dhënat ruhen në Pallatin e Drejtësisë. Përderisa KGJK raporton kapacitete të mjaftueshme në lidhje me softuerin dhe harduerin, ajo ende ka nevojë të institucionalizoj nënshkrimin digjital.⁵⁰⁷ KGJK nuk ka mundur të siguroj të dhëna të ndara sipas gjinisë për rastet e krimit kibernetik. Sipas KGJK-së, “Të dhënat statistikore të bazuara në gjini kërkojnë shumë punë pasi nuk janë

pjesë e raporteve standarde”. Në fillim, përfaqësuesit e KGJK-së thanë se mund të nxjerrin të dhëna të tilla, nëse është e nevojshme, duke qenë se numri i rasteve të krimit kibernetik është i ulët. Megjithatë, ata më vonë refuzuan sepse kërkonte shumë kohë. As KGJK-ja nuk mund të nxirrte të dhëna statistikore lidhur me personat me aftësi të kufizuara, edhe pse gjykatat kishin trajtuar raste të tilla.⁵⁰⁸ Kjo sugjeron sisteme joadekuate për mbledhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave, pavarësisht kërkesave në Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026.⁵⁰⁹ Pamundësia për të ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë sugjeron se SMIR ka nevojë për kategori shtesë dhe/ose stafi ka nevojë për trajnim për të siguruar futjen e duhur të të dhënave.

503 Po aty. Me sa duket është pjesë e projektit TIK/SIMÇ.

504 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Raporti Vjetor për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2023, f. 87.

505 Po aty.

506 Korrespondenca e RrGK me KGJK, shtator 2023.

507 Po aty.

508 Po aty.

509 Qeveria, Ministria e Drejtësisë, [Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026](#), 2022, f. 46.

Gjykatat themelore janë në proces të digjitalizimit të dosjeve dhe arkivave. Departamenti i Teknologjisë Informative të KGJK-së ka integruar SMIR-in me Sistemin Qendror Kombëtar të Dokumentave Penale dhe projektin e regjistrimit audio dhe video.⁵¹⁰ KGJK ka përparuar në miratimin e kriterëve për shpërndarje automatike të rastësishme të lëndëve tek gjyqtarët e gjykatave themelore përmes SMIR-it.⁵¹¹ Analiza gjinore nuk informoi projektimin e këtyre sistemeve. Kjo mund të kontribuoj në pabarazitë gjinore. Për shembull, caktimi i rastësishëm i gjyqtarëve ka çuar në rastet e dhunës me bazë gjinore që iu caktohen gjyqtarëve që nuk kanë marrë trajnim të specializuar për trajtimin e rasteve të tilla.⁵¹² Kjo mund të nënkuptojë se atyre u mungojnë njohuritë dhe aftësitë adekuate për trajtimin e duhur të rasteve. Ky rrezik mund të shmanget duke përfshirë kriteret shtesë në programin softuer, sipas të cilit certifikimi i dhunës me bazë gjinore figuron në algoritmin që përcakton caktimin e gjyqtarit.

Konventa e Stambollit kërkon që të gjitha palët të vënë në dispozicion infrastrukturën, duke u mundësuar viktimave të dëshmojnë me teknologjitë e duhura të komunikimit. KPP gjithashtu lejon dëshminë përmes teknologjisë video-konferencë në drejtim të mbrojtjes së dëshmitarëve.⁵¹³ EULEX-i ka vërejtur një dështim në sigurimin e regjistrimit audio sipas KPP-së, duke ia atribuar këtë kryesisht mungesës së burimeve teknike.⁵¹⁴ Sipas KGJK:

Vetëm disa gjykata janë të pajisura me të gjitha mjetet përkatëse teknologjike për të mbrojtur dëshmitarët në procedurat gjyqësore, duke u mundësuar atyre që të japin dëshminë e tyre edhe jashtë gjykatave. Këto mjete ofrojnë mundësinë për të mbetur anonim duke ndryshuar zërin dhe duke mos treguar fytyrën. Tani për tani, këto mjete janë në dispozicion në Gjykatat Themelore të Prishtinës, Gjilanit dhe Prizrenit. Një projekt i Ambasadës Amerikane do të mundësojë pajisjen e të gjitha gjykatave të tjera themelore me mjete të tilla. Projekti synon të pajis 27 gjykata me mjete audio dhe video, pajisje regjistrimi, përkthim të njëkohshëm, mjete transkriptimi dhe trajnim të IT dhe stafit për përdorimin e mjeteve.⁵¹⁵

510 Republika e Kosovës, KGJK, [Raporti Vjetor i Punës 2022](#), f. 40.

511 Digjitalizimi i të dhënave, SMIR dhe platforma e noterëve kanë marrë mbështetje nga UNDP (intervistë e RrGK me UNDP, 2023). RrGK nuk mund të gjente informacione për platformën e noterëve në internet.

512 RrGK, [Nga Ligjet në Veprim](#), 2021, f. 92.

513 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Kodi Nr. 08/L-032 Kodi i Procedurës Penale të Kosovës](#), 2022, neni 147.

514 EULEX, [Raporti i Monitorimit të Drejtësisë](#), 2021.

515 Korrespondenca e RrGK me KGJK, maj 2023.

Infrastruktura për mbrojtjen e grave dhe burrave në procedurat gjyqësore duket e kufizuar në vetëm tri komuna, megjithëse gjykatat që u mungojnë këto mjete mund të mbajnë seanca në gjykata me mjete të tilla.⁵¹⁶ Sipas EULEX-it, mangësitë teknike kontribuojnë në zgjatjen e panevojshme të seancave dëgjimore për shkak të procesit që kërkon kohë të prodhimit të shënimeve me shkrim, devijimit të vëmendjes nga elementet kryesore të seancave dhe përkeqësimit të mundshëm të cilësisë së dëshmive.⁵¹⁷ Pajisja e gjykatave me teknologjinë e duhur dhe dhënia e aftësisë për të regjistruar audio-regjistrimin e seancave në sallën e gjyqit do të kontribuonte në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së procedurave gjyqësore. Kjo do të ishte veçanërisht e dobishme kur bëhet fjalë për marrjen në pyetje të palëve dhe dëshmitarëve. Me mbështetjen e EULEX-it, gjykatat kanë filluar instalimin e televizorëve në sallat e gjyqit, të cilat u mundësojnë grave, ndër të tjera, të dëshmojnë jashtë sallës së gjyqit dhe jashtë syve të autorëve të dyshuar. Megjithatë, përdorimi i një infrastrukture të tillë mbetet i ulët.

Zyrat e Ndhmës Juridike Falas

Përfaqësuesit e Agjencisë së Ndhmës Juridike Falas deklaruan se kanë një bazë të dhënash “shumë funksionale” që nga viti 2013, e cila është ridizajnuar në vitin 2018; ajo përfshin të gjithë personat që aplikojnë për ndihmë juridike falas, të dhënat e tyre dhe informacionin rreth shërbimeve të ofruara.⁵¹⁸ Mund të gjeneroj statistika në lidhje me përfituesit e ndihmës juridike falas. Në vitin 2023, Agjencia shtoi kategoritë për ngacmimet seksuale në bazën e të dhënave. Që nga gushti 2023, ishte raportuar një rast ngacmimi dhe një ngacmimi seksual.⁵¹⁹ Agjencia nuk ka të dhëna për krimet kibernetike. As nuk ruan të dhëna për shërbimet e ndihmës juridike të ofruara për personat me aftësi të kufizuara në lidhje me krimet digjitale. Në mënyrë të ngjashme, ata nuk u kërkojnë personave LGBTQI+ të ndajnë informacione për identitetin e tyre gjinor ose orientimin seksual, kështu që një informacion i tillë nuk ruhet. Ndërkohë, Agjencia ofron ndihmë juridike për të gjithë njerëzit, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike apo orientimi seksual.⁵²⁰ Agjencia ka sisteme shtesë të menaxhimit të të dhënave të brendshme.⁵²¹

Institucioni Ombudsperson

Ky Institucion ka një sistem elektronik të menaxhimit të të dhënave për gjurmimin e rasteve. Megjithatë, ai nuk ka “një sistem adekuat të menaxhimit të të dhënave për të gjurmuar në mënyrë sasiore llojet e rasteve të asistuar dhe rezultatet e tyre, por planifikohet të zhvilloj një bazë të dhënash të tillë”.⁵²²

516 Po aty.

517 EULEX, Raporti i Monitorimit të Drejtësisë, 2021.

518 Korrespondenca e RrGK me Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas, Shtator 2023.

519 Po aty.

520 Po aty.

521 Për shembull, këto përfshijnë MBNJSE dhe *Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës*.

522 RrGK, *Nga Ligjet në Veprim*, 2021, f. 125.

Në bazën e tij elektronike të të dhënave online për pranimin e ankesave, Ombudspersoni nuk ka një kategori për diskriminim në bazë gjinore.⁵²³

Njerëzit

Ky seksion analizon shkrim-leximin digjital, duke përfshirë ndërgjegjësimin e ndryshëm të grave dhe burrave për shërbimet digjitale që lidhen me sundimin e ligjit, mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë kibernetike; shkallën në të cilën ata

kanë qasje dhe përdorin mjete digjitale që lidhen me krimin kibernetik; dhe përdorimin e tyre të shërbimeve të drejtësisë për të adresuar dhunën digjitale.

“Qytetarët priren të mos lexojnë standardet e mbrojtjes së të dhënave [dhe] niveli i ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave mbetet shumë i ulët.”

– Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave të Kosovës

Literatura Digjitale, Ndërgjegjësimi dhe Mbrojtja

Përderisa RrGK nuk mundi të gjente ndonjë hulumtim në mbarë Kosovën, intervistat sugjeruan se njerëzve u mungonin informacionet në lidhje me format e ndryshme të krimit kibernetik dhe të drejtat e tyre për t’u mbrojtur prej tij. Njerëzit nuk i kuptojnë rreziqet që paraqet interneti për fëmijët dhe prindërit thuhet se nuk i mbrojnë siç duhet fëmijët e tyre nga dhuna, veçanërisht shantazhi, i cili prek në masë të madhe gratë dhe vajzat.⁵²⁴ Fëmijët nuk janë të vetëdijshëm për

dëmin e shkëmbimit të përmbajtjes në internet, si fotografitë dhe videot, gjë që i bën ata veçanërisht të ndjeshëm ndaj shfrytëzimit.⁵²⁵ Pavarësisht përpjekjeve të AIP-it për të rritur ndërgjegjësimin, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave në Kosovë vuri në dukje se qytetarët në përgjithësi nuk e dinë “si përpunohen të dhënat e tyre, pse dhe kur”.⁵²⁶ Komisioneri i tha RrGK-së: “Qytetarët e Kosovës priren të mos i lexojnë standardet e mbrojtjes së të dhënave të kontraktorëve dhe operatorëve të ndryshëm. Si të tillë, edhe pse kemi vërejtur përmirësime të lehta, niveli i ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave mbetet shumë i ulët.”⁵²⁷ Vetëm disa iniciativa në Kosovë kanë rritur ndërgjegjësimin për mbrojtjen e të dhënave.⁵²⁸ Edhe më pak përpjekje

523 RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), 2022, f. 76.

524 ABGJ, intervistë RrGK, 2023.

525 Fadil Abdyli, shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, PK, dhe Krenare Sogojeva Drëmak, Komisionere e Kosovës për Informim dhe Privatësi, [deklaratë](#) e bërë gjatë programit televiziv “Divers – ‘Mbrojtja e të dhënave personale në internet’”, RTK, YouTube, 10 shkurt 2023, qasur më 22 nëntor 2023.

526 RTK, [“Divers - Mbrojtja e të dhënave personale në internet”](#), 10 Shkurt 2023.

527 Intervistë e RrGK me AIP, 2021.

528 Shih seksionin mbi AIP në Kapitullin 1 dhe kapitullin Edukimi.

kanë përfshirë një perspektivë gjinore, të tilla si mënyrat se si gratë, burrat dhe personat e tjerë identifikues mund të jenë në rrezik. Ndërgjegjësimi i qytetarëve në lidhje me përpunimin e të dhënave në internet dhe krimin kibernetik është gjithashtu i ulët, gjë që kontribuon në shkeljen e të drejtave të mbrojtjes së të dhënave.⁵²⁹

Sa i përket ndërgjegjësimit lidhur me sinjalizimin, Instituti Demokratik i Kosovës ka bërë një studim për zbatimin, ndërgjegjësimin dhe zbatimin e përgjithshëm të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve me punonjësit e sektorit privat dhe nëpunësve civil. Studimi zbuloi se shumica e të anketuarve nuk do të raportonin një kërcënim ose dëmtim të interesit publik.⁵³⁰ Pak më shumë se gjysma e të anketuarve (52%) besonin se ndërmarrja e një veprimi nuk do të kishte ndonjë ndikim pozitiv. Për më tepër, disa besonin se sinjalizimi do të ndikonte në statusin e tyre të punësimit (27%) ose degradimin e karrierës (29%).⁵³¹ Më pak të anketuar (21%) raportuan frikën nga hakmarrja si arsye për mos raportim. Të anketuarve të cilët deklaruan se nuk do të ndiheshin të sigurt duke raportuar kërcënime ose dëmtime ndaj interesit publik ndaj personave përgjegjës për sinjalizimin, iu kërkua të elaborojnë pse; 54% nuk kishin besim te zyrtari përgjegjës për trajtimin e raporteve të sinjalizimit. Të anketuarit përmendën mungesën e integritetit profesional të zyrtarit sinjalizues (39%) dhe marrëdhënien e personit me personat e dyshuar të përfshirë në këtë rast (29%).⁵³² Studimi nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë. Ndërkohë, sugjeron se as gratë dhe as burrat nuk duket se do të raportojnë rastet.

Studimi i mëtejshëm i ndërgjegjësimit të ndryshëm të grave dhe burrave në lidhje me sinjalizimin, duke përfshirë të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi prevalencën, mund të zbuloj nëse gratë mund të kenë më pak gjasa të raportojnë shkeljet e ligjit në mënyrë digjitale. Arsyet e mundshme për mos raportimin e grave mund të jenë se ato janë më pak të punësuar në sektorin publik dhe privat, frika e humbjes së punës, frika për sigurinë e tyre dhe/ose mungesa e besimit në institucionet gjyqësore. Anonimiteti i ofruar nëpërmjet zgjidhjeve të raportimit digjital mund të lehtësoj raportimin.

Përdorimi i teknologjisë për krimin kibernetik

Në vitin 2022, PK kishte 131 raste të raportuara për qasje të gabuar në sisteme kompjuterike, 38 raste të vjedhjes së identitetit dhe dy raste të shkeljeve të bazave të të dhënave kompjuterike. Rritja e sulmeve kibernetike kundër mediave ka ndikuar në punën e tyre.⁵³³ Ndërkohë, institucionet përjetuan edhe disa sulme kibernetike, duke çuar në keqfunksionime të faqeve të tyre

529 Abdyli, Fadil, shef i Njesisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, PK, [deklaratë](#) e bërë gjatë programit televiziv "Divers – Mbrojtja e të dhënave personale në internet", RTK, YouTube, 10 shkurt 2023, qasur më 22 nëntor 2023.

530 Instituti Demokratik i Kosovës, [Ligji për Mbrojtjen e Denoncuesve](#), 2020, f. 29.

531 Po aty.

532 Po aty.

533 Po aty.

të internetit dhe sistemeve të punës.⁵³⁴ Përkundër kërkesave, PK-ja nuk ka ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me autorët e krimeve kibernetike. Megjithatë, oficerët vunë re se shumica e autorëve kanë qenë burra.⁵³⁵

Dhuna me bazë gjinore është dhuna e ushtruar ndaj një personi për shkak të gjinisë së tij/saj. Duke pasur parasysh normat shoqërore dhe marrëdhëniet e pushtetit, gratë priren të përjetojnë dhunë me bazë gjinore më shumë se burrat. Dhuna me bazë gjinore është një shkelje e të drejtave. Shumica e formave të dhunës me bazë gjinore përbëjnë vepra penale që kërkojnë veprim nga ofruesit e drejtësisë, duke përfshirë policinë, prokurorët dhe gjyqtarët, në drejtim të garantimit të sundimit të ligjit. Dhuna me bazë gjinore është e përhapur në Kosovë dhe në mbarë botën. Sondazhi përfaqësues i OSBE-së me 1990 gra të moshave 18-74 vjeç zbuloi se 54% kishin përjetuar dhunë psikologjike, fizike ose seksuale nga duart e një partneri intim që nga moshën 15 vjeç, dhe 29% kishin përjetuar ngacmime seksuale.⁵³⁶ Ekzistojnë dallime minimale në prevalencën e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore në zonat urbane dhe rurale, por moshën ishte një faktor kyç. Gratë e reja (mosha 18-29 vjeç) kishin më shumë gjasa të deklaronin se kishin përjetuar ngacmime seksuale që nga moshën 15 vjeç. Aty ku 29% e të gjitha grave raportuan një ngacmim të tillë, 42% e grave të reja e kishin përjetuar atë. Për më tepër, 24% e grave të reja kishin përjetuar ngacmime seksuale vitin e fundit. Ndërkohë, gratë mbi 60 vjeç kishin më shumë gjasa të deklaronin se kishin pësuar dhunë fizike dhe/ose seksuale gjatë jetës së tyre. Gratë serbe kishin më shumë gjasa se gratë shqiptare të raportonin se kishin përjetuar dhunë fizike ose seksuale. Gjetjet sugjeruan që rastet nuk raportohen, veçanërisht në zonat rurale.

Hulumtimet tregojnë se dhuna me bazë gjinore jashtë linje pasqyron dhunën me bazë gjinore në internet. Një raport zbuloi se 45% e viktimave të dhunës në familje kishin përjetuar një formë abuzimi në internet gjatë marrëdhënies së tyre dhe 48% raportuan se kishin përjetuar ngacmime ose abuzime në internet nga ish-partneri i tyre pasi kishin lënë një lidhje.⁵³⁷ Rreth 38% raportuan se u përballën me ndjekje në internet pasi kishin lënë lidhjen dhe 75% raportuan se policia nuk dinte si t'i përgjigjej abuzimit dhe ngacmimit në internet. Raporti zbuloi se abuzimi i autorëve është veçanërisht shkatërrues për shkak të natyrës "gjithmonë aktive" të jetës në internet.⁵³⁸ Kjo mund të ndihet e lodhshme dhe e pashmangshme për viktimat pasi mund të jetë e vështirë të bllokosh plotësisht abuzuesin nga kontakti. As nuk është e lehtë

534 Radio Evropa e Lirë, "Sulmet kibernetike, Kosovës i kanë ardhur nga Serbia deri te Rusia", 12 Korrik 2019, qasur më 15 Gusht 2023.

535 Intervistë e RrGK me Njësinë e Hetimit të Krimeve Kibernetike të PK-së, nëntor 2021. Në përgjithësi, burrat kanë shumë më tepër gjasa se gratë të kryejnë krime; në vitin 2015, 95% e të rriturve të dënuar nga gjykatat themelore ishin burra dhe në vitin 2016, 96% e shkelësve të mitur ishin djem (RrGK, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018).

536 OSBE, [Anketa për mirëqenien dhe sigurinë e grave](#), 2019.

537 Hulumtimi i Women's Aid, [Women's Aid mbi abuzimin e marrëdhënieve intime dhe të rinjtë](#) (18 deri në 25 vjeç) 2020.

538 Po aty., f. 3.

për një të ri që ka vuajtur nga dhuna të “përjashtoj” ose të mbyll mediat e tyre sociale, pasi ato janë thellësisht të integruar në jetën e tyre sociale.⁵³⁹

Ndërkohë, dhuna e dëshmuar në internet mund të frymëzoj dhunën me bazë gjinore jashtë linje. Disa studime kanë treguar një lidhje pozitive midis ekspozimit ndaj pornografisë në internet dhe sjelljes që mbështet dhunën ndaj grave.⁵⁴⁰ Burrat që shikojnë pornografi në internet kanë më shumë gjasa të kryejnë sulme seksuale dhe të tregojnë më pak ndjeshmëri ndaj viktimave të përdhunimit.⁵⁴¹

Përderisa Kosovës i mungojnë të dhënat sasiore në lidhje me prevalencën e krimit kibernetik dhe dhunës kibernetike që prek gra dhe burra të ndryshëm, dëshmi të tjera globalisht,⁵⁴² rajonalisht,⁵⁴³ dhe lokalisht⁵⁴⁴ sugjerojnë se dhuna kibernetike duket se prek gratë dhe vajzat në mënyrë disproporcionale.⁵⁴⁵ BE-ja ka vlerësuar se një në dhjetë gra ka përjetuar një formë të ngacmimit kibernetik që nga mosha 15 vjeçare.⁵⁴⁶ Kjo nënvizon nevojën për të zhvilluar masa specifike për të parandaluar dhunën me bazë gjinore në internet.⁵⁴⁷

Gratë dhe vajzat mund të ekspozohen ndaj formave të ndryshme të dhunës kibernetike me bazë gjinore, të cilat mund të përfshijnë dhunën psikologjike, sulmet kibernetike, ngacmimet në internet, shfrytëzimin seksual dhe rekrutim për trafikim seksual (nën pretendime të rreme si punë jashtë vendit), si dhe shkelje të rënda të privatësisë, të tilla si doksimi ose «pornografia hakmarrëse».⁵⁴⁸ Termi “doksing” është zhargon për postimin e dokumenteve

539 Po aty, f. 3.

540 G. M. Hald, N. M. Malamuth, C. Yuen, “[Pornografia dhe qëndrimet që mbështesin dhunën kundër](#)

[Gratë: Rishikimi i marrëdhënies në studimet joeksperimentale](#)”, Sjellja Agresive, vëll. 36, nr. 1 (2010): 14–20.

541 Oddone-Paolucci, E., Genius, M., Violato, C., “[Një Meta-Analizë e Hulmimit të Botuar mbi Efektet e pornografisë](#)”, në The Changing Family and Child Development, 2000, fq. 48–59. Shih gjithashtu: J. L. Carr, K. M. VanDeusen, “[Faktorët e rrezikut për agresionin seksual mashkullor në kampuset e kolegjeve](#)”, Revista e Dhunës në Familje, vëll. 19, nr. 5, 2004, fq. 279–89.

542 Rrjeti Digixem360, “[Pse gratë janë më shumë viktime të krimeve kibernetike sesa burrat?](#)”, Prill 2022; dhe IEBGJ, “[Dhuna kibernetike është një kërcënim në rritje, veçanërisht për gratë dhe vajzat](#)”, 19 qershor 2017.

543 Qendra e Gjenezës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë, Eugenia Dorokhova, hvale vale, Vasilika Laçi, Aida Mahmutovic, [Dhuna Kibernetike kundër Grave dhe Vajzave në Ballkanin Perëndimor: Studime të Rasteve të Përzgjedhura dhe Qasje e Qeverisjes së Sigurisë Kibernetike](#), 2021. Ata sugjeruan që “numri i rasteve të VAWG kibernetike dhe abuzimi i lehtësuar nga teknologjia në rajonin e Ballkanit Perëndimor janë po aq të larta sa në vendet e tjera evropiane.”

544 Demokracia për Zhvillim, Leonida Molliqaj, “[Interneti duhet të jetë një vend i sigurt për grate](#)”, 16 Mars 2023.

545 Shih, për shembull, Drouin, Ross dhe Tobin, “[Sexting: një mjet i ri, digjital për agresionin e partnerit intim?](#)”, Computers in Human Behaviour, 50, 2015, f. 197, dhe M.A. Franks dhe D. Citron, “[Kriminalizimi i pornos hakmarrëse](#)”, Rishikimi i Ligjit të Wake Forest, 49, 2014, f. 345.

546 KE, “[Çfarë është dhuna me bazë gjinore?](#)”, qasur më 15 gusht 2023.

547 UN Women, [Analiza gjinore në fushat teknike](#): Përfshirja digjitale, 2019.

548 UN Women, [Analiza gjinore në fushat teknike](#): Përfshirja digjitale, 2019.

në internet në lidhje me një person tjetër pa leje; ka tendencë të jetë një veprim keqdashës që një hacker përdor kundër njerëzve me të cilët hakeri nuk i pëlqen ose nuk pajtohet.⁵⁴⁹ Grupe specifike të grave janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna kibernetike, të tilla si gratë e reja, pakicat etnike, lezbiket, biseksuale, queer dhe transgjinore, dhe ato me aftësi të kufizuara, si dhe gratë mbrojtëse të të drejtave të njeriut, politikanet dhe gazetaret.⁵⁵⁰ Gratë e moshës së mesme që përdorin rrjetet e mediave sociale mund të jenë veçanërisht të ndjeshme ndaj dhunës në internet, pasi disa mund të jenë më pak të informuara për përdorimin e sigurt të internetit.⁵⁵¹

Abuzimi seksual i bazuar në fotografi është raportuar në Kosovë. Një rast i raportuar në RrGK kishte të bënte me një grua të re e cila kishte ndarë foto të natyrës seksuale me të dashurin e saj; pasi ata e ndërprejnë lidhjen, ai kërcënoi se do t'i shpërndante publikisht fotot përmes rrjeteve sociale. Rasti kishte të bënte me ryshfet përmes të cilit ajo siguronte pagesa financiare në mënyrë që ai të mos shpërndante fotot. Ndërsa fillimisht hezitoi, ajo përfundimisht e raportoi rastin në polici me mbështetjen e RrGK-së. Mungesa e një përkufizimi të qartë ligjor e bëri të vështirë trajtimin; çështja mbeti në vazhdim në vitin 2023. Në një rast tjetër, pasi një grua i dha fund lidhjes me një burrë, ai kërcënoi se do të shpërndante fotot e saj; RrGK ndihmoi, dhe autori u dënua për shantazh sipas Kodit Penal. Mediat kanë raportuar raste të ngjashme të ish të dashurve që shpërndajnë foto dhe video intime, të cilat PK i ka trajtuar edhe si raste shantazhi.⁵⁵²

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (ZKBDK) ka vërejtur se interneti po përdoret nga trafikantët e qenieve njerëzore si “fusha digjitale gjuetie”.⁵⁵³ Si PK ashtu edhe AIP vunë në dukje se abuzimi me internetin tek fëmijët është shqetësues, veçanërisht fotografitë dhe videot e shkëmbyera online.⁵⁵⁴ Sipas Njësisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike të PK-së, platformat Instagram, Facebook dhe Snapchat janë vendi ku shpërndahet pjesa më e madhe e përmbajtjes që përfshin abuzim seksual. “Në shumicën dërrmuese të rasteve që marrim, janë fëmijët që shkëmbejnë, përdorin ose bëhen objekt i materialeve seksuale në internet. Kjo është shqetësuese, sepse në të ardhmen ata vetë mund të bëhen abuzues seksual”, tha Fadil Abdyli, shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike në PK.⁵⁵⁵ Është e paqartë nëse djemtë apo

549 Kaspersky, “Çfarë është Doxing - përkufizim dhe shpjegim”, qasur më 15 gusht 2023.

550 UN, [Raporti i të Drejtave të Njeriut 2017](#), 2018.

551 Intervistë e RrGK, 2022.

552 Ilirjana Hoti, “[Është arrestuar i dyshuari i cili ka kërcënuar një grua duke e shantazhuar me publikim të videove dhe fotove intime](#)”, Koha.net, 6 shtator 2023, qasur më 20 dhjetor 2023; Sinjali, “Një i dashuri i kërkon 70 mijë euro një vajze në Lipjan duke kërcënuar se do të ndajë foto intime me familjen e saj”, 4 korrik 2021.

553 UNODC, “Përdorimi i Internetit nga Trafikantët” K. 5 në Raportin Global mbi Trafikimin e Njerëzve 2020, 2020.

554 Abdyli, Fadil, shef i Njësisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, PK, [deklaratë](#) e bërë gjatë programit televiziv “Divers – Mbrojtja e të dhënave personale në internet”, RTK, YouTube, 10 shkurt 2023, qasur më 22 nëntor 2023.

555 Po aty.

vajzat, si përdorues të internetit, prirën të përfshihen më shumë në vepra të tilla penale. Megjithatë, duke pasur parasysh se dhuna me bazë gjinore tenton të prek gratë dhe vajzat në Kosovë më shumë se burrat dhe djemtë, mund të konkludohet se vajzat mund të jenë më të ndjeshme ndaj krimeve të tilla.

Marrëdhëniet e pushtetit kontribuojnë në mënyrën se si dhuna me bazë gjinore manifestohet, dënohet shoqërisht dhe trajtohet nga institucionet. Dhuna me bazë gjinore, duke përfshirë ngacmimin në internet, ndjekjen, ngacmimin, shkeljen e privatësisë personale dhe abuzimin seksual, ndodh për shkak të strukturave të socializuara të pushtetit. Fakti që burrat nga pikëpamja shoqërore prirën të jenë në pozita pushteti më shumë se gratë, i vendos ata në një pozicion që të përdorin fuqinë e tyre politike, ekonomike, fizike dhe psikologjike mbi gratë. Ky pushtet ushtrohet edhe nëpërmjet teknologjive digjitale.

Marrëdhëniet e pushtetit brenda familjes mund t'i kontribuojnë burrave, baballarëve, vëllezërve ose burrave të tjerë, dhe ndonjëherë edhe grave, anëtarëve të familjes si vjehrra, duke kontrolluar viktimat, si për shembull pengimi i tyre nga përdorimi i mjeteve digjitale, largimi nga shtëpia ose raportimi i dhunës. Kjo mund të përfshijë kontrollin fizik, si dhe kontrollin psikologjik dhe ekonomik. Teknologjia digjitale mund të përdoret për të kontrolluar viktimat duke monitoruar lëvizjet e tyre siç është raportuar në Kosovë. Për shembull, viktimat e dhunës me bazë gjinore janë monitoruar nga ish-bashkëshortët ose autorët e tyre, të cilët instalojnë programe të ndryshme në telefonat e tyre ose vendosin gjurmues GPS në makinat e tyre pa dijeninë e tyre.⁵⁵⁶

Ndërsa çdokush mund të ndikohet nga krimi financiar kibernetik, burrat mund të jenë më të prirur për të qenë viktimat të mashtrimeve financiare në internet, mashtrimin të investimeve dhe vjedhjes së identitetit, duke pasur parasysh se ata posedojnë më shumë kapital dhe pronë sesa gratë.⁵⁵⁷ Prandaj, ata kanë më shumë burime financiare që mund të jenë në rrezik. Njerëzit e moshuar gjithashtu raportohet se janë në rrezik më të madh.⁵⁵⁸

Përdorimi i shërbimeve të drejtësisë për të adresuar dhunën digjitale

Nëse ndiheshin të kërcënuar në internet, 57% e grave dhe 66% e burrave thanë se PK-ja do të ishte autoriteti i parë që do të kontaktonin për ndihmë.⁵⁵⁹ Megjithatë, 15% e grave dhe burrave thanë se nuk do të kërkonin ndihmë nga askush. Nëse njerëzit nuk kërkojnë ndihmë, institucionet e kanë të vështirë t'i mbrojnë ata. Kur u pyetën se cilat shërbime duhet të ofrojnë institucionet në internet, 19% e grave dhe 13% e burrave thanë se duhet të ofrohet një linjë

556 Monitorimi i rasteve nga RrGK.

557 RrGK, Analiza Gjinore e Kosovës, 2018, f. 41.

558 Polly Jean Harrison, "Gratë kanë më pak gjasa të kenë përjetuar një mashtrim financiar sesa burrat", The Fintech Times, 18 janar 2021.

559 UNDP, [Anketa Digjitale e Familjeve](#), 2022.

ndihmëse për dhunën në familje.⁵⁶⁰ Ndërkohë, RrGK ka kërkuar nga PK-ja të dhëna të ndara sipas gjinisë për personat që kanë pësuar krime kibernetike dhe dhunë kibernetike, por nuk kanë marrë përgjigje.

Marrëdhëniet e pushtetit mund ta bëjnë të vështirë për gratë, vajzat dhe djemtë qasjen tek institucionet. Normat shoqërore dhe presioni, duke përfshirë fushatat e shpifjeve në internet që synojnë gratë që kanë pësuar dhunë, mund t'i pengojnë gratë e tjera të raportojnë raste sepse ato nuk duan të jenë objektivi i viktimizimit të mëtejshëm. Për shembull, në një rast të dhunës me bazë gjinore, media raportoi se burri i një gruaje e kishte rrahur sepse ajo nuk gatua për të. Komentet e bëra në platformat mediatike justifikuan dhunën.⁵⁶¹ Nëse gratë që përjetojnë dhunë shohin komente të tilla, ato mund të hezitojnë të raportojnë dhunën nga frika e fushatave të ngjashme të shpifjeve në internet. Fajësimi i viktimave mund t'i bëjë viktimat të hezitojnë të raportojnë krimin kibernetik.

Mungesa e një baze të dhënash ndër-institucionale plotësisht funksionale me informacionin e rasteve të disponueshme online në kohë reale e bën të vështirë monitorimin nëse gratë dhe burrat të ndryshëm po përdorin shërbimet publike online për qasje në drejtësi, përfshirë dhunën me bazë gjinore dhe krimet kibernetike. RrGK ka kërkuar informata nga institucionet por nuk ka marrë përgjigje.

Teknologji të tilla si tele-këshillimi ose raportimi në internet mund të ofrojnë mundësi për raportimin e dhunës nëse merren masat e duhura paraprake. Gjatë pandemisë COVID-19 RrGK bashkëpunoi me Qendrën Autonome të Grave në Beograd për të zhvilluar një Protokoll për Këshillim Online për Gratë që përjetojnë dhunë, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare. Ndonëse nuk është një shërbim i institucionalizuar, Protokollin përcakton procedurat për garantimin e mbrojtjes së grave që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore gjatë ofrimit të shërbimeve këshillimore nëpërmjet telefonit ose aplikacioneve të telefonave inteligjentë. Pilotuar nga strehimoret në Kosovë, kjo përvojë mund të informoj krijimin e një Protokollit të ngjashëm për institucionet përkatëse për trajtimin e rasteve në të ardhmen. Strehimoret vazhdojnë të përdorin Protokollin, duke theksuar se ka qenë thelbësore që stafi i strehëzave të ndihmojë gratë dhe vajzat që nuk mund të dalin nga shtëpia për të raportuar dhunën. Gjatë viteve 2021 dhe 2022, strehimoret këshilluan rreth 2000 gra viktime të dhunës duke përdorur këtë Protokoll.⁵⁶² Kështu, përveç rëndësisë së tij në mes të krizave, tele-këshillimi mund të jetë i dobishëm për gratë që jetojnë në izolim që nuk mund të largohen nga shtëpitë e tyre për të kërkuar mbështetje, për gratë me aftësi të kufizuara dhe për gratë në zonat rurale, të cilave për arsye gjeografike dhe financiare mund t'u mungoj qasja për transportin dhe shërbimet publike.

560 Po aty.

561 Telegraf, "*Profesori universitar nga Lipjani rrahu gruan pasi nuk i gatoi pite me spinaq*", 14 Gusht 2023, qasur më 26 November 2023.

562 Korrespondencë e RrGK me strehimoret.

Duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të të dhënave midis institucioneve, nevojitet monitorim i mëtejshëm për të kuptuar shkallën në të cilën gratë dhe burrat të ndryshëm kanë qasje në drejtësi për krimin kibernetik dhe dhunën kibernetike me bazë gjinore.

Konkluzione

Sa i përket **Rregullores**, kuadri ligjor që ka të bëjë me digjitalizimin dhe sundimin e ligjit është kryesisht neutral gjinor dhe i mungon vëmendja ndaj disa formave të dhunës kibernetike dhe kërcënimeve digjitale që mund të prekin gratë dhe burrat ndryshe. Meqenëse Konventa e Stambollit nuk i referohet formave të ndryshme të dhunës kibernetike ndaj grave, Kosova mund të rishikoj kornizën e saj aktualisht joadekuate ligjore për të adresuar dhunën kibernetike dhe kërcënimet digjitale në përputhje me Direktivën e propozuar të BE-së për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Përmirësimi i kornizës ligjore mund të kontribuoj në përmirësimin e sundimit të ligjit dhe qasat në drejtësi. Kodi Penal duhet të trajtoj në mënyrë eksplicite sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë përkufizimet dhe rregullimin e dhunës kibernetike me bazë gjinore në format e saj të ndryshme si abuzimi seksual i bazuar në fotografi, ngacmimi seksual në internet dhe mesazhet e natyrës seksuale.⁵⁶³ Ligji i ri për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave nuk siguron një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë dhunën kibernetike. Ai nuk ka asnjë nen që rregullon vepra të tilla, por vetëm një përkufizim të “hakmarrjes pornografike”. LMDHP dhe Ligji për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës Kibernetike duhet të vendosin mbrojtje më të mirë për gratë, personat LGBTIQ+ dhe grupet e cënueshme. Legjislacioni dytësor, si p.sh. PSV-të e ardhshme për dhunën me bazë gjinore, duhet të specifikojë mjetet për mbrojtjen e viktimave me një qasje të përgjegjshme ndaj gjinisë duke përdorur menaxhimin e sigurt dhe ndërinstucional të rasteve digjitale. Të gjitha strategjitë dhe planet e veprimit kanë nevojë për më shumë objektiva, tregues, baza, objektiva dhe buxhete të përgjegjshme ndaj gjinisë. Për të informuar të gjithë legjislacionin e ri dhe të rishikuar, VN(B)GJ duhet të kryhen së bashku me Vlerësimet e Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave, siç parashikohet nga LMDHP.

Sa i përket **Qeverisjes**, nënpërfaqësimi i grave në udhëheqje, koordinim, zbatim, monitorim dhe vlerësim në qeveri dhe në sistemin e drejtësisë mund të nënkuptojë se nevojat dhe sfidat me të cilat përballen gratë janë të paadresuara në politikëbërje dhe programim, duke përfshirë edhe digjitalizimin. Ekziston një informacion minimal mbi aftësitë për digjitalizim të përgjegjshëm gjinor, megjithëse komentet gjatë intervistave sugjerojnë nevojën për të rritur më tej kapacitetet për një qasje të përgjegjshme gjinore. Ndryshimet në kuadrin ligjor në lidhje me dhunën kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave duhet të shoqërohen me trajnime të institucionalizuara. Pak

njerëz në sektorin e sundimit të ligjit kanë njohuri për proceset e digjitalizimit të përgjegjshëm gjinor. Përkundrazi, zyrtarët prireshin ta konsideronin gjininë të parëndësishme për digjitalizimin, duke deklaruar se veprimet drejt digjitalizimit janë të njëjta për të gjithë; prandaj, ato nuk përfshinin konsideratat gjinore në proceset e digjitalizimit. Kjo qasje neutrale gjinore ndaj digjitalizimit mund të kontribuojë në efektet negative gjinore duke përforcuar status quo-në dhe normat dhe marrëdhëniet e vendosura gjinore. Pak shërbime publike digjitale janë të disponueshme, duke penguar analizën gjinore të përpunimit të krimit kibernetik dhe çështjeve civile të lidhura me kibernetikën. Kapacitetet dhe përdorimi joadekuat i SMIR dhe sistemit të menaxhimit të rasteve të Ministrisë së Drejtësisë për rastet e dhunës me bazë gjinore minon trajtimin efektiv të rasteve si dhe mirëmbajtjen e të dhënave për të informuar analizën gjinore. As financimi dhe prokurimi nuk mund të monitorohen nga perspektiva gjinore për shkak të mungesës së informacionit të disponueshëm publikisht.

Kërkohen investime të konsiderueshme në pajisje dhe softuer digjital për të përmirësuar **infrastrukturën** e sektorit për t'iu përgjigjur krimit kibernetik dhe dhunës kibernetike. Infrastruktura mund të përdoret për të rritur qasjan në drejtësi për personat e izoluar; të zvogëloj traumatizimin përmes dëshmive të regjistruara dhe televizive në sallat e gjyqit; caktojnë rastësisht gjyqtarë të certifikuar siç duhet; dhe të zbatojnë mbikëqyrjen elektronike të lëvizjeve të autorëve drejt parandalimit të recidivizmit. Softueri i përmirësuar mund të mundësojë në mënyrë transparente qasjan e publikut në ndjekjen e rasteve përmes sistemit të drejtësisë dhe monitorimin e performancës së akterëve përgjegjës.

Në dukje, **njerëzve** u mungon njohuria se çfarë përbën krimin kibernetik, mbrojtjen e të dhënave dhe si të sigurohet mbrojtja, duke përfshirë edhe fëmijët, megjithëse mungojnë të dhënat. Burrat kanë më shumë gjasa të kryejnë krime kibernetike, duke përfshirë dhunën me bazë gjinore, ndërsa gratë, fëmijët dhe personat LGBTIQ+ duken më të prirur për t'i vuajtur këto krime për shkak të marrëdhënieve dhe normave të pushtetit me bazë gjinore. Raportohet rrallë për krimet kibernetike dhe kështu monitorimi i qasjat në drejtësi ka qenë i vështirë. Gratë në veçanti hezitojnë të raportojnë krimet kibernetike duke pasur parasysh mosbesimin ndaj institucioneve dhe frikën e tyre se raporti i tyre do të bëhet publik, duke rrezikuar sigurinë e tyre si dhe marrëdhëniet familjare dhe sociale. Tele-këshillimi mund të lehtësoj qasjan në shërbime. Sundimi i ligjit dhe shërbimet shoqëruese për njerëzit mund të përmirësohen duke avancuar digjitalizimin me përgjegjësi gjinore.

Digjitalizimi i shërbimeve sociale

Digjitalizimi ofron potencial për përmirësimin e shërbimeve sociale për gratë dhe burrat, duke paraqitur njëkohësisht rrezikun e vazhdimësisë së pabarazive ekzistuese gjinore.¹ Në këtë kapitull shqyrtohen përpjekjet e Kosovës për digjitalizimin e shërbimeve sociale publike, duke vlerësuar secilin nga dimensionet e Modelit të Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës të përgjegjshëm gjinore: Korniza Ligjore, Qeverisja, Infrastruktura dhe Njerëzit.

1 UN Women, Judy Wajcman, Erin Young dhe Anna Fitz Maurice, "The digital revolution: Implications for gender equality and women's rights 25 years after Beijing" (shqip: *Revolucioni digjital: Implikimet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave 25 vjet pas Pekinit*), 2020.

Korniza Ligjore: Analiza gjinore e politikave publike mbi digjitalizimin e shërbimeve sociale

Në këtë seksion analizohet njohja dhe marrja parasysh e aspektit gjinor tek ligjet, politikat dhe strategjitë e rëndësishme sa i përket digjitalizimit të shërbimeve sociale.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare

I miratuar së pari në vitin 2007 dhe i amendamentuar²në vitin 2012, ky ligj rregullon ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për personat dhe familjet në nevojë. MPMS e kishte përgjegjësinë për të organizuar dhe ofruar Shërbimet Sociale dhe ato Familjare. Megjithëkëtë, MPMS pushoi së ekzistuari në vitin 2020 dhe MFPT mori përsipër detyrat e saj, disa prej të cilave iu barten Ministrisë së Drejtësisë në³. Ligji përkufizon “familjet në nevojë” si ato kur:

njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit u nevojitet ndihma në përkujdesjen për fëmijën për shkak të gjendjes së tyre ose gjendjes së fëmijës, në rrethana kur fëmija është duke pësuar dëmtim serioz për shkak të lënies pas dore, abuzimit nga ana e prindit ose prindërve të tij, për shkak të paaftësisë së prindit ose prindërve apo kujdestarit që të përkujdesen për të në mënyrë adekuate, ose i është ekspozuar mundësisë [...].⁴

Ministria përgjegjëse kujdeset edhe për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara mendore dhe ata me zhvillim mendor të vonuar që nuk kanë persona të tjerë për t’u kujdesur për ta.⁵ “Përkujdesja e drejtpërdrejtë sociale” nënkupton ofrimin e ndihmës personave në nevojë në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin dhe mbikëqyrjen.⁶ Banorët e Kosovës kanë “qasje të drejtë dhe të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim, siç është raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare apo sociale, pasuria, lindja apo diçka tjetër.”⁷ Në këtë ligj nuk përmendet gjinia, identiteti gjinor apo orientimi seksual. Në përgjithësi, ligji nuk merr parasysh barazinë gjinore. Ai nuk ofron asnjë përkufizim të gjinisë ose seksit, megjithëse gratë dhe burrat e

2 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2012.

3 Për më shumë informata, shih seksionin për [Qeverinë](#).

4 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2012. Neni 1, paragrafi 4.

5 Po aty., neni 12, paragrafi 12.3a.

6 Po aty., neni 1, paragrafi 1.3.

7 Po aty., neni 2.

cenueshëm mund të përballen me sfida që lidhen me aspektin gjinor në qasjen në shërbime dhe mund të kenë nevojë për shërbime të përgjegjshme gjinore.

Sa i përket birësimit, në ligj ceket se çiftet e martuara do të kenë trajtim preferencial me rastin e birësimit të fëmijëve.⁸ Duke qenë se Ligji i Kosovës për Familjen ende e përkufizon martesën si bashkësi në mes të dy personave të sekseve të ndryshme,⁹ ky ligj diskriminon personat LGBTIQ+. Në listën e arsyeve se përse personat mund të kenë nevojë për shërbime sociale, Ligji nuk përfshin shërbimet për personat që kanë pësuar çfarëdo forme të dhunës me bazë gjinore, sipas kërkesave të Konventës së Stambollit. Ky ligj i referohet vetëm dhunës në familje. Pra, për shembull, gratë që kanë pësuar përdhunim nuk do të kualifikoheshin për shërbime sociale.

Ligji nuk përmend digjitalizimin e shërbimeve sociale dhe familjare në përgjithësi e as ofrimin e shërbimeve sociale për personat që kanë përjetuar dhunë kibernetike ose krim kibernetik. I vetmi referim për digjitalizimin paraqitet në nenin 15, ku ligji thekson se “I gjithë komunikimi verbal, i shkruar ose elektronik lidhur me ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në mes të një individi ose një familje që shfrytëzon shërbime të tilla dhe profesionistit të shërbimeve sociale dhe familjare trajtohet me mirëbesim.” Nëse një profesionist i shërbimeve sociale dhe familjare shpërndan informacionin lidhur me ndonjë rast tej palët e treta të paautorizuara, kjo përbën “shkelje flagrante profesionale” dhe ai mund t’i nënshtrohet ndjekjes penale sipas Kodit Penal. Në këtë ligj nuk përmendet gjinia ose aspekti gjinor sa i përket digjitalizimit.

Ligji përkufizon “Personin në nevojë” si cilindo person që ka nevojë për shërbime sociale, duke përfshirë:

fëmijët pa përkujdesje prindërore; fëmijët me sjellje asociale; delikuentë të mitur; ata me marrëdhënie të çrregulluara në familje; me moshë të shtyrë; me sëmundje fizike ose aftësi të kufizuara fizike; me aftësi të kufizuara mendore; sëmundje mendore; me rrezik ndaj shfrytëzimit ose abuzimit; dhunë në familje; viktimat të trafikimit me qenie njerëzore; personat me varësi nga alkooli ose droga; me emergjencë ose që kanë pësuar nga fatkeqësia natyrore ose të shkaktuara nga njeriu; ose ndonjë arsye tjetër që e bën atë person nevojtar.¹⁰

8 Po aty, neni 11, paragrafi 11.21.c. “Përparësinë e birësimit të fëmijëve ka çifti i martuar”.

9 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 2004/32 i familjes i Kosovës](#), 2006, neni 14. “Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërish në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes”.

10 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2007, neni 1.

Përkufizimi mund të përditësohet në mënyrë që të përfshijë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, sipas Konventës së Stambollit,¹¹ Përkufizimi mund të përditësohet në mënyrë që të përfshijë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, sipas Konventës së Stambollit, duke përfshirë dhunën kibernetike me bazë gjinore, për të cilën viktimat mund të kenë nevojë për shërbime sociale për t'u rikuperuar, siç është ofrimi i psikoterapisë së përshtatur. Përkufizimi tani përfshin vetëm viktimat e dhunës në familje, të cilat mund të pengojnë qasjen në shërbimet sociale për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë që kanë përjetuar dhunë kibernetike me bazë gjinore.

Roli i asistentëve personalë nuk është i përcaktuar në mënyrë të qartë në kornizën ligjore të Kosovës.¹² Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare e përkufizon "Përkujdesjen e drejtpërdrejtë sociale" si "ofrimin e ndihmës në lidhje me punët e shtëpisë, kujdesin personal, lëvizshmërinë, komunikimin ose mbikëqyrjen që mund të ofrohet në shtëpinë e vetë personit, në një qendër të specializuar të qëndrimit ditor ose në një institucion rezidencial".¹³ Personat në nevojë nënkuptojnë personat me sëmundje fizike ose aftësi të kufizuara.¹⁴ Procesi i aplikimit për përkujdesje të drejtpërdrejtë sociale nuk është i detajuar në Ligj, por Qendrat për Punë Sociale (QPS) në secilën komunë duket se janë përgjegjëse për identifikimin e personave të cilët kanë të drejtë për përkujdesje sociale dhe për koordinimin e përkujdesjes sociale. Nuk është paraparë asnjë përpjekje për digjitalizimin e këtyre shërbimeve, edhe pse kjo mund të integrohet në platformën eKosova. QPS-të mbajnë lista të personave që kanë nevojë për shërbime sociale dhe duhet t'i vizitojnë rregullisht ata "për të monitoruar sigurinë dhe mirëqenien e tyre".¹⁵

Në përgjithësi, ky ligj është **neutral** në aspektin **gjinor** sa i përket komunikimeve elektronike dhe digjitalizimit. Përkufizimi i ligjit për familjen është **negativ** në aspektin **gjinor**, meqenëse përforcon rolet dhe stereotipat ekzistues gjinorë, duke diskriminuar personat që përfshihen në martesë të të njëjtit seks dhe që duan të birësojnë fëmijë.

Një projektligj i ri për shërbimet familjare dhe sociale u prezantua për konsultim publik në vitin 2021. Sipas këtij projektligji, fëmijët që përjetojnë varësi nga interneti do të kenë mbrojtje përmes këtij ligji.¹⁶ Në të nuk është dhënë përkufizimi se çfarë nënkupton "varësia nga interneti" dhe nuk ofrohet ndonjë mbrojtje për fëmijët që kanë përjetuar dhunë kibernetike ose krim kibernetik, siç është pornografia kibernetike e as nuk shpjegohet se si punonjësit socialë do ta ofrojnë këtë mbrojtje. +Në shumë referime të tij për

11 Këshilli i Evropës, [Konventa e Stambollit](#), neni 3, "Përkufizimet".

12 RrGK, Përmbledhje e politikave, "[Financimi i përgjegjshëm gjinor i asistentëve personalë për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë](#)", 2022.

13 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2007, neni 1.

14 Po aty, neni 1.3, e.6.

15 Po aty, neni 7, "Roli i Qendrës për Punë Sociale".

16 Republika e Kosovës, Kuvendi, Projektligji për shërbime sociale dhe familjare, neni 34, "Fëmijët si përfitues të shërbimeve sociale", që nga vitit 2021.

dhunën në familje, projektligji nuk përfshin personat që kanë përjetuar dhunë kibernetike, duke përfshirë atë në bazë të gjinisë, seksit, identitetit gjinor dhe/ose orientimit seksual. RrGK ka dhënë komente mbi këtë projektligj, duke theksuar nevojën që ai të ofrojë shërbime më të mira sociale dhe financim, veçanërisht për rastet e dhunës me bazë gjinore. RrGK ka rekomanduar që ligji i ardhshëm të përdorë një qasje të integruar të shërbimeve sociale me një qasje holistike ndaj shërbimeve sociale, duke përfshirë edhe njohjen dhe marrjen parasysh të aspektit gjinor.

Projektligji përmban pak referime për digjitalizimin e shërbimeve sociale. Neni 13 detyron institucionet që ofrojnë shërbime sociale dhe ato familjare të ruajnë dokumentacionin e përfituesve në kopje fizike si dhe në formën elektronike, nëse është e mundur. Ky dokumentacion, elektronik ose jo, duhet të mbrohet nga qasja e paautorizuar, publikatat dhe keqpërdorimi. Departamenti përkatës i Ministrisë përgjegjëse duhet të mirëmbajë, ruajë, përdorë dhe mbikëqyrë bazën e të dhënave dhe sistemin e përgjithshëm të të dhënave në lidhje me shërbimet sociale dhe familjare.¹⁷ Ofruesit e certifikuar të shërbimeve sociale janë përgjegjës për planifikimin e shërbimeve sociale. Ligji nuk specifikon ende ndonjë rol për IA në kryerjen e vlerësimeve të nevojave, megjithëse kjo tani po përdoret në disa vende.¹⁸

Ligji për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë

I ndryshuar në vitin 2012, ky Ligj rregullon Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë (SNS) me “qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes ndaj familjeve të rrezikuara në aspektin social”.¹⁹ Ky ligj përcakton se cilët persona dhe familje kanë të drejtë të marrin ndihmë sociale si dhe kriteret që ata duhet t'i plotësojnë. Për të përfituar nga NSK, familjet duhet të hynë në njërin nga dy kategoritë: 1) familja ku të gjithë anëtarët janë të varur dhe asnjë nuk është i punësuar; ose 2) familja me një anëtar të aftë për punë me të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç, ose një fëmijë jetim nën moshën 15 vjeç në përkujdesje të përhershme.²⁰ Ligji i përkufizon personat e varur si: personat mbi moshën 18 vjeç me “aftësi të kufizuara të përhershme dhe të rënda” që i bëjnë të paftë për të punuar; personat e moshës 65 vjeç e më të moshuar; kujdestarët e përhershëm të personat me aftësi të kufizuara, personat e moshës 65 vjeç ose më të moshuar të cilëve u nevojitet kujdes i përhershëm, ose fëmijët nën moshën pesë vjeç; personat nën moshën 14 vjeç; personat e moshës 15 deri në 18 vjeç që ndjekin shkollim të rregullt të mesëm; dhe prindërit vetushqyes

17 Po aty. Neni 123, “Mbledhja e të dhënave”. Në projektligj, kjo është përgjegjësi e MPMS-së, por përgjegjësitë e ministrive kanë ndryshuar dhe kjo me sa duket do t'i bartet Ministrisë së re përgjegjëse, e cila duket se do të jetë Ministria e Drejtësisë në vitin 2023.

18 Shoqata Ndërkombëtare e Sigurimeve Shoqërore, “*Artificial Intelligence in Social Security: Background and Experiences*” (shqip: *Inteligjenca artificiale në sigurimet shoqërore: Historiku dhe përvojat*), 2020. Për shembull, vende si Kanadaja, Belgjika, Brazili dhe Estonia përdorin IA. Për diskutim të mëtejshëm, shih seksionin mbi [Infrastrukturën](#).

19 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë](#), 2012, neni 1.

20 Po aty, neni 4.

me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeç.²¹ Ligji nuk përfshin viktimat e dhunës me bazë gjinore në mesin e personave “të varur”, edhe pse kjo do të mund të siguronte mbështetje shtetërore për viktimat derisa ato të jenë të sigurta dhe të afta për punë.

Ligji e bën MPMS-në përgjegjëse për menaxhimin e SNS-së, kurse komunat e administrojnë atë përmes QPS-ve si pjesë e shërbimeve të decentralizuara sociale.²² Pas ndryshimeve në Qeveri në vitin 2021, MPMS pushoi së ekzistuari dhe MFPT mori përgjegjësinë për SNS.²³ As digjitalizimi e as menaxhimi i të dhënave nuk përmenden në këtë ligj. Po ashtu as nuk i referohet gjinisë ose seksit, si p.sh. të aplikuesve ose pranuesve të SNS-së. Si i tillë, ky ligj është **neutral** në aspektin **gjinor**.

Në vitin 2019, MPMS ka përgatitur një koncept-dokument të ri për Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale, i cili përfshinte një objektiv drejt përmirësimit të mirëqenies sociale duke:

zgjeruar dhe rritur cilësinë e mbrojtjes dhe shërbimeve sociale dhe familjare, me fokus të veçantë në grupet e cënueshme dhe barazinë gjinore, dhe duke ulur varfërinë dhe përjashtimin social përmes ofrimit të shërbimeve dhe përfitimeve të integruara për gratë dhe burrat në nevojë dhe grupet e tjera të cënueshme.²⁴

Në koncept-dokumentin nuk ishte përmendur digjitalizimi në mënyrë specifike. Megjithatë, ai vuri në dukje se QPS-të kishin shumë shqetësime në lidhje me zbatimin e sistemit dhe se megjithëse baza e të dhënave e SNS-së është elektronike, ajo nuk e zvogëlon në mënyrë të dukshme barrën administrative. Koncept-dokumenti vuri re se disa QPS ende verifikojnë në mënyrë manuale disa teste të ‘varfërisë’ *Proxy Means Tests* (PMT) dhe çështjet varen nga ngritja e objektivitetit të PMT-ve. Më tej, Koncept-dokumenti thekson se stafit të QPS-së i mungojnë njohuritë dhe kapacitetet për përdorimin e sistemit të TI-së për SNS.²⁵ PMT është një mjet ku informacioni mbi karakteristikat e familjes

21 Kuvendi i Kosovës, [Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale](#), 2003, neni 2, paragrafi 2.7

22 Po aty, neni 2, paragrafi 2.13.

23 Asnjë vendim zyrtar në lidhje me këtë ndryshim nuk është në dispozicion për publikun. Për më shumë informata, shih seksionin për [Qeverinë](#).

24 Qeveria, MPMS, Departamenti për Politikë Sociale dhe Familje, Koncept-dokumenti për Skemën e Ndhmës Sociale, 2019, Qëllimi strategjik 3.

25 Qeveria, MPMS, Departamenti për Politikë Sociale dhe Familje, [Koncept-dokumenti për Skemën e Ndhmës Sociale](#), 2019, f. 19.

ose të individit korrelojnë me nivelet e mirëqenies në një algoritëm për të përcaktuar një përafrim për të ardhurat, mirëqenien ose nevojat e familjes.²⁶

Në koncept dokumentin thuhet se ligji nuk do të ketë ndikim gjinor. Në një fusnotë të dokumentit, thuhet se ndikimi gjinor do të vlerësohet përmes vlerësimeve të ndikimit gjinor. Për sa i përket faktit nëse ky ligj do të diskriminojë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthor kundër gjinisë, përkatësisë etnike, orientimin seksual apo kategorive të tjera, ai thotë “Jo”, edhe pse ende nuk është bërë vlerësimi i ndikimit gjinor.²⁷ Megjithëse janë identifikuar shumë pengesa në lidhje me shërbimet aktuale sociale dhe ato familjare, aspekti i kryefamiljarëve (burra) që marrin SNS nuk përfshihet në listën e pengesave që do të adresohen. Konsultimet me OSHCG-të për këtë çështje nuk janë përmendur, edhe pse në Koncept- dokumentin theksohet se janë zhvilluar konsultimet me OSHC-të. Organizatat që janë përmendur se janë konsultuar fokusohen kryesisht në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.²⁸

Koncept- dokumenti ka një objektiv specifik për barazinë gjinore dhe disa tregues të ndërlydhur. Si i tillë, ai mund të konsiderohet i **përgjegjshëm gjinor**. Dokumenti është **neutral** në aspektin **gjinor** për sa i përket digjitalizimit. Në këtë dokument nuk janë paraparë mënyrat për të mbrojtur gratë dhe burrat nga paragjykimet e mundshme gjinore në algoritmet e SNS dhe metodologjitë e IA e që mund të përdoren në PMT dhe as nuk kërkohet qartë mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë, analiza dhe raportimi publikisht transparent përmes përdorimit të mjeteve digjitale.

Në vitin 2019, (ish) Qeveria e Kosovës miratoi Koncept-dokumentin për shërbimet sociale dhe familjare. Opsioni i tretë i propozuar nga Grupi Punues u vlerësua si i duhur, duke rekomanduar hartimin e një projektligji të ri me të cilin do të shfuqizohet, plotësohet dhe ndryshohet Ligji nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare.²⁹ Me Qeverinë e re të udhëhequr nga Kurti që nga viti 2021, ky projektligj është nxjerrë për konsultime publike dhe u miratua në shtator të vitit 2023.³⁰ Nga tetori i vitit 2023, projektligji ishte në shqyrtim nga Komisioni Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Sa i përket zbatimit, një vlerësim i Bankës Botërore për SNS arriti në përfundimin se “mbulimi i të varfërve me SNS është i ulët, vetëm rreth një e treta e kuintalit të poshtëm përfiton nga SNS-ja”.³¹ Për më tepër, roli i SNS-së

26 Grupi i Bankës Botërore, [Proxy means tests for targeting social programs](#): Simulations and speculation, Autorë/redaktorë: Margaret E. Grosh dhe Judy L. Baker, 2012.

27 Po aty, f. 80.

28 Po aty, f. 54. Për shembull, kjo përfshin Terre de Homes, UNICEF dhe SOS fshatrat.

29 Child Hub, [Koncept Dokumenti për Shërbimet Sociale dhe Familjare në Kosovë](#), 2019, i qasur më 30 nëntor 2023.

30 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Draft Ligji nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2023.

31 Grupi i Bankës Botërore, [Studimi mbi skemën e ndihmës sociale në Kosovë: Vlerësimi dhe opsionet për reformë](#), 2019, f. 26.

në uljen e varfërisë ka qenë modest.³² Raporti nuk përfshinte ndonjë analizë gjinore për të vlerësuar se si SNS-ja po arrin tek gratë dhe burrat e ndryshëm brenda familjeve. Megjithatë, Banka Botërore kreu një analizë të përshpejtuar gjinore për të informuar hartimin e Projektit e Reformimit të Sistemit të Ndhmës Sociale në Kosovë.³³ Nuk duket se ekziston ndonjë vlerësim *ex-post* i ndikimit gjinor nga qeveria për qasjen e grave dhe burrave në burimet e SNS brenda familjeve.

Ligji për financimin e programeve të veçanta të banimit

Ky ligj i vitit 2010 synon të ofrojë mundësi banimi për individët dhe familjet që janë ekonomikisht të paaftë për të paguar banimin me çmime të tregut të lirë. Ligji parasheh mënyra për financimin e programeve të banimit³⁴ Në të thuhet se komunat janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave të familjeve përfituese, si dhe për identifikimin e nevojave për banim të popullsisë.³⁵ Ligji nuk parasheh digjitalizimin e shërbimeve të banimit social, mirëmbajtjen dhe raportimin transparent publik të të dhënave elektronike të konsoliduara për përfituesit, komunikimin digjital me përfituesit ekzistues ose potencialë, standardet e privatësisë ose mbrojtjen e të dhënave.

Në mesin e atyre që kanë të drejtë për banim social, ligji i jep përparësi familjeve me kryefamiljare gra.³⁶ Ky është i vetmi referim në Ligj sa i përket gjinisë. Pra, ligji është i **përgjegjshëm gjinor**, megjithëse mund të bëjë më shumë. Për shembull, ligji mund të kishte priorizuar të drejtën e të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe të vartësve të tyre, si dhe të personave LGBTIQ+ të pastrehë për t'i siguruar banim. Gjithashtu mund të kishte kërkuar analiza gjinore në procesin e identifikimit të nevojave për banim dhe priorizimin e përfituesve. Ligji mund të kishte qenë më i përgjegjshëm në aspektin gjinor në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurimin e masave paraprake të sigurisë fizike të përgjegjshme gjinore në ndërtesa, duke marrë parasysh mundësinë e theksuar që gratë beqare janë pre e kërcënimeve. Një vlerësim i Ligjit i kryer nga Këshilli i Evropës konstatoi se “pak grave viktime të dhunës në familje iu është siguruar banimi social.”³⁷ Në disa raste, gratë plotësonin kushtet për ndihmë, por nuk e morën atë sepse nuk kishin prioritet sipas ligjit. Kjo, së bashku me qasjen e ulët në pronë, ka përjetësuar përjashtimin e banimit për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar dhunë në familje.

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti

Ky ligj i vitit 2014 rregullon pensionet e financuara nga shteti, në bazë të moshës, pensionistëve që kanë kontribuar në pension dhe aftësisë së

32 Po aty, f. 32

33 Shih seksionin [Financimi dhe prokurimi](#) për më shumë informata.

34 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit](#), 2010, neni 1.

35 Po aty, neni 25.

36 Po aty, neni 11, paragrafi 1.3.

37 Këshilli i Evropës, [Vlerësimi i përafrimit të ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës* me standardet e Konventës së Stambollit](#), 2022, f. 45.

kufizuar.³⁸ Pensionet kontribut paguese të moshës llogariten bazuar në fondet e paguara në sistemin e pensioneve (zakonisht nga burrat, duke marrë parasysh shkallën e tyre më të lartë të punësimit), ndërsa pensionet bazike të moshës janë për personat e moshës 65 vjeç e lart.³⁹ Ligji rregullon pensionet mujore shtesë: pension i paaftësisë së përhershme për qytetarët që plotësojnë kriteret kualifikuese; pension të parakohshëm për minatorët; pension invalidor i punës për personat që kanë pësuar lëndime, invaliditet ose sëmundje profesionale gjatë punës; dhe pension familjar për anëtarët e familjes në rast të vdekjes së të punësuarit. Ligji nuk i referohet në mënyrë eksplicite procedurave të digjitalizimit apo aplikimit elektronik. Aplikuesit duhet të aplikojnë për pensione në Ministri, gjë që nënkupton se aplikacionet duhet të dorëzohen personalisht.⁴⁰ Kjo mund të ndikojë ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm. Për shembull, gratë zakonisht mbështeten te të afërmit e tyre burra për transport ose mund të mos kenë kohë për të shkuar fizikisht në Ministri, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara.⁴¹ Ligji është **neutral** në aspektin **gjinor**. Nuk u gjet asnjë vlerësim publik i zbatimit të ligjit që përmban analizën e ndikimit gjinor.

Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre

Ky ligj parasheh përfitime financiare nga shtetit për personat e prekur nga lufta, duke përfshirë dëshmorët, invalidët, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, familjet e tyre dhe personat që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës.⁴² Gjinia përmendet duke iu referuar bashkëshortit/bashkëshortes dhe nënës/babait si përfitues. Përveç përfitimeve mujore financiare, ligji parasheh zbritje ose transport falas; barnat specifike; shërbimet shëndetësore parësore, dytësore dhe terciare; prioritet në punësim në sektorin publik dhe privat; lirimi nga taksat dhe tarifatat doganore për automjetet speciale për nevoja personale; tarifatat e liruar dhe reduktimi i harxhimeve të energjisë elektrike për nevoja personale; lirimi nga tatimi në pronë; përkujdesja për banim; përparësi e regjistrimit dhe pranimit në institucionet arsimore publike; lirimi nga pagesat administrative në arsimin universitar publik; dhe shpenzimet e varrimit.⁴³ Për të marrë këto përfitime, aplikuesi duhet të parashtojë kërkesën në Zyrën Rajonale të Departamentit të Ministrisë për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimat Civile të Luftës.⁴⁴ Në vitin 2014, ky ligj u ndryshua dhe plotësua për të përfshirë viktimat e dhunës seksuale të kryera gjatë luftës,

38 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti](#), 2014, neni 1.

39 Po aty, nenet 7 dhe 8.

40 Po aty, neni 19.

41 RrGK, *Analiza gjinor për Kosovën*, 2018.

42 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre](#), 2011.

43 Po aty, neni 6.

44 Po aty, neni 16, paragrafi 2.

gjithëpërfshirës i grave dhe burrave.⁴⁵ Ligji u ndryshua për të përfshirë një nen që kërkon nga autoritetet përkatëse të mbrojnë të dhënat e personave që i kanë mbijetuar dhunës seksuale.⁴⁶ Në të thuhet se “Regjistrimi, mirëmbajtja dhe përdorimi i të dhënave personale të këtyre personave do të bëhet në përputhje me kërkesat e përcaktuara me LMDHP dhe Kodin Penal.”⁴⁷ Përndryshe, ligji nuk e përmend digjitalizimin dhe njerëzit duhet të aplikojnë personalisht për të marrë përfitime. Në përgjithësi, Ligji është i **përgjegjshëm gjinor**, duke marrë parasysh ndryshimet e tij. Nuk u gjet asnjë vlerësim publik i zbatimit të ligjit që përmban analizën e ndikimit gjinor.

Programi i Reformave Ekonomike

Në lidhje me shërbimet sociale, PRE për 2022-2024 përmend sfidat mes nevojave të shtuara të qytetarëve për mbrojtje dhe shërbime sociale, veçanërisht pas humbjeve të vendeve të punës dhe të ardhurave për shkak të pandemisë COVID-19.⁴⁸ Prandaj, Masa e Reformës PRE #20 planifikon të përmirësojë shërbimet sociale dhe të fuqizojë grupet e përjashtuara. Aktiviteti 2 parashih zhvillimin e Sistemit Informativ SNS dhe krijimin e Sistemit të Integruar të Informacionit për Mirëqenien Sociale, si dhe digjitalizimin e të dhënave për skemat e pensioneve.⁴⁹ Një tregues i rezultatit i Masës së Reformës #19 drejt “Përmirësimit të shërbimeve sociale dhe fuqizimit të grupeve të përjashtuara” është “Rritja e shkallës së mbulimit të familjeve që jetojnë në varfëri nga skemat e ndihmës sociale”. Kjo masë nuk kërkon të dhëna të ndara sipas gjinisë sipas kërkesave të Ligjit për Barazinë Gjinore, që do të thotë se Sistemi i Integruar i Informacionit mund të mos monitorojë dhe në këtë mënyrë të mundësojë raportimin se sa gratë dhe burrat përfitojnë nga skemat e SNS-së. Ndërkohë, qëllimi i Masës së Reformës #19 thuhet se është në përputhje me objektivin 1 të OZHQ-së, “T”i jepet fund varfërisë në të gjitha format e saj kudo”,⁵⁰ dhe objektivin 5, “Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave”, drejt objektivit të BE-së. për vitin 2030: “Shërbimet publike të modernizuara që u përgjigjen nevojave të shoqërisë” përmes digjitalizimit të shërbimeve, me asistencën IPA të BE-së. Qeveria nuk ka vendosur tregues të përgjegjshëm gjinorë për të matur këtë ose pikënisjet ose objektivat e ndara sipas gjinisë. As buxheti i alokuar nuk përfshin buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Prandaj, PRE është **neutral** në aspektin **gjinor** sa i përket digjitalizimit të shërbimeve sociale.

45 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre](#), 2014.

46 Po aty, Neni 19.

47 Po aty.

48 Republika e Kosovës, Qeveria, [PRE 2022-2024](#), f. 118.

49 Po aty, f. 119.

50 Po aty, f. 184. qëllimi 1.4 është “Deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjithë burrat dhe gratë, veçanërisht personat e varfër dhe të cenusëshëm, të kenë të drejta të barabarta në burimet ekonomike, si dhe qasje në shërbimet bazë, pronësinë dhe kontrollin mbi tokën dhe format e tjera të pronës, trashëgiminë, burimet natyrore, teknologjitë e reja të përshtatshme dhe shërbimet financiare, duke përfshirë mikrofinancimin”.

PKZMSA 2022-2026

PKZMSA 2022-2026 përsërit shqetësimet e Raportit të KE-së të vitit 2019 për ofrimin e shërbimeve sociale,⁵¹ duke thënë se “ofrimi i shërbimeve sociale për grupet e cënueshme pengohet më tej nga [mungesa] e mbledhjes së të dhënave për [popullsinë] e ndarë sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, aftësive dhe cënueshmërisë”.⁵² Një objektivi afatmesëm i PKZMSA 2022-2026 është zhvillimi i një sistemi të mbrojtjes sociale që mbështet punësimin dhe rrit përfshirjen e grupeve të synuara; kjo përfshin zhvillimin e politikave dhe programeve me qëllim të sigurimit dhe rritjes së cilësisë së skemave të mbrojtjes sociale, shërbimeve sociale dhe mbulimit më të mirë për kategoritë sociale dhe grupet e tjera të përjashtuara.⁵³ Në kapitullin e politikave sociale, PKZMSA 2022-2026 planifikon të miratojë dy ligje: Ligjin e ri për Shërbimet Sociale dhe Familjare, i cili “do të mundësojë avancimin e shërbimeve sociale, do të forcojë qendrat për punë sociale në nivel lokal, do të përcaktojë procedurat e licencimit dhe kornizën e funksionimit të ofruesve të shërbimeve sociale nga sektori joqeveritar dhe privat”; dhe Ligjin e ri për Skemën e Ndhmës Sociale, i cili “do të eliminojë kriteret diskriminuese për marrjen e ndihmës sociale, krijojë mundësi për aktivizim në masa aktive të tregut të punës për përfituesit e skemës së ndihmës sociale dhe përfshirjen e familjeve në nevojë.” Asnjë nga këto masa nuk i referohet në mënyrë specifike se si reformat e SNS-së mund të ndikojnë tek gratë dhe burrat. As nuk specifikon se si do të informohet digjitalizimi i shërbimeve sociale nga analiza gjinore. Treguesit, pikënisjet, objektivat dhe buxheti që kanë lidhje me këto reforma nuk janë të përgjegjshëm në aspektin gjinor ose të ndara sipas gjinisë. Pra, megjithëse PKZMSA 2022-2026 është ndër PKZMSA-të me perspektivë gjinore më të përfshirë deri më sot, sa i përket shërbimeve sociale, ai është **neutral** në aspektin **gjinor**.

Qeverisja

Ky seksion shqyrton qeverisjen dhe deri në çfarë mase janë të angazhuara gratë dhe burrat në udhëheqje, planifikim, zbatim, koordinim, monitorim dhe vlerësim të politikave dhe programeve drejt digjitalizimit të shërbimeve sociale, aftësive të tyre dhe njohjes dhe marrjes parasysh të aspektit gjinor tek shërbimet sociale publike digjitale, financimi dhe prokurimi.

Korniza ligjore e bëri MPMS-në përgjegjëse për administrimin e shërbimeve dhe ndihmës sociale. Historikisht, MPMS kishte përgjegjësinë e **planifikimit**, **koordinimit**, **zbatimit** dhe **monitorimit** të politikave dhe shërbimeve sociale. Në vitin 2020, Qeveria vendosi të mbyllë këtë ministri dhe kompetencat e saj iu barten MFPT-së dhe ZKM-së. MFPT ka përgjegjësinë të zhvillojë politikat e

51 KE, [Raporti për Kosovën 2019](#), 2019.

52 Republika e Kosovës, Qeveria, [PKZMSA 2022-2026](#), 2022.

53 Po aty, f. 168.

2022/2023,

MFPT punësoi 225 gra dhe 197 burra.

Në pozitat vendimmarrëse 21 janë gra dhe 41 burra.

punës dhe të mirëqenies sociale, si dhe të hartojë dhe zbatojë legjislacionin.⁵⁴ Divizionet e mëparshme brenda MPMS-së janë zhvendosur në MFPT. Në fund të vitit 2022, qeveria vendosi të zhvendos Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Drejtësisë. Riorganizimi i qeverisë në lidhje me shërbimet dhe ndihmën sociale nuk është shpjeguar në mënyrë transparente për publikun apo bazuar në ndryshime të qarta politikash, gjë që ka bërë të ndërlikuar të kuptohet se cili organ qeveritar është përgjegjës për cilin shërbim.⁵⁵ Në përgjithësi, kjo ka përfshirë udhëheqjen e dobët në emër të Qeverisë së Kosovës në kuptim të konsultimit me ekspertët dhe shoqërinë civile për këto vendime, si dhe në komunikimin e tyre me publikun, në mënyrë digjitale dhe ndryshe. Në vitin 2022/2023, MFPT punësoi 225 gra (53%) dhe 197 burra (47%).⁵⁶ Në pozitat vendimmarrëse 21 janë gra (34%) dhe 41 burra (66%).

Divizioni i Politikave Sociale dhe Familjare është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave, si dhe monitorimin e zbatimit të standardeve të politikave sociale dhe familjare.⁵⁷ Divizioni ka 48 punonjës, por të dhënat e ndara sipas gjinisë për divizionet nuk janë në dispozicion online.⁵⁸ Në dhjetor të vitit 2022, qeveria njoftoi se Ministria e Drejtësisë do të merrte përgjegjësinë për politikat sociale dhe familjare dhe Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjare do të funksiononte në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Qeveria nuk ka publikuar asnjë vendim në lidhje me këtë transferim të kompetencave. As faqja e internetit e Ministrisë së Drejtësisë nuk përmbante informacione për Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare që nga dhjetori 2023. Vetëm Buxheti i Kosovës për vitin 2023 pasqyron Departamentin në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe jo MFPT-së,⁵⁹ ku ishte më parë. Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, Departamenti i Shërbimeve Sociale dhe Mbrojtjes së Fëmijëve ka një komision për licencimin e OJQ-ve, subjekteve private dhe individëve që ofrojnë shërbime sociale profesionale.⁶⁰ Këto subjekte mund të aplikojnë në mënyrë elektronike për licencim dhe Ministria e Drejtësisë mban të dhëna të ndara sipas gjinisë për aplikuesit.⁶¹ Megjithatë, të dhëna të tilla nuk publikohen.

54 Kjo është nxjerrë nga përgjegjësitë e mëparshme ekzistuese të MPMS: Republika e Kosovës, ZKM, [Rregullore nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe ministrive; si dhe të Qeverisë së Kosovës](#), MPMS, 22 mars 2011, qasur më 31 maj 2023.

55 RrGK, “[RrGK e shqetësuar për ndryshimet e përgjegjësisë qeveritare në ofrimin e shërbimeve sociale](#)”, 3 prill 2023.

56 Korrespondenca e RrGK-së me MFPT, 21 korrik 2023.

57 Republika e Kosovës, Qeveria, [MPMS](#), qasur më 31 maj 2023.

58 Po aty.

59 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023](#), 2022, Departamenti për shërbime sociale, f. 42.

60 Korrespondenca e RrGK-së me Ministrinë e Drejtësisë, nëntor 2023.

61 Po aty.

Në kuadër të MFPT-së, Divizioni i Shërbimeve Sociale propozon, zhvillon dhe monitoron zbatimin e legjislacionit, standardeve dhe procedurave të shërbimeve sociale. Ai duhet të koordinojë aktivitetet me institucionet tjera relevante dhe të monitorojë punën e QPS-ve nëpër komuna.⁶² Divizioni ka 10 punonjës, por të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë të publikuara online.⁶³ Thuhet se nuk janë bërë vlerësime të ndikimit gjinor për të informuar vlerësimin e ndihmës sociale ose shërbimeve sociale.⁶⁴ Asnjë shërbim nuk ofrohet online.

Departamenti i Skemave Sociale (DSS) ka mbetur nën MFPT-në me divizione për Politikën e Skemave Sociale, Ndihmën Sociale dhe Përfitimet Sociale.⁶⁵ Përfaqësuesit e DSS-së thanë se vazhdojnë koordinimin me Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Drejtësisë.⁶⁶ Gjatë planifikimit, DSS tha se kishte konsultuar ABGJ-në gjatë hartimit të politikave si Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare,⁶⁷ edhe pse nuk është aplikuar VN(R) GJ në procesin e hartimit të ligjit. DSS është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave për aplikuesit dhe përfituesit e SNS, si dhe menaxhimin e bazës së të dhënave të ndihmës sociale dhe regjistrin social për zbatimin e testit të varfërisë (PMT).⁶⁸ Gratë janë të mbi përfaqësuara në mesin e punonjësve brenda divizioneve të këtij Departamenti (Tabela 1).

Tabela 1. Numri i punonjësve sipas divizionit dhe gjinisë

Divizioni	# i punonjësve Bazuar në Rregullore	Punonjësit aktualë			
		Burrat		Gratë	
		#	%	#	%
Politika e skemave sociale Divizioni	6	1	20%	4	80%
Divizioni i ndihmës sociale	8	3	75%	1	25%
Divizioni i përfitimeve Sociale	6	1	25%	3	75%
Gjithsej	20	5	38%	8	62%

62 Po aty.

63 Po aty.

64 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

65 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Rregullore nr. 02/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e financave, punës dhe transfereve](#), 31 mars 2023, qasur më 14 gusht 2023, neni 7, Departamentet dhe Divizionet e Ministrisë.

66 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

67 Po aty.

68 MFPT, [Rregullore nr. 02/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e financave, punës dhe transfereve](#), neni 50, Divizioni i ndihmës sociale.

Në kuadër të DSS-së, Divizioni i Ndhmës Sociale duhet të mbledhë, analizojë, raportojë dhe bashkëpunojë me ASK-në për publikimin e të dhënave për varfërinë.⁶⁹ ASK publikon statistika mujore, tremujore dhe vjetore për mirëqenien sociale. Statistikat mujore për mirëqenien sociale u përditësuan që nga korriku 2023, por statistikat tremujore nuk janë përditësuar që nga prilli 2021, kurse statistikat vjetore janë në dispozicion vetëm deri nga viti 2018.⁷⁰

Nga 36 kategori për të cilat të dhënat e mirëqenies sociale raportohen çdo tremujor, vetëm 16 ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë.⁷¹ Kudo që gjinia përdoret si tregues, po ashtu përdoret edhe kombësia (d.m.th., përkatësia etnike) si dhe komuna (vendndodhja). DSS ka shprehur shqetësimin lidhur me mungesën e koordinimit të të dhënave ndërmjet ASK-së, MFPT-së, DSS-së dhe QPS-ve; mbledhja dhe publikimi i koordinuar i të dhënave mund të informojë më mirë hartimin e politikave publike për shërbimet sociale.⁷² Mungesa e të dhënave të sakta digjitale pengon aftësinë e DSS-së për të përmbushur përgjegjësitë e saj për të bërë hulumtime që do të lehtësonin monitorimin, vlerësimin dhe hartimin më të përgjegjshëm gjinor të shërbimeve të ndihmës sociale. Sidomos DSS-ja nuk ka bërë deri më tani monitorimin apo vlerësimin që përfshin analizën gjinore, duke përfshirë edhe kohën kur ka funksionuar në kuadër të MPMS-së.⁷³

Ish Divizioni për Planifikim dhe Përfshirje Sociale publikoi në vitin 2021 një raport statistikor mbi numrin e përfituesve të SNS-së sipas komunës, moshës, gjinisë dhe kombësisë (d.m.th., përkatësisë etnike).⁷⁴ Divizioni tha se arsyeja kryesore e hartimit të raportit ishte zbatimi i një detyrimi ndaj BE-së si pjesë e marrjes së financimit të IPA 2019, për të raportuar për treguesin e shtatë: “Të dhëna statistikore transparente dhe të ndara sipas gjinisë për shpërndarjen e ndihmës sociale”.⁷⁵ Përkundër kryerjes së kësaj detyrë thjesht për të raportuar në BE, Divizioni mund ta kishte bërë këtë një praktikë të standardizuar dhe të institucionalizuar në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, duke ofruar të dhëna të rregullta të ndara sipas gjinisë për ASK-në për përfituesit. Megjithatë, nuk u prodhuan raporte të mëtejshme.

Departamenti i Pensioneve ka mbetur nën MFPT-në, i përbërë nga divizionet për politikën pensionale dhe aftësi të kufizuara, pensionet e jashtme, administrimin e skemave pensionale dhe administrimin e skemave pensionale

69 Po aty, neni 5.

70 ASK, “Të dhënat e ASK-së”, qasur më 14 gusht 2023.

71 ASK, [Statistikat e mirëqenies sociale](#), tremujori, 2023.

72 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

73 Po aty.

74 MPMS, Departamenti për Politikë Sociale dhe Familje, [Raport statistikor: Numri i përfituesve të Skemës së Ndhmës Sociale sipas komunës, moshës, gjinisë dhe përkatësisë etnike](#), janar 2021.

75 Po aty.

për kategoritë e luftës.⁷⁶ Departamenti i Pensioneve është përgjegjës për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave dhe statistikave mbi pagesat e pensioneve. Nuk ofrohet asnjë shërbim online. Departamenti i pensioneve përbëhet nga 55 punonjës, por të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin të disponueshme.

Secila **komunë** ka një drejtori përgjegjëse për shëndetësi dhe mirëqenie sociale. Drejtoritë duhet të sigurojnë që QPS-të në zonën e tyre të kenë burime për të përmbushur standardet e specifikuar nga Ministria. Këtu përfshihen kategoritë dhe numri i stafit profesional të punësuar. Ata mund të ofrojnë ose lehtësojnë, përmes QPS-së ose OJQ-ve, ofrimin e shërbimeve shtesë.⁷⁷ Qeveria duhet të sigurojë që shërbimet sociale të jenë në dispozicion për të gjithë banorët “pa asnjë dallim, si raca, përkatësia etnike, gjinia, gjuha, religjioni, mendimi politik, origjina kombëtare apo sociale, pasuria, lindja apo diçka tjetër”.⁷⁸ Nëpërmjet Departamenteve komunale për Mirëqenie Sociale, Qeveria duhet të monitorojë punën e ofruesve të shërbimeve, veçanërisht atyre të angazhuar në shërbimet e rehabilitimit dhe riintegritimit.⁷⁹ Pra, shërbimet sociale janë të decentralizuara. Komunitat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve sociale,⁸⁰ sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare.⁸¹

Duke funksionuar në kuadër të ZKM-së, **ASK**-ja është përgjegjëse për mbledhjen, shpërndarjen dhe koordinimin e statistikave zyrtare sociale. Përdorimi i treguesve të gjinisë, përkatësisë etnike, moshës dhe aftësisë nga ASK në statistikat sociale është rritur, por mund të përmirësohet. Raporti i KE-së për Kosovën 2020 vuri në dukje se nevojitet më shumë koordinim dhe udhëheqje më e fortë e qeverisë për të zbatuar Ligjin për Barazi Gjinore dhe se institucionet duhet të përmirësojnë mbledhjen, mirëmbajtjen dhe raportimin transparent të të dhënave të ndara sipas gjinisë.⁸² Gjetja/përcjellja e pamjaftueshme e përfituesve sipas gjinisë nga qeveria, e bën të vështirë me kalimin e kohës monitorimin e ndryshimeve sociale ose ndërmarrjen e vlerësimeve *ex-post* të ndikimit gjinor. Të dhëna të tilla do të mundësonin analizën gjinore që informon më mirë planifikimin dhe buxhetimin.

76 MFPT, [Rregullore nr. 02/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e financave, punës dhe transfereve](#), neni 7, Departamentet dhe Divizionet e Ministrisë.

77 Ligji për shërbime sociale dhe familjare, Roli i komunës, neni 6, paragrafi 6.7.

78 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2005, neni 2.1.

79 Po aty, nenet 2 dhe 3.

80 Qendra Evropiane për hulumtim dhe politika të mirëqenies sociale, “[Monitorimi dhe vlerësimi i shërbimeve sociale në Kosovë – sfidat dhe rekomandimet e politikave](#)”, përmbledhje e politikave, 2019/14.

81 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale](#), 2008 dhe [Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2005.

82 KE, [Raporti për Kosovën 2020](#), 2020, f. 34.

Kuvendi është përgjegjës për hartimin e ligjeve, miratimin e buxheteve dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe programeve nga Qeveria, veçanërisht Komisioni parlamentar për Legjislacion, Mandatet, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Ai në përbërjen e tij ka dy gra (20%) dhe tetë burra (80%). Nënperfaqësimi i grave në këtë Komision mund të pengojë kontributin e tyre në legjislacionin për digjitalizim, si dhe monitorimin e përgjegjshëm gjinor të zbatimit të tij. Sipas procesverbalit e gjetur në faqen e internetit të Kuvendit, Komisioni nuk ka pasur asnjëherë ndonjë diskutim rreth buxhetimit të përgjegjshëm gjinor apo qasje gjithëpërfshirëse ndaj digjitalizimit në lidhje me këtë sektor.⁸³

Aftësitë

Punonjësit socialë kanë mungesë të njohurive mbi ndikimin që teknologjitë digjitale mund të kenë tek fëmijët.⁸⁴ Për të mbrojtur fëmijët, ata duhet të dinë se si fëmijët përdorin komunikimin online dhe rrjetet sociale, si dhe për kërcënimet dhe rreziqet aktuale në internet. Ato kanë nevojë të dinë e të kuptojnë ndikimin e teknologjisë tek fëmijët dhe të rinjtë, si dhe se si përdorimi i teknologjisë nga prindërit dhe kujdestarët ndikon tek fëmijët dhe familjet. Vlerësimet e familjes mund të përmbajnë pyetje për të kuptuar përdorimin

e teknologjisë dhe efektet në familje dhe anëtarët e saj individualë. Bazuar në vlerësime të tilla, ndërhyrjet mund të dizajnohen për të “mbështetur përdorimin e duhur të teknologjisë brenda familjeve”. Në Kosovë, asnjë vlerësim i njohur nuk ka ekzaminuar kapacitetet e punonjësve socialë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi i mundshëm online.

Asnjë analizë e njohur, përfshirë analizën gjinore, nuk është ndërmarrë për të kuptuar nevojat e punonjësve të qeverisë, stafit të administratës publike ose punonjësve socialë në lidhje me transformimin digjital të shërbimeve sociale. Zyrtarët vunë re se kjo nuk është konsideruar e nevojshme.⁸⁵ Një zyrtar i DSS komentoi:

“Për të bërë një analizë të nevojave të punonjësve socialë në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve sociale, [...] fillimisht duhet të kenë një kompjuter ose një tablet. Deri vonë, ata nuk i kishin.”

- Zyrtar, DSS

Për të bërë një analizë të nevojave të punonjësve socialë në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve sociale, për shembull, nëse ata dinë të përdorin kompjuterin, tabletin ose ndonjë pajisje tjetër, fillimisht duhet të kenë një kompjuter ose një tablet. Deri vonë, ata nuk i kishin.

83 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Komisioni për Legjislacion, Mandatet, Imunitetet, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit](#), qasur më 28 gusht 2023.

84 Sarah Pink, “[Digital social work: Conceptualising a hybrid anticipatory practice](#)” (shqip: *Puna digjitale sociale: Konceptimi i një praktike parashikuese hibride*), *Qualitative Social Work*, 2022, Vol. 21(2) 413–430, SAGE.

85 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, MFPT, 2023.

Që tani e tutje, mendojmë se do të ishte një ide e mirë që të fillonim vlerësimin e nevojave të tyre.⁸⁶

Vëzhgimet e zyrtarëve sugjerojnë se punonjësve socialë në QPS shpesh u mungojnë aftësitë profesionale digjitale për futjen e të dhënave rreth përfituesve të SNS-së.⁸⁷ Kjo kontribuon në integrimin e ngadaltë të të dhënave të qëndrueshme dhe në kohë në SNS. Stafi i QPS-së gjithashtu ka mungesë të njohurive dhe kapaciteteve për përdorimin e sistemit TI të SNS.⁸⁸ Në vitin 2019, Banka Botërore arriti në përfundimin se mungesa e njohurive dhe kapaciteteve në mesin e stafit të QPS-së për përdorimin e sistemit të TI-së ishte një sfidë e dukshme.⁸⁹ Zyrtarët vunë re se përmirësimet e infrastrukturës do të kërkojnë një vlerësim të nevojave të punonjësve socialë për aftësitë digjitale,⁹⁰ dhe kjo mund të përfshijë analizën gjinore.

Punonjësit socialë duhet të sigurojnë konfidencialitetin.⁹¹ Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare e konsideron shkëmbimin e informacionit, elektronik ose tjetër, me palët e treta të paautorizuara një formë të “shkeljes flagrante profesionale”, potencialisht përgjegjëse për ndjekje penale sipas Kodit Penal⁹² Nuk ekziston asnjë provë që punonjësit socialë u nënshtrohen masave disiplinore të brendshme, se iu është hequr licenca ose se përballen me dënime gjyqësore për shkak të shkeljes së konfidencialitetit.⁹³ Megjithatë, vëzhgimet e RrGK-së për punën e QPS-ve sugjerojnë se kanë ndodhur thyerje të konfidencialitetit, por ndoshta nuk janë raportuar apo trajtuar. Për shembull, disa punonjës socialë ndërmjetësojnë takimet midis viktimave dhe autorëve të krimit ose ndajnë vendndodhjen e viktimave me autorët, duke besuar se viktimat duhet të përpiqen të pajtohen me autorët e dhunës për të qëndruar së bashku.⁹⁴

Një punonjës social i tha RrGK-së: “Ndonjëherë edhe policia thyen konfidencialitetin dhe informacioni përhapet shpejt, veçanërisht nëse bashkëshorti i viktimës ka pushtet ose është i njohur brenda institucioneve.”⁹⁵

86 Po aty.

87 Po aty.

88 MPMS, Departamenti për Politikë Sociale dhe Familje, [Koncept-dokumenti për Skemën e Ndihmës Sociale](#), 2019, f. 19.

89 Grupi i Bankës Botërore, [Studimi mbi skemën e ndihmës sociale në Kosovë: Vlerësimi dhe opsionet për reformë](#), 2019, f. 37.

90 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS, MFPT, 2023.

91 Në përputhje me [Ligjin nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale](#), 2008, nenet 12.2 dhe 17; Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligjin nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2005, nenet 6 dhe 7; dhe Statutin e Komunës (secila komunë harton statutet për QPS-të, që përfshin konfidencialitetin).

92 Neni 15.

93 Korrespondenca e RrGK-së me the Ministria e Drejtësisë, nëntor 2023.

94 RrGK, [Nga Ligjet në Vepra](#), 2021, f. 108.

95 Korrespondenca e RrGK-së me punonjësin social, gusht 2023.

Sigurimi i konfidencialitetit dukej gjithashtu se ishte një sfidë për aktorët e tjerë që asistonin rastet e dhunës në familje. Një punonjës social tha: “Ndoshta kur përmirësohet sistemi i të dhënave, atëherë mund të mbrojmë identitetin e rasteve. Dhe ne [institucionet] të gjithë do të kemi qasje më të lehtë, pa rrezikuar identitetin e personit.”⁹⁶ Deri më sot, asnjë vlerësim nuk duket të ketë shqyrtuar konfidencialitetin në lidhje me të dhënat që ata i mirëmbajnë apo integrojnë në SMIL ose nëse menaxhimi elektronik i të dhënave ka ndikuar në besimin e viktimave te punonjësit socialë. As nuk duket se janë vlerësuar aftësitë e profesionistëve të shërbimeve sociale për të siguruar mbrojtjen e të dhënave.

Shërbimet publike digjitale

Informacioni për ndryshimet dhe bartje e kompetencave nga MPMS në MFPT në Ministrinë e Drejtësisë nuk është publikisht në dispozicion në faqet e internetit të këtyre ministrive, duke çuar kështu në konfuzion se cila Ministri është përgjegjëse për çfarë. Informacioni në faqet e internetit të qeverisë në lidhje me shërbimet sociale ishte konfuz në vitin 2023. Faqja e vjetër e internetit e Ministrisë së Financave mbeti aktive pa përditësime të fundit në shërbime apo përgjegjësi. Megjithëse MPMS nuk ekzistonte më, faqja e saj e internetit vazhdoi të shfaqte informacione të pasakta dhe të vjetruara për departamentet dhe divizionet.⁹⁷ Në vjeshtën e vitit 2023, MFPT ende nuk kishte pasqyruar ndryshimet në përgjegjësi në faqen e saj të internetit, megjithëse përditësimet ekzistonin që nga dhjetori.⁹⁸ Vonesat në ofrimin e informacionit në kohë rreth shërbimeve mund të kontribuojnë në konfuzionin e qytetarëve që kërkojnë në internet informacion rreth shërbimeve dhe ndihmës sociale. Mungesa e informacionit digjital në kohë e bën të vështirë për të ndjekur monitorimin e vazhdueshëm të lajmeve, progresin në hartimin e politikave dhe njoftimet tjera që lidhen me politikën sociale dhe familjare, duke penguar kështu pjesëmarrjen e publikut në këto procese, qasjen në shërbime dhe monitorimin e progresit të shoqërisë civile, duke përfshirë edhe analiza gjinore.

Faqja e internetit e MPMS-së nuk përmban asnjë shërbim online për qytetarët. Disa informacione janë në dispozicion në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, por vetëm versioni shqip është i përditësuar; shumica e dokumenteve, vendimeve dhe të dhënave nuk janë në dispozicion në gjuhën angleze ose serbe.⁹⁹ Gjuha e përdorur nuk i referohet në mënyrë specifike grave ose burrave, por emrat pasqyrojnë paragjykimet mashkullore. Pamjet vizuale në faqen e internetit përbëhen kryesisht nga burra. Pra, gjuha dhe pamjet vizuale janë negative në aspektin gjinor. Seksioni i ri për DSS-në në faqen e internetit të MFPT është në tri gjuhë. Megjithatë, informacioni është kryesisht i disponueshëm në

96 Po aty.

97 Republika e Kosovës, [MPMS, faqja e internetit](#), “Departamentet”, qasur më 2 dhjetor 2023.

98 Republika e Kosovës, [MFPT, faqja e internetit](#), qasur më 4 tetor 2023 dhe 2 dhjetor 2023.

99 Republika e Kosovës, [MPMS faqja e internetit](#), qasur më 2 dhjetor 2023.

gjuhën shqipe dhe për disa shërbime nuk ekzistonte përmbajtja.¹⁰⁰ Seksioni “Si mund të” në faqen e internetit shpjegon se si të aplikohet për shtesat e lehonisë, shtesat e fëmijëve, pensionet dhe skemat sociale. Për aplikimet për pensione, faqja e internetit i drejton përdoruesit në seksionin e pensioneve MFPT. Për shtesat, ai i ridrejton përdoruesit në platformën eKosova për të aplikuar. Platforma eKosova mund të përmirësohet për të përfshirë aplikacione digjitale për pensione dhe skema sociale. Nuk duket se ekziston asnjë shërbim tjetër publik online në faqen e internetit të MFPT-së.

Për t’u kualifikuar për SNS-së ose shërbime sociale, procesi i vlerësimit kërkon ende që aplikuesit të jenë fizikisht të pranishëm.¹⁰¹ Individët duhet të dorëzojnë aplikacione në kopje fizike me dokumente që ilustrjnë se i përmbushin kriteret për ndihmë sociale, personalisht në QPS-në komunale më të afërt. Nuk kërkohet asnjë pagesë. QPS-të ofrojnë informacion bazë për plotësimin e aplikacionit për SNS, i cili përfshin një formular të marrë në QPS, certifikatën e lindjes për të gjithë anëtarët e familjes, një kopje të letërnjoftimit të aplikuesit, vërtetime që tregojnë nëse fëmijët e familjes janë duke ndjekur shkollimin, një vërtetim nga Zyra për punësim që tregon statusin e punësimit dhe një faturë të energjisë elektrike. Për të kërkuar përfitimet e papunësisë, duhet të

paraqiten dëshmi mjekësore ose raporte. Zyrtarët e ASHI thanë se janë duke u përpjekur që të integrojnë këto dhe të dhëna të ngjashme të përdoruesve në platformën eKosova, në mënyrë që përdoruesit e eKosova tashmë të kenë një profil me këto dokumente; atëherë ata nuk do të kishin nevojë të siguronin të njëjtat dokumente për secilin shërbim.¹⁰² Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur ende. Vënia në dispozicion e shërbimeve të tilla digjitale, duke përfshirë ndërveprueshmërinë dhe shkëmbimin e të dhënave nëpër institucione, mund të lehtësojë procesin e aplikimit për ndihmë sociale, duke qenë se qytetarët nuk do të duhej t’i nënshtroheshin procedurave të shumta për të marrë dokumente për aplikim.

Nga digjitalizimi i këtyre shërbimeve mund të përfitojnë gratë dhe burrat që kanë vështirësi të qasin fizikisht shërbimet publike. Për shembull, gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara, që jetojnë në zona gjeografike rurale, ose nuk kanë kohë ose financa për të udhëtuar, nuk do të duhej të vizitonin fizikisht QPS-të ose institucionet e nivelit qendror për të iniciuar ose ndjekur aplikimet.

Gjetja e ndihmës sociale, përfitimeve dhe aplikimeve për pensione në internet mund të mbështesë gratë dhe burrat që kanë përjetuar ose përjetojnë dhunën me bazë gjinore, veçanërisht nëse janë në rrezik të dhunës së mëtejshme,

“Nëse do të ekzistonte mundësia që unë të gjeja online aplikacionin tim për banim social, kjo do të ishte një ndihmë e madhe. Kam shumë frikë të largohem nga shtëpia dhe të vizitoj Qendrën për Punë Sociale për të pyetur. Kam frikë t’i lë fëmijët e mi vetëm në shtëpi, pasi kam frikë se do t’i gjejë burri im.”

- Gruaja që përjeton dhunë me bazë gjinore

100 Republika e Kosovës, MFPT, faqja e internetit, “Politikat sociale” qasur më 2 dhjetor 2023.

101 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

102 Intervista e RrGK-së me ASHI, 2021.

nuk mund të largohen nga shtëpia e tyre ose kanë frikë të largohen. Një grua që përjetonte dhunë me bazë gjinore i tha RrGK-së: “Nëse do të ekzistonte mundësia që unë të gjeja online aplikacionin tim për banim social, kjo do të ishte një ndihmë e madhe. Kam shumë frikë të largohem nga shtëpia dhe të vizitoj Qendrën për Punë Sociale për të pyetur. Kam frikë t’i lë fëmijët e mi vetëm në shtëpi, pasi kam frikë se do t’i gjejë burri im”¹⁰³ Edhe pse ky rast i referohet banimit social, probleme të ngjashme ekzistojnë me aplikacionet e tjera që kërkojnë prani fizike.

Rezultatet nëse ndonjë aplikacion për SNS është pranuar apo jo, duhet t’i dërgohen në mënyrë elektronike aplikuesit brenda 45 ditëve.¹⁰⁴ Periudha e gjatë e pritjes është identifikuar si një arsye pse disa njerëz mund të mos angazhohen në punësim afatshkurtër ose punë sezonale, pasi koha e nevojshme për t’u ri-kualifikuar për ndihmë sociale mund të rrezikojë jetesën e tyre për një muaj e gjysmë gjatë pritjes së përgjigjes.¹⁰⁵ Kjo mund të rezultojë në punë joformale pasi punonjësit mund të përballen me barrë administrative dhe pasoja financiare për raportimin e punës afatshkurtër. Kjo nga ana tjetër mund të kontribuojë në shkeljen e të drejtave të punëtorëve për punonjësit që punojnë pa kontrata, si dhe në humbjen e të ardhurave nga tatimet për shtetin. Digjitalizimi i këtyre shërbimeve mund të ndihmojë në përshtetimin e procesit të rishikimit, duke krijuar kështu një mjedis të përshtatshëm për më shumë njerëz që marrin aktualisht ndihmë sociale për t’u futur në ekonominë formale, veçanërisht për punë sezonale dhe afatshkurtër, duke adresuar kështu edhe joformalitetin. Kjo do të kishte pasoja pozitive për gratë, burrat dhe shoqërinë.

Dy shërbime sociale ofrohen përmes platformës eKosova: aplikacionet online për “shtesat e lehonisë” dhe për “shtesat për fëmijë”.¹⁰⁶ Qeveria i ndërmoi këto masa si pjesë e pakos së ringjalljes ekonomike COVID-19 në vitin 2021.¹⁰⁷ Sipas masës 3.5, “gratë e papunësuaras pas lindjes së fëmijës në 12 muajt e fundit, mund të marrin mbështetje financiare prej 170 € për gjashtë muajt; kurse, gratë e punësuaras mund të marrin mbështetje financiare prej 170 € për tre muajt, përveç kompensimit të rregullt të tyre të pushimit të lehonisë”.¹⁰⁸ Shtesat për fëmijët u transferuan në llogaritë bankare të nënave.¹⁰⁹ Vetëm nënat mund të aplikojnë për shtesa për fëmijë, përveç nëse nëna mungonte,

103 Biseda e RrGK-së me gruan që përjeton dhunë, 2022.

104 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 2003/15 për Skemën për Ndhimën Sociale në Kosovë](#), neni 8.

105 RrGK për FAO, *Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale*, së shpejti do të publikohet.

106 MPB, ASHI, [Platforma eKosova](#).

107 MFPT, [Pako e ringjalljes ekonomike](#), 2021, qasur më 15 gusht 2023.

108 MFPT, lajmet, [Fillon mbështetja për lehonat dhe skema për shtesat për fëmijë](#), 2021, qasur më 9 dhjetor 2023.

109 Koha.net, [“Shtesat për fëmijë, Murati: Mbi 89 mijë gra hapën llogari bankare për herë të parë”](#), 8 mars 2023, qasur më 15 gusht 2023.

baballarët mund të aplikonin në këtë rast.¹¹⁰ Fillimisht, vendimi i Qeverisë parashihte vetëm shtesa për fëmijë për fëmijët e lindur në vitet 2020 dhe 2021.¹¹¹ Megjithatë, që nga janari 2023, njerëzit mund të aplikojnë për shtesa për fëmijë për fëmijët e lindur që nga viti 2012.¹¹² Shtesat për fëmijët nga dy deri në 16 vjeç janë 10 € në muaj dhe 20 € në muaj për fëmijët 0-24 muajsh.¹¹³

Si shtesat për lehonisë ashtu edhe për fëmijën, me sa duket mbetën në fuqi në vitin 2023, megjithëse RrGK nuk gjeti asnjë vendim zyrtar për vazhdimin e masave. EKosova ofron shërbime në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe, por jo të gjithë personat me aftësi të kufizuara kanë qasje në formularët online.

Gratë e papunësuaras pas lindjes së fëmijës në 12 muajt e fundit, mund të marrin mbështetje financiare prej 170 € për gjashtë muaj.

Gratë e punësuaras mund të marrin mbështetje financiare prej 170 € për tre muaj, përveç kompensimit të rregullt të tyre të pushimit të lehonisë

Informacioni online ishte i paqartë në lidhje me kualifikueshmërinë e grave për shtesat e lehonisë. Një fushatë informuese u publikua në gjuhën shqipe në vitin 2021.¹¹⁴ Ai nuk përmbante kriteret e kualifikueshmërisë dhe shpjegonte shkurtimisht teknikat e regjistrimit, hyrjes në platformën eKosova dhe aplikimit. Pa informacion të mjaftueshëm, një zyrtar tha se “Gratë shpesh nuk e dinë nëse mund të aplikojnë për shtesa të lehonisë. Për shembull, nëse ato janë të punësuaras, ato shpesh nuk e konsiderojnë veten të kualifikuar dhe nuk aplikojnë.”¹¹⁵ Në faqen e internetit të MFPT-së nuk ka të dhëna miqësore për përdoruesit që njerëzit të shohin ose analizojnë sasinë e fondeve të shpërndara, si p.sh. një vizualizimi interaktiv

i përfituesve sipas moshës, komunës, përkatësisë etnike dhe informacioneve të tjera demografike. Megjithatë, zyrtarët vërejtën se digjitalizimi i këtyre dy shërbimeve ka pasur efekte pozitive; 89,241 gra hapën llogari bankare për herë të parë për të marrë shtesa për fëmijë.¹¹⁶ Gratë duhej të hapnin profilin në eKosova, të cilin zyrtarët e konsideruan si masë pozitive ndaj asaj që më shumë gra të kenë qasje në shërbimet publike. Kjo mund të mundësojë që më shumë gra të përfitojnë nga shërbimet e eKosova në të ardhmen, pasi më shumë shërbime publike po digjitalizohen. Për shembull, më shumë gra mund të kërkojnë drejtpërdrejt përfitime të ndihmës sociale.

Sa i përket pensioneve, njerëzit nuk mund të aplikojnë ose të ndërpresin pensionet online. Ata mund të kenë qasje në pasqyrat e llogarisë së tyre për kursime pensionale vetëm përmes platformës eKosova. Asnjë shërbim tjetër

110 MFPT, *Vendimi mbi caktimin e kushteve dhe kritereve për zbatimin e pjesshëm të masës 3.5 - PAGESAT PËR LEHONAT DHE SHTESAT PËR FËMIJË TË PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE*, qasur më 15 gusht 2023.

111 Po aty., A) Forma e subvencionit, paragrafi 2.1

112 Po aty., paragrafi 2.4

113 Po aty. Dhe komenti i DSS për projektligjin, nëntor 2023.

114 *Ministria e Financave / Republika e Kosovës* [Ministria e Financave / Republika e Kosovës], [Facebook](#), qasur më 2 Dhjetor 2023.

115 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

116 *Koha.net*, “*Shtesat për fëmijë, Murati: Mbi 89 mijë gra hapën llogari bankare për herë të parë*”, 8 mars 2023, qasur më 15 Gusht 2023.

social ende nuk është digjitalizuar.¹¹⁷ Qeveria nuk ka digjitalizuar aplikacionet apo përditësimet mbi proceset e aplikimit për banim social, ndihmë sociale, përfitime për kategoritë e luftës duke përfshirë personat që kanë pësuar dhunë seksuale gjatë luftës, pensionet, përfitimet e pushimit të lehonisë, kujdestarinë ndaj fëmijëve, birësimin ose shërbimet sociale, duke përfshirë ato për fëmijët në paraburgim, personat me aftësi të kufizuara, asistentët e tyre personalë ose shtëpitë e të moshuarve. As procesi i licencimit të ofruesve të shërbimeve profesionale nuk është digjitalizuar, si p.sh. për të ndihmuar personat që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore, fëmijët apo asistentët personalë për personat me aftësi të kufizuara. Ministria e Drejtësisë ka bërë njoftimin në maj të vitit 2023 se shërbimet sociale do të digjitalizohen “së shpejti”.¹¹⁸

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë shërbimet sociale, duhet të ofrojnë informacione dhe të rrisin ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme që lidhen me aktivitetet online.¹¹⁹ Megjithatë, RrGK nuk ka mundur të gjejë dëshmi për ndonjë fushatë të tillë publike online nga Ministria e Drejtësisë, MFPT, apo komunat. Meqenëse pak shërbime publike janë në dispozicion online, përfshirja e tyre e aspektit gjinor nuk mund të vlerësohet.

Financimi dhe prokurimi

Qeveria duhet të ndajë çdo vit fonde për komunat dhe organizatat që ofrojnë shërbime sociale dhe familjare në emër të shtetit, të shpërndara nëpërmjet prokurimit publik të këtyre shërbimeve.¹²⁰ Komunat menaxhojnë shëndetin, arsimin, trajnimin, punësimin dhe shërbimet sociale. QPS-të në secilën komunë zbatojnë ndihmën dhe shërbimet sociale. Për të ofruar këto shërbime, komunat varen nga Granti i Përgjithshëm i bartur çdo vit nga buxheti i Kosovës, i cili përbën më shumë se 80% të pothuajse të gjitha buxheteve të komunave, përveç Prishtinës.¹²¹ Komunat mund të gjenerojnë të ardhura, duke i ndarë këto për të adresuar çështje të tilla si dhuna me bazë gjinore, por pak e bëjnë këtë gjë.¹²² Pasi që transfertat e buxhetit të qeverisë qendrore llogariten në bazë të një formule të përcaktuar ligjërish, komunat përballen me kufizime në sasinë e financimit që mund të kërkojnë nga buxheti i nivelit qendror. Ata nuk kanë as sisteme adekuate për gjetjen/përcjelljen e përfituesve të shërbimeve, të cilat mund të informojnë kërkesat buxhetore, duke përdorur buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. As KASH dhe as Buxheti i Kosovës nuk

117 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

118 Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, lajme: “*Së shpejti fillon digjitalizimi i shërbimeve që ofron Ministria e Drejtësisë*”, 12 maj 2023, qasur më 2 dhjetor 2023.

119 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës](#), 2019.

120 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare](#), 2007, neni 2.10.

121 Republika e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, [Tregues të Performancës për Nivelin Lokal Qeverisës për vitin 2018](#), 2019, qasur më 11 dhjetor 2023.

122 RrGK, [Nga Ligjet në Vepra](#), 2021, f. 63.

përmbajnë informacione që kanë të bëjnë me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor për ndihmë apo shërbime sociale.¹²³

Pavarësisht decentralizimit, financimi dhe infrastruktura janë të pamjaftueshme.¹²⁴ Ofruesve të shërbimeve, përfshirë QPS-ve dhe strehimoreve, u mungojnë alokimet e mjaftueshme buxhetore për kryerjen e përgjegjësisë të tyre ligjore, veçanërisht për burimet njerëzore, automjetet dhe hapësirën e duhur.¹²⁵ Një përfaqësues i MPMS-së vërejtë financim të pamjaftueshëm për zbatimin e PSV-ve për dhunën në familje për shkak se punonjësve socialë u mungojnë automjetet për të vizituar viktimat.¹²⁶ Pra, siç u diskutua në seksionin për **Infrastrukturën**, infrastruktura e pamjaftueshme pengon aftësinë për të ofruar shërbime sociale.

Në përgjithësi, MPMS më parë, MFPT dhe Ministria e Drejtësisë nuk kanë ofruar në faqet e tyre të internetit informacione të qasshme për publikun, të përshtatshme për përdoruesit dhe në kohë në lidhje me financimet publike të planifikuara dhe të shpenzuara për shërbimet publike sociale dhe asistencën; as buxhetimi i përgjegjshëm gjinor nuk përdoret për të ilustruar vizualisht se si kanë përfituar nga gratë dhe burrat nga shpenzimet. MPMS dhe RrGK bashkëpunuan për të krijuar procese për buxhetim të përgjegjshëm gjinor lidhur me shërbimet dhe ndihmën sociale në vitin 2014 dhe 2015, duke publikuar të dhëna ndërthurëse, të ndara sipas gjinisë. Megjithatë, as MPMS-ja dhe as ministrinë që më vonë morën përgjegjësitë e saj, duket se nuk kanë vazhduar të përdorin zgjidhjet digjitale për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Kjo është një mundësi e humbur pasi dëshmitë për shpenzimet e mëparshme mund të kishin mbështetur kërkesat buxhetore për vitet e ardhshme.

PRE 2023-2025 rendit Projektin e Reformimit të Sistemit të Ndihmës Sociale në Kosovë si kyç.¹²⁷ Ai synon të forcojë sistemet e ofrimit të mbrojtjes sociale dhe të përmirësojë performancën e SNS-së, duke përfshirë rregullimin e kriterëve të kualifikueshmërisë.¹²⁸ Vlerësimi i përsheptuar i SNS-së i bërë për të informuar dizajnin e ndërhyrjes përfshinte analizën gjinore. Ai zbuloi disa mangësi në promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë pengesat dhe barrierat administrative që minojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.¹²⁹ Duke qenë se legjislacioni për SNS-në u miratua në fillim të viteve

123 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026](#), 2023; Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023](#), 2022.

124 Qendra Evropiane për hulumtim dhe politika të mirëqenies sociale, “[Decentralizimi i Shërbimeve Sociale në Kosovë – Sfidat dhe Rekomandimet e Politikave](#)”, përmbledhje e politikave, 2018/5.

125 RrGK, [Nga Ligjet në Vepra](#), 2021, f. 106.

126 Po aty, f. 107.

127 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformave Ekonomike 2023-2025](#), 2023.

128 Po aty.

129 Korrespondenca e RrGK-së me Bankën Botërore në Kosovë, shtator 2023.

2000 dhe u ndryshua në vitin 2012, dy kategoritë e përcaktuara ngushtë për t'u kualifikuar për SNS janë të vjetruara. Si pasojë e kësaj, sipas Bankës Botërore, i rrituri i dytë në familje, zakonisht grua, duhet të kërkojë statusin e personit “të varur”, gjë që është ligjërisht e mundur nëse ajo kujdeset për të paktën një fëmijë nën moshën pesë vjeç (ose një jetim nën 15 vjeç), është me aftësi të kufizuara ose ka detyrime perkujdesjeje për një anëtar të familjes me aftësi të kufizuara. “Rezultati është se shumë gra në familjet me SNS janë të përjashtuara nga tregu i punës”.¹³⁰ Sipas Agjencisë për Punësim të Republikës së Kosovës (APRK), në mesin e 10,389 përfituesve të SNS të regjistruar në vitin 2017, vetëm 519 ishin gra (5%).¹³¹ Projekti planifikon të heqë kufizimet për pjesëmarrjen në tregun e punës për gratë në familjet përfituese të SNS-së; të zhvillojë një mjet profilizimi për punëtorët e rasteve për të identifikuar pengesat për pjesëmarrjen në tregun e punës; dhe të zhvillojë mekanizmat për referimin e përfituesve të aftë për punë në shërbimet e punësimit, duke u dhënë përparësi grave për programet aktive të tregut të punës (PATP).¹³² Projekti synon që gratë të përbëjnë së paku 30% të përfituesve dhe të dyfishojë

pjesën e grave përfituese të SNS të regjistruara si të papuna në APRK nga pesë për qind në dhjetë për qind. Projekti i planifikuar do të financohet nga një Shoqatë Ndërkombëtare për Zhvillim - Banka Botërore me kredi prej 47 milionë euro dhe do të zbatohet përgjatë pesë viteve.¹³³ Marrëveshja është nënshkruar ndërmjet Qeverisë dhe Bankës Botërore në tetor të vitit 2021. Raportohet se ajo është ratifikuar nga Kuvendi në prill 2023 dhe zbatimi ka filluar në maj të vitit 2023.¹³⁴

Ministria e Drejtësisë, MPMS dhe MFPT kanë publikuar thirrjet dhe dosjet e tenderit në lidhje me e-prokurimin në faqet e tyre të internetit. Sa i përket Ministrisë së Drejtësisë, nga 27 konkurse të shqyrtuara, vetëm në njërin (3%) janë përdorur prapashtesat “i” dhe “e” në titull, duke inkurajuar të dyja gjinitë të aplikonin.¹³⁵ Ndërkohë, 24 (89%) kishin një deklaratë që inkurajonte të dyja gjinitë ose gjininë e nënpërfaqësuar për të aplikuar.¹³⁶ Në mesin e 55 vendeve të lira të punës të shpallura në faqen e internetit të MFPT-së, në asnjërën prej tyre nuk shkruante që synonin si burrat ashtu edhe gratë duke pasur parasysh paragjykimet gjinore

i
nga 27 konkurse të shqyrtuara, vetëm në njërin janë përdorur prapashtesat “i” dhe “e” në titull, duke inkurajuar të dyja gjinitë të aplikonin.

130 Po aty.

131 Po aty.

132 Po aty.

133 Banka Botërore, komunikatë për shtyp, “[Me mbështetjen e Bankës Botërore, Kosova do të përmirësoj sistemin e ndihmës sociale](#)”, 29 shtator 2021, qasur më 10 dhjetor 2023.

134 Zyrtar i MFPT-së, koment për projektligjin, nëntor 2023. Megjithatë, kjo marrëveshje nuk është shtuar në listën e marrëveshjeve ndërkombëtare të Kuvendit (Republika e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, “[Marrëveshjet ndërkombëtare 2023](#)”, qasur më 21 dhjetor 2023).

135 Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, [Konkurse](#), qasur më 15 shtator 2023. Në të thuhet: “*Nëpunës/e Administrativ/e në Drejtorinë Qendrore të Shërbimit Sprovues të Kosovës*”.

136 Republika e Kosovës, Ministria e Drejtësisë, [Konkurse](#), qasur më 28 gusht 2023.

në gjuhën e përdorur; 42 (76%) kishin një deklaratë që inkurajonte të dyja gjinitë ose gjininë e nënpërfaqësuar për të aplikuar.¹³⁷ Fakti që disa dokumente të MFPT-së u skanuan e bëri të vështirë kërkimin e fjalëve kyçe si “gjinia” dhe kryerjen e analizave gjinore. Proceset për OShC-të dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve, përfshirë strehimoret, për të aplikuar për fondet e qeverisë nuk janë digjitalizuar, edhe pse kjo do të mund të lehtësonte proceset dhe të zvogëlonte barrën administrative për strehimoret dhe Qeverinë, veçanërisht nëse aplikime të tilla do të mund të ripërtëriheshin lehtësisht në bazë vjetore. Për të tria ministritë, dosjet e tenderit për e-prokurimin nuk përmbanin asnjë deklaratë që inkurajonte bizneset në pronësi të grave të aplikojnë. Komisionet përgjegjëse të Kuvendit nuk kanë diskutuar buxhetin e përgjegjshëm gjinor në lidhje me shërbimet dhe ndihmën sociale.

Infrastruktura

Ky seksion shqyrton disponueshmërinë e infrastrukturës gjinore për digjitalizimin e shërbimeve sociale. Të gjitha institucioneve u mungon softueri qendror për menaxhimin e të dhënave si dhe hardueri adekuat.¹³⁸ Në përgjithësi, ekzistojnë baza të të dhënave të brendshme për skemat sociale, por nuk ka udhëzim administrativ apo detaje të veçanta të protokollit proceset e punës nga mbledhja e të dhënave deri te raportimi.¹³⁹ Të dhënat mbrohen në përputhje me LMDHP dhe ruhen në bashkëpunim me ASHI. Nëse institucionet përkatëse ose donatorët kërkojnë të dhëna, MFPT nënshkruan marrëveshje që rregullojnë përdorimin e tyre të të dhënave, konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave personale.¹⁴⁰

Për ndihmën sociale, baza e të dhënave e SNS-së ekziston që nga viti 2005. MFPT e menaxhon atë në nivel qendror, dhe QPS-të në komuna e përditësojnë atë me të dhëna për përfituesit.¹⁴¹ Baza e të dhënave përmban variabla për gjininë, moshën, kombësinë (d.m.th., përkatësinë etnike) dhe komunën.¹⁴² Megjithatë, punonjësit socialë jo gjithmonë e kanë përditësuar rregullisht bazën e të dhënave, dhe disa QPS-ve u mungonte infrastruktura e duhur, siç janë tabletët ose kompjuterët për futjen e të dhënave. Disa donatorë kanë kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës së QPS-ve duke dhënë donacion pajisje si tableta dhe kompjuterë, por infrastruktura mbetet e pamjaftueshme për të mbështetur reformat digjitale.¹⁴³ Futja e dobët e të dhënave çon në të dhëna të pasakta, duke penguar kështu përdorimin e duhur të të dhënave për të informuar politikëbërjen e përgjegjshme gjinore dhe gjetjen e grupeve të

137 Republika e Kosovës, MFPT, [Konkurse](#), qasur më 28 gusht 2023.

138 UNDP, [Hartëzimi i mbledhjes së të dhënave për zhvillim, kapacitete të zgjeruara institucionale për përdorimin e të dhënave në Kosovë](#), 2023, f. 27.

139 Korrespondenca e DSS-së me RrGK-në, nëntor 2023.

140 Po aty.

141 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

142 Po aty.

143 Po aty.

synuara për SNS.¹⁴⁴ Për sa i përket ndërveprueshmërisë, Qeveria ka lidhur SNS me Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Punësim (SMIP) në drejtim të mbështetjes së politikës të përfshirjes së punës aktive. Megjithatë, MPMS-ja ka vërejtur se

edhe pse sistemi TI për SNS është i integruar me shumicën e skemave të transfertave sociale të MPMS-së dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), shkëmbimi i të dhënave me programet e tjera është i kufizuar ose për shkak të mungesës së sistemeve të TI-së në disa institucione ose mungesës së marrëveshjeve zyrtare për shkëmbimin e të dhënave në rastet kur ekzistojnë sisteme të tilla. Disa programe thelbësore për zbatimin e SNS-së, si regjistri i gjendjes civile, regjistri i automjeteve, regjistri i nxënësve dhe studentëve, etj., nuk kanë shkëmbim të dhënash me sistemin SNS.¹⁴⁵

Pra, ekzistojnë probleme me ndërveprueshmërinë ndërinsticionale, duke ndikuar në përpjekjet e qeverisë për të ulur barrën administrative. Krijimi i softuerit të përditësuar dhe nënshkrimi i marrëveshjeve që mbështesin ndërveprimin ndërmjet institucioneve mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike. Ndërkohë, softueri i ri do të duhet të sigurojë mbrojtje adekuate të të dhënave të përdoruesve, duke përfshirë shpjegime të qarta në lidhje me ndarjen e të dhënave ndërmjet institucioneve dhe çfarë përfshin kjo, në mënyrë që përdoruesit të mund të japin pëlqimin e informuar për ndarjen e informacionit të tyre personal ndërmjet institucioneve

Sistemi i Informacionit SNS nuk mbledh dhe përpunon të dhëna në mënyrë të tillë që të vlerësojë nevojat aktuale të grave dhe burrave. Kriteret aktuale të testit të varfërisë nuk sigurojnë që ndihma sociale synon familjet më të varfra. PMT nuk shqyrton nëse familjet kanë të ardhura të mjaftueshme për të përmbushur nevojat bazë bazuar në ndonjë prag minimal të përcaktuar; në vend të kësaj, ai “cakton në mënyrë të paqartë pikë për çdo burim të ardhurash, pavarësisht nga përbërja e familjes.”¹⁴⁶ Dy tregues PMT mund të kontribuojnë në përjashtim: pronësia e automjeteve¹⁴⁷ dhe pronësia e tokës ose dhënia me qira e më shumë se 0.5 hektarë tokë; zotërimi i këtyre aseteve nuk do të thotë se një familje nuk është e varfër. Edhe pse QPS-të përdorin një pyetësor të standardizuar për të vlerësuar karakteristikat e familjes si pjesë e PMT-së,

144 Po aty.

145 Po aty., dhe MPMS, Departamenti për Politikë Sociale dhe Familje, [Koncept-dokumenti për Skemën e Ndhmës Sociale](#), 2019.

146 Po aty.

147 Po aty. Përjashton automjetet që janë të parapara dhe përdoren për transportin e anëtarëve të familjes me aftësi të kufizuara të përhershme.

faktorët mund të ndikojnë në objektivitet.¹⁴⁸ Këto dhe shqetësime të tjera u ngritën nga udhëheqësit e njësisve të SNS dhe stafi i QPS-së.¹⁴⁹

PMT nuk përfshin tregues që ndërlidhen me gjininë për t'u marrë parasysh nevojën. Asnjë analizë gjinore nuk ka shqyrtuar se si kriteret e PMT mund të ndikojnë në kualifikueshmërinë e nënave beqare ose grave kryefamiljare. Për shembull, gratë kryefamiljare mund të kenë pronë, por nuk mund ta përdorin atë për të gjeneruar të ardhura, ndërsa shitja e kësaj toke për të ardhura mund t'i lërë të pastreha dhe të varfra. Mungesa e treguesve të PMT-së të përgjegjshëm gjinor kontribuon në të dhëna të pamjaftueshme në Sistemin e Informacionit SNS që mund të informojë vendimmarrjen më të përgjegjshme gjinore. Sistemet digjitale të përmirësuara mund të ndihmojnë në gjetjen e të dhënave për të informuar vendimet e politikave dhe për të arritur tek më shumë përfituesit, duke ofruar shërbime më të synuara për të përmbushur nevojat e grave dhe burrave. Për shembull, analiza e ndikimit gjinor mund të tregojë se kur gratë marrin ndihmën sociale, këto mjete kanë më shumë gjasa të mbështesin ushqimin dhe nevojat bazë, duke pasur parasysh rolet dhe përgjegjësitë e tyre të kujdesit brenda shtëpisë.¹⁵⁰ Nëse gratë nuk janë pranuese të drejtpërdrejta, ato mund të mos kenë qasje në fondet e SNS brenda familjes. Duke marrë parasysh që gratë janë kujdestaret kryesore të fëmijëve dhe të moshuarve, SNS mund të përdoret në mënyrë më efikase brenda familjes nëse gratë janë pranues të drejtpërdrejta. Megjithatë, nevojiten hulumtime të mëtejshme se si përdoret ndihma sociale në familjet e Kosovës.

Zyrtarët janë të vetëdijshëm për mangësitë e PMT-së dhe planifikojnë t'i zgjidhin këtë problem duke modifikuar kriteret e SNS-it gjatë reformave të ardhshme.¹⁵¹ DSS po punon ngushtë me disa donatorë (p.sh. GIZ, Banka Botërore) për të krijuar infrastrukturën e duhur për gjetjen, mirëmbajtjen dhe integrimin e të dhënave në bazën e të dhënave qendrore të informacionit për SNS. Kjo do të kërkonte që treguesit dhe algoritmet e përafërta të përfshijnë tregues të përgjegjshëm gjinor për të mundësuar analizën gjinore të nevojave, informimin e asistencës së disponueshme dhe për të arritur tek personat në nevojë.

Sa i përket shërbimeve sociale, me mbështetjen e UNDP-së, MFPT ka krijuar doracakë që specifikojnë se si duhet të përpunohen rastet nga punonjësit socialë, duke përfshirë formularët dhe shabllonet e digjitalizuara.¹⁵² Është krijuar menaxhimi i digjitalizuar i rasteve lidhur me udhëzimet administrative për vendosjen e fëmijëve dhe të rriturve nën kujdestari; vendosja dhe strehimi rezidencial i fëmijëve pa kujdes prindëror në një shtëpi komunitare; strehim

148 Po aty.

149 Grupi i Bankës Botërore, [Studimi mbi skemën e ndihmës sociale në Kosovë: Vlerësimi dhe opsionet për reformë](#), 2019.

150 RrGK, [Buxhetimi drejt mirëqenies sociale: Analizë gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë për 2016-2018](#), 2015, f. 32.

151 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS, MFPT, 2023.

152 Korrespondenca e UNDP-së me RrGK-në, gusht 2023.

familjar; dhe rregullimi i procedurave të birësimit për fëmijët pa përkujdesje prindërore. Punonjësve socialë u kërkohet të përdorin menaxhimin e rasteve digjitale për këto raste. UNDP mbështeti hartimin e udhëzimeve administrative që rregullojnë strehimin rezidencial për të rriturit me aftësi të kufizuara dhe shëndetin mendor; banim rezidencial për të rritur dhe të moshuar; dhe kontraktimi i shërbimeve sociale dhe familjare nga qeveria. Megjithatë, ishte e paqartë nëse këto udhëzime ishin miratuar dhe si rezultat nuk ishin zhvilluar ndërfaqet digjitale. Sistemet e brendshme të menaxhimit të të dhënave nuk duken ende të jenë në dispozicion për shërbime të tjera sociale.

Kryesisht për shkak të mungesës së infrastrukturës, qeveria nuk ka filluar të përdorë IA për të përpunuar aplikacionet për SNS, shërbimet sociale, banimin social ose pensionet.¹⁵³ Disa vende kanë filluar të përdorin IA për të vlerësuar nevojat për ndihmë dhe shërbime sociale.¹⁵⁴ Disa po përdorin sisteme të automatizuara të drejtuara nga të dhënat për të marrë vendime për shërbimet sociale dhe përfitimet shtetërore të mirëqenies bazuar në

modele parashikuese.¹⁵⁵ Digjitalizimi mund të lehtësojë arritjen tek më shumë gra dhe burra dhe të rrisë efikasitetin e shërbimeve sociale. Megjithatë, përdorimi i IA për të vlerësuar nevojat dhe për të organizuar shërbimet nuk vjen pa rreziqe.¹⁵⁶ Algoritmet e IA-së mësojnë nga të dhënat historike, të cilat mund të përfshijnë paragjykime nga vendimet njerëzore dhe paragjykimet sociale. Siç u përmend, Kosova nuk ka të dhëna të mjaftueshme të ndara sipas gjinisë në lidhje me mirëqenien sociale. Si rezultat i kësaj, algoritmet mund të përjetësojnë pa dashje paragjykimet gjinore dhe të tjera, duke çuar në rezultate të padrejta ose diskriminuese. Për shembull, paragjykimi i natyrshëm në PMT mund të ndikojë në vendimet e IA. Kriteret, treguesit dhe algoritmet e përdorura në çdo IA të ardhshme për shërbimet sociale duhet të bazohen në analizën e ndikimit gjinor *ex ante* për të siguruar që ato të marrin parasysh në mënyrë adekuate nevojat e grave dhe burrave.

Digjitalizimi mund të lehtësojë arritjen tek më shumë gra dhe burra dhe të rrisë efikasitetin e shërbimeve sociale.

Zyrtarët vunë re se angazhimi i zyrtarëve për shërbimet sociale do të ishte thelbësor në mes të çdo përdorimi të ardhshëm të IA-së për të shmangur

153 Intervista e RrGK-së, 2023. Financuar nga BE-ja dhe Qeveria, në vitin 2017 OJQ-ja Developing Together krijoi një softuer në të cilin mund të kenë qasje të gjitha komunat dhe të regjistrojnë përfituesit potencial dhe aktual të banimit social. Megjithatë, raportohet se pak e përdorin atë, kryesisht për shkak të stafit të pamjaftueshëm (KE, Rrjeti Evropian i Politikave Sociale, [National strategies to fight homelessness and housing exclusion](#), (Strategjitë kombëtare për të luftuar çështjen e të pastrehëve dhe përjashtimin e banimit 2019).

154 Shoqata Ndërkombëtare e Sigurimeve Shoqërore, “[Artificial Intelligence in Social Security: Background and Experiences](#)” (shqip: *Inteligjenca artificiale në sigurimet shoqërore: Historiku dhe përvojat*), 2020. Për shembull, po përdoret në vende si Kanadaja, Belgjika, Brazili dhe Estonia.

155 UN Women, Judy Wajcman, Erin Young dhe Anna FitzMaurice, “[The digital revolution: Implications for gender equality and women’s rights 25 years after Beijing](#)” (shqip: *Revolucioni digjital: Implikimet për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave 25 vjet pas Pekinit*), 2020.

156 Po aty dhe Shoqata Ndërkombëtare e Sigurimeve Shoqërore, “[Artificial Intelligence in Social Security: Background and Experiences](#)” (shqip: *Inteligjenca artificiale në sigurimet shoqërore: Historiku dhe përvojat*), 2020.

paragjykimet e mundshme gjinore që mund të dalin nga algoritmet. Një zyrtar i DSS komentoi:

Digjitalizimi duhet të kontribuojë në uljen e barrës administrative për qytetarët. Ai duhet t'u ofrojë atyre mundësinë për të gjetur online aplikacionet e tyre për shërbimet sociale. Megjithatë, digjitalizimi gjithashtu duhet të marrë në konsideratë një qasje holistike ndaj qytetarëve [...] Prekja dhe perspektiva njerëzore janë thelbësore për një proces të drejtë.¹⁵⁷

Si pasojë e mungesë së të dhënave të ndara me bazë gjinore, parashihet që përdorimi i teknologjisë në përcaktimin e përfituesve të asistencës sociale mund të jetë i ndikuar dhe të diskriminojë gratë. Prandaj, zyrtarë të MFPT kanë theksuar se duhet të krijohet një balancë midis vlerësimeve të automatizuara dhe ruajtjes së vlerësimit njerëzor në këtë proces. Disa kritere të PMT-së do të vazhdojnë të kërkojnë verifikim manual nga zyrtarët e shërbimeve sociale. Ndërkohë, ekzistojnë mundësi për të lidhur verifikimet fizike me sistemet digjitale, të tilla si përdorimi i telefonave të mençur ose tabletëve për të futur të dhëna menjëherë gjatë vizitave të menaxhimit të rasteve.

Baza e të dhënave për rastet e dhunës me bazë gjinore e menaxhuar nga Ministria e Drejtësisë është relevante për shërbimet sociale.¹⁵⁸ QPS-të marrin pjesë në mekanizmat koordinues komunal, të cilët mund të përfitojnë nga posedimi i softuerit digjital të ndërveprueshëm përmes të cilit mund të koordinojnë menaxhimin e rasteve nëpër institucione, komuna dhe rastet e recidivistëve të paraqitura në lokacione të ndryshme. Kërkohen përmirësime të mëtejshme të sistemit për të lehtësuar menaxhimin e rasteve në përputhje me kornizën ligjore. Siç u diskutua në kapitullin e mëparshëm, shërbimet e tele-këshillimit digjital gjithashtu mund të mbështesin punën e punonjësve socialë për të arritur tek grupet e cenushme dhe të izoluar për të ofruar mbështetje më të rregullt dhe me kosto të leverdishme, nëse krijohen me mbrojtjet e duhura.¹⁵⁹

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Përgjithshëm për Shërbimet Sociale dhe Familjare, si organ i pavarur, ka dy komisione për licencimin e profesionistëve në nivelet bazë, të mesëm dhe të lartë.¹⁶⁰ Ekzistojnë dy regjistra që dokumentojnë licencat e miratuara për profesionistë individualë, OJQ dhe subjekte private. Thuhet se aplikacionet mund të dorëzohen online ose

157 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

158 Për më shumë informata lidhur me këtë bazë të dhënash, shih Kapitullin 2.

159 Për shembull, shih protokollin e tele-këshillimit RrGK-së, të zhvilluar në bazë të praktikave më të mira ndërkombëtare.

160 Korrespondenca e RrGK-së me Ministrinë e Drejtësisë, nëntor 2023.

fizikisht, por RrGK nuk ka mundur të gjejë ndonjë aplikacion të tillë online. Sipas Ministrisë, ekzistojnë dallime në numrin e aplikacioneve të dorëzuara dhe licencave të dhëna për gra dhe burra.¹⁶¹

Njerëzit

Në këtë seksion shqyrtohet se deri në çfarë mase shërbimet sociale digjitale janë të qasshme për gra dhe burra. Ky seksion analizon nëse ata kanë njohuri të mjaftueshme dhe aftësi të zotësisë digjitale për të përdorur shërbimet sociale digjitale, nëse këto shërbime i mbrojnë në mënyrë adekuate ato dhe mirëqenien e tyre digjitale dhe se si rolet, normat dhe marrëdhëniet e pushtetit të socializuara gjinore mund të jenë barriera për qasjen dhe përdorimin e shërbimeve sociale të digjitalizuara.

Qasja

Në nivel global, organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimat e abuzimit në internet.¹⁶² Dy shërbimet e vetme sociale në eKosova janë në gjuhë të ndryshme por të pa qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Meqenëse në Kosovë janë të disponueshme pak shërbime digjitale, njerëzit në përgjithësi nuk mund të kenë qasje në shërbime të tilla. Prandaj, është e vështirë të vlerësohet qasja e grave dhe burrave. As nuk është e mundur të vlerësohet se si gratë dhe burrat që flasin gjuhë të ndryshme dhe kanë nivele të ndryshme arsimore, prejardhje ekonomike dhe aftësi mund të kenë qasje në shërbimet online. Duke pasur parasysh normat gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit, qasja e grave në shërbimet publike digjitale mund të pengohet.¹⁶³

Pjesëmarrja, pronësia dhe përdorimi

Sipas ASK-së, në korrik të vitit 2023, 20,937 familje me 82,621 anëtarë kanë pranuar SNS-në, që paraqet një rënie prej 16.5% të numrit të familjeve përfituese krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.¹⁶⁴ Raportet nuk ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë për anëtarët e familjes dhe disa raporte nuk publikohen. Personat në këto raporte janë përdoruesit e mundshëm të shërbimeve potenciale të digjitalizuara të SNS në të ardhmen. Në Kosovë burrat priren të “përfaqësojnë” familjen gjatë parashtrimit të kërkesës për ndihmë sociale si kryefamiljarë.¹⁶⁵ Sa për të ilustruar trendin afatgjatë,¹⁶⁶ në janar të vitit 2021, nga 25,678 familje që përfitonin ndihmë sociale, 16,947 (66%) ishin të regjistruara me emra burrash, ndërsa 8,821 (34%) ishin

161 Po aty.

162 Për shembull, shih Qendra e Ekspertizës për Abuzimin Seksual të Fëmijëve, “[Managing risk and trauma after online sexual offending](#)” [Menaxhimi i rrezikut dhe traumave pas ngacmimeve seksuale online], 2023. Ky udhëzues ka për qëllim të ndihmojë profesionistët të mbështesin familjet.

163 Shih Kapitullin 1.

164 ASK, [Statistikat e mirëqenies sociale](#), korrik 2023.

165 RrGK, “[Pandemia nuk njeh gjini?](#)”, 2020, f. 49.

166 RrGK, [Buxhetimi drejt mirëqenies sociale: Analizë e përsheptuar gjinore për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë](#), 2014.

2021

nga 25,678 familje që përfitonin ndihmë sociale, 56% ishin të regjistruara me emra burrash, ndërsa 34% ishin regjistruar në emra grash.

regjistruar në emra grash.¹⁶⁷ Nëse digjitalizohen aplikacionet për SNS, por kriteret mbeten të njëjta, të dhënat sugjerojnë se më shumë burra se gra do të përdorin profile digjitale për të aplikuar për ndihmë. Megjithatë burrat priren të marrin ndihmën sociale në emër të familjeve të tyre, pak më shumë gra varen nga ky financim. Nga 103,303 anëtarë të familjes që përfitonin, 49% ishin burra ndërsa 51% ishin gra.¹⁶⁸ Nuk ka informacion të mjaftueshëm se si ndihma sociale shpërndahet në praktikë brenda familjeve dhe nëse nga ajo përfitojnë të gjithë anëtarët e familjes në mënyrë të barabartë. Asnjë studim

qeveritar nuk e ka vlerësuar këtë.¹⁶⁹ Duke pasur parasysh rolet ekzistuese gjinore dhe marrëdhëniet e pushtetit brenda familjeve kosovare, përfshirë prirjet e burrave për të marrë vendime lidhur me burimet familjare, nuk mund të supozohet se gratë dhe burrat përfitojnë në mënyrë të barabartë nga ndihma sociale shtetërore.¹⁷⁰ Një analizë gjinore e mënyrës se si familjet përdorin SNS-në dhe se si gratë dhe burrat përfitojnë nga ajo, mund të informojë hartimin e serishëm e PMT-së, treguesve të tij, softuerit dhe vendimmarrjen e informuar nga IA për përfituesit.

Një shqetësim në prezantimin e shërbimeve publike digjitale SNS është nëse personat e varfër zotërojnë ose kanë qasje në pajisjet që mund t'i përdorin për shërbime. Fakti që shumica e njerëzve në Kosovë kanë telefona inteligjentë personalë (98% e grave dhe burrave) sugjeron një qasje mjaft të gjerë.¹⁷¹

Megjithatë, grupet e cënueshme ka gjasa të mbipërfaqësohen në mesin e atyre që nuk kanë pronësi dhe qasje, veçanërisht gratë, të cilat priren të kenë më pak burime financiare sesa burrat. Pa pajisje, ato mund të mos jenë në gjendje të qasen në shërbimet e ardhshme elektronike.

Në vitin 2022 pak njerëz përdorin internetin për t'u qasur në shërbimet publike. ASK ka gjetur se nga ata që kanë përdorur internetin në 12 muajt e fundit, 72% nuk e kanë përdorur atë për shërbime publike, dhe vetëm 11% e kanë përdorur atë për të pasur qasje në informacione rreth shërbimeve publike si pensionet.¹⁷² Edhe pse të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin të disponueshme, kjo sugjeron që pak gra ose burra përdorin internetin për shërbime sociale publike.

Vetëm 7% e grave dhe burrave të anketuar në sondazhin e UNDP-së kishin përdorur eKosova për të aplikuar për një shtesë për fëmijë në kuadër të

167 MPMS, Departamenti për Politika Sociale dhe Familje, *Raport statistikor: Numri i përfituesve të Skemës së Ndhmës Sociale sipas komunës, moshës, gjinisë dhe përkatësisë etnike*, janar 2021.

168 Po aty.

169 Intervista e RrGK-së me përfaqësuesit e DSS-së, 2023.

170 RrGK, "Pandemia nuk njeh gjini ?", 2020, f. 49.

171 UNDP, *Digital Household Survey*, 2022.

172 ASK, *Rezultatet e Anketës për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në vitin 2022*, 2022, f. 14.

masave të Qeverisë për ringjalljen nga COVID-19.¹⁷³ Ndërkohë 3% e grave të anketuara kishin aplikuar për shtesa të lehonisë përmes eKosova.¹⁷⁴ Gjetjet nuk kontrollonin nëse të anketuarit/at ishin prindër apo do të kualifikoheshin për këtë përfitim. Kur u pyetën se cilat shërbime do të donin t'i ofronte eKosova, 17% e të anketuarve (15% e grave dhe 19% e burrave) u përgjigjen se do të dëshironin shërbime të përmirësuara për çështjet sociale.¹⁷⁵ Më tej, 12% e grave dhe burrave thanë se shërbimet për çështje sociale janë më të dobishmet dhe duhet të ofrohen online. Kjo sugjeron në përgjithësi përdorim ose prirje të ulët për të përdorur shërbimet publike digjitale si nga gratë ashtu edhe nga burrat.

Zotësi digjitale – Aftësitë dhe Ndërgjegjësimi

Qeveria mund të përdorë mjete digjitale për të informuar njerëzit rreth shërbimeve sociale. Me gjasë për shkak të mungesës së shërbimeve të tilla, RrGK gjeti dëshmi minimale të fushatave ndërgjegjësuese që synonin gra dhe burra të ndryshëm. MFPT publikoi dy video për dy shërbimet që ofron përmes platformës eKosova: shtesat për lehonat dhe fëmijët. Videot shpjegojnë vetëm aspektet teknike të aplikimit për shtesa. E-Kosova ka video të ngjashme me udhëzime teknike për të gjitha shërbimet. Fakti që njerëzve u mungonte njohuria rreth këtyre masave të COVID-19 sugjeron rëndësinë e informimit të synuar për të rritur ndërgjegjësimin për shërbimet e ardhshme. Duke qenë se gra dhe burra të ndryshëm mund të përdorin mjete të ndryshme komunikimi, informimi do të duhet t'u përgjigjet nevojave të tyre të informacionit dhe platformave të përdorura, duke përfshirë mbërritjen tek personat me aftësi të kufizuara dhe ata që flasin gjuhë të ndryshme. Fushatat informuese mund të adresojnë çështjet e privatësisë dhe pëlqimit të informuar lidhur me ndarjen e të dhënave nëpër institucionet. Personat që përdorin ndihmë sociale dhe shërbime sociale mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë në përdorimin e shërbimeve digjitale kur ato bëhen të disponueshme. RrGK nuk mundi të gjejë ndonjë hulumtim mbi zotësinë digjitale në mesin e grupeve të cënueshme që kanë nevojë për ndihmë; dhe shërbime sociale, megjithëse të dhënat mbi aftësitë digjitale në mesin e popullsisë së përgjithshme sugjerojnë se aftësitë e dobëta digjitale mund të pengojë qasjen e tyre në shërbimet e digjitalizuara.

Mirëqenia dhe Mbrojtja Digjitale

Duke pasur parasysh mungesën e shërbimeve sociale digjitale, ky hulumtim nuk mund të vlerësojë besimin e përdoruesve në këto platforma, etikën e shërbimeve online, privatësinë ose mbrojtjen e të dhënave, megjithëse këto do të meritojnë të merren në konsideratë gjatë dizajnit të softuerit të ri. Siç vë në dukje Instituti AI Now, "Njerëzit+ më të rrezikuar nga dëmtimi nga sistemet e IA-së janë shpesh ata që janë më pak të aftë të kundërshtojnë rezultatet".¹⁷⁶ Përfituesit e ndihmës sociale, përfituesit e shërbimeve sociale, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe personat që kanë përjetuar dhunë me bazë

173 UNDP, [Digital Household Survey](#), 2022.

174 Po aty.

175 UNDP, [Digital Household Survey](#), 2022.

176 Instituti "AI Now", "[Raporti i AI Now](#)", 2018, f. 6.

gjinore janë padyshim ndër kategoritë më të cenueshme, prandaj mbështeten në këtë ndihmë. Pra, nevojitet mbështetje shtesë për t'u siguruar që ata janë të informuar për të drejtat e tyre dhe për të mbrojtur shkeljet e mundshme të të drejtave të tyre. Instituti AI Now bën thirrje për mbështetjen e ndihmës juridike përmes avokatëve publikë, të cilët mund të përfaqësojnë ata që janë të shkëputur nga shërbimet sociale për shkak të vendimmarrjes algoritmike.

Konkluzione

Për sa i përket **aspektit rregullativ**, ligjeve dhe politikave që lidhen me digitalizimin e shërbimeve dhe ndihmës sociale, ato janë më të përgjegjshme ndaj aspektit gjinor, por mund të përmirësohen me qasje më të reja. Proceset e hartimit të politikave ofrojnë mundësi për të qartësuar angazhimet e qeverisë rreth sistemeve digjitale të përgjegjshme gjinore për shërbime dhe ndihmë; sociale, duke përfshirë zbatimin e tyre, ndërveprueshmërinë ndërinstytucionale (p.sh., ndërmjet komunave, ministrive dhe ASK-së), monitorimin dhe vlerësimin.

Qeveria ka pësuar disa ndryshime që kanë prekur përgjegjësitë për shërbimet sociale. Këto ndryshime kanë ngadalësuar reformat digjitale që mund të ofrojnë shërbime sociale më cilësore, në kohë dhe të përgjegjshme në aspektin gjinor. Sistemet e dobëta të menaxhimit të të dhënave të qeverisë pengojnë ofrimin në kohë të shërbimeve, statistikave sociale të ndara sipas gjinisë dhe planifikimin dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Aftësitë e zyrtarëve për përdorimin e zgjidhjeve digjitale të përgjegjshme gjinore për ofrimin e shërbimeve duken të dobëta pasi atyre u mungojnë sistemet dhe mjetet digjitale. Shumë pak shërbime publike janë digjitalizuar. Buxheti i përgjegjshëm gjinor dhe e-prokurimi nuk janë institucionalizuar. Menaxhimi i dobët i të dhënave pengon buxhetimin e përgjegjshëm gjinor që mund të informojë kërkesat më të sakta të buxhetit vjetor.

Kosova nuk ka **infrastrukturë**, harduerike dhe softuerike për mbështetjen e ndihmës sociale dhe ofrimin e shërbimeve sociale. Mungesa e treguesve të PMT të përgjegjshme gjinore dhe e variablave të shërbimeve sociale kontribuon në të dhëna të pamjaftueshme për informimin e vendimmarrjes më të përgjegjshme gjinore. Edhe pse janë planifikuar zhvillime në infrastrukturë, pak nga ato kanë filluar. Këta do të duhet të marrin në konsideratë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, bazuar në analizën gjinore.

Meqenëse pak shërbime sociale janë në dispozicion në mënyrë digjitale, **njerëzit** kanë qasje minimale në to, pra përdorimi i shërbimeve digjitale nga gratë dhe burrat nuk mund të vlerësohet. Informimi i përshtatur për gratë dhe burrat do të duhet të sigurojë njohuri adekuate për shërbimet e disponueshme, të drejtat e tyre për mbrojtjen e të dhënave dhe aftësitë e tyre digjitale për të aplikuar për shërbime sociale.

Digjitalizimi i arsimit

Meqë nxënësit kanë gjithnjë e më shumë njohuri dhe zotësi në fushën e teknologjisë informative, kërkesat për përditësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe proceseve të të nxënësve janë rritur me qëllim për të pasur vëmendjen e nxënësve dhe mbajtur të interesuar ata.¹ Teknologjia mund të lehtësojë qasjen në regjistrim, materialet e kurseve dhe sistemet e notimit si dhe në aspektet e tjera të arsimit. Ndërkohë, pandemia COVID-19 vuri në pah se qasja e barabartë në internet dhe zotësia digjitale janë thelbësore për djemtë dhe vajzat që të vazhdojnë shkollimin e tyre.² OBZHE ka shprehur shqetësimin në lidhje me mungesën e “qasjes universale në infrastrukturë (harduer dhe softuer) dhe mungesën e përgatitjes adekuatë të mësuesve dhe nxënësve sa i përket kërkesave unike që paraqesin mësimdhënien dhe të nxënësve online.”³

Në këtë seksion shqyrtohet njohja dhe marrja parasysh e aspektit gjinor në përpjekjet e Kosovës për të digjitalizuar arsimin. Në seksionet shqyrtohen Rregullimi, Qeverisja, Infrastruktura dhe Njerëzit. Ky seksion diskuton AAP-në që e ofron MASHTI, ndërkaq programi për aftësimin profesional drejt punësimit, të cilin e ofron kryesisht MFPT dhe Ministria e Ekonomisë, diskutohet në kapitullin vijues.

1 OBZHE, *Innovating Education and Educating for Innovation: The Power of Digital Technologies and Skills*, (Edukimi inovativ dhe edukimi për inovacion: Fuqia e teknologjive dhe aftësi digjitale) 2016.

2 OBZHE, *Strengthening online learning when schools are closed: The role of families and teachers in supporting students during the COVID-19 crisis*, (Fuqizimi i mësimin online kur shkollat janë të mbyllura: Roli i familjeve dhe mësimdhënësve në mbështetjen e nxënësve gjatë krizës COVID-19), 2020.

3 Po aty, f. 3.

Korniza Ligjore: Analiza gjinore e politikave publike mbi digjitalizimin e arsimit

Në këtë seksion analizohet njohja dhe marrja parasysh e aspektit gjinor tek ligjet dhe politikat sa i përket digjitalizimit në sektorin e arsimit.

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve

Ky ligj i vitit 2019 u jep shkollave përgjegjësinë e mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë sigurimin e “internetit të sigurt në hapësirat publike”.⁴ Ai nuk u përgjigjet në mënyrë eksplicite mënyrave të ndryshme se si vajzat dhe djemtë mund të jenë në rrezik, gjë që do t’u mundësonte institucioneve arsimore si MASHTI-it, Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA), mësuesve dhe prindërve të adresojnë rastet. Institucionet duhet të zbatojnë programe arsimore në drejtim të mbrojtjes dhe kujdesit për fëmijët, duke përfshirë rishikimin e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera me perspektivë tek mbrojtja e fëmijëve; eliminimi i stereotipave gjinorë, paragjyqimeve dhe praktikave të tjera; dhe zhvillimi i udhëzimeve për mbrojtjen e fëmijëve nga informacioni i dëmshëm.⁵ Ligji është i **përgjegjshëm gjinor** në lidhje me arsimin sepse synon të adresojë stereotipat gjinorë dhe ka potencialin të jetë transformues në aspektin gjinor varësisht nga mënyra e zbatimit të tij.

Nuk duket se ekziston asnjë akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji në institucionet arsimore. Legjislacioni që përcakton detyrimet e institucioneve arsimore për të adresuar dhunën kibernetike, ngacmimin online, përpunimin e të dhënave personale dhe mirëqenien digjitale të vajzave dhe djemve mund të marrë parasysh dallimet gjinore. Ky i fundit mund të adresojë marrëdhëniet e pushtetit dhe kushtet sociale që mundësojnë dhunën e shkaktuar nga burrat,⁶ duke i mbështetur kështu nxënësit për të sfiduar rolet dhe stereotipat gjinorë me qëllim të krijimit të një mjedisi më të sigurt në internet për vajzat dhe djemtë.

Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

LMDhP rregullon mbrojtjen e privatësisë së fëmijëve në internet, duke vendosur parime dhe rregulla themelore për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale, përfshirë të dhënat që lidhen me fëmijët.⁷ Me këtë ligj u jepet fëmijëve e drejta e privatësisë, duke përfshirë edhe ajo online. Ai kërkon që me çdo përpunim të të dhënave personale të fëmijëve duhet të mbrohet privatësia e tyre dhe të sigurohet që të dhënat e tyre personale të mos përdoren në mënyrën që do të mund t’i dëmtonte ata.⁸ Nëse fëmija është nën moshën 16 vjeç, prindi ose kujdestari ligjor i fëmijës duhet të japë pëlqimin para se të

4 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 06/L-084 për mbrojtjen e fëmijës](#), 2019. Për më shumë informata rreth ligjit, shih kapitullin 1.

5 Po aty., neni 63, paragrafi 2.

6 RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, f. 1. Termi i adaptuar nga anglishtja “male violence”.

7 Për më shumë informata rreth këtij ligji, shih kapitullin 1.

8 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale](#), 2019, neni 41.

dhënat personale të fëmijës të mund të përpunohen në lidhje me shërbimet e shoqërisë së informacionit.⁹ Ligji thekson se kontrolluesi i të dhënave duhet të përpiqet të verifikojë nëse prindi ose kujdestari ka dhënë pëlqimin. Ligji nuk parasheh se si vajzat dhe djemtë mund të ndikohen ndryshe nga kërcënimet e të dhënave, pra ligji është **neutral** në aspektin **gjinor**.

Ligji për Arsimin Para-universitar

Ky ligj i vitit 2011 rregullon të drejtat e fëmijëve për arsim.¹⁰ Ai përcakton parimet themelore, rregullat për organizimin, menaxhimin dhe financimin e arsimit parauniversitar, duke përfshirë të drejtat dhe detyrimet e nxënësve, prindërve dhe institucioneve arsimore. Me këtë ligj mbrohet e drejta e çdo fëmije për arsim fillor falas, të detyrueshëm që zgjat nëntë vjet dhe garanton qasje në arsimin e mesëm për të gjithë fëmijët që përfundojnë arsimin fillor. Ligji mbron të drejtat e fëmijëve për mosdiskriminim, për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për të mësuarit, pjesëmarrjen në vendimmarrje në lidhje me arsimimin e tyre dhe qasjen në shërbimet mbështetëse të tillë si arsimi special dhe këshillimi. Në Ligj thuhet se Ministria, komunat dhe institucionet arsimore duhet të ndjekin normat arsimore ndërkombëtarisht të pranuar, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e grupeve të cënueshme dhe promovimin e barazisë gjinore.¹¹ Ky ligj është i **ndjeshëm gjinor**. Megjithatë, ai nuk i kushton vëmendje digjitalizimit.

Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore

Ky ligj i vitit 2013 rregullon transferimin e njohurive dhe teknologjisë, si dhe ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së kërkimit shkencor që mbështet progresin ekonomik, teknologjik, kulturor dhe atë social, duke përfshirë inovacionin.¹² Me këtë ligj kërkohen mjete adekuate për realizimin e këtyre synimeve.¹³ “Trajtimi i barabartë i meshkujve dhe femrave” është ndër parimet e tij.¹⁴ Edhe pse ligji është përgjithësisht i **ndjeshëm** në aspektin **gjinor**, duke qenë se e ka përmendur këtë trajtim të barabartë, ai është **neutral** në aspektin **gjinor** sa i përket digjitalizimit në mënyrë specifike.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional

Ky ligj i vitit 2013 rregullon sistemin kombëtar të AAP-së në përputhje me nevojat e zhvillimit social, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe ato teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve.¹⁵ Ministria përgjegjëse për punën duhet të analizojë nevojat e tregut të punës dhe të

9 Po aty., neni 7, paragrafi 1.

10 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës](#), 2011.

11 Po aty., neni 3.

12 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore](#), 2013, neni 2.

13 Po aty., neni 5.

14 Po aty., neni 4.

15 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional](#), 2013, neni 1.

mbështesë MASHT-in në hartimin e AAP-së për të përmbushur nevojat.¹⁶ Me këtë ligj nuk kërkohet në mënyrë eksplicite analiza gjinore ose përshtatja e programeve të AAP-së për nevojat e grave dhe burrave. Neni 13 rregullon themelimin dhe funksionimin e Agjencisë për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimin e të Rriturve (AAAPARR). Ligji nuk është përditësuar që të korrespondojë me dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore, që kërkojnë baraspeshë gjinore në këtë Agjenci. Ky ligj është **neutral gjinor**.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës

Ky ligj i vitit 2013 vendosi përgjegjësitë e MASHT-it, ministrive, komunave, institucioneve dhe palëve të tjera të interesuara në planifikimin e arsimit dhe trajnimit për të rritur.¹⁷ Sistemi i arsimit për të rritur përfshin arsimin dhe trajnimin formal dhe joformal.¹⁸ Kandidatët e interesuar duhet të regjistrohen në programet e arsimit dhe trajnimit për të rritur përmes konkursit publik bazuar në kriteret e specifikuar.¹⁹ Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t'u regjistruar. Masat afirmative nuk janë paraparë edhe pse lejohen me Ligjin për Barazi Gjinore. Ligji nuk merr parasysh aspektin gjinor apo digjitalizimin dhe është **neutral gjinor**.

Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Ky ligj i vitit 2023 përcakton përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare për Akreditim (AKA) si agjenci rregullatore që mbikëqyr akreditimin, riakreditimin, vlefshmërinë dhe monitorimin me qëllim të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.²⁰ Në të thuhet se "AKA mund të administrojë aspekte të procesit të akreditimit edhe në formë elektronike (online)."²¹ AKA përbëhet nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Administrata, dhe Komisioni i Ankesave. Ligji është i **përgjegjshëm gjinor**, duke theksuar se "përbërja e Këshillit siguron përfaqësimin gjinor"²² dhe se lista e shkurtër e kandidatëve e Komisionit duhet të respektojë "përbërjen gjinore".²³ Në praktikë, Kryetari i Këshillit është grua, por vetëm një nga pesë anëtarët e Këshillit është grua.

Rregullore për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar

Rregullorja e vitit 2013 përkufizon shumicën e formave të dhunës, duke përfshirë dhunën seksuale, abuzimin seksual, dhunën fizike/emocionale,

16 Po aty., neni 11.

17 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional për të Rritur në Republikën e Kosovës](#), 2013.

18 Po aty., neni 6.

19 Po aty., neni 12.

20 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim](#), 2023, nenet 1 dhe 6.

21 Po aty., neni 30.

22 Po aty., neni 9.

23 Po aty., neni 15.

dhunën digjitale dhe abuzimin seksual për qëllime komerciale.²⁴ Ai parasheh krijimin e një regjistri konfidencial për evidentimin e rasteve të dhunës në institucionet arsimore parauniversitare.²⁵ Ligji e bën përgjegjës Drejtorin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare për marrjen, arkivimin dhe analizimin e këtyre të dhënave. Në këtë rregullore nuk bëhen dallime në lidhje me gjininë në parandalimin ose referimin e rasteve të dhunës në shkollë, siç janë dobësitë potencialisht të ndryshme të vajzave dhe djemve ndaj dhunës ose parashikimi i mekanizmave alternativë të raportimit në rast se vajzat nuk ndjehen të sigurta për të raportuar dhunën tek drejtorët e shkollave që priren të jenë burra. Pra, ky Protokoll është **neutral gjinor**. RrGK nuk ka mundur të gjejë asnjë raport për shkallën në të cilën shkollat e kanë ndjekur këtë Protokoll, ndonjë të dhënë për rastet e raportuara, apo nëse drejtorët mbanin të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Kjo Rregullore e vitit 2013 vendosi përgjegjësitë e Departamentit të Shkencës dhe Teknologjisë në Ministri, duke rregulluar punën e Divizionit të Teknologjisë dhe Divizionit për Inovacion dhe Transfer të Teknologjisë.²⁶ Ajo nuk i referohet masave gjinore apo atyre afirmative në organizimin e brendshëm të Ministrisë apo baraspeshës gjinore mes punonjësve në të gjitha nivelet e as nuk inkurajon përfshirjen e parimeve të barazisë gjinore në punën e tij në drejtim të adresimit të nevojave të vajzave dhe djemve në lidhje me inovacionin dhe teknologjinë. Prandaj, Rregullorja është **neutrale gjinore**.

Udhëzim Administrativ për Krijimin e Strukturës Stimuluese për Mbështetjen e Shkollimit të Nxënësve në Drejtimet Deficitare dhe për Vajzat/Gratë në Drejtimet Teknike në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional

Ky Udhëzim Administrativ i vitit 2020 ka për qëllim të inkurajojë nxënësit të regjistrohesh në Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) në fushat ku janë regjistruar pak studentë, veçanërisht duke inkurajuar gratë që të regjistrohesh në fushat teknologjike.²⁷ Të gjitha të rejtat që përfundojnë arsimin e mesëm të ulët, plotësojnë kriteret e Udhëzimit dhe marrin vlerësimin maksimal nga komisioni që përzgjedh bursistët do të përfitojnë bursën trevjeçare në fushën teknologjike.²⁸ Për vitin shkollor 2021-2022,

24 Republika e Kosovës, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, Rregullore QRK nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar, 2013.

25 Po aty, Neni 25.

26 Republika e Kosovës, Qeveria, Rregullore (QRK) nr. 39/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 2013.

27 MASHTI, Udhëzimi administrativ nr. 136/20 për krijimin e strukturës stimuluese për mbështetjen e shkollimit të nxënësve në drejtimet deficitare dhe për vajzat/gratë në drejtimet teknike në institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP), 2020.

28 Po aty, neni 2.

2023-2024

MASHTI shpërndau 70 bursa për vajza lidhur me këtë udhëzim, 40 për drejtime deficitare dhe 30 për drejtime teknike.

MASHTI ofroi 20 bursa me vlerë 500 € në vit për vajzat që ndjekin shkollën profesionale në teknologji ushqimore dhe agrobiznes dhe 40 bursa për vajzat që regjistrohen në degët teknike në shkollat profesionale (p.sh. instalime për ngrohje, ajër të kondicionuar dhe furnizim me ujë; instalime elektrike; mekatronikë;²⁹ ose automekanikë).³⁰; ose automekanikë). Për vitin shkollor 2023-2024, MASHTI shpërndau 70 bursa për vajza lidhur me këtë udhëzim, 40 për drejtime deficitare dhe 30 për drejtime teknike.³¹ Ky Udhëzim Administrativ dhe vendimet shoqëruese të qeverisë janë **transformuese gjinore**; ata mbështesin gratë e reja në qasjen në arsim që mund t'u mundësojë atyre të përfshihen në profesione ku gratë historikisht kanë qenë të nënpërfaqësuar. Masa të ngjashme afirmative transformuese gjinore mund t'i kishin mbështetur djemtë që të bëhen mësues të arsimit parashkollor dhe fillor, duke përfshirë mbrojtjen e fëmijëve në lidhje me digjitalizimin.

Udhëzim Administrativ për Mbrojtjen e Fëmijëve/ Nxënësve në internet, në Institucionet e Arsimit Parauniversitar

Ky Udhëzim Administrativ i vitit 2019 ka për qëllim të mbrojë fëmijët dhe nxënësit nga kërcënimet online në institucionet e arsimit parauniversitar, duke ofruar udhëzime për “si të vendosen politika dhe procedura për sigurinë online dhe të promovohet një sjellje e sigurt dhe e përgjegjshme online”; përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e MASHT-it, DKA-ve, mësime ndihmëse, prindërve dhe nxënësve; specifikuar aktivitetet të ndaluara në internet si “bullizmi kibernetik, ngacmimi dhe qasja në përmbajtje të papërshtatshme”; vendosur masa për shkelje si masat disiplinore dhe sanksionet ligjore; dhe duke inkurajuar ndërgjegjësimin për rreziqet e përdorimit të internetit dhe mediave sociale dhe si t'i zbuten ato.³² Ky Udhëzim nuk përfshin fare perspektivën gjinore, megjithëse mund të kishte përcaktuar sesi abuzimi mund të ndikojë në nxënës dhe nxënësit në mënyra të ndryshme e që lidhet me dhunën seksuale online.³³ Në këtë udhëzim as nuk është e cekur qartë se cilat sanksione ekzistojnë, përfshirë edhe ato për mësuesit, DKA-të dhe personelin tjetër në institucionet arsimore nëse ata nuk raportojnë dhunë seksuale online tek institucionet përgjegjëse ose nëse ata kryejnë akte të tilla. Pra, ky udhëzim është **neutral** në aspektin **gjinor**,

29 Mekatronika është një fushë multidisiplinare që përfshin ndërthurjen e mekanikës, elektronikës dhe informatikës (Michigan Technological University, “What is Mechatronics?” (Çfarë është mekatronika?), 2024, qasur më 8 janar 2024).

30 MASHTI, [Vendim për ndarjen e bursave për nxënës në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtimet teknike](#), 2 qershor 2021.

31 MASHTI, [Vendim për ndarjen e bursave për nxënës në drejtimet deficitare dhe bursa për vajza në drejtimet teknike](#), 26 maj 2023.

32 Republika e Kosovës, Qeveria, [Udhëzimi administrativ nr. 01/2019 për mbrojtjen e fëmijëve/ nxënësve në internet në Institucionet e Arsimit Parauniversitar](#), 2019.

33 Shih kapitullin 2.

Udhëzim Administrativ për Ndalimin e Telefonave Celularë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar

Udhëzimi Administrativ i vitit 2018 ndalon telefonat celularë në mjediset shkollore nga mësuesit dhe nxënësit.³⁴ Drejtoria e shkollës mund të sekuestrojë telefonat celularë e përdorur nga nxënësit, të informojë prindërit ose të përfshijë policinë nëse ky veprim përsëritet.³⁵ MASHT-i, DKA-të dhe drejtoritë e shkollave janë përgjegjëse për rishikimin e rregulloreve të brendshme të shkollave dhe vendosjen e masave për ndalimin e telefonave celularë.³⁶ Nuk ekziston asnjë informacion në lidhje me zbatimin. MASHTI nuk mbledh informacion nga DKA-të në lidhje me konfiskimin e telefonave celularë,³⁷ kështu që statistikën përmbledhëse të ndara sipas gjinisë nuk janë në dispozicion. Udhëzimi nuk përcakton procedura për raportimin e keqpërdorimit të telefonit celular, për gjetjen/përcjelljen e të dhënave të ndara sipas gjinisë për keqpërdorimet e raportuara, ose për përdorimin e raporteve të tilla për të marrë masa të mëtejshme. Ky udhëzim është **neutral gjinor**.

Protokolli për Parandalimin dhe Referimin Dhunës në Institucionet e Arsimit Para-universitar

Protokolli i vitit 2013 kërkon që drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar të regjistrojnë rastet e raportuara të dhunës në shkollë dhe t'i përcjellin ato në DKA.³⁸ Më pas, DKA-ja duhet t'i dorëzojë MASHT-it një raport përmbledhës, përgjegjës për analizimin dhe publikimin e të dhënave. Në Protokoll dhuna digjitale përkufizohet si "çfarëdo forme e dërgimit të mesazheve përmes internetit apo telefonisë mobile. Ka për qëllim lëndimin, shqetësimin apo çfarëdo lloj tjetër të dëmtimit të fëmijës i cili nuk mund të mbrohet nga veprimet e tilla. Shfaqet në formë të video apo mesazheve tekstuale, fotografive apo thirrjeve.³⁹ Drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar duhet të raportojnë të dhënat statistikore për rastet e dhunës në mënyrë elektronike nëse kanë qasje në internet ose, nëse jo, në kopje fizike.⁴⁰ Protokolli nuk e përmend bullizmin. Në të nuk bëhen dallime në lidhje me gjininë në parandalimin ose referimin e rasteve të dhunës në shkollë, si p.sh. dobësitë e ndryshme ndaj dhunës që mund të kenë vajzat dhe djemtë ose shkalla në të cilën vajzat dhe djemtë mund të ndjehen të sigurt për të raportuar dhunën tek drejtorët e shkollave që zakonisht janë burra. Pra, ky Protokoll është **neutral gjinor**. Ai mund të bazohet në Protokollin e ri Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale, duke përpunuar përgjegjësitë institucionale dhe siguruar një qasje të përgjegjshme gjinore, përfshirë rastet e dhunës digjitale. RrGK nuk ka mundur të gjejë asnjë raport

34 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHT, [Udhëzimi administrativ nr. 20/2018 për ndalimin e telefonave celularë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar](#), 2018.

35 Po aty., neni 3.

36 Po aty., neni 4.

37 Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

38 Republika e Kosovës, Qeveria,

39 Po aty.

40 Po aty.

lidhur me shkallën në të cilën shkollat e kanë zbatuar këtë Protokoll apo ndonjë të dhënë për rastet e raportuara.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021

Me këtë plan kërkohej pajisje e shkollave me pajisje TIK, kurrikula të reja, tekste shkollore dhe mjete të mësimdhënies.⁴¹ Plani thekson se pjesëmarrja dhe arsimit gjithëpërfshirës duhet të kontribuojnë në parandalimin e varfërisë, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, fuqizimin e grave dhe integrimin e të gjithë njerëzve në shoqëri.⁴² Për promovimin e përfshirjes dhe përdorimit të pajisjeve personale të TIK-ut, sipas këtij plani, planifikohen subvencione për blerjen e tabletave me kosto të ulët për nxënësit nga familjet me kushte të dobëta ekonomike.⁴³ Në plan thuhet se dallimet gjinore duhet të merren parasysh në rregulloret komunale që mbështesin regjistrimin dhe ndjekjen e djemve dhe vajzave në arsimin parashkollor dhe të mesëm.⁴⁴ Ai synon të rrisë për 20% regjistrimin e nxënësve në profilet teknike përmes stimujve, duke përdorur një fond të përbashkët të krijuar nga qeveria dhe bizneset.⁴⁵ Në përgjithësi, në këtë dokument përmenden vajzat dhe gratë në disa rezultate, objektiva dhe aktivitete specifike, duke adresuar rolet dhe stereotipat gjinorë. Pra, kjo strategji është **transformuese gjinore**.

RrGK nuk ka gjetur asnjë dëshmi për ndonjë raport të qeverisë rreth monitorimit të zbatimit të kësaj Strategjie, ndonëse kjo mund të kishte informuar Strategjinë e re. Megjithatë, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), OShC, ka bërë një vlerësim, duke theksuar zbatimin e pamjaftueshëm.⁴⁶ KEC konstatoi se djemtë kanë më shumë gjasa të regjistrohen në shkollat profesionale sesa vajzat. Në vitin akademik 2019/2020, në shkollat e AAP janë regjistruar 23,868 djem (58%) krahasuar me 16,949 (42%) vajza.⁴⁷ Prej nxënësve të regjistruar në programet e AAP-së për TIK, 73% ishin djem dhe 27% vajza.

Strategjia e Arsimit 2022-2026

Në vitin 2022, Qeveria miratoi këtë Strategji, duke synuar promovimin e arsimit cilësor për të gjithë.⁴⁸ Ajo ka pesë fusha prioritare: 1) Arsimit në fëmijërinë e hershme; 2) Arsimit parauniversitar; 3) AAP dhe Arsimit për të rritur; 4) Arsimit i lartë; dhe 5) Digjitalizimi i Arsimit.⁴⁹ Të gjithë mund të kishin të përfshirë fokusin ndaj gjinisë, por nuk e bënë atë. Edhe pse nuk përmend

41 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHT, [Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021](#), 2016, Qëllimi i strategjisë 5.

42 Po aty, Qëllimi i strategjisë 1.

43 Po aty, f. 77.

44 Po aty, f. 44.

45 Po aty, rezultatet 6.2, f. 84.

46 KEC, [Vlerësimi i Zbatimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021 Arritje të pamjaftueshme](#), 2021.

47 Po aty.

48 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022.

49 Po aty, f. 8.

aspektin gjinor në mënyrë eksplicite, Strategjia njih rëndësinë e promovimit të barazisë gjinore dhe zotësisë digjitale në arsim. Ajo ka për qëllim të zhvillojë aftësi digjitale të nxënësve dhe mësuesve dhe të adresojë pabarazitë gjinore në qasjen në burimet dhe teknologjinë digjitale. Strategjia synon të promovojë përfshirjen e mjediseve “të ndjeshme gjinore” të mësimdhënies dhe të të nxënësve që adresojnë stereotipat gjinorë, promovojnë qëndrime pozitive ndaj barazisë gjinore dhe mbështesin pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në arsim. Veçanërisht, këto janë të përgjegjshme gjinore apo edhe transformuese gjinore më shumë sesa të ndjeshme gjinore, pasi ato kërkojnë të adresojnë pabarazitë dhe potencialisht të transformojnë normat dhe marrëdhëniet gjinore. Strategjia përfshin përdorimin e teknologjisë digjitale për të “përmirësuar shërbimet dhe cilësinë në arsim” duke:

1. Krijuar dhe funksionalizuar platformën digjitale gjithëpërfshirëse dhe të centralizuar
2. Përgatitur dhe prodhuar materiale digjitale shumëdimensionale dhe cilësore të mësimdhënies për nivele, klasa dhe lëndë të ndryshme
3. Furnizuar IAT [Institucionet Arsimore dhe Trajnuese] dhe IAL [Institucionet e Arsimit të Lartë] me rrjete cilësore interneti dhe pajisje të nevojshme teknologjike
4. Kultivuar kompetencë digjitale tek të gjitha palët në arsim dhe në të gjitha institucionet arsimore
5. Krijuar mekanizmat institucionalë që mundësojnë zbatimin e digjitalizimit dhe përdorimin e teknologjisë në arsim⁵⁰

Vetëm një tregues i ndikimit merr parasysh gjininë: “Përqindja e mësuesve, stafit menaxhues dhe administrativ të institucioneve arsimore dhe nxënësve, të ndarë sipas gjinisë, të cilët demonstrojnë kompetencë bazë digjitale në fushat përkatëse që lidhen me rolin e tyre”. Nga 20 treguesit e rezultateve, asnjëri nuk e kishte të përfshirë perspektivën gjinore e nuk e kishte as ndonjë tregues, pikënisja apo objektiv.

Në drejtim të ofrimit të mundësive për përdorimin e TIK-ut në IAT dhe IAL, Strategjia planifikon të krijojë klube studentore vullnetare për mirëmbajtjen bazë të pajisjeve TIK në shkolla ku nxënësit e interesuar për TIK do të trajnohen dhe do të fitojnë përvojë, të udhëhequr nga mësuesit e TIK-ut; kjo masë synon pjesëmarrjen e barabartë gjinore.⁵¹ MASHTI gjithashtu planifikon të zhvillojë një udhëzues për përgatitjen dhe ofrimin e trajnimeve në kompetencat digjitale

50 Po aty, Qëllimi i strategjisë 5, f. 9.

51 Po aty, Qëllimi i strategjisë 5.3, f. 79.

për organizatat arsimore dhe stafin e tyre, duke përfshirë udhëzimet digjitale, udhëheqjen, integrimin gjinor dhe përfshirjen e prindërve në edukimin digjital.⁵² Në përputhje me përkufizimet e BE-së, përtej TI-së, kompetenca digjitale përfshin një tranzicion gjithëpërfshirës institucional, duke përfshirë menaxhimin, administrimin, mësimdhënien dhe të nxënit.

Plani i Veprimit i Strategjisë përmban objektiva, objektiva dhe tregues që e kanë të integruar perspektivën gjinore dhe ka për qëllim të transformojë normat dhe stereotipat gjinorë, përfshirë tekstet shkollore. Plani përfshin masa afirmative për vajzat në TI.⁵³ Një prej objektivave është të implementohen hulumtime nga Instituti i Mësimin të Aplikuar për të përputhur programet me nevojat e tregut të punës, duke përfshirë “bazuar në nevojat e vajzave dhe grave në tregun e punës”.⁵⁴ Kjo Strategji dhe Plan Veprimi merr parasysh dhe fokusohet në dallimet, normat dhe stereotipat që lidhen me gjininë dhe përpiqen t’i zvogëlojnë ato, përfshirë ato që lidhen me digjitalizimin. Kështu, ai është **transformues gjinor**.

Strategjia e Kosovës për Rini 2019-2023

Në këtë Strategji përmendet TI.⁵⁵ Ajo bën thirrje për trajnime për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, kërcënimet e ndryshme nga interneti, terrorizmi dhe kërcënimet tjera që minojnë një mjedis të sigurt për të rinjtë dhe të rejtat në Kosovë. Në Strategji nuk bëhet dallimi mes grave të reja dhe burrave të rinj, vajzave dhe djemve. Në të nuk përmendet prevalenca e dhunës me bazë gjinore që prek gratë dhe vajzat, duke përfshirë edhe përmes TI-së, si një kërcënim potencial për sigurinë. Strategjia vë në dukje se të rinjtë luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e paqes, por nuk arrin ta diskutojë këtë nga perspektiva gjinore, pavarësisht nga vëmendja në rritje ndërkombëtare ndaj ndërlidhjeve midis agjendave të Grave, Paqes dhe Sigurisë dhe Rinisë, Paqes dhe Sigurisë.⁵⁶

Planit të veprimit i mungojnë treguesit, pikënisjet, objektivat dhe buxheti të ndara sipas gjinisë. Objektivat dhe aktivitetet nuk synojnë të transformojnë normat gjinore, të adresojnë dhunën kibernetike me bazë gjinore ose të përmirësojnë njohuritë e të rinjve në lidhje me mirëqenien e tyre digjitale nga perspektiva gjinore. Këto nuk i referohen as përdorimit të platformave të internetit nga gratë e reja dhe burrat e rinj, aftësive digjitale ose krijimit të ekosistemeve të inovacionit që dekonstruktajnë rolet dhe stereotipat gjinorë.

52 Po aty, f. 82.

53 Po aty, [Plani i Veprimit](#), f. 53.

54 Po aty, f. 54.

55 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, [Strategjia për Rini 2019-2023](#), 2019.

56 RrGK, [Një ulëse në tryezë](#), 2021.

Ekzistojnë plane për të mbështetur gratë dhe të rinjtë në zonat rurale nëpërmjet 20 projekteve në vit dhe pesë ngjarjeve avokuese.⁵⁷ Në drejtim të zhvillimit të arsimit joformal, në plan thuhet [*theks i shtuar*]:

Megjithëse nuk përfundon me ndonjë lloj diplome, arsimi joformal pasuron dhe ndërton aftësitë dhe shkathtësitë e *një të riu [young man]*. Arsimi joformal [i jep] *një të riu [young man]* aftësi dhe përvoja jetësore ku gjërat mësohen hapur. Përmes edukimit joformal *një i ri [young man]* nuk i mëson gjërat në klasë apo në mënyrë sistematike.⁵⁸

Kjo gjuhë përforcon stereotipat gjinorë. Megjithëse Strategjia synon të mbështesë termin “Rinia”, që përfshin të rejat dhe të rinjtë, Strategjia përdor termin “burrë [young man]” si term neutral gjinor. Kjo kontribuon në përforcimin e stereotipave gjinorë që e marrin të shprehurit në mashkullore si dicka të nënkuptuar.⁵⁹ Siç ka shkruar Criado Perez, “Kur thua burrë, ti nuk i përfshin edhe gratë, edhe nëse të gjithë teknikisht e dinë këtë!”. Studime të shumta në një sërë gjuhësh gjatë dyzet viteve të fundit kanë konstatuar vazhdimisht se ajo që quhet ‘mashkullore/mashkull në terma gjenerikë (duke përdorur fjalë si ‘ai’ në mënyrë neutrale gjinore) në fakt nuk lexohet në mënyrë të përgjithshme. Lexohet me shumicë dërrmuese si mashkull.”⁶⁰

Pra, pavarësisht një mase afirmative për vajzat në TI, kjo Strategji është **negative** në aspektin **gjinor**, sepse përforcon normat gjinore duke nënkuptuar se burrat janë më të përshtatshëm për këto forma të edukimit. Edhe pse e miratuar në vitin 2019, ajo nuk duket se i është nënshtruar një VN(B)Gj për të informuar dizajnin e saj dhe nuk adreson nevojat e grave të reja dhe burrave të rini. As nuk parasheh ndonjë masë specifike për të përfshirë më shumë gra dhe vajza në sektorin e TIK.

Deri më sot, në faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nuk duket të jetë publikuar asnjë raport zyrtar për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Analiza gjinore ex-post ka mundur të përfshihej në vlerësimin e Strategjisë.

57 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, [Strategjia për Rini 2019-2023](#), 2019, Veprimi 3.3.5.

58 Po aty, f. 10.

59 Caroline Criado Perez, *Invisible Women (Gratë e padukshme)*, 2019, f. 15.

60 Po aty, f. 15.

“Kur thua burrë, ti nuk i ‘përfshin edhe gratë, edhe nëse të gjithë teknikisht e dinë këtë.’. Studime të shumta në një sërë gjuhësh gjatë dyzet viteve të fundit kanë konstatuar vazhdimisht se ajo që quhet ‘mashkullore/mashkull në terma gjenerikë (duke përdorur fjalë si ‘ai’ në mënyrë neutrale gjinore) në fakt nuk lexohet në mënyrë të përgjithshme. Lexohet me shumicë dërrmuese si mashkull.”

- Caroline Criado Perez

Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021

Me këtë SKZH arsimit u konsiderua si prioritet kryesor qeveritar me zhvillimin e kapitalit njerëzor si një nga pesë objektivat strategjike.⁶¹ Sipas SKZH-së, shkollave dhe bibliotekave rurale u mungon qasja në infrastrukturën e TI-së. Prandaj, SKZH planifikoi të koordinojë palët e interesuara në sektorin e TIK-ut, duke siguruar shpërndarje dhe përdorim të gjerë të TI-së në arsim.⁶² Ky dokument kishte masa konkrete drejt “ndërtimit të një fuqi punëtore më të punësueshme”, e cila lidhet me arsimin.⁶³ Në të nuk ka asnjë referencë të qartë rreth gjinisë, grave, burrave, vajzave ose djemve në lidhje me veprimet e planifikuara të SKZH-së në arsim, të cilat përfshijnë: rritjen e përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore; përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies; përmirësimin e korrelacionit ndërmjet aftësive të fituara në arsim dhe nevojave të tregut të punës; fuqizimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe certifikimit; dhe përmirësimin e planifikimit të shpenzimeve.⁶⁴

Këto ndërhyrje mund të ndikojnë ndryshe tek gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, por nevojat e tyre të ndryshme nuk u morën parasysh. SKZH mund të kishte përmendur nevojat specifike arsimore të vajzave në lidhje me TIK-un, drejt planifikimit të shpenzimeve të përgjegjshme gjinore. Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies ka mundur t’i referohet transformimit të normave gjinore përmes trajnimit të mësuesve dhe pedagogjisë. Përmirësimi i shpenzimeve ka mundur të përfshijë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor sipas Ligjit për Barazi Gjinore. SKZH nuk përdor buxhetim të përgjegjshëm gjinor për të specifikuar shpenzimet e planifikuara për gra dhe burra të ndryshëm. Megjithatë në SKZH përmenden gratë dhe përfshihen aktivitete që synojnë gratë, veprimet që lidhen me digjitalizimin e arsimit janë **neutrale gjinore**. Analiza *ex-post* e ndikimit gjinor të SKZH-së në lidhje me digjitalizimin e arsimit mund të informojë VN(B)Gj *ex-ante* për SKZH-në e re.

Programi i Reformave Ekonomike

PRE-të përfshijnë reforma të planifikuara për të rritur konkurrencën, për të përmirësuar kushtet për rritje gjithëpërfshirëse dhe për të krijuar vende pune; kjo përfshin përmirësimin e arsimit dhe aftësive bazuar në nevojat e tregut të punës.⁶⁵ Në PRE e parë e Kosovës në vitin 2016 thuhet se burimet njerëzore, veçanërisht studentët e arsimuar në universitetet vendore, kishin nevojë për trajnime shtesë për sektorët që merren me TIK.⁶⁶ Ai vuri re nevojën për të rritur talentin dhe për të krijuar vende pune digjitale, duke u fokusuar

61 Republika e Kosovës, Qeveria, OPM, [Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021](#), 2016.

62 Po aty, f. 46.

63 Po aty, Masa 3: Lidhshmëria më e mirë mes arsimit dhe tregut të punës, Ndikimi në zhvillim, f. 13.

64 Po aty, Ndërhyrjet e SKZH, f. 10.

65 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2019-2021](#), 2019. Vini re se hiperlidhjet (hyperlinks) në këtë seksion mund të mos jenë më funksionale për shkak të ndryshimeve në faqen e internetit të Qeverisë..

66 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike](#), 2016.

tek të rinjtë, gratë dhe personat me aftësi të kufizuara.⁶⁷ Në zgjerimin e rrjeteve dhe shërbimeve të infrastrukturës TIK drejt zhvillimit socio-ekonomik, PRE parashikoi që një projekt pilot i titulluar Women in Online Work- Gratë në punë online (WOW) do të synonte 100 gra në dy komuna, do të trajnonte 90 të rinj në TIK dhe do të ofronte praktika në kompanitë anëtare të STIKK ku të rinjtë mund të praktikojnë dhe shfaqin aftësitë e tyre para punëdhënësve të mundshëm.⁶⁸

Në PRE të vitit 2017 thuhet se faza e ndërtimit të kapaciteteve të WOW përfshinte trajnime në aftësitë teknike dhe të buta të kërkuara për punësim në platformat ndërkombëtare online.⁶⁹ WOW thuhet se kishte rezultate pozitive: 56% e 100 grave të synuara që morën pjesë nënshkruan të paktën një kontratë për punë online.⁷⁰ Megjithatë, kjo masë nuk u vazhduar në PRE

56% e 100 grave të synuara që morën pjesë nënshkruan të paktën një kontratë për punë online.

2017-2019 apo PRE 2018-2020; Kjo e fundit vetëm vuri në dukje se USAID dhe Helvetas vazhduan të mbështesin WOW në katër komuna në vitin 2017, ku 260 gra mësuan aftësi për punë në platformat ndërkombëtare online, aftësi teknike si kodimi dhe shkathtësitë e buta.⁷¹ Në vend që të vazhdojë me WOW, PRE 2019-2021 parashikoi trajnimin e të paktën 400 të rinjve drejt zhvillimit të burimeve njerëzore për ekonominë digjitale dhe mbështetjes së bizneseve digjitale.⁷² Aktiviteti nuk përfshinte të dhëna ose objektiva të ndara sipas gjinisë. PRE 2020 raportoi se ky aktivitet ishte në “fazat fillestare”; nuk përmbante të dhëna të ndara sipas gjinisë për gratë dhe burrat e rinj të arritur.⁷³ Masa u riformulua në PRE 2020-2022, e cila parashihte trajnimin e të rinjve, lidhjen e tyre me mundësitë e punësimit online përmes Programit Youth Online dhe Upward (YOU) të zbatuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe ngritjen e një Qendre të Ekselencës

Digjitale që do të bënte furnizimin me pajisje.⁷⁴ Në raportimin e progresit të PRE 2021-2023, në PRE 2022-2024 thuhet se pandemia kontribuoi në një vonesë në mbajtjen e këtyre trajnimeve online.⁷⁵ Megjithatë, aty cekej se prokurimi për ofrimin e gjashtë moduleve ishte në zhvillim e sipër, duke përfshirë trajnimin e planifikuar për rreth 500 të rinj me 300 orë mësimore për secilin modul.⁷⁶ Me PRE 2022-2024 është planifikuar që trajnimi të fillojë në janar 2022, duke synuar të arrijë të paktën 2,000 të trajnuar dhe të rrisë

67 Po aty., f. 76.

68 Po aty., Masa 8 e reformave, f. 77.

69 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike](#), 2017.

70 Po aty., f. 130.

71 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2018-2020](#), 2018.

72 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2019-2021](#), 2019.

73 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2020-2022](#), 2020.

74 Po aty., Masa 13 në kuadër të reformave.

75 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2022-2024](#), 2022.

76 Modulet përfshinin: “Python, Advanced 154 Network Administrator, Mobile Development, Digital Marketing, Full Stack developer, 3D printing technology, ose IT Essentials”.

kapacitetet e tyre të kërkimit të punës në tregun lokal të TIK-ut. Ky PRE nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit e synuar ose nuk përmend masat afirmative për të siguruar pjesëmarrjen e grave.⁷⁷ PRE 2023-2025 raportoi se grupet e para përfunduan trajnimin në vitin 2022 dhe rreth 400 persona të trajnuar u certifikuan.⁷⁸ Ai parashikoi trajnimin e 810 të rinjve në 10 module. Përsëri, nuk u ofrua asnjë ndarje sipas gjinisë, pavarësisht rekomandimeve të RrGK-së që PRE të ketë tregues, pikënisjet, objektivat dhe raportimin për përfituesit të ndara sipas gjinisë.⁷⁹

PRE 2020-2022 ka planifikuar pilotimin e një platforme digjitale TIK në vitin 2021 dhe zbatimin e kurrikulave të reja të AAP-së.⁸⁰ PRE 2022-2024 raportoi se platforma digjitale TIK u kompletua në bashkëpunim me Odën e Tregtisë.⁸¹ PRE nuk përmend nëse analiza gjinore informoi dizajnin e tij ose nëse të dhënat e ndara sipas gjinisë do të gjurmohen.

Në përgjithësi, çdo vit PRE-të kanë demonstruar një perspektivë të përmirësuar gjinore. Në përgjithësi, ata janë të **përgjegjshëm gjinor**. Megjithatë, veçanërisht lidhur me digjitalizimin dhe arsimin, PRE-të nuk kanë marrë parasysh në mënyrë të vazhdueshme dallimet në lidhje me gjininë. Masat vjetore mund të kishin specifikuar dhe adresuar më tej sfidat me të cilat përballen gratë në qasjen e barabartë në arsimin digjital, duke pasur parasysh normat gjinore dhe stereotipat që pengojnë pjesëmarrjen e tyre.⁸² Procesi PRE mundëson monitorimin vjetor të progresit. Megjithatë, PRE-të nuk kanë pasur vazhdimisht tregues, pikënisjet ose objektiva të ndara sipas gjinisë për të lehtësuar monitorimin nëse nga kanë përfituar si të rinjtë ashtu edhe të rejat. Analiza gjinore dhe konsultimet me OShCG-të mund të informojnë PRE-të e ardhshme, duke siguruar që nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve të merren parasysh në hartimin e programeve, platformave dhe mundësive të trajnimit për sektorin e TIK-ut. Tabelat raportuese për zbatimin e PRE-ve mund të kishin ofruar të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit sipas Ligjit për Barazinë Gjinore. Qeveria gjithashtu ka mundur të hartojë raporte vjetore ose afatmesme për zbatimin e PRE-së, të ngjashme me raportet për zbatimin e ARE.

Agjenda për Reforma Evropiane

ARE synon të rrisë qasjen në arsim për fëmijët, përfshirë ata me nevoja të veçanta, nga komunitetet e pakicave etnike dhe gratë.⁸³ Ajo është krijuar për të rritur kapacitetet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe për

77 Shih kapitullin 1.

78 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2023-2025](#), 2023.

79 Rekomandimet e RrGK-së të bëra gjatë konsultimeve për PRE 2021-2023, ERP 2023-2025, dhe raportet e vlerësimit për PRE.

80 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2020-2022](#), 2020, Masa 16.

81 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2022-2024](#), 2022, f. 157.

82 Shih kapitullin 1.

83 Republika e Kosovës, Qeveria, [Faza e dytë e prioritetëve Politike BE ▫ Kosovë: Agjenda për Reforma Evropiane \(ARE\) II](#), 2021.

të lehtësuar qasjen në arsim për fëmijët me aftësi të kufizuara. Megjithatë, lidhur me TIK-un dhe arsimin, ARE 2021-2023 nuk përfshin asnjë masë apo tregues në lidhje me barazinë gjinore në arsim dhe digjitalizim. Në të përmendet trajnimi i mësimdhënësve dhe rritja e cilësisë së arsimit.⁸⁴ Megjithatë, këto objektiva nuk e specifikojnë nevojën për të përdorur metoda më transformuese gjinore të mësimdhënies gjatë transmetimit të aftësive digjitale. Objektivat nuk kanë tregues, pikënisje, objektiva ose buxhet për të matur ndryshimet që lidhen me avancimin e barazisë gjinore. Në përgjithësi, ARE është e përgjegjshme gjinore, pasi përpiket të adresojë disa pabarazi. Megjithatë, lidhur me digjitalizimin e arsimit, ARE II nuk përmban asnjë perspektivë gjinore dhe është **neutrale gjinore**. Qeveria ka publikuar raportin e fundit të ARE II në vitin 2022; në të nuk trajtohen zhvillimet që lidhen me arsimin dhe digjitalizimin.

Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021

Në këtë Strategji të vitit 2017 barazia gjinore u konsiderua si një çështje ndërthurëse dhe ishin të përfshira disa masa që lidhen me arsimin.⁸⁵ Ajo diskuton se si gratë romë dhe ashkali përballen me diskriminim të dyfishtë bazuar në gjininë dhe përkatësinë e tyre etnike. Aty përmendet se niveli i ulët i arsimimit në mesin e romëve dhe ashkalive kontribuon në papunësi dhe shëndet të dobët. Me qëllim të rritjes së përfshirjes, Strategjia ka planifikuar disa masa që synojnë gratë dhe vajzat romë dhe ashklike, siç janë masat afirmative dhe programet arsimore përgatitore për të mbështetur regjistrimin dhe qëndrimin e tyre në IAL; vendosjen e treguesve të ndjeshëm gjinor në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) për Romët dhe Ashkalitë; dhe rritjen e ndërgjegjësimit të vajzave për rëndësinë e regjistrimit në kohë dhe ndjekjes së shkollimit.⁸⁶ Strategjia i referohet gjinisë në disa objektiva dhe aktivitete që synojnë gratë dhe vajzat. Prandaj, në përgjithësi, Strategjia është e **përgjegjshme gjinore**. Megjithatë, në lidhje me digjitalizimin, Strategjia është **neutrale gjinore**. Plani i Veprimit nuk përmban asnjë tregues, pikënisje, ose objektiva të ndara sipas gjinisë, ose tregues për të matur se si Strategjia e ka avancuar barazinë gjinore. As ndonjë buxhet i qartë nuk është alokuar duke përdorur parimet më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.

Zyra e ZKM-së për Qeverisje të Mirë ishte përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të Strategjisë. Në vitin 2020, Zyra publikoi një Raport të Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019.⁸⁷ Ai nuk përmban informata të hollësishme

84 Po aty, Qëllimi 3.4.a dhe 3.4.b.

85 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, [Strategjia për përfshirjen e komuniteteve Rom dhe Ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021](#), 2017. Përfaqësuesit politikë egiptianë kërkuan të mos përfshiheshin në Strategji.

86 Po aty, aktivitetet 1.1.5, 1.2.1, dhe 1.3.2, paragrafët 40-43.

87 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, [Raporti i Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019 mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021](#), 2020.

për zbatimin e aktiviteteve në Strategji, veçanërisht për vajzat romë dhe ashkalike. Raporti ofron vetëm informata për aktivitetet e ndërgjegjësimit për regjistrimin në kohë dhe ndjekjen e shkollimit, kryesisht të organizuara nga OSHC-të. Në raport përmendet një diskutim i vitit 2017 mbi këtë temë në bashkëpunim me MASHT-in, mbi krijimin e fondit për Arsim të Romëve dhe Zërin e Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve në Kosovë. Sipas raportit, asnjë veprim tjetër nuk është ndërmarrë në tre vjet.

Strategjia nuk merr parasysh nevojën për të siguruar që vajzat dhe djemtë romë dhe ashkali të kenë qasje në pajisjet digjitale dhe mundësi për të avancuar aftësitë e tyre digjitale.

Strategjia nuk merr parasysh nevojën për të siguruar që vajzat dhe djemtë romë dhe ashkali të kenë qasje në pajisjet digjitale dhe mundësi për të avancuar aftësitë e tyre digjitale. Pandemia e COVID-19 solli në pah mungesën e qasjes të tyre në pajisje të tilla digjitale, gjë që pengoi pjesëmarrjen e tyre arsimore.⁸⁸ Megjithëse vlerësimi i Strategjisë u publikua në shtator 2020, gjashtë muaj të pandemisë, çuditërisht në të nuk përmenden nevojat arsimore dhe barrierat me të cilat u përballën vajzat dhe djemtë romë dhe ashkali gjatë kësaj periudhe.

Përmes kësaj Strategjie, MASHT lansoi disa programe të bursave që synojnë nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë. Nga vlerësimi rezulton se janë dhënë 500 bursa në vitin 2017, 507 në 2018 dhe 593 në vitin 2019.⁸⁹ Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfitueset apo ndonjë indikacion se vajzat dhe gratë e reja romë, ashkalike dhe egjiptiane kishin prioritet. As bursat nuk priren të jepen në fusha të lidhura me TIK-un. Në vlerësimin afatmesëm thjesht ceket se MASHT-i shpall thirrjen për bursa çdo vit dhe procesi i përzgjedhjes është i bazuar në merita, sipas Udhëzimit Administrativ për ndarjen e bursave. Ky udhëzim nuk përfshin asnjë masë afirmative për vajzat, edhe pse mund të ishte bërë kjo në listën që ka prioritet kategori të veçanta për studentët që të marrin bursa.⁹⁰ Megjithëse Strategjia ka skaduar në vitin 2021, vlerësim përfundimtar që përmban analizën e ndikimit gjinor nuk është ende në dispozicion.

Qeverisja

Ky seksion shqyrton qeverisjen në lidhje me digjitalizimin e sektorit të arsimit dhe deri në çfarë mase kanë marrë pjesë gratë dhe burrat në udhëheqjen,

88 KEC, *Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë*, 2021, f. 72.

89 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, *Raporti i Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019 mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021*, 2020, f. 33.

90 Po aty, f. 26. Pra, në bazë të kriterëve në Udhëzimin administrativ nr. 12/2015 për ndarjen e bursave, neni 4.

koordinimin, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave që lidhen me digjitalizimin dhe arsimin. Ai gjithashtu diskuton aftësitë për reformat digjitale dhe marrjen parasysh e aspektit gjinor tek shërbimet digjitale në dispozicion. Së fundi, ai analizon marrjen parasysh e aspektit gjinor në financimin dhe prokurimin nga qeveria në sektorin e arsimit

MASHTI më parë MASHT, është përgjegjës për sektorin e arsimit.⁹¹ Në përgjithësi, MASHTI ka 148 të punësuar në administratën qendrore, duke përfshirë 73 gra (49%) dhe 75 burra (51%).⁹² Njëzet gra (54%) dhe 17 burra (46%) kanë pozita **udhëheqëse**. Një grup punues për digjitalizimin dhe arsimin Ai përbëhej nga një baraspeshë gjinore me 15 burra (56%), duke

përfshirë kryesuesin dhe 12 gra (44%). Siç ilustron korniza ligjore, ka pasur disa përmirësime në planifikimin e përgjegjshëm gjinor në këtë Ministri. Një pjesëmarrëse në hulumtim reflektoi: “Ajo që i mungon Ministrisë është një zë i fortë i një personi apo zyrtari të caktuar për t’ia kujtuar këtë [njerëzve] gjatë gjithë kohës..., Duhet të jesh si një mushkonjë, të gumëzhish, të gumëzhish dhe ta përmendësh gjatë gjithë kohës [gjininë]”, duke iu referuar nevojës për t’i sjellë vazhdimisht vëmendje analizës gjinore dhe implikimeve gjinore në vendimmarrje.⁹³ Ndërkohë, planet e punës së DKA-së që i shqyrtoi RrGK-ja nuk përmbanin ndonjë masë specifike për bullizmin kibernetik, ngacmimin seksual ose dhunën seksuale.⁹⁴

“Duhet të jesh si një mushkonjë, të gumëzhish, të gumëzhish dhe ta përmendësh gjatë gjithë kohës [gjininë].”

- Pjesëmarrëse në hulumtin

MASHTI është përgjegjës kryesor për **koordinimin** e reformave në lidhje me digjitalizimin në sektorin e arsimit.⁹⁵ Menaxhimi i arsimit parauniversitar ndahet ndërmjet nivelit qendror (MASHTI), nivelit komunal (DKA) dhe Institucionet Edukative Arsimore dhe Aftësuese (IEAA). Koordinimi ndërmjet tyre është i ulët për shkak të kapaciteteve të dobëta njerëzore dhe ndryshimeve të shpeshta në staf, shpesh për shkak të ndikimit politik.⁹⁶ Strategjia e Arsimit 2022-2026 duhet të zbatohet, monitorohet, raportohet dhe “ndërlidhet dhe koordinohet” me SKZH 2030.⁹⁷ SKZH nuk është publikuar, duke e bërë këtë të vështirë. MASHTI planifikon të krijojë një Grup për Zbatimin e Strategjisë së Arsimit, të udhëhequr nga

91 MASHT u bë MASHTI, duke shtuar ‘inovacionin’ në emërtimin dhe në përgjegjësitë në vitin 2020, sipas raportimeve dhe lajmeve online; RrGK nuk ka gjetur ndonjë burim zyrtar se kur është ndryshuar saktësisht emri.

92 Korrespondenca e RrGK-së me MASHTI, 2023.

93 Intervista e RrGK-së me një përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, gusht 2023.

94 RrGK shqyrtoi mostrën e planeve të punës, kryesisht të përzgjedhura si rajonet kryesore në Kosovë dhe që prekin më së shumti studentët: Pejë, Gjakovë, Prishtinë dhe Podujevë.

95 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022, Plani i Veprimit, 2022, f. 61.

96 Po aty, f. 37.

97 Po aty, f. 88.

Ministri ose Zëvendësministri, koordinuar nga Sekretari i Përgjithshëm dhe të përbërë nga zyrtarë të njësive organizative të MASHTI-t përgjegjës për zbatimin e Strategjisë, Zyrës së ZKM-së për Planifikim Strategjik dhe MFPT.⁹⁸ Strategjia nuk kërkon në mënyrë eksplicite baraspeshë gjinore në këtë mekanizëm ose pjesëmarrjen e ZBGJ të MASHTI-it, megjithëse kjo mund të ndihmojë në sigurimin e koordinimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të përgjegjshëm gjinor në lidhje me reformat digjitale. MASHTI duhet ende të zhvillojë mekanizma adekuat koordinues që lehtësojnë rrjedhën e informacionit dhe komunikimin e rregullt ndërmjet MFPT-së dhe MASHTI-t, dhe ndërmjet MASHT-it dhe DKA-ve për çështjet e financimit.⁹⁹ MASHTI ka një Divizion të Shkencës dhe Teknologjisë, mirëpo nuk dihet nëse i njëjti është përgjegjës për digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë digjitale në fushën e arsimit. RrGK nuk ka gjetur dëshmi që divizione përkatëse për digjitalizimin ekzistojnë edhe në kuadër të DKA, në IEAA-ve, shkollave etj, të cilët kanë rol të ndryshëm nga specialistët e IT-së, që kujdesen për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike. Historikisht, MPMS ka planifikuar politika për punësim dhe profesione, edhe pse këto kompetenca i janë bartur MFPT-së. APRK koordinon politikat përmes qendrave rajonale, duke ndihmuar punëkërkuësit e rritur me trajnime. MASHTI është përgjegjës për zhvillimin e politikave dhe hartimin e legjislacionit për arsimin, përfshirë AAP-në. MASHTI bashkëpunon me AAAPARR, DKA-të,¹⁰⁰ dhe organe të tjera për të ofruar AAP për të rinjtë, duke synuar t'i pajisë nxënësit me kompetenca dhe aftësi për fuqinë punëtore. Ligji i AAP-së i vitit 2006 institucionalizoi bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve arsimore dhe partnerëve socialë.¹⁰¹ Këshilli për AAP dhe të Rriturit (KAAPRR) këshillon qeverinë për AAP dhe arsimin për të rritur dhe miraton standardet profesionale. KAAPRR punon në kuadër të MASHTI-t dhe ka 15 anëtarë duke përfshirë përfaqësues të MASHTI-t, (më parë) MPMS-së, MTI-së, Ministrisë së Shëndetësisë, Odës Ekonomike të Kosovës, sindikatave, bizneseve dhe OJQ-ve.¹⁰² Numri i grave dhe burrave në Këshill nuk dihet. Edhe pse Këshilli u krijua në vitin 2014, ai ka pasur vështirësi për t'u bërë plotësisht funksional, pjesërisht për shkak se anëtarët nuk u kompensuan për shërbimin e tyre.¹⁰³ AAAPARR menaxhon qendrat e kompetencës së AAP-së të financuara nga donatorët dhe institucionet e AAP-së për të rritur. Detyrat e saj përfshijnë zhvillimin e standardeve, kurrikulave, materialeve dhe trajnimin e mësimdhënësve. Agjencia merret me financat, burimet njerëzore

98 Po aty.

99 Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF), "[Kosovo Rapid Education Diagnosis \(RED\): Addressing the weak links](#)" (*Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta*), 2023, f. 10.

100 ETF, [Quality Assurance in Vocational Education and Training in Kosovo](#), ETF Forum Member Institution: National Qualifications Authority, (*Sigurimi i Cilësisë në Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë, Institucioni Anëtar i Forumit të ETF: Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve*), 2020, f. 5.

101 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-183 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional në Kosovë](#), 2006.

102 Jetë Aliu, Ema Rraci dhe Kushtrim Bajrami, [Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë](#), Kosovë, Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim (KEEN): 2019, f. 17.

103 Po aty, f. 19.

dhe infrastrukturën për institucionet publike të AAP-së. AAAPARr mbikëqyr gjashtë qendra, ndërsa të tjerat funksionojnë në kuadër të sistemit komunal të arsimit. DKA-të drejtojnë institucionet arsimore publike, objektet, regjistrimin, stafin dhe trajnimet. Drejtorët zgjidhen nga kryetarët e komunave. Meqenëse shumë palë të interesuara janë të përfshira në ofrimin e ekspertizës për programet e AAP-së, koordinimi, duke përfshirë reformat digjitale, kërkon planifikim të qartë dhe ndarje të përgjegjësive në nivel qendror dhe vendor.

Qeveria ka filluar **zbatimin** e disa reformave që lidhen me digjitalizimin. MASHTI së bashku me donatorët ndërkombëtarë themeluan Qendrën Kosovare e Firmave Ushtrimore për të zhvilluar Aftësitë dhe Kompetenca Digjitale (AKD) për shkollat dhe nxënësit e AAP-së duke përfshirë simulimin e biznesit virtual.¹⁰⁴ MASHTI është në proces të krijimit të Qendrës së Kompetencës për TIK-un të fokusuar në gjashtë kualifikime të TIK e që konsiderohen si prioritete për sektorin e TIK: zhvillues-kodimi i aplikacioneve, teknik i informatikës së biznesit, teknik i sistemeve, teknik i dizajnit grafik, teknik i dizajnit të mediave interaktive dhe teknik elektronik.¹⁰⁵ E mbështetur nga LuxDev, Qendra e Kompetencës për TIK do të mbështesë MASHTI-n në zhvillimin e kualifikimeve për këto profile, përfshirë standardet profesionale, kurrikulat, materialet për mësimdhënie dhe të nxënit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve të menaxherëve dhe mësuesve.¹⁰⁶ Të gjitha kualifikimet janë duke u zhvilluar për të reflektuar nevojat e tregut të punës, me qëllim të lehtësimit të tranzicionit të studentëve në tregun e punës menjëherë pas diplomimit.¹⁰⁷ Duke qenë se MASHTI nuk e ka ende në pronësi këtë qendër, ata nuk kanë mundur të japin informacione për fazën e zhvillimit të saj.¹⁰⁸ MASHTI ka iniciuar reforma në AAP me qëllim të përgatitjes së fuqisë punëtore të ardhshme me aftësitë e nevojshme në tregun e punës, por ende ka shqetësime se shkollat e AAP janë të specializuara në profile që nuk përputhen me nevojat e tregut të punës për shkak të analizave dhe hulumtimeve të pamjaftueshme, dhe kjo ndikon në punësimin e studentëve.¹⁰⁹

Të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit e masave të MASHTI-t që lidhen që me TIK-un, si trajnimet dhe bursat nuk ishin në dispozicion. MASHTI ka zbatuar disa masa afirmative në drejtim të edukimit transformues gjinor dhe digjitalizimit, si bursa për vajzat që ndjekin shkollën profesionale në fushat teknike ku ato kanë qenë të nënpërfaqësuar. Nuk ka dëshmi të përdorimit të masave të ngjashme transformuese gjinore për të inkurajuar djemtë të përfshihen në fusha ku ata janë të nënpërfaqësuar, siç është mësimdhënia në shkolla fillore.

104 ETF, “[Digital skills and online learning in Kosovo](#)” (*Shkathhtësitë digjitale dhe mësimi online në Kosovë*), 2020, f. 1.

105 Po aty, f. 2 dhe Korrespondence e RrGK-së me MASHTI-n, 2023.

106 Po aty.

107 Po aty.

108 Po aty.

109 Jetë Aliu, Ema Rraci dhe Kushtrim Bajrami, *Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë* KEEN: 2019, f. 8.

Qeveria filloi reformat në drejtim të përmirësimit të **mbrojtjes** në sistemin arsimor pas miratimit të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve dhe udhëzimeve administrative përkatëse për mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve nga kërcënimet online. MASHTI ka një Doracak për Parandalimin e Dukurive Negative në Shkolla të Mesme të Larta dhe pakon e Udhëzimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Internet.¹¹⁰ Modulet tematike për mbrojtjen e fëmijëve përfshijnë: 1. Parandalimin dhe referimin e dhunës në shkolla; 2. Parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës; 3. Mbrojtjen e fëmijëve në internet; 4. Parandalimin e diskriminimit në shkolla; 5. Promovimin e Barazisë Gjinore; 6. Parandalimin e gjuhës së urrejtjes; 7. Parandalimin e dhunës në familje; 8. Parandalimin e trafikimit të fëmijëve; 9. Parandalimin e ngacmimeve seksuale; 10. Programin e Iniciativës së të Rinjve - Y Youth; 11. Parandalimin e martesave të hershme; dhe 12. Parandalimin e punës së fëmijëve. Modulet trajtojnë bullizmin kibernetik, por jo nga perspektiva gjinore

Asnjë nga këto ligje apo rregullore nuk përmban ndonjë referencë për bullizmin ose bullizmin kibernetik, e lëre më perspektivën gjinore.

Sistemi arsimor ka kontrollues të të dhënave ku 1022 burra (64%) dhe 570 gra (36%).¹¹¹ Gjatë pandemisë COVID-19, duke përdorur platformat Zoom, Google Meet, Viber dhe WhatsApp, qeveria, mësuesit dhe prindërit mund të mos kenë ndërmarrë hapa të duhur për të mbrojtur mirëqenien digjitale të fëmijëve dhe të dhënat personale.¹¹² Nuk ekziston asnjë dëshmi që kontrolluesi i të dhënave i MASHTI-t ka bërë ndonjë Vlerësim të Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave që përfshin çfarëdo vlerësimi të ndikimit gjinor, megjithëse rekomandohet ligjërisht kur “përdoren teknologji të reja” dhe kur përpunimi i të dhënave mund të kontribuojë në rrezik të lartë” për të drejtat dhe liritë e njerëzve.¹¹³ Duke marrë parasysh se këto ishin teknologji të reja me përdorim të papritur dhe të përhapur, Kontrolluesi i të Dhënave duhet të kishte ekzaminuar ndikimin e mundshëm, duke përfshirë edhe atë tek vajzat dhe djemtë e ndryshëm.

Komunat janë përgjegjëse për buxhetimin dhe pajisjen e shkollave me infrastrukturë adekuate. DKA-të duhet të koordinohen me MASHT-in në raportimin e zbatimit të zotimeve ligjore dhe ato të politikave, duke përfshirë edhe digjitalizimin. RrGK ka analizuar faqet e internetit të shtatë komunave për të vlerësuar zbatimin e këtyre përgjegjësive nga ana e tyre.¹¹⁴ Vetëm gjysma e komunave të vlerësuara periodikisht kanë publikuar plane veprimi online që

110 MASHTI, [Module Tematike për Mbrojtjen e Fëmijëve](#), 2023, qasur më 11 dhjetor 2023.

111 MASHTI Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

112 MASHTI Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

113 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale](#), 2019, Neni 35, Vlerësimi i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave.

114 Duke pasur parasysh kufizimet kohore, RrGK zgjodhi komunat që kanë popullsinë më të madhe dhe në këtë do të prekeshin më shumë nxënës/studentë. RrGK supozoi se nëse komunave më të mëdha do t'u mungonin këto, atëherë komunat më të vogla me më pak burime ndoshta nuk do t'i kishin ato. Në hulumtimet e ardhshme mund të shqyrtohet kjo.

nga viti 2021. Këto ishin planifikuar për të zgjeruar infrastrukturën digjitale në shkolla (d.m.th., pajisje dhe internet), por nuk përmendën mbrojtjen e fëmijëve apo mirëqenien digjitale. Vetëm tri komuna kanë publikuar raporte vjetore dhe asnjëri nuk kishte informata për digjitalizimin apo përpjekjet për mbrojtjen e fëmijëve. Asnjë nga këto plane veprimi ose raporte nuk përmbante ndonjë analizë gjinore apo informata të ndara sipas gjinisë. Mungesa e transparencës së materialeve të publikuara onlime e bën të vështirë monitorimin e përpjekjeve të qeverisë për të përmbushur përgjegjësitë, duke përfshirë kryerjen e analizës së ndikimit gjinor.

Monitorimi dhe vlerësimi i progresit nga MASHTI në zotimet digjitale, duke përfshirë analizën *ex-post* të ndikimit gjinor, është i pakët. Kjo e bën të vështirë vlerësimin e progresit në këto programe bazuar në informacionin që është në dispozicion publikisht. ETF ka vërejtur se koordinimi ndërinstytucional, monitorimi, llogaridhënia, kapaciteti i dobët institucional në lidhje me financimin dhe kornizat joadekuate të raportimit mbeten të gjitha çështje.¹¹⁵

Komisioni i Kuvendit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë dhe Sport monitoron zbatimin e përgjegjësive dhe programeve nga Qeveria që lidhen me arsimin. Ky Komision ka gjashtë gra (60%) dhe katër burra (40%). Nënperfaqësimi i burrave në këtë Komision mund të pengojë kontributin e tyre në legjislacion drejt një qasjeje më gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme gjinore ndaj digjitalizimit, si dhe në monitorimin e zbatimit të tij. Nga prilli 2021 deri në korrik 2023, Komiteti ka mbajtur 60 takime. Digjitalizimi në arsim u përmend në lidhje me librat,¹¹⁶ inventarin e shkollave dhe krijimin e një kulture të përdorimit të digjitalizimit në klasa,¹¹⁷ digjitalizimin e infrastrukturës shkollore,¹¹⁸ dhe studimin e fizibilitetit të AKA-së për digjitalizim.¹¹⁹ Gjatë takimit të Komisionit, ministri i MASHT-it tha se ligji lejon tekste në formë digjitale dhe për këtë qëllim janë ndarë 6.5 milionë euro.¹²⁰ Komisioni ende nuk ka diskutuar për barazinë gjinore ose buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në lidhje me digjitalizimin.

Sa i përket **pjesëmarrjes së publikut**, kishte informacion të pamjaftueshëm nëse janë mbajtur diskutime publike për të informuar projektligjet e fundit në sektorin e arsimit. Megjithëse, thuhet se disa ligje u “përgatitën” me nxitim, me kohë minimale për konsultim publik.¹²¹ Në nivel komunal, korniza ligjore parasheh mundësi që prindërit dhe nxënësit të angazhohen në qeverisje dhe vendimmarrje në lidhje me arsimin, por pak informata zyrtare ishin ne

115 ETF, [Kosovo Rapid Education Diagnosis \(RED\): Addressing the weak links](#) (*Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta*), 2023, f. 6.

116 Republika e Kosovës, Kuvendi, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë dhe Sport, [Procesverbali \(6 Korrik 2021\)](#), qasur më 28 gusht 2023.

117 Po aty, [Procesverbali \(15 shkurt 2022\)](#) qasur më 28 gusht 2023.

118 Po aty, [Procesverbali \(24 maj 2022\)](#), qasur më 28 gusht 2023.

119 Po aty, [Procesverbali \(7 qershor 2022\)](#), qasur më 28 gusht 2023.

120 Po aty, [Procesverbali \(27 prill 2023\)](#), qasur më 28 gusht 2023.

121 Intervista e RrGK-së me zyrtarin që është i angazhuar në procese, 2021.

dispozicion publikisht në lidhje me masën në të cilën kjo është realizuar ose sa shumë gra, burra, vajzat dhe djemtë kanë marrë pjesë në vendimmarrje. Zgjidhjet digjitale për një angazhim të tillë duket se nuk ekzistojnë.

23% e fëmijëve dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre në lidhje me të drejtat e barabarta për djemtë dhe vajzat.

Në anketën e tij Young Voices, Save the Children zbuloi se 84% e fëmijëve kosovarë mendojnë se është e rëndësishme që politikanët dhe vendimmarrësit të dëgjojnë se çfarë mendojnë fëmijët.¹²² Për më tepër, fëmijët dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre (43%) në lidhje me arsimin dhe shkollën e tyre; ata ndihen kompetent për të dhënë inpute dhe për të kontribuar në vendimmarrje. Më tej, 23% e fëmijëve dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre në lidhje me të drejtat e barabarta për djemtë dhe vajzat. Sondazhi zbuloi se vajzat dhe djemtë mendojnë se kanë mundësi të ngjashme për të ndikuar në shkollën e tyre.

Ka pak informata në lidhje me se deri në çfarë mase prindërit marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me prioritetet e shkollave ose të DKA-së, përfshirë reformat digjitale. Thuhet se shumë shkolla nuk kanë email për të gjithë prindërit, gjë që pengon komunikimin dhe angazhimin e prindërve.¹²³ Sipas Strategjisë së Arsimit 2022-2026, menaxhimi duhet të mbështetet duke forcuar rolin e Bordit Drejtues të Shkollës dhe Këshillit të Prindërve në përmirësimin e shkollave sepse shkëmbimi i përvojave mund të rrisë performancën e shkollës.¹²⁴ MASHTI gjithashtu planifikon të hartojë dhe publikojë udhëzime për përfshirjen dhe mbështetjen e prindërve në arsimin digjital në vitin 2024.¹²⁵ Më pas, MASHTI dhe DKA do të publikojnë raporte për vlerësimin e funksionimit të bordeve drejtuese të shkollave dhe këshillave të prindërve.¹²⁶ Zbatimi i kësaj Strategjie të Arsimit filloi në vitin 2023, kështu që raportet nuk janë ende në dispozicion.

Aftësitë

Sa i përket **disponueshmërisë** së ekspertizës gjinore për të mbështetur reformat, intervistat në përgjithësi sugjeruan që profesionistët e TIK-ut prireshin të mos ishin të vetëdijshëm për barrierat me të cilat përballen gratë dhe vajzat në pjesëmarrjen në transformimin digjital. Ata mund të mos i kenë marrë parasysh pengesat e tilla as gjatë dizajnit të zgjidhjeve digjitale në sektorin e arsimit. Si rezultat i kësaj, mjetet, softuerët dhe programet digjitale mund të mos adresojnë në mënyrë adekuate nevojat e grave, burrave, vajzave dhe djemve. Në vitin 2021, një pjesëmarrës në hulumtim nga radhët e institucioneve vërejti: “E gjithë ekspertiza për çështje gjinore, vie përmes juve [RrGK, dhe], ndërkaq institucionet janë të shtyra në shumicën e rasteve

122 Save the Children, *Young Voices*, 2022. Anketa është realizuar në shtator dhe tetor 2021 me një mostër prej 1300.

123 Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

124 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 57.

125 Po aty, Veprimi 5.4.30.

126 Po aty, Plani i Veprimit, 2022, Veprimi 2.1.6.

[nga aktorët ndërkombëtarë], që të integrojnë perspektivën gjinore siç duhet në ligje”¹²⁷ Pjesëmarrësi në hulumtim sugjeroi se ekspertiza e RrGK-së ka qenë e vetmja ekspertizë gjinore të cilën e ka përdorur MASHTI në planifikimin e ligjeve, politikave dhe programeve. Në vitin 2023, MASHTI raportoi se ZBGJ është e angazhuar në procese.¹²⁸

Kuptimi i pamjaftueshëm i konsideratave gjinore mund të dëmtojë përpjekjet për të integruar vëmendjen ndaj gjinisë në reformat digjitale dhe materialet mësimore. Një zyrtar publik tha se “tradicionalisht, fusha e TIK-ut konsiderohej një fushë vetëm për djem dhe burra; për shkak të normave të socializuara gjinore, vajzat dhe gratë nuk mund të konsideroheshin si profesionistë në këtë fushë.¹²⁹ Një temë e përsëritur mes zyrtarëve të intervistuar ishte se “këto norma gjinore tani kanë pushuar së ekzistuari.”¹³⁰ Megjithatë, dëshmitë në seksionin [Njerëzit](#) më poshtë sugjerojnë të kundërtën. Supozime të tilla nga zyrtarët mund të ndikojnë në vendimin e tyre nëse do të përdorin masa afirmative për të mbështetur gratë e reja për të ndjekur arsimin e mëtejshëm në TIK, siç ilustron nga heqja e masave afirmative si bursat që synojnë vajzat. Stereotipat gjinorë të mbështetur nga mësuesit gjithashtu mund t'i largojnë gratë e reja nga ndjekja e karrierës në TIK. Kjo sugjeron nevojën për trajnime të mëtejshme për rolet, normat dhe marrëdhëniet gjinore për zyrtarët, mësuesit dhe administratorët e shkollave.

Në Strategjinë e Arsimit 2022-2026, MASHTI planifikon të hartojë një udhëzues për përgatitjen dhe ofrimin e programeve të trajnimit në kompetencat digjitale për organizatat arsimore (përfshirë stafin e tyre), i cili do të përmbajë udhëzime për planin digjital të institucionit arsimor, udhëheqjen digjitale, vlerësimin e institucionit, sigurimin e cilësisë në këtë fushë, integrimin gjinor dhe angazhimin e prindërve në edukimin digjital.¹³¹ Një tregues i planifikuar është “përqindja e mësuesve, stafit menaxhues dhe administrativ të institucioneve arsimore dhe studentëve që demonstrojnë kompetencë bazë digjitale në fushat përkatëse që lidhen me rolin e tyre, e ndarë sipas gjinisë”.¹³² Nuk ka asnjë pikënisje, e cila sugjeron se nuk ka pasur ndonjë vlerësim të aftësive digjitale të mësuesve, menaxherëve ose stafit administrativ. Një tregues tjetër është “numri i punonjësve në nivele dhe lloje të ndryshme të institucioneve që mundësojnë realizimin e digjitalizimit dhe përdorimit të teknologjisë në sektorin e arsimit, në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore, të ndarë sipas gjinisë”.¹³³ Pikënisja është “0”, që sugjeron se asnjë punonjës nuk kishte mundur digjitalizimin dhe përdorimin e teknologjisë në sektorin e arsimit që nga viti 2022. Asnjë analizë qeveritare

127 Intervista e RrGK-së me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, 2021.

128 Takimi i RrGK-së me MASHTI-n, 2023.

129 Intervista e RrGK-së me zyrtarin publik, 2021.

130 Intervista e RrGK-së me zyrtarin publik, 2021.

131 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022, f. 85.

132 Po aty, treguesi 4.

133 Po aty, Treguesi 5.

nuk duket të ketë vlerësuar kapacitetet e administratorëve të shkollave dhe mësuesve për digjitalizim ose digjitalizim të përgjegjshëm gjinor.¹³⁴ Asnjë bazë të dhënash apo sistem monitorimi nuk përcjell/gjurmon aftësitë digjitale të mësuesve, trajnimin formal të ofruar ose nevojat e zhvillimit profesional që lidhen me digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor.

MASHTI ka raportuar se 18 mijë mësues janë trajnuar për përdorim të kompjuterit.¹³⁵ MASHTI gjithashtu ka bashkëpunuar me GIZ për të ofruar trajnime për të gjithë mësuesit në shkollat e AAP-së; 40 mësues të TIK-ut u trajnuan në platformën Moodle.¹³⁶ Donatorë të ndryshëm thuhet se kanë ofruar trajnime për digjitalizim, por ky nuk ka qenë i institucionalizuar.¹³⁷ Të dhënat e ndara sipas gjinisë për pjesëmarrësit në trajnim nuk ishin në dispozicion. Vlerësimi i baraspeshës gjinore midis mësuesve që kanë ndjekur trajnime për digjitalizimin, gjininë ose të dyja nuk ishte i mundur duke pasur parasysh mungesën e një baze të konsoliduar e të dhënave të trajnimeve të ndjekura, mbi çfarë dhe nga kush, që përmban të dhëna të ndara sipas gjinisë. Ndërkohë, një pjesëmarrëse në hulumtim vërejti: “Ndarja gjinore fillon më herët. Në arsimin parauniversitar dhe të hershëm mbizotërojnë gratë, dhe në nivelet më të larta burrat.”¹³⁸ Pra, ndjekja e trajnimit të mësuesve është e paracaktuar nga niveli i arsimit që ata japin. Meqenëse gratë në përgjithësi japin mësim në nivele më të ulëta dhe burrat japin mësim në ato më të larta, ato nuk do të përfaqësoheshin në mënyrë të barabartë mes mësuesve që marrin trajnime për digjitalizimin (në bazë gjinore) për grupmoshat e tyre të nxënësve. Përmirësimi i baraspeshës gjinore midis mësuesve në çdo trajnim të ofruar do të kërkonte fillimisht përdorimin e masave afirmative për të punësuar më shumë burra në arsimin e hershëm dhe më shumë gra në nivelet më të larta të arsimit.

Në Strategjinë e Arsimit 2022-2026 thuhet se vlerësimi i performancës së mësuesve (VPM), si një komponent i licencimit të mësuesve, nuk ka “arritur të zbatohet” siç ishte paraparë; vetëm 755 mësues ishin vlerësuar deri në mars 2020.¹³⁹ Asnjë e dhënë e ndare sipas gjinisë për mësuesit e vlerësuar nuk ishte në dispozicion publikisht. Strategjia planifikon të krijojë një sistem të përmirësuar për licencimin e mësuesve, vlerësimin e performancës dhe avancimin në karrierë.¹⁴⁰ MASHTI planifikon të analizojë mundësitë e zbatimit të VPM-ve dhe të funksionalizojë softuerin për sistemin e licencimit.¹⁴¹ Plani i Veprimit përfshin një tregues për të zhvilluar kriteret dhe udhëzimet bazë për

134 Kështu deklaroi MASHTI gjatë një takimi të Nënkomitetit të MSA-së për Politikë Sociale dhe Arsim, 2022; MASHTI konfirmoi se nuk kanë informacion nëse është bërë ndonjë vlerësim i tillë (korrespondencë, tetor 2023).

135 Korrespondenca, tetor 2023.

136 Po aty.

137 Komenti për draft raportin, nëntor 2023.

138 Intervista e RrGK-së me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, 2021.

139 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022, f. 39.

140 Po aty, Qëllimi specifik 2.8.

141 Po aty., f. 68.

VPM-të, duke përfshirë kërkesat bazë të kualifikimit për vlerësuesit e VPM.¹⁴² Shkalla në të cilën vëmendja ndaj kapaciteteve të mësuesve për digjitalizimin ose transformimin e normave gjinore do të përfshihej në vlerësime ishte e paqartë. Ky udhëzues është dashur të publikohej në vitin 2022 në faqen e internetit të MASHTI-t. Në vitin 2023 nuk dukej se ekzistonte asnjë bazë e të dhënave online për institucionet e nivelit vendor dhe qendror për të integruar të dhënat mbi VPM-të.

Për shumicën e treguesve që përfshijnë menaxhimin e të dhënave, Plani i Veprimit i Strategjisë së Arsimit përmend “dokumentet e referuara” për rezultatet e monitorimit në një “bazë të dhënash përkatëse”. Plani i Veprimit nuk përcakton qartë se cilat baza të të dhënave do të përdoren dhe cilat institucione do të jenë përgjegjëse; është e paqartë nëse kjo do të përfshijë një bazë të dhënash të koordinuar. Për shembull, për treguesin “Ngritja e kapaciteteve të DKA-ve për të përmbushur rolin e tyre mbikëqyrës”, referenca është: “Lista e zyrtarëve të trajnuar të DKA-së e marrë nga baza e të dhënave përkatëse”.¹⁴³ It është e paqartë nëse këto baza të dhënash do të përfshijnë tregues që lidhen me gjininë, në drejtim të gjetjes/përcjelljes së grave dhe burrave të vlerësuar, të trajnuar dhe të kualifikuar, duke përfshirë edhe kualifikimet për digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor. Strategjia dhe Plani i Veprimit nuk përmendin konsultimet me ekspertët gjinorë ose OShCG-të për të integruar një qasje të përgjegjshme ndaj gjinisë në kriteret dhe udhëzimet e VPM-së.

MASHTI krijoi një udhëzues të përgjithshëm për organizimin e mësimdhënies në vitin shkollor 2020/2021, gjatë pandemisë, i cili adresonte nevojën për trajnimin e mësuesve, stafit menaxhues të shkollës, stafit mbështetës dhe aktorëve të tjerë. Sipas udhëzuesit, veprimet më urgjente për trajnimin e detyrueshëm për mësimin online ishin koordinimi i DKA-ve për kërkesat dhe nevojat për trajnim për mësuesit; trajnimin e mësuesve për të përdorur platformën e të mësuarit, metodat e mësimdhënies online dhe mjetet e TIK-ut; dhe këshillimin e DKA-ve, mësuesve dhe prindërve që të përdorin mjetet e TIK-ut.¹⁴⁴ Megjithatë, nuk ekzistonte ndonjë plan i detajuar për trajnimin e mësuesve në vitin shkollor 2020/2021.¹⁴⁵ As ndonjë vlerësim i disponueshëm publikisht nuk monitoron zbatimin e udhëzuesit, duke përfshirë analizën e ndikimit gjinor.

Sipas një pjesëmarrësi në hulumtim, “Problemi është se kurrikula nuk zbatohet. Kjo ka të bëjë me trajnimin e mësuesve... se si të mësojnë kurrikulat për aftësitë digjitale... Problemi është se MASHTI nuk ka një strategji për trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve.”¹⁴⁶ Një tjetër pjesëmarrës tha:

142 Po aty, [Plani i Veprimit](#), treguesi 2.8.1.2.

143 Po aty, treguesi 2.1.1.

144 KEC, [Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë](#), 2021.

145 Po aty.

146 Intervista e RrGK-së me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, 2021.

Ne mendojmë se legjislacioni është aty, por qasja është e vjetërsuar dhe duhet të ringjallet me ide dhe njerëz. Natyra e punës dhe e të menduarit... çdo gjë po ndryshon. [...] Digjitalizimi ka një kuptim të vjetër... “Ne do t’ju mësojmë se si të përdorni Excel.” Ne duhet t’u mësojmë atyre mënyra të ndryshme të të menduarit, algoritme t reja të të menduarit.¹⁴⁷

Intervistat sugjeruan se mësuesve mund t’u mungojnë kapacitetet për mësimdhënie në lidhje me digjitalizimin, e lëre më të përfshijnë perspektivën gjinore.

Në lidhje me raportimin e ngacmimeve në internet ose ngacmimeve kibernetike në arsim, përgjegjësitë nuk janë të përcaktuara qartë. Rastet e raportuara nga vajzat duket se mbeten në shkollë, e cila përpiket t’i zgjidhë këto çështje brenda saj. Një nxënëse e shkollës së mesme i tha RrGK-së:

Dy shokë të klasës publikuan fotot e mia online dhe u tallën me mua, dhe unë e raportova rastin në polici. Fillimisht, drejtori i shkollës u përpoq ta mbante çështjen brenda klasës sime dhe rekomandoi që “lajmi të mos përhapej”. Për fat të mirë, kisha prindër mbështetës që më inkurajuan të paraqes rastin. [...] Shokët e mi të klasës u suspenduan për tre javë, por kjo nuk do të thotë asgjë për ta. Në fakt, ata ishin të lumtur që kishin disa ditë pushimi nga shkolla. [...] Shkova dhe fola me psikologun tonë të shkollës, duke menduar se mund t’i besoja asaj pasi ishte grua, dhe ajo përfundoi duke më fajësuar mua për atë që ndodhi.¹⁴⁸

Çdo shkollë duhet të ketë një psikolog dhe një pedagog.¹⁴⁹ Psikologu i shkollës duhet të kontribuojë në të mësuarit dhe të promovojë zhvillimin kognitiv, emocional, social dhe personal. Ata gjithashtu duhet të ndihmojnë në “tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë aktorët e shkollës.”¹⁵⁰ Shkollat nuk kanë mjaftueshëm psikologë dhe përvoja e kësaj vajze, ndër të tjera të ndara me RrGK-në, sugjeron se psikologëve të punësuar mund t’u mungojnë kapacitetet profesionale për të ndihmuar vajzat që përballen me bullizmin kibernetik.¹⁵¹

147 Intervista RrGK-së, gusht 2023.

148 Informacion i ndarë me RrGK në mënyrë joformale, 2023.

149 Republika e Kosovës, [Udhëzimi Administrativ MASHT nr. 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla](#), 2014.

150 Po aty, neni 16.

151 Meritë Krasniqi, “[I paraportuar dhe i injoruar, bullizmi përndjek nxënësit e Kosovës](#)”, *Kosovo 2.0*, 10 dhjetor 2019.

Drejtorët e institucioneve të arsimit parauniversitar duhet të regjistrojnë rastet e raportuara të dhunës në shkollë dhe t'i përcjellin në DKA.¹⁵² DKA-të duhet t'i dorëzojnë raportet përmbledhëse MASHTI-t, si institucioni përgjegjës për analizimin dhe publikimin e të dhënave. DKA-të janë gjithashtu të obliguara që:

Të vlerësojnë dhe luftojnë dhunën në institucionet parauniversitare në mënyrë efektive; të bashkëpunojnë me ministritë përkatëse për të krijuar strategji për rehabilitimin dhe integrimin social të shkelësve të mitur; të punojnë me Këshillat e Prindërve dhe Nxënësve të Kosovës për të avokuar për të drejtat e fëmijëve në arsim; [dhe] të ndihmojnë institucionet parauniversitare në vlerësimin e situatës së tyre të sigurisë.¹⁵³

Hulumtimet sugjerojnë se këto përgjegjësi nuk janë zbatuar, se drejtorët e shkollave hezitojnë të raportojnë rastet e bullizmit dhe se vetëm rastet e rënda raportohen në DKA-të.¹⁵⁴ Gjatë tryezave, “përfaqësuesit e DKA-së [pohuan se] rastet e ngacmimit shpesh mbahen sekret sepse, nëse raportohen, ato do të reflektonin negativisht në performancën e përgjithshme të shkollës”, tha Arbër Maliqi nga Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë për median Kosovo 2.0.¹⁵⁵ Ai tha se raste të tilla kategorizohen si të rënda vetëm kur kanë të bëjnë me dhunë fizike, por ngacmimet verbale nuk raportohen. Kjo sugjeron që shkollave dhe DKA-ve mund t'u mungojnë kapacitetet për të trajtuar rastet e ngacmimit në internet, bullizmit dhe dhunës që prek fëmijët në shkollë. Është e paqartë nëse profesionistët përgjegjës për trajtimin e rasteve të tilla kanë ndjeshmëri dhe profesionalizëm të mjaftueshëm gjinor.

Shërbimet Publike Digjitale

MASHTI ka një faqe interneti funksionale, të përditësuar shpesh, në dispozicion në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe.¹⁵⁶ Megjithatë, jo të gjitha strategjitë, vendimet dhe dokumentet janë në dispozicion në tri gjuhë. Për shembull, Plani i Veprimit i Strategjisë së Arsimit 2022-2026 është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe. Të dhënat e ndara sipas gjinisë mund të gjenden për numrin e bursave të dhëna për universitete, si dhe për personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat etnike, sipas emrit dhe mbiemrit të përfituesve.¹⁵⁷ Informacione specifike të ndara sipas gjinisë për bursat e lidhura me TIK nuk

152 Republika e Kosovës, Qeveria, [Rregullore QRK - nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar](#), 2013.

153 Po aty.

154 Meritë Krasniqi, “[I paraportuar dhe i injoruar, bullizmi përndjek nxënësit e Kosovës](#)”, *Kosovo 2.0*, 10 dhjetor 2019.

155 Po aty.

156 MASHTI, [faja e internetit](#), qasur më 29 gusht 2023.

157 Po aty.

janë në dispozicion. Imazhet në faqen e internetit tregojnë gra, burra, vajza dhe djemë. Gjuha dhe imazhet e përdorura janë të **ndjeshme gjinore**.

Pandemia e COVID-19 kontribuoi në ndërprerje të mëdha në arsim dhe katapultoi përpara procesin e digjitalizimit të sistemit arsimor. Shkollat u mbyllën më 13 mars 2020 kur rasti i parë lokal me COVID-19 u regjistrua¹⁵⁸ dhe u rihapën më 14 shtator 2020 nën masa të rrepta distancimi dhe maskash.¹⁵⁹ Lindi nevoja urgjente për të kaluar të gjithë mësimdhënien fizike në mësimdhënie virtuale përmes platformave online. Kjo sfidoi mënyrën tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënësve, duke i vendosur mësuesit dhe nxënësit në situata të vështira.¹⁶⁰ Gjatë fazës së mbylljes, disa materiale mësimore u shpërndanë përmes platformave online dhe disa mësimet në lëndët bazë u transmetuan në televizion. MASHTI punoi me kompani për t'u ofruar nxënësve kompjuterë dhe qasje falas në internet.¹⁶¹ Mësimi në distancë u praktikua nëpërmjet platformave online pasi Qeveria miratoi Masterplanin për vitin shkollor 2020-2021.¹⁶² Plani kishte tre skenarë për të mësuarit online: mësimdhënie në shkolla, mësim i kombinuar nëpërmjet platformave online dhe shkollave, dhe mësimin online dhe në distancë. Janë marrë masa në bazë të rreziqeve që paraqiste pandemia në çdo vend.¹⁶³

Që nga viti 2009, MASHTI ka një Platformë e-Mësimi, e cila ofron burime për mësuesit për të mësuar metoda novatore të mësimdhënies për shkollat e AAP-së, ofron qasje më të lehtë për mësuesit dhe nxënësit në arsimin formal parauniversitar dhe synon të “modernizojë sistemin arsimor të Kosovës”.¹⁶⁴ Nxënësit dhe prindërit gjithashtu kanë mundur të përdorin Platformën, dhe ajo kishte afërsisht 100,000 përdorues deri në vitin 2019.¹⁶⁵ Platforma e Edukimit nuk duket të jetë aktive tani. E krijuar para pandemisë, Platforma nuk i plotësonte të gjitha nevojat e mësimin online, pasi Qeveria u mobilizua për të krijuar një platformë tjetër për shkollimin online, të njohur si “e- Mësimi”.¹⁶⁶ Që nga dhjetori 2021, Kosovës i mungonte një qasje e konsoliduar kombëtare për mësimin elektronik. “Ekzistojnë shumë platforma të ndryshme, dhe ato nuk janë të kombinuara, kështu që është një rrëmujë”, tha një zyrtar për RrGK-në. “MASHTI duhet të zotërojë iniciativat dhe të ketë prioritet se cili model do

158 RrGK, “*Pandemia nuk njeh gjini?*”, 2020.

159 KTV, “*Rritet shqetësimi për mbyllje të shkollave pas rezultimit me COVID-19 të mësuesve në Prishtinë*” 28 shtator 2020, qasur më 8 tetor 2023.

160 ETF, *Education, Training and Employment Developments*, [Zhvillimet në arsim, trajnim dhe punësim], 2020.

161 Po aty, f. 7.

162 Republika e Kosovës, Qeveria, *Programi i reformave ekonomike 2021-2023*, 2021, f. 95.

163 Po aty, f. 96.

164 ETF, “*Digital skills and online learning in Kosovo*” [Shkathtësitë digjitale dhe mësimi online në Kosovë], 2020 f. 4.

165 Po aty.

166 RrGK nuk mundi të gjente ndonjë vendim për datën e saktë se kur u bë funksional, por publikimet dhe postimet u bënë pjesë e **platformës** në vitin 2021.

të jetë modeli kombëtar”¹⁶⁷ RrGK u përpoq të siguronte informacion mbi përparimin e mëtejshëm të arritur.

Një zyrtar i MASHTI-t tha se ata kishin planifikuar reagimin ndaj COVID-19 “për të plotësuar nevojat e njerëzve në përgjithësi”.¹⁶⁸ Ata nuk morën parasysh nevojat potencialisht të ndryshme të vajzave, djemve, grave dhe burrave. Zyrtarët supozuan se masat edukative ishin **neutrale gjinore**, duke deklaruar se ato ishin “të drejta”, duke i trajtuar të gjithë njësoj.¹⁶⁹ Megjithatë, vajzat dhe djemtë mund të mos kenë pasur qasje të barabartë në shkollim duke pasur parasysh numrin e kufizuar të televizorëve, tabletave dhe mjeteve digjitale në familjet e tyre.¹⁷⁰ Para se mësuesit të fillonin edukimin televiziv ose online, MASHTI nuk kishte analizuar kushtet shtëpiake të familjeve për të siguruar që teknologjia do të ishte e disponueshme. As nuk mori parasysh se si programi i ri online dhe përmbajtja e tij mund të përdoret për të transformuar pabarazitë gjinore. Masat mbrojtëse ishin gjithashtu të pamjaftueshme.

Në vitin 2023, MASHTI raportoi se ofronte mësim në distancë të përshtatur për nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara nëpërmjet platformave elektronike si Zoom, Google Meet, Google Classroom, Facebook dhe Viber.¹⁷¹ Divizioni për Arsimit Gjithëpërfshirës koordinoi mësimin në distancë për nxënësit me nevoja të veçanta. Qendrat burimore kanë këshilluar prindërit, mësuesit dhe asistentët për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta, duke përfshirë materialet dhe videot pedagogjike online. I mbështetur nga UNICEF-i dhe Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, MASHTI ka ofruar shërbime psikosociale dhe edukative online, duke angazhuar 43 terapeutë me profile të ndryshme. U krijua një platformë “edukimi gjithëpërfshirës” për të “siguruar mundësi për zhvillimin socio-emocional dhe konjitiv të fëmijëve me nevoja të veçanta”.¹⁷² Platforma ofron aktivitete edukative për fëmijët dhe materiale për prindërit/kujdestarët ligjorë, mësuesit dhe asistentët e fëmijëve me nevoja të veçanta.¹⁷³

MASHTI duket se ka nënshkruar më shumë se 50 marrëveshje me shkollat profesionale për të bashkëpunuar nëpërmjet një platforme digjitale të quajtur “The Future Workplace”, me fokus në TIK.¹⁷⁴ Platforma synon të lehtësojë të kuptuarit e tregut të TIK-ut duke gjurmuar të dhënat e ofertës dhe kërkesës, duke ofruar njohuri se si sistemi arsimor duhet të modifikohet për t’iu përshtatur kërkesave të tregut dhe duke ofruar një shteg për eksplorimin

167 Intervista e RrGK-së, dhjetor 2021.

168 RrGK, “*Pandemia nuk njeh gjini*”, 2020.

169 Po aty.

170 Shih seksionin [Njerëzit](#) të këtij kapitulli.

171 Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

172 Po aty.

173 RrGK nuk mundi ta gjente platformën online, por ajo mund të jetë vetëm për përdorim të brendshëm.

174 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2020-2022](#), 2020, f. 94.

e kapaciteteve njerëzore të TIK-ut në Kosovë.¹⁷⁵ Future Workplace është një mjet digjital i drejtuar nga të dhënat, i ndërtuar nga Fondacioni Millenium Kosova (MFK) / MCC dhe i zbatuar nga Open Data Kosova (ODK) dhe Oda Ekonomike e Kosovës. Të dhënat e platformës përfshijnë atë që studentët e TIK-ut po mësojnë në shkollën e mesme dhe universitet, numrin e të diplomuarve në TIK, në cilat aktivitete angazhohen bizneset e TIK-ut, sa fitojnë bizneset e TIK-ut dhe cilat aftësi kërkohen për TIK-un. MASHTI, ATK, ODK, Oda Ekonomike e Kosovës dhe bizneset vendore të TIK ofrojnë të dhëna për të mbushur platformën. Të dhënat mund të gjenden vetëm nga viti 2015. Platforma ofron disa të dhëna të ndara sipas gjinisë, si numri i të diplomuarve

në shkollat e mesme dhe universitetet e TIK. Megjithatë, të dhënat e ndara sipas gjinisë mund të ishin futur në seksionet Statistika, Të dhënat e Kompanisë dhe Të dhënat e të diplomuarve. Kjo mund të sigurojë njohuri për gratë dhe burrat e përfshirë ose që hyjnë në tregun e TIK-ut. Informacioni mbi pagat mesatare për gratë dhe burrat gjithashtu mund të jetë faktorë motivues të dobishëm, duke shfaqur performuesit më të mirë në mbështetjen e barazisë gjinore në TIK.

MASHTI duket se ka nënshkruar më shumë se 50 marrëveshje me shkollat profesionale për të bashkëpunuar nëpërmjet një platforme digjitale të quajtur “The Future Workplace”, me fokus në TIK

MASHTI krijoi një platformë tjetër të quajtur Busulla.com, e cila kishte për qëllim të ofronte udhëzime profesionale, burime arsimore dhe këshillim për karrierë.¹⁷⁶ Megjithatë, kjo platformë kishte periodikisht vështirësi teknike.¹⁷⁷ Në vitin 2020, Busulla botoi një libër të quajtur “Këshillim dhe orientimi në karrierë përmes Busulla.com”.¹⁷⁸ Gjinia nuk merret parasysh në mënyrë eksplicite në asnjë nga katër modulet e saj.¹⁷⁹ Duke pasur parasysh rolet dhe stereotipat gjinorë, gjinia mund të ndikojë në mundësitë e karrierës, të tilla si gratë që regjistrohen në TIK ose burrat që kërkojnë kualifikime për të punuar në sektorin e arsimit. Prandaj,

këshillimi për karrierë online mund të synojë të largojë stereotipat gjinorë kur këshillon nxënësit, vajzat dhe djemtë, për profesionet e mundshme, veçanërisht të lidhura me profesionet që aktualisht janë të ndara sipas gjinisë. Libri rendit vlera të shumta që duhet të merren parasysh kur zgjidhet një mjedis i punës. Asnjë nuk e përmend barazinë gjinore. Edhe pse barazia gjinore

175 Po aty, dhe The Future Workplace, “[About the future workplace](#)” [Rreth vendit të punës në të ardhmen], qasur më 17 gusht 2023.

176 Busulla, [Këshillimi dhe orientimi në karrierë përmes Busulla.com](#) libri, qasur më 31 gusht 2023.

177 Në gusht 2023, në faqen e internetit thuhej, “Platforma didaktike për edukimin në karrierë, Busulla.com, nuk është aktualisht në dispozicion për shkak të ndërprerjes së përkohshme të shërbimit si rezultat i detyrimeve të papaguara të mirëmbajtjes dhe borxhit të akumuluar”. (Busulla.com, qasur më 31 gusht 2023).

178 Po aty.

179 Po aty. Modulet përfshijnë: Modulin 1: Busulla.com - 5 hapat e orientimit në karrierë, Moduli 2: Vlerësimi i mundshëm dhe interpretimi i rezultateve të testit të vetëvlerësimit, Moduli 3: Roli i Busulla.com në arritjen e objektivave të orientimit në karrierë të përshkruara në kornizën kurrikulare dhe në kurrikulën bazë dhe Moduli 4: Aktivitete të paraplanifikuara shkollore për arritjen e objektivave të ndërlidhura të orientimit në karrierë.

nuk është domosdoshmërisht një vlerë e shtuar e një punonjësi, religjioni është i cekur, i cili mund të kontribuojë në përjashtimin e grave, burrave, vajzave dhe djemve që i përkasin një feje specifike ose që nuk janë religjiozë. Kjo mund të përforcojë bindjet se vendet e punës vlerësojnë individët fetarë dhe i japin përparësi punësimit të tyre. Më tej, pasi ky libër është krijuar nga Busulla.com, i menaxhuar nga MASHTI, libri është dashur të pasqyrojë sekularizmin, siç përcaktohet me Kushtetutën e Kosovës.¹⁸⁰

Menaxhuar nga MASHTI që nga prilli 2023, Sistemi Informativ i Kosovës për Kërkime (SIKK) shërben si një depo për informacione mbi kërkimin, duke përfshirë modulet për institucionet kërkimore, hulumtuesit, publikimet, projektet dhe revistat.¹⁸¹ Ai synon “të shërbejë si burim provash” për politikëbërësit në Qeveri dhe IAL-të mbi treguesit kryesorë të kërkimit. Ai do të sigurojë të dhëna për patentat, projektet kërkimore dhe publikimet për të informuar politikëbërjen, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve kërkimore. SIKK kërkon që hulumtuesit në Kosovë të regjistrojnë dhe ngarkojnë publikimet e tyre kërkimore dhe shkencore. Informacioni në lidhje me gjininë e studiuesve të regjistruar nuk është i disponueshëm publikisht. Një kërkim për termin “gjini” rezulton në botime akademike.

Përveç koordinimit të proceseve dhe platformave të mësimin elektronik, **DKA**-të duket se nuk ofrojnë shërbime publike digjitale në nivel komunal.

Në lidhje me **AAP**-në, RrGK nuk gjeti shërbime publike digjitale të ofruara për studentët. Pavarësisht investimeve të konsiderueshme të donatorëve, shkollave profesionale u mungojnë materialet adekuate të mësimdhënies dhe të mësuarit, gjë që ka ndikuar negativisht në cilësinë e AAP-së.¹⁸² Kjo gjithashtu ndikon në progresin në ofrimin e shërbimeve publike online. Sistemi i AAP-së nuk ofron shërbime këshillimi dhe udhëzime në karrierë në institucionet arsimore dhe shërbimet publike të punësimit.¹⁸³ Kjo sugjeron që shërbimet e këshillimit online nuk janë gjithashtu në dispozicion.

Universiteti i Prishtinës përdor Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS).¹⁸⁴ Ai është në dispozicion vetëm në gjuhën shqipe. Studentët Bachelor, Master dhe PhD mund të përdorin SEMS për të parë orarin e ligjëratave, provimeve dhe rezultateve të provimeve, si dhe për të pranuar ose refuzuar notat. SEMS përdoret për të aplikuar për provime, ID dhe punë si staf akademik, si dhe për diploma ose verifikim dokumentesh. Pagesat e universitetit gjithashtu mund të përpunohen.¹⁸⁵ Duket se nuk lejon regjistrimin

180 Republika e Kosovës, [Kushteta e Republikës së Kosovës](#), neni 8, “Shteti laik”.

181 Republika e Kosovës, [SIKK](#), 2022-2023, qasur më 7 dhjetor 2023. Informacioni në këtë paragraf është marrë nëpërmjet korrespondencës me mbështetësit e SIKK, tetor 2023.

182 Aliu, Jetë, Ema Rraci dhe Kushtrim Bajrami, [Arsimi dhe aftësimi profesional në Kosovë: Sfidat dhe mundësitë](#), KEEN: 2019.

183 Po aty.

184 Universiteti i Prishtinës, [SEMS](#), qasur më 9 tetor 2023.

185 Po aty.

në klasa. Sipas të dhënave të SEMS, numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2023/2024 ishte 4270, ku përfshihen 2913 gra (68%) dhe 1357 burra (32%).¹⁸⁶ Të dhënat tregojnë se 151 studentë janë gra (3.5%) dhe 204 burra (4.8%) në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike; Në këtë Fakultet janë regjistruar pak më shumë burra (57%) sesa gra (43%).

Të dhënat tregojnë se 151 studentë janë gra (3.5%) dhe 204 burra (4.8%) në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike.

Universiteti i Prishtinës ka një Zyrtar për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimet dhe Sulmet Seksuale përgjegjës për trajtimin e rasteve të ngacmimeve seksuale, duke përfshirë “thirrjet ngacmuese, përfshirë mesazhet me tekst përmes telefonit, mesazhet e pranuar në mënyrë elektronike, media sociale, apo aplikacione dhe mjete të tjera komunikimi”.¹⁸⁷ Zyrtari u emërua në vitin 2022.¹⁸⁸ Baza e të dhënave për regjistrimin e raporteve me të dhëna në bazë të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar është duke u zhvilluar dhe pritet të kompletohet së shpejti, në bashkëpunim me Zyrën e TI-së në Universitetin e Prishtinës.¹⁸⁹ Nga emërimi i Zyrtarit deri në shtator 2023, ajo kishte marrë pesë raste të ngacmimeve seksuale ndaj grave, të trajtuara duke përdorur Rregulloren përkatëse.¹⁹⁰ Vetëm një rast kishte elemente të bullizmit kibernetik. Zyrtari e ka ndarë Rregulloren me studentët, administratorët, pedagogët dhe stafin akademik përmes emailit. Dekanët kanë ofruar qasje të lidhur me Rregulloren në faqen e internetit të Universitetit, dhe faqja e internetit i secilës njësi akademike ka përfshirë Rregulloren që mundëson qasje në informacion.¹⁹¹ Një email zyrtar ekziston në faqen e internetit të Universitetit për raportimin e rasteve, i cili u është ndarë studentëve dhe stafit përmes emailit.¹⁹²

AAK digjitalizoi procesin e akreditimit në vitin 2021, duke krijuar një mjet të quajtur e-Akreditim.¹⁹³ Digjitalizimi ka rritur transparencën e rezultateve të akreditimit dhe ka mundësuar një proces më të shpejtë akreditimi.¹⁹⁴

186 Të dhënat SEMS, qasur më 9 tetor 2023.

187 Universiteti i Prishtinës, [Rregullore për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Universitetin e Prishtinës](#), 2021, qasur më 5 dhjetor 2023.

188 Gentiana Ahmeti, “UP me zyrtar për parandalimin e mbrojtjen nga ngacmimet seksuale”, Kallxo.com, 10 shkurt 2022.

189 Korrespondenca e RrGK-së me Zyrtarin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimet dhe Sulmet Seksuale, shtator 2023.

190 Po aty. Universiteti i Prishtinës, [Rregullore për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Ngacmimi Seksual në Universitetin e Prishtinës](#), 2021, neni 7, qasur më 5 dhjetor 2023.

191 Po aty.

192 Po aty. E-mail-i është: report.case@uni-pr.edu.

193 Republika e Kosovës, MASHTI, AKA, “[Programet e akredituara të studimit](#)”, qasur më 6 nëntor 2023. Gjithashtu, korrespondencë me përfaqësuesit e ALLED, tetor 2023. ALLED mbështeti zhvillimin e saj me kërkesë të AKA-së.

194 Po aty.

Financimi dhe Prokurimi

Në përgjithësi, arsimiti përbën 4% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) dhe 13% të shpenzimeve totale të qeverisë.¹⁹⁵ Qeveria e konsideron arsimin digjital prioritet në KASH për 2023-2025.¹⁹⁶ Prioritetet e tij përfshijnë harmonizimin e AAP-së me IT-në dhe zhvillimet e tregut të punës, përdorimin e zgjidhjeve digjitale për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe përdorimin e teknologjisë digjitale për të përmirësuar cilësinë dhe shërbimet e arsimit. Planet buxhetore parashikojnë investime për të mbështetur digjitalizimin, në bashkëpunim me aktorë të tjerë (AIS). Kostoja totale e parashikuar për zbatimin e Strategjisë së Arsimit është 322,847,140 €, nga të cilat 51,664,751 € (16%) janë planifikuar për digjitalizimin e arsimit.¹⁹⁷ Shpenzimet e planifikuara në KASH janë të pamjaftueshme për përmbushjen e ambicieve të përcaktuara në Strategjinë e Arsimit 2022-2026; gjysma e kostove të digjitalizimit nuk mbulohen, duke rrezikuar kështu zbatimin.¹⁹⁸ Edhe pse Plani i Veprimit i Strategjisë ka disa tregues që i referohen gjinisë, nuk mund të matet shumica e buxhetuar për gratë dhe burrat duke përdorur buxhetimin e përgjeshëm gjinor.

Në SKZH 2016-2021 thuhet se përgjithësisht financimi i qeverisë për sistemin arsimor ka qenë “jo sistematik” se sa i bazuar në “ndonjë tendencë demografike apo vlerësim të nevojave për zhvillimin e kapaciteteve të mësimdhënies [...] duke e bërë të vështirë parashikimin e tendencave dhe nevojave me kohë.”¹⁹⁹ ETF ka theksuar nevojën për decentralizimin e menaxhimit financiar nëpërmjet DKA-ve.²⁰⁰ Aktualisht, buxheti i nivelit qendror mbetet mbështetësi kryesor i sektorit, pavarësisht modelit të decentralizuar: ai siguron gati 93% të buxhetit të sektorit, ndërsa komunat kontribuojnë vetëm 5% nga burimet e tyre. Mesatarisht, kjo përfaqëson vetëm një të gjashtën e burimeve të tyre, me mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet komunave. Formula aktuale e financimit të qeverisë nuk merr parasysh të dhëna të sakta, shkallën e shkollave dhe dallimet në nevojat e shkollave të AAP-së; në veçanti, të dhënat e komunave me shumicë serbe janë para disa vjetëve.²⁰¹

MASHTI thuhet se është një nga institucionet e Kosovës që përfiton më së shumti nga financimi i donatorëve. Megjithatë, nuk ka një regjistrim të qartë dhe të përditësuar rregullisht të të gjitha kontributeve të donatorëve.²⁰² Kjo

195 ETF, *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the weak links (Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta)*, 2023.

196 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2023-2025*, 2022.

197 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, Qëllimi i strategjisë 5, Tabela 3.

198 ETF, *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the weak links (Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta)*, 2023, f. 35.

199 Republika e Kosovës, Qeveria, OPM, *Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH)*, 2016, f. 15.

200 ETF, *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the weak links (Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta)*, 2023, f. 6.

201 Po aty.

202 Po aty.

pengon konsolidimin e burimeve për sektorin e arsimit dhe kufizon aftësinë e MASHTI-t për të marrë vendime të bazuara në dëshmi. Ndërkohë, kjo dëshmon një udhëheqje joadekuate. ETF arriti në përfundimin se mungesa e të dhënave financiare lehtësisht në dispozicion dhe koordinimi ndërinstucional janë probleme kyçe, që ndikojnë në nivel makro (MASHTI), në nivel të mesëm (DKA) dhe në nivel mikro (shkolla), duke përfshirë kompetencat e prokurimit dhe auditimit.²⁰³

MASHTI menaxhon financimin e AAP-së, duke përfshirë partneritetin publiko-privat. MFPT gjithashtu luan një rol kyç në burimet financiare.²⁰⁴ Anketa e Barometrit Kosovar të AAP-së zbuloi se një nga sfidat kryesore me të cilat përballen shkollat e AAP-së është buxheti i pamjaftueshëm.²⁰⁵ Prandaj, janë bërë përpjekje për të mbështetur formula të përmirësuar për buxhetimin e shkollave të AAP-së. Formulatat online për planifikimin financiar për AAP-në nuk përfshijnë aktualisht buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.²⁰⁶

Si rezultat i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-2021, Qeveria themeloi një fond për të mbështetur shkollimin e vajzave dhe grave në fushat teknike ku ato kanë qenë të nënpërfaqësuar historikisht, përmes të cilit MASHTI, universitetet dhe shkollat profesionale kanë ofruar 190 bursa për gra dhe vajza ndërmjet vitit 2017 dhe 2022.²⁰⁷ Shuma e shpenzuar nuk ishte në dispozicion. Më pas, MASHTI raportoi dhënien e 40 bursave për vajza në TIK për vitin akademik 2020/2021.²⁰⁸ Në po të njëjtin vit, në bashkëpunim me Qeverinë e Hungarisë, MASHTI dha 50 bursa të plota për studime në universitetet hungareze, duke përfshirë 25 bursa për nivelin bachelor për 14 gra të reja dhe 11 burra të rinj me shtatë bursa për gra në shkenca kompjuterike; 20 bursa për programin master për një baraspeshë gjinore të burrave dhe grave; dhe pesë bursa për doktoratë për dy gra dhe tre burra. Në vitin 2021, MASHTI siguroi 1 milion euro për bursa STEM nga të cilat përfituan 812 gra të reja që u regjistruan në vitin e parë të studimeve; 14 studentë (13 gra dhe një burrë) me nevoja të veçanta morën bursa për STEM në vlerë prej 700 € për secilin, gjithsej prej 9,800 € për studime bachelor (13) dhe master (një). Ndërkohë, janë ndarë 1,799 bursa për studentë “elitë” në IAL-të publike në vlerë prej 700€ secila, në total prej 1,259,300€ (66% për gra, 34% për burra); ishte e paqartë nëse këto kishin të bënin me TIK-un. Në vitin 2022, 106 bursa kishin për qëllim të inkurajonin vajzat të ndiqnin profilet teknike dhe djemtë për të

203 Po aty.

204 Mbështetja e Bashkimit Evropian për Rikualifikimet. Profesionale dhe Profesionet në Arsimin dhe Aftësimin Profesional (ESVETPRO), “Rreth AAP”, qasur më 28 gusht 2023.

205 Aligning Education for Employment- Përafrimi i Arsimit për Punësim (ALLED²), [Raporti i Barometrit të AAP-së së Kosovës 2021-2022](#), 2022, qasur më 28 gusht 2023. Për më shumë informata, shih kapitullin 5.

206 ALLED², [Planifikimi Financiar për Sistemin AAP në Kosovë: Propozim për Përmirësim](#), 2020, qasur më 28 gusht 2023. Për më shumë informata, shih seksionin vijues [Infrastruktura](#).

207 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGj, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), 2020. Kjo lidhet me Aktivitetin 1.14.

208 Të gjitha informatat në këtë paragraf janë nga korrespondenca me MASHTI-n, tetor 2023.

fituar aftësitë e nevojshme për tregun e punës, në vlerë prej 500 € në vit; dhe janë dhënë përafërsisht 3,365 bursa STEM në vlerë prej 1,000 € secila. MASHTI gjithashtu ka mbështetur STIKK në promovimin e arsimimit të vajzave në TIK përmes trajnimeve dhe mentorimit, si dhe bursave për vajzat

Informacioni se si u zgjodhën pranuesit nuk ishte publikisht i disponueshëm, kështu që është e paqartë nëse kishte masa afirmative për vajzat romë, ashkali, egjiptiane, me aftësi të kufizuara apo nga fshati. Ndërkaq, 750 nxënës të shkollave të mesme romë, ashkali dhe egjiptianë kanë përfituar bursa në vitin shkollor 2018/2019, me një vlerë prej 48% më shumë se në vitin 2017/2018.²⁰⁹ Prapë, të dhënat e ndara sipas gjinisë për përfituesit nuk ishin në dispozicion, si dhe informacioni për fushat e studimit ose kriteret për përzgjedhjen e fituesve. Fakti që Kosova nuk përdor buxhetimin programor e bën të vështirë arritjen e një vlerësimi të saktë të shumës së përgjithshme të fondeve të shpenzuara për bursa, e lëre më për vajzat dhe djemtë. Vetëm informacione të pjesshme për përfituesit gjenden në raporte të ndryshme pa informacion të saktë buxhetor të ndarë sipas gjinisë.

Asnjë nga informacionet mbi buxhetin apo shpenzimet e MASHTI-t nuk përfshin buxhetim të përgjegjshëm gjinor. KASH 2024-2026 përmend buxhetimin gjinor si një komponent që synon promovimin e disiplinës fiskale në institucionet qendrore dhe lokale.²¹⁰ Megjithatë, MASHTI nuk ka zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në KASH apo buxhetin e tij. Prandaj, përkundër zotimeve të Qeverisë për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, asnjë nga informacionet mbi shpenzimet e planifikuara nuk është i ndarë sipas gjinisë. Në raportin e auditimit të pasqyrave financiare vjetore të MASHTI-t për vitin 2022, buxheti i përgjegjshëm gjinor nuk është përfshirë.²¹¹ As komisionet mbikëqyrëse, përkatësisht Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere dhe Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë dhe Sport, nuk e kanë përmendur ndonjëherë buxhetin e përgjegjshëm gjinor në takimet e tyre.²¹²

Dosjet e tenderit për **e-prokurimin** nuk përmbajnë asnjë deklaratë që inkurajon bizneset në pronësi të gjinive të nënpërfaqësuar të aplikojnë. As nuk parashohin masa afirmative për kompanitë që punojnë për të avancuar më tej barazinë gjinore brenda tyre.

209 Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, [Raporti i Vlerësimit Afatmesëm 2017-2019 mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021](#), f. 24, qasur më 13 dhjetor 2023.

210 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026](#), 2023, f. 19, qasur më 18 shtator 2023.

211 Republika e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2022](#), qasur më 18 shtator 2023.

212 Rishikimi nga RrGK-ja i transkriptove nga takimet e Komisionit, i bërë në gusht 2023.

Ky seksion shqyrton statusin e lidhjes së internetit, harduerit dhe softuerit që mbështesin digjitalizimin e arsimit nga perspektiva gjinore. Ai trajton shkurt ekosistemin e inovacionit.

Lidhja e internetit

Interneti me shpejtësi të lartë është një parakusht i domosdoshëm për mundësitë konkurruese të mësimi digjital, duke përfshirë teknologjinë Classroom 3.0. Përkundër disponueshmërisë së gjerë të internetit në Kosovë, përdorimi i teknologjisë në klasa ka qenë i kufizuar nga mungesa e **infrastrukturës së lidhjes me internetin, mjeteve digjitale** (p.sh., laptopë, tablet, telefona inteligjentë) dhe udhëzime për mësimin digjital online²¹³ Zgjerimi i ngadalshëm i infrastrukturës së internetit me brez të gjerë, veçanërisht shpërndarja e tij e pabalancuar midis zonave urbane dhe rurale, ka ndikuar në produktivitetin dhe mundësitë për punën në distancë të mësuesve dhe të mësuarit digjital.²¹⁴ Në vitin 2022, vlerësohet se vetëm rreth 38% e shkollave ishin të pajisura me kompjuterë të lidhur në internet, duke përfshirë 31% të shkollave në zonat rurale dhe 48% të shkollave urbane.²¹⁵ Pandemia COVID-19 vuri në pah infrastrukturën e pamjaftueshme dhe përshpejtoi përmirësime në infrastrukturën digjitale në dispozicion në shkolla. Mbështetur nga Projekti KODE i financuar nga Banka Botërore, i zbatuar nga Ministria e Ekonomisë, 107 shkolla u lidhën me internetin me shpejtësi të lartë në vitin 2023.²¹⁶ Pavarësisht progresit, sipas ETF, “çështja e infrastrukturës dhe kapacitetit digjital të shkollave është pengesa e parë për digjitalizimin e arsimit”.²¹⁷ Veçanërisht, Strategjia e Arsimit 2022-2026 e ka njohur këtë çështje dhe në vitin 2023 MASHTI ka planifikuar të ndajë 6.3 milionë euro për pajisjen e shkollave me pajisje TIK. t.²¹⁸

Në vitin 2022, vlerësohet se vetëm rreth 38% e shkollave ishin të pajisura me kompjuterë të lidhur në internet.

Mjetet dhe softuerët digjital

Raportohet se nuk është bërë asnjë vlerësim sistematik i nevojave për harduer dhe TI, e lëre më analiza gjinore.²¹⁹ Përveç pajisjes së shkollave me kompjuterë, një pjesëmarrës në hulumtim vërejti se shumica e të rinjve kanë telefona inteligjentë; në vend të ruajtjes së ndalesës së tanishme universal për

213 ETF, “[Digital skills and online learning in Kosovo](#)”, [Shkathtësitë digjitale dhe mësimi online në Kosovë] 2020, f. 5; dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës, [Mësimi në distancë, e-Mësimi në Institucionet Parauniversitare të Kosovës në rrethanat e COVID-19](#) .2020.

214 Po aty.

215 UNDP, [Digital Household Survey](#), 2022.

216 Banka Botërore, komunikatë për shtyp, “[Every Village in Kosovo Now Connected to High-Speed Broadband Internet, With World Bank Support](#)” [Çdo fshat në Kosovë tani është i lidhur me internetin me brez të gjerë me shpejtësi të lartë, me mbështetjen nga Banka Botërore], 2023, qasur më 5 dhjetor 2023.

217 ETF, [Kosovo Rapid Education Diagnosis \(RED\): Addressing the weak links \(Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta\)](#), 2023, f. 4.

218 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i reformave ekonomike 2023-2025](#), 2023, f. 123.

219 Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

telefonat inteligjentë në klasa, institucionet arsimore mund të konsiderojnë se si përdorimi i mbikëqyrur dhe i moderuar i telefonave inteligjentë mund të lehtësojë mësimin, duke punuar me mjetet digjitale që të rinjtë i kanë dhe i përdorin tashmë.²²⁰

Strategjia e Arsimit 2022-2026 pranon se pavarësisht përmirësimeve, mbetet shumë punë për digjitalizimin e sektorit të arsimit, duke përfshirë investimet në infrastrukturë dhe digjitalizimin e të dhënave.²²¹ It Aty thuhet se digjitalizimi i të dhënave “është reduktuar kryesisht në mbledhjen dhe përpunimin elektronik të të dhënave për institucionet arsimore, duke përfshirë të dhënat për pjesëmarrësit, stafin dhe, deri diku, infrastrukturën e institucioneve”.²²² Të dhënat menaxhohen nga dy sisteme brenda MASHTI-t: Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) dhe Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim të Lartë (SMIAL). SMIA është një sistem kyç për koordinim pasi organizon sistematikisht informacionin bazë në lidhje me arsimin, duke mundësuar menaxhimin dhe zhvillimin e sektorit. Ai shërben si qendër informative për MASHTI-n dhe komunat, duke lehtësuar monitorimin që mund të informojë zhvillimin e politikave arsimore.²²³ Zyrtarët komunalë me qasje të regjistruar si përdorues në këtë sistem mund të kenë qasje në informacione për të gjitha shkollat në territorin e tyre, duke përfshirë të dhënat sipas vendndodhjes, nivelit të arsimit, numrit të studentëve dhe numrit të mësimdhënësve, ndër të tjera. Ai mundëson përcjelljen e regjistrimit, përfundimin dhe ndërprerjen e arsimit të vajzave dhe djemve. Megjithatë, ai nuk përmban të dhëna të ndara sipas gjinisë për nxënësit me aftësi të kufizuara ose të etnive të ndryshme.²²⁴ SMIA ka disa të dhëna në lidhje me mësuesit, por nuk mund të ndajë sipas gjinisë të dhëna në lidhje me kualifikimet e mësuesve dhe trajnimet e ndjekur nga ata, megjithëse kjo do të mundësonte politikëbërje të zgjuar, të bazuar në fakte dhe ndërhyrje zhvillimore.²²⁵

MASHTI përdor një Sistem të Paralajmërimit të Hershëm për identifikimin e fëmijëve në rrezik të ndërprerjes së shkollimit, i zhvilluar në bashkëpunim me

220 Intervista e RrGK-së, gusht 2023.

221 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022, f. 45.

222 Po aty.


223 KEEN dhe BE në Kosovë, *“Udhëzues për përdorimin e sistemit të menaxhimit të informatave në arsim (SMIA) në nivelin komunal”*, ND, f. 5.

224 MASHTI konfirmoi se të dhënat e ndara sipas gjinisë sipas përkatësisë etnike nuk ishin në dispozicion. (korrespondenca, tetor 2023).

225 Intervista e RrGK-së, gusht 2023.

UNICEF.²²⁶ Asnjë nga treguesit dhe faktorët e rrezikut nuk lidhet në mënyrë eksplicite me gjininë, seksualitetin ose identitetin gjinor, megjithëse këto mund të kontribuojnë në rrezik, siç është martesë e hershme, e cila priret të prekë më shumë vajzat sesa djemtë. Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm gjurmon/përcjell pjesëmarrjen, duke përfshirë emrin e fëmijës dhe moshën e fëmijës, por jo gjininë e fëmijës. Prandaj, nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë. Të dhëna të tilla mund të ndihmojnë në identifikimin e tendencave të lidhura me gjininë tek fëmijët në rrezik. Ndërkohë, UN Women thuhet se ka mbështetur një platformë hartografike digjitale për të identifikuar komunitat ku gratë e reja dhe vajzat nga grupet e pakicave etnike janë në rrezik më të lartë për të ndërprerë shkollimin e tyre.²²⁷

Tabela 1. Rastet e raportuara të dhunës në shkolla sipas gjinisë së fëmijëve të përfshirë



226 Treguesit përfshijnë: (a) Vijueshmëria: Nxënësi/ja ka munguar më shumë se 18 orë në muaj pa ndonjë arsye të vlefshme; (b) Performanca akademike: Nxënësi/ja nuk mund të lexojë, shkruajë ose numërojë në mënyrë të përshtatshme për moshën e tij/saj ose nxënësi/ja ka nota shumë të ulëta në lëndët bazë; (c) Sjellja: Nxënësi në mënyrë të përsëritur silltet keq ose është shumë agresiv në shkollë; (d) Moshë: Nxënësi/ja është më i madh/e se shokët e tij/saj dy vjet ose më shumë; (e) Shëndeti: Nxënësi/ja ka një paaftësi ose nevoja të veçanta arsimore ose sëmundje kronike ose probleme të tjera të rënda shëndetësore fizike/psikike (përfshirë traumat e kaluara); (f) Rrethanat familjare: Nxënësi/ja përballet me rrethana të ndërlikuara familjare; dhe (i) Siguria: Nxënësi/ja është viktimë ose në rrezik nga: (i) Dhuna në familje, (ii) Forma të tjera abuzimi, neglizhenca ose shfrytëzimi. Fillimisht të përdorur nga UNICEF-i, lista e plotë është këtu: UNICEF, [Early Warning Systems for Students at Risk of Dropping Out](#), [Sistemet e paralajmërimit të hershëm për nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollimit] 2018.

227 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGj, [Raporti i monitorimit dhe vlerësimit për arritjen e objektivave për monitorimin dhe zbatimin e aktiviteteve të PKBGJ Plani i Veprimit 2020-2022](#), Periudha e raportimit: 2020 dhe 2021, 2023, f. 127.

DKA-të duhet të përpilojnë raporte për rastet e dhunës në institucionet arsimore brenda komunës dhe t'i dorëzojnë periodikisht në Njësinë e MASHTI-t, përgjegjëse për SMIA.²²⁸ Në tre vitet e fundit akademike, MASHTI ka marrë raportime për 99 raste të dhunës, që kanë prekur 22 vajza (22%) dhe 77 djem (78%) (Tabela 1.) Megjithatë, intervistat e RrGK-së sugjerojnë se jo të gjitha rastet janë raportuar; rastet që përfshijnë ngacmim kibernetik, ngacmim seksual ose dhunë kibernetike mund të mos konsiderohen mjaft serioze për t'u raportuar dhe për këtë arsye mund të mos regjistrohen Nisur nga marrëdhëniet gjinore, raste të tilla mund të prekin më shumë vajzat sesa djemtë, megjithëse nevojiten të dhëna të mëtejshme për të arritur në përfundime të sakta dhe për të planifikuar më mirë masat parandaluese.

Kosova nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme që nxënësit të specializohen në TIK. Kosova ka 70 shkolla të AAP ku DSC²²⁹ ofrohet si lëndë, por rrallë si kualifikim.²³⁰ Në fund të vitit 2019 nuk ekzistonte asnjë shkollë profesionale specifike e kualifikuar për TIK.²³¹ UNDP arriti në përfundim në vitin 2021 se “mungon investimi në aftësitë e zotësisë digjitale; shumë nga përpjekjet për të integruar TIK-un në arsimin parauniversitar kanë qenë të pasuksesshme, ndërsa universitetet nuk janë të financuara mjaftueshëm dhe kërkojnë investime të konsiderueshme në infrastrukturë dhe staf”.²³² Në përgjithësi, institucioneve arsimore u mungon infrastruktura adekuate për ta bërë në dispozicion gjerësisht mësimin e-AAP. Për të adresuar këtë, financiar nga BE-ja dhe Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) po zbaton projektin Përafrimi i Arsimit me Nevojat e Tregut të Punës (ALLED). Ai ka mbështetur 28 ofrues të shërbimeve arsimore, duke përfshirë 24 shkolla AAP dhe katër fakultete me pajisje IT SMART (p.sh., kompjuterë dhe tabletë), instalime elektrike dhe internet me shpejtësi të lartë si parakushte për ofrimin e teknologjisë së re Classroom 3.0 për realitetin e shtuar dhe virtual (AVR).²³³ Teknologjia AVR krijon një mjedis të simuluar me kompjuter me të cilin përdoruesit ndihen sikur janë në mjedisin real, duke ofruar qasje të reja për mësimdhënien në shkolla që përndryshe mund të mos jenë në dispozicion për arsye të ndryshme infrastrukturore.²³⁴ ALLED ka mbështetur gjashtë shkolla të AAP-së për të përmirësuar cilësinë e programeve bazuar në nevojat e tregut të punës; ka ofruar pajisje dhe trajnime për mësimdhënës në DSC, duke përfshirë videopedagogjinë dhe përdorimin e

228 Republika e Kosovës, Qeveria, [Rregullore QRK nr. 21/2013 për Protokollin për Parandalimin dhe Referimin e Dhunës në Institucionet e Arsimit Parauniversitar](#), 2013.

229 Nga anglishtja: Digital Skills and Competence

230 ETF, “[Digital skills and online learning in Kosovo](#)” [Shkathtësitë digjitale dhe mësimi online në Kosovë], 2020, f. 2.

231 Po aty.

232 UNDP, [Digital Readiness Assessment](#), 2021.

233 Kjo përfshinte EON Reality, një teknologji që ofron zgjidhje mësimore duke përdorur realitetin e shtuar dhe virtual. Për më shumë informata, shih EON Reality, “[Effortless self-service AR & VR: Bringing immersive technology to the masses](#)”, 2023, qasur më 6 nëntor 2023.

234 ALLED², “[The future is here!](#)”, YouTube, 2023, qasur më 6 nëntor 2023.

softuerit simulues, i cili nuk ekzistonte më parë në Kosovë.²³⁵ Synimi është që këto shkolla të jenë “Foleja digjitale AVR e Kosovës për AAP”, të cilat mund të shërbejnë si qendra trajnimi, duke ua përcjellë këto aftësi shkollave të tjera. Teknologjia AVR mund ta bëjë AAP-në më tërheqëse për gratë e reja.²³⁶ ALLED ka përdorur pamjet transformuese gjinore në shpjegimin e AVR-së, duke i inkurajuar vizualisht gratë të hyjnë në fushat e shkencës dhe teknologjisë, ku ato kanë qenë të nënpërfaqësuar historikisht (shih Figurën1).

Figurë 1. ALLED² Kosova inkurajon vajzat të përfshihen në shkencë përmes videove për AVR



Burimi: ALLED² Kosovo, “The Future is here!”, YouTube video, 2023


Historikisht, AAP-të kanë pasur softuer joadekuat për organizimin e të dhënave për shkollat dhe përfituesit. ALLED ka zhvilluar Barometrin e AAP-së për MASHTI-n për të ruajtur të dhënat për AAP-të me afërsisht 200 pyetje në lidhje me drejtorët, nxënësit dhe sfidat me të cilat përballen. Softueri e ka të përfshirë perspektivën gjinore dhe të dhënat mund të ndahen sipas gjinisë. Të dhënat mund të mbështesin vendimmarrjen nga MASHTI dhe AAP-të duke identifikuar pabarazitë gjinore dhe më pas masa afirmative për adresimin e tyre. EduNET ofron informacion rreth 20 shkollave pjesëmarrëse të AAP-së dhe programeve të tyre, duke përfshirë një Komunitet Digjital të Praktikës. ALLED ka mbështetur PlanifikoVET, një platformë interaktive që krijoi një formulë financimi për të lehtësuar planifikimin financiar më efikas dhe efektiv

235 I referohet kornizave të BE-së për sipërmarrjen (EntreComp) dhe kompetencën digjitale (DigComp).

236 Intervista e RrGK-së, 2023. Për më shumë informata, shih seksionin [Njerëzit](#).

për shkollat e AAP-së të financuara nga shteti; është hapur më shumë se 15,000 herë.²³⁷ Videot promovuese në lidhje me të përfshijnë diskutime të përgjegjshme gjinore të financimit në lidhje me punësimin e një baraspeshe gjinore të punonjësve, pushimin e lehonisë dhe përfshirjen e një baraspeshe gjinore të grave dhe burrave, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, në videot. Mesazhet dhe pamjet vizuale mund të kontribuojnë në transformimin e normave gjinore në lidhje me rolet që gratë dhe burrat mund të luajnë në profesione të ndryshme (shih Figurën 2).²³⁸

Figurë 2. ALLED² Videoja në YouTube rreth PlanVET përfshin imazhe transformuese gjinore të grave dhe burrave në arsimin dhe aftësimin profesional



Burimi: ALLED² Kosovo, "PlanVET", YouTube

Ekosistemi i inovacionit

Në vitin 2022, pas një marrëveshjeje të nënshkruar nga ministri i MASHTI dhe Komisioneri i BE-së për Inovacion, Kërkim, Kulturë, Arsim dhe Rini në vitin 2021, Kosova iu bashkua Horizon Europe, programit kryesor të BE-së për financimin e kërkimit dhe inovacionit me një buxhet total prej 95.5 miliardë euro.²³⁹ Kosova fitoi statusin e asociuar, duke u bërë pjesë e Zonës Evropiane të Kërkimit, e cila u mundëson subjekteve juridike dhe individëve nga Kosova të marrin pjesë në ekosistemin pan-evropian të kërkimit dhe inovacionit.²⁴⁰ Ai mundëson kërkimin dhe inovacionin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke

237 ALLED² Kosovë, "PlanVET", YouTube, 2022, qasur më 6 nëntor 2023; dhe korrespondenca me ALLED², tetor 2023.

238 Po aty.

239 MASHTI, "Kosova merr statusin e asociuar në programin ["Horizon Europe"](#) me të drejta të plota", 7 dhjetor 2021; MASHTI, "Kuvendi ratifikoi marrëveshjen për programin ["Horizon Europe"](#) dhe atë për shkëmbimin akademik ["Fulbright"](#).", 21 janar 2022).

240 Po aty.

mbështetur zbatimin e politikave të BE-së dhe adresimin e sfidave globale përmes kërkimit dhe inovacionit. MASHTI ka publikuar pak informacion për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe se sa kanë përfituar hulumtuesit gra dhe burra nga ajo.

Horizon Europe kërkon krijimin e një Pike Kombëtare Kontakti për të shpërndarë informacion tek institucionet dhe individët në lidhje me programet, thirrjet dhe procesin e aplikimit.²⁴¹ Faqja e internetit e MASHTI-t nuk përmban hiperlidhje për informacionin e kontaktit të personit përgjegjës. Nuk ekziston asnjë informacion se sa ky person ka informuar apo ndihmuar gra dhe burra të ndryshëm me thirrjet e Horizon 2020. Strategjia e Arsimit 2022-2026 vuri në dukje se Kosova ka pak projekte të mbështetura nga financimi i BE-së për hulumtim dhe inovacion përmes Horizon 2020 dhe se që nga viti 2022 vetëm Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Prizrenit kishin marrë grante nga ky program.²⁴² Arsyet përfshijnë infrastrukturën e pamjaftueshme për hulumtim shkencor, pasi IAL-ve u mungojnë strategjitë gjithëpërfshirëse për hulumtimin shkencor dhe ato kanë fonde dhe kapacitete të kufizuara për t'u angazhuar në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar.²⁴³

Në përgjithësi, ka ekzistuar infrastruktura joadekuate për krijimin e një ekosistemi inovativ në Kosovë, duke marrë parasysh se një në gjashtë shkolla publike nuk kishte qasje në internet, dy të tretat nuk kishin laborator të TI-së dhe, mesatarisht, shkollat kishin vetëm një kompjuter për 35 nxënës.²⁴⁴ Një pjesëmarrës në hulumtim reflektoi:

Nuk ka të bëj me ndarje mashkull/femër. Është mungesa e një kornize të duhur që do të jetë e qasshme për të gjithë hulumtuesit. Na mungon infrastruktura bazë kërkimore dhe të dhënat se sa hulumtues kemi. [...] Nuk [ka] në të vërtetë asnjë mundësi për fëmijët për t'u qasur në ekosistemet e inovacionit. Është embrional, për të mos thënë më së paku, në Kosovë.²⁴⁵

Pa infrastrukturën bazë, është e vështirë të nxitet inovacioni, e lëre më të përfshihen vajza dhe djem në mundësitë për inovacion.

241 MASHTI, "U mbajt takimi i parë për programin "Horizon Europe" me anëtarët e rinj të Pikës Kombëtare të Kontaktit", 9 korrik 2021.

242 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 51.

243 Po aty, f. 52.

244 ETF, *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the weak links (Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta)*, 2023, f. 37.

245 Intervista e RrGK-së me përfaqësues të organizatës ndërkombëtare, 2021.

Ky seksion shqyrton deri në çfarë mase arsimit digjital është i qasshëm për vajza, djem, gra dhe burra; pronësinë e tyre dhe përdorimin e mjeteve digjitale për arsim; si kanë marrë pjesë në programe arsimore; nëse kanë aftësi digjitale për të mësuar; dhe shkallën në të cilën ekzistojnë mbrojtje adekuate për edukimin digjital, duke ruajtur mirëqenien e tyre digjitale.

92% e djemve dhe 89% e vajzave kishin qasje në internet në shtëpi.

Qasja, pronësia dhe përdorimi i mjeteve digjitale për edukim

Në vitin 2021, nga 95% e njerëzve të moshës 16-74 vjeç që përdornin internetin, vetëm 19% thanë se e përdornin atë për aktivitete mësimore si libra elektronikë, materiale audio-vizuale dhe mësim softuerësh.²⁴⁶ Sondazhi i *Young Voices* 2021 zbuloi se 70% e fëmijëve thanë se kishin qasje në një kompjuter (69% e djemve dhe 71% e vajzave); 92% e djemve dhe 89% e vajzave kishin qasje në internet në shtëpi.²⁴⁷ Ndërkohë, 85% e vajzave dhe djemve kishin telefona personalë. Sipas një sondazhi të vitit 2022, 31% e fëmijëve kishin kompjuter për shkollë (29% e vajzave dhe 34% e djemve), dhe 18% më shumë kishin kompjuterë por nuk i përdornin për të mësuar (18% e vajzave dhe 17% e djemve).²⁴⁸ Ndërkohë, fëmijët kishin qasje në kompjuter (70%), internet (92%) dhe telefon personal (85%). Vetëm 31% e të anketuarve thanë se përdorin internetin për arsimim (30% e grave dhe 32% e burrave). Të dhënat e ndara sipas gjinisë se si vajzat dhe djemtë e përdornin internetin ndryshe për edukim nuk ishin në dispozicion.

Mes pandemisë COVID-19, “Edukimi në distancë – Kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për fëmijët 0–6 vjeç” ishte platforma e parë e organizuar për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Më shumë se 1600 edukatorë u trajnuan për të përdorur platformën. Me ndihmën e prindërve dhe edukatorëve, fëmijët e moshës 0-5 vjeç mund të kenë qasje në këto shërbime të edukimit të hershëm. Platforma ka marrë më shumë se 2.5 milionë klikime ose vizitorë dhe ka më shumë se 223,000 përdorues. Ajo ofron më shumë se 1000 aktivitete çdo ditë, të ndara sipas grupmoshave (0-2, 3-5) në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe rome.²⁴⁹ Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për përqindjen e vajzave dhe djemve që e kanë përdorur atë ose nëse gratë apo burrat janë më të përfshirë në mbështetjen e edukimit të hershëm të fëmijëve të tyre.

Kur u pyetën nëse kishin pajisje që fëmijët e tyre të ndiqnin mësimin në distancë gjatë pandemisë, 99% e prindërve thanë se kishin televizor dhe

246 Republika e Kosovës, Qeveria, OPM, KAS, *Rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit 2021* f. 11.

247 Save the Children, *Young Voices*, 2022, f. 16. Nga 1242 fëmijë të moshës 12-16 vjeç të anketuar duke përdorur mostrën e rastësishme, 55% ishin djem, 43% ishin vajza, 0.2% u identifikuan si jobinarë, 0.3% u përgjigjën se nuk e dinin dhe 1.2% preferuan të mos përgjigjen (f. 2).

248 UNDP, *Digital Household Survey*, 2022.

249 Po aty.

92% kishin kompjuter, laptop ose tablet me lidhje interneti.²⁵⁰ Megjithatë, në disa familje, shumë fëmijë kishin klasa përmes platformës Zoom në të njëjtën kohë, por familja kishte në dispozicion vetëm një telefon inteligjent ose pajisje.²⁵¹ Familjet me fëmijë të moshave të ndryshme me një pajisje të vetme mund të lejojnë vetëm një fëmijë të ndjekë shkollimin. Pra, mungesa e qasjes në pajisje mund të ketë penguar ndjekjen e fëmijëve në arsim. Në dekadat e mëparshme në Kosovë, nëse familjet do të duhej të zgjidhnin se cili fëmijë do të ndiqte arsimin për shkak të burimeve të kufizuara financiare, ato prireshin t'i dërgonin djemtë në shkollë duke pasur parasysh se do të kishin shanse më të mira për të siguruar punë më vonë në jetë për shkak të roleve dhe marrëdhënieve të vendosura gjinore.²⁵² Duke pasur parasysh normat gjinore, djemtë mund të kenë marrë trajtim preferencial nëse në familje kishte vetëm një pajisje. Pra, pengesat në qasjen e pajisjeve mund të kenë ndikuar ndryshe tek fëmijët, në varësi të gjinisë, rrethanave socio-ekonomike, vendndodhjes gjeografike dhe përkatësisë etnike.²⁵³

Gjatë pandemisë COVID-19, MASHTI nuk i ka marrë parasysh nevojat e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë për qasje në mjete digjitale dhe internet gjatë organizimit të mësimin në distancë.²⁵⁴ KEC ka pajisur me tableta 30 familje romë në Komunën e Graçanicës në vitin 2021, duke mundësuar qasje në teknologji, mësim dhe marrëdhënie me bashkëmoshatarët e tyre.²⁵⁵ Megjithatë, niveli i nevojës ishte më i madh. Sipas Roma Veritas Kosova, instrumentet e pakta digjitale penguan ndjekjen e mësimave nga nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë.²⁵⁶ Të dhënat e ndarë sipas gjinisë nuk u ofruan.

Duke pasur parasysh se dhuna me bazë gjinore mbetet e përhapur në Kosovë dhe thuhet se është rritur gjatë mbylljes për shkak të COVID-19,²⁵⁷ strehimoret ishin të mbipopulluara me të mbijetuarat e dhunës që kërkonin strehim, shpesh së bashku me fëmijët e tyre. Përfaqësueset e strehimoreve raportuan se sfidë e madhe ishte organizimi i mësimin në distancë për fëmijët.²⁵⁸ Donatorët kontribuan me televizorë, kompjuterë dhe printera në strehimore, duke ofruar qasje në mësimin përmes televizionit dhe online.²⁵⁹

250 UN Kosovo Team, Raporti, [Vlerësimi i Përsheptuar i Ndikimit Social-Ekonomik i COVID-19 në Kosovë](#), Wave 2, 2021. Ky raport nuk kishte të dhëna për vështirësitë me të cilat ballafaqoheshin nxënësit/studentët romë, ashkali apo egjiptianë.

251 RrGK, ["Pandemia nuk njeh gjini?"](#), 2020.

252 Biseda e RrGK-së me me aktiviste për të drejtat e grave.

253 Intervista e RrGK-së, 2021.

254 RrGK, ["Pandemia nuk njeh gjini?"](#), 2020.

255 Romani Early Years Network, ["Reduktimi i boshllëqeve digjitale për fëmijët e grupeve të marginalizuara në Kosovë"](#), lajmet, 21 shtator 2021, qasur më 7 dhjetor 2023.

256 Roma Veritas Kosovo, [COVID-19 Pandemic, Roma, Ashkalia and Egyptian Situation Report for Kosovo](#), 2020.

257 Shih kapitullin 2.

258 UN Peacekeeping, ["Children in Kosovo shelters helped to continue online learning as domestic violence rates spike"](#), [Fëmijët në strehimoret e Kosovës u ndihmuan në vazhdimin e mësimin online me rritjen e shkallës së dhunës në familje]28 maj 2020, qasur më 7 dhjetor 2023.

259 Po aty.

Megjithatë, mundësitë e të mësuarit për fëmijët në këto mjedise ishin të kufizuara; strehimoreve u mungonte infrastruktura e duhur për të plotësuar nevojat e fëmijëve të ndryshëm. Fëmijët gjithashtu kërkonin ndihmë shtesë për përdorimin e teknologjisë për t'u qasur në mësimin online, dhe fëmijët në strehimore nuk kishin gjithmonë vëmendje dhe udhëzim të mjaftueshëm.²⁶⁰

Pjesëmarrja dhe zotësia digjitale

Mes mbylljes së vendit për shkak të COVID-19 dhe mbylljes së shkollave, një sondazh i vitit 2020 zbuloi se 96% e fëmijëve ndiqnin mësimin në distancë, ndërsa 4% e fëmijëve (5% e vajzave dhe 3% e djemve) nuk mundën të merrnin pjesë.²⁶¹ Pandemia zgjeroi më tej pabarazitë ekzistuese në pjesëmarrjen në arsim, arritjet dhe njohuritë midis fëmijëve më të favorizuar dhe atyre nga grupet e cenueshme, duke përfshirë fëmijët me status të ulët socio-ekonomik, nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.²⁶² Grupet e tjera etnike kishin një përqindje të mungesës prej 3% nga orët online, ndërkaq nxënësit romë, ashkali dhe egjiptianë kishin një përqindje të mungesës prej 10%.²⁶³ Sipas të dhënave zyrtare, në vitin shkollor 2020-2021, 109 nxënës ndërpreën arsimimin e tyre, duke përfshirë 63 djem (58%) dhe 46 vajza (42%).²⁶⁴ Dallimet gjinore në secilin grup etnik nuk ishin në dispozicion.

Ndërkohë, MASHTI theksoi se “të dhënat për braktisjen e shkollës mbeten mjaft të paplota, pasi raportet për braktisjen e shkollës janë të paplota”. MASHTI mund të mos ketë të dhëna të sakta nëse pandemia COVID-19 ka kontribuar në rritjen e braktisjes së shkollës. Një pjesëmarrës në hulumtim vërejt:

Raportet e prodhuara nga MASHTI në sistemin e raportimit nuk tregojnë ndonjë ndryshim në shkallën e braktisjes së shkollës. Megjithatë, të dhënat nga komunat, të cilat vinin nga burime të ndryshme, kishin mospërputhje në mënyrën se si ishin mbledhur dhe raportuar nëpër komuna të ndryshme. Pra, ne nuk mund të përjashtojmë mundësinë që braktisjet nuk janë raportuar ose nuk janë regjistruar siç duhet.²⁶⁵

260 Korrespondenca e RrGK-së me strehimoret.

261 UN Kosovo Team, UN Women, UNFPA, UNDP, [Vlerësimi i Shpejtë i Ndikimit socio-ekonomik në ekonominë shtëpiake në Kosovë: Anketa me ekonomi familjare](#); Microsoft BI, 2021, qasur më 7 dhjetor 2023.

262 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, [Strategjia e Arsimit 2022-2026](#), 2022, f. 30.

263 Romani Early Years Network, [“Reduktimi i boshllëqeve digjitale për fëmijët e grupeve të marginalizuara në Kosovë”](#), lajmet, 21 shtator 2021, qasur më 7 dhjetor 2023.

264 Korrespondenca e RrGK-së me MASHTI-n, shtator 2023.

265 Korrespondenca e RrGK-së me MASHTI-n, shtator 2023.

SMIA me sa duket mundëson monitorimin sistematik të trendeve të tilla. Megjithatë, jo të gjitha komunat kanë ofruar të dhëna cilësore, veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19, dhe ka pasur dallime në të dhëna në krahasim me trendet e viteve të mëparshme.²⁶⁶ Kjo mund të sugjerojë raportim të pamjaftueshëm të braktisjes së shkollimit. Shifra të sakta se sa fëmijëve u mungonte qasja në arsimin online sipas gjinisë, vendndodhjes, moshës, përkatësisë etnike dhe aftësisë nuk janë në dispozicion. Prandaj, është e vështirë të ndërmerret një analizë e saktë e ndikimit gjinor, duke vlerësuar nëse pandemia ndikoi në shkallën e ndjekje dhe përfundimit të shkollës. As shkollat nuk i raportojnë gjithmonë rastet Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, megjithëse një informacion i tillë mund të ndihmojë në parashikimin e rrezikut të mungesës së fëmijëve ose të ndërprerjes së shkollës; Sistemit i mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë.²⁶⁷

Pandemia e COVID-19 zbuloi se disa nxënësve u mungonin aftësitë dhe ndërgjegjësimi se si të përdornin platformat online, megjithëse të dhënat e ndara sipas gjinisë duken të padisponueshme.²⁶⁸ Në disa raste, nxënësit thuhet se ishin më të hapur ndaj mësimin dhe kërkimit online sesa mësimdhënësit e tyre.²⁶⁹ Familjarizimi i të rinjve me teknologjinë, megjithëse për qëllime argëtimi dhe komunikimi, thuhet se ka kontribuar në zotësinë e tyre digjital.²⁷⁰

Për të mbështetur mësimin online të nxënësve, mësuesit kishin nevojë për njohuri dhe praktikë për të përdorur teknologjinë.²⁷¹ Megjithatë, kapacitetet e TI-së të mësimdhënësve mbetën të ulëta në Kosovë.²⁷² Në një studim të vitit 2021, rreth 66% e mësuesve nuk kishin përvojë në përdorimin e teknologjisë në metodologjitë e tyre të mëparshme të mësimdhënies; 31% kishin marrë pjesë herë pas here në mësimin online; dhe më pak se 3% kishin përvojë të vazhdueshme të të mësuarit online.²⁷³ Nuk u ofruan të dhëna të ndara sipas gjinisë. Mësimdhënësit që kishin përvojë mësimore online prireshin të ishin më të rinj dhe kishin marrë pjesë në programe ndërkombëtare studimore. Shumica e mësuesve (58%) nuk kishin pasur kurrë ndonjë përvojë me platformat online (p.sh. Google Classroom, Google Meet, Zoom) dhe 36% thanë se përvojat e tyre me platformat online ishin të rralla. Vetëm 6% i njihnin mirë këto platforma dhe i kishin përdorur me nxënësit e tyre. Më pak

266 Intervista e RrGK-së, 2022.

267 Shih seksionin për [Infrastrukturë](#).

268 Intervista e RrGK-së, 2021.

269 ETF, [Kosovo Rapid Education Diagnosis \(RED\): Addressing the weak links](#)(*Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta*), 2023, f. 5.

270 Korrespondenca e RrGK-së me ASHI, nëntor 2021.

271 T.J. Kopcha, "Teachers' perceptions of the barriers to technology integration and practices with technology under situated professional development"[Perceptimet e mësimdhënësve për pengesat në integrimin e teknologjisë dhe praktikave me teknologjinë në kushtet e zhvillimit profesional] *Computers & Education*, 59(4), 2012.

272 Zamira Hyseni Duraku, "[Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Arsim dhe Mirëqenie, Implikime Praktike dhe Mësime për të ardhmen](#)", 2021.

273 Arlinda Beka, "[Iniciativat transformuese të shkollave përmes përdorimit të teknologjive digjitale në Kosovë gjatë Covid-19](#)", *Arsimi Fillor Online*, 2021; 20 (1): pf. 851-860.

se 30% patën mundësinë të ndjekin trajnime për përdorimin e platformave online. Për ata që kishin marrë pjesë, shumica e trajnimeve u ofruan nga shkollat ku ata punonin, kryesisht në Prishtinë. Megjithëse të dhënat e ndara sipas gjinisë për edukimin digjital të mësuesve nuk ishin në dispozicion, ky studim sugjeroi se moshë dhe vendndodhja gjeografike ndikuan në aftësitë e disa mësuesve për të zhvilluar aftësitë e tyre digjitale dhe për të përdorur mjete digjitale në mësimdhënien e tyre. Kjo mund të ndikojë në të mësuarit pasi mësuesit mund të mos jenë në gjendje t'ua përcjellin zotësinë digjitale nxënësve të tyre.

COVID-19 në mënyrë të qartë nxiti më shumë mësues të përdorin teknologjinë në klasat e tyre. Sipas shumicës së drejtorëve të shkollave, para pandemisë pak mësues përdornin platforma të të mësuarit online sepse nuk kishin ndjekur ndonjë program për zhvillimin e kapaciteteve.²⁷⁴ Vetëm 55% e drejtorëve të shkollave raportuan se kanë pasur trajnime për TIK dhe mësimdhënie që nga viti 2020.²⁷⁵ Sipas KEC-it, nevoja për zhvillim profesional të mësimdhënësve

në aftësitë digjitale është përmbushur me pjesëmarrjen vullnetare në trajnime nga vetë mësimdhënësit, ndërsa disa shkolla dhe DKA kanë pritur me shpresën se MASHTI apo trajnerët do ta ofrojnë atë.²⁷⁶ Në partneritet me 20 shkolla profesionale, projekti ALLED synoi të arrinte tek rreth 1000 mësues dhe trajnerë. MASHTI, GIZ, the British Council, Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA), Fondacioni për Popullsinë e Kosovës dhe UNICEF kanë ofruar trajnime në platforma të ndryshme mësimore dhe të mësuarit në distancë.²⁷⁷ Të dhënat e ndara sipas gjinisë se cilët mësues kishin qasje në një mësim të tillë nuk ishin në dispozicion.

Aftësia e mësuesve për të përdorur mjete digjitale duket se bazohet në një kombinim të burimeve në dispozicion, qasjes në teknologji, qasjes në mundësitë e të mësuarit, kapaciteteve të tyre individuale dhe motivimit të tyre për të mësuar dhe përdorur mjete digjitale. Në vitin 2023, ETF

arriti në përfundimin se “mungesa e kompetencave digjitale të edukatorëve në hartimin dhe mësimdhënien që kombinojnë dhe zotërojnë metodat tradicionale dhe digjitale” mbetet një pengesë për digjitalizimin e barabartë në sektorin e arsimit.²⁷⁸ Asnjë trajnim i institucionalizuar nuk ka ekzistuar për mësuesit mbi gjininë, digjitalizimin ose digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor. MASHTI ka planifikuar trajnime si dhe punësimin e koordinatorëve të TIK-ut, të

“Mësuesit kundërshtojnë reformën digjitale. Ata janë të vetëdijshëm se nxënësit e tyre dinë më shumë se çfarë dinë ata për digjitalizimin.”

- Prindi, cituar nga ETF

274 Instituti Pedagogjik i Kosovës, *Mësimi në distancë, e-Mësimi në Institucionet Parauniversitare të Kosovës në rrethanat e COVID-19*, 2020.

275 Po aty.

276 Po aty, f. 55.

277 Po aty.

278 ETF, *Kosovo Rapid Education Diagnosis (RED): Addressing the weak links (Diagnozë e përshpejtuar e arsimit në Kosovë: Adresimi i hallkave të dobëta)*, 2023, f. 4.

cilët pritet të mbështesin edukatorët dhe shkollat në identifikimin e nevojave dhe zgjidhjeve për arsimin digjital.²⁷⁹ Nuk ka informacion të mjaftueshëm nëse mësuesit kanë kapacitete adekuate për të zhvilluar përmbajtje mësimore të përgjegjshme gjinore (pedagogji) në mjetet e të mësuarit digjital dhe mund të sigurojnë që ajo përmbajtje mund të arrijë tek nxënësit e ndryshëm.

Njohuritë digjitale të prindërve mund të ndihmojnë në përgatitjen më të mirë të fëmijëve për mësimin online. Në disa raste, prindërve iu desh të forconin zotësinë e tyre digjitale, në mënyrë që të mund të mbështesin fëmijët e tyre me mësimin online gjatë pandemisë. Duke pasur parasysh rolin e tyre të socializuar gjinor si kujdestare, gratë priren të shpenzojnë më shumë kohë duke u kujdesur për fëmijët, duke përfshirë mësimin e fëmijëve të përdorin teknologjinë në mënyrë që ata të mund të ndjekin shkollimin online.²⁸⁰ Edukimi i pamjaftueshëm paraprak për mënyrën e përdorimit të mjeteve digjitale, së bashku me kapacitetet e pamjaftueshme të mësuesve për të ofruar ndihmë shtesë për fëmijët që kanë vështirësi me mësimin online, vendosi një barrë shtesë për prindërit, veçanërisht nënat. Disa gra raportuan se duhej të largoheshin nga puna për të ndihmuar në mësimin e fëmijëve të tyre duke pasur parasysh mungesën e burimeve dhe programeve shtetërore gjatë pandemisë. Ndërkohë, përgjegjësitë e kujdesit ka të ngjarë të kufizonin kohën dhe aftësinë e grave për të qasur në mundësitë e të mësuarit digjital.

Dëshmitë e shumta ilustrojnë nevojën për përmirësimin e zotësisë digjitale dhe aftësive TIK në Kosovë.²⁸¹ Në përgjithësi, ekziston një mospërputhje midis studentëve që trajnohen në profile specifike të TIK-ut dhe nevojave të kompanive të TIK-ut për punonjës të rinj.²⁸² Mundësitë e disponueshme për zhvillimin e aftësive nuk janë në përputhje me nevojat e tregut.²⁸³ Problemet e lartpërmendura lidhur me infrastrukturën e pamjaftueshme të kombinuara me mungesën e mësimeve të kualifikuara në mbështetjen e zhvillimit të aftësive digjitale kontribuojnë në aftësitë e pamjaftueshme të zotësisë digjitale në Kosovë.

Në përgjithësi, djemtë kanë më shumë gjasa të regjistrohen në shkollat e AAP-së sesa vajzat. Nga të gjithë nxënësit e shkollave profesionale në vitin akademik 2021/2022, 42% ishin gra/vajza dhe 58% burra/djem.²⁸⁴ Në pesë vitet e fundit, vajzat kanë ndjekur vazhdimisht AAP në TIK në shkallë dukshëm më të ulët se sa djemtë (shih Figurën 3).²⁸⁵

279 Po aty, f. 37.

280 RrGK, "Pandemia nuk njeh gjini?", 2020.

281 Shih seksionet Rregullimi dhe Qeverisja të këtij kapitulli.


282 ETF, *Digital skills and online learning in Kosovo* [Shkathësitë digjitale dhe mësimi online në Kosovë], 2020, f. 2. Për diskutim të mëtejshëm, shih kapitullin 5.

283 Republika e Kosovës, Qeveria, *Programi i reformave ekonomike 2020-2022*, 2020, f. 91.

284 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, ASK, *Statistikat e Arsimit në Kosovë 2021/2022, 2022*, grafiku 4, f. 27.

285 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 41.

Figurë 3. Vajzat dhe djemtë e regjistruar në arsimin e mesëm profesional sipas viteve



Burimi: Përshtatur nga MASHTI, Strategjia e Arsimit 2022-2025

Të dhënat e ndara sipas gjinisë sugjerojnë se vajzat priren të studiojnë fushën e shëndetit dhe mirëqenies, biznesit, administratës dhe drejtësisë, dhe djemtë priren të studiojnë inxhinieri, prodhim, ndërtim dhe TIK (Figura 4).²⁸⁶

Figurë 4. Regjistrimi në arsimin e mesëm profesional sipas fushës dhe gjinisë

ISCED-F fields	2016/17		2017/18		2018/19		2019/20		2020/21	
	Total	Girls	Total	Girls	Total	Girls	Total	Girls	Total	Girls
Human sciences and arts	1,323	832	1,558	1,024	1,448	1,023	1,568	1,067	1,546	1,059
Business, administration & justice/law	13,550	6,346	13,817	6,609	12,381	5,762	10,920	5,023	10,005	4,616
ICT	5,460	1,729	5,299	1,602	4,772	1,388	4,148	1,132	3,857	929
Engineering, manufacturing & construction	15,342	3,595	15,288	3,578	14,534	3,391	13,179	2,960	12,389	2,638
Agriculture, forestry, fishery and veterinary	1,301	404	1,824	656	1,541	536	1,333	442	1,227	466
Health and Welfare	7,152	4,822	7,591	5,161	8,022	5,495	8,839	6,123	8,912	6,330
Services	1,258	363	1,306	338	1,087	319	830	212	842	256
Other	0	0	83	24	18	2	0	0	72	33
Total	45,386	18,091	46,766	18,992	43,803	17,916	40,817	16,959	38,850	16,327

Source: EMIS/MESTI

Burimi: MASHTI, Strategjia e Arsimit 2022-2025

Më pak gra se burra ndjekin arsimin universitar në TIK. Në vitin akademik 2021/2022, nga 575 studentë në universitetet publike dhe private, 205 gra (36%) dhe 370 burra (64%) janë diplomuar në nivel bachelor në TIK.²⁸⁷ Nga 96 studentë, 40 gra (42%) dhe 56 (58%) burra u diplomuan në nivelin master në TIK.²⁸⁸ Në vitin akademik 2022/2023, nga 2,701 studentë në universitetet publike dhe private, 871 gra (32%) dhe 1,830 burra (68%) u regjistruan për herë të parë në nivelin bachelor në TIK.²⁸⁹ Gjithsej 7243 studentë studionin TIK në nivelin bachelor, 32% gra dhe 68% burra.²⁹⁰ Nga 290 studentë që u regjistruan për herë të parë në nivelin master në TIK, 45% ishin gra dhe 55% ishin burra.²⁹¹ Në total janë regjistruar 549 studentë, 48% gra dhe 52% burra.²⁹² Këto të dhëna sugjerojnë se gratë e reja ende mund të përballen me më shumë sfida për të qasur edukimin dhe njohuritë në TIK, si dhe mundësi për zhvillimin e aftësive të zotësisë digjitale.

“Mungesa e vetëbesimit, ndërgjegjësimit, e kombinuar me stereotipet gjinore ndikojnë që gratë të mos ndihen rehat për të studiuar TIK-un.”

- Pjesëmarrëse në hulumtimin e RrGK-së, 2021

Disa faktorë mund të kontribuojnë në këtë ndarje gjinore. Së pari, në përgjithësi, ekzistojnë dallime gjinore në **arritjet arsimore** në Kosovë.²⁹³ Nivelet e ulëta arsimore mund të pengojnë zotësinë digjitale, qasjen në njohuri dhe edukimin e vazhdueshëm në lidhje me TIK-un dhe digjitalizimin. Meqenëse gratë, mesatarisht, kanë nivele më të ulëta arsimimi se burrat, gratë mund të jenë të pafavorizuara për të vazhduar edukimin e tyre, duke përfshirë edhe digjitalizimin.

Së dyti, **normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore** mund të pengojnë qasjen e vajzave dhe grave në arsim në fushat e TIK-ut. Vajzat nuk kanë të njëjtat mundësi qasjeje si djemtë, madje edhe kur kanë, vajzat shpesh monitorohen dhe kufizohen në përdorimin e tyre të internetit në një masë shumë më të madhe sesa djemtë.²⁹⁴ Kjo mund të pengojë mundësitë e tyre për të mësuar aftësitë digjitale.

Stereotipat gjinorë rreth profesioneve gjithashtu mund të ndikojnë në qasjen e vajzave në arsim në TIK. Një grua e re e angazhuar në IT e kujtoi:

287 Republika e Kosovës, Qeveria, OPM, KAS, *Statistikat e Arsimit të Lartë sipas Fushave të Studimit 2022/2023*, f. 6, qasur më 12 dhjetor 2023.

288 Po aty, f. 12, qasur më 12 dhjetor 2023.

289 Po aty, f. 2, qasur më 12 dhjetor 2023.

290 Po aty, f. 4, qasur më 12 dhjetor 2023.

291 Po aty, f. 8, qasur më 12 dhjetor 2023.

292 Po aty, f. 10, qasur më 12 dhjetor 2023.

293 Shih kapitullin 1.

294 UNICEF, *Growing Up in a Connected World - Understanding Children's Risks and Opportunities in a Digital Age*, [Të rritesh në një botë të lidhur - të kuptuarit e rreziqeve dhe mundësive të fëmijëve në epokën digjitale], 2019, f. 13.

Prindërit e mi vazhduan të dyshonin në zgjedhjen time për të ndjekur një karrierë në programim. Ata nuk mendonin se do t'ia dilja dhe do të gjeja një punë, pasi Inxhinieria Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës kishte një histori që kishte më shumë burra. Kështu që unë ndoqa karrierën në inxhinieri kompjuterike në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë.²⁹⁵

Intervistat e RrGK-së sugjerojnë se mësuesit dhe prindërit mund t'i dekurajojnë gratë e reja që të përfshihen në fushën e TIK-ut, sepse ajo është perceptuar si një fushë për burrat. “Një nga problemet e AAP-së është atraktiviteti dhe disi perceptimi është se AAP-ja dhe të gjitha këto profesione janë për burra”, vuri në dukje një pjesëmarrës në hulumtim.²⁹⁶ Për të adresuar këto sfida, ALLED ka pajisur shkollat AAP me mjete digjitale drejt rritjes së atraktivitetit të AAP-së dhe drejt rritjes së vetëbesimit tek vajzat dhe gratë e reja për të aplikuar.²⁹⁷ Për shembull, inxhinieria mekanike tradicionalisht ka pasur më shumë studentë burra të regjistruar. ALLED ka prezantuar pajisje të reja digjitale në gjashtë shkolla që lidhen me energjinë, bujqësinë, përpunimin e ushqimit dhe inxhinierinë mekanike që u mundësojnë nxënësve të ndërtojnë kabinete tredimensionale duke përdorur mjete digjitale, në vend të aktit fizik të krijimit të kabineteve. Sektorë të tillë historikisht konsideroheshin “për burra”, bazuar në rolet gjinore të socializuara dhe supozimet se gruaja nuk mund të kryente punë fizike, si ndërtimi i mobileve ose përdorimi i motorëve. Teknologjitë e reja lehtësojnë qasjen e grave në këto fusha. Tani, më shumë mësuese gra po i bashkohen trajnimit AVR.²⁹⁸ AVR ka përmirësuar imazhin e AAP-së, në mënyrë që të rejat dhe prindërit e tyre t'i konsiderojnë profesionet e AAP-së më të përshtatshme dhe tërheqëse për gratë.²⁹⁹ Ekzistojnë korrelacione midis të bërit tërheqëse të një teknologjie të tillë dhe avancimit teknik të vajzave.³⁰⁰ Pra, teknologjia e digjitalizimit dhe industrisë 4.0 mund të kontribuojë në ndryshimin e stereotipave gjinorë në lidhje me profesionet e përshtatshme për gratë.³⁰¹

Një faktor i tretë që mund të kontribuojë në ndarjen e të mësuarit digjital mund të jetë **koha** për të vijuar shkollimin dhe për të zhvilluar aftësitë e zotësisë digjitale. Gratë dhe burrat e kalojnë kohën e tyre ndryshe. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e kujdesit dhe të shtëpisë, gratë mund të kenë më pak kohë se

295 Intervista e RrGK-së me një grua të re inxhinierë kompjuterike, 2023.

296 Intervista e RrGK-së, dhjetor 2021.

297 Po aty.

298 Korrespondenca me ALLED², tetor 2023.

299 Po aty.


300 Po aty.

301 Korrespondenca, nëntor 2023.

burrat për të zgjeruar aftësitë e tyre digjitale, arsimimin, njohuritë dhe/ose kapacitetet profesionale në lidhje me digjitalizimin.³⁰²

Së katërti dhe potencialisht e ndërlidhur, **vendndodhja gjeografike** e mundësive për të mësuar dhe arritur zotësinë digjital mund të jetë e vështirë për t'u qasur për gratë dhe vajzat. Shumica e mundësive të mësimit digjital janë në dispozicion në zonat urbane, kështu që personat që jetojnë në zonat rurale mund të përballen me sfida shtesë për të qasur në edukim. Burrat zotërojnë më shumë makina sesa gratë, dhe gratë priren të mbështeten më shumë në transportin publik sesa burrat (Figura 5).³⁰³ Distanca gjeografike nga mundësitë e mësimit digjital së bashku me transportin publik të pamjaftueshëm dhe më pak kohë mund të pengojë qasjen e grave në edukimin dhe aftësitë digjitale.

Figura 5. Përqindja e automjeteve të regjistruara në emër të grave dhe burrave



Së pesti dhe i ndërlidhur, fakti që gratë në përgjithësi kanë më pak **burime financiare** se burrat mund të pengojë qasjen e tyre në mjetet digjitale për arsim dhe mësim, në transport për të qasur në edukim dhe në pagesën e shkollimit për arsimin e lartë që do të rriste aftësitë e tyre digjitale.

Së gjashti, disa mundësi mësimi mund të jenë të paarritshme për fëmijët dhe të rinjtë me **aftësi të kufizuara**. Periudha e pandemisë përgjithësisht u shoqërua me izolimin në shtëpi, ndryshimet në rutinën e përditshme dhe mungesën e qasjes në shërbime, të cilat ndikuan negativisht në gjendjen

emocionale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore, duke kontribuar në stresin e prindërve të tyre dhe përfshirje minimale në mësimin online.³⁰⁴ Edhe pse MASHTI ka zhvilluar platformën e arsimit gjithëpërfshirës dhe shërbime të tjera për fëmijët me nevoja të veçanta,³⁰⁵ ka pak analiza të pavarura nëse vajzat dhe djemtë me aftësi të kufizuara kanë pasur mbështetjen e duhur për të qasur mësimin online dhe/ose aftësitë digjitale para, gjatë dhe pas pandemisë. Aktivistet e të drejtave të grave që punojnë me personat me aftësi të kufizuara kanë vërejtur se avancimi i aftësive të TIK-ut mund të jetë një investim arsimor, duke u mundësuar personave me aftësi të kufizuara të socializohen, të punojnë nga shtëpia, të gjenerojnë të ardhurat e tyre dhe të rrisin pavarësinë e tyre ekonomike, veçanërisht e rëndësishme për gratë me aftësi të kufizuara.³⁰⁶

302 Shih kapitullin 1.

303 Kjo bazohet në diskutimet e RrGK-së me gratë (Shih kapitullin 1). Lidhur me pronësinë e automjeteve, korrespondenca e RrGK-së me MPB-në, 2022.

304 KEC, *Ndikimi i Pandemisë COVID-19 në Arsimin Parauniversitar në Kosovë*, 2021, f. 50.

305 Shih seksionin *Qeverisja* të këtij kapitulli.

306 Fokus grupi i RrGK-së me gratë me aftësi të kufizuara, Prizren, 2022.

Së shtati, pabarazitë ndërthurëse gjinore dhe sociale mund të pengojnë qasjen e vajzave dhe djemve të **pakicave etnike** në aftësitë digjitale. Duke pasur parasysh shkallën e tyre përgjithësisht më të lartë të braktisjes, mungesën e qasjes në pajisjet e TI-së,³⁰⁷ dhe mundësitë e humbura për edukimin digjital gjatë pandemisë COVID-19, vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë mbeten ndër më të marginalizuarit kur bëhet fjalë për zotësinë digjitale. Për shkak të statusit të tyre social dhe kushteve të jetesës, ata mund të mos zotërojnë ose të kenë qasje në mundësitë e të mësuarit digjital. Vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë mund të mos jenë në gjendje të

3% e grave të anketuara rome, ashkali dhe egjiptiane raportuan se nuk kishin ndonjë edukim.

ndjekin arsimin, përfshirë mësimin digjital, për shkak të roleve sociale dhe gjinore (p.sh., punët e shtëpisë, puna e fëmijëve, martesat e hershme). Sfidat strukturore, siç është mungesa e interesit të disa prindërve për arsimin, shtojnë pengesat me të cilat përballen fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.³⁰⁸ Në një sondazh të vitit 2021, 33% e grave të anketuara rome, ashkali dhe egjiptiane raportuan se nuk kishin ndonjë edukim.³⁰⁹ Vetëm 4% kishin përfunduar studimet universitare. Shumica e grave që nuk e kanë mbaruar shkollën fillore e kanë braktisur shkollën për shkak të gjendjes së tyre ekonomike (38%). Të tjerë përmendën presionin e familjes (18%); kohë të rrezikshme për edukim (17%) me sa duket gjatë viteve

1990; nuk kanë dashur të vazhdojnë shkollimin (11%); ishin të martuar (10%); dhe çështjet familjare (4%). Gjinia, përkatësia etnike dhe statusi socio-ekonomik ndërthuren për të ndikuar në qasjen e djemve dhe vajzave romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim, duke përfshirë zotësinë digjitale.

Duke pasur parasysh sfidat arsimore të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë, në vitin 2018 Qeveria miratoi një Udhëzim Administrativ për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore, me qëllim të ndihmës së fëmijëve për të rritur performancën mësimore dhe për të parandaluar braktisjet.³¹⁰ OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare themeluan qendra mësimore në komuna të ndryshme për të përfshirë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë në sistemin arsimor, duke pasur parasysh nivelin e ulët të ndjekjes dhe përfundimit të tyre, performancën e pakënaqshme në shkollë dhe përfshirjen e dobët sociale.³¹¹ Nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë për pjesëmarrjen e vajzave dhe djemve në Qendrat Mësimore. Ndërkohë, Qendrat Mësimore nuk mësojnë aftësi digjitale, edhe pse hulumtimi sugjeron se zotësia digjitale është ndër faktorët

307 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 37.

308 Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur, Kosovo Research and Analysis Fellowship, "Reformimi ose rikonceptualizimi i arsimit postpandemik në Ballkanin Perëndimor?", Analizë e Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë, 2020.

309 QKSGj, *Gjendja ekonomike e grave rome, ashkallike dhe egjiptiane*, , 2021.

310 RrGK nuk ka mundur të gjejë Udhëzimin Administrativ 19/2018, por është cituar në PKZMSA 2021-2025.

311 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 35.

që motivojnë fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë për të përfunduar arsimin³¹² Më tej, qendrave u mungon financimi i qëndrueshëm,³¹³ duke përfshirë mësimdhënien për çdo gjë tjetër përpos lëndëve shumë bazë. Kjo duket një mundësi e humbur për të ndërtuar mbi interesin e të rinjve romë, ashkali dhe egjiptianë për TIK-un, drejt mbështetjes së tyre për t'iu qasur vendeve të punës në TI. Duke marrë parasysh sfidat me të cilat ballafaqohen, Strategjia e Arsimit 2022-2026 ka një tregues që lidhet me përfshirjen e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptianë, veçanërisht vajzat, në arsim.

Fëmijët serbë gjithashtu u përballën me sfida që të përfshiheshin në arsim gjatë COVID-19. MASHTI filloi ofrimin e mësimit online për fëmijët e klasave 1-5 më 24 mars 2020, për klasat 6-9 dhe shkollën e mesme një javë më vonë dhe për folësit e gjuhës turke dhe boshnjake më 30 mars. Megjithatë, mësimi online nuk filloi për nxënësit serbë deri më 1 shtator, sepse këto komuna donin të përdornin planet dhe programet mësimore nga Serbia.³¹⁴ Për shkak të kësaj çështjeje politike, fëmijët serbë humbën pesë muaj mësim, gjë që mund të kishte kontribuar në avancimin e aftësive të tyre digjitale. Komunitet me shumicë serbe nuk raportojnë rregullisht të dhëna për vijueshmërinë e nxënësve serbë,³¹⁵ kështu që të dhënat e ndara sipas gjinisë për shkollën e vijueshmërisë dhe braktisjes së tyre në lidhje me COVID-19 nuk janë në dispozicion.

Mirëqenia dhe mbrojtja digjitale

Edhe pse fëmijët nuk lejohen të përdorin telefona celularë në shkollë,³¹⁶ disa fëmijë mbajnë pajisje me vete. Nuk ka të dhëna për numrin e rasteve në të cilat DKA-të kanë sekuestruar telefona. Jashtë ambienteve të shkollës, socializimi ndodh nëpërmjet rrjeteve sociale, shpesh duke përfshirë marrëdhëniet me fëmijët e tjerë të zhvilluara në shkollë.³¹⁷ Shumë fëmijë kanë qasje të pambikëqyrrur online përmes kompjuterëve ose telefonave dhe ekspozimi i tyre në internet i bën ata të prirur ndaj kërcënimeve digjitale.³¹⁸ Fëmijët kanë thënë se mund të shprehen lirisht online, por numri i madh i llogarive anonime dhe bullizmi online i shqetëson ata.³¹⁹ Nxënësit thanë se u përballën me bullizmin kibernetik në platformat e njohura të mediave sociale si Instagram

312 Kushtrim Bajrami dhe Kujtim Koci, "Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim", 2018.

313 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 35.

314 RrGK, "Pandemia nuk njeh gjini?", 2020, f. 63.

315 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Strategjia e Arsimit 2022-2026*, 2022, f. 35.

316 Republika e Kosovës, Qeveria, MASHTI, *Udhëzimi administrativ nr. 20/2018 për ndalimin e telefonave celularë në Institucionet e Arsimit Parauniversitar*, 2018.

317 Kjo është arsyeja pse RrGK diskuton mirëqenien digjitale të fëmijëve në lidhje me arsimin e jo në kapitujt e mëparshëm.

318 UNICEF, *Growing Up in a Connected World - Understanding Children's Risks and Opportunities in a Digital Age* [Të rritesh në një botë të lidhur - të kuptuarit e rreziqeve dhe mundësive të fëmijëve në epokën digjitale], 2019.

319 Save the Children, *Young Voices*, 2022, f. 6.

dhe Facebook, duke përfshirë fyerje, sharje, dhe përmbajtje të pakëndshme, si dhe keqpërdorim të të dhënave personale dhe vjedhje të fjalëkalimeve.³²⁰

Në vitin 2014, djemtë raportuan se kishin hasur në nivele më të larta të bullizmit kibernetik sesa vajzat.³²¹ Raporti i vitit 2016 që pasoi zbuloi se bullizmi kibernetik midis fëmijëve u rrit nga 53% në 2014 në 61% në 2016; afërsisht 57% e fëmijëve që raportonin bullizëm online ishin djem.³²² Pabarazitë gjinore u shfaqën në lidhje me përmbajtjen pornografike, ku 45% e djemve dhe 31% e vajzave raportuan ekspozimin.³²³ Në vitin 2022, 14% e djemve dhe 9% e vajzave rrallë ose kurrë nuk ndiheshin të **sigurt** në internet.³²⁴ Në të kundërt, 49% e djemve dhe 67% e vajzave thanë se ndiheshin gjithmonë të sigurt në internet.³²⁵ Megjithatë, 35% e fëmijëve raportuan se ndiheshin të bullizuar ose të ngacmuar gjatë vitit të kaluar, online ose në shkollë. Ata thanë se ndodhin disa lloje të bullizmit online, të tilla si fyerjet, sharjet, përhapja e thashethemeve dhe shpërndarja e fotove ose videove të turpshme.

Për shkak të normave gjinore patriarkale, vajzat mund të jenë të ndjeshme ndaj bullizmit online,³²⁶ edhe pse mund të mos e raportojnë atë. Gjashtëdhjetë për qind e vajzave nxënëse thanë se kishin përjetuar ngacmime seksuale.³²⁷ Vajzat kërcënohen dhe ngacmohen online në rastet që lidhen me shkollën dhe Universitetin.³²⁸ Raportet e mediave sugjerojnë se djemtë kanë përdorur telefona për të ngacmuar seksualisht vajza.³²⁹ Rritja e përdorimit të mësimin online gjatë COVID-19 mund të ketë kontribuar në shkallë më të lartë të ngacmimeve seksuale të vajzave, si nga shokët e klasës ashtu edhe nga mësuesit.³³⁰ RrGK poashtu ka pranuar raporte për profesorë që ngacmojnë studentet e reja përmes komunikimeve përmes telefonave dhe komunikimeve online. Rastet e edukatorëve që dyshohet se ngacmojnë seksualisht nxënësit janë publikuar në media, duke përfshirë histori për rastet gjyqësore të iniciuara.³³¹ Për shkak të marrëdhënive të pa baraspeshuara të pushtetit, ku profesorët kanë kontrollin e të dhënave personale të grave të reja, notat, të

320 Krasniqi, Meritë, "I paraportuar dhe i injoruar, bullizmi përndjek nxënësit e Kosovës", *Kosovo 2.0*, 10 dhjetor 2019.

321 B. Musmurati dhe T. Zymeri, "Raporti mbi sigurinë e fëmijëve në internet", Save the Children, 2014.

322 T. Zymeri, A. Gashi dhe L. Latifi, "Siguria e fëmijëve në internet", Save the Children, 2016.

323 Po aty.

324 Save the Children, *Young Voices*, [Zërat e rinj] 2022, f. 16.

325 Po aty, f. 41.

326 Inna Agadzhanova, "The Role of Gender in Cyberbullying Involvement" [Roli i Gjinisë në Përfshirjen e Bullizmit Kibernetik], *Kid Actions*, 8 mars 2022, qasur më 7 dhjetor 2023.

327 OSCE, *Anketa për Mirëqenien dhe Sigurinë e Grave në Kosovë*, 2019.

328 Arbisa Shefkiu, "Dyshim për ngacmim seksual të një nxënëseje në Malishevë", *Kallxo.com*, 27 tetor 2021, qasur më 7 dhjetor 2023.

329 Po aty.

330 The Guardian, "Distressing and confronting: online sexual harassment rises for Australian university students during Covid" [Në anglisht], mars 2022, qasur më 7 dhjetor 2023.

331 RrGK, *Sexual Harassment in Kosovo*, 2018.

dhënat akademike dhe, rrjedhimisht, perspektivat e punësimit, gratë e reja rrallë raportojnë ngacmime nga frika e pasojave.³³² Meqenëse raportohen pak raste, duket se janë ndërmarrë pak masa disiplinore ndaj profesorëve, mësuesve ose studentëve të përfshirë në bullizëm ose dhunë kibernetike.³³³

Ndërkohë, “Djemtë kanë presion për të qenë më të fortë edhe nëse shprehin ndjenjat e tyre”, vuri në dukje një vajzë 15-vjeçare.³³⁴ Normat gjinore përfshijnë presionin social dhe pritshmëritë e vendosura ndaj djemve, sipas të cilave ata duhet të jenë të guximshëm dhe të mos shfaqin asnjë dobësi.³³⁵ Norma të tilla të socializuara gjinore mund të kontribuojnë që djemtë të fshehin abuzimin, duke rrezikuar shëndetin e tyre mendor dhe fizik, si dhe në përforsimin e maskuliniteteve toksike ku burrat duhet të jenë të fortë dhe të fuqishëm, veçanërisht në raport me gratë.³³⁶ Kjo mund të krijojë një mjedis të favorshëm

për dhunën e shkaktuar nga burrat ndaj grave, online dhe offline, si rezultat i normave sociale të përforsuara nëpërmjet edukimit,³³⁷ si dhe që ndikon negativisht në mirëqenien psikologjike.³³⁸ Norma të tilla mund të kontribuojnë në bullizmin dhe dhunën edhe mes djemve, pasi agresiviteti dhe dhuna mund të konsiderohen në shoqëritë patriarkale si “rites de passage” në burrëri dhe maskulinitet.³³⁹

Bullizmi online dhe dhuna kibernetike mund të ndikojnë në **mirëqenien** e fëmijëve. “Për shkak të bullizmit online, nuk kam llogari në rrjetet sociale”, tha një vajzë 14-vjeçare. Pra, bullizmi mund të kontribuojë në izolimin social dhe madje edhe depresionin tek të rinjtë, duke pasur parasysh përdorimin e gjerë të mediave sociale për të komunikuar dhe ruajtur marrëdhëniet shoqërore.³⁴⁰ Bullizmi online ka ndikuar në shëndetin mendor të fëmijëve:

“Djemtë kanë përjetuar më shumë presion gjatë pandemisë Covid-19, sepse kur prindërit e tyre kanë humbur vendet e punës, ata janë ndjerë të shtyrë të sigurojnë të ardhura për familjen dhe të punojnë.”

- Vajzë 15 vjeçare, cituar nga Save the Children

332 Biseda e RrGK-së me shumë gra të reja që përjetuan ngacmime seksuale në Universitetin e Prishtinës.

333 *Epoka e re*, “Kërcënojnë studentët: Merrni masa ose publikojmë emrat e profesorëve që bëjnë ngacmime seksuale”, 15 shkurt 2020.

334 Save the Children, *Young Voices*, 2022, f. 16.

335 Po aty, f. 16.

336 Dennis E. Reidy, Danielle S. Berke, Brittany Gentile dhe Amos Zeichnerb “Man enough? Masculine discrepancy stress and intimate partner violence”, National Library of Medicine, PubMed Central [në anglisht], 2014.

337 Po aty.

338 Alfred, Hammer dhe Good, “Male student Veterans: Hardiness, psychological well-being, and masculine norms” *Psychology of Men & Masculinity* [në anglisht] 2013.

339 David Plummer dhe Stephen Geofroy, “When bad is cool: Violence and crime as rites of passage to manhood”, *Caribbean Review of Gender Studies*, 4, [në anglisht] Janar 2010.

340 Për më shumë informata, shih Kapitullin 1.

fëmijët që përjetuan bullizmin online kishin më shumë gjasa të raportonin se ndiheshin të trishtuar ose të dëshpëruar, kishin probleme me gjumin dhe ndjeheshin të izoluar nga bashkëmoshatarët e tyre. Kur u pyetën për bullizmin kibernetik, 85% e fëmijëve thanë se duhet bërë më shumë për ta parandaluar atë.³⁴¹

Mes rritjes së konsiderueshme të fëmijëve që përdorin mësimin online gjatë pandemisë COVID-19, asnjë fushatë nuk duket të ketë informuar prindërit ose fëmijët në lidhje me **mbrojtjen e të dhënave**. Vetëm 60% e djemve dhe 62% e vajzave thanë se mësuan të përdorin internetin në mënyrë të **sigurt** në shkollë.³⁴² Fëmijët thanë se duhet të informohen për sigurinë në internet dhe se si mund të mbrohen në internet. Për shkak të zotësisë së tyre të pamjaftueshme digjitale, prindërit mund të mos kenë njohuri për rreziqet që lidhen me bullizmin kibernetik, dhunën kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve. Pra, prindërit mund të mos i mbrojnë siç duhet fëmijët e tyre.³⁴³ Në total, 87% e të anketuarve në sondazhin e UNDP-së thanë se edukimi mbi sigurinë në internet duhet të jetë pjesë e arsimit formal shkollor; dhe vetëm 3% nuk ishin dakord.³⁴⁴

“Për shkak të bullizimit në internet, unë nuk përdor rrjetet sociale.”

- Vajzë 14 vjeçare, cituar nga Save the Children

Disponueshmëria dhe miratimi i mekanizmave mbrojtës nga qeveria është përmirësuar me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve të vitit 2019, si dhe me udhëzimet administrative, udhëzimet dhe rregulloret e MASHTI-t për adresimin e dhunës në shkollë. Megjithatë, një pjesëmarrës i hulumtimit komentoj se ka “shumë pak dëshmi për respektimin e ndonjë protokollit për mbrojtjen e fëmijëve në shkollë”, duke përfshirë edhe atë lidhur me digjitalizimin.³⁴⁵ MASHTI dhe komunat nuk ofrojnë udhëzime të mjaftueshme, të përgjegjshme gjinore për shkollat se si të trajtojnë bullizmin kibernetik, duke penguar kështu adoptimin në praktikë. Ata nuk kanë publikuar asnjë informacion për zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Mbrojtjen

online të Fëmijëve/Nxënësve në Institucionet e Arsimit Parauniversitar.³⁴⁶ Nuk ekziston asnjë informacion i disponueshëm publikisht për kurrikulat për mësimin e sigurisë në internet, mbrojtjen e të dhënave personale në internet, sigurinë nga dhunën kibernetike ose mirëqenien digjitale. As RGK nuk mundi të gjente ndonjë fushatë edukative në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe prindërve për kërcënimet kibernetike. Nuk u gjet asnjë dëshmi

341 Save the Children, *Young Voices*, 2022, f. 6.

342 Po aty.

343 Siç ilustron kapitujt e mëparshëm, të rriturve u mungon njohuria edhe për mbrojtjen e të dhënave.

344 UNDP, *Digital Household Survey*, 2022.

345 Korrespondenca me RrGK-në, tetor 2023.

346 Republika e Kosovës, Qeveria, [Udhëzimi administrativ nr. 01/2019 për mbrojtjen online të fëmijëve/studentëve në institucionet e arsimit parauniversitar](#), 2019. Për më shumë informata, shih seksionin mbi [Rregullimin](#) të këtij kapitulli.

e koordinimit mësues-prindër për të rritur ndërgjegjësimin, pavarësisht kërkesave ligjore.³⁴⁷ Prandaj, njerëzve mund t'u mungojë **vetëdija** se si të raportojnë dhunën kibernetike me bazë gjinore në lidhje me arsimin, duke kontribuar kështu në mosraportimin.

Konkluzione

Sa i përket aspektit **rregullativ dhe kornizës ligjore**, marrja parasysh e aspektit gjinor tek politikat publike që lidhen me digjitalizimin dhe arsimin dallon; ligjet dhe politikat më të reja janë më të përgjegjshme gjinore apo edhe më transformuese. Megjithatë, disa strategji relativisht të reja, më të gjera që kanë referime ndaj arsimit dhe digjitalizimit, si Strategjia për Rininë 2019-2023, SKZH 2016-2021 dhe ARE mbeten neutrale gjinore sa i përket digjitalizimit. Strategjive më të reja gjithashtu u mungojnë treguesit e qartë, pikënisjet, objektivat dhe buxhetet që përmbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Kjo pengon monitorimin dhe vlerësimin e kontributeve për barazinë gjinore dhe mund të ndërhyjë në synimet e qeverisë për politikëbërjen e bazuar në dëshmi të informuara nga analiza e ndikimit gjinor. Korniza ligjore mbetet e pamjaftueshme për mbrojtjen e vajzave dhe djemve të ndryshëm nga rreziqet e lidhura me gjininë si dhuna kibernetike, bullizmi kibernetik nga shokët e klasës ose ngacmimi seksual online nga bashkëmoshatarët ose personeli i shkollës. Ai nuk merr parasysh sa duhet pengesat që hasin vajzat dhe djemtë e ndryshëm në qasjen në arsim cilësor, mjete digjitale dhe aftësi digjitale, veçanërisht barrierat me të cilat përballen vajzat dhe djemtë romë, ashkali dhe egjiptianë.

Sa i përket **Qeverisjes**, ekziston një baraspeshë gjinore brenda MASHTI-t, kështu që gratë dhe burrat kontribuojnë në vendimmarrje. Ekzistojnë sisteme të pamjaftueshme për gjetjen/përcjelljen dhe njohjen e aftësive të stafit udhëheqës, administratorëve të shkollave dhe mësuesve për të zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar reformat digjitale të përgjegjshme gjinore. Shërbimet publike digjitale të zhvilluara për e-Mësimin duket se nuk i kanë marrë parasysh sa duhet nevojat e vajzave dhe djemve. Sistemet e monitorimit dhe raportimi online i bullizmit kibernetik, ngacmimit seksual ose dhunës kibernetike në institucionet arsimore duket se nuk ekzistojnë. Mbledhja jo adekuate e të dhënave në shkolla dhe analiza e pamjaftueshme e të dhënave mund të ndikojë në vendimmarrjen e përgjegjshme gjinore për financimin e shkollave. Buxhetimi i përgjeshëm gjinor nuk është aplikuar

COVID-19 ekspozoi mungesën e **infrastrukturës** për digjitalizimin e arsimit në shkolla dhe shtëpi, duke katapultuar përpara planet e qeverisë dhe investimet ndërkombëtare në infrastrukturë. data. Infrastruktura adekuate mbetet e padisponueshme për sa i përket harduerit, softuerit dhe mundësive

të inovacionit. Softueri nuk mundëson gjithmonë mirëmbajtjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë.

Qasja në arsim, njohuri dhe zotësi digjitale dallon për njerëz të ndryshëm në varësi të pabarazive të ndërthurura që lidhen me gjininë, rrethanat ekonomike, përkatësinë etnike, (pa)aftësinë, vendndodhjen gjeografike dhe kohën. Gjatë pandemisë, nxënësit serbë, romë, ashkali, egjiptianë dhe me aftësi të kufizuara, si dhe ata të prekur nga dhuna me bazë gjinore, u përballën me sfida të shtuara. Vajzat kanë ndjekur arsimin për TIK në nivele më të ulëta se djemtë, kryesisht për shkak të stereotipave gjinorë lidhur me profesionet që i pengonin vajzat të angazhoheshin në këtë sektor. Për shkak të dinamikës së pushtetit gjinor, vajzat dhe gratë e reja mund të jenë në rrezik më të madh nga ngacmimi seksual dhe bullizmi kibernetik. Të njëjtat dinamika të pushtetit kontribuojnë në raportimin e paktë të rasteve pasi vajzat kanë frikë nga pasojat për mundësitë e tyre arsimore dhe të punësimit. Mësimdhënësve, prindërve dhe nxënësve/studentëve u mungon edukimi adekuat mbi sigurinë online të studentëve, mbrojtjen e të dhënave dhe mirëqenien digjitale, duke përfshirë edhe nga perspektiva gjinore. Angazhimi mësues-prindër në mirëqenien digjitale të nxënësve duket gjithashtu i ulët.

Digjitalizimi i punësimit dhe punës

Digjitalizimi ka transformuar botën e punës dhe paraqet mundësi të reja pune për gratë dhe burrat në mbarë botën. Ky kapitull shqyrton reagimin gjinor të përpjekjeve për digjitalizimin e programeve dhe proceseve të punësimit dhe punës, duke analizuar Rregulloren, Qeverinë, Infrastrukturën dhe Njerëzit. Kjo përfshin diskutimin e përgjegjshmërisë gjinore të AFP-së që nuk zbatohet nga MASHT-i, e cila synon të zhvilloj aftësi që adresojnë nevojat e tregut të punës.¹

Korniza Ligjore: Analiza gjinore politikave publike mbi digjitalizimin dhe punësimin

Ky seksion analizon reagimin gjinor të ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me digjitalizimin e punësimit dhe punës.

Ligji për Punën

Ky ligj i vitit 2010 rregullon “të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës”.² Kërkon shpërblim të barabartë për gratë dhe burrat, si dhe të drejta të barabarta në tregun e punës.³ Ligji i vjetër nuk i referohet punësimit apo digjitalizimit. As nuk rregullon vetëpunësimin, punën e pavarur, punën në distancë, apo marrëveshje të tjera fleksibile të punës që kanë të bëjnë me digjitalizimin. Kosova ende duhet të transpoztoj Direktivën e BE-së për trajtimin e barabartë ndërmjet burrave dhe grave të vetëpunësuar.⁴

Ligji i Punës përcakton diskriminimin në lidhje me seksin dhe ka një nen mbi diskriminimin në punë që përmend mundësi të barabarta për “kërkuesit meshkuj dhe femra” në punësim.⁵ Diskriminimi me bazë gjinore trajtohet edhe në Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁶ RrGK gjeti se “korniza joharmonike ligjore, me përkufizime dhe sanksione të mbivendosura dhe të ndryshme, mund të kontribuoj në konfuzion të madh dhe pasiguri ligjore në gjykata”; paqartësi në procedurat për paraqitjen e kërkesave; dhe shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të grave në lidhje me rekrutimin, promovimin, pushimin e lehonisë dhe ngacmimet seksuale në punë.⁷ Ligji i Punës ka kontribuar në diskriminimin me bazë gjinore në punësimin për shkak të kërkesës ligjore që punëdhënësit duhet të paguajnë për gjashtë muaj pushim të lehonisë, një dekurajues për punësimin e grave në vitet e tyre riprodhuese.⁸ Kjo mund të ndikoj edhe në punësimin e grave në punë të lidhura me TIK-un. Nëse IA duhet të futet për të mbështetur proceset e punësimit, diskriminimi para-ekzistues i bazuar në gjini në punësim mund të ndikoj në algoritme, duke kontribuar në diskriminimin e vazhdueshëm.⁹ Duke pasur parasysh këto çështje, veçanërisht nenin për pushimin e lehonisë, ligji është **negativ ndaj aspektit gjinor**, duke kontribuar drejtpërdrejt në

2 Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 03/L-212 për Punën, 2010, Neni 1

3 Po aty, Neni 55.

4 BE, Direktiva 2010/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 [mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një veprimtari në cilësinë e të vetëpunësuarit](#) dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 86/613 /EEC, OJ L 180, 2010, f. 1.

5 Nenet 1.17 dhe 6, respektivisht.

6 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore](#), 2015, dhe [Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#), 2015.

7 RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), Botimi i dytë, 2022, f. 35.

8 Po aty. dhe RrGK, [Mbajtja e një ekuilibri: Ndryshimi i Ligjit për Punën](#), 2016, f. 1.

9 Çështja e diskutuar në ngjarjen rajonale “Efektet e Tranzicionit Digjital në Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC)” organizuar nga TACSO, 3 gusht 2023.

diskriminimin me bazë gjinore ndaj grave gjatë punësimit,¹⁰ dhe duke prekur edhe gratë në sektorin e TIK-ut.

Ligji i Punës nuk është i harmonizuar me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës, i cili synon të përmirësoj rregulloret në lidhje me aranzhimet fleksibile të punës, pushimin e lehonisë, lejen e atësisë, pushimin prindëror dhe pushimin e kujdestarit.¹¹ Ligji i vitit 2010 nuk i rregullon këto leje. Përvoja e BE-së sugjeron se ndryshimet e duhura mund të lehtësojnë hyrjen e grave në fuqinë punëtore, duke përfshirë sektorin e TIK-ut.¹² Kjo do të ndodhte për shkak të specifikave të karrierës në këtë sektor, të cilat mundësojnë fleksibilitet, përmes të cilit transformimi digjital mund të çoj në kushte më fleksibile pune në mënyra që gratë të përfitojnë.¹³ Direktiva nuk i referohet në mënyrë eksplicite digjitalizimit, por parashikon rregullime fleksibil të punës duke përfshirë punën në distancë.¹⁴ Ekziston një shqetësim se si do të zbatohet fleksibiliteti në praktikë, si e drejta për t'u shkëputur nga puna dhe rreziqet që teknologjia mund të zgjeroj në vend që të reduktoj pabarazitë.¹⁵

BE-ja po vlerëson një propozim për një direktivë për të përmirësuar kushtet e punës në punën e platformës,¹⁶ e cila është një "formë punësimi në të cilën organizatat ose individët përdorin një platformë online për të hyrë në organizata ose individë të tjerë për të zgjidhur probleme specifike ose për të ofruar shërbime specifike në këmbim të pagesës".¹⁷ Legjislacioni i planifikuar vjen pasi gjykatat në të gjithë BE-në përballen me një numër në rritje të çështjeve që kërkojnë të përmirësojnë të drejtat e punës së punëtorëve me kontratë afatshkurtër,¹⁸ të cilat shpesh lidhen me punën në internet. Shënimi shpjegues për draft tekstin e direktivës referon mbrojtjen e grave në punën e platformës. Raportuesi i Parlamentit Evropian nga Komiteti për Punësimin dhe Çështjet Sociale ka propozuar përfshirjen e tekstit të mëposhtëm në Direktivë:

10 RrGK, *Gjetja e ekuilibrit: Ndryshimi i Ligjit të Punës*, 2016, f. 1.

11 *Direktiva e BE-së 2019/1158 për balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët dhe shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 2010/18/BE*, 2019.

12 RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë*, Botimi i dytë, 2022.

13 Anthony Larsson dhe Yamit Viitaaja, "Identifikimi i ndarjes digjitale gjinore: Si mund të ndikoj digjitalizimi në kushtet e ardhshme të punës për gratë", 2020.

14 *Direktiva e BE-së 2019/1158 për balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët dhe shfuqizimi i Direktivës së Këshillit 2010/18/BE*, 2019, Neni 3.1.f.

15 Për një diskutim të plotë, shih David JJ Ryan për RrGK dhe UNFPA, *Zgjerimi i Zgjedhjeve përmes Politikave Miqësore për Familjen*: Raporti Analitik i Kosovës, 2021. f. 17-19.

16 Elisabetta Gualmini, Raportuese e Parlamentit Evropian për Komisionin për Punësimin dhe Çështjet Sociale, *Raport mbi propozimin për një direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për përmirësimin e kushteve të punës në punën në platformë*, (COM(2021)0762 – C9-0454/2021 – 2021/0414 (COD)), 2022.

17 Observatori Evropian i Jetës së Punës – EurWORK, "Puna në platformë", *Përkufizim*. Më parë, Eurofound përdorte termin "punësim në turmë" për të kapur punën e klikimit të lidhur fillimisht me konceptin, por fenomeni ka ndryshuar dhe tani përfshin shumë lloje të tjera detyrash. Prandaj, Eurofound ka miratuar termin punë në platformë që nga viti 2018.

18 Joanna Gill për Fondacionin Thomson Reuters, "A mundet që rregullat e reja të BE-së ta bëjnë koncertin më të drejtë?", 3 shkurt 2023.

Për të mbrojtur personat që kryejnë punë në platformë nga dhuna, duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore, Shtetet Anëtare do të marrin masat e nevojshme për të siguruar që platformat digjitale të punës të zhvillojnë politika kundër dhunës dhe ngacmimit dhe të marrin masa parandaluese, në veçanti duke krijuar, me përfshirjen e përfaqësuesve të personave që kryejnë punë në platformë, kanale efektive të raportimit përmes platformave digjitale të punës, infrastrukturës digjitale ose mjeteve të ngjashme efektive.¹⁹

Në shkurt 2023, Parlamenti votoi për të hyrë në negociata ndërinstitucionale, duke miratuar raportin e Raportuesit dhe në qershor Këshilli Evropian ra dakord.²⁰ Negociatat filluan në korrik 2023.

Ndërkohë, diskutimet për projektligjin e punës në Kosovë kanë vazhduar që nga viti 2018. OBSHC-të kanë dorëzuar rekomandime në përputhje me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës. Që nga viti 2023, Qeveria nuk kishte ofruar një draft të ri për konsultim publik. As nuk kishte kryer një vlerësim ex-post të ndikimit gjinor të ligjit aktual, i cili mund të informonte projektligjin e ri. Ndërsa Kosova vazhdon të finalizoj Ligjin e Punës, ekzistojnë mundësitë për të inkorporuar kërkesat nga Direktiva e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës dhe Direktivës së propozuar për punën në platformë.

Ligji për Inspektoratin e Punës

Ligji për Inspektoratin e Punës, i ndryshuar në 2002 dhe 2008, ngarkon Inspektoratin me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës. MPMS-ja e mëparshme themeloi dhe mbikëqyrte Inspektoratin e Punës.²¹ Inspektorati duhet të adresoj çdo kërkesë të punonjësit në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave të punës. Nëse konstatohet një shkelje, Inspektorati duhet të marrë masa administrative.²²

Ankesat duhet të mbeten konfidenciale për të mbrojtur punonjësit.²³ Megjithatë, punëdhënësit i jepet informacion për të mbrojtur ankesën e tij.²⁴ Kjo kontradiktë në konfidencialitet mund t'i largoj punonjësit nga raportimi i shkeljeve të të drejtave të punës nga frika e pasojave.²⁵

19 Elisabetta Gualmini, Raportuese për Komisionin për Punësimin dhe Çështjet Sociale, [Raport mbi propozimin për një direktivë të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për përmirësimin e kushteve të punës në punën në platformë](#), 2022, Neni 15, Paragrafi 1.

20 Këshilli Evropian, Këshilli i Bashkimit Evropian, Deklaratë për shtyp, "[Të drejtat për punonjësit e platformës: Këshilli pajtohet me pozicionin e tij](#)" 12 qershor 2023, qasur më 8 dhjetor 2023.

21 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-017 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Inspektoratin e Punës](#) Nr. 2002/9, 2008, Neni 3.

22 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës](#), 2002, Neni 5.

23 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-212 për Punën](#), 2010, Neni 5.8.

24 Po aty, Neni 82.

25 RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), Botimi i dytë, 2022, f. 54.

Ligji nuk i referohet gjinisë, siç është hetimi i diskriminimit me bazë gjinore në punë ose në punësim. Si i tillë, ky ligj është **neutral gjinor**. Ai nuk përfshin as referenca për digjitalizimin, si për shembull detyrimet e Inspektoratit për të mbledhur dhe mbajtur në mënyrë të sigurt të dhëna të ndara sipas gjinisë për personat që parashtrojnë ankesa ose natyrën e ankesave të lidhura me gjininë. RrGK nuk gjeti analiza ex-post mbi zbatimin e ligjit duke përfshirë analizën e ndikimit gjinor. Inspektorati publikon raporte vjetore në faqen e tij të internetit.²⁶ Megjithatë, ato ofrojnë vetëm të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe i referohen gjinisë në lidhje me gratë dhe burrat që punojnë me ose pa kontrata.

Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

Ky ligj i vitit 2013 kërkon parandalimin e rreziqeve në punë, eliminimin e faktorëve që kontribuojnë në aksidente, ofrimin e informacionit, organizimin e konsultimeve me punonjësit dhe pjesëmarrjen e ekuilibruar në përmirësimin e shëndetit dhe sigurisë në punë.²⁷ Punëdhënësit duhet të përmirësojnë vazhdimisht kushtet e punës drejt shëndetit dhe sigurisë, pasi proceset teknike dhe teknologjike ndryshojnë.²⁸ Më tej, punëdhënësit duhet të hartojnë politika gjithëpërfshirëse parandaluese në lidhje me teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhëniet sociale dhe faktorët në mjedisin e punës.²⁹ Ligji nuk specifikon nevojën për t'u konsultuar me punëtorët gra dhe burra. Ligji është **neutral gjinor**.

Asnjë analizë nuk duket se ka monitoruar zbatimin e këtij ligji apo nuk ka mbledhur të dhëna për masën në të cilën transformimi digjital ka përfituar apo dëmtuar shëndetin dhe sigurinë e grave dhe burrave të punësuar. Hulumtimi i RrGK-së ka treguar se pak inspektime të punës janë marrë me shëndetin dhe sigurinë e grave në punë.³⁰

Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës

Ky ligj i vitit 2014 rregullon themelimin, organizimin, përgjegjësitë dhe financimin e APRK-së si ofrues publik i shërbimeve të tregut të punës, duke përfshirë politikat e punësimit dhe trajnimit profesional.³¹ Përgjegjësitë e zyrave të punës përfshijnë regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave të punëkërkuesve; informimin dhe këshillimin e punëkërkuesve; vlerësimin e nevojave për të informuar planet individuale të punësimit me orientimi në karrierë, trajnimin profesional, ndërmjetësimin e punësimit dhe subvencionet; zbatimin e masave aktive të tregut të punës; dhe promovimin e vetëpunësimit, sipërmarrjes dhe rehabilitimit profesional për grupet e cënueshme.³² Masat

26 Republika e Kosovës, [Inspektorati i Punës](#), uebfaqe, 2022, qasur më 10 tetor 2023.

27 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë](#), 2013, Neni 1.

28 Po aty, Neni 6.

29 Po aty, Neni 7.

30 RrGK, [Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë](#), Botimi i dytë, 2022.

31 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, 2014](#), Neni 6.

32 Po aty, Neni 7.

aktive të punës konsistojnë në “mbështetje dhe ndërhyrje të përkohshme për individë ose grupe” që përballen me vështirësi për të hyrë në punësim.³³ Ligji nuk e obligon APRK-në të bëjë analiza gjinore, si për shembull kur përgatit analizat e tregut të punës,³⁴ ose për të mbajtur të dhëna të digjitalizuara të ndara sipas gjinisë. As nuk specifikon ndonjë shërbim digjital të përgjegjshëm për gjininë që APRK duhet të ofrojë në internet. Pra, ligji është **neutral gjinor**. APRK nuk ka raporte vjetore në faqen e saj të internetit, të cilat mund të vlerësojnë reagimin gjinor të shërbimeve të tij publike, duke përfshirë vlerësimin e ndikimit gjinor ex-post.³⁵ As Zyrat e Punësimit apo Qendrat e Formimit Profesional (QFP) nuk kanë raporte të tilla.

Ligji për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara

Ky ligj i vitit 2009 thotë se personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e rehabilitimit dhe formimit profesional.³⁶ Qendra e Rehabilitimit Profesional të Kosovës është përgjegjëse për ngritjen e aftësive profesionale bazuar në nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin e teknologjisë për trajnimin dhe edukimin e personave me aftësi të kufizuara.³⁷ Ligji detyron organet shtetërore, punëdhënësit dhe OJQ-të të krijojnë kushte të përshtatshme dhe të punësojnë personat me aftësi të kufizuara. Çdo punëdhënës duhet të punësojë të paktën një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë punonjës.³⁸ Ligji i ndryshuar dhe plotësuar i vitit 2016 e përcakton formimin profesional si “proces arsimor për ndërtimin e aftësive, përmirësimin e kapaciteteve për të siguruar dhe kryer punë cilësore, për të avancuar nga një pozicion pune në tjetrin, duke përfshirë trajtimin e ndryshimeve në teknologji” dhe kushtet e tregut të punës.³⁹ Trajnimi profesional dhe rehabilitimi i personave me aftësi të kufizuara duhet të përfshijë këshillim mbi proceset teknologjike dhe aplikimin e teknologjisë.⁴⁰

Ligji nuk përmend gratë apo burrat. Megjithatë, ai parashikon mbështetje dhe trajnime profesionale bazuar në “trajtimin e barabartë duke përfshirë mundësitë gjinore”.⁴¹ Edhe pse ky ligj i referohet mbrojtjes nga diskriminimi dhe në përgjithësi është i **ndjeshëm gjinor**, ai është **neutral gjinor** lidhur me digjitalizimin.

33 Po aty, Neni 3.

34 Po aty, Neni 1.3.

35 APRK, “[Documentet](#)”, qasur më 4 shtator 2023.

36 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara](#), 2009, Neni 8.

37 Po aty, Neni 15.

38 Po aty, Neni 12, paragrafi 1 dhe 2.

39 Po aty, i ndryshuar dhe plotësuar me [Ligjin Nr. 05/L-078 për Trajnimin, Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin me Personat me Aftësi të Kufizuara](#), 2016.

40 Po aty, Neni 8.

41 Po aty, Neni 2.

RrGK nuk mund të gjente ndonjë analizë zyrtare të disponueshme publikisht të zbatimit të ligjit, e cila mund të kishte përfshirë analizën e ndikimit gjinor ex-post. Nuk ka të dhëna për numrin e personave me aftësi të kufizuara, gra dhe burra, të punësuar në sektorin privat apo publik, e lëre më në punë digjitale apo në sektorin e TIK-ut. OSHC-të që mbështesin personat me aftësi të kufizuara kanë deklaruar se Ligji është larg zbatimit, veçanërisht përgjegjësia e punëdhënësve për të punësuar të paktën një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë të punësuar; ata vërejtën mosveprimin e qeverisë në zbatimin e këtij neni.⁴²

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021

SKZH 2016-2021 përfshin punësimin, veçanërisht zhvillimin e burimeve njerëzore. Ajo synonte të adresonte pengesat kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.⁴³ SKZH-ja vëzhgoi renditjen e ulët të Kosovës në rajon për sa i përket fuqisë punëtore të kualifikuar dhe u përpoq të “ndryshoj politikat drejt bërjes së fuqisë punëtore të Kosovës si një motor zhvillimi”,⁴⁴ Një ndërhyrje e planifikuar ishte të përmirësonte korrelacionin midis aftësive të fituara në arsim dhe nevojave të tregut të punës, duke e bërë më të lehtë për studentët të gjenin punë dhe për nxënësit të hynin në shkollat profesionale.⁴⁵ Aktivitetet e planifikuara në kuadër të kësaj ndërhyrjeje nuk specifikojnë nevojën për zhvillimin e aftësive digjitale dhe SHTIM. As SKZH nuk i dha përparësi aftësive digjitale në programet e AFP-së, megjithëse planifikoi të ofroj AFP-në në sektorët prioritar.⁴⁶ Një aktivitet parashikonte zbatimin e PEDK dhe një skeme TIK nën Fondin e Punësimit dhe Zhvillimit, duke përfshirë zhvillimin e burimeve njerëzore për një ekonomi digjitale.⁴⁷ Nuk i referohej gjinisë në zhvillimin e këtyre burimeve njerëzore, megjithëse PEDK ka aktivitete që synojnë gratë në teknologji. SKZH nuk iu referua gjinisë ose nënpërfaqësimit të grave në AFP, TIK ose punë të tjera të lidhura me digjitalizimin. Ajo nuk përmbante tregues, baza, objektiva ose buxhete të përgjegjshme për gjininë që do të mundësonin matjen e progresit drejt barazisë gjinore. Ishte **neutrale gjinore**.

Nuk ekziston asnjë monitorim zyrtar i disponueshëm publik i SKZH-së 2016-2021, i cili mund të kishte përfshirë analizën e ndikimit gjinor ex-post për të informuar SKZH-në e re. SKZH-ja e re (2030) u hap për konsultim publik në vitin 2022.⁴⁸ RrGK e komentoi atë përmes platformës së konsultimit publik, duke përfshirë Planin e Veprimit dhe nevojën për tregues më të mirë të ndarë sipas gjinisë. Ekzistojnë mundësi për një SKZH 2030 më gjithëpërfshirëse gjinore, veçanërisht në lidhje me digjitalizimin dhe punën.

42 Diskutimet e RrGK me OSHC-të, 2018-2023; dhe KE, [Raporti i Kosovës 2022](#), 2022, f. 39.

43 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia Zhvillimore Kombëtare 2016-2021](#), 2016, f. 4.

44 Po aty, f. 6.

45 Po aty, f. 1.

46 Po aty, f. 13, Masa 3, Aktiviteti 2.

47 Po aty, f. 46, Masa 30, Aktiviteti 4.

48 Republika e Kosovës, ZKM, Zyra e Planifikimit Strategjik, [Strategjia Zhvillimore Kombëtare 2030](#), 2022.

Strategjia Zhvillimore e Inspektoratit të Punës 2023-2027

Kjo strategji synon të përmirësoj kapacitetet dhe punën e Inspektoratit të Punës, veçanërisht të inspektorëve.⁴⁹ Strategjia dhe Plani i Veprimit rrjedhin nga një analizë e sistemit të inspektimit të punës dhe një “proces konsultativ” me grupin e punës.⁵⁰ Anëtarët e grupit të punës nuk janë të listuar, kështu që është e paqartë nëse janë konsultuar OGSHC-të apo ABGJ. As nuk është e qartë nëse analiza e kërkuar ex-ante e ndikimit gjinor është kryer për të informuar Strategjinë, duke marrë parasysh përhapjen e diskriminimit me bazë gjinore në punë dhe mungesën e inspektimeve.⁵¹ Strategjia nuk përmend dallimet gjinore në kushtet e punës.

Strategjia vëren se nuk ekziston një sistem i standardizuar për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e statistikave të inspektimit të punës, gjë që çon në “planifikimin joefikas të vizitave të inspektimit” dhe përdorimin e pamjaftueshëm të të dhënave për të informuar vendimmarrjen strategjike; më tej vërehet “mungesa e një sistemi elektronik për ruajtjen e të dhënave dhe shkëmbimin e informacionit me institucionet e tjera qeveritare”.⁵² Prandaj, ajo planifikon të krijoj Sistemin e Informacionit të Inspektoratit të Punës (LIIP) për të “lehtësuar kalimin nga inspektimet e bazuara në letër dhe planifikimi i punës në inspektime elektronike dhe mbledhje automatike të të dhënave”.⁵³ Aktualisht, Inspektorati kryen inspektime duke përdorur letër dhe fut të dhëna të kufizuara në Microsoft Excel. LIIP do të mundësonte përdorim më efikas të burimeve të kufizuara, veçanërisht të kohës së inspektorëve.⁵⁴ Strategjia nuk specifikon nëse gjinia ose tregues të tjerë do të integrohen në LIIP. Është planifikuar rritja e numrit të inspektorëve, por nuk thuhet se kjo do të bëhet duke përdorur masa afirmative drejt barazisë gjinore në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. RrGK ka rekomanduar vazhdimisht që Inspektorati të angazhoj më shumë gra inspektore për të ndihmuar në adresimin e diskriminimit me bazë gjinore në punë.⁵⁵ Strategjia është në thelb **neutrale gjinore**, duke përfshirë edhe digjitalizimin e punës së Inspektoratit.

Strategjia Sektoriale 2018-2022

Kjo Strategji mbulonte fushat që ishin nën mandatin e MPMS-së.⁵⁶ Ajo synonte të përmirësonte politikat e punësimit, shërbimet dhe mirëqenien drejt zhvillimit gjithëpërfshirës dhe anëtarësimit në BE. Ajo synonte të rriste punësimin duke adresuar mospërputhjen midis aftësive dhe kërkesave të tregut; për të reduktuar pasivitetin; për të administruar më mirë tregun e punës; për

49 Inspektorati i Punës, *Strategjia Zhvillimore e Inspektoratit të Punës 2023-2027*, 2023, f. 4.

50 Po aty.

51 RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë*, 2022, f. 5.

52 Inspektorati i Punës, *Strategjia Zhvillimore e Inspektoratit të Punës 2023-2027*, 2023, f. 8.

53 Po aty, Objektivi 2 i Strategjisë.

54 Po aty., f. 11.

55 RrGK, *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Kosovë*, 2022, f. 86.

56 Republika e Kosovës, MPMS, *Strategjia Sektoriale 2018-2022*, 2017.

Strategjia ofronte një pasqyrë të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe përmendte një masë punësimi të ARE-s për të rritur pjesëmarrjen e grave.

të përmirësuar kushtet e punës; dhe për të reduktuar punësimin informal.⁵⁷ Strategjia ofronte një pasqyrë të pjesëmarrjes së grave në tregun e punës dhe përmendte një masë punësimi të ARE-s për të rritur pjesëmarrjen e grave.⁵⁸ Strategjia ka vëzhguar disa angazhime për arritjen e kësaj në strategjitë e tjera. Ajo parashikoi përmirësimin e punësimit të grave përmes masave

aktive të tregut të punës, duke planifikuar një vlerësim të këtyre masave për të kuptuar më mirë nevojat e grave.⁵⁹ Rezultati i pritshëm ishte rritja e numrit të grave përfituese; megjithatë, nuk u përmend asnjë buxhet.⁶⁰ Për promovimin e punës së QFP-ve dhe Zyrave të Punësimit në drejtim të përfshirjes së grave dhe adresimit të ndarjes profesionale të bazuar në gjini, Strategjia buxhetoi 58,000 €. ⁶¹ Strategjia përmendi shkurt se institucionet kanë mungesë të digjitalizimit; vetëm një masë trajtonte digjitalizimin, veçanërisht lidhur me skemën e pensioneve kontributdhënëse.⁶²

Strategjia ishte e **përgjegjshme gjinore** pasi merrte parasysh pabarazitë gjinore dhe kërkonte t'i reduktonte ato. **Ishte neutrale gjinore** në lidhje me digjitalizimin. Asnjë vlerësim i njohur ex-post nuk e ka ekzaminuar zbatimin e tij, duke përfshirë analizën e ndikimit gjinor.

Programet e Reformës Ekonomike

Drejt rritjes së punësueshmërisë së grupeve të cenueshme, veçanërisht grave dhe të rinjve të papunë afatgjatë, PRE 2020-2022 përfshiu një rishikim të Planit të Veprimit për Rritjen e Punësimit të të Rinjve dhe adresimin e sfidave për punësimin e grave.⁶³ Ai parashikoi trajnimin e 1000 personave në aftësitë e ekonomisë digjitale në 2020 dhe 2021. Një tregues ishte përqindja e individëve me aftësi digjitale; nuk ishte e ndarë sipas gjinisë. PRE vlerësoi se sektori i TIK-ut punësonte afërsisht 2,000 punonjës, që përbën më pak se 1% të të gjithë punonjësve, krahasuar me gati 4% të punonjësve në BE.⁶⁴ Nuk është cekur përqindja e grave dhe burrave të punësuar në këtë sektor. Ai deklaroi se Masa e Reformës 12, "Përmirësimi i Mjedisit për Inovacion dhe Sipërmarrje", ka ndikuar pozitivisht tek gratë përmes granteve dhe mbështetjes financiare për start-up-et. Falë kësaj mbështetjeje u hapën rreth 80 biznese të reja me nga dy deri në tre punonjës; 60% ishin të udhëhequra nga gratë.⁶⁵ PRE 2020-2022 ka planifikuar trajnime dhe këshillime

57 Po aty, f. 38.

58 Po aty, f. 12.

59 Po aty, f. 40.

60 Po aty, f. 58, Aktivitet 4.

61 Po aty, f. 59, Aktiviteti 9.

62 Po aty, f. 77, Aktiviteti 4.

63 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2020-2022](#), 2020, f. 101.

64 Po aty, f. 82.

65 Po aty, f. 84.

për të lidhur të rinjtë me mundësitë e punësimit në internet përmes Programit YOU. Ai nuk përmbante tregues të ndarë sipas gjinisë. Kështu, në lidhje me punësimin dhe digjitalizimin, PRE 2020-2022 ishte **neutral gjinore**.

PRE 2021-2023 planifikoi të “përmirësoj mjedisin për kërkimin, inovacionin dhe sipërmarrjen” duke plotësuar kuadrin ligjor, duke rritur fondet për Kërkimin, Zhvillimin dhe Inovacionin dhe funksionalizimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Ai synonte gjithashtu të zgjeronte “infrastrukturën dhe shërbimet e rrjeteve TIK për zhvillimin socio-ekonomik” drejt kërkimit dhe zhvillimit në TIK dhe forcimit të kapitalit njerëzor.⁶⁶ Kjo masë parashikonte skemat e kuponëve të inovacionit, skemat e garancisë së kredisë, programet për të lidhur bizneset me akademinë dhe trajnimin për të rinjtë dhe gratë sipërmarrëse në TIK.⁶⁷ Ai deklaroi shumën e fondeve të shpërndara për të mbështetur bizneset inovative fillestare, por nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë.⁶⁸ Dokumenti vëzhgoi se si mungesa e infrastrukturës së internetit me brez të gjerë gjatë pandemisë ndikoi negativisht në produktivitetin, konkurrencën e kompanive dhe mundësitë për vetëpunësim, mësimin në distancë, mësimin digjital dhe marketingun digjital. Dallimet gjinore nuk u diskutuan.

PRE parashikoi gjithashtu “Përmirësimin dhe zgjerimin e shërbimeve publike të punësimit dhe rritjen e punësimit të të rinjve të papunë afatgjatë, grave dhe grupeve të tjera të cenueshme”.⁶⁹ Një masë që synon “të rrisë punësueshmërinë dhe aftësitë për të papunët afatgjatë, të rinjtë, gratë dhe grupet e tjera të cenueshme të regjistruara në zyrat e punësimit dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës”. Kjo ishte planifikuar të përfshinte “përmirësimin e shërbimeve publike të punësimit dhe trajnimin profesional”, përmirësimin e masave aktive të tregut të punës nëpërmjet reformave të politikave, nënkontraktimin e ofruesve privat për programet e AFP-së dhe “hapjen e profileve të reja” bazuar në kërkesat e tregut të punës.

PRE 2021-2023, PRE 2022-2024,⁷⁰ dhe PRE 2023-2025⁷¹ ka integruar gjininë më mirë se PRE-të e mëparshme. Megjithatë, lidhur me digjitalizimin dhe zhvillimin e aftësive të TIK-ut drejt punësimit, asnjëri nuk përfshin tregues të ndarë sipas gjinisë për pjesëmarrësit në trajnim. Aktivitetet që lidhen me TIK-un nuk përmbajnë të dhëna të mjaftueshme të ndara sipas gjinisë. Kështu, në lidhje me punësimin dhe digjitalizimin, PRE-të janë të **përgjegjshme gjinore** në disa seksione, por vetëm të **ndjeshme gjinore** në të tjera. Ato mund të kishin përmbajtur më shumë tregues, baza, objektiva dhe angazhime buxhetore të përgjegjshme ndaj gjinisë, si p.sh. duke synuar një numër të

66 Po aty, f. 57, Masa 12.

67 Po aty, f. 84.

68 Po aty, f. 84.

69 Po aty, Masa 18.

70 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024](#), 2022

71 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2023-2025](#), 2023.

saktë të grave dhe burrave në Programin Youth Online dhe Upward (YOU). PRE-të gjithashtu mund të kishin një qasje më të ndërlidhur ndaj masave dhe aktiviteteve të punësimit të lidhura me digjitalizimin, duke marrë parasysh nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm të etnive dhe aftësive të ndryshme, si p.sh. duke zhvilluar më tej shërbime elektronike në Platformën eKosova dhe duke aplikuar modulën e pagesave elektronike.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2022-2026

PKZMSA 2022-2026 përfshin planet për miratimin dhe fillimin e zbatimit të Strategjisë së re Digjitale të Kosovës (2021-2030).⁷² Asnjë nga 15 prioritetet afatmesme të planifikuara për 2021-2024 nuk është i ndarë sipas gjinisë. Kapitulli 19 i Acquis fokusohet në Politikën Sociale dhe Punësimin, i cili përfshin standardet minimale në ligjin e punës, barazinë, shëndetin dhe sigurinë në punë dhe kundër diskriminimit.⁷³ Kërkesat e MSA-së përfshijnë nevojën për të krijuar mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, personat me aftësi të kufizuara, pakicat dhe grupet e tjera të cënueshme.⁷⁴ Aty përmendet përkrahja e donatorëve për ngritjen e kapaciteteve për MPMS-në dhe APRK-në, si dhe projektin për rritjen e punësimit të të rinjve. Këto synojnë: “Një treg gjithëpërfshirës social dhe dinamik i punës që ofron vende pune”, duke përfshirë vetëpunësimin e të rinjve. Një objektiv afatmesëm është mbështetja e ndërmarrjeve sociale me subvencione dhe grante për punësimin e grupeve të cënueshme.⁷⁵ Asnjë nga 11 masat sipas këtij Kapitulli nuk është i integruar gjinor, megjithëse Kapitulli përmend Ligjin për Barazi Gjinore si relevant. Nën Kapitullin 23 të Acquis mbi Gjyqësorin dhe të Drejtat Themelore, PKZMSA përfshin një objektiv afatmesëm drejt fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave në lidhje me eliminimin e dhunës me bazë gjinore.⁷⁶ PKZMSA nuk përmend shprehimisht aftësitë digjitale për punësim ose nuk ofron objektiva, tregues, baza, objektiva ose buxhet të përgjegjshëm gjinor për këto reforma. Prandaj, dokumenti është i **përgjegjshëm gjinor** në përgjithësi, por i **ndjeshëm gjinor** në lidhje me digjitalizimin dhe punësimin.

ZKM kryen monitorimin tremujor dhe vjetor të PKZMSA-së.⁷⁷ Sipas raportit të vitit 2022, asnjë nga masat lidhur me punësimin dhe digjitalizimin nuk zbatohet. Ndërsa raporti përmend gjininë që lidhet me të dhënat statistikore të pamjaftueshme për punën informale dhe hendekun gjinor të pagave, ai nuk diskuton digjitalizimin e punësimit nga perspektiva gjinore.⁷⁸

72 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit \(PKZMSA\) 2022-2026](#), 2022, f. 124.

73 Po aty, f. 164

74 Po aty, f. 166.

75 Po aty, f. 170.

76 Po aty, f. 192.

77 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Raport për zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit \(PKZMSA\) gjatë vitit 2022, 2023](#).

78 Po aty, ff. 41, 59-60.

Agjenda e Reformës Evropiane

Një objektiv i ARE-s është të rrisë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës.⁷⁹ Ajo ka prioritet trajtimin e punës së padeklaruar, “e cila prek gratë në përqindje më të lartë”, duke “përqendruar në punësimin formal, kushtet e punës dhe masat parandaluese; si dhe përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe ndalimin e punës së padeklaruar”.⁸⁰ Prioritetet e ARE përfshijnë përmirësimin e punësimit, të drejtave të punës dhe mirëqenies sociale, si dhe inkurajimin e përfshirjes së grave, pakicave dhe personave me aftësi të kufizuara.⁸¹ ARE parashikon rritjen e shkallës së punësimit të grupeve “më pak gjasa për t’u punësuar” duke ofruar mundësi punësimi dhe trajnime në IT për gratë, të rinjtë dhe duke hartuar profile të reja trajnimi.⁸² Lidhur me rritjen e punësimit, ai ka katër tregues: “Hartimi i një skeme për ripunësimin e individëve që kanë humbur punën gjatë pandemisë; mbështetje për punësimin e grave; punësim dhe trajnim për TI; [dhe] mbështetje për punësimin e personave me aftësi të kufizuara”.⁸³ Asnjë objektiv apo tregues nuk i referohet në mënyrë eksplicite gjinisë, punësimit dhe digjitalizimit. Në përgjithësi, ARE II është **përgjegjëse gjinore** pasi përpiqet të trajtoj dhunën me bazë gjinore, si dhe të fuqizoj gratë ekonomikisht. Në lidhje me punësimin dhe digjitalizimin, ARE II është **neutrale gjinore** pasi asnjë tregues, bazë, objektivë ose buxhet nuk matin kontributet për barazinë gjinore.

Qeverisja

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën gratë dhe burrat të ndryshëm kanë marrë pjesë në drejtimin, planifikimin, zbatimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve që lidhen me digjitalizimin e punësimit dhe punës. Ai diskuton aftësitë e tyre, shërbimet publike digjitale dhe financimin dhe prokurimin në lidhje me punësimin dhe punën nga perspektiva gjinore.

Historikisht, **MPMS-ja** tashmë e vjetëruar ka hartuar dhe **planifikuar** politikat e punës dhe punësimit, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin. Sipas faqes së vjetër, edhe pse ende të disponueshme, të MPMS-së, Departamenti i Punës kishte tre divizione: Divizioni i Politikave të Punësimit, Divizioni i Aftësimin Profesional dhe Divizioni i Koordinimit dhe Monitorimit të Zyrave të Punësimit.⁸⁴ Pas riorganizimit të ministrive

79 Republika e Kosovës, Qeveria, Faza e Dytë e Prioriteteve Politike BE-Kosovë: [Agjenda e Reformës Evropiane \(ARE\) II](#), 2021, f. 58.

80 Po aty, f. 58.

81 Po aty.

82 Po aty, Shtylla 3, treguesit: 3.1.c.1.1., 3.1.c.1.4., dhe 3.2.b.2.1.

83 Po aty, Objektiva 3.1.c.1.

84 Republika e Kosovës, MPMS, [Departamenti i Punës dhe Punësimit](#), uebfaqja, qasur më 8 dhjetor 2023.

nga qeveria, **MFPT** mori këto përgjegjësi. Është organi kryesor qeveritar përgjegjës për **udhëheqjen, planifikimin, koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin** e zbatimit të përpjekjeve të digjitalizimit që lidhen me punësimin dhe punën. RrGK nuk mundi të gjente një vendim publik të qeverisë që detajonte përgjegjësitë apo ndarjet e saj. Faqja e internetit e MFPT, e përditësuar në vjeshtën e 2023, përfshinte Departamentin për Politikën e Punës dhe Punësimin me Departamentin e Punës dhe Punësimin, Divizionin e Politikave të Marrëdhënive të Punës dhe Dialogut Social dhe Divizionin e Politikave të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.⁸⁵ Nuk kishte informacion në dispozicion në lidhje me pjesëmarrjen e grave dhe burrave në vendimmarrje.

Më parë, shërbimet publike të punësimin ishin nën MPMS.⁸⁶ Tani, në kuadër të MFPT, **APRK udhëheq** shumicën e shërbimeve publike të punësimin si një organ i pavarur. APRK është përgjegjëse për zbatimin e punësimin dhe **aftësimin** profesional përmes tetë qendrave për aftësim profesional.⁸⁷ Zyra qendrore në Prishtinë **koordinon** aktivitetet me zyrat e punësimin, QFP-të dhe institucionet tjera komunale.⁸⁸ APRK ka një Bord Këshillëdhënës me nëntë anëtarë, duke përfshirë përfaqësues nga MFPT, MIST, MASHT, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, organizatat e punëdhënësve, organizatat e punëtorëve, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës.⁸⁹ Strategjia e Arsimit 2022-2026 thekson rëndësinë që MASHT dhe MFPT të koordinojnë arsimin e të rriturve, AFP dhe Arsimin e të Rriturve, AAAPARr, institucionet e AFP-së, Zyrat e Punësimin dhe QFP-të.⁹⁰ Ristrukturimi i APRK është duke u zhvilluar dhe është planifikuar të finalizohet në vitin 2023.⁹¹ KE ka vërejtur nevojën për të rritur portofolin e shërbimeve të APRK-së dhe masat aktive të tregut të punës, për t'u kujdesur për më shumë punëkërkues dhe për të përmirësuar ndjeshëm menaxhimin, kapacitetet operacionale, "këshillimin për punësim, priorizimin e grave, të rinjve dhe të papunëve afatgjatë", menaxhimin e të dhënave, monitorimi dhe vlerësimi.⁹² Pavarësisht kërkesave, të dhënat për punonjësit gra dhe burra nuk u dhanë, kështu që nuk mund të vlerësohej shkalla në të cilën gratë dhe burrat të ndryshëm janë të angazhuar në vendimmarrje në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve të punësimin ose përfitimin nga këto shërbime. Duke pasur parasysh përgjegjësitë e tij për analizat e tregut të punës, anketat dhe studimet e nevojave të tregut të punës,⁹³ PARK duhet të kishte kryer një analizë gjinore

85 Republika e Kosovës, MFPT, [Departamenti për Punë dhe Politika të Punësimin](#), faqe interneti, qasur më 8 dhjetor 2023.

86 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [APRK](#), faqe interneti, 2023, qasur më 8 dhjetor 2023.

87 Po aty.

88 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimin të Republikës së Kosovës](#), 2014, Neni 6, 1.12.

89 Po aty, Neni 13.

90 Republika e Kosovës, Kuvendi, MASHT, [Strategjia e Edukimit 2022-2026](#), 2022, . 73.

91 KE, [Raporti i Kosovës 2022](#), 2022..

92 Po aty.

93 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-205 për Agjencinë e Punësimin të Republikës së Kosovës](#), 2014.

se si digjitalizimi i shërbimeve të tij mund të ndihmonte më shumë gra dhe grupe të cenueshme të qasen në tregun e punës, por një analizë e tillë duket se nuk ekziston.

Bizneset në pronësi të grave mund të jenë veçanërisht të cenueshme ndaj shkeljeve të të drejtave, ngacmimeve seksuale dhe kimit kibernetik për shkak të strukturave të pushtetit të pabarabartë, gjinor dhe ndërgjegjësimi të pamjaftueshëm për mekanizmat mbrojtës. Për shembull, një grua që zotëronte një biznes të vogël prodhimi ndau përvojën e saj duke përdorur mediat sociale në internet për të shitur produktet e saj.¹⁶⁴ Pasi publikoi numrin e saj të telefonit si pronare e kompanisë, ajo përjetoi ngacmime seksuale dhe përndjekje. Kjo vazhdoi për tre vjet. Si rezultat, ajo hoqi numrin e saj nga rrjetet sociale, gjë që e bëri të vështirë zhvillimin e biznesit të saj, pasi nuk mund të merrte porosi. Adresimi i përndjekjes dhe ngacmimeve seksuale në internet është përgjegjësi e PK-së. Megjithatë, biznesmenja tha se një oficer policie e inkurajoi që të mos e raportonte rastin pasi “do të duhej shumë kohë për të gjetur personin” dhe “rasti nuk do të merrej seriozisht nga policia”. Përgjigje të tilla mund t'i dekurajojnë gratë nga kërkimi i drejtësisë. Duke pasur parasysh

160 Po aty, “[Kategoritë e blerjeve në internet](#)”,

161 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

162 Forumi Ekonomik Botëror, [Raporti Global i Hendekut Gjinor 2022](#), 2022.

163 KKBZTH, [Bërja e politikave tregtare të përgjegjshme ndaj gjinisë: Kërkesat për të dhëna, zhvillimet metodologjike dhe sfidat](#), 2019.

164 Pjesëmarrëse, Trajnimi i RrGK për diskriminimin me bazë gjinore në punë, 2021.

marrëdhëniet e socializuara të pushtetit dhe tendencat më të gjera në lidhje me ngacmimin seksual ndaj grave, gratë afariste mund të jenë më të prirura ndaj ngacmimeve seksuale sesa burrat, gjë që mund të ndikoj në bizneset e tyre, si dhe në mirëqenien e tyre personale. Frika nga kërcënimet mund t'i pengoj gratë të përdorin zgjidhje digjitale për të zgjeruar bizneset e tyre.

Për shkak të qasjes së pamjaftueshme në njohuri ose burime financiare, gratë afariste mund të kenë mungesë të infrastrukturës për të mbrojtur veten, biznesin dhe punonjësit e tyre. MSME-të në pronësi të grave mund të jenë më të prirura ndaj sulmeve kibernetike dhe shkeljeve të të dhënave, sepse ato kanë më pak qasje në financa për të blerë softuer mbrojtës. Duke pasur parasysh njohuritë e kufizuara të grave dhe burrave për krimin kibernetik, gratë dhe burrat pronarë të MSME-ve mund të mos jenë të vetëdijshëm për kërcënimet kibernetike.

RrGK nuk mund të gjente informacione ose të dhëna të ndara sipas gjinisë për besimin e burrave dhe grave në bizneset ose operatorët digjital, si për shembull në kryerjen e pagesave online;¹⁶⁵ përgjegjshmëria gjinore e standardeve etike të bizneseve në lidhje me digjitalizimin; mbi mbrojtjen e bizneseve të dhënave personale të përdoruesve online; ose sigurinë kibernetike në kryerjen e pagesave në internet. Këto fusha kërkojnë hulumtime të mëtejshme, duke përfshirë analizën gjinore. Institucionet përkatëse nuk raportuan ndërmarrjen e ndonjë fushate që synonte në mënyrë specifike bizneset në pronësi të grave me informacion rreth mirëqenies digjitale.¹⁶⁶

Konkluzione

Sa i përket **Rregullores**, ligjet, strategjitë dhe programet që lidhen me biznesin dhe tregtinë priren të jenë neutrale gjinore. Me sa duket, ato nuk janë hartuar bazuar në VN(B)GJ ose konsultime adekuate me gratë dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë ZBGJ. Nuk kanë tregues, baza, objektiva ose buxhete të përgjegjshme ndaj gjinisë, kështu që është e vështirë të monitorohet ose vlerësohet progresi. Pagesat elektronike, tregtia digjitale, tregtia elektronike dhe mbrojtja adekuate e bizneseve dhe konsumatorëve që angazhohen në biznes dhe tregti të digjitalizuar kërkojnë rregullim të mëtejshëm bazuar në VN(B)GJ. Rregulloret në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve ishin neutrale gjinore.

Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë e bëri të vështirë vlerësimin e reagimit gjinor të politikave dhe programeve të **qeverisë**. Pa VN(B)GJ, angazhimin e ZBGJ-së në politikëbërjen për digjitalizimin dhe objektivat e qarta drejt barazisë gjinore në dokumentet e politikave, mund të konkludohet se nuk ka integrim të mjaftueshëm gjinor të programimit. Ndërkohë që ekzistojnë angazhime për avancimin e barazisë gjinore, politikat dhe deklaratat publike

165 Globalisht, barometrat e besimit nuk publikojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Për shembull, shihni Edelman, Edelman [Barometri i Besimit 2022](#), 2022.

166 Intervistat e RrGK me MIST dhe AKIN, 2021.

të zyrtarëve sugjerojnë aftësi të pamjaftueshme për politikat dhe programet e integritit gjinor. Platformave dhe shërbimeve digjitale në përgjithësi u mungon një perspektivë gjinore dhe të dhëna të ndara sipas gjinisë për përdoruesit. Përderisa AKIN mban të dhëna të ndara sipas gjinisë, Qeveria nuk ka publikuar të dhëna të ndara sipas gjinisë për të gjitha subvencionet dhe kreditë e dhëna. Buxheti i përgjegjshëm gjinor nuk është zbatuar.

Sa i përket **Infrastrukturës**, ndërveprueshmëria është e pamjaftueshme, tregtia elektronike është në një fazë fillestare dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk janë të disponueshme. Qasja në rrjetet me brez të gjerë dhe 5G është e pamjaftueshme. Zhvillimi i një ekosistemi inovativ po tërheq interes në rritje, por reagimi i tij gjinor mbetet i pasigurt.

Ekzistojnë informacione minimale të ndara sipas gjinisë në lidhje me **biznesin** dhe nevojiten analiza të mëtejshme gjinore. Gratë janë të nënpërfaqësuar në mesin e pronarëve të bizneseve dhe bizneseve fillestare për shkak të kufizimeve sociale dhe financiare. Ato përballen me sfida të shtuara për shkak të roleve gjinore që pengojnë qasjen e tyre në rrjete, zgjerimin e partneriteteve dhe rrjedhimisht rritjen e biznesit. Duke pasur parasysh mungesën e të dhënave, është e vështirë të vlerësohet njohuria e grave dhe burrave afarist në lidhje me digjitalizimin e bizneseve të tyre, megjithëse Kosovës në përgjithësi i mungon shkrim-leximi digjital. Mbështetja financiare për digjitalizimin e biznesit është e vështirë të vlerësohet duke pasur parasysh mungesën e të dhënave publike të ndara sipas gjinisë.

Ka të dhëna të kufizuara të ndara sipas gjinisë për **njerëzit**. Duke pasur parasysh rolet dhe marrëdhëniet gjinore, gratë afariste duket se kanë më pak qasje në trajnime dhe informacion dhe janë më të prirura për të përjetuar ngacmime dhe dhunë seksuale, gjë që ndikon negativisht në bizneset e tyre. Pak biznese në pronësi të grave janë të regjistruara, megjithëse përqindja është në rritje. Ndërsa disa avantazhe të përpjekjeve të digjitalizimit u bënë të dukshme gjatë pandemisë, gratë nuk janë gjithmonë në gjendje të përfitojnë nga mundësitë digjitale. Ato kanë më pak qasje në kapitalin social dhe financiar për të mbështetur dhe rritur bizneset e tyre.

Digjitalizimi i bujqësisë

Sektori i bujqësisë përbën afërsisht 8% të PBB-së së Kosovës dhe punëson rreth 23% të fuqisë punëtore.¹ Megjithëse pandemia e COVID-19 bëri që fermerët të pësonin humbje në prodhim dhe shitje,² sektori ka mundësi për rritje dhe për kontribut në jetesën e grave dhe burrave. Digjitalizimi ofron premtime për përmirësimin e produktivitetit, rrjetëzimit, marketingut dhe shitjeve për sektorin e bujqësisë.³ OUB përcakton “e-bujqësinë” për të përfshirë “dizajnimin, zhvillimin dhe aplikimin e mënyrave inovative për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë teknologjitë digjitale - në fushën rurale, me fokus parësor në bujqësi, duke përfshirë peshkimin, pylltarinë dhe blegtorinë”.⁴ Ky kapitull shqyrton përgjegjësinë gjinore të përpjekjeve dhe mundësive për digjitalizimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë, duke përfshirë dimensionet e Rregullores, Qeverisë, Infrastrukturës dhe dimensionet e njerëzve të Modelit të Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës që i përgjigjet gjinisë. Kapitulli bazohet në metoda të përziera kërkimore duke përfshirë analizën e përmbajtjes, analizën e të dhënave dhe intervistat; ai gjithashtu bazohet në një anketë përfaqësuese të ekonomive familjare në mbarë Kosovën me pyetje specifike për digjitalizimin.⁵

1 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023](#), 2021, f. 65.

2 Po aty.

3 RrGK për OUB, *Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme*.

4 OUB, [Strategjia Kombëtare e Bujqësisë elektronike](#), 2017.

5 RrGK për OUB, *Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, 2023. Analiza gjinore përfshiu një anketë statistikisht përfaqësuese në mbarë Kosovën me 809 familje rurale, me 400 gra dhe 409 burra në moshë pune (18-65). Ai përmban analiza të mëtejshme në lidhje me gjininë, digjitalizimin dhe ekonominë rurale.*

Korniza ligjore: Analiza gjinore e politikave publike mbi digjitalizimin e bujqësisë

Ky seksion analizon reagimin gjinor të ligjeve dhe politikave që lidhen me digjitalizimin e sektorit bujqësor.

Ligji për Regjistrimin e Bujqësisë

Ky ligj i vitit 2012 specifikon përmbajtjen dhe organizimin e Regjistrimit të Bujqësisë.⁶ Ai trajton mbledhjen, përpunimin, mbrojtjen e të dhënave personale dhe publikimin e të dhënave.⁷ ASK është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave.⁸ Ligji kërkon mbledhjen e të dhënave të bazuara në seks, lidhur me ekonomitë shtëpiake bujqësore; gjininë e pronarit të biznesit bujqësor dhe anëtarëve të familjes që punojnë për të; dhe kohën e shpenzuar për punë bujqësore, veprimtari të tjera fitimprurëse dhe arsimim.⁹ Për të gjitha llojet e njësive bujqësore, përfshirë ekonomitë shtëpiake bujqësore, kërkohen të dhëna për makineritë, pajisjet dhe ndërtesat bujqësore.¹⁰ Mund të mblidhen të dhëna për shkallën në të cilën njësitë bujqësore kanë përdorur mjete digjitale dhe digjitalizim në punën e tyre, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë për pronësinë, përdorimin dhe qasjen, por Ligji nuk e kërkon këtë.

Mbledhja e të dhënave përfshin një anketë të bërë derë më derë duke përdorur pyetëtorin e regjistrimit në ekonomitë shtëpiake bujqësore.¹¹ Kjo metodë mund të jetë joefikase dhe e pasaktë për shkak të gabimeve njerëzore.¹² Ekziston një teknologji më moderne për të përmirësuar cilësinë, efikasitetin dhe afatin kohor të rezultateve statistikore,¹³ edhe pse konteksti i Kosovës dhe nevoja për të arritur familje të ndryshme dhe të anketuar (sipas gjinisë) duhet të merren parasysh në digjitalizimin e regjistrimit. Familjet bujqësore anketohen në bazë të listave nga regjistrimi i popullsisë, ndërsa ndërmarrjet bujqësore, sipërmarrësit dhe njësitë e tjera ligjore që ushtrojnë veprimtari bujqësore anketohen në bazë të regjistrit të bizneseve, të përditësuar nga burimet statistikore dhe administrative në dispozicion.¹⁴

Në përgjithësi, ky ligj është i **ndjeshëm gjinor** sepse i referohet mbledhjes së disa të dhënave të ndara sipas gjinisë. Për sa i përket digjitalizimit të mbledhjes së të dhënave, ai është **neutral gjinor** dhe nuk i referohet dallimeve të mundshme në përdorimin e mjeteve digjitale nga gratë dhe burrat për të marrë pjesë në regjistrim ose për kryerjen e punëve bujqësore. Ligji

6 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-127 për Regjistrimin e Bujqësisë](#), 2012, Neni 1.

7 Po aty, Neni 1.

8 Po aty, Neni 10.

9 Po aty, Neni 6.

10 Po aty, Paragrafi 2.

11 Po aty, Neni 8.

12 FarmErp, [Mbledhja e të dhënave bujqësore: Kuptimi i rolit të Agritech në mbledhjen e të dhënave të fermës](#), 29 qershor 2022.

13 Po aty.

14 Po aty.

mund të kërkoj të dhëna të mëtejshme të ndara sipas gjinisë në lidhje me përdorimin e kohës brenda ekonomive shtëpiake bujqësore dhe digjitalizimit. Pavarësisht kërkesave, gjatë regjistrimit të bujqësisë janë mbledhur të dhëna të pamjaftueshme të ndara sipas gjinisë, si gjinia e pronarëve dhe punonjësve. Ato nuk ofrojnë të dhëna të mëtejshme ndërsektoriale të ndara sipas gjinisë, sipas përkatësisë etnike, vendndodhjes, moshës ose faktorëve të tjerë demografik.¹⁵

Ligji për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural

Ky ligj i 2023 shfuqizoi ligjet e mëparshme.¹⁶ Ai rregullon hartimin dhe zbatimimin e politikave kombëtare, të cilat duhet të jenë jodiskriminuese dhe të promovojnë barazinë.¹⁷ Ai specifikon se Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë do të shërbej si Agjenci e Pagesave dhe do të jetë përgjegjëse për zbatimimin e masave për bujqësinë dhe zhvillimin rural.¹⁸ Ai do të menaxhoj bazat dhe regjistrat e të dhënave bujqësore,¹⁹ duke përfshirë: gratë; prodhuesit dhe përpunuesit e produkteve bujqësore dhe ushqimore; shfrytëzuesit e tokës bujqësore (SIPT); identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve; përfituesit; prodhuesit në bujqësi të integruar; prodhuesit në prodhimin organik; tregtarët dhe importuesit e produkteve të caktuara bujqësore; Rrjetin e të dhënave të kontabilitetit të fermave (RrDHKF); çmimet e tregut të produkteve bujqësore; produktet bujqësore në skemat e cilësisë; dhe ndihma shtetërore në bujqësi. Ligji nuk specifikon që këto regjistra dhe baza të të dhënave duhet të mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë.

Ligji thekson se MBPZHR mund të bashkëpunojë me ministrinë e tjera, IAL-të dhe strukturat e tyre shkencore për të “bashkëfinancuar kërkimin mbi projektet zhvillimore” për bujqësinë, zhvillimin rural dhe infrastrukturën. Ligji parasheh themelimin e Këshillit për Kërkime të Aplikuara në Bujqësi për zbatimimin e projekteve. RrGK nuk gjeti dëshmi të ndonjë publikimi apo hulumtimi të kryer nga ky Këshill që përfshin analiza gjinore, siç është situata e grave dhe burrave në bujqësi. Ai nuk i referohet digjitalizimit siç është transformimi i procedurave të aplikimit nga fizike në elektronike ose tek përfituesit e masave. Ligji është **neutral gjinor**.

Programi për Zhvillim Rural 2020-2021

MBPZHR e ka zhvilluar këtë program bazuar në draft programin shtatëvjeçar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020.²⁰ Objektivi ishte rritja e konkurrencës së sektorit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, duke përdorur teknologjinë moderne për të rritur prodhimin, produktivitetin dhe sigurinë ushqimore.²¹ Ai identifikon sfidat duke përfshirë mungesën e njohurive se

15 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

16 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 08/L-072 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural](#), 2023.

17 Po aty., Neni 9, Paragraf 1.

18 Po aty., Neni 18.

19 Po aty., Paragrafi 2.6.

20 RrGK nuk ka mundur ta gjejë këtë program në internet dhe kështu ka analizuar vetëm planin 2020-2021.

21 Republika e Kosovës, MBPZHR, [Programi për Zhvillim Rural 2020-21](#), PD, f. 9.

si të përdoret teknologjia moderne, mjetet e pamjaftueshme financiare për investime dhe konkurrenca e ulët e fermerëve në tregjet e brendshme dhe të jashtme. Një tregues për matjen e objektivit për përdorimin më të mirë të teknologjisë moderne është numri i fermave të modernizuara që përdorin ose aplikojnë teknologji moderne.²² Objektivi për vitin 2021 ishte 472, por nuk ishte i ndarë sipas gjinisë. Programi nuk përmendi sfidat me të cilat përballen gratë në bujqësi, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin,²³ nuk përmbante asnjë masë afirmative për të adresuar sfidat dhe i mungonte një buxhet i përgjegjshëm për gjininë. Prandaj, **ishte neutral gjinor**. Programi vuri në dukje se “Të gjitha projektet e mbështetura nga Programi i Zhvillimit Rural i nënshtrohen kontrollit ex-post për një periudhë trevjeçare.”²⁴ Megjithatë, nuk u krye asnjë analizë e njohur ex-post e ndikimit gjinor për të vlerësuar sesi zbatimi i tij ndikoi ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm në bujqësi, megjithëse kjo mund të ishte përdorur për të informuar Strategjinë e re që zëvendëson këtë Program.

Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028

E miratuar në vitin 2021, kjo Strategji synon të mbështes një sektor konkurrues, inovativ agro-rural “të bazuar në njohuritë, teknologjinë dhe standardet moderne”.²⁵ Ajo planifikon zhvillimin e qëndrueshëm me vëmendje në përdorimin e burimeve natyrore dhe mjedisit. Ajo gjithashtu kërkon të siguroj “aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi të jetës për banorët në zonat rurale”. MBPZHR është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit përmes Autoritetit Menaxhues për këtë Strategji. Një objektiv është rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit në treg, duke u fokusuar në “kërkimin, inovacionin, teknologjinë dhe digjitalizimin”. Objektivi për reformën gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale kërkon digjitalizim dhe transferim njohurish.²⁶ Një objektiv për mbështetjen e bizneseve në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe ndërtimin e infrastrukturës sociale parashikon “promovimin e barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cenueshme”.²⁷ Strategjia thekson se “pjesëmarrja e grave në proceset vendimmarrëse do të sigurohet”, duke u dhënë grave mundësi të barabarta për të hyrë në fonde.²⁸ Strategjia në përgjithësi është e **përgjegjshme gjinore** pasi merr në konsideratë pabarazitë gjinore dhe objektivat e saj synojnë t’i adresojnë ato. Megjithatë, ajo është e **ndjeshme gjinore** vetëm në lidhje me digjitalizimin, sepse treguesit, bazat dhe objektivat nuk masin se si Strategjia do ta çoj më

22 Po aty, f. 37.

23 Shih RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme, dhe seksioni Njerëzit.

24 Republika e Kosovës, MBPZHR, [Programi për Zhvillim Rural 2020-21](#), PD, f. 16

25 Republika e Kosovës, Qeveria, MBPZHR, [Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028](#), 2021, f. 6.

26 Po aty, Objektiva 4, 4.3.

27 Po aty, Objektiva 3, 3.4.

28 Po aty, f. 43.

tej barazinë gjinore. Strategjia nuk përfshin buxhetim të përgjegjshëm ndaj gjinisë, si p.sh. se si fondet do të mbështesin gratë dhe burrat.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit

SKZH parashikoi mbështetje për sektorët e bujqësisë dhe IT.²⁹ Një aktivitet ishte krijimi i një platforme informacioni për Sistemin e Integruar të Informacionit të Bujqësisë për të nxitur konkurrencën në këtë sektor.³⁰ Kjo përfshinte RrDHKF, Regjistrin Elektronik të Fermerëve, Sistemin e Identifikimit të Parcelave të Tokës dhe Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit. Një aktivitet tjetër parashikonte forcimin e sistemit të menaxhimit të informacionit për fermat bujqësore dhe regjistrin e produkteve.³¹ Masat për bujqësinë dhe menaxhimin e të dhënave nuk kanë marrë parasysh gjininë. Ato as nuk shpjeguan se si masat dhe aktivitetet do të ndikonin tek gratë dhe burrat e ndryshëm në bujqësi. Prandaj, SKZH është **neutrale gjinore** në lidhje me bujqësinë dhe digjitalizimin.

Programet e Reformës Ekonomike

Planet PRE 2022-2024 për ndryshime strukturore në sektorin e bujqësisë.³² Plani bazohet në PRE 2021-2023, i cili synonte të përafronte politikat me Politikën e Përbashkëta Bujqësore të BE-së, digjitalizimin e sistemeve, rritjen e prodhimit vendor dhe rritjen e fuqisë punëtore të angazhuar në zinxhirin e prodhimit, përpunimit dhe shërbimit.³³ PRE rendit teknologjinë e vjetërsuar dhe mungesën e një sistemi të digjitalizuar midis barrierave strukturore që minojnë zhvillimin e sektorit bujqësor. Faktorë të tjerë përfshijnë madhësinë mesatare të fermës, produktivitetin e ulët, kostot e larta të prodhimit, fragmentimin e tokës, prodhimin e ulët dhe infrastrukturën e dobët të ujitjes. Një masë parasheh që MBPZHR, e mbështetur nga BAZH, do të zhvilloj softuer për sistemin e menaxhimit të granteve dhe subvencioneve.³⁴ Pavarësisht nga një mori problemesh të përmendura, asnjë aktivitet tjetër nuk ka të bëjë me digjitalizimin e sektorit bujqësor. Nuk ka as ndonjë tregues për të matur përmirësimet. Në lidhje me rezultatet sociale, punësimin, varfërinë dhe barazinë gjinore, PRE thekson se masat bujqësore synojnë të respektojnë barazinë gjinore dhe se gratë do të kenë prioritet kur vlerësohen aplikimet.³⁵ Ky PRE është i **përgjegjshëm gjinor**, pasi kërkon të reduktojë pabarazitë gjinore. Megjithatë, nuk janë përcaktuar tregues, baza, caqe apo buxhete lidhur me barazinë gjinore që do t'i mundësonin MBPZHR-së të masë ndryshimet e iniciuara nga kjo Strategji me kalimin e kohës.

29 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia Zhvillimore Kombëtare 2016-2021 \(SKZH\)](#), 2016.

30 Po aty, Masa e Reformës nr. 18: "Përmirësimi i NVM-ve në aktivitete me vlerë të shtuar më të lartë", Aktiviteti 3, f. 32.

31 Po aty, Masa e Reformës nr. 31: "Infrastruktura bujqësore në shërbim të agrobiznesit", Aktiviteti 5.

32 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024](#), 2022, Masa 15.

33 Po aty, f. 104.

34 Po aty, Masa 15.

35 Po aty, f. 105.

PRE 2023-2025 gjithashtu parashikon ndryshime strukturore në sektorin e bujqësisë. Ndërsa vëzhgon ndryshimet e arritura në vitin 2022, ajo pranon se disa aktivitete të planifikuara u zbatuan vetëm pjesërisht. Prandaj, ajo përfshin të njëjtën masë si PRE 2022-2024. Një aktivitet është që MBPZHR të ofroj trajnime dhe transferim njohurish, duke përfshirë inovacionin “si pjesë thelbësore e bujqësisë”. Kjo masë synon të respektoj barazinë gjinore. Duke parë se sektori i bujqësisë punëson rreth 23% të popullsisë së Kosovës, ajo shpreh shqetësimin lidhur me disbalancimin gjinor. Masa përfshin “dhënien e përparësisë gjinore” në vlerësimin e aplikacioneve dhe krijimin e vendeve të punës drejt gjenerimit të të ardhurave, adresimit të varfërisë dhe përmirësimit të mirëqenies.³⁶ PRE është i **përgjegjshëm gjinorë** në lidhje me bujqësinë dhe digjitalizimin, pasi kërkon të reduktoj pabarazitë gjinore përmes masave afirmative. Megjithatë, nuk janë vendosur tregues, baza, objektiva ose buxhete të përgjegjshme ndaj gjinisë që do t’i mundësonin MBPZHR-së të masë ndryshimin.

Qeverisja

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën gratë dhe burra të ndryshëm kanë marrë pjesë në udhëheqjen, koordinimin, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave që lidhen me digjitalizimin e bujqësisë. Ai diskuton aftësitë për politikëbërje dhe programim të përgjegjshëm gjinor. Ai gjithashtu vlerëson reagimin gjinor të shërbimeve publike digjitale, financimin e qeverisë dhe prokurimet në lidhje me digjitalizimin e bujqësisë.

MBPZHR është përgjegjëse për hartimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve që zhvillojnë bujqësinë, duke përfshirë bagëtinë, prodhimin bimor, zhvillimin rural dhe standardet e mirëmbajtjes.³⁷ Në vitin 2023, MBPZHR ka të punësuar 62 gra (41%) dhe 89 burra (59%).³⁸ Në pozitat vendimmarrëse, katër gra (36%) dhe shtatë burra (64%) kanë shërbyer si drejtor/e të departamenteve, ndërsa 11 gra (38%) dhe 18 burra (62%) kanë punuar si udhëheqës/e divizionesh. Kështu, ekziston një çekuilibër gjinor.

Ministria ofron shërbime të ekstensionit bujqësor dhe këshillimor rural në mbarë Kosovën përmes Departamenteve të Shërbimit Këshillimor dhe këshilltarëve publik lokal.³⁹ Këto janë në dispozicion në të gjitha komunitat; shërbimet janë falas dhe financohen nga qeveria.⁴⁰ Në maj 2022, kishte 445 këshilltarë të licencuar bujqësor me 38 që punonin për Qeverinë, duke përfshirë shtatë gra (18%) dhe 31 burra (82%).⁴¹ 407 këshilltarë të tjerë privat të licencuar nga Qeveria përfshinin 133 gra (33%) dhe 274 burra

³⁶ Po aty, f. 115.

³⁷ Republika e Kosovës, MBPZHR, faqja e internetit, “[Mandati dhe historiku](#)”, 2020, qasur në korrik 2023.

³⁸ Korrespondenca e RrGK me MBPZHR, 4 korrik 2023.

³⁹ [Faqja e internetit e MBPZHR](#), qasur më 11 shtator 2023.

⁴⁰ RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

⁴¹ Po aty.

(67%). MBPZHR ka licencuar 13 kompani për të ofruar shërbime këshilluese, dhe vetëm një është në pronësi të gruas. Nënperfaqësimi i grave në mesin e ofruesve të shërbimeve të ekstensionit mund të nënkuptojë se disa gra në zonat rurale mund të mos ndihen rehat duke u qasur në shërbimet e ofruara nga burrat, duke pasur parasysh normat dhe perceptimet sociale.⁴² Kjo mund të ndikojë gjithashtu në qasjen e grave në mjetet digjitale.

Duke marrë parasysh se strategjitë nuk kanë pasur gjithmonë vëmendje të mjaftueshme për të çuar më tej barazinë gjinore ose treguesit dhe objektivat përkatëse, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi mund të mos kenë qenë të përgjegjshëm ndaj gjinisë. Duke pasur parasysh se përpjekjet për digjitalizim janë mjaft të reja në MBPZHR, RrGK nuk mundi të gjej ndonjë analizë ex-post të ndikimit gjinor që trajton se si politikat dhe programet e MBPZHR-së kanë ndikuar tek gratë dhe burrat e ndryshëm.

Komisioni i Kuvendit për **Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë** është përgjegjës për monitorimin e përpjekjeve të Qeverisë në lidhje me bujqësinë, duke përfshirë digjitalizimin. Ka një bilanc gjinor prej pesë grave (50%) dhe pesë burrave (50%).⁴³ Në dy vjet, ky Komitet mbajti 53 takime për të cilat ekzistojnë të dhëna publike, por asnjëherë nuk ka diskutuar për digjitalizimin e bujqësisë me përgjegjësi gjinore, buxhetimin me përgjegjësi gjinore, apo financimin e përgjegjshëm gjinor për digjitalizimin e këtij sektori.

Aftësitë

Në përgjithësi, ka mungesë të ekspertëve me njohuri si në bujqësi ashtu edhe në digjitalizim.⁴⁴ Zyrtarët e përfshirë në bujqësi dukej se nuk e kuptonin qartë se çfarë do të thotë digjitalizim.⁴⁵ Ata “pohuan se digjitalizimi është shumë i rëndësishëm, siç u pa veçanërisht gjatë pandemisë COVID-19”, por “ata nuk kishin informacion dhe ide se si mund të përdoret digjitalizimi për bizneset dhe shërbimet e qytetarëve”.⁴⁶ Ata e konsideruan digjitalizimin “një proces të gjatë dhe të ndërlikuar”. Zyrtarët prireshin ta kuptonin digjitalizimin ngushtësisht si një “platformë e faqeve në internet” ku njerëzit mund të gjenin informacione rreth asaj që ofrojnë institucionet, siç janë proceset e hapura të prokurimit dhe aplikimet për grante ose subvencione.⁴⁷ Disa zyrtar vunë re se “procesi i digjitalizimit mund të siguroj forma më të shpejta, më të lehta dhe më efektive të komunikimit me fermerët, dhe se digjitalizimi mund të përfshij përditësimin e faqeve të tyre të internetit, përshtetimin e procedurave të shkarkimit dhe ngarkimit [] dhe trajnimin e fermerëve se si të përdorin telefonat inteligjent,

42 Po aty.

43 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë](#), qasur më 2 shtator 2023.

44 Intervistë e RrGK me palët e interesuara, dhjetor 2021.

45 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

46 Po aty.

47 Po aty.

kompjuterët dhe uebfaqe të ndryshme”.⁴⁸ Zyrtarët prireshin të mos e kishin konsideruar digjitalizimin nga perspektiva gjinore. Kjo dhe fakti që ligjet dhe strategjitë nuk kanë përfshirë gjithmonë vëmendjen e mjaftueshme ndaj gjinisë sugjeron se disa zyrtarëve u mungojnë njohuritë dhe aftësitë për të mbështetur proceset e digjitalizimit të përgjegjshëm gjinor në bujqësi. Asnjë vlerësim i njohur nuk ka shqyrtuar nevojat e trajnimit të MBPZHR-së dhe punonjësve të tjerë të qeverisë lidhur me digjitalizimin dhe barazinë gjinore.⁴⁹ Zyrtarët e MBPZHR raportohet se kanë njohuri dhe kapacitete të kufizuara për integrimin gjinor.⁵⁰ MBPZHR ka koordinuar me ABGJ për të ofruar trajnime, edhe pse palët e interesuara kanë vërejtur se mund të kishte pasur pjesëmarrje më të madhe.⁵¹

Shërbimet Publike Digjitale

Janë të disponueshme pak shërbime publike digjitale. MBPZHR përditëson shpesh faqen e saj në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Megjithatë, shumica e informacionit në lidhje me shërbimet online disponohen vetëm në gjuhën shqipe.⁵² Faqja e internetit ofron informacione se si të aplikoni për grante dhe subvencione, duke përfshirë thirrjet e publikuara për aplikime. Listat e përfituesve janë në dispozicion sipas emrit të përfituesit, komunës, shumës dhe emrit të projektit.⁵³ Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk publikohen. Një analizë e thirrjeve për të aplikuar për grante dhe subvencione, si dhe dokumente të tjera në faqen e internetit sugjeron se gjuha është neutrale gjinore. Imazhet dhe pamjet vizuale në faqen e internetit janë **neutrale gjinore**, duke përfaqësuar gratë dhe burrat.

Financimi dhe Prokurimi

KASH bën thirrje për buxhetim gjinor.⁵⁴ Kapitulli i MBPZHR nuk përmbante tregues apo objektiva drejt barazisë gjinore. Kështu, MBPZHR ende nuk ka zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, duke përfshirë edhe digjitalizimin. MBPZHR ka marrë mbështetje se si ta bëjë këtë, por nuk e ka përcjellur vazhdimisht.⁵⁵ Siç ka raportuar RrGK, “pasi Kosova nuk përdor buxhetimin programor, nuk ekziston asnjë sistem për analizimin e shumës së subvencioneve bujqësore të shpërndara për gratë dhe burrat”.⁵⁶ MBPZHR nuk publikon informacione të përgjegjshme gjinore në lidhje me buxhetin e

48 Po aty.

49 Korrespondenca e RrGK me OUB, gusht 2023.

50 Po aty.

51 Intervistë e RrGK me palët e interesuara, dhjetor 2021.

52 [MBPZHR faqja e internetit](#), qasur më 11 shtator 2023.

53 Po aty.

54 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026](#), 2023, Shtylla IV, f. 19, qasur më 18 shtator 2023.


55 RrGK ofroi trajnime dhe mentorim për MBPZHR në vitin 2017, duke prodhuar së bashku [Buxhetim për Bujqësi më të Mirë dhe Zhvillim Rural](#), i cili mund të shërbej si një udhëzues për aplikimin e buxhetit të përgjegjshëm gjinor.

56 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

tyre në internet, megjithëse kjo do të ishte një praktikë më e mirë në përputhje me QZHQ 5.c.1 të OKB-së.

Megjithëse financimi ka përfshirë masa afirmative për gratë fermere, një analizë e përfituesve të granteve dhe subvencioneve të MBPZHR-së sugjeron se burrat kanë përfituar më shumë se gratë. Në vitin 2020, 28,501 persona morën subvencione, duke përfshirë 1,358 gra (5%) dhe 27,142 burra (95%).⁵⁷ Ka pasur 343 grante: 130 për gra (38%) dhe 213 për burra (62%). Në vitin 2021, rreth 24,958 fermer përfituan nga subvencionet; vetëm 1,268 ishin gra (5%), duke marrë së bashku gati 1.9 milion € (7%).⁵⁸ Ndërkohë, burrat kanë marrë më shumë se 27 milion euro (93%). Në vitin 2022, gratë morën 29% të granteve dhe 5% të subvencioneve (Tabela #).⁵⁹ Situata është përmirësuar vetëm pak që nga viti 2017, kur RrGK zbuloi se “gratë përbënin vetëm 19% të të gjithë përfituesve të subvencioneve dhe transfereve” dhe morën më pak se 3% të shpenzimeve.⁶⁰ Ndërsa pabarazitë janë pjesërisht për shkak të faktit se gratë janë të nënpërfaqësuar në mesin e pronarëve të bizneseve bujqësore, kjo e bën të qartë nevojën e madhe për të identifikuar mënyra inovative për të mbështetur bizneset bujqësore të udhëhequra nga gratë. Kjo pabarazi gjinore në pjesëmarrje dhe financim nënvizon nevojën për përpjekje të vazhdueshme për të adresuar pabarazitë gjinore dhe për të promovuar mundësi të barabarta drejt një shpërndarjeje më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë të burimeve ndërmjet fermerëve.

Tabela #. Grantet dhe subvencionet e MBPZHR në vitin 2022 sipas gjinisë



57 Korrespondenca e RrGK me OUB, tetor 2023.

58 Republika e Kosovës, MBPZHR, *Raporti i Gjelbërt 2022 [Green Report 2022]*, qasur më 2 shtator 2023.

59 Korrespondenca me MBPZHR, tetor 2023.

60 RrGK, *Buxhetimi për Bujqësi dhe Zhvillim më të Mirë Rural*, 2017, f. 5.

Në përgjigje të pandemisë COVID-19, Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike të Qeverisë përfshinte dyfishimin e buxhetit të Programit të Pagesave Direkte në 2020, i buxhetuar në 24 milionë euro.⁶¹ Në shtator 2020, qeveria vendosi të dyfishoj shumat e pagesave direkte (subvencioneve) për çdo kulturë në Programin e Pagesave Direkte.⁶² Në vitin 2020, subvencionet kishin 28,501 përfitues gjithsej, duke përfshirë 1,358 gra (5%) dhe 27,142 burra (95%), duke demonstruar një çekuilibër gjinor.⁶³ Një çekuilibër gjinor ka ekzistuar edhe në ndarjen e granteve lidhur me këtë masë në vitin 2020: nga 343 projekte, gratë kishin 130 (38%), dhe burrat kishin 213 (62%).⁶⁴ RrGK nuk mund të gjente ndonjë analizë në lidhje me atë se si subvencionet dhe grantet përfitonin gra dhe burra të ndryshëm për të vlerësuar reagimin e tyre gjinor ose nëse ato përfshinin ndonjë iniciativë të lidhur me digjitalizimin.

Lidhur me prokurimin dhe punësimin, uebfaqja e MBPZHR ka një kategori për mundësitë e punësimit. Në mesin e 44 vendeve të lira të punës të analizuara nga RrGK në shtator 2023, asnjëra nuk përdori emra gjinorë asnjëherë për të synuar si burrat ashtu edhe gratë. Përkundrazi, emrat u shkruan për t'iu referuar burrave. Ndërkohë, 36 (82%) kishin një deklaratë që inkurajonte të dyja gjinitë ose gjininë e nënpërfaqësuar për të aplikuar,⁶⁵ dhe tetë (18%) nuk kishin një deklaratë të tillë. Dosjet e tenderit për prokurimin elektronik nuk kanë ndonjë deklaratë që inkurajon bizneset në pronësi të gjinisë së nënpërfaqësuar të aplikojnë.

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të MBPZHR për vitin 2022 nuk përfshin buxhetim të përgjegjshëm ndaj gjinisë.⁶⁶ Zyra Kombëtare e Auditimit nuk ka rekomanduar që MBPZHR të përfshij buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në praktikat e saj financiare.

Infrastruktura

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën është e disponueshme infrastruktura gjinore për sektorin bujqësor, duke përfshirë mjetet digjitale, softuerin dhe ekosistemet e inovacionit.

Mjetet dhe softueri digjital

Sektori i bujqësisë në përgjithësi është “digjitalizuar keq, me vetëm disa ferma me teknologji bujqësore precize”.⁶⁷ Kjo mund të jetë për shkak të

61 Republika e Kosovës, ZKM, Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike, 2020, Masa 4A. Lidhja nuk ishte më e qasshme në internet deri në kohën e këtij publikimi.

62 Korrespondencë me MBPZHR, tetor 2023.

63 Po aty.

64 Po aty.

65 MBPZHR, “Mundësi pune”, faqe interneti, qasur më 2 shtator 2023.

66 Zyra Kombëtare e Auditimit, *Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për vitin 2022*, qasur më 18 shtator 2023.

67 Republika e Kosovës, Qeveria, MBPZHR, *Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028*, 2021, f. 25.

“kapaciteteve të kufizuara financiare për të investuar në teknologjinë e re”.⁶⁸ Mungesa e pajisjeve moderne bujqësore në dispozicion në Kosovë, qasja në pajisje elektronike dhe shërbimi konsistent i internetit në fshatrat e largëta ishin ndër arsyet kryesore pse gratë dhe burrat e anketuar u përballën me sfida për digjitalizimin e punës bujqësore.⁶⁹

Është e vështirë të krahasohen të ardhurat bujqësore dhe jobujqësore sepse Kosova nuk ka pagesa direkte.⁷⁰ Infrastruktura e pagesave direkte u mundëson konsumatorëve të blejnë produkte duke përdorur llogaritë e tyre bankare nëpërmjet internetit. Pagesat direkte përdoren rrallë në Kosovë, veçanërisht në krahasim me vendet e BE-së.⁷¹ Aktualisht, pagesat direkte janë të disponueshme vetëm për disa kultura dhe kafshë; ato nuk janë të mundshme për tokën bujqësore.⁷² Duke pasur parasysh përdorimin e gjerë të parave të gatshme në blerjen e produkteve bujqësore, është e vështirë të monitorohet blerja e produkteve, shitjet, çmimet dhe informacione të tjera që mund të jenë të dobishme për prodhuesit, shitësit dhe konsumatorët. Disponueshmëria e kufizuar e kësaj infrastrukture ndikon në analizën gjinore të sjelljeve të ndryshme të konsumatorëve gra dhe burra që blejnë produkte të ndryshme bujqësore, të cilat mund të jenë informacione të dobishme për prodhuesit dhe shitësit. Pandemia e COVID-19 ekspozoi nevojën urgjente për digjitalizimin e bujqësisë. Shitjet më të ulëta kontribuan në humbjen e fitimeve,⁷³ disa prej të cilave mund të ishin parandaluar nëse pagesat direkte digjitale do të ishin të mundshme.⁷⁴

Në përgjithësi, MBPZHR-së i mungojnë sistemet për mbledhjen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.⁷⁵ Si SKZH 2016-2021 ashtu edhe PRE 2022-2024 renditën teknologjinë e vjetëruar dhe mungesën e sistemeve të digjitalizuara midis barrierave strukturore që minojnë zhvillimin e sektorit bujqësor, duke identifikuar infrastrukturën e nevojshme.⁷⁶ Këto politika evidentuan infrastrukturën e pamjaftueshme më parë të MBPZHR. Që nga viti 2023, zyrtarët e MBPZHR-së thanë se kanë softuer për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve dhe Regjistrin Elektronik të Fermerëve.⁷⁷ Regjistri mbledh informacione personale për fermerët, duke përfshirë gjininë e tyre,

68 Po aty.

69 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

70 Republika e Kosovës, Qeveria, MBPZHR, [Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028](#), 2021, f. 15.

71 Po aty.

72 Po aty.

73 Banka Botërore, [Cenueshmëria gjatë Covid-19 në Ballkanin Perëndimor](#), 2020, f. 6.

74 IADK, [“OUB dhe IZHBK prezantojnë rekomadimet për digjitalizimin e bujqësisë në Kosovë”](#), faqe interneti, 2022, qasur më 13 December 2023.

75 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

76 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024](#), 2022, Masa 15; dhe Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, [Strategjia Kombëtare Zhvillimore 2016-2021](#) (SKZH), 2016, Reforma Masa 18, Aktiviteti 3, f. 32, dhe Masa e Reformës 31, Aktiviteti 5.

77 Korrespondenca e RrGK me MBPZHR, shtator 2023.

kombësinë [etninë], tokën, mekanizmat bujqësore, bagëtinë dhe nënshkrimin elektronik.⁷⁸ Nuk përfshin informacione në lidhje me personat me aftësi të kufizuara. Sistemi i identifikimit të parcelave përfshin informacione të digjitalizuara që kanë të bëjnë me parcelat e tokës, dhe të dhënat bazë për fermerët merren nga Regjistri Elektronik i Fermerëve.⁷⁹ RrDHKF dhe Sistemi i Integruar i Informacionit Bujqësor janë funksional.⁸⁰ Ndërkohë nuk është zhvilluar Sistemi i Integruar i Administrimit dhe Kontrollit në Bujqësi. Asnjë softuer nuk duket të përfshij të dhëna për përdorimin e teknologjisë ose njohurive nga fermerët duke përdorur zgjidhje digjitale, të ndara sipas gjinisë.⁸¹ Sipas zyrtarëve, shumica e sistemeve mbajnë të dhëna për gjininë dhe vendndodhjen gjeografike, por jo për përkatësinë etnike ose aftësinë e kufizuar. Për më tepër, sistemet nuk kanë kapacitet për të gjeneruar të dhëna të ndara sipas gjinisë. Funksionalizimi i kësaj infrastrukture mund të lehtësoj analizën gjinore për të informuar politikëbërjen në bujqësi.

Ekosistemi Inovativ

RrGK u përpoq të gjente ndonjë dëshmi të ekosistemeve inovative në lidhje me sektorin e bujqësisë. Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural vëren se “një boshllëk horizontal lidhet me digjitalizimin e institucioneve dhe përfshirjen e dobët të inovacionit në rrjetet e transferimit të njohurive”.⁸²

Njerëzit

Ky seksion shqyrton se si normat, rolet dhe marrëdhëniet gjinore mund të ndikojnë në angazhimin e grave dhe burrave të ndryshëm në transformimin digjital të sektorit të bujqësisë. Ai diskuton qasjen e ndryshme të grave dhe burrave, pronësinë dhe përdorimin e mjeteve digjitale, si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në lidhje me reformat digjitale. Më pas, ai trajton aftësitë dhe ndërgjegjësimin e tyre të shkrim-leximit digjital dhe diskuton shkurtimisht mirëqenien dhe mbrojtjen digjitale.

Qasja, Pronësia, Përdorimi dhe Pjesëmarrja

Zyrtarisht, sektorët e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit punësojnë rreth 19,700 njerëz, afërsisht 76% burra dhe 22% gra.⁸³ Megjithatë, të dhënat zyrtare nuk pasqyrojnë me saktësi të gjitha gratë dhe burrat e përfshirë në këta sektorë, pasi disa punojnë në mënyrë informale pa e regjistruar punësimin e

78 Po aty.

79 Po aty.

80 Po aty.

81 Intervistë e RrGK me ekspertë e OUB-s, dhjetor 2021.

82 Republika e Kosovës, Qeveria, MBPZHR, [Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028](#), 2021, f. 49.

83 Po aty, f. 21. Gjinia e 2% të mbetur me sa duket ishte e panjohur.

tyre. Në vitin 2022, ishin rreth 51% e grave rurale dhe 49% e burrave rural të angazhuar në punë joformale ose të cenueshme.⁸⁴

Pak fermer kanë ndërmarrë hapa drejt modernizimit dhe digjitalizimit të veprimtarive të tyre bujqësore.⁸⁵ Një studim i vitit 2022 i bizneseve bujqësore zbuloi se pak të anketuar përdornin teknologji në punën e tyre.⁸⁶ Fermerët priren të përdorin metodat tradicionale të prodhimit dhe teknologjinë e vjetërsuar.⁸⁷ Aty ku pajisjet më të avancuara mund të kursejnë kohë, kjo mungesë e teknologjisë moderne kontribuon në orare më të gjatë të punës për të njëjtën sasi produkti. Ndërsa shumica e burrave dhe grave kanë qasje në telefonat inteligjent dhe internet, gratë rurale kanë më pak qasje në TIK dhe media sociale për punë, për shkak të niveleve të tyre relativisht më të ulëta të arsimit, kohës së kufizuar, qasjes më të dobët në financa dhe normave sociale.⁸⁸

Gratë rurale (87%) dhe burrat rural (85%) prireshin të përdornin TIK-un për komunikim më shumë sesa për biznes, megjithëse burrat përdornin mediat sociale për punë më shumë sesa gratë. Vetëm afërsisht një e treta e grave dhe burrave rural të anketuar përdorën aplikacione telefonike për të kontrolluar parashikimin e motit dhe vetëm një e katërta përdorën aplikacione telefonike për përditësime mbi çmimet e tregut.⁸⁹ Gratë dhe burrat që punojnë në ekonomitë rurale zakonisht komunikojnë përmes mediave sociale, si Facebook, Viber dhe WhatsApp, dhe ata rrallë përdorin email. Ata priren të preferojnë takimet fizike ndaj komunikimit online, duke e konsideruar ndërveprimin fizik “më efektiv”.⁹⁰ Gratë e përfshira në aktivitetet bujqësore, duke përfshirë OGSHC-të, thanë se “preferonin takime ballë për ballë për rrjetëzim dhe shkëmbim informacioni me fermerë të tjerë, shoqata dhe zyrtarë të bujqësisë”.⁹¹ Në mënyrë të ngjashme, UNDP-ja zbuloi se megjithëse ekzistonin mundësitë për përdorimin e TIK-ut për tu qasur në shërbimet publike për aktivitetet bujqësore, 38% e grave rurale dhe 41% e burrave rural prireshin të telefononin ose vizitonin një zyrë.⁹² Shqetësimi i grave dhe burrave rural me internetin mund të kontribuoj në mungesën e qasjes së tyre në shërbimet publike, duke përfshirë ato që lidhen me digjitalizimin e aktiviteteve bujqësore.⁹³

84 RrGK për FAO, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

85 Po aty.

86 IZHBK dhe OUB, Report, “Vlerësimi i bujqësisë digjitale, gjinisë dhe rinisë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike”, 2022, f. 21. Sondazhi raportoi 13% por nuk përfshiu kampionim të rastësishëm dhe kështu mund të mos jetë përfaqësues i popullatës së bizneseve bujqësore.

87 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

88 Po aty.

89 Po aty.

90 Po aty.

91 Po aty.

92 UNDP, [Anketa digjitale e familjeve](#), 2022.

93 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

Ndërkohë, 7% e grave rurale dhe 8% e burrave rural thanë se nuk kishin qasje në blerjen ose mirëmbajtjen e teknologjive digjitale.⁹⁴ Nga bizneset bujqësore të anketuara, “63% nuk kishin qasje në burime financiare për të investuar në teknologjitë e reja”.⁹⁵ Gratë dhe të rinjtë u përballën me sfidat më të mëdha pasi kishin më pak qasje në vendimmarrje dhe financa, veçanërisht pasi prona familjare priret të regjistrohet në emër të burrave. Të kesh më pak qasje në pronë dhe financa sesa burrat mund të nënkuptoj që gratë nuk mund të përballojnë të investojnë në reformat digjitale. Mund të nënkuptoj gjithashtu që gratë janë më pak të afta të përshtaten me krizat si kufizimet fillestare të COVID-19 në lëvizje. Qeveria u dha subvencione vetëm fermerëve të regjistruar dhe i pajisi ata me leje speciale për t’u kthyer në punë gjatë kufizimeve.⁹⁶ Meqenëse gratë kanë më pak biznese bujqësore të regjistruara, ato ka të ngjarë të kenë më pak qasje në këto subvencione; gratë që punonin në bujqësi gjithashtu duhej të merreshin me punën me përgjegjësitë e shtuara të kujdesit për fëmijët, gjë që kufizoi kohën që ato kishin në dispozicion për të hetuar zgjidhjet digjitale për bizneset e tyre bujqësore.

Vështirësitë për të hyrë në transportin publik kanë penguar qasjen e disa grave në tregje për shitjen e produkteve të tyre.⁹⁷ Qasja e dobët në transport mund t’i pengoj gratë të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me digjitalizimin e bujqësisë. Duke u përballur me çështje veçanërisht sfiduese të lëvizshmërisë, gratë me aftësi të kufizuara kanë vërejtur se familjet e tyre nuk e kanë konsideruar se mund të kontribuojnë në bizneset bujqësore; megjithatë, ato theksuan se TIK u ka krijuar mundësi atyre që të angazhohen më shumë sepse kanë më shumë kohë se anëtarët e tjerë të familjes për të mbështetur zhvillimin digjital të bizneseve bujqësore të familjeve të tyre, si përmes kërkimit të zgjidhjeve inovative, ndjekjes së trajnimeve online mbi teknologjitë e reja dhe përmirësimin të reklamimi online të produkteve.⁹⁸

Sa i përket pjesëmarrjes, 91% e grave rurale dhe 79% e burrave rural deklaruan se nuk angazhohen në vendimmarrje politike.⁹⁹ Shumë pak gra morën pjesë në vendimmarrje, takime bujqësore (vetëm 3% e grave dhe 12% e burrave), arsimim apo trajnim në lidhje me bujqësinë, e lëre më digjitalizimin e këtij sektori.¹⁰⁰ Arsyet kryesore të grave përfshinin mungesën e interesit, “informacionin e pamjaftueshëm, mungesën e transportit, detyrat shtëpiake dhe normat sociokulturore, ku burrat kanë tendencë të përfaqësojnë familjet e tyre në proceset vendimmarrëse”.¹⁰¹

94 Po aty.

95 IZHBK, “OUB dhe IZHBK prezantojnë rekomadimet për digjitalizimin e bujqësisë në Kosovë”, 2022.

96 Po aty.

97 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

98 Po aty.

99 Po aty.

100 Po aty.

101 Po aty.

Aftësitë dhe ndërgjegjësimi i shkrim-leximit digjital

Fermerët priren të ndihen më të sigurt duke përdorur metodat tradicionale, sepse atyre u mungon njohuria se si të përdorin teknologjitë më të reja dhe përfitimet nga ajo. Disa kanë frikë të humbasin klientët ekzistues nëse fillojnë të bëjnë biznes në internet.¹⁰² Përafërsisht 30% e grave rurale dhe 28% e burrave rural menduan se nuk kishin informacion të mjaftueshëm për shërbimet dhe teknologjitë digjitale në dispozicion. Më tej, 23% e grave rurale dhe 20% e burrave rural nuk përdornin teknologjinë digjitale në punën e tyre sepse mendonin se u mungonin njohuritë se si ta përdorin atë, duke përfshirë rritjen e fitimit ose marketingun. Arsimi i kufizuar i grave rurale paraqiste një sfidë për digjitalizimin e aktiviteteve të tyre bujqësore; shumë nuk kishin njohuri dhe aftësi se si të përdornin telefonat inteligjent, laptopët dhe internetin. Fermerëve u mungojnë “aftësitë e buta, mjetet financiare dhe vullneti për të filluar përdorimin e mjeteve digjitale më të avancuara”.¹⁰³

Njohuritë e pamjaftueshme për mënyrën e përdorimit të teknologjisë kanë ndikuar negativisht tek fermerët. Gratë veçanërisht kanë pasur vështirësi për ta aplikuar, sepse atyre u mungonte njohuria se si të përdorin platformat digjitale për të aplikuar për grante dhe subvencione, dhe ato do të preferonin të aplikonin fizikisht.¹⁰⁴

MBPZHR ZBGJ tha se institucioni kishte ofruar trajnime për fermerët se si të përdorin teknologjinë dhe pajisjet e reja dhe se gratë kishin marrë pjesë.¹⁰⁵ Megjithatë, ZBGJ vërejti se në përgjithësi “pjesëmarrja e grave në trajnime mbetet e ulët; kjo është më shumë për shkak të mungesës së vullnetit të grave për të marrë pjesë”, tha ajo.¹⁰⁶ Ndërsa asnjë analizë gjinore nuk duket të ketë ekzaminuar arsyet pse gratë mund të mos marrin pjesë në trajnime digjitale, hulumtimi sugjeron se disponueshmëria e kohës dhe qasja fizike mund të jenë ndër faktorët kryesor, së bashku me normat gjinore të socializuara. Siç sugjerojnë intervistat e RrGK me gratë në zonat rurale, gratë kanë më pak kohë për t’u angazhuar për shkak të punëve të shtëpisë, kujdesit për fëmijët dhe anëtarët e familjes; atyre u mungon gjithashtu informacioni për mundësitë e të mësuarit dhe nuk kanë qasje në transport për të marrë pjesë në trajnime.¹⁰⁷

Sipas OUB dhe IZHBK, 67% e bizneseve bujqësore që ata anketuan e konsideruan investimin në digjitalizim shumë të rëndësishëm për të ardhmen e tyre.¹⁰⁸ Ndërkohë 11% deklaruan se nuk do të përdornin kurrë teknologjitë

102 Po aty.

103 IZHBK dhe OUB, Raport, “Vlerësimi i bujqësisë digjitale, gjinisë dhe rinisë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike”, 2022, f. 43.

104 Intervistat e RrGK.

105 Intervistë e RrGK me ZBGJ, MBPZHR, mars 2022.

106 Po aty.

107 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

108 IADK, “*FAO dhe IADK prezantojnë rekomadimet për digjitalizimin e bujqësisë në Kosovë*” [FAO and IADK present recommendations for digitalisation of agriculture in Kosovo], 2022.

digjitale.¹⁰⁹ Në çdo rast, 96% deklaruan se nuk kishin asnjë program në dispozicion në zonën e tyre për të mbështetur zhvillimin e biznesit digjital dhe 44% thanë se nuk kishte mbështetje për trajnime. Nuk u dhanë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Ndërkohë, RrGK zbuloi se vetëm 5% e grave rurale dinin për shërbimet e ofruara të ekstensionit.¹¹⁰ Kjo sugjeron që ndërgjegjësimi i pamjaftueshëm për mundësitë e disponueshme mund t'i pengoj gratë të kenë qasje në trajnim, mentorim dhe shërbime të tjera mbështetëse që mund t'u mundësojnë atyre të digjitalizojnë punën e tyre bujqësore.

Mirëqenia dhe Mbrojtja Digjitale

Ekziston një mungesë e përgjithshme e infrastrukturës digjitale për bujqësinë në Kosovë. Kështu, nuk ka mjaft teknologji digjitale ekzistuese për të vlerësuar reagimin gjinor të masave mbrojtëse. Në mënyrë të ngjashme, mirëqenia digjitale e grave dhe burrave në bujqësi nuk mund të vlerësohet.

Konkluzione

Për sa i përket **rregullores**, kuadri ligjor dhe i politikave lidhur me digjitalizimin e bujqësisë është neutral gjinor, i ndjeshëm dhe i përgjegjshëm, në varësi të legjislacionit, ku politikat e reja janë më të përgjegjshme gjinore. Strategjitë nuk përcaktojnë tregues të qartë, baza, objektiva ose buxhete të ndara sipas gjinisë, kështu që është e vështirë të monitorohet ose vlerësohet progresi.

Në lidhje me **qeverisjen**, MBPZHR nuk ka një ekuilibër gjinor në të gjitha nivelet e vendimmarrjes. Meqenëse strategjitë nuk kanë përfshirë gjithmonë vëmendje të mjaftueshme për të çuar më tej barazinë gjinore, zbatim, monitorimi dhe vlerësimi mund të mos jenë gjithashtu të përgjegjshëm ndaj gjinisë, megjithëse asnjë analizë ex-post e ndikimit gjinor duket se nuk ka ekzaminuar se si politikat dhe programet e MBPZHR-së kanë ndikuar tek gratë e ndryshme dhe burrat. Zyrtarët priren të kenë mungesë njohurish dhe si rrjedhim aftësive për të mbështetur proceset e digjitalizimit të përgjegjshëm gjinor në bujqësi, megjithëse disa shohin mundësitë që paraqet digjitalizimi. Shërbimet publike digjitale janë shumë të kufizuara. Financimi ka përfshirë masa afirmative për gratë fermere, por gratë vazhdojnë të marrin shumë më pak fonde në grante dhe subvencione. MBPZHR nuk ka zbatuar buxhetim të përgjegjshëm gjinor.

Infrastruktura digjitale është përmirësuar vitet e fundit, por nevojiten dhe planifikohen zhvillime shtesë të softuerit. Në të gjitha sistemet, aftësitë e analizës së të dhënave kërkojnë përmirësim për të mundësuar analizën gjinore që mund të informoj politikëbërjen.

109 IZHBK, "OUB dhe IZHBK prezantojnë rekomadimet për digjitalizimin e bujqësisë në Kosovë", 2022.

110 RrGK për OUB, Profili Gjinor i Kosovës: Bujqësia dhe Jetesa Rurale, e ardhshme.

Sa i përket **njerëzve**, ndërsa gratë dhe burrat rural kanë qasje të barabartë dhe pothuajse universal në telefonat inteligjent dhe internetin, pak e përdorin teknologjinë për punën e tyre bujqësore. Njohuritë dhe informacionet e pamjaftueshme rreth përfitimeve që digjitalizimi mund t'u sjellë bizneseve të tyre, së bashku me hezitimin për të përqafuar ndryshimin, duket se janë ndër faktorët kryesor që ngadalësojnë pranimin e reformave digjitale nga gratë dhe burrat. Gratë në bujqësi përballen me sfida të shtuara në lidhje me kohën, burimet, financat, transportin, rrjetet, trajnimin dhe subvencionet që pengojnë angazhimin e tyre në transformimin digjital. Duke pasur parasysh se sektori bujqësor ka infrastrukturë minimale digjitale dhe pak njerëz e përdorin atë, ky raport nuk mund të vlerësoj plotësisht nëse ekzistojnë mbrojtje të mjaftueshme për mirëqenien e grave dhe burrave të ndryshëm.

Digjitalizimi i mbrojtjes së mjedisit, energjisë dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimatike

Ndërsa digjitalizimi mund të ofrojë përfitime, ai gjithashtu mund të ndikojë negativisht në mjedis, si duke rritur përdorimin e energjisë dhe emetimet e karbonit, ashtu në asgjësimin e pahijshëm të mjeteve digjitale në deponi, gjë që kontribuon në mbetjet elektronike (e-mbeturinat).¹ Kështu, BE-ja ka prioritet tranzicionin e gjelbër së bashku me zhvillimin ekonomik, lirinë dhe mbrojtjen e qytetarëve, duke përfshirë digjitalizimin.² Objektivat përkatëse të BE-së PVGJ III e kanë përfshirjen e grave të ndryshme në proceset vendimmarrëse për ruajtjen e mjedisit dhe ndryshimet klimatike; dhe përmirësimin e qasjes së tyre në ekonominë e gjelbër dhe rrethore, mundësitë e sipërmarrjes dhe mjetet alternative të jetesës.³

1 See C. Stoll, L. Klaaßen, dhe U. Gellersdörfer, "Gjurma e karbonit e Bitcoin", *Joule* 3, 2019, ff. 1647–1661; dhe Ankit, et al., "Mbetjet elektronike dhe rrjedhjet e tyre Ndikimi në shëndetin dhe mjedisin e njeriut: Kërcënimi dhe menaxhimi ekologjik global", *Teknologjia dhe Inovacioni Mjedisor*, 2021.

2 BE, "Prioritetet e BE-së". Shih poashtu KE, "Prioritetet e Komisionit Evropian", qasur më 29 gusht 2023.

3 KE, Objektivat dhe Treguesit për të përshtatur zbatimin e Planit të Veprimit Gjinor III (2021-25), BE, Komunikimi i Përbashkët për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Plan i Veprimit Gjinor i BE-së (PVGJ) III – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe të grave fuqizimi në Veprimin e Jashtëm të BE-së, 2020, f. 30-31.

Në nivel global, gratë mbajnë në mënyrë disproporcionale barrën e degradimit ekstrem të mjedisit dhe ndryshimeve klimatike.⁴ Kur burimet e ujit dhe energjisë rrallohen, gratë duhet të kushtojnë më shumë nga koha e tyre për të siguruar familjet e tyre, shpesh në kurriz të arsimit, mundësive ekonomike të paguara ose kohës së lirë.⁵ Gratë përbëjnë 80% të popullsisë së zhvendosur me forcë për shkak të ndryshimeve klimatike dhe përballen me një rrezik 14 herë më të lartë të vdekshmërisë për shkak të ndryshimeve klimatike.⁶

Kosova përballlet me sfida të shumta mjedisore, duke përfshirë ndotjen, ndryshimet klimatike, fatkeqësitë natyrore dhe kapacitetet e pamjaftueshme për t'iu përgjigjur këtyre çështjeve.⁷ Disa nga sfidat mjedisore të Kosovës lidhen me emetimet e CO2 nga prodhimi dhe përdorimi i energjisë, kështu që ky raport diskuton çështjet e ndërlydhura të përdorimit të energjisë, mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike. Kosova prodhon shumicën e energjisë përmes termocentraleve të vjetruara me qymyr, e përdor energjinë në mënyrë joefikase dhe pëson humbje teknike në rrjetet e shpërndarjes së energjisë elektrike.⁸ Sektori i energjisë, termocentralet, transporti, aktivitetet bujqësore dhe mbeturinat shtëpiake janë ndër kontribuesit më të mëdhenj në ndotjen e ajrit.⁹ Meqenëse ndryshimet klimatike ndikojnë ndryshe tek gratë dhe burrat e ndryshëm, nevojat e tyre ndryshojnë.¹⁰ Prandaj, politikat e përshtatjes dhe zbutjes ndaj ndryshimeve klimatike duhet të bazohen në analizën gjinore dhe të jenë të përgjegjshme gjinore.¹¹

Ky kapitull shqyrton përgjegjshmërinë gjinore të përpjekjeve të digjitalizimit të Kosovës në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, energjinë dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike, duke shqyrtuar dimensionet e Rregullores, Qeverisjes, Infrastrukturës dhe Njerëzve të Modelit të Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës të Përgjegjshëm ndaj Gjinisë.¹²

4 UNECE, *Standardi i përgjegjshëm gjinor*, 2019.

5 Po aty.

6 BE, Komunikatë e Përbashkët për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Plani i Veprimit Gjinor i BE-së (PVGJ) III – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Veprimin e Jashtëm të BE-së, 2020, f. 18.

7 UNDP, faqe interneti, “Mjedisi, klima dhe qëndrueshmëria ndaj fatkeqësive”, qasur më 23 gusht 2023 por nuk është me e qasshme.

8 Republika e Kosovës, Qeveria, Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023, 2021, f. 60.

9 UNDP, “Gjinia dhe ndryshimet klimatike në Kosovë: analiza gjinore në sektorët e ndërlydhur me ndryshimet klimatike dhe veprimi i ndryshimeve klimatike”, përmbledhje e politikave, draft i ndarë me RrGK, f. 11.

10 Po aty.

11 Shih kapitullin 1.

12 Ndërsa një pjesë e përgjegjësive të MMPHI, transporti, planifikimi hapësinor dhe qytetet digjitale nuk u shqyrtuan në detaje për shkak të kufizimeve kohore dhe informacionit. Për një diskutim të shkurtër, shihni Kapitullin 1.

Korniza ligjore: Analiza gjinore e politikave publike mbi digjitalizimin e mbrojtjes së mjedisit, energjisë dhe ndryshimeve klimatike

Ky seksion analizon reagimin gjinor të ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me digjitalizimin e mbrojtjes së mjedisit, energjisë dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimatike. Ai diskuton shkallën në të cilën këto janë miratuar në praktikë me informacion të disponueshëm.

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Ligji original i 2010-ës synonte të “parandalonte ose zbuste ndikimet negative të projekteve të propozuara publike dhe private”, duke mbrojtur dhe përmirësuar mjedisin, shëndetin e njerëzve dhe cilësinë e jetës.¹³ Ai deklaroi se një Vlerësim i Ndikimit Mjedisor (VNM) do të vlerësojë ndikimet direkte dhe indirekte të një projekti të caktuar në qeniet njerëzore, florën, faunën, tokën, ujin, ajrin dhe klimën.¹⁴ Ligji nuk përmbante një perspektivë gjinore ose nuk kërkonte ndonjë vlerësim të ndikimit gjinor si pjesë e VNM-së. Ai ishte **negativ gjinor**, duke përforcuar normat dhe stereotipet gjinore përmes gjuhës së tij.¹⁵

Në vitin 2022, Qeveria miratoi një ligj të ri për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i cili hyri në fuqi në vitin 2023, duke zëvendësuar versionin e vitit 2010. Qëllimi i tij është të parandalojë ose reduktoj ndikimet negative të projekteve të propozuara publike dhe private duke përcaktuar rregullat dhe procedurat për marrjen e pëlqimit që përfshin vlerësimin e ndikimeve të projekteve në mjedis.¹⁶ Ai përcakton procesin e VNM-së për të përfshirë përgatitjen e një raporti nga aplikantët e projektit, konsultimet publike, rishikimin institucional të VNM-së dhe informacione shtesë si dhe konkluzionet e Ministrisë bazuar në ekzaminimin e tij.¹⁷ Në përputhje me rregulloret e BE-së, ligji e përkufizon “projektin” si “ekzekutimin e punimeve të ndërtimit, të instalimeve të tjera apo skemave të tjera, heqjen ose çaktivizimin e instalimeve ose skemave, [apo] ndërhyrje të tjera në mjedisin natyror dhe peizazhin”.¹⁸ Ligji nuk i referohet digjitalizimit, siç janë detyrimet për digjitalizimin e të dhënave ose proceset e VNM. Megjithatë ligji përmend në mënyrë eksplicite projektet digjitale, ku projektet e digjitalizimit mund të kenë implikime mjedisore, për të cilat duhet të kryhen VNM.

13 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis](#), 2010, Neni 1, paragrafi 1.

14 Po aty, Neni 3.

15 Përdoret vazhdimisht forma mashkullore e emrave kur i referohet posteve publike, si Ministri, Kryetari, Inspektori, Aplikuesi dhe Eksperti.

16 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis](#), 2023, Neni 1.

17 Po aty, Neni 3, Paragrafi 1.14.

18 Po aty, Neni 2.

Me prodhimin gjithnjë në rritje të produkteve elektronike, rritet nevoja për asgjësimin e mbetjeve të lidhura, duke çuar në përdorimin e vendgrumbullimeve të paligjshme dhe një kërkesë në rritje për ndërtimin e vendeve të duhura të depozitimit të mbetjeve elektronike. Nëse nuk ndërtohen sipas rregulloreve mjedisore dhe shëndetësore, këto vende paraqesin një kërcënim joproportional për gratë dhe fëmijët. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) i ka identifikuar këto vende si një rrezik global në rritje për gratë që punojnë në sektorët informal të mbetjeve dhe fëmijët që luajnë në ato zona për shkak të ekspozimit të tyre ndaj kimikateve toksike.¹⁹ Kjo nënvizon rëndësinë e kryerjes së një analize gjinore krahas VNM-ve për të siguruar që ndërtimet përfshijnë masa për të eliminuar ekspozimin ndaj kimikateve që paraqesin rreziqe specifike për gratë. Ligji i ri nuk përmban asnjë referencë për gjininë dhe nuk kërkon që VNM të përfshijë analizën e ndikimit gjinor. Ligji përdor gjuhë të njëanshme gjinore, duke iu referuar inspektorit të mjedisit si “ai”, duke supozuar se roli do të plotësohet nga një burrë.²⁰ Ai është **negativ gjinor**, duke përforcuar normat dhe stereotipet gjinore përmes gjuhës së tij, ndërkohë që lejon që VNM-të të injorojnë dallimet gjinore, duke përforcuar potencialisht në vend që të adresojnë pabarazitë. VNM-ve të kryera për të informuar projektet në lidhje me digjitalizimin mund t’i mungojnë analizat e ndikimit gjinor se si ndryshimi i klimës dhe degradimi mjedisor mund të ndikojnë në mënyra të ndryshme tek gratë dhe burrat.

Ligji dhe Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor

Në vitin 2010, Kuvendi miratoi Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM), i cili synon të siguroj mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut përmes vlerësimit mjedisor të planeve dhe programeve.²¹ Në qershor 2023, Qeveria miratoi një projektligj të ri për Vlerësimin Strategjik Mjedisor që përcakton rregullat dhe procedurat për vlerësimin e “ndikimeve mjedisore të planeve dhe programeve të iniciuara nga autoritetet lokale dhe qendrore për të siguruar [një] nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit” dhe zhvillim të qëndrueshëm.²² Projektligji përputhet me Direktivën e BE-së për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.²³ Sipas udhëzimeve të KE-së, planet e përdorimit të tokës i nënshtrohen VSM-së, duke përcaktuar se si mund të zhvillohet toka ose duke vendosur rregulla ose udhëzime për llojin e zhvillimit që mund të jetë i përshtatshëm ose i lejueshëm në zona të veçanta, siç janë planet e menaxhimit të mbetjeve ose burimet ujore. Ngjashëm me Direktivën e BE-së, projektligji zbatohet për ndikimet mjedisore të “bujqësisë, pylltarisë, peshkimit, energjisë, industrisë, transportit, menaxhimit të mbetjeve, telekomunikacionit, turizmit, planifikimit të qytetit dhe vendit

19 OBSh, [Mbetjet elektronike në rritje ndikon në shëndetin e miliona fëmijëve](#), paralajmëron OBSh, 2021.

20 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis](#), 2010 dhe [Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis](#), 2023.

21 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor](#), 2010.

22 Republika e Kosovës, Qeveria, [Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor](#), 2023.

23 BE, [Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit](#) e datës 27 qershor 2001 mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, 2001.

ose përdorimit të tokës” dhe për zonat e mbrojtura si NATURA 2000 , në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës.²⁴

Ligji i BE-së nuk kërkon që VSM-ja të përfshijë analizën e ndikimit gjinor, megjithëse analiza gjinore e ndikimeve potencialisht të ndryshme mjedisore të projekteve të planifikuara mbi gratë dhe burrat mund të informojë planet dhe miratimet. Projektligji i Kosovës për VSM-në nuk kërkon analiza gjinore dhe as nuk tregon se si përdorimi i tokës mund të ndikojë ndryshe tek gratë dhe burrat. Ai thotë se Komisioni i VSM-së në Ministri duhet të pasqyrojë balancën gjinore. Megjithatë, ligji përdor gjuhë të njëanshme gjinore duke iu referuar inspektorëve të mjedisit si “ai”. Pra, ligji është **negativ gjinor**.

Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit

Ky ligj i vitit 2009 “harmonizon zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet bazë për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm”.²⁵ Ai synon të promovojë krijimin e një mjedisi të shëndetshëm në përputhje me standardet e BE-së.²⁶ Ai parashikon një VNM për projektet e planifikuara dhe të realizuara, duke përfshirë ndryshimet në teknologji, veçanërisht ato që mund të rezultojnë në ndotje të madhe mjedisore ose të përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut.²⁷ Personat që “aplikojnë teknologji që janë të dëmshme për mjedisin duhet të ndër marrin të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse dhe të sigurisë” për të reduktuar rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.²⁸ Ligji e obligon Qeverinë që çdo vit t’i raportojë Kuvendit për gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në të në krahasim me raportin e mëparshëm, duke përfshirë ndikimin mjedisor në shëndetin publik; dëmtimi i mjedisit; zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit për mjedisin; masat e marra për mbrojtjen e natyrës; përfitimet e masave duke përfshirë zhvillimin ekonomik; menaxhimin e burimeve natyrore; mbrojtjen e mjedisit; dhe financimi i mbrojtjes së mjedisit.²⁹

Ligji nuk e parashikon në mënyrë eksplicite nevojën për analizë gjinore, siç janë ndikimet potencialisht diferenciale të dëmit mjedisor në shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe burrave; ndikimet e strategjive dhe planeve të veprimit mbi gra dhe burra të ndryshëm; si gratë dhe burrat kanë përfituar ekonomikisht ose si i menaxhojnë burimet e tyre natyrore; apo

24 Republika e Kosovës, Qeveria, [Projektligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor](#), 2023. NATURA 2000 është një rrjet i qendrave të rritjes dhe pushimit për speciet e rralla dhe të kërcënuara, dhe disa lloje të rralla të habitateve natyrore që mbrohen. Ai mbulon të 27 vendet anëtare të BE-së në tokë dhe në det. Rrjeti synon të sigurojë mbijetesën afatgjatë të specieve dhe habitateve më të vlefshme dhe të kërcënuara të Evropës të listuara nën [Direktivën e Zogjve](#) dhe [Direktivën e Habitaveve](#). Edhe pse jo anëtare dhe ligjërish nuk është e detyruar të marrë pjesë, Kosova ka pranuar të identifikojë zonat paraprake që do të kualifikoheshin për të qenë pjesë e NATURA 2000.

25 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit](#), 2009, Neni 1, Paragrafi 1.

26 Po aty, Neni 1, Paragrafi 2.

27 Po aty, Neni 29.

28 Po aty, Neni 16.

29 I Po aty, Neni 25.

përgjegjshmërinë gjinore të financimit për mbrojtjen e mjedisit. Ligji nuk e merr parasysh apo përmend fare gjininë. Prandaj, ky ligj është **neutral gjinor**, duke përfshirë edhe digitalizimin. Një qasje neutrale ndaj gjinisë mund të kontribuojë në rezultate negative gjinore duke i vendosur pa dashje gratë ose burrat në rrezik.

RrGK analizoi nga perspektiva gjinore katër VNM të disponueshme publikisht për dy parqe diellore, një zgjerim të terminalit të aeroportit dhe një fabrikë çimentoje.³⁰ Të kryera në 2022 dhe 2023, VNM përfshinte demografinë e popullsisë, vendbanimet dhe projektet e ndikimit negativ që mund të kenë në jetën e njerëzve, të kërkuara si pjesë e VNM-ve.³¹ Asnjë nuk përfshinte ndonjë analizë të ndikimit gjinor. Analiza gjinore mund të kishte ekzaminuar ndikimet e mundshme në shëndetin e grave dhe burrave që vijnë nga ndotja e ajrit, zhurma, substancat toksike, ndryshimet në kushtet e jetesës ose rreziqe të tjera që lidhen me këto projekte. VNM-të gjithashtu mund të kishin marrë parasysh çdo ndikim mjedisor dhe shëndetësor mbi punëtorët e ndryshëm gra dhe burra të angazhuar në projekte ndërtimi.

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës

Ky ligj i vitit 2010 rregullon mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës.³² Ai zbatohet për të gjithë personat, akterët dhe institucionet, me përjashtim të rasteve urgjente për të shmangur rrezikun për jetën, shëndetin e njerëzve ose pronën; për të shpëtuar njerëz ose pronë; dhe për të mbrojtur Kosovën.³³ Ligji kërkon pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje lidhur me mbrojtjen e natyrës.³⁴ Kjo do të kërkonte qasje në informacion rreth mundësive për të marrë pjesë, të cilat qasje në teknologji mund të lehtësohej. Gratë, veçanërisht gratë rurale, mund të kenë më pak qasje në teknologji dhe informacion, gjë që mund të pengojë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje,³⁵ edhe pse ligji nuk e trajton këtë.

Qytetarët e BE-së priren të kenë mungesë informacioni mbi legjislacionin që mbron biodiversitetin, dhe kjo duket se rezulton nga dallimet në qasjen në teknologji, duke përfshirë atë midis grave dhe burrave. Sipas sondazhit të Eurobarometrit 2019, 48% e qytetarëve të BE-së thanë se BE-ja duhet të

30 Republika e Kosovës, MMPHI, “*Shpalljet*”. *Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis* “Limak Kosovo International Airport” S.C. SH.A.; *Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Parkun e Energjisë Diellore “Slivova 1” me fuqi 0.8 MW, Dragoc – Prishtinë*; “Swiss Solar Park” L.L.C. Gjakovë; *Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Impiantin e Betonares*. Të gjitha të qasura më 29 gusht 2023.

31 BE, *Direktiva 2014/52/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014*, që ndryshon Direktivën 2011/92/BE për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis, Neni 3(1)(a).

32 Republika e Kosovës, Kuvendi, *Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës*, 2010, Nenet 1 dhe 2.

33 Po aty, Neni 3.

34 Po aty, Neni 6, Paragrafi 2.9.

35 *Konventa për Diversitetin Biologjik, Adresimi i Çështjeve Gjinore dhe Veprimet në Objektivat e Biodiversitetit*, 2020, f. 12.

informojë më mirë qytetarët për biodiversitetin.³⁶ Gratë prireshin të ishin më pak të informuara për NATURA 2000 sesa burrat me 17%.³⁷ Mungesa e qasjes së grave dhe veçanërisht grave rurale në teknologji kontribuon në mungesën e informacionit mbi ruajtjen e natyrës.³⁸ RrGK nuk ka gjetur të dhëna të tilla për Kosovën. Megjithatë, studimet në nivel global dhe rajonal sugjerojnë se ekziston një lidhje midis digjitalizimit, mbrojtjes së mjedisit dhe gjinisë, duke sugjeruar rëndësinë e përfshirjes së tyre në Ligj.

Ligji konsideron “zona të rëndësishme ekologjikisht” në përputhje me NATURA 2000, një rrjet habitatesh dhe specimesh të rralla dhe të kërcënuara në Evropë të identifikuar përmes Zonave të Veçanta të Ruajtjes dhe Zonave të Veçanta të Mbrojtjes.³⁹ Edhe pse NATURA 2000 shtrihet kryesisht në shtetet anëtare të BE-së, rajonet biogjeografike përfshijnë Kosovën.⁴⁰ Çdo ndërhyrje në natyrë, sipas ligjit, i nënshtrohet vlerësimit të specieve dhe zonave të mbrojtura; ajo duhet të vlerësoj efektet në zonat e veçanta të ruajtjes dhe mbrojtjes.⁴¹ Mjetet digjitale mund të përdoren për regjistrimin e specieve dhe habitateve të rralla dhe të kërcënuara në Kosovë, si dhe në kryerjen e vlerësimeve, megjithëse Ligji nuk e përmend këtë. Rastet e ndërhyrjes në “zonat e rrjetit ekologjik” për të cilat kërkohet një VNM nuk përmendin ndonjë analizë të ndikimit gjinor.⁴² Ligji nuk përmban perspektivë gjinore, prandaj është **neutral gjinor**.

Ligji për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera

Ky ligj i 2011 fokusohet në menaxhimin e “mbrojtjes kundër çdo fatkeqësie natyrore dhe fatkeqësive të tjera”, parandalimin, reduktimin dhe zbutjen e pasojave.⁴³ Ai e bën shtetin përgjegjës për të ndihmuar në “restaurimin dhe rikuperimin nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera” për të mbrojtur shëndetin dhe jetën e “njerëzve, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit”.⁴⁴ Në lidhje me digjitalizimin, ai e bën shtetin përgjegjës për vendosjen dhe mirëmbajtjen e komunikimit elektronik për “mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë”.⁴⁵ Ligji thotë se çdo qytetar i aftë për punë mund të angazhohet në mbrojtje dhe shpëtim, përveç fëmijëve dhe grave shtatzëna; si burrat ashtu edhe gratë mbi 15 vjeç mund të angazhohen në strukturat vullnetare të mbrojtjes dhe

36 BE, Eurobarometer, “Qëndrimet e evropianëve ndaj diversitetit”, 2019, qasur më 21 dhjetor 2023.

37 I. Kokkoris, et al., “Natura 2000 Ndërgjegjësimi Publik në BE: Një parakusht për një politikë të suksesshme të ruajtjes”, Politika e përdorimit të tokës 125, 2023.

38 Konventa për Diversitetin Biologjik, “Adresimi i Çështjeve Gjinore dhe Veprimet në Objektivat e Biodiversitetit”, 2020.

39 KE, Mjedisi, “Natura 2000”, qasur më 21 dhjetor 2023.

40 Po aty.

41 Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, 2010, Neni 7.

42 Po aty. Neni 34, Paragrafi 2.

43 Republika e Kosovës, Kuvendi, Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, 2011, Neni 2.

44 Po aty. Neni 36.

45 Po aty.

shpëtimit.⁴⁶ Përveç këtyre referencave për gratë dhe burrat, Ligji nuk përmend asnjë mënyrë tjetër sesi gjinia mund të merret parasysh në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera. Kështu, ky ligj është i **ndjeshëm gjinor**, por nuk i përgjigjet gjinisë dhe nevojave të ndryshme potenciale të grave dhe burrave në mes të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Ligji për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit

Ky ligj i vitit 2013 rregullon inspektimet dhe inspektorët në fushat që kanë të bëjnë me ujin, natyrën, planifikimin e përdorimit të hapësirës dhe ndërtimet.⁴⁷ Ai nuk përmend asgjë në lidhje me digjitalizimin e mbajtjes së të dhënave, mirëmbajtjen e të dhënave ose mbrojtjen e të dhënave për gra dhe burra të ndryshëm që raportojnë keqpërdorim. Ligji nuk përmend gjininë, barazinë gjinore, burrat apo gratë. Gjuha është diskriminuese gjinore, duke iu referuar detyrave të një inspektori si “të tijat”. Kjo përforcon normat gjinore dhe stereotipet se vetëm burrat janë të kualifikuar dhe të aftë për të shërbyer si inspektor. Prandaj, ligji është **negativ gjinor**.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2020

Në drejtim të anëtarësimit në BE, kjo Strategji thoshte se Kosova duhet të harmonizoj legjislacionin e saj me NATURA 2000 dhe të zbatojë masat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.⁴⁸ Në parim të anëtarësimit në BE, kjo Strategji thoshte se Kosova duhet të harmonizojë aplikimin e saj me NATURA 2000 dhe të zbatojë masat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.⁴⁹ Ajo vëzhgoi mbështetjen e sektorit bujqësor në burimet natyrore dhe përfitimet e mundshme nga biodiversiteti përmes sistemeve dhe teknologjive të duhura të menaxhimit.⁵⁰ Ndryshe, kjo Strategji nuk ka marrë parasysh digjitalizimin apo gjininë. Strategjia ishte **neutrale gjinore**.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike 2014-2024

Kjo Strategji e vitit 2014 parashikonte një “Kosovë elastike ndaj klimës” që trajton në mënyrë efektive ndryshimet klimatike dhe i përgjigjet ndikimeve të tij bazuar në parimet e miratuara ndërkombëtarisht. Ajo e bëri ndryshimin e klimës një prioritet të qeverisë dhe merr në konsideratë masat zbutëse dhe përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike.⁵¹ Ajo synonte të rriste “kapacitetin adaptues të sistemeve natyrore, ekosistemeve të cënueshme dhe shoqërisë”, veçanërisht duke synuar fermerët dhe gratë e varfëra, në mënyrë që ato të mund të trajtonin ndikimet dhe rreziqet klimatike.⁵² Komponenti Kombëtar i

46 Po aty, Nenet 19 dhe 21.

47 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit](#), 2013, Nenet 1 dhe 2.

48 Republika e Kosovës, Qeveria, MMPHI, [Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin](#), 2020.

49 Po aty, f. 7.

50 Po aty, f. 23.

51 Po aty, f. 9.

52 Po aty, f. 9, Objektiva 2.

Përshtatjes synonte të mbështeste veprime të reja klimatike edhe për grupet e cenueshme. Megjithatë, asnjë masë apo tregues nuk synonte gratë. As Komponenti nuk përfshinte baza, objektiva apo buxhete të përgjegjshme për gjininë, të cilat mund të përdoren për të monitoruar dhe vlerësuar progresin drejt barazisë gjinore. Është e paqartë nëse ndonjë V(N)BGJ ka informuar këtë Strategji. Strategjia ishte e **ndjeshme gjinore**, pasi vuri në dukje pabarazitë gjinore, por nuk i trajtonte ato. RrGK nuk mund të gjente ndonjë dëshmi të disponueshme publikisht të një analize ex-post të ndikimit gjinor që po kryhej për të informuar Strategjinë e ardhshme.

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike 2019-2028 dhe Plani i Veprimit për Ndryshimet Klimatike 2019-2021

Miratuar në vitin 2018, kjo Strategji përcakton politikat dhe masat për reduktimin e emetimeve të gazeve serrë (EGS) dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në drejtim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm.⁵³ Kjo Strategji ka të njëjtin synim si Strategjia e mëparshme: të rris “kapacitetin adaptues të sistemeve natyrore, ekosistemeve të cenueshme dhe shoqërisë”, duke u fokusuar te fermerët dhe gratë e varfëra.⁵⁴ Asnjë objektiv, masë, tregues, bazë apo buxhet tjetër nuk i referohet gjinisë. Prandaj, Strategjia është e **ndjeshme gjinore** pasi thekson shkurt nevojën për t’u marrë parasysh gratë, por nuk është e përgjegjshme gjinore sepse nuk përfshin asnjë veprim për të rritur kapacitetet adaptive të grave.

Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031

Kjo Strategji synon “të ofrojë energji të besueshme, të përbalueshme dhe të pastër” si “thelbësore për zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe mirëqenien sociale të qytetarëve të saj”.⁵⁵ Ajo përcakton veprime për zhvillimin e sektorit të energjisë.⁵⁶ Një objektiv përfshin përmirësimin e qëndrueshmërisë së sistemit duke modernizuar rrjetet e energjisë, duke reduktuar humbjet dhe duke siguruar sigurinë kibernetike të sektorit.⁵⁷ Një tjetër parashikon fuqizimin dhe mbrojtjen e konsumatorëve, veçanërisht konsumatorëve të cenueshëm, dhe ruajtjen e shëndetit të njerëzve dhe mjedisit.⁵⁸ Qëllimi i saj është të zhvillojë aftësitë “për gratë dhe burrat në përputhje me nevojat e sektorit dinamik të energjisë”.⁵⁹ Një objektiv specifik parashikon “pjesëmarrjen e grave me mundësi të barabarta në programet e edukimit dhe trajnimit [për energjinë] (përfshirë përmes skemave të bursave) dhe promovimin e përfshirjes së grave në kompanitë dhe institucionet e sektorit të energjisë”.⁶⁰ Strategjia thotë se

53 Republika e Kosovës, Qeveria, MMPH, [Strategjia për Ndryshimet Klimatike 2019-2028](#), 2018, f. 6.

54 Po aty, f. 12.

55 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031](#), f. 6.

56 Po aty, f. 10.

57 Po aty, f. 7.

58 Po aty, f. 9, Objektiva 5.

59 Po aty, f. 26.

60 Po aty, f. 36, Objektiva specifike 4.3.

9% e punonjësve të sektorit të energjisë ishin gra në vitin 2021 dhe synon ta rris këtë në 11% deri në vitin 2024 dhe të paktën 25% deri në vitin 2031.⁶¹ Prandaj, kjo Strategji është e **përgjegjshme gjinore** pasi synon të reduktojë pabarazitë gjinore në sektorin e energjisë. Trajnimi dhe edukimi i planifikuar ka të ngjarë të përfshijnë vëmendjen ndaj zhvillimeve digjitale në këtë sektor.

Kjo Strategji zëvendësoi Strategjinë e mëparshme të Energjisë për vitet 2017-2026,⁶² e cila ishte **neutrale gjinore**. RrGK nuk ka mundur të gjej ndonjë vlerësim publik të ndikimit gjinor ex-post të Strategjisë së mëparshme të Energjisë, gjë që mund të kishte informuar Strategjinë.

Draft Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Kosovës 2025-2030

Kosova është dashur të zhvillojë një plan të integruar të energjisë dhe klimës për 2021-2030, duke synuar të adresojë efikasitetin e energjisë, energjinë e ripërtëritshme, reduktimin e emetimeve dhe ndërlikohen; megjithatë, qeveria ka raportuar vonesa për shkak të pandemisë.⁶³ Qeveria publikoi një draft të planit në korrik 2023.⁶⁴ Ai përmend mbështetjen financiare për gratë sipërmarrëse nga viti 2020 e në vazhdim: “Mbështesim gratë në kryerjen e investimeve të nevojshme në masat e efikasitetit të energjisë dhe pajisjet moderne që do t’i ndihmojnë ato të rrisin biznesin e tyre dhe të përdorin energjinë e gjelbër”.⁶⁵ Draft plani përmend barazinë gjinore vetëm një herë:

Prioriteti i këtij objekti është zhvillimi i një mjedisi stabil dhe mbështetës për kërkimin shkencor dhe inovacionin në Kosovë, i mbështetur nga një infrastrukturë funksionale ligjore dhe avancimi i kulturës për kërkime shkencore të besueshme në institucionet akademike, shkencore dhe ekonomike, duke përfshirë strategjinë dhe programe për barazi gjinore.⁶⁶

Në përgjithësi, draft Plani është **neutral gjinor**. Është e paqartë nëse një analizë gjinore e ka informuar këtë Strategji.

61 Po aty, f. 37.

62 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës, 2017-2026](#).

63 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2021-2023](#), 2021, f. 59.

64 Republika e Kosovës, Qeveria, [Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Kosovës, 2025-2030](#),

Versioni i parë draft, botuar nga GIZ GmbH. Qeveria gjermane po mbështet finalizimin e tij, të bashkë-zbatuar nga GIZ Kosova Energy Project II dhe Ekipi Ekonomik Gjerman, i financuar nga Ministria Gjermane e Çështjeve Ekonomike dhe Veprimit Klimatik (f. 13).

65 Po aty, f. 24, masa 11, duke cituar Raportin e 5-të të Progresit të Energjisë së Ripërtëritshme të Kosovës për 2020-2021.

66 Po aty, f. 55, Objektiva 1.

Programet Evropiane të Reformës

PRE 2021-2023 parashikoi ndarjen e granteve për masat e efikasitetit për bizneset e grave dhe praktikantët për 100 gra në sektorin e energjisë, dhe PRE 2022-2024 raportoi ndarje të suksesshme të këtyre fondeve.⁶⁷

Drejt anëtarësimit në BE dhe tranzicionit të gjelbër, PRE 2023-2025 planifikon të zhvillojë ligje dhe kushte drejt efikasitetit të energjisë dhe burimeve të rinovueshme të energjisë që do të “adresojnë komponentët e barazisë gjinore, arsimit dhe inovacionit në sektorin e energjisë, duke ndikuar kështu pozitivisht në mirëqenien e qytetarëve dhe pjesëmarrësve në tregun e energjisë”.⁶⁸ Objektivi i katërt përfshin miratimin e një “strategjie koherente afatgjatë të energjisë dhe klimës për uljen e emetimeve të karbonit”, rritjen e efikasitetit të energjisë sipas angazhimeve në Agjendën e Gjelbër të BP, miratimin e një plani veprimi që identifikon kostot e energjisë dhe ofrimin e “masave zbutëse për konsumatorët e cenueshëm”.⁶⁹ PRE nuk i ndan të dhënat e konsumatorëve sipas gjinisë. Masat e planifikuara në lidhje me Agjendën e Gjelbër nuk përfshijnë digjitalizimin ose përdorimin e teknologjive të reja. Ato as nuk ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë. Masa 7 për reduktimin e ndotjes së mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit përmend barazinë gjinore si një ndikim të pritshëm social, por nuk jep hollësi. Këto masa parashikojnë krijimin e vendeve të reja të punës në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së “grupeve të marginalizuara” në ekonominë formale, por nuk referojnë gjininë.⁷⁰ Ky PRE nuk përfshin tregues, vija bazë, objektiva ose buxhet për të matur progresin drejt barazisë gjinore. As nuk specifikon ndonjë masë afirmative në lidhje me punësimin në sektorin e energjisë, megjithëse mund të parashikonte masa afirmative për t’i dhënë prioritet angazhimit të më shumë grave në përputhje me PVGJ III. Masave për mbrojtjen e mjedisit dhe transformimin digjital iu mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë.

Qeverisja

Ky seksion shqyrton shkallën në të cilën gratë dhe burra të ndryshëm kanë marrë pjesë në udhëheqjen, koordinimin, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve që lidhen me digjitalizimin e mbrojtjes së mjedisit, energjisë dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimatike. Ai diskuton aftësitë e zyrtarëve për politikëbërje dhe programim të përgjegjshëm gjinor. Më pas, ai shqyrton përgjegjshmërinë gjinore të shërbimeve publike digjitale që lidhen me mjedisin, energjinë dhe ndryshimet klimatike, si dhe financimin dhe prokurimin e qeverisë.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) “përgatit politika publike, harton akte ligjore, harton dhe miraton

67 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2022-2024](#), 2022, f. 142.

68 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2023-2025](#), 2023, Reforma Masa 5.

69 Po aty, f. 11.

70 Po aty, Masa reformuese 7, fq.77-78.

akte nënligjore, i zbaton ato dhe përcakton standardet e detyrueshme në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujit, planifikimit hapësinor, ndërtimit, banimit, kadastrës, transporti rrugor, hekurudhor, transportit ajror, transportit detar dhe sigurisë rrugore”.⁷¹ Është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me mjedisin dhe planifikimin hapësinor. Ajo mbikëqyr zbatimin e standardeve të vendosura, monitoron gjendjen e mjedisit dhe planifikimin hapësinor, dhe menaxhon përdorimin dhe zhvillimin e infrastrukturës.⁷²

Në MMPHI, shtatë gra (21%) dhe 25 burra (78%) mbajnë poste vendimmarrëse.⁷³ Gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar, duke përbërë më pak se 38% të të gjithë punonjësve.⁷⁴ Ndërsa ZBGJ mund të mbështeste integrimin e perspektivës gjinore në ligje dhe politika, asaj i mungonte informacioni rreth proceseve të digjitalizimit në Ministri.⁷⁵ Kështu, ajo nuk mund të kontribuonte në mënyrë adekuate në informimin e reformave digjitale nga perspektiva gjinore.

VNM-të kërkojnë konsultime publike.⁷⁶ Diskutimet publike mund të ndihmojnë në mbledhjen e të dhënave nga gratë dhe burra të ndryshëm për projektligjet dhe politikat dhe zbatimin e tyre. Megjithatë, historikisht, MMPHI dhe autoritetet komunale përgjegjëse rrallë kanë organizuar konsultime publike dhe gratë kanë qenë të nënpërfaqësuar në mesin e pjesëmarrësve.⁷⁷ Megjithëse MMPHI i konsideron diskutimet publike të dobishme për adresimin e çështjeve mjedisore, publikut i mungon informacioni dhe pak njerëz marrin pjesë në diskutime të tilla.⁷⁸ Platforma e konsultimit publik ka një listë të kufizuar të konsultimeve publike të vazhdueshme dhe të përfunduara që nga viti 2021.⁷⁹ RrGK gjeti vetëm një konsultim publik relevant për një raport të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për planin zhvillimor të Komunës së Kaçanikut të organizuar nga Komuna në korrik 2023. RrGK gjeti informacione në lidhje me dy konsultime publike të organizuara nga Komuna e Prishtinës në vitin 2019 për dy VNM-të.⁸⁰ Asnjë nuk kishte informacion në lidhje me barazinë gjinore.

71 Republika e Kosovës, Qeveria, [Rregullorja nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive](#), 2021, f. 61.

72 Po aty, f. 62.

73 Korrespondenca e RrGK me MMPHI, 2023.

74 Korrespondenca e RrGK me MMPHI, 2016, cituar në RrGK, [Buxhetimi për një mjedis më të mirë: një analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor](#), 2016.

75 RrGK intervistë, 2021.

76 Po aty, Neni 3, pParagrafi 1.14.

77 RrGK, [Buxhetimi për një mjedis më të mirë](#), 2016.

78 Republika e Kosovës, Qeveria, MMPHI, [Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin](#), 2020, f. 23.

79 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, Zyra për Qeverisje të Mirë, Konsultimet Publike, Lista e konsultimeve publike më të fundit, [“Kërko konsultimet”](#), qasur më 25 tetor 2023.

80 Komuna e Prishtinës, [Debatet Publike 2019](#), qasur më 25 tetor 2023.

MMPHI duhet të monitorojë nëse janë kryer VNM për projektet e planifikuara dhe të realizuara, duke përfshirë ndryshimet në teknologji.⁸¹ RrGK nuk ka mundur të gjejë informacion të disponueshëm publikisht nëse kjo është bërë dhe kështu nuk mund të analizojë përgjegjshmërinë gjinore të VNM-ve apo monitorimin e tyre nga MMPHI. Të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me inspektimet mjedisore nuk ishin gjithashtu të disponueshme.

Në kuadër të MMPHI, **Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave** është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisore dhe dhënien e rekomandimeve.⁸² Një grup pune me zyrtar të MMPHI shqyrton aplikimet. Një grup pune i përkohshëm ad-hoc aktualisht trajton aplikimet dhe të dhënat lidhur me gjininë në lidhje me anëtarët e tyre nuk janë të disponueshme. Grupi i mëparshëm përfshinte dy gra dhe tre burra.⁸³

Gjithashtu nën MMPHI është edhe **Këshilli Kombëtar i Ndryshimeve Klimatike**, i cili mbikëqyr zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit.⁸⁴ Këshilli është organ ndërinstytucional i përbërë nga të gjithë ministrat, i udhëhequr nga ministri i MMPHI-it.⁸⁵ Këshilli kishte dy gra (30%) dhe shtatë burra (70%) në 2022.⁸⁶ Sekretariati Teknik i Këshillit përbëhet nga shoqëria civile, akterë ndërkombëtarë dhe institucione të tjera përkatëse. Këshilli planifikon të krijojë një bord akademik këshillues për të informuar politikën e ndryshimeve klimatike.⁸⁷ Këshilli është ende në proces të funksionimit të plotë, kështu që progresi drejt krijimit ose zbatimit të përgjegjësive gjinore ose analizave gjinore në punën e tij ka qenë gjithashtu i ngadaltë. Pjesëmarrja në Këshill përfshin njerëz në pozita të veçanta vendimmarrëse ose me kredenciale të lidhura me këtë fushë, kështu që nuk merret parasysh gjinia.⁸⁸ Duke pasur parasysh se shumica e pjesëmarrësve kanë qenë burra, nënfaqësimi i grave në vendimmarrje mund të ndikojë në reagimin gjinor të punës së Këshillit.

Këshilli koordinon të gjitha aktivitetet që dalin nga Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK) dhe Protokolli i Kiotos, përgatit dokumentacionin për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin në protokollin dhe marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me ndryshimet klimatike dhe siguron zbatimin e projekteve që ndikojnë në ndryshimet klimatike.⁸⁹ Protokolli i Kiotos funksionalizon KKKBNK duke i angazhuar vendet dhe ekonominë e industrializuara në tranzicion të kufizojnë dhe reduktojnë

81 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit](#), 2009, Neni 29.

82 Po aty, Republika e Kosovës, MMPHI, uebfaqja, [Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave](#), 2023, qasur më 21 dhjetor 2023.

83 RrGK intervistë, 2023.

84 MMPHI, [Udhërrëfytyesi rrethor i ekonomisë së Kosovës](#), 2023.

85 RrGK intervistë, 2023.

86 Po aty. Poashtu shih: MMPHI, Facebook, [“Të rejtat”](#), janar 2022, qasur më 21 dhjetor 2023.

87 RrGK intervistë, 2023.

88 RrGK intervistë, 2023.

89 MMPHI, [Udhërrëfytyesi rrethor i ekonomisë së Kosovës](#), 2023.

emetimet e EGS në përputhje me objektivat individuale të dakorduara.⁹⁰ Edhe pse Kosova nuk mund të bëhet palë e Protokollit duke pasur parasysh se OKB-ja nuk e njeh Kosovën, Qeveria e Kosovës është zotuar të ndërmarr hapin në lidhje me përshtatjen dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike.⁹¹ Për shembull, Marrëveshja e Parisit i detyron kombet të luftojnë ndryshimet klimatike duke synuar të mbajnë “rritjen e temperaturës mesatare globale nën 2°C mbi nivelet para-industriale” dhe duke ndjekur përpjekjet “për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1.5°C mbi nivelet para-industriale”.⁹² Ndërkohë që Kosova është në linjë me vendet e tjera në zbatimin e Marrëveshjes së Parisit, përjashtimi i saj nga OKB-ja ka penguar përpjekjet e vendit për zbutjen e ndryshimeve klimatike për shkak të mungesës së qasjes së Kosovës në financim të drejtpërdrejt.⁹³ Kjo gjithashtu pengon përpjekjet për digjitalizimin e ndryshimeve klimatike dhe për të siguruar reagimin gjinor.

Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) është institucion qeveritar i themeluar në vitin 2003.⁹⁴ Ajo operon brenda MMPHI dhe është përgjegjëse për zhvillimin dhe koordinimin e një “sistemi unik informacioni për mbrojtjen e mjedisit”, si dhe mbledhjen e të dhënave në lidhje me mjedisin.⁹⁵ AMMK ka gjashtë institute dhe drejtori.⁹⁶ Drejtorja për Vlerësimin Mjedisor konsiderohet si “shtylla kryesore” e AMMK-së, përgjegjëse për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit.⁹⁷ Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë nuk përfshijnë qartë analizën e ndikimit gjinor, megjithëse analiza gjinore mund të mbështes analizën e të dhënave mjedisore, duke përdorur mjete digjitale.

Instituti **Hidrometeorologjik i Kosovës** që funksionon në kuadër të AKMM është organi kryesor përgjegjës për monitorimin e ndotjes së ajrit, reshjeve atmosferike dhe ujërave sipërfaqësore. Instituti duhet të jap paralajmërim të hershëm për çdo fatkeqësi hidrometeorologjike.⁹⁸ Shumica e shërbimeve të Institutit ekzistojnë online, duke u ofruar qytetarëve të dhëna në kohë reale.⁹⁹ Për të siguruar të dhëna, kërkohet punë fizike për të menaxhuar matësat e

90 UN, [Ndryshimet klimatike, çfarë është Protokollin e Kiotosë?](#), qasur më 21 dhjetor 2023.

91 Republika e Kosovës, Kuvendi, faqja e internetit, [“Angazhimi i Kosovës”](#), 2019, qasur më 21 dhjetor 2023.

92 KKKBNK, [Marrëveshja e Parisit](#).

93 RrGK intervistë, 2023.

94 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 2002/8 për Mbrojtjen e Mjedisit](#), 2008.

95 Po aty, Neni 60, Paragrafi 2.

96 AKMM, faqe interneti, [“Drejtorja për Vlerësimin Mjedisor”](#), 2022, qasur më 21 dhjetor 2023. Këtu përfshihen Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, Drejtorja për Administrimin e Pjesës Kombëtare “Sharri”, Drejtorja për Administrimin e Pjesës Kombëtare “Bjeshkët e Nemuna”, Drejtorja për Vlerësimin Mjedisor dhe Drejtorja e Administrimit të Monumenteve të Natyrës me rëndësi të veçantë.

97 Po aty.

98 Po aty, [“Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës”](#) Detyrat dhe përgjegjësitë, qasur më 31 gusht 2023.

99 Republika e Kosovës, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, [faqe interneti](#), qasur 21 dhjetor 2023.

shiut, të cilët ndihmojnë në identifikimin e niveleve të shiut dhe mundësojnë paralajmërime, si p.sh. për përmytjet e shpejta.¹⁰⁰ Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin të disponueshme nëse gratë apo burrat e kryejnë këtë punë, duke përfshirë menaxhimin e të dhënave që rezultojnë. AKMM duhet të sigurojë që gratë dhe burrat të kenë qasje të barabartë në të dhënat në kohë reale në rastet e përmytjeve të shpejta, të cilat janë bërë më të shpeshta dhe madje vdekjeprurëse.¹⁰¹ Informacioni i pamjaftueshëm është i disponueshëm në lidhje me qasjen e grave dhe burrave në një informacion të tillë.

Autoriteti Rregullativ i Shërbimit të Ujit (ARRU) është një institucion i pavarur përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të të gjithë ofruesve të shërbimeve të ujit.¹⁰² Drejtoresha e Autoritetit është një grua, ndërsa të dhënat për personelin nuk u gjetën. Rreth 79% e popullsisë ka ujë të furnizuar nga kompanitë rajonale të ujit të menaxhuara nga ARRU, ndërsa banorët e tjerë mund të kenë ofrues uji të palicensuar nga ARRU.¹⁰³ Inspektorët e autoritetit monitorojnë zbatimin e politikave të furnizimit me ujë duke përdorur sistemet digjitale të kompanive rajonale të ujit, të cilat mbajnë të dhëna për furnizimin me ujë.¹⁰⁴ Autoriteti nuk mban të dhëna për konsumatorët pasi kjo bëhet nga kompanitë rajonale të ujit, të cilat duhet të përdorin standardet e mbrojtjes së të dhënave sipas ligjit të Kosovës.¹⁰⁵

Ministritë e tjera kanë detyra që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, energjinë dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike. **MIST** mund të mbështes zhvillimin e sektorit privat në lidhje me ekonominë rrethore duke i bërë operacionet e biznesit më rrethore dhe duke kontribuar në inovacionin që mund të forcojë qarkullimin në të gjithë ekonominë.¹⁰⁶ MIST miratoi një Kornizë të Menaxhimit Mjedisor dhe Social për PEDK.¹⁰⁷ Ndërsa PEDK është i përgjegjshëm ndaj gjinisë,¹⁰⁸ ai nuk ka tregues, baza dhe objektiva për të matur ndryshimet drejt barazisë gjinore në lidhje me mbrojtjen e mjedisit. Megjithatë, një VNM u krye për të informuar hartimin e projektit. Në kuadër të MIST-it, **Agjencia Kosovare për Eficiencë të Energjisë** është përgjegjëse për zhvillimin e

100 RrGK intervistë, 2023.

101 Uran Haxha, “Përmytjet po e befasojnë Kosovën”, Kosovo 2.0, 19 shtator 2023, qasur më 21 dhjetor 2023. Në qershor të vitit 2023, një grua dhe djali i saj pesëvjeçar humbën jetën nga një përmytje.

102 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit](#), 2016, Neni 4. ARRU përbëhet nga “katër departamente dhe një njësi inspektuese, tre departamente janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për zyrën punë si dhe një njësi inspektimi që mbikëqyr zbatimin e akteve ligjore të ARRU” (Autoriteti Rregullativ i Shërbimit të Ujit, [faqe interneti](#), qasur më 4 shtator 2023).

103 Korrespondenca e RrGK me ARRU, shtator 2023.

104 Po aty.

105 Po aty.

106 OBZHE, Indeksi i Politikave të NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: [Vlerësimi i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën](#), 15. Kosovë: Profili i Ekonomisë së Kosovës, 2022.

107 Ministria e Zhvillimit Ekonomik, “[Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social për Projektin e Ekonomisë Digjitale të Kosovës](#)”, 2019, f. 6.

108 Shih kapitullin 6.

politikave, mbështetjen e komunave në krijimin e planeve të efijencës së energjisë dhe monitorimin e zbatimit të tyre.¹⁰⁹

MBPZHR është përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural;¹¹⁰ dy rreziqe kryesore janë mungesa e ujit dhe stinët e thata më të përhapura, veçanërisht në zonën gjeografike të Dukagjinit, që është rajoni më i madh bujqësor.¹¹¹ Qeveria kërkon të përshtatet me ndryshimet klimatike duke ndërtuar diga në Firaje dhe Shtime. Megjithatë, ndërtimi i rezervave shtesë ujore për qëllime bujqësore është në pritje të fondeve adekuate.¹¹² Për këto projekte ndërtimi, nuk është kryer asnjë analizë e ndikimit gjinor, përfshirë si pjesë të VNM-ve, megjithëse projektet mund të kenë ndikime të lidhura me gjininë. Disponueshmëria dhe qasja e ujit mund të ndikoj ndryshe tek gratë dhe burrat, duke ndikuar si në bizneset bujqësore ashtu edhe në familjet individuale që përdorin bujqësinë e jetesës.

Ministria e Ekonomisë ka departamente për Energji dhe Miniera. **Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale** është përgjegjës për “kërkimin dhe shfrytëzimin e rregullt të resurseve minerale në Kosovë dhe shfrytëzimin optimal të burimeve minerale në të gjitha aktivitetet në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe Strategjinë e Minerave”.¹¹³ Departamenti i Energjisë është përgjegjës për hartimin e politikave dhe masave, zbatimin e tyre, monitorimin dhe nxitjen e investimeve në sektor drejt një “furnizimi të sigurt dhe të përballueshëm me energji për konsumatorët bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm”.¹¹⁴ Inspektorati i Energjisë monitoron zbatimin e ligjeve dhe politikave përkatëse.¹¹⁵ Departamenti i Minerave është përgjegjës për krijimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, duke pasur parasysh “aspektet sociale dhe mjedisore”.¹¹⁶

Në përgjithësi, asnjë nga këto organe qeveritare nuk ka përgjegjësi të qarta në lidhje me avancimin e barazisë gjinore, veçanërisht në lidhje me digjitalizimin. As RrGK nuk mund të gjente ndonjë vlerësim të ndikimit gjinor të prodhuar nga këto organe që mund të kenë informuar punën e tyre.

109 [Agjencia Kosovare për Efijencë të Energjisë](#), uebfaqja, 2023, qasur më 21 dhjetor 2023.

110 Republika e Kosovo, [MBPZHR](#), faqe interneti, 2020, qasur më 21 dhjetor 2023.

111 RrGK intervistë, 2023.

112 RrGK intervistë, 2023.

113 Republika e Kosovës, [Funksioni i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale](#), qasur më 21 dhjetor 2023.

114 Republika e Kosovës, [Ministria e Ekonomisë](#), uebfaqja, “Departamenti i Energjisë”, 2023, qasur më 21 dhjetor 2023.

115 Po aty. Këto përfshijnë [Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë](#), 2016; [Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike](#), 2010; [Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë](#), 2016; [Ligji Nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion](#), 2018; [Ligji Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike](#), 2015; [Ligji Nr. 05/L-082 për Gazin Natyror](#), 2016; dhe [Ligjin Nr. 06/L-079 për Efijencën e Energjisë](#), 2018.

116 Po aty.

Komisioni për **Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë** i Kuvendit të Kosovës është përgjegjës për përcaktimin dhe monitorimin e zbatimit nga qeveria të politikave dhe programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë digjitalizimin.¹¹⁷ Roli i Komitetit shtrihet në integrimin e praktikave të qëndrueshme mjedisore në sektorë të ndryshëm. Ai bashkëpunon me komisione të tjera, veçanërisht Komisionin për Buxhetin dhe Transferet, për të siguruar financimin e iniciativave mjedisore. Ai kryen rishikime të legjislacionit dhe buxheteve përkatëse. Në dy vjet, ky Komitet ka mbajtur 53 mbledhje për të cilat ekzistojnë të dhëna publike; ai kurrë nuk diskutoi buxhetin e përgjegjshëm gjinor. Vetëm tre takime (6%) përfshinin përmendjen e gjinisë, dhe digjitalizimi u përmend dy herë (4%). Për shembull, deputetja Fitore Pacolli-Dalipi vërejti se meqenëse investitorët organizuan debate për VNM pranë lokacioneve të projektit, pak qytetar morën pjesë.¹¹⁸ “Në debate të tilla që bëhen nëpër kafenetë e fshatrave, gratë nuk marrin pjesë”, tha ajo. Mbajtja e takimeve në kafene tregoi mungesën e konsideratës për përfshirjen gjinore në diskutimet e VNM-së, sepse gratë rurale priren të mos i vizitojnë këto vende. Si rezultat, debatet mund të mos kenë adresuar nevojat dhe shqetësimet e grave, duke penguar një vlerësim gjithëpërfshirës të efekteve të mundshme të projektit. Në lidhje me digjitalizimin, MMPHI raportoi se ata kanë digjitalizuar pagesat dhe shërbimet e ujit dhe se shërbimi i pajisjeve online në lidhje me certifikatat e pronës tashmë është në dispozicion përmes platformës digjitale të Kosovës.¹¹⁹ Megjithatë, bazat e të dhënave digjitale gjeohapësinore kanë qenë të mangëta në planifikim, duke i dhënë përparësi zhvillimit të biznesit mbi përmirësimin e jetës së qytetarëve.¹²⁰ Diskutimet për digjitalizimin nuk iu referuan gjinisë dhe anasjelltas.

Aftësitë

Kur u pyetën për infrastrukturën digjitale, një koment i përsëritur ishte se MMPHI ka një faqe interneti.¹²¹ Kjo sugjeron mirëkuptim të kufizuar midis zyrtarëve të infrastrukturës digjitale dhe mundësive për përdorimin e saj, e lëre më për sigurimin e reagimit të saj gjinor. Fakti që pak ligje dhe politika përmbanin analiza gjinore ose masa të përgjegjshme gjinore tregon mangësi në aftësitë e vendimmarrësve për të siguruar ligje dhe politika të përgjegjshme ndaj gjinisë në lidhje me digjitalizimin në këta sektorë. Politikëbërësit luftuan për të kuptuar marrëdhëniet midis ndryshimit të klimës, mjedisit, energjisë, digjitalizimit dhe barazisë gjinore.¹²²

117 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë](#), qasur më 2 shtator 2023.

118 Po aty, [Minutat e mbledhjes \(13.12.2022\)](#), qasur më 2 shtator 2023.

119 Po aty, [Minutat e mbledhjes \(6.12.2022\)](#), qasur më 2 shtator 2023.

120 Po aty, [Minutat e mbledhjes \(27.5.2022\)](#), qasur më 2 shtator 2023.

121 RrGK intervistë, shtator 2021.

122 RrGK intervistë, 2021.

Shërbimet Publike Digjitale

MMPHI ka një faqe interneti lehtësisht të qasshme. Sidoqoftë, përdoruesit mund të ngatërrohen për shkak të mungesës së një uebsajti të vetëm, funksional dhe të bashkuar. Në vitin 2023, dy faqe interneti funksionuan njëkohësisht.¹²³ Faqja më e re e MMPHI-së ka informacione për mjedisin dhe infrastrukturën. Ka informacione të dobishme në dispozicion në shqip, por jo të gjitha informacionet ekzistojnë në anglisht dhe serbisht. Faqja e internetit lidhet me Platformën e Konsultimeve Publike dhe me Qasjen në Dokumente Publike.¹²⁴ Shërbime të tjera të ofruara janë monitorimi i cilësisë së ajrit, programi i legalizimit (për legalizimin e ndërtimeve pa leje nëpërmjet regjistrimit në Kadastër),¹²⁵ dhe raportimin e veprimeve të paligjshme.¹²⁶ Gjuha është **negative gjinore** pasi përdor kryesisht emra mashkullor, veçanërisht në thirrjet e publikuara. Duke qenë se shumica e personave që mbajnë pozita vendimmarrëse në Ministri janë burra, shumica e imazheve portretizojnë më shumë burra sesa gra në takimet mes zyrtarëve.

Zgjidhjet digjitale mund të lehtësojnë pjesëmarrjen e grave dhe burrave, të tilla si nëpërmjet konsultimeve në internet, anketave dhe mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë për të informuar politikën dhe programet e reagimit ndaj mbrojtjes së mjedisit, energjisë dhe ndryshimeve klimatike. MMPHI ka disa platforma online për komunikim me qytetarët. Qytetarët mund t'i "shkruajnë ministrin". Formulari kërkon emrin dhe emailin e personit, por jo gjininë,¹²⁷ kështu që do të ishte e vështirë për MMPHI të monitoronte tendencat se kush shkruan letra për cilat tema pa punën manuale të kodimit të të dhënave bazuar në emra. Faqja e internetit ofron gjithashtu mundësinë që qytetarët të raportojnë aktivitete të paligjshme, të tilla si dëmtimi i lumenjve, degradimi i pyjeve dhe ndërtimet ilegale.¹²⁸ Raportimi është anonim, me sa duket për të inkurajuar raportimin pa frikë nga pasojat. Kështu, MMPHI nuk mund të gjurmtojë shkallën në të cilën gratë dhe burrat e përdorin këtë funksion. Disa shërbime publike janë të disponueshme në internet, si pagesat direkte për energjinë dhe ujin nëpërmjet aplikacioneve ose faqeve të internetit të organizuara nga ofruesit e shërbimeve private. Asnjë prej tyre nuk kërkon informacion për gjininë, kështu që të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk mund të gjurmohen për përdoruesit e këtyre shërbimeve publike të digjitalizuara.

MMPHI po kalon një proces të digjitalizimit të VNM-ve, ku aplikantët mund të ngarkojnë online dokumentet e kërkuara. Zyrtarët vunë re se kjo do të

123 [Ministria e Infrastrukturës](#) and [MMPHI faqe interneti](#), qasur më 4 shtator 2023.

124 Po aty.

125 Banka Botërore po financon përmirësimin dhe digjitalizimin e të gjitha regjistrave kadastralë; ajo planifikon të nisë shërbime elektronike të disponueshme publikisht dhe investime në grupet e të dhënave gjeohapësinore (korrespondenca e RrGK me Bankën Botërore, shtator 2023).

126 Po aty.

127 Republika e Kosovës, Qeveria, MMPHI, uebfaqja, Ministria, "[Shkruaj Ministrisë](#)", 2023, qasur më 31 gusht 2023.

128 [MMPHI faqe interneti](#), qasur më 31 gusht 2023.

kursej kohë dhe do ta bëj procesin më efikas.¹²⁹ As AKMM dhe as Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës nuk kanë faqe interneti, por e përdorin Facebook-un për njoftime. ARRU ka një faqe interneti funksionale dhe të përditësuar në shqip, anglisht dhe serbisht.¹³⁰ Informacioni mund të gjendet lehtësisht, megjithëse asnjë shërbim nuk ofrohet në internet, përveç dërgimit të mesazheve direkt në institucion. Gjuha dhe pamjet vizuale të përdorura janë neutrale gjinore.

Pak faqe interneti zyrtare të qeverisë komunale u përditësuan që nga tetori 2023, dhe shumica e komunave përdorën uebfaqe alternative me domene joqeveritare.¹³¹ Kjo mund të pengoj qasjen e qytetarëve në informacionin e saktë në kohë reale dhe të dëmtoj pjesëmarrjen e tyre në konsultimet publike mbi VNM-të dhe planifikimin e buxhetit për ndërhyrjet në lidhje me mjedisin.

Financimi dhe Prokurimi

Në vitin 2016, RrGK mbështeti MMPHI-në e atëhershme për të zbatuar përgjegjësitë e saj të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Megjithatë, bazuar në dokumentet zyrtare të disponueshme publikisht, duket se Ministria nuk ka vazhduar zbatimin e buxhetit të përgjegjshëm ndaj gjinisë.¹³² Përderisa KASH i referohet buxhetimit gjinor drejt disiplinës fiskale, MMPHI nuk ka zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në kapitullin e saj të KASH-it.¹³³ Kapitulli nuk përmban ndonjë objektiv specifik, tregues, bazë ose objektiva që lidhen me barazinë gjinore.¹³⁴ Qeveria ka planifikuar të mbështes investimet në zgjidhjet digjitale për të adresuar ndryshimet klimatike. Për shembull, PRE 2021-2023 parashikonte grante për masat e efikasitetit për bizneset e grave dhe praktikantët për 100 gra në sektorin e energjisë; dhe PRE 2022-2024 raportuan alokimin e suksesshëm të këtyre fondeve.¹³⁵ Megjithatë, nuk është raportuar informacion i saktë në lidhje me numrin e përfituesve dhe shumën e shpenzuara; RrGK nuk mundi ta gjej këtë informacion në internet. As RrGK nuk mund të gjente informacione të ndara sipas gjinisë në dispozicion të publikut që u përkasin përfituesve të investimeve të tjera të mbështetura nga qeveria në mbrojtjen e mjedisit, energjinë dhe ndryshimet klimatike. Raporti i auditimit të MMPHI-it për vitin 2022 nuk përfshin buxhetimin e

129 RrGK intervistë, 2023.

130 Republika e Kosovës, [Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit](#), uebfaqja, 2017, qasur më 4 shtator 2023.

131 Shih: Republika e Kosovës, [Uebfaqet e Komunave të Republikës së Kosovës](#), qasur më 25 tetor 2023.

132 RrGK, [Buxheti për një mjedis më të mirë: një analizë gjinore e shpenzimeve dhe shërbimeve në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor](#), 2016.

133 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026](#), 2023, qasur më 6 tetor 2023.

134 Po aty, ff. 82-84.

135 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi i Reformës Ekonomike 2023-2025](#), 2023, Tabela 11, f. 142.

përgjegjshëm gjinor.¹³⁶ As Zyra Kombëtare e Auditimit nuk dha rekomandime për të inkorporuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në praktikat financiare të Ministrisë, megjithëse ky është një detyrim ligjor, duke përfshirë përpjekjet për digjitalizim.

Në vitin 2020, BE-ja angazhoi 9 miliardë euro nga financimi IPA III për 2021-2027 për BP-në për lidhje të qëndrueshme, rritjen e kapitalit njerëzor, promovimin e konkurrencës dhe rritjes gjithëpërfshirëse dhe lehtësimin e tranzicionit të gjelbër dhe digjital.¹³⁷ Një buxhet vjetor prej 400,000 € është paraparë për projektet që kanë të bëjnë me ekonominë e gjelbër, me fokus në rritjen e ndërgjegjësimit, por nuk ka informacion për aktivitetet e realizuara deri më sot.¹³⁸ As nuk kishte informacion në dispozicion në lidhje me reagimin gjinor të aktiviteteve që lidhen me tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital.

MMPHI ka dy llogari në platformën e prokurimit elektronik: një për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe një për Ministrinë e Infrastrukturës. Edhe pse këto dy ministri janë bërë një, MMPHI-s i mbetet prokurimi i ndarë sipas ministrive të mëparshme. Dosjet e tenderit në platformën e prokurimit elektronik nuk përmbajnë asnjë deklaratë që inkurajon bizneset në pronësi të gjinive të nënpërfaqësuar të aplikojnë. Ato as nuk ofrojnë masa afirmative për kompanitë që punojnë për të çuar më tej barazinë gjinore brenda vendit.

Infrastruktura

Ky seksion shqyrton disponueshmërinë dhe reagimin gjinor të mjeteve digjitale që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, energjinë dhe ndryshimet klimatike. Ekziston pak ose aspak infrastrukturë për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për të informuar politikëbërjen në këta sektorë. MMPHI thuhet se kishte planifikuar të zhvillonte softuer shtesë, por përpjekjet u ndaluan në pritje të miratimit të Agjendës Digjitale.¹³⁹ Infrastrukturës digjitale ekzistuese të energjisë dhe ujit i mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë për ndjekjen e konsumit të burimeve. Ndërsa informacioni për përdorimin e energjisë elektrike dhe gjurmën e karbonit bazohet kryesisht në supozime, hulumtimi sugjeron se burrat kanë kërkesa më të larta.¹⁴⁰ Gjurmimi i të dhënave për përdorimin e energjisë në kohë dhe vendndodhje të ndryshme gjeografike, të ndara sipas gjinisë, mund të mbështes një sistem “ndotësi paguan” si dhe

136 Republika e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, *Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2022*, qasur më 18 shtator 2023.

137 KE, Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve: *Një Plan Ekonomik dhe Investues për Ballkanin Perëndimor*, 2020.

138 OBZHE, *Indeksi i Politikës së NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2022: Vlerësimi i Zbatimit të Aktit të Biznesit të Vogël për Evropën, 2022*.

139 RrGK intervistë, 2023.

140 Phil Grünwald and Marina Diakonova, “Dallimet shoqërore, aktivitetet dhe performanca: Ekzaminimi i rolit të gjinisë në kërkesën për energji elektrike në Mbretërinë e Bashkuar”, *Kërkimi i Energjisë dhe Shkenca Sociale, Vëllimi 69*, 2020.

të mbështes ndërgjegjësimin më të synuar për gjininë për reduktimin e konsumit.

Nuk duket se ekziston asnjë infrastrukturë digjitale për inspektorët që të menaxhojnë rastet duke përfshirë informacionin e ndare sipas gjinisë për personat që raportojnë shkelje të supozuara, ndotësit, llojin e ndotjes ose shkeljes së pretenduar, statusin e rastit ose gjobat.

Mjetet dhe teknologjia digjitale mund të përdoren për të parashikuar dhe për t'iu përgjigjur krizave klimatike. Teknologjia konsiderohet thelbësore për të vlerësuar, reduktuar dhe menaxhuar rrezikun që rrjedh nga ndryshimet klimatike, duke përdorur një informacion të tillë për sistemet e paralajmërimit të hershëm.¹⁴¹ Përveç Institutit Hidrometeorologjik, përgjegjës për paralajmërimin e përmbytjeve të shpejta, Qeveria nuk ka asnjë sistem paralajmërimi të hershëm, e lëre më sisteme paralajmërimi me perspektivë gjinore. As skemat e sigurimit nuk mbulojnë në mënyrë adekuate të gjitha familjet dhe bizneset në Kosovë, duke i mbrojtur ato nga krizat e ndryshimeve klimatike dhe humbjet e lidhura me motin.¹⁴² Shembujt global ofrojnë modele praktike dhe të besueshme që përdorin teknologjinë, si sigurimi i indeksit të motit. Kjo zgjidhje përdor një indeks që merr në konsideratë “modelet e reshjeve, temperaturën dhe tregues të tjerë” të lidhur me rreziqet që lidhen me motin.¹⁴³ Disa vende kanë adoptuar mësimin e makinerive për të kuptuar dhe menaxhuar rreziqet në mënyrë efektive, duke krijuar një indeks që lidh të dhënat lokale meteorologjike me vëzhgimet e motit për të informuar strategjitë më të gjera të menaxhimit të rrezikut.¹⁴⁴

Zgjidhjet digjitale për parashikimin e krizave të lidhura me klimën dhe për komunikimin efektiv të paralajmërimeve duhet të bazohen në analizën gjinore. Për shkak të mungesës së qasjes ndaj informacionit në kohë reale, gratë dhe grupet e cenueshme mund të preken në mënyrë disproporcionale nga krizat e ndryshimeve klimatike. Hulumtimet sugjerojnë marrjen parasysh të praktikave historikisht gjinore në teknologji kur hartohen strategjitë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike drejt shmangies së riprodhimit të marrëdhënieve të pabarabarta gjinore.¹⁴⁵

141 OBZHE, “Teknologji për reduktimin dhe menaxhimin e humbjeve dhe dëmeve” në Menaxhimin e rreziqeve klimatike, përballë humbjeve dhe dëmeve, OBZHE, 2021.

142 Republika e Kosovës, Qeveria, MBPZHR, [Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028](#), 2021.

143 OBZHE, “Teknologji për reduktimin dhe menaxhimin e humbjeve dhe dëmeve” në Menaxhimin e rreziqeve klimatike, përballë humbjeve dhe dëmeve, OBZHE, 2021.

144 Po aty.

145 N. Gonda, “Ndryshimet klimatike, “teknologjia” dhe gjinia: “Përshtatja e grave ndaj ndryshimeve klimatike me soba gatimi dhe rezervuarë uji”, Gjinia, Teknologjia dhe Zhvillimi, 2017.

Ky seksion shqyrton qasjen, pjesëmarrjen dhe përdorimin e digjitalizimit të grave dhe burrave të ndryshëm në lidhje me mjedisin, energjinë dhe reagimin ndaj ndryshimeve klimatike. Më pas, ai diskuton ndërgjegjësimin e njerëzve dhe aftësitë përkatëse të shkrim-leximit digjital. Së fundi, ai diskuton mbrojtjen dhe mirëqenien digjitale nga perspektiva gjinore.

Qasja, Pjesëmarrja dhe Përdorimi

EU PVGJ III bën thirrje për pjesëmarrjen e grave të ndryshme në vendimmarrje për politikën dhe veprimet e ruajtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, si dhe punësimin e tyre në ekonominë e gjelbër dhe rrethore.¹⁴⁶ Duke qenë se pak gra janë në pozita vendimmarrëse në Qeveri dhe pak gra dhe burra janë përfshirë në konsultimet publike në këta sektorë, pjesëmarrja në vendimmarrje duket minimale për të gjithë qytetarët dhe veçanërisht për gratë. Nënperfaqësimi i grave në konsultimet publike lidhet me normat gjinore dhe marrëdhëniet në familje. Burrat historikisht janë konsideruar si kryefamiljar me përgjegjësinë për të përfaqësuar interesat e familjes në diskutime dhe takime publike.¹⁴⁷ Më tej, burrat priren të marrin pjesë pasi gratë kanë “punët e shtëpisë për të bërë dhe nuk kanë kohë për këtë”, tha një zyrtar.¹⁴⁸ Rolet e socializuara gjinore, koha e pamjaftueshme, financat e kufizuara për të udhëtuar në takime dhe transporti i padisponueshëm në zonat rurale mund të jenë barriera për gratë që të kenë qasje në proceset vendimmarrëse.

Historikisht, pjesëmarrja e grave në sektorin e energjisë ka qenë e ulët dhe lidhshipi i dominuar nga meshkujt.¹⁴⁹ Kjo është pjesërisht për shkak të normave gjinore në lidhje me atë që përbën punë të përshtatshme për gratë.¹⁵⁰ Masat afirmative duket se kanë kontribuar në rritjen e pjesëmarrjes së grave. Në vitin 2021, gratë përbënin 9% të punonjësve të sektorit të energjisë,¹⁵¹ duke reflektuar një rritje të lehtë krahasuar me 7% në 2018.¹⁵² Qeveria u përpoq të rriste pjesëmarrjen e tyre në 11% deri në 2024 dhe 25% deri në 2031.¹⁵³

Disa studime kanë arritur në përfundimin se gratë janë përgjegjëse për përdorimin e më shumë energjisë elektrike. Megjithatë, hulumtimi i fundit i

146 BE, Komunikimi i Përbashkët për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, [Plani i Veprimit Gjinor i BE-së \(PVGJ\) III](#) – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Veprimin e Jashtëm të BE-së, 2020.

147 RrGK intervistë, 2021-2023; RrGK, [Nuk ka më justifikime](#), 2015, ff. 29-30.

148 RrGK intervistë, 2022.

149 USAID, [“Avancimi i Barazisë Gjinore në Sektorin e Energjisë së Kosovës”](#), 2021, qasur më 5 janar 2024.

150 RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018, f. 2.

151 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, 2023](#), f. 37.

152 KSM, [“Gratë po nxisin ndryshimin në sektorin e energjisë në Kosovë”](#), 2020.

153 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Ekonomisë, [Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031, 2023](#), f. 37.

kryer në Mbretërinë e Bashkuar e kundërshtoi këtë supozim, duke gjetur se megjithëse gratë përfshihen në aktivitete me një gjurmë më të madhe energjie, ato përdorin më pak energji elektrike sesa burrat për të kryer shumë nga këto aktivitete.¹⁵⁴ Studimet në kontekste të tjera kanë treguar se mungesa e të drejtave të grave për të hyrë dhe përdorur energjinë elektrike kontribuon në më pak mundësi sesa burrat për t'u përfshirë në vendimmarrje.¹⁵⁵ Në Kosovë, energjia përdoret për “ngrohjen e hapësirave, klimatizimin, ngrohjen e ujit sanitar, gatimin, ndriçimin dhe përdorimin e pajisjeve shtëpiake dhe individuale”. Për shkak të angazhimit të tyre në punë të papaguar, veçanërisht në mbajtjen e shtëpisë, gratë konsiderohen si “konsumatore kryesore të familjes”.¹⁵⁶ Kështu, ngritja e kapaciteteve për gratë në efikasitetin e energjisë mund të forcoj pozitën e tyre socio-ekonomike.¹⁵⁷

Ekzistojnë pak mundësi për të përdorur mjete digjitale në sektorët e lidhur me energjinë, kështu që përdorimi i saj prej grave dhe burrave nuk mund të vlerësohet. Siç u theksua, formularët online të MMPHI-së për paraqitjen e ankesave për dëmtime pyjore, dëmtime lumore ose ndërtime pa leje janë anonime. Pagesat online për ujë, energji elektrike dhe mbeturina nuk kërkojnë të dhëna të lidhura me gjininë. Kështu, analiza gjinore në lidhje me përdoruesit e shërbimeve nuk është e mundur. Mbledhja e këtij informacioni mund të zbuloj se kush tenton t'i përdorë këto shërbime ose të raportoj degradimin e mjedisit, duke lehtësuar një shtrirje më të mirë të synuar për të inkurajuar më shumë raportime. Të dhëna të tilla mund të hedhin dritë nëse gratë apo burrat janë më të prirur të përdorin shërbimet publike digjitale për shpenzimet e shërbimeve, duke informuar më tej shtrirjen. Aktualisht, më shumë gra (9%) sesa burra (7%) mendojnë se platforma eKosova duhet të ofroj një shërbim online për raportimin e ndotjes së mjedisit.¹⁵⁸

Në vitin 2017, KSM filloi Programin Prag Kosovë, me qëllim të fuqizimit të sektorit të energjisë, ofrimit të mundësive për gratë dhe promovimit të qeverisjes transparente.¹⁵⁹ KSM siguroi fonde për përmirësimin e izolimit të shtëpive, duke kontribuar në efikasitetin e energjisë. Ajo gjithashtu ofroi mundësi për gratë sipërmarrëse për të “investuar dhe për të përfituar nga efikasiteti i energjisë”.¹⁶⁰ KSM ofroi trajnime që rritën njohuritë e grave për

154 Phil Grünewald and Marina Diakonova, “Dallimet shoqërore, aktivitetet dhe performanca: Ekzaminimi i rolit të gjinisë në kërkesën për energji elektrike në Mbretërinë e Bashkuar”, *Kërkimi i Energjisë dhe Shkenca Sociale, Vëllimi 69*, 2020.

155 T. Winther, et al., “Në dritën e asaj që ne nuk mund të shohim: eksplorimi i ndërlidhjeve midis gjinisë dhe aksesit të energjisë elektrike”, *Kërkime për Energjinë dhe Shkenca Sociale*, 2020.

156 Asociacioni i Grave në Sektorin e Energjisë së Kosovës, *Diversiteti gjinor në sektorin energjetik të Kosovës*, 2022, fq. 32-33.

157 T. Winther, et al., “Në dritën e asaj që ne nuk mund të shohim: eksplorimi i ndërlidhjeve midis gjinisë dhe aksesit të energjisë elektrike”, *Kërkime për Energjinë dhe Shkenca Sociale*, 2020.

158 UNDP, *Anketa Digjitale e familjeve*, 2022.

159 KSM, faqe interneti, “Programi Prag i Kosovës”, 2023, qasur më 21 dhjetor 2023.

160 KSM, faqe interneti, “Investimi në Efikasitetin e Energjisë Nxit ndryshimin për Gratë Sipërmarrëse të Kosovës”, 28 mars 2021, qasur më 21 dhjetor 2023.

efikasitetin e energjisë dhe qasjen e tyre në financa. Bursat e KSM për gratë e reja u fokusuan në SHTIM dhe fushat që lidhen me energjinë.¹⁶¹ Deri në gusht 2022, 28 gra kishin marrë bursa KSM për të hyrë në sektorin e energjisë.¹⁶²

Aftësitë dhe ndërgjegjësimi i shkrim-leximit digjital

MMPHI ka theksuar nevojën për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e çështjeve mjedisore dhe biodiversitetit duke forcuar bashkëpunimin me MASHT-in, DKA-të dhe shkollat. MMPHI konstatoi si sfidë mungesën e fondeve për edukimin mjedisor dhe mungesën e trajnimeve mjedisore.¹⁶³

Anketat në mbarë Kosovën mbi perceptimet dhe njohuritë e qytetarëve mund të informojnë politikat, por të dhëna të tilla mungojnë. Asnjë anketë gjithëpërfshirëse nuk ka ekzaminuar njohuritë e grave dhe burrave në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, konsumin e energjisë, reagimin ndaj ndryshimeve klimatike, mjetet digjitale të lidhura me to ose mënyrën e raportimit të shkeljeve mjedisore. Sondazhet publike globale sugjerojnë se njerëzit në Kosovë kanë më pak gjasa se ata në vendet e tjera që ta konsiderojnë ndryshimin e klimës një fushë me prioritet të lartë për Qeverinë,¹⁶⁴ për shkak të çështjeve të tjera të ngutshme si zhvillimi socio-ekonomik, punësimi dhe politika.¹⁶⁵ Në vitin 2023, njerëzit konsideronin papunësinë (33%) dhe varfërinë (20%) problemet më të rëndësishme; vetëm 1.4% e konsideruan mjedisin një shqetësim kyç.¹⁶⁶ Përafërsisht 16% e grave dhe 13% e burrave thanë se nuk kishin njohuri për mjedisin. Pak më shumë gra thanë se dinin “shumë për këtë temë” (16%) sesa burra (14%). Megjithatë, nuk duket se ekziston ndonjë ndryshim domethënës midis grave dhe burrave në lidhje me njohuritë e tyre për ndryshimet klimatike, ku 65% e burrave dhe 62% e grave pretenduan se kishin dëgjuar për të.¹⁶⁷ Gratë dhe burrat priren të marrin informacion në lidhje me klimën nëpërmjet të njëjtave mjete komunikimi, veçanërisht nëpërmjet TV dhe mediave sociale.¹⁶⁸

Një anketë e kryer në komunën e Prizrenit zbuloi se shumica e qytetarëve (83%) kishin vërejtur ndryshime në reshje, temperatura, stinët, vërshimet dhe

161 KSM, [Kalimi i Pragut për Mundësi të Barabarta: Raporti përmbledhës mbi aktivitetet gjinore dhe përfshirjes sociale të zbatuara gjatë programit Pragu nga Millenium Foundation Kosova](#), 2022.

162 KSM, [Tabela e treguesve kryesor](#), 2022, qasur më 21 dhjetor 2023.

163 Republika e Kosovës, MMPHI, [Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin](#), 2020, ff. 27-28.

164 A. Leiserowitz, et al., “Opinion Public Ndërkombëtar mbi Ndryshimet Klimatike, 2022”. New Haven, CT: Programi Yale për Komunikimin e Ndryshimeve Klimatike dhe të Dhënat për Mirë në Meta, 2022. Të dhënat e ndara sipas gjinisë nuk ishin të disponueshme.

165 UNDP Kosovë, [“Eksplorimi i sfidave dhe mundësive të ndryshimeve klimatike në tranzicionin në një ekonomi neutrale të karbonit në Kosovë”](#), 2022, qasur më 21 dhjetor 2023.

166 UNDP Kosovë, [“Përmbledhje e Pulsit Publik XXIV”](#), 2023, f. 24. Anketa përfshiu 1,306 pjesëmarrës në kërkim.

167 UNDP Kosovë, [“Eksplorimi i sfidave dhe mundësive të ndryshimeve klimatike në tranzicionin në një ekonomi neutrale të karbonit në Kosovë”](#), 2022, qasur më 21 dhjetor 2023.

168 Po aty, f. 21.

thatësira.¹⁶⁹ Megjithëse studiuesit nuk dhanë të dhëna të ndara sipas gjinisë, 84% e të anketuarve kishin dëgjuar për ndryshimet klimatike, kryesisht përmes mjeteve digjitale si televizioni (46%) dhe interneti (30%). Më pak të anketuar (16%) kishin marrë informacion të tillë nga institucionet arsimore. Shumica e qytetarëve treguan se ishin disi të informuar për ndryshimet klimatike (58%), ndërsa vetëm 16% e konsideronin veten mjaftueshëm të informuar dhe 26% nuk ndiheshin të informuar. Ndër çështjet mjedisore, shumë njerëz ishin të shqetësuar për plehrat (28%), ndotjen e ajrit (23%), ndotjen e ujit (17%) dhe trafikun (15%). Në një anketë në mbarë Kosovën, si gratë (25%) ashtu edhe burrat (27%) e konsideruan ndotjen e ajrit një shqetësim kryesor.¹⁷⁰ Kur u pyetën për efektet e ndryshimeve klimatike, shumica parashikuan një ndikim të mëvonshëm (37%), ndërsa 33% ishin të pasigurt. Vetëm 27% besonin në një efekt të menjëhershëm. Pothuajse gjysma e qytetarëve të anketuar (49%) janë pajtuar se mund të bëhet diçka për të përmirësuar situatën, ndërsa 40% janë të pasigurt. Qytetarët prireshin të konsideronin autoritetet e qeverisjes vendore dhe kombëtare përgjegjëse për trajtimin e ndryshimeve klimatike (40%), ndërsa 37% vunë re përgjegjësinë individuale. Shumica (63%) nuk kishin marrë asnjë masë apo veprim për të adresuar ndryshimet klimatike. Ndër ata që e bënë, shumica kishin marrë pjesë në aktivitete pastrimi (59%) dhe mbjellje të florës në hapësira publike (24%). Edhe pse anketa nuk ishte përfaqësuese e të gjithë popullatës së Kosovës, ajo sugjeron nevojën për rritje të mëtejshme të vetëdijes lidhur me ndryshimet klimatike, duke përfshirë përdorimin e zgjidhjeve digjitale për të adresuar ndryshimet klimatike.

Gratë mund të kontribuojnë ndjeshëm në adresimin e ndryshimeve klimatike pasi ato shpesh janë përgjegjëse për mbledhjen dhe ruajtjen e burimeve të ujit dhe energjisë.¹⁷¹ Fushatat digjitale në internet mund të inkurajojnë gratë dhe burrat që të marrin në konsideratë se si të ruajnë energjinë dhe të mbrojnë mjedisin. Megjithatë, RrGK gjeti pak shembuj të përpjekjeve për ngritjen e vetëdijes që synon gra dhe burra të ndryshëm në gjuhët e tyre, veçanërisht në zonat rurale. E përballur me krizën energjetike në vitin 2022, kompania KEDS zhvilloi një fushatë online në bashkëpunim me kryetarët e komunave. Përmes videove online, kryetarët e komunave u bënë thirrje qytetarëve që të kursejnë energjinë, duke synuar përgatitjen për dimrin e ardhshëm; ata nuk i lidhën në mënyrë eksplicite përpjekjet e ruajtjes me shqetësimet mjedisore ose ndonjë çështje të lidhur me gjininë.¹⁷²

169 *Ec ma ndryshe*, “Përceptimi i qytetarëve të Prizrenit për ndryshimet klimatike”, qasur më 22 dhjetor 2023. Gjetjet u publikuan si infografikë dhe nuk kishte asnjë informacion në lidhje me madhësinë e kampionit ose ndonjë të dhënë të ndara sipas gjinisë.

170 UNDP Kosovë, “Eksplorimi i sfidave dhe mundësive të ndryshimeve klimatike në tranzicionin në një ekonomi neutrale të karbonit në Kosovë”, 2022, f. 28.

171 Katharina Miller dhe Sylvia Cleff Le Divellec, Shoqata Evropiane e Juristeve të Grave për RrGK, Dokument pune, “

Integrimi gjinor i kornizës ligjore të Kosovës për mjedisin në përputhje me zotimet e BE-së”, 2023.

172 KEDS Energjia, Facebook, “Kampanja për Kursim të Energjisë Elektrike” 2022, qasur më 21 dhjetor 2023.

Iniciativat dhe organizatat e shoqërisë civile si GAIA organizuan gjithashtu fushata për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e natyrës, veçanërisht tek të rinjtë.¹⁷³ UNDP përfshiu studentët në bashkë-dizajnimin e aktiviteteve drejt një mjedisi më të gjelbër në zonat më të ndotura të Prishtinës. Rekomandimet përfshinin “programe të mikro-lëvizshmërisë, infrastrukturë miqësore për këmbësorët, hapësira shoqërore që pastrojnë ajrin, gjelbërim, panele diellore dhe transport publik efikas dhe stacione autobusësh të pajisur me pastrues ajri”. Përqendrimi në kryeqytet neglizhon sfidat me të cilat përballen gratë dhe burrat në zonat rurale,¹⁷⁴ ku nevojitet ndërgjegjësimi i mëtejshëm.

Mirëqenia dhe Mbrojtja Digjitale

Digjitalizimi ofron mundësi për të adresuar shumë sfida të zhvillimit, duke përfshirë ndryshimet klimatike. Megjithatë, nëse nuk përdoren siç duhet, mjetet digjitale mund të përkeqësojnë pabarazitë ekzistuese sociale dhe gjinore. Komisioni për Statusin e Grave ka vërejtur se mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe seksit në lidhje me shumë çështje mjedisore i bën gratë dhe vajzat dhe nevojat e tyre të padukshme për politikëbërësit.¹⁷⁵ Në Kosovë, sektorët e mjedisit dhe energjisë kanë të dhëna të pamjaftueshme të ndara sipas gjinisë si dhe analiza gjinore,¹⁷⁶ gjë që pengon politikëbërjen të adresoj në mënyrë adekuate nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm. Asnjë hulumtim i njohur nuk ka ekzaminuar besimin e publikut tek inspektorët e mjedisit. Në drejtim të mirëqenies së grave dhe burrave, zhvillimi i softuerit të ri që digjitalizon shërbimet në lidhje me paralajmërimin e hershëm të rreziqeve klimatike, ujin, energjinë dhe raportimin online të shkeljeve mjedisore duhet të marrë parasysh standardet etike të përgjegjshme ndaj gjinisë, mbrojtjen e të dhënave, privatësinë, besimin dhe sigurinë kibernetike. Aktualisht, të gjitha raportimet që ekzistojnë janë konfidenciale dhe anonime.

Konsumi i energjisë është identifikuar si shkak për emetimet më të larta të CO₂ dhe degradimin e mjedisit.¹⁷⁷ Prodhimi i energjisë, veçanërisht nga qymyri, mund të kontribuoj që gratë të përballen me pasojat më të mëdha në

173 L. Bahtiri, “Perceptimet e të rinjve kosovarë për gjendjen mjedisore në Kosovë”, Ndryshimet klimatike 4, 2019.

174 UNDP Kosovë, uebfaqja, [Transformimi Digjital: Fuqizimi i një Ardhmeje të Qëndrueshme](#), 26 korrik 2023, qasur më 21 dhjetor 2023.

175 OKB, Këshilli Ekonomik dhe Social, [Komisioni për Statusin e Grave, Sesioni i Gjashtëdhjetë e gjashtë](#), 2022; dhe të Drejtat e Njeriut të OKB-së, Procedura Speciale, Raportues Special për të drejtat e njeriut dhe mjedisin, “Gratë, vajzat dhe e drejta për një mjedis të shëndetshëm: Praktika të mira”, 2023.

176 RrGK, [Analiza Gjinore e Kosovës](#), 2018.

177 J. Chontanawat, “Marrëdhënia ndërmjet konsumit të energjisë, emetimit të CO₂ dhe rritjes ekonomike në ASEAN: Modeli i Kointegrimit dhe Kauzalitetit”, Raportet e Energjisë, Konferenca e 6-të Ndërkombëtare për Kërkimin e Energjisë dhe Mjedisit - Energjia dhe mjedisi: sfidat drejt ekonomisë rrethore, 6 (1 shkurt 2020): fq 660–65. Në Kosovë, një sasi e madhe e energjisë është përdorur për prodhimin e kriptovalutave. Sipas PK-së, brenda një dite në një fshat të Zubin Potokut janë gjetur dhe konfiskuar 11 pajisje të përdorura për prodhimin e kriptovalutave (KosovaPost, “[Konfiskohen në veri 11 pajisje për kriptovaluta, pronari dyshohet se gjendet në Beograd](#)”, 11 qershor 2023, qasur më 15 gusht 2023.

shëndetin publik sesa burrat. Jetëgjatësia në Kosovë mbetet e ulët, pjesërisht për shkak të varfërisë, por edhe për shkak të faktorëve mjedisor.¹⁷⁸ Gratë në zonat rurale vuajnë më shumë pasoja sepse kanë qasje më të dobët në shërbimet shëndetësore sesa burrat dhe gratë në zonat urbane, pjesërisht për shkak të normave socio-kulturore.¹⁷⁹ Kështu, degradimi i mjedisit mund të ndikoj më shumë në shëndetin e grave sesa të burrave, sepse ato kanë më pak qasje në trajtim, edhe pse kjo ende nuk është hulumtuar dhe evidentuar mjaftueshëm në Kosovë.

Një çështje tjetër e hulumtuar mjaftueshëm është ndikimi që mjetet digjitale mund të kenë në mjedis, duke minuar potencialisht mirëqenien e grave dhe burrave të ndryshëm. Globalisht, mbetjet elektronike, duke përfshirë telefonat celularë, kompjuterët, televizorët dhe ngrirësit, po shkaktojnë sëmundje që vijnë nga gjellitja, thithja dhe kontakti i lëkurës me toksinat.¹⁸⁰ Nuk duket se ekzistojnë të dhëna në Kosovë për hedhjen e pakontrolluar të pajisjeve digjitale në deponi dhe rrugë ujore apo efektet e saj në shëndetin e njerëzve. Kjo kërkon ekzaminim të mëtejshëm duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të vetëdijes apo kontrollit të qeverisë për hedhjen e produkteve elektronike në tokat dhe lumenjtë e Kosovës.

Konkluzione

Nuk ekziston asnjë analizë gjithëpërfshirëse gjinore në lidhje me ndryshimet klimatike ose mjedisin; do të kërkonte një sipërmarrje të konsiderueshme duke pasur parasysh dimensionet e shumta që kërkojnë ekzaminim. Lidhur me **Rregulloren**, asnjë nga ligjet apo politikat përkatëse nuk duket të jetë informuar nga VN(B)GJ-ja e kërkuar. As nuk u kryen vlerësime ex-post të barazisë gjinore për të përcaktuar ndikimin e politikave që kanë pasur mbi gra dhe burra të ndryshëm. Kështu, ligjet dhe politikat nuk janë mjaftueshëm të përgjegjshme ndaj gjinisë, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me digjitalizimin.

Lidhur me **qeverisjen**, nënpërfaqësimi i grave në vendimmarrje, aftësitë minimale të zyrtarëve për politikëbërje të përgjegjshme gjinore dhe kufizimet në të dhënat e ndara sipas gjinisë janë barrierat kryesore për zhvillimin e ligjeve dhe politikave të përgjegjshme gjinore. Shërbimet digjitale nuk plotësojnë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave për informacion, angazhim në internet dhe shërbime elektronike. Ato as nuk mbledhin të dhëna të ndara sipas gjinisë që mund të përdoren për të informuar politikëbërjen dhe shërbimet. Buxheti i përgjegjshëm gjinor nuk është aplikuar vazhdimisht, duke përfshirë edhe prokurimin elektronik ose financimin për digjitalizim.

178 Republika e Kosovës, Qeveria, ZKM, ABGJ, [Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#), 2020.

179 Po aty.

180 M. Jain, et al., "[Rishikim mbi menaxhimin e E-mbeturinave dhe ndikimin e tij në mjedis dhe shoqëri](#)", *Buletini i Menaxhimit të Mbetjeve*, 2023.

Kosova ka një **infrastrukturë** digjitale shumë të kufizuar për këta sektor dhe të dhënat e ndara sipas gjinisë mblidhen rrallë.

Pak **njerëz** mund të kenë qasje ose të përdorin zgjidhje digjitale, duke përfshirë analizën gjinore. Ekziston një kërkim minimal se si njerëzit përdorin teknologjinë që lidhet me mbrojtjen e mjedisit, energjinë ose reagimin ndaj ndryshimeve klimatike, apo rreth njohurive të tyre. Përderisa mungojnë hulumtimet, shkalla e degradimit dhe ndotjes së mjedisit në Kosovë sugjeron vetëdijen e pamjaftueshme për mjedisin apo mjetet digjitale që mund të ndihmojnë në adresimin e këtyre çështjeve. Duke pasur parasysh infrastrukturën minimale digjitale në dispozicion, vlerësimi i mbrojtjes dhe mirëqenies digjitale nga perspektiva gjinore është i vështirë.

Digjitalizimi i kujdesit shëndetësor

Pandemia e COVID-19 shërbeu si katalizator për përdorimin e teknologjive dhe shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor. Ajo solli një epokë të re të “kujdesit shëndetësor digjital”, e përcaktuar për të përfshirë përdorimin e “aplikacioneve mobile për kujdesin shëndetësor, telemjekësisë dhe analitikës së të dhënave me qëllim të përmirësimit të sistemeve të kujdesit shëndetësor.¹ Edhe pse kujdesi shëndetësor digjital mund të “forcojë barazinë gjinore nëpërmjet rritjes së qasjes në kujdesin shëndetësor, fuqizimit të të dhënave shëndetësore të personit dhe zvogëlimit të barrës së punës së kujdesit të papaguar, ai rrallëherë dizajnohet nga perspektiva e barazisë gjinore.”² Aplikacionet digjitale të përdorura për shërbimet shëndetësore mund të “përforcojnë paragjykimet gjinore ose seksizmin, të injorojnë pabarazitë gjinore dhe të përdorin algoritme të njëanshme”.³ Si kudo tjetër, pandemia përshpejtoi nevojën për t’u digjitalizuar sektori i shëndetësisë në Kosovë, ku opsionet digjitale të kujdesit shëndetësor ishin praktikisht joekzistente. Në këtë kapitull shqyrtohen përpjekjet e Kosovës për digjitalizimin e kujdesit shëndetësor, përmes analizimit të dimensioneve si Rregullimi, Qeverisja, Infrastruktura dhe Njerëzit të Modelit të Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës të përgjegjshëm gjinor.

1 Caroline Figueroa, Tiffany Luo, Adrian Aguilera dhe Courtney Lyles, “[The need for feminist intersectionality in digital health](#)” [Nevoja për ndërthurje feministe në kujdesin shëndetësor digjital], 2021.

2 Po aty.

3 Po aty.

Korniza ligjore: Analiza gjinore politikave publike mbi digjitalizimin e kujdesit shëndetësor

Në këtë seksion analizohet njohja dhe marrja parasysh e aspektit gjinor tek ligjet dhe politikat sa i përket digjitalizimit të kujdesit shëndetësor.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e bën CEDAW drejtpërsëdrejti të zbatueshëm në Kosovë, duke përfshirë edhe në këtë sektor.⁴ Sipas CEDAW, shtetet duhet të ndërmarrin masa për të “eliminuar diskriminimin ndaj grave në fushën e kujdesit shëndetësor, në mënyrë që të sigurohet, mbi bazën e barazisë mes burrave dhe grave, qasja në shërbimet e kujdesit shëndetësor, përfshirë edhe në ato që lidhen me planifikimin familjar.”⁵ Shtetet duhet të sigurojnë qasje të barabartë në objekte të kujdesit shëndetësor, shërbime, informata, këshillim dhe arsim. Kjo “nënkupton detyrimin për të respektuar, mbrojtur dhe përmbushur të drejtat e grave në kujdes shëndetësor”.⁶ Komiteti CEDAW kërkon më tej që shtetet të mos e kufizojnë qasjen e grave në shërbimet e kujdesit shëndetësor ose klinikat mbi bazën e gjinisë së tyre, statusit martesor ose autorizimit nga anëtarët e familjes ose autoritetet shëndetësore. Shtetet duhet të sigurojnë qasje në këto shërbime për gratë në zonat rurale.⁷

Kosova, për shkak të statusit të saj politik, të panjohur në OKB, nuk është nënshkruese zyrtare dhe nuk ka nevojë të raportojë zyrtarisht për zbatimin e CEDAW. Shoqëria civile ka prodhuar një “raport në hije”, por ai është i vjetërsuar.⁸

Ligji për shëndetësi

Ligji i vitit 2012 siguron shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse pa diskriminim “në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës”.⁹ Në ligj ceket se Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurojë themelimin, zhvillimin, dhe funksionimin e sistemit unik dhe të integruar të informimit shëndetësor (SISh). Të gjitha institucionet shëndetësore duhet të sigurojnë mbledhje dhe raportim të rregullt, të qasshëm, konfidencial dhe të sigurt të të dhënave.¹⁰ Për të siguruar vazhdimësinë e trajtimit, institucionet e kujdesit shëndetësor duhet të ofrojnë qasje në të dhënat elektronike ose informatat e shkruara në objekte që ofrojnë shërbime diagnostikimi, trajtimi ose rehabilitimi.¹¹

4 Republika e Kosovës, [Kushtetuta](#), 2008, neni 22.

5 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, [CEDAW](#), 1979, [Rekomandimi i përgjithshëm 24 për Nenin 12 \(Gratë dhe Kujdesi Shëndetësor\)](#).

6 Po aty.

7 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, [CEDAW](#), 1979, neni 14, paragrafi 2.

8 QKSGJ, [Monitorimi i zbatimit të CEDAW në Kosovë](#).

9 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësi](#), 2012, neni 5, 1.2.

10 Po aty, nenet 49 dhe 52.

11 Po aty, neni 53.

Përveç klauzolës kundër diskriminimit, në Ligj nuk përmendet gjinia dhe është **neutral** në aspektin **gjinor**. Në të nuk theksohet nevoja për të ruajtur të dhënat e ndara sipas gjinisë në SISh, pavarësisht nga kërkesat e Ligjit për Barazi Gjimore. Ky lëshim mund të kontribuojë që mbledhja, mirëmbajtja dhe publikimi i të dhënave përkatëse të jetë i pamjaftueshëm. Edhe pse RrGK-ja nuk ka gjetur ndonjë raport zyrtar në dispozicion për publikun për monitorimin e zbatimit të këtij Ligji, dëshmitë në këtë kapitull sugjerojnë për mangësi në zbatim.” Në strategjinë e Sektorit për kujdesin shëndetësor thuhet se nuk ekziston ndonjë pasqyrë e saktë e situatës shëndetësore “për shkak të kufizimeve në shtrirjen dhe saktësinë e të dhënave.¹²

Ligji për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës ndaj Kujdesit Shëndetësor

Me këtë ligj të vitit 2007 u sigurohet çdo banori e drejta në kujdesin shëndetësor bazuar në shëndetin “e tij”.¹³ Banorët mund të kenë qasje në dokumentacionin dhe të dhënat që lidhen me gjendjen e tyre shëndetësore dhe trajtimin mjekësor.¹⁴ Ata kanë të drejtën e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.¹⁵ Edhe pse ligji u ndryshua në vitin 2022, në të ende mungon referenca për të dhënat elektronike të kujdesit shëndetësor.¹⁶ Me këtë ligj nuk u kërkohet institucioneve të digjitalizojnë të dhënat e pacientëve, mandati që mund t’i bëntë informatat dhe shërbimet shëndetësore më të qasshme. Në Ligj ceket se “ai, i/e tij ose atij gjithmonë nënkuptojnë gjininë femërore, përveç në rastet kur shprehimisht është përcaktuar ndryshe”.¹⁷ Prandaj, ligji është **negativ** në aspektin **gjinor** dhe gjuha negative në aspektin gjinor ngulmon të jetë e pranishme në Ligjin e vitit 2022.

Ligji për Inspektoratin Shëndetësor

Në këtë ligj thuhet se Inspektorati Shëndetësor është autoritet administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili bën monitorimin e jashtëm profesional të institucioneve shëndetësore sipas Ligjit për Shëndetësi, pa marrë parasysh financimin dhe pronësinë e institucioneve.¹⁸ Inspektorati gjithashtu është përgjegjës për evidentimin e dokumenteve, dëshmimeve dhe formularëve mjekësorë.¹⁹ As ligji i vitit 2006 e as versioni i tij i ndryshuar i vitit 2022, nuk specifikon se si Inspektorati duhet të mbledhë, evidentojë dhe mbrojë të

12 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, [Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021](#), 2016, f. 12.

13 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës ndaj Kujdesit Shëndetësor](#), 2007, neni 4.

14 Po aty., neni 19, paragrafi 19.1.

15 Po aty., neni 20, paragrafi 20.1.

16 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 08/L-051 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Banorëve të Kosovës ndaj Kujdesit Shëndetësor](#), 2022.

17 Po aty., neni 2, paragrafi 2.2. Për diskutim të mëtejme, shih Kapitullin 2.

18 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor](#), 2006, Neni 1, i ndryshuar dhe i plotësuar me [Ligjin nr. 08/L-049 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor](#), 2022.

19 Po aty., neni 6.

dhënat e inspektimit. Në të nuk specifikohet nevoja për të ruajtur të dhënat e ndara sipas gjinisë. RrGK nuk gjeti dëshmi se Inspektorati kishte sistem ekzistues dhe funksional të menaxhimit të të dhënave, kështu që do të ishte e vështirë të vlerësohej qasja e grave dhe burrave në shërbimet e inspektimit. Ky ligj është **neutral gjinor** sa i përket digjitalizimit dhe barazisë gjinore.

Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021

Kjo Strategji kishte për qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor.²⁰ Në Strategji përmendet se pajisjet mjekësore të teknologjisë së lartë përmirësojnë kapacitetet e diagnostikimit dhe trajtimit, por rrisin edhe shpenzimet në kujdesin shëndetësor, duke theksuar se Kosova nuk ka investuar në ripërtëritjen dhe blerjen e pajisjeve mjekësore të teknologjisë së lartë.²¹ Ministria e Shëndetësisë synonte të adresonte nevojat e grupeve të cënueshme duke zhvilluar shërbime për personat me aftësi të kufizuara, pacientët me kujdes paliativ (p.sh. pacientët me sëmundje terminale), të burgosurit dhe të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore, përfshirë trafikimin me qenie njerëzore.²² Megjithatë, në asnjë qëllim, tregues, pikënisje, objektiv ose buxhet nuk përmendet barazia gjinore ose ndonjë përpjekje për avancimin e barazisë gjinore. As nuk u synua me Strategji të digjitalizohen shërbimet në mënyrë të përgjegjshme gjinore; të evidentohen të dhëna elektronike, të përditësuara, të ndara sipas gjinisë; ose të zhvillohen aplikacione dhe mjete elektronike komunikimi që arrijnë tek gra dhe burra të ndryshëm, veçanërisht në zonat rurale ose tek personat me aftësi të kufizuara, të cilët mund të përfitojnë nga shërbimet shëndetësore të digjitalizuara. Strategjia ishte **neutrale** në aspektin **gjinor**, duke përmendur gjininë vetëm në lidhje me statistikat e popullsisë dhe vdekjeve. RrGK nuk ka mundur të gjejë ndonjë raport zyrtar në dispozicion për publikun ose analizë ex-post të ndikimit gjinor për monitorimin e zbatimit të Strategjisë, gjë që mund të informonte strategjinë e ardhshme.

Plani i komunikimit për sigurime shëndetësore 2017-2021

Ky Plan i vitit 2017 u përpilua si pjesë e Reformës së Financimit të Sektorit Shëndetësor për të ngritur njohuritë e qytetarëve në lidhje me të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe përfitimet e pritshme nga skema e sigurimeve shëndetësore.²³ Objektivat specifike përfshinin komunikimin efektiv të jashtëm, të brendshëm dhe ndërqeveritar. Fokusi ndaj nevojave të ndryshme të komunikimit të grave dhe burrave, mesazheve që tërheqin pozitat e ndryshme socio-ekonomike të grave dhe burrave dhe materialeve të komunikimit të përgjegjshëm gjinor mund të ishte përfshirë në Plan. Sidoqoftë, Plani ishte **neutral** në aspektin **gjinor**, duke përmendur gjininë vetëm në lidhje me statistikat e regjistrimit të popullsisë. Përmes asnjë raporti në dispozicion

20 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, [Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021](#), 2016.

21 Po aty, Kapitulli 4.4.

22 Po aty, f. 43.

23 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, Zyra e Ministrisë, [Plani i komunikimit për sigurime shëndetësore 2017-2021](#), 2017, f. 17.

për publikun nuk ishte monitoruar zbatimi i Planit, e as nuk ishte bërë analiza e ndikimit gjinor.

Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor pas Pandemisë COVID-19

Ky plan synonte të zbatonte OZHQ 3.4 me qëllim për të siguruar jetë të shëndetshme dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë.²⁴ Ishte plan njëvjeçar për vitin 2023, që kërkonte monitorim më pas. Plani nuk përmbante asnjë qëllim, tregues, pikënisje, objektiv ose buxhet në lidhje me barazinë gjinore, megjithëse mund të kishte marrë në konsideratë se si COVID-19 mund të ketë ndikuar ndryshe në shëndetin mendor të grave dhe burrave ose se si kanë përfituar gratë dhe burrat nga ndërhyrjet shtetërore. Ai ishte **neutral** në aspektin gjinor.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Ndërlidhur me Kapitullin 28 të legjislacionit të BE-së (Acquis), “Mbrotjtja e Konsumatorit dhe Shëndetit”, PKZMSA 2021-2025 parasheh funksionalizimin e sistemit të sigurimeve shëndetësore, duke përfshirë kornizën e nevojshme legjislative; mbledhjen e primeve përmes Fondit të Sigurimeve; dhe përmirësimin e SISH.²⁵ Ai përsërit gjetjet e Raportit të KE-së për Kosovën 2020 se “më shumë burime financiare duhet të ndahen për shëndetësinë”, duke mundësuar kështu reforma si dhe zgjerimin e SISH.²⁶ Në PKZMSA nuk përmendet në mënyrë eksplicite gjinia, gratë ose burrat në kujdesin shëndetësor dhe është **neutral** në aspektin gjinor.

PKZMSA 2022-2026 i referohet projektit të Kujdesit Shëndetësor të Qasshëm dhe Cilësor, të financuar nga Qeveria Zvicerane, i cili do të fokusohet në përmirësimin e qasjes në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor, cilësinë e shërbimeve, menaxhimin shëndetësor dhe fuqizimin e pacientëve, veçanërisht të grupeve të cenueshme.²⁷ Në të nuk përmendet digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore apo gjinia dhe është **neutral** në aspektin gjinor.

Agjenda për Reforma Evropiane II

Në ARE II ishte përmendur shkurtimisht shëndeti, por jo digjitalizimi i shërbimeve shëndetësore.²⁸ Në vitin 2021m Agjenda parashihte, hartimin e një strategjie të re sektoriale shëndetësore për 2022-2031, por Ministria e Shëndetësisë nuk e ka publikuar një strategji të tillë. Parashihte edhe kryerjen e një analize për të identifikuar prioritetet dhe forcuar sistemin shëndetësor.

24 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, [Plani i Veprimit për Shëndetin Mendor pas Pandemisë COVID-19](#), 2022.

25 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit \(PKZMSA\) 2021-2025](#), 2021.

26 Po aty, f. 220.

27 Republika e Kosovës, Qeveria, [Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit \(PKZMSA\) 2022-2026](#), 2022, f. 231.

28 Republika e Kosovës, Integrimi Evropian, [Faza e dytë e prioritetëve politike BE ▣ Kosovë: Agjenda për Reforma Evropiane \(ARE\) II](#), qasur më 21 dhjetor 2023.

Kjo duhet të përfshijë VN(B)Gj, por kjo nuk përmendet në mënyrë të qartë, dhe veprimi është **neutral gjinor**. RrGK nuk ka mundur të gjejë dëshmi nëse konsultimet publike ishin informuar ndonjë analizë të tillë para hartimit të strategjisë së re, ose nëse Ministria e Shëndetësisë kishte planifikuar të bëjë analizë të ndikimit gjinor

Qeverisja

Ky seksion shqyrton deri në çfarë mase kanë marrë pjesë gratë dhe burrat në udhëheqjen, koordinimin, planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave që lidhen me digitalizimin e kujdesit shëndetësor. Ai diskuton aftësitë e zyrtarëve dhe punonjësve të kujdesit shëndetësor për të ndërmarrë reforma digjitale të përgjegjshme gjinore. Së fundi, ai analizon marrjen parasysh e aspektit gjinor në shërbimet publike digjitale përkatëse, financim dhe prokurimin.

Kujdesi shëndetësor në Kosovë është i organizuar në tri nivele: atë primar, sekondar dhe terciar. Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen nga institucionet shëndetësore publike, private dhe publiko-private. **Ministria e Shëndetësisë** është kryesisht përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit. Ajo mbikëqyr ofrimin e kujdesit shëndetësor në institucionet publike dhe ato private në të tre nivelet e kujdesit shëndetësor.²⁹ Ministria është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e ligjeve dhe politikave që sigurojnë një sistem jodiskriminues të kujdesit shëndetësor; monitorimin e situatës; zbatimin e masave për parandalimin, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve; dhe zhvillimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor.³⁰ Ministria duhet të zbatojë politikat zhvillimore, duke mbështetur dhe udhëhequr institucionet e tjera, punonjësit komunalë, punëdhënësit, shoqërinë civile, qytetarët, banorët dhe sistemin e kujdesit shëndetësor.³¹ Kjo nënkupton koordinim, duke përfshirë reformat digjitale. Në Ministrinë e Shëndetësisë gratë zënë 13 (43%) kurse burrat 17 (56%) pozita vendimmarrëse.³² Ndërkohë në administratën qendrore të Ministrisë punojnë 77 gra (55%) dhe 61 burra (44%). Stafi për **SISh** ka baraspeshë gjinore prej tre grash dhe tre burrash. Pra, baraspesha gjinore pothuajse ekziston në pozitë dhe proceset vendimmarrëse. ZBGJ tha se ajo ishte konsultuar në hartimin e koncept dokumenteve, por jo të ligjeve apo strategjive.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKSHP) është institucioni më i lartë shëndetësor, profesional dhe shkencor në Kosovë. Ai zhvillon, organizon, mbikëqyr dhe zbaton politikat e shëndetësisë publike.³³ IKSHP mbulon të gjithë Kosovën përmes degëve të tij, Instituteve të Shëndetit Publik, në gjashtë

²⁹ Po aty.

³⁰ Republika e Kosovës, [Ministria e Shëndetësisë](#), faqja e internetit, “Fushëveprimi”, qasur më 14 shtator 2023.

³¹ Po aty.

³² Korrespondenca e RrGK-së me Ministrinë e Shëndetësisë, korrik 2023.

³³ IKSHP, [faqja e internetit](#), 2017, qasur më 22 dhjetor 2023.

qendra rajonale. Ai gjithashtu paraqet bazën për Fakultetin e Mjekësisë. Organizon dhe mbikëqyr studimet dhe vlerëson formimin shkencor dhe profesional të kandidatëve për punë në shëndetësinë publike.³⁴ IKSHP nuk ofron asnjë shërbim digjital. Gjatë pandemisë COVID-19, IKSHP përdori mediat sociale, kryesisht Facebook-un, për të komunikuar me qytetarët

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është një institucion shëndetësor autonom dhe i pavarur në Prishtinë.³⁵ Ai në vete ka institucione publike të kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar, duke përfshirë Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës.³⁶ Komunitet kanë **Qendra të Mjekësisë Familjare**. Ka shtatë spitale të përgjithshme rajonale në Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren, Ferizaj, Gjakovë dhe Vushtrri.

Inspektorati Shëndetësor në Kosovë është organ administrativ i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili ushtron mbikëqyrje të jashtme profesionale të institucioneve shëndetësore.³⁷ Ai e ka selinë në Prishtinë dhe 12 inspektorë. Inspektorati mbikëqyr inspektimet, merr masa dhe shqipton gjoka.³⁸ Duke qenë se mandati i tij ligjor është **neutral** sa i përket **gjinisë**, informata rreth marrjes parasysh të aspektit gjinor në punën e tij ishin vështirë për t'u gjetur. Inspektorati nuk ka faqe interneti apo shërbime të digjitalizuara. Informatat e vetme online rreth këtij institucioni gjenden në një link në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili përmban emrin e nënkryetarit të Inspektoratit.³⁹

Në përgjithësi, sa i përket institucioneve publike të kujdesit shëndetësor, RrGK nuk ka mundur të gjejë ndonjë shërbim të digjitalizuar. Në Raportin e KE-së për Kosovën 2023 ekziston një observim që

Kosova ka sistemin e-shëndeti, i cili mundëson komunikim virtual ndërmjet përdoruesve/pacientëve dhe mjekëve të përgjithshëm, ofron shërbime këshillimore dhe përmban të dhëna për pranimet,

³⁴ Po aty.

³⁵ Republika e Kosovës, [Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës](#), faqja e internetit, "Historiku SHSKUK", qasur më 10 gusht 2023.

³⁶ Republika e Kosovës, Qeveria, [Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës](#), 2013, f. 5. Këtu përfshihet Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK); Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës; Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë; Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive; Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut; Qendra Kombëtare e Telemjekësisë; Spitali i Përgjithshëm në komunat e Kosovës; Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë për Integrim në bashkësi; dhe Qendra Integruese dhe Rehabilituese e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtim. Këto nuk kanë faqe të internetit apo shërbime digjitale.

³⁷ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor](#), 2006, neni 1.

³⁸ Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 08/L-049 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor](#), 2022, neni 1.

³⁹ Ministria e Shëndetësisë, [faqja e internetit](#), qasur më 22 dhjetor 2023.

shkarkimet dhe transferimet e pacientëve. Megjithatë, nuk përdoret nga të gjitha institucionet shëndetësore dhe mbeten për t'u shtuar funksionalitete të mëtejshme (që mbulojnë patologjinë, radiologjinë, transfuzionin e gjakut, vaksinimin dhe ndërhyrje të tjera).⁴⁰

Përkundër kërkimit, RrGK nuk ka mundur ta gjejë këtë sistem në internet që nga janari 2024.

Sa i përket **pjesëmarrjes** së profesionistëve në sektorin e shëndetësisë, në institucionet shëndetësore publike, 34% nga 8812 të punësuar janë burra dhe 66% janë gra, kryesisht për shkak se gratë priren të jenë infermiere.⁴¹ Në Odën e Infermierëve në Kosovë, 80% nga 25,463 anëtarë janë gra dhe 20% janë burra. Mbipërfaqësimi i grave mes infermierëve është tregues i normave gjinore, ku gratë priren të shërbejnë si kujdestare dhe burrat priren të mbajnë pozita më të larta dhe më të paguara. Fatkeqësisht, ASK-ja nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për mjekët, dentistët, farmacistët dhe fizioterapeutët. Gjinia e ofruesve të kujdesit shëndetësor mund të ndikojë tek pacientët dhe gatishmëria e tyre për të marrë shërbime, duke përfshirë shërbimet digjitale të kujdesit shëndetësor. Hulumtimi i RrGK zbuloi se:

Duke pasur parasysh vlerat e disa grave, ato mund të mos dëshirojnë të preken nga burra që nuk janë burrat e tyre, edhe nëse janë mjekë [...] 23.8% e grave e konsideronin problem të pasurit ofrues të kujdesit shëndetësor të gjinisë tjetër, gjë që kufizon qasjen e tyre në kujdesin shëndetësor krahasuar me 18.4% të burrave. Pikëpamjet e tilla ishin më të përhapura në zonat rurale ku 25.3% e kosovarëve e konsideronin këtë si problem, krahasuar me 15.0% në zonat urbane.⁴²

Ndërkohë që ekzistojnë informata të kufizuara në lidhje me marrjen parasysh të integritit të aspektit gjinor në reformat për digjitalizimin në këtë Ministri, fakti që shumica e ligjeve dhe politikave janë neutrale në aspektin gjinor tregon se gjinia nuk është konsideruar si pjesë e këtyre reformave dhe kështu fokusi për të avancuar barazinë gjinore mund të mos ketë qenë i integruar në reforma në mënyrë adekuate. Normat dhe vlerat gjinore duhet të merren parasysh gjatë dizajnit të shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor, duke siguruar kështu që shërbimet të mund të ofrohen grave nga gratë.

40 KE, [Raporti për Kosovën 2023](#), 2023, f. 92.

41 ASK, [Seria 5: Statistikat Sociale, Statistikat e Shëndetësisë](#) 2022, f. 10, qasur më 22 dhjetor 2023.

42 RrGK, [Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë](#), 2016, f. 44.

Përgjegjësitë e **Komisionit të Kuvendit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** përfshijnë zhvillimin e politikave që sigurojnë mirëqenien dhe mbrojtjen sociale të grupeve të cenueshme dhe rishikimin e legjislacionit dhe buxheteve. Ai mbikëqyr zbatimin e ligjeve në juridiksionin e tij. Komisioni ka katër anëtare gra (40%) dhe gjashtë anëtarë burra (60%).⁴³ Nënperfaqësimi i grave mund të pengojë përfshirjen nga Komisioni të pikëpamjeve të grave në politikëbërjen dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor të përgjeshëm gjinor.

Aftësitë

ZBGJ ka ndjekur trajnime se si të përdoren teknologjitë digjitale dhe, sipas korrespondencës së fundit, besonte se kishte kapacitete të mjaftueshme në mesin e stafit për t'i përdorur ato.⁴⁴ RrGK-ja nuk ka mundur të gjejë ndonjë analizë në dispozicion për publikun për aftësitë e zyrtarëve të **Ministrisë** për të ndërmarrë reforma digjitale të përgjegjshme gjinore. Fakti që ligjet, politikat dhe reformat në përgjithësi nuk e kanë të përfshirë perspektivën gjinore sugjeron për kapacitete të pamjaftueshme për të siguruar fokusin ndaj barazisë gjinore.

Stafi i SISH ka përgatitje arsimore në TIK, duke përfshirë kapacitetet për zhvillimin, administrimin dhe menaxhimin e të dhënave.⁴⁵ Ministria ofron trajnime për stafin për të qenë të përditësuar me inovacionet teknologjike. Megjithatë, thuhet se SISH ka nevojë për të paktën 15 persona të tjerë për të menaxhuar operacionet e tij.⁴⁶ Edhe pse SISH është funksional sipas Ministrisë, pjesëmarrës të tjerë të hulumtimit thanë se ai nuk është ende plotësisht funksional.⁴⁷ Vizita në secilën klinikë të kujdesit shëndetësor publik ilustron se shumica e punonjësve të kujdesit shëndetësor ende përdorin regjistrat në letër dhe jo sisteme elektronike, duke sugjeruar kështu për mangësi në aftësitë për të kaluar në këtë sistem digjital. Nuk u gjetën të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me aftësitë digjitale të punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe nevojat e tyre për t'u përshtatur me evidentimin e sigurt të të dhënave digjitale dhe/ose shërbimet e kujdesit shëndetësor digjital.

Ndërkohë, Kosova nuk ka mjaftueshëm ofrues të trajnuar të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, gjë që mund të pengojë progresin në miratimin dhe zbatimin e reformave teknike dhe inovative digjitale në sistemin e kujdesit shëndetësor.⁴⁸ Kosova mund të mos ketë ekspertë të specializuar në informatikë shëndetësore apo teknologji mjekësore.⁴⁹ Hulumtimet e publikuara në vitin

43 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale](#), qasur më 2 shtator 2023.

44 Korrespondenca e RrGK-së, shtator 2021.

45 Po aty.

46 Po aty.

47 Po aty., dhe komenti mbi draft raportin gjatë rishikimit nga kolegët, 2023.

48 Shegë Bahtiri dhe Erza Selmani, [Digjitalizimi i kujdesit publik shëndetësor në Kosovë: Pasqyrë e përgjithshme dhe sfidat](#), Konrad Adenauer Foundation (KAS) në Kosovë, 2023, pf. 11-12. Hulumtimi nuk ka përfshirë analizën gjinore.

49 Po aty.

2021 zbuluan se punonjësit e kujdesit shëndetësor kanë pak vetëbesim në përdorimin e teknologjive digjitale, sepse u mungon arsimimi dhe aftësimi profesional.⁵⁰ Një studim tjetër zbuloi se shumica e infermierëve “kishin më shumë gjasa ta imagjinonin veten duke përdorur kompjuterin, laptopin ose telefonat inteligjentë dhe më pak të ngjarë ta imagjinonin veten duke përdorur ndonjë robot ndihmës ose telemjekësi”, megjithëse infermierët shprehën interes për trajnime të mëtejshme për përdorimin e teknologjisë shëndetësore.⁵¹

Shërbimet Publike Digjitale

Qeveria përdori platformën eKosova për të mbështetur vaksinimet gjatë pandemisë COVID-19.⁵² Ky ishte ndër shërbimet e para online në dispozicion në Kosovë. Sa i përket shërbimeve digjitale shëndetësore, eKosova ofron qasje në pasaportat digjitale të vaksinimit dhe së fundi është shtuar edhe mundësia për të zgjedhur apo ndryshuar mjekun familjar. Kur u pyetën se sa efektive ishte qeveria në përdorimin e teknologjive digjitale për t’iu përgjigjur ndaj COVID-19, 35% e të anketuarve në anketën e UNDP-së mendonin se qeveria ishte efektive, ndërsa 16% kishin mendimin se qeveria ishte joefektive ose shumë joefektive.⁵³

Gjatë karantinës COVID-19, ABGJ bashkëpunoi me Ministrinë e Shëndetësisë për të ofruar këshillim falas për shëndetin mendor. Ministria ka punuar me Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës për të ofruar shërbime falas të tele-këshillimit në gjuhën shqipe dhe serbe për personat që kishin ankth për shkak të izolimit gjatë karantinës. Është e paqartë nëse këto shërbime vazhduan edhe pas pandemisë, megjithëse shërbime të tilla mund të jenë të dobishme për gratë e izoluara edhe në kohë jo-pandemike. E as RrGK-ja nuk ka mundur të gjejë ndonjë analizë ndërthurëse gjinore për ofruesit dhe marrësit e këtyre shërbimeve. Statistikat Shëndetësore të ASK-së në vitin 2020 dhe 2021 nuk përmbanin të dhëna të ndara sipas gjinisë për personat që përdorin shërbimet publike të shëndetit mendor gjatë pandemisë

ASK publikon të dhëna për sektorin e shëndetësisë çdo vit. Ai përfshin të dhëna të ndara sipas gjinisë për punonjësit në institucionet shëndetësore publike, lindjet, vdekjet, lëndimet dhe sëmundjet⁵⁴ Përkundër kërkesave në Ligjin për Barazi Gjinore, ASK nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për pacientët që vizitojnë QKUK-në, spitalet e përgjithshme, qendrat kryesore të mjekësisë

50 Po aty, citim i Adnan Hoxha, Besarta Taganoviq dhe Arben Hysenaj, “Hulumtimi cilësor: Përcaktuesit dhe Implikimet Afatgjata të Gatishmërisë dhe Besimit të Profesionistëve Shëndetësor të Kosovës në Teknologjinë Digjitale”, *Pielęgniarsstwo w Opiece Długoterminowej / Long-Term Care Nursing* 6 (4): 47-56, 2021.

51 Po aty, citim i Petrit Beqiri et al., “Afiniteti për teknologjinë asistuese dhe interesi për trajnimin e ardhshëm të infermierëve kosovarë 2023.

52 [EKosova](#), qasur më 10 gusht 2023.

53 UNDP, [Digital Household Survey](#), 2022.

54 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, ASK, *Seria 5: Statistikat Sociale: Statistikat Shëndetësore 2020*, 2021.

familjare apo institucionet e shëndetit mendor e as nuk ofron të dhëna të ndara sipas gjinisë për vdekjet në QKUK, stafin që ofron shërbime COVID-19 apo lëndimet në vendin e punës. Në mesin e llojeve të vizitave (p.sh., në shtëpi, ato ditore, specialiste, psikiatri, sport, terapi, argëtim), nuk ekzistojnë të dhëna për shërbimet e kujdesit shëndetësor online ose psikoterapisë. Pra, të dhëna në dispozicion për publikun janë pamjaftueshme për të vlerësuar përfshirjen e aspektit gjinor në shërbimet digjitale të kujdesit shëndetësor.

Faqet e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe ofruesve publikë të shërbimeve publikohen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.⁵⁵ The Faqja e internetit e Ministrisë ka informata për Ministrinë, organizimin, funksionet, legjislacionin, strategjitë, lajmet dhe vegëzat për ofruesit e shëndetit publik. Faqja e internetit nuk ka asnjë mjet për personat me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, gjuha dhe imazhet e përdorura janë neutrale në aspektin gjinor. I vetmi shërbim digjital është “Raportimi” për informimin e Ministrisë për parregullsitë. Aty mund të përshkruhen problemet, të bashkëngjiten fotot dhe parashtresat për Ministrinë.⁵⁶ Fushat e vetme që kërkohen në formularin e raportimit janë tema, kategoria (shërbimet administrative ose shëndetësore), mesazhi dhe ngarkimi në media. Nuk ekziston asnjë fushë për gjininë e personit që paraqet parregullsinë, gjë që pengon përcjelljen e përdorimit të këtij funksioni nga gratë dhe burrat.

Faqja e internetit e **Inspektoratit Shëndetësor** përmban vetëm informacionin e kontaktit të zëvendësit të kryeinspektorit shëndetësor.⁵⁷ Nuk përmban optionin për asnjë shërbim digjital.

Financimi dhe prokurimi

Në përgjithësi, Kosova nuk ka metodologji të besueshme për vlerësimin e kostove mjekësore.⁵⁸ KASH bën thirrje për buxhetim gjinor drejt arritjes së disiplinës fiskale.⁵⁹ Ministria e Shëndetësisë ende nuk ka zbatuar buxhetimin e përgjegjshëm gjinor; KASH-i nuk përmban asnjë qëllim, tregues, pikënisje ose objektiv në lidhje me barazinë gjinore ose matjen e përfitimeve nga shërbimet e kujdesit shëndetësor të financuara nga qeveria për gra dhe burra. Monitorimi/përcjellja digjitale e shpenzimeve duke përdorur të dhëna të ndara sipas gjinisë mund ta lehtësojë këtë, por duket se nuk ekziston ende. Ministria e Shëndetësisë përdor e-prokurimin për prokurim.⁶⁰

55 Republika e Kosovës, “[Ministria e Shëndetësisë](#)”, faqja e internetit, qasur më 14 shtator 2023.

56 Po aty.

57 Republika e Kosovës, Ministria e Shëndetësisë, faqja e internetit, “[Inspektorati i Shëndetësisë](#)”, qasur më 14 dhjetor 2023.

58 EC, [Kosovo 2022 Report](#), 2022, f. 92.

59 Republika e Kosovës, Qeveria, MFPT, [Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2024-2026](#), 2023, Pillar IV, f. 19.

60 Kufizimet kohore penguan analizën e plotë mbi njohjen dhe marrjen parasysht të aspektit gjinor në prokurim.

Raporti i auditimit i Ministrisë për vitin 2022 nuk përfshinte të dhëna të ndara sipas gjinisë ose informata mbi kontributin në barazinë gjinore.⁶¹ Zyra Kombëtare e Auditimit nuk rekomandoi përfshirjen e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në praktikat financiare të Ministrisë. Ndërkohë, në raportin e auditimit ka observime për mangësi në menaxhimin e shërbimeve të specializuara nga Ministria. Lëshimi me vonesë i vendimeve për pushimin e lehonisë ka sjellë ka çuar në vonesë tre mujore në kompensimin e specialistëve; kompensimin jo të duhur për pushimin e lehonisë dhe shtesat e ndërlidhura ndikuan negativisht në buxhetin e Ministrisë. Zyra Kombëtare e Auditimit këshilloi Ministrin që të nxirrte menjëherë vendimet për pushimin e lehonisë për të mbrojtur të drejtat e specialistëve për kompensim dhe, sipas nevojës, për të zbatuar një ngrirje pagash me qëllim të parandalimit të dëmtimit financiar.⁶² Kjo ishte pika e vetme e raportit të auditimit lidhur me barazinë gjinore. Në mënyrë të ngjashme, asnjë informatë nuk ekzistonte në raportin e auditimit të vitit 2021 mbi përfshirjen e aspektit gjinor në shpenzimet e Ministrisë për reagimin ndaj COVID-19.⁶³

Infrastruktura

Ky seksion shqyrton disponueshmërinë e infrastrukturës digjitale të përgjegjshme gjinore në sektorin e shëndetësisë. Ai trajton shkurt ekosistemin e inovacionit.

Mjete dhe softuer digjital

Lidhur me shëndetin publik, Raporti i KE-së për Kosovën 2021 theksoi se gjatë pandemisë COVID-19, Kosova ka pasur progres të dukshëm në përmirësimin e mbikëqyrjes, hetimit të rasteve, gjurmimit të kontakteve, menaxhimit të rasteve dhe vaksinimit.⁶⁴ Megjithatë, është observuar progres i kufizuar në mbrojtjen e shëndetit, veçanërisht duke marrë parasysh futjen e pjesshme të SISh. Planet kanë ekzistuar prej kohësh për të zhvilluar SISh drejt përmirësimit të vendimmarrjes së bazuar në dëshmi. SISh do të funksiononte në mbarë Kosovën deri në vitin 2020 dhe të shërbente si një regjistër gjithëpërfshirës për kancerin, duke mbështetur programet e ekzaminimit/testimit.⁶⁵ Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, SISh ka një Sistem Informativ Shëndetësor Bazë dhe Sisteme të Trashëgimisë.⁶⁶ SISh bazë mundëson regjistrimin e vizitave mjekësore tek ofruesit e shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor dhe në disa klinika të specializuara. Ai gjithashtu mundëson regjistrimin e pacientit, menaxhimin e radhës, procedurën mjekësore, diagnostikimin, përshkrimin

61 Republika e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2022](#) 2023.

62 Po aty, rekomandimi B1, f. 7-8.

63 Zyra Kombëtare e Auditimit, [Raporti i auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2021](#), qasur më 15 janar 2024.

64 KE, Raporti për Kosovën 2021, 2021.

65 Republika e Kosovës, Zyra Kombëtare e Auditimit, [Efikasiteti dhe efektiviteti në zbatimin e sistemit informativ unik të të integruar shëndetësor](#), 2017.

66 Korrespondenca e RrGK-së me Ministrinë e Shëndetësisë, korrik 2023.

e terapisë, të dhënat e vaksinimit, referimin e pagesës dhe printimin e raporteve. Sistemet e trashëgimisë mundësojnë digjitalizimin e punës dhe proceseve nga Ministria dhe institucionet shëndetësore. Për shembull, mundëson menaxhimin e stokut farmaceutik, regjistrimin e të dhënave të stafit shëndetësor, aplikimet online për institucionet shëndetësore private, skedarët digjitalë, aplikimet online për specializimet dhe menaxhimin e specialistëve. Sistemi përfshin të dhëna personale dhe mjekësore që ndërlidhen me vizitat mjekësore që rrjedhin nga të dhënat personale ekzistuese në sistem. Ato mund të filtrohen ose të ndahen sipas gjinisë, vendndodhjes, moshës dhe diagnozës; përkatësia etnike nuk është përfshirë në mënyrë eksplicite. Sistemi është në ASHI. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, infrastruktura për administrimin, menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave është e mjaftueshme.⁶⁷ (Ajo menaxhohet nga stafi i SISh dhe kompanitë e kontraktuara për mirëmbajtjen e sistemit. Sipas zyrtarëve, stafi i Ministrisë së Shëndetësisë është i pajisur me sistemin Zero Client (model kompjuterik i bazuar në server, në të cilin pajisja kompjuterike e përdoruesit përfundimtar nuk ka ruajtje lokale) dhe pajisje të tjera të nevojshme.⁶⁸ Megjithatë, nuk ka pasur asnjë analizë të duhur të sfidave të sigurisë së të dhënave në lidhje me digjitalizimin e të dhënave të pacientëve, gjë që kontribuon në shqetësimet në lidhje me privatësinë dhe sigurinë e të dhënave të SISh.⁶⁹

Pavarësisht përpjekjeve drejt reformave, Kosova nuk ka pasur progres me SISh.⁷⁰ Një studim i vitit 2021 zbuloi se nuk kishte metodologji të koordinuar të punës, kontabilitet të përputhshëm me sistemin, mjete, mbështetje softuerike ose sistem komunikimi për të informuar treguesit e politikave shëndetësore.⁷¹ Qendrat e mjekësisë familjare ende përcjellin të dhënat duke përdorur të dhënat fizike.⁷² Meqenëse institucionet e kujdesit shëndetësor ende regjistrojnë të dhënat me dorë në regjistrat në letër, është jashtëzakonisht e vështirë të referohen pacientët duke përdorur shkëmbimin elektronik të të dhënave ose të identifikohen me kohë krizat e mundshme shëndetësore. Përdorimi i papërshtatshëm i infrastrukturës së SISh-it ndikon gjithashtu në disponueshmërinë e statistikave shëndetësore cilësore të ndara sipas gjinisë. Pa të dhënat e SISh, është e vështirë të analizohet përdorimi i shërbimeve shëndetësore nga gratë dhe burrat. Në komunat me shumicë serbe, të dhënat mjekësore nuk raportohen në institucionet e Kosovës,⁷³ kështu që mungojnë të dhënat e ndara sipas gjinisë për serbët e Kosovës.

67 Po aty.

68 Po aty.

69 Bahtiri, Shegë dhe Selmani, Erza, [Digjitalizimi i kujdesit publik shëndetësor në Kosovë: Pasqyrë e përgjithshme dhe sfidat](#), Konrad Adenauer Foundation (KAS) në Kosovë, 2023, f. 10.

70 EC, [Kosovo Report 2023](#), 2023, f. 49.

71 Afrim Loku, Nadire (Shehu) Loku dhe Lindita Loku, "Menaxhimi i Sistemit Informativ në Institucionet Shëndetësore të Kosovës: Rast Studimi", *Journal of International Cooperation and Development*, Vëllimi 4. nr. 2, nëntor 2021.

72 Ekonomia Online, [Mosfunksionimi i shërbimit informativ shëndetësor zvarrit digjitalizimin](#), 2018.

73 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, [Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021](#), 2016, f. 12.

Infrastruktura e dobët ose përdorimi i kufizuar i saj, mund ta bëjë të vështirë përcjelljen e trendeve dhe çështjeve shëndetësore që ndërliken me gjininë. Vetëm përmes monitorimit elektronik në kohë reale mund të gjurmohen trendet në sëmundjet specifike gjinore si kanceri i gjirit. Si shembull tjetër, institucionet shëndetësore janë ndër pikat e para të kontaktit në rastet e dhunës me bazë gjinore.⁷⁴ Evidentimi i të dhënave elektronike për raste të tilla, duke përfshirë dyshimin për abuzim, ndërkohë që siguron mbrojtjen e këtyre të dhënave, mund të ndihmojë në dokumentimin dhe identifikimin e trendeve të abuzimit. Nëse pacientët me lëndime që mund të rrjedhin nga abuzimi vizitojnë institucionet e kujdesit shëndetësor një ose më shumë herë, evidentimi i mirë i të dhënave digjitale mund të ndihmojë në identifikimin e rasteve të tilla si dhe të dokumentojë prova në rast se pacienti dëshiron t'i përdorë ato më vonë në procedurat ligjore.

Ministria e Shëndetësisë ka krijuar një Program për Vizitat në Shtëpi për të mbërritur deri tek fëmijët dhe prindërit e tyre në mbarë Kosovën. Ministria është duke e digjitalizuar sistemin e informacionit të Programit, i cili përfshinte ofrimin e 300 tabletave kompjuterike për infermierët që ofrojnë shërbime shëndetësore nëpërmjet Programit, të mbështetur nga USAID përmes UNICEF-it.⁷⁵

Nga perspektiva gjinore, shërbimet shëndetësore online si këshillimi mund të lehtësojnë qasjen në të dhëna dhe kujdes shëndetësor, veçanërisht për gratë në vendet rurale dhe disa gra me aftësi të kufizuara të cilave u mungon qasja e barabartë në transport dhe që përballen me pengesa të tjera financiare në qasjen e këtyre shërbimeve.⁷⁶ Këshillimi online i kujdesit shëndetësor mund të informojë pacientët për të drejtat e tyre dhe të mbështesë mirëqenien e tyre. Megjithatë, Kosova duket se nuk ka ende infrastrukturë për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor online.

Disponueshmëria e mbështetjes psikologjike konfidenciale dhe cilësore online, përfshirë edhe asaj për personat që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore, mbetet e kufizuar. Aktualisht, ofruesit publikë të shërbimeve nuk ofrojnë shërbime të tilla.⁷⁷ Gjatë pandemisë COVID-19, RrGK-ja dhe Qendra e Grave Autonome në Serbi zhvilluan një Protokoll që vendosi parime dhe standarde për shërbimet e këshillimit online. Protokollin përmban disa masa sigurie dhe procedura hap pas hapi për ofruesit e shërbimeve për të ndihmuar gratë që përdorin komunikimin digjital. Ai bazohet në praktikat më të mira ndërkombëtare në sigurinë e të dhënave që synojnë të mbrojnë gratë që marrin këto shërbime. Shumica e strehimoreve po e përdorin këtë Protokoll për të

74 RrGK, *Nga ligjet në vepra: Monitorimi i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë*, 2021.

75 UN Kosovo Team, "UNKT në pika të shkurta – korrik 2023". Shih gjithashtu Programin e UNICEF-it për Kosovën, Facebook, *lajme*, 4 korrik 2023, qasur më 9 janar 2024.

76 RRGK, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*, 2016.

77 Republika e Kosovës, Qeveria, Ministria e Shëndetësisë, *Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2017-2021*, 2016, Kapitulli 4.4.

udhëhequr shërbimet e tyre të këshillimit online.⁷⁸ Ekzistojnë mundësi që institucionet shëndetësore të konsiderojnë miratimin e Protokollit të RrGK si pjesë e PSV-ve të ardhshme të rishikuara.

Ekosistemet e inovacionit

Pak është bërë në sektorin e shëndetësisë në Kosovë. Në kontrast me këtë, zhvillimet e fundit në IA globalisht po mundësojnë ndryshime të rëndësishme në kujdesin shëndetësor, të tilla si aftësimi i pacientëve që përsuan goditje në tru të flasin pas 20 vjetësh duke konvertuar sinjalet e trurit në të folur.⁷⁹ Industria e kujdesit shëndetësor në disa vende përdor IA tani për të automatizuar vendimmarrjen; në të ardhmen IA mund të jetë përgjegjëse për “bërjen e zgjedhjeve që ndikojnë në trajektoren e jetës së njerëzve, si p.sh. se cilin trajtim mjekësor të marrin [ose] nëse kanë të drejtë për sigurimin e jetës apo kredi”.⁸⁰ Përfshirja e aspektit gjinor në algoritmet e IA në sektorin e shëndetësisë ende nuk është marrë parasysh në Kosovë, por mund të jetë thelbësore për të siguruar mbrojtje adekuate për gra dhe burra të ndryshëm.

Njerëzit

Ky seksion analizon qasjen dhe përdorimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga gratë dhe burrat; zotësinë dhe ndërgjegjësimin e tyre digjital për të mundësuar përdorimin e shërbimeve digjitale; dhe sa mirë i mbrojnë këto shërbime ata dhe mirëqenien e tyre digjitale.

Qasja dhe përdorimi

Përveç studimeve për korrupsionin, qasjen në kujdesin antenatal, dhe vështirësitë me të cilat përballen pakicat në qasjen e kujdesit, asnjë analizë e njohur që është gjithëpërfshirëse e aspektit gjinor nuk ka analizuar qasjen në kujdes shëndetësor për gratë dhe burrat që nga studimi i RrGK-së në vitin 2016.⁸¹ Bazuar në një anketë të ekonomive familjare në mbarë Kosovën, studimi i RrGK-së zbuloi se gratë priren të kenë mungesë të qasjes në kujdesin shëndetësor në krahasim me burrat, veçanërisht gratë në zonat rurale dhe ato të përkatësisë etnike boshnjake, gorane, rome, ashkali dhe egjiptiane.⁸² Për shkak të normave sociale, gratë prireshin të kishin më pak kohë se burrat për t’u qasur në shërbimet e kujdesit shëndetësor, meqenëse gratë ishin më të angazhuara në punët e shtëpisë dhe kujdeseshin për të tjerët.⁸³ Barrierat financiare gjithashtu i penguan gratë të kenë qasje në kujdesin shëndetësor, duke qenë se pak gra kishin qasje në të ardhura. Besimet ndikuan gjithashtu

78 Intervistat e RrGK-së me strehimoret, 2023.

79 Pam Belluck, “A Stroke Stole Her Ability to Speak at 30. A.I. Is Helping to Restore It Years Later” [Goditja në tru ia vodhi aftësinë e të folurit në moshën 30-vjeçare. IA po ndihmon atë vite më vonë], *New York Times*, 24 gusht 2023.

80 M. West, R. Kraut dhe H. Ei Chew, *Do të skuqesha nëse do mundja: mbyllja e hendekut gjinor në zotësitë digjitale përmes edukimit*, UNESCO, 2019.

81 RrGK, *Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë*, 2016, f. 6.

82 Po aty., f. 51.

83 Po aty., f. 43.

në qasjen e grave në kujdesin shëndetësor, të tilla si se “gratë duhet të jenë të forta dhe të mos kenë nevojë të vizitojnë mjekun”; për shkak të vlerave sociale, gratë mund të hezitojnë të vizitojnë mjekët meshkuj.⁸⁴

Qasja e dobët në kujdesin shëndetësor mund të jetë komplikuar gjatë pandemisë, veçanërisht duke pasur parasysh kufizimet në lëvizje dhe ndërprerjet në transportin publik, në të cilin gratë zakonisht mbështeten më shumë se burrat.⁸⁵ Gratë raportuan vështirësi në marrjen e shërbimeve jashtë rajoneve të tyre, duke përfshirë kujdesin shëndetësor. Pa perspektivë gjinore, “masa të veçanta për të siguruar funksionimin e reparteve gjinekologjike”, informata dhe staf të mjaftueshëm, më pak gra kanë kërkuar shërbime gjinekologjike gjatë pandemisë, sipas QKSGJ.⁸⁶

Në përgjithësi, as gratë dhe as burrat nuk mund të përdorin shërbimet digjitale të kujdesit shëndetësor, sepse Kosova nuk ka vendosur infrastrukturën e nevojshme. Më shumë gra sesa burra kishin profile në platformën eKosova, megjithëse të dhënat e ndara sipas gjinisë për përdorimin e shërbimeve të e-shëndeti nuk ishin në dispozicion. Për sa i përket përdorimit të përgjithshëm që nga lansimi, platforma ka 852,000 përdorues të regjistruar dhe janë përdorur 2.37 milionë shërbime “shëndetësore”, sipas të dhënave të eKosova.⁸⁷ Natyra e saktë e këtyre shërbimeve është e paqartë (p.sh., disa mund të kenë përfshirë takime për vaksinimin kundër COVID-19). Nëse transformimi digjital i shërbimeve shëndetësore është i informuar nga analiza gjinore, gra dhe burra të ndryshëm mund të kenë përmirësuar qasjen në kujdesin shëndetësor. Pa analizën e duhur gjinore, pengesat para-ekzistuese në qasjen e shërbimeve të kujdesit shëndetësor mund të pengojnë qasjen e grave në shërbimet digjitale të kujdesit shëndetësor.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor digjital mund të rrisin potencialisht qasjen e ndryshme të grave dhe burrave në kujdesin shëndetësor. Për gratë, të cilat priren të kenë më pak kohë, qasje në transport dhe burime financiare për të qasur kujdesin shëndetësor në vendndodhje fizike, shërbimet e kujdesit shëndetësor digjital kanë mundësi të mbështesin diagnostikimin dhe trajtimin.

Zotësi digjitale – Aftësitë dhe Ndërgjegjësimi

Meqë ka pak shërbime digjitale, nuk ekziston asnjë informatë në lidhje me shkallën në të cilën gratë dhe burrat kanë njohuri, ndërgjegjësim dhe aftësi digjitale të mjaftueshme për të gjetur, qasur dhe përdoruar shërbimet digjitale të kujdesit shëndetësor. Në caktimin e termineve për vaksinimet gjatë COVID-19, të moshuarit dhe personat në zonat rurale duket se kanë hasur më shumë vështirësi se qytetarët e tjerë. ASHI shpenzoi kohë të konsiderueshme duke ofruar udhëzime se si të caktohen takime/termine ose të bëhet regjistrimi në

84 Po aty.

85 RrGK, “*Pandemia nuk njeh gjini ?*”, 2020.

86 QKSGJ, *Shëndeti riprodhues i vajzave dhe grave gjatë pandemisë COVID-19* 2020.

87 eKosova, qasur më 10 janar 2024.

platformë.⁸⁸ ASHI nuk mbante të dhëna të ndara sipas gjinisë për telefonuesit, gjuhët që ata flisnin ose aftësitë e tyre. Përcjellja dhe raportimi më i mirë i të dhënave ndërthurëse të ndara sipas gjinisë nga platforma eKosova mund të ndihmojë në informimin e politikave dhe masave të përgjegjshme gjinore për qytetarë të ndryshëm.

Ministria e Shëndetësisë mund të përdorë mjete komunikimi digjitale, duke përfshirë mediat sociale, në fushata të synuara për të informuar gra dhe burra të ndryshëm për shëndetin e tyre, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe të drejtat e tyre. Përveç fushatës vjetore për ndërgjegjësimin për kancerin e gjirit në tetor që synon gratë, RrGK-ja nuk gjeti asnjë dëshmi të fushatave informative online të përgjegjshme gjinore që synojnë gra dhe burra të ndryshëm sa i përket shërbimeve apo të drejtave të tyre në kujdes shëndetësor.

Mirëqenia dhe Mbrojtja Digjitale

Institucionet e kujdesit shëndetësor që fusin të dhënat e pacientëve janë përgjegjës për “mbledhjen, ruajtjen dhe menaxhimin e rregullt dhe të sigurt të të dhënave”.⁸⁹ Ata duhet të sigurojnë mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Institucionet bashkëpunojnë me ASHI dhe AIP për të siguruar mbrojtjen e të dhënave. Platforma eKosova përdor mekanizmat e sigurisë në përputhje me udhëzimet e AIP-it. Nuk është raportuar asnjë ankesë në lidhje me keqpërdorimin e të dhënave, përfshirë ato të ndërlydhura me shërbimet shëndetësore të ofruara përmes platformës.⁹⁰

Praktikuesit e kujdesit shëndetësor, veçanërisht psikiatërit, kanë vërejtur se pacientët kanë hezitur të kërkojnë kujdes nga frika e shkeljes së konfidencialitetit.⁹¹ Më saktësisht, 11% e kosovarëve në vitin 2016 mendonin se privatësia e tyre ishte shkelur teksa po merrnin shërbimin të kujdesit mjekësor. Barrierat kryesore të konfidencialitetit të identifikuar ishin: mungesa e hapësirës në institucionet shëndetësore, mungesa e respektimit dhe kuptimit të konfidencialitetit mjek-pacient, dokumentet që mund të shkeleshin lehtësisht dhe të dhëna personale që mund të qaseshin lehtësisht.⁹² Në vitin 2021, qytetarët thuhet se nuk kishin njohuri se çfarë nënkupton privatësia online.⁹³ Kjo mund të nënkuptojë që njerëzit nuk e dinë se kur ndodh shkelja e të drejtave të tyre e privatësisë dhe mu për këtë nuk mund të kërkojnë ndihmë. Nuk kishte të dhëna përfaqësuese, të ndara sipas gjinisë.

Strukturat e pushtetit mund të ndikojnë në privatësinë dhe qasjen e grave dhe burrave në shërbimet e kujdesit shëndetësor në mënyra të ndryshme, duke përfshirë në ato digjitale. Gratë dhe vajzat mund të hezitojnë të kërkojnë

88 Intervista e RrGK-së me ASHI, 2021.

89 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësi](#), 2012, neni 52, paragrafi 2.1.

90 Intervista e RrGK-së me ASHI, 2021.

91 RrGK, [Qasja në kujdesin shëndetësor në Kosovë](#), 2016.

92 Po aty.

93 Intervista e RrGK-së me AIS, 2021.

shërbime të kujdesit shëndetësor digjital nga frika se të dhënat e tyre personale mund të zbulohen. Duke pasur parasysh rolet gjinore të socializuara, anëtarët e familjes (bashkëshortët, prindërit, fëmijët ose familja e gjerë) mund të insistojnë që të shoqërojnë gratë për të vizituar mjekun. Gjithashtu, gjatë pandemisë, anëtarët e familjes shpesh caktojnë termine për njëri-tjetrin ose merrnin pjesë në takimet e caktuara të kujdesit shëndetësor të pacientëve, duke u lejuar pacientëve pak privatësi për të diskutuar mirëqenien e tyre me ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Kjo paraqet një pengesë sociokulturore ndaj konfidencialitetit, ku ofruesit e kujdesit shëndetësor ende e konsiderojnë familjen si mekanizëm mbrojtës dhe mbështetës për individët dhe mu për këtë më të përshtatshëm për t'i ndihmuar ata të adresojnë çështjet e kujdesit shëndetësor sesa kur janë individët vetëm.⁹⁴ Gratë, megjithatë, mund të mos dëshirojnë që të dhënat e tyre private të ndahen me anëtarët e familjes, dhe për këtë arsye mund të zgjedhin të mos kërkojnë kujdes shëndetësor. Institucionet shëndetësore që mbledhin të dhëna duhet të jenë të vetëdijshme për aspektet gjinore të ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave dhe të parandalojnë personat e paautorizuar, duke përfshirë anëtarët e tjerë të familjes që të kenë qasje në të dhëna, duke përfshirë edhe në të dhënat digjitale.

Konkluzione

Sa i përket **Kornizës ligjore**, kohët e fundit nuk është bërë asnjë analizë gjinore për të informuar reformat drejt digjitalizimit të shërbimeve shëndetësore. Në përgjithësi, të gjitha ligjet dhe politikat që kanë të bëjnë me sektorin e shëndetësisë dhe digjitalizimin janë neutrale ose negative ndaj aspektit gjinor. Përmes asnjë raporti në dispozicion për publikun nuk ishte monitoruar zbatimi i tyre, e as nuk ishte bërë analiza e ndikimit gjinor

Ndërkohë që ekzistojnë informata minimale në lidhje me kapacitetet e **Qeverisë** për të zbatuar reformat e shëndetit digjital, fakti që ligjet dhe politikat rrallë përmendin digjitalizimin, se ato janë neutrale ose negative gjinore dhe se SISh përdoret rrallë, sugjeron për aftësi të pamjaftueshme. I vetmi shërbim publik digjital në dispozicion përmes eKosova ka të bëjë me vaksinat kundër pandemisë. Shërbime të tjera publike që mund të lehtësojnë qasjen e grave dhe burrave në kujdesin shëndetësor nuk ekzistojnë ende, kështu që marrja parasysh e aspektit gjinor në to nuk mund të vlerësohet. Financimi i sektorit shëndetësor nuk përfshinte buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Infrastruktura që përfshin softuerin dhe harduerin për evidentimin e të dhënave mjekësore digjitale të sakta dhe në kohë ekziston, por përvetësimi i tyre duket se po vonon. Pra, sektori ka mungesë të të dhënave elektronike të ndara sipas gjinisë. Si rezultat i kësaj, çdo dallim midis grave dhe burrave është vështirë për t'u identifikuar dhe trajtuar në vendimmarrje, politikëbërje

dhe programe. Ekzistojnë pak zgjidhje inovative dhe inovacioni i ardhshëm duhet të bazohet në analizën gjinore.

Është e vështirë të analizohet fusha **Njerëzit**, qasja, përdorimi dhe ndërgjegjësimi i grave dhe burrave të ndryshëm në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor digjital, duke pasur parasysh mungesën e shërbimeve të tilla. Nuk ekzistojnë as të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar përpjekjet për mbrojtjen e të dhënave apo mirëqenien e grave dhe burrave në lidhje me shërbimet e kujdesit shëndetësor digjital. Shqetësimet në lidhje me konfidencialitetin e pacientit ofrojnë një pasqyrë në lidhje me të drejtat e mundshme dhe shkeljet e privatësisë që do të duhet të merren parasysh në të ardhmen në të dhënat digjitale dhe shkëmbimi i informatave. Në përgjithësi, mbetet shumë për të bërë drejt digjitalizimit të sektorit të kujdesit shëndetësor në Kosovë.

Digjitalizimi I mediave dhe I komunikimit

Komunikimi përfshin një proces që synon të krijojë kuptim, duke u nisur nga “pyetjet në lidhje me mënyrën se si njerëzit krijojnë kuptimin psikologjik, social dhe kulturor; si kuptohen mesazhet intelektualisht; dhe si lind dhe zgjidhet paqartësia”.¹ Mediat përfshijnë “mjete komunikimi jopersonale të cilat kanë funksione të tilla si informimi, rritja e ndërgjegjësimit, edukimi, socializimi, argëtimi dhe përcaktimi i agjendës, duke përfshirë të gjitha llojet e imazheve gojore, të shkruara dhe vizuale”.² Teknologjia ka ndryshuar ndjeshëm mjetet e komunikimit. Burimet e informacionit kanë ndryshuar; media tradicionale e bazuar në letër është zëvendësuar kryesisht nga mediat digjitale të lajmeve.³ Mundësitë e shumta të mediave digjitale shoqërohen me sfida që lidhen me dezinformimin, keqinformimin, shkeljet e të drejtave të autorit, sigurinë e të dhënave dhe sigurinë personale.⁴

1 K. Rosengren, “Komunikimi, hyrje”, Sage, 2000, cituar në B. Ruler, “Teoria e Komunikimit: Një Shtyllë e Nënvlërësuar mbi të cilën mbështetet Komunikimi Strategjik”, Gazeta Ndërkombëtare e Komunikimit Strategjik, 2018.

2 IGI Global, “Manual i Kërkimit mbi Ndikimin e Kulturës dhe Shoqërisë në Industrinë e Argëtimit”, 2014.

3 Universiteti Carlow, “Si e ka ndryshuar komunikimin media digjitale”, 2021.

4 Abraham, “Ndikimi i medias digjitale në shoqëri”, Revista Ndërkombëtare e Mendimeve të Kërkimit Kreativ, 8, 5, 2020.

Në shumë mënyra, “hapësira kibernetike dukej si një arenë e re neutrale gjinore”.⁵ Megjithatë, zhvillimi i teknologjisë dhe medias zbarkohet në një “hapësirë gjinore” të pabarazive strukturore sociale, ekonomike dhe politike, të cilat prodhojnë barriera për gratë dhe vajzat e ndryshme për tu qasur dhe përdorur TIK-un digjital.⁶ Barrierat mund të jenë materiale, sociale, kulturore, psikologjike, politike dhe institucionale, dhe ato mund të kenë efekte të ndryshme tek burrat dhe gratë, duke përfshirë grupe të ndryshme.⁷ Digjitalizimi i mediave dhe i komunikimeve, veçanërisht i telefonave celular, mund të përfitoj nga gratë duke rritur qasjen e tyre në informacion, pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse, kohën në dispozicion dhe sigurinë, duke u mundësuar atyre të kërkojnë ndihmë.⁸ Ai gjithashtu mund të kontribuoj në kapërcimin e roleve patriarkale dhe në përmirësimin e situatës ekonomike dhe sociale të grave, të tilla si lehtësimi i pjesëmarrjes në punë me pagesë dhe avokimi në internet. Ndërkohë, zhvillimi teknologjik ka çuar në rritjen e mbikëqyrjes nga qeveritë dhe korporatat, duke përforcuar normat ekzistuese socio-kulturore dhe pabarazitë strukturore dhe duke i transferuar ato në hapësirën online.⁹ Gratë mund të jenë në rrezik të ndjekjes në internet, ngacmimeve seksuale dhe fushatave të shpifjeve gjinore¹⁰ (d.m.th., një përpjekje komunikimi e qëllimshme, e paramenduar ose strategjike për të minuar besueshmërinë, reputacionin ose punën e një individi ose grupi).¹¹ Mediat shpesh përjetësojnë norma dhe stereotipe diskriminuese gjinore.¹²

Ky kapitull shqyrton digjitalizimin e mediave dhe komunikimeve në Kosovë, duke përfshirë dimensionet e Kornizës ligjore, Qeverisjes, Infrastrukturës dhe Njerëzve të Modelit të Transformimit Digjital Gjithëpërfshirës, të përgjegjshëm ndaj gjinisë. Ai identifikon dhe përshkruan çdo dimension, duke vlerësuar reagimin gjinor.

5 Judy Wajcman, Erin Young, and Anna Fitzmaurice, “Revolucioni Digjital: Implikimet për Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Grave 25 vjet pas Pekinit”, 2020, f. 4.

6 C. Cummings, T. O’Neil, “A e rrisin zërin dhe ndikimin e grave dhe vajzave teknologjitë digjitale të informacionit dhe komunikimit? Një shqyrtim i shpejtë i provave”, ODI, 2015, ff. 7-11.

7 Po aty.

8 Shih OBZHE, “Kapërcimi i ndarjes gjinore digjitale: Përishi, Përmirëso, Përgatit”, 2018, f. 42; C. Cummings, T. O’Neil, “A e rrisin zërin dhe ndikimin e grave dhe vajzave teknologjitë digjitale të informacionit dhe komunikimit? Një shqyrtim i shpejtë i provave”, ODI, 2015; H. Al-Alosi, “Luftimi i zjarrit me zjarr: Eksplorimi i potencialit të teknologjisë për të ndihmuar viktimat të luftojnë dhunën e partnerit intim”, Agresioni dhe Sjellja e Dhunshme, 52, 2020.

9 Judy Wajcman, Erin Young, and Anna Fitzmaurice, “Revolucioni Digjital: Implikimet për Barazinë Gjinore dhe të Drejtat e Grave 25 vjet pas Pekinit”, 2020, ff. 2-3.

10 Partneriteti Global për Veprim mbi Abuzimin me Bazë Gjinore në internet, “Dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia: Analiza paraprake e peizazhit”, 2023; UNESCO, “The Chilling: Tendencat globale në dhunën në internet kundër grave gazetarë”, 2021.

11 Përkufizimi i përshtatur nga Jonathan Day, “Çfarë është një fushatë shpifjeje? A mund të dallosh dhe ta mundesh një?”, Demokracia dhe Drejtësia, 28 mars 2023.

12 UNICEF dhe UN Women, “Rishikimi i provave: Hartimi i lidhjes ndërmjet raportimit mediatik të dhunës ndaj vajzave”, 2022, f. 7.

Korniza ligjore: Analiza gjinore e politikave publike mbi digjitalizimin e mediave dhe komunikimit

Politikat e Kosovës duhet të jenë në përputhje me Acquis të BE-së, Kapitullin 10 “Shoqëria e Informacionit dhe Mediat”, i cili adreson komunikimin elektronik, shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe politikat audio-vizuale me të cilat rregulloret e BE-së promovojnë dhe inkurajojnë konkurrencën, zhvillimin dhe një qasje gjithëpërfshirëse ndaj shërbimeve dhe teknologjive moderne, duke theksuar interesat e përdoruesve.¹³ Ky seksion analizon reagimin gjinor të ligjeve dhe politikave që lidhen me median, komunikimin dhe digjitalizimin.

Ligji për Komunikimet Elektronike

Ky ligj i vitit 2021 rregullon rrjetet, shërbimet dhe burimet e komunikimeve elektronike, duke përfshirë pajisjet radio dhe terminale, përdorimin e tyre dhe marrëdhëniet shoqërore që lidhen me to. Ligji mbron të dhënat personale, veçanërisht të drejtën e privatësisë në përpunimin e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik.¹⁴ Ligji thotë se ofruesit e shërbimeve digjitale duhet të ofrojnë shërbime mbi një “bazë të drejtë, të arsyeshme dhe jodiskriminuese”.¹⁵ Megjithatë, hartuesit e humbën mundësinë për të përfshirë barazinë gjinore dhe për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara midis parimeve të tij. Barazia mund të ishte konsideruar në zhvillimin e politikave që rregullojnë përdorimin dhe menaxhimin e burimeve. Meqenëse Ligji rregullon çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të dhënave personale, ai duhet të pasqyroj Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili njih dhe mbron karakteristikat që lidhen me seksin.

Për sa i përket transparencës dhe publikimit të informacionit, ligji kërkon që rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik të disponueshëm publikisht të ofrojnë informacion me interes publik pa pagesë.¹⁶ Ky kusht mund të kishte inkurajuar promovimin e materialeve elektronike që rrisin ndërgjegjësimin e grave dhe burrave të ndryshëm në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë personale dhe privatësinë, veçanërisht lidhur me dhunën me bazë gjinore në internet.

Ky ligj është **neutral gjinor** sepse nuk përmend gjininë, gratë apo burrat. Ai nuk përfshin mbrojtjen gjinore për gratë dhe burrat e cenueshëm si konsumator të komunikimeve elektronike. As nuk siguron në mënyrë eksplicite që komunikimi elektronik ofron shërbime të qasshme për të gjithë qytetarët, duke përfshirë gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara.

13 KE, Komunikatë nga komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, [Kompasi digjital 2030: Mënyra evropiane për Dekadën Digjitale](#), Bruksel, 9 Mars 2021, Kapitulli 10.

14 Republika e Kosovës, Kuvendi, [Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike](#), 2021, Artikulli 2.

15 Po aty, Artikulli 3 dhe 42.

16 Po aty, Artikulli 65.

Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave

Ky ligj i vitit 2012 themeloi Komisionin e Pavarur për Media (KPM) për të promovuar zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm të shërbimeve mediatike audio-vizuale që plotësojnë nevojat e të gjithë qytetarëve.¹⁷ Sipas ligjit, KPM-ja duhet të hartoj një politikë transmetuese në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të transmetimit dhe të drejtave të njeriut, legjislacionin përkatës të BE-së dhe Direktivën e KE-së për shërbimin mediatik audiovizual, duke respektuar demokracinë, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes.¹⁸ Politika e transmetimit duhet të “promovoj programe të prodhuara në vend, arsimore dhe kulturore, veçanërisht programe rinore” që pasqyrojnë barazinë mes qytetarëve dhe komuniteteve në Kosovë.¹⁹

Në përfundim të kësaj analize, RrGK ofron zgjidhje të propozuara për problemet që janë identifikuar gjatë hulumtimit. Këtu janë konsoliduar disa nga rekomandimet kryesore, kurse sugjerime shtesë mund të nxirren nga gjetjet në secilin kapitull përkatës. Ato janë të organizuara sipas institucionit përgjegjës dhe sipas radhës në të cilën janë të paraqitura në këtë raport, me përjashtim të rekomandimeve për bashkëpunim ndërsektorial dhe atyre për BE-në, të cilat janë listuar qysh në fillim. Në kuadër të çdo kapitulli, rekomandimet janë të renditura sipas fushave – Korniza Ligjore, Qeverisja, Infrastruktura dhe Njerëzit.

Për Qeverinë, Sektorin Privat, Donatorët dhe Bashkëpunimin e Shoqërisë Civile

- Të sigurohet angazhimi i shoqërisë civile, veçanërisht OShCG-ve me ekspertizë përkatëse, në hartimin e ligjeve dhe politikave të reja të ndërlidhura me digjitalizimin duke i përfshirë ato në grupet punuese zyrtare, dëgjimet publike si dhe nëpërmjet platformës së konsultimit publik.
- Të gjitha politikat publike në raport me digjitalizimin, të përcillen me objektivë, indikatorë, dhe synime të qarta në raport me reduktimin e hapësirës gjinore (Gender Digital Divide).
- Të mblidhen, evidentohen, analizohen dhe përdoren të dhëna të ndara sipas gjinisë nga të gjitha institucionet për të siguruar që dizajnimi i aplikacioneve, platformave dhe shërbimeve publike digjitale është i informuar nga nevojat e grave dhe burrave, duke përfshirë edhe ato që ndërlidhen me njohuritë, përdorimin, sigurinë, privatësinë, mbrojtjen dhe mirëqenien digjitale. Të krijohen mekanizma llogari dhënës dhe inspektues për mbajtjen dhe përditësimin e këtyre të dhënave.
- Të vazhdohet me financimin e OShCG-ve të kualifikuara për të bërë analiza ndërthurëse gjinore me qëllim për të mbështetur Qeverinë me ekspertizë, duke informuar integrimin e perspektivës gjinore në ligjet, politikat, programet dhe buxhetet.
- Të ketë bashkëpunim për të bërë analizën ndërthurëse gjinore mbi mbrojtjen që lidhet me digjitalizimin, duke përfshirë mirëqenien digjitale, besimin te operatorët, mbrojtjen e të dhënave, standardet etike të përgjegjshme gjinore dhe privatësinë, drejt identifikimit të kërcënimeve që prekin gra dhe burra të ndryshëm.
- Të ketë bashkëpunim në financimin e nismave për të ngritur aftësitë digjitale, ndërgjegjësimin dhe mirëqenien e grave dhe burrave nga perspektiva gjinore. Të sigurohet financim i përgjegjshëm gjinor për procesin e transformimit digjital.
- Të mbështeten financiarisht OShCG-të dhe të ketë bashkëpunim me to për të vazhduar të sfidohen rolet dhe stereotipat patriarkalë gjinorë përmes fushatave të ndërgjegjësimit online që transformojnë këto norma.
- Të ketë bashkëpunim për të hartuar dhe zbatuar fushata ndërgjegjësimi që synojnë gra dhe burra të ndryshëm me informata në lidhje me format e krimit kibernetik, dhunën kibernetike dhe mënyrën e raportimit të

tyre; shërbimet digjitale në dispozicion; mirëqenien digjitale, sigurinë dhe privatësinë; dhe mundësitë për përdorimin e mjeteve digjitale përtej mediave sociale. Të përdoren imazhe që kundërshtojnë dhe transformojnë stereotipat gjinorë në lidhje me aftësinë e grave dhe burrave për t'u përfshirë në digjitalizim, duke përfshirë edhe në arsimin e lartë dhe punësimin në fushat digjitale. Të krijohen mekanizma digjitalë për komente/informata kthyesë përmes të cilave mblidhen të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke mundësuar kështu analizën e efektivitetit të fushatave dhe bërë përshtatjen sipas nevojës.

- Të kontaktohen OShCG-të për të mbështetur trajnimin, mentorimin dhe asistimin e grave të marginalizuara dhe të cenueshme përmes qasjes “të mësuarit nëpërmjet praktikës” gjatë procesit të digjitalizimit, duke ngritur kështu aftësitë digjitale të grave dhe qasjen në shërbimet publike online.
- Të mbështeten OShCG-të për të ofruar ndihmë juridike, veçanërisht duke ndihmuar grupet e cenueshme, e drejta për punë dhe të drejtat e tjera e të cilave mund të shkelen nga puna online, IA ose mjete të tjera digjitale.
- Të mbështeten OSHCG-të dhe bizneset në pilotimin e iniciativave të reja, siç janë ato të rekomanduara për MBPZHR.

Për Parlamentin, Komisionin dhe Zyrën e BE-së në Kosovë

- Të miratohet Direktiva e propozuar e BE-së për luftimin e dhunës me bazë gjinore online, duke përfshirë përkufizimin dhe rregullimin e qartë të sigurisë kibernetike dhe formave të ndryshme të dhunës kibernetike.
- Të kërkohet dhe sigurohet analiza gjinore dhe të përfshihen e qëllimeve, treguesve, pikënisjeve dhe objektivave të përgjegjshme gjinore në veprimet që lidhen me digjitalizimin, duke përfshirë ato për mbështetjen e drejtpërdrejtë të buxhetit të qeverisë, drejt gjetjes të ndikimeve të BE-së në barazinë gjinore, përmbushjes së kriterëve të OBZHE-së për shënjimit gjinor dhe përmbushjes së synimit të PVGJ III të BE-së që 85% e të gjitha veprimeve (nismave) të mbështetura nga BE-ja të jenë të përgjegjshme gjinore. Të sigurohet kontrolli i cilësisë së shënuesve gjinorë dhe që veprimet plotësojnë kriteret e OBZHE-së. Të përfshihen kërkesa më të qarta për analiza gjinore dhe programe të përgjegjshme gjinore në rregulloret e ardhshme të BE-së për financimin e jashtëm.
- Të përfshihet më mirë perspektiva gjinore në Kornizën Metodologjike për Parimet e Administratës Publike, duke përfshirë më shumë tregues që lidhen me barazinë gjinore, drejt mbështetjes së vendeve potenciale kandidate në reformat e përgjegjshme gjinore të administratës publike. Të sigurohet që kontraktorët, si SIGMA, t'i përdorin dhe të raportojnë për këto.
- Të inkurajohet fuqimisht Qeveria përmes dialogut politik dhe të sigurohet që të gjithë kontraktorët të përdorin VN(B)GJ për të informuar të gjitha projektligjet dhe politikat, përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin, sipas detyrimeve ligjore.
- Gjatë monitorimit dhe vlerësimit të Kontratës për Reformën e Sektorit të Kosovës për Reformën e Administratës Publike, të përfshihen kërkesa të qarta për analizën e ndikimit gjinor ex post, duke pasur parasysh se objektivat dhe treguesit fillestarë nuk ishin mjaftueshëm të përgjegjshëm

gjinore në përputhje me zotimet e BE-së. Të përdoren gjetjet për të informuar planifikimin e programeve dhe financimin e ardhshëm.

- Të inkurajohet qeveria që të angazhojë ekspertë në fushën e barazisë gjinore, duke përfshirë OShCG të ndryshme, në hartimin e ligjeve dhe politikave të reja, më të përgjegjshme gjinore, në lidhje me digitalizimin.

Për Kuvendin e Republikës së Kosovës

- Të finalizohet dhe publikohet Plani i Veprimit për zbatimin e OZHQ-ve, duke vendosur zotime të qarta, tregues, pikënisje, objektiva dhe afate kohore për progresin në OZHQ-të lidhur me aspektin gjinor dhe digitalizimin. Kjo përfshin treguesin OZHQ5c1 mbi buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. Të sigurohet monitorimi dhe raportimi i rregullt, transparent mbi progresin.
- Të ndryshohet dhe të plotësohet Rregullorja e Punës e Kuvendit për të siguruar që Qeveria të ketë kryer VN(B)GJ të kërkuar, ndër kriteret e tjera minimale në procesin e hartimit legjislativ si ndikimi i buxhetit dhe harmonizimi me legjislacionin (Acquis) e BE-së, para se draft-aktet të dorëzohen në komisionet parlamentare. Kjo mund të përfshijë vlerësimin e cilësisë së VN(B)GJ dhe sigurimin që gjetjet nga ai të jenë adresuar në mënyrë adekuate në projektligje. Duke qenë se Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Ligjore dhe Procedurale duhet të sigurojë koherencë me interesin publik dhe harmonizimin me legjislacionin (acquis) të BE-së, si dhe me traktatet dhe konventat ndërkombëtare në Kushtetutë, ajo mund të sigurojë përputhshmërinë me VN(B)GJ gjatë zbatimit të planit vjetor legjislativ. Të përmirësohet softueri që digjitalizon procesin e rishikimit legjislativ duke përfshirë kontrollin e marrjes parasysht dhe përfshirjes së perspektivës gjinore në projektligjet. Të futet VN(B)GJ dhe çdo koment parlamentar mbi to në Sistemin e Gjurmimit Legjislativ, për t'i vënë ato në dispozicion për publikun.
- Të sigurohet pjesëmarrja e barabartë gjinore (50%) në Kuvend dhe komisionet parlamentare sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, me qëllim të pasqyrimin të pikëpamjeve të grave dhe burrave në të gjithë politikëbërjen, monitorimin dhe vlerësimin, duke përfshirë edhe ato lidhur me digitalizimin.
- Të përmirësohet koordinimi ndërmjet komisioneve parlamentare që punojnë në digjitalizim, aspektin gjinor dhe buxhetin dhe financat, si p.sh. përmes seancave dëgjimore të përbashkëta për të nxjerrë nga njohuritë dhe ekspertizën e njëri-tjetrit, si dhe për të diskutuar ndërlidhjet midis gjinisë, digjitalizimit dhe financimit në sektorë të ndryshëm.
- Të digjitalizohet vijueshmëria dhe votimi, duke mundësuar analizën gjinore të vijueshmërisë së deputetëve dhe mënyrës së votimit nga deputetët, si dhe duke përmirësuar transparencën e punës së tyre.
- Të monitorohet zbatimi nga qeveria të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si pjesë e procesit të buxhetit vjetor, duke përfshirë edhe atë që ndërlidhet me digjitalizimin. Të bëhet rishikimi në mbledhjet e komisioneve nëse ministritë po e aplikojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në sektorë specifikë.
- Të sigurohet që të dhënat e digjitalizuara në lidhje me debatet e Kuvendit, mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe të dhënat legjislative po përditësohen rregullisht, janë në dispozicion në të gjitha gjuhët zyrtare

dhe që funksionet e kërkimit mundësojnë kërkime të lidhura me gjininë (p.sh., fjalë kyçe si gjinia, gratë, burrat, meshkujt dhe femrat)

- Të ftohen ekspertët në fushën e barazisë gjinore, përfshirë OShCG-të, të ndajnë njohuritë dhe hulumtimin e tyre gjatë seancave parlamentare dhe mbledhjeve të komisioneve, duke informuar debatin parlamentar me ekspertizën e tyre dhe duke kontribuar drejt një demokracie më pjesëmarrëse.
- Të bëhet vlerësimi i nevojave për të identifikuar nevojat për zhvillimin e kapaciteteve të deputetëve dhe stafit të Kuvendit mbi digjitalizimin dhe integrimin e perspektivës gjinore, dhe së bashku. Të dizajnohet përmbajtja e trajnimit i bazuar në vlerësimin në koordinim me donatorët dhe ekspertët e OShCG-s[.
- Të prezantohen kërkesat për trajnim të detyrueshëm për barazinë gjinore, integrimin e perspektivës gjinore, kryerjen e VN(B)GJ-ve dhe për aftësitë digjitale për anëtarët e ardhshëm të Kuvendit. Pjesëmarrja në trajnime dhe të zbatohen njohuritë e reja.
- Të zbatohet buxheti i përgjegjshëm gjinor duke përfshirë analizën gjinore, qëllimet, treguesit dhe objektivat në KASH-in e Kuvendit, duke ofruar aneksin e kërkuar të buxhetit dhe duke e vënë atë në dispozicion për publikun dhe të kuptueshëm përmes vizualizimeve online.

Për Qeverinë e Kosovës dhe Zyrën e Kryeministrit

- Të rritet pjesëmarrja e grave në proceset vendimmarrëse në përputhje me përkufizimin e Ligjit për Barazinë Gjinore për pjesëmarrje të barabartë (50%), për të siguruar që të dëgjohet zëri i grave në reformat digjitale. Me ABGJ, Të inkurajohet dhe jepen udhëzime për të mbështetur përdorimin e masave afirmative në punësim dhe promovim, veçanërisht në vendimmarrje dhe fushat e TI-së, në të gjithë qeverinë dhe administratën publike, duke hedhur poshtë mitet dhe duke adresuar keqkuptimet në lidhje me punësimin e bazuar në merita dhe mënyrën e zbatimit të masave afirmative drejt avancimit të barazisë gjinore si pjesë e punësimit të bazuar në merita.
- Me ABGJ, të jepen udhëzime për të gjitha ministritë dhe komunat se si të përmirësohet angazhimi i ZBGJ-ve në proceset vendimmarrëse që lidhen me digjitalizimin me qëllim të përfshirjes së perspektivës së përgjegjshme gjinore ose transformuese në këto procese. Të përfshihen ZBGJ-të në grupet e punës për ligjet dhe politikat që lidhen me digjitalizimin.
- Të kërkohet trajnim i detyrueshëm për barazinë gjinore, integrimin e perspektivës gjinore, kryerjen e VN(B)GJ-ve, politikëbërjen e përgjegjshme gjinore, planifikimin e programeve, buxhetimin dhe për aftësitë digjitale të përgjegjshme gjinore për të gjithë ministrat e ardhshëm, ZBGJ-të dhe nëpunësit publikë. Të bëhet buxheti adekuat për trajnime të tilla.
- Të sigurohet që ministritë po i bëjnë VN(B)GJ-të për të informuar të gjitha ligjet, politikat, strategjitë, programet dhe infrastrukturën e re, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin. Të krijohen lista të kontrollit të digjitalizuara për të mbështetur rishikimin e përputhshmërisë me vlerësimet e ndikimit rregullator duke përfshirë VN(B)GJ. Mos të procedohen ligjet dhe politikat për miratim pa e rishikuar VN(B)GJ e kërkuar nga ABGJ për sigurimin e cilësisë.

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Statistikat Zyrtare për të kërkuar mbledhjen dhe dorëzimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë në ASK për të gjitha kategoritë. Bazuar në Ligjin për Barazinë Gjinore, të futen kërkesa të qarta ligjore për të gjitha institucionet që të evidentojnë dhe publikojnë rregullisht të dhëna ndërthurëse institucionale online të ndara sipas gjinisë, duke përfshirë shërbimet e ofruara për përfitues të ndryshëm. Të kërkohej nga ASK që t'i ndajë të dhënat edhe me institucionet. Të sqarohet koordinimi digjital në ndarjen e të dhënave duke përdorur mjete digjitale për të lehtësuar ndarjen në kohë dhe efikasë të të dhënave mes institucioneve. Kjo duhet të përfshijë të dhëna në lidhje me digjitalizimin dhe përfituesit e transformimit digjital.
- Të ndryshohet neni 3 i Ligjit për Komunikimet Elektronike, për mosdiskriminimin, për të përfshirë parimin e barazisë gjinore, marrë parasysh nocionin e seksit dhe gjinisë, si dhe nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Të merret parasysh barazia në përdorimin dhe menaxhimin e burimeve. Ky ligj duhet të pasqyrojë LMDHF-në, i cili njeh dhe mbron karakteristikat që ndërlidhen me seksin.
- Të sigurohet përmes ABGJ që të gjitha planet e veprimit të Qeverisë të përfshijnë qëllime, tregues, pikënisje dhe objektiva të qarta për matjen e ndikimeve në barazi gjinore, si dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor të identifikuar qartë tek institucionet përgjegjëse për ndarjet buxhetore. Të sigurohet që buxhetet po planifikohen dhe alokohen si pjesë e proceseve buxhetore afatmesme dhe vjetore.
- Të sigurohet që përsëritjet e ardhshme të SKZH-së, ARE-së, PRE-së dhe PKZMSA-së të bazohen në VN(B)GJ, të përfshihet perspektiva gjinore në fokusin ndaj dallimeve ndërthurëse gjinore në të gjithë sektorët dhe të përfshihen objektivat, masat, treguesit, pikënisjet, objektivat dhe buxhetet të përgjegjshme gjinore që synojnë të adresojnë pabarazitë gjinore, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin.
- Të përfshihen në Planin e Veprimit dhe matricën e monitorimit të Strategjisë për Sigurinë e Kosovës 2022-2027 më qëllime, tregues, baza, objektiva, masa dhe buxhet m[të përgjegjshëm gjinor, duke përfshirë edhe ato në kapitullin për transformimin digjital dhe dhunën kibernetike.
- Të sigurohet që Programi i ri i Statistikave Zyrtare të kërkojë që ministritë dhe institucionet e tjera të mbledhin, analizojnë, publikojnë dhe dorëzojnë rregullisht të dhëna statistikore dhe administrative të ndara sipas gjinisë. Të sigurohet që institucionet përgjegjëse po e zbatojnë këtë kërkesë. Të përfshihen në Program objektivat, treguesit, aktivitetet dhe buxheti drejt avancimit të barazisë gjinore. Të bëhet analiza ex-post e ndikimit gjinor të Programit aktual, duke përfshirë edhe atë që ndërlidhet me prezantimin e CAPI, për të analizuar rezultatet dhe nevojat në lidhje me aspektin gjinor dhe për të informuar programin e ri.
- Të institucionalizohet raportimi vjetor për PRE-të të ngjashme me raportimin aktual vjetor për PRE, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë.
- Të institucionalizohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor si pjesë e proceseve buxhetore shumëvjeçare dhe vjetore për të gjitha ministritë, së bashku me MFPT. Të sigurohet që KASH-et e të gjitha ministrive dhe organizatave të tjera buxhetore të përfshijnë qëllime, tregues, objektiva dhe shpenzime të planifikuara të qarta drejt avancimit të barazisë gjinore. Të gjitha

organizatat buxhetore duhet të publikojnë online analiza gjinore duke informuar shpenzimet e planifikuara buxhetore dhe anekset.

- Të sigurohet që në të gjitha konkurset e vendeve të reja punës dhe e-prokurim në të gjitha ministritë të përdoret gjuha që inkurajon të aplikojnë gratë dhe burrat e ndryshëm. Të inkurajohen të gjitha ministritë që të vendosin masa afirmative për kompanitë që punojnë për avancimin e barazisë gjinore brenda tyre.
- Të vazhdohet sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës të konsultimit publik për të gjitha projektligjet dhe politikat, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin. Të përfshihen ekspertë gjinorë dhe ZBGJ-të në hartimin e politikave të digjitalizimit, duke përfshirë ekspertizën sektoriale, për të kuptuar dhe trajtuar më mirë nevojat e ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve.
- Të nxiten si pjesë të procesit të rishikimit legjislativ kërkesat që raportet periodike zyrtare të monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe strategjive duhet të përfshijnë analizën e ndikimit gjinor ex-post dhe të jenë në dispozicion për publikun, drejt informimit të monitorimit të pavarur të progresit dhe hartimit të ligjeve dhe strategjive të reja të bazuara në dëshmi.
- Të sigurohet që monitorimi dhe raportimi mbi DA dhe proceset e transformimit digjital të përfshijnë analizën gjinore; të përfshihet kjo përgjegjësi në mënyrë eksplicite brenda përgjegjësive të punës të Komisionit për Transformimin Digjital.
- Të përmirësohen mekanizmat mbrojtës si pjesë e procesit të digjitalizimit, duke u mbështetur nga gjetjet nga analiza e rekomanduar gjinore drejt sigurimit të një mjedisi të sigurt online për gra, burra, vajza dhe djem. Të kërkohen dhe të ndërmerren vlerësime të rrezikut të përgjegjshëm gjinor me konsultime me palët e interesuara.
- Të institucionalizohet dhe funksionalizohet përdorimi i nënshkrimit digjital. Të sigurohet që aktorët që e përdorin atë, duke përfshirë bizneset në pronësi të grave dhe burrave, të kenë ndërgjegjësimin e duhur digjital në lidhje me përfitimet nga ai.

Për Agjencinë e Statistikave të Kosovës në Zyrën e Kryeministrit

- Të publikohen rregullisht të dhëna të ndara sipas gjinisë sipas përkatësisë etnike, moshës, vendndodhjes rurale/urbane dhe aftësisë së kufizuar për të gjithë sektorët. Të sigurohen këto të dhëna në faqen e internetit të ASK-së, duke mundësuar që analiza gjinore të informojë politikëbërjen më të bazuar në dëshmi.

Për Ministrinë e Punëve të Brendshme

- Të monitorohet dhe sigurohet zbatimi në kohë i zotimeve për blerjen e infrastrukturës për mbikëqyrje elektronike, drejt zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Kjo do të kontribuojë dukshëm në mbrojtjen e grave që kanë përjetuar dhunë me bazë gjinore.
- Të specifikohen përgjegjësitë e njësive të PK-së lidhur me krimin kibernetik. Të organizohen trajnimet e përbashkëta për zyrtarët e PK-së të specializuar në sigurinë kibernetike dhe ata të specializuar në fushën e dhunës me bazë gjinore, duke inkurajuar dhe lehtësuar bashkëpunimin

ndërmjet këtyre njësive në trajtimin e rasteve të krimit kibernetik me bazë gjinore, duke marrë nga dhe mbështetur në ekspertizën e tyre përkatëse.

- Të miratohet legjislacioni dytësor që specifikon mekanizmat koordinues dhe organet përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në internet kafe dhe klube për video lojëra, duke përfshirë masa specifike kundër përmbajtjes pornografike, ndëshkimin e abuzuesve të fëmijëve në internet, reduktimin e qasjes së fëmijëve në materiale të pashëndetshme dhe kërcënuese për jetën dhe asistimin e fëmijëve në rrezik nga çdo formë e dhunës në internet, siç parashihet në Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve. Të sigurohet që akti nënligjor përfshin përkufizime të qarta të dhunës kibernetike me bazë gjinore.
- Të sigurohet që në Strategjinë e Sigurisë Kibernetike të kërkohet që doracaku për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike të jetë i përgjegjshëm gjinor, si p.sh. asistimi i rasteve të dhunës kibernetike me bazë gjinore. Platforma e planifikuar e sigurisë kibernetike duhet të mbledhë të dhëna të ndara sipas gjinisë të personave që e përdorin atë, të sigurojë konfidencialitet, të mbrojë standardet etike, të mbrojë të dhënat dhe të sigurojë një ndërfaqe miqësore për përdoruesit, duke përfshirë mekanizmat e referimit përmes të cilave përdoruesit mund të parashirojnë ankesa. Fushata e planifikuar e ndërgjegjësimit duhet të ketë si synim transformimin e normave gjinore përmes mesazheve dhe imazheve, si dhe të ketë fokusin në dhunën kibernetike me bazë gjinore. Duhet të përfshihen alokime të qarta dhe adekuate buxhetore. Treguesi dhe objektivat për bursat e studentëve në STEM duhet të jenë të ndara sipas gjinisë. Të sigurohen burime adekuate dhe qasje e institucionalizuar për përfshirjen e edukimit për sigurinë kibernetike në kurrikulat e përhershme se sa iniciativat ad-hoc të financuara pamjaftueshëm. Strategjia mund të ketë qëllime, tregues, pikënisje, objektiva dhe ndarje buxhetore më të përgjegjshme gjinore, duke identifikuar institucionet përgjegjëse.

Për Departamentin për Reformën e Administratës Publike

- Të bëhet auditimi gjinor të praktikave të punësimit, promovimit dhe shkarkimit për të kuptuar më mirë arsyet pse gratë dhe burrat nuk punësohen dhe nuk promovohen në pozita vendimmarrëse në mënyrë të barabartë sipas Ligjit për Barazinë Gjinore. Bazuar në këtë, të rishikohet dhe ndryshohet HRMIS nga perspektiva gjinore, duke përfshirë analizën gjinore e trendeve në menaxhimin e burimeve njerëzore; mbështetjen e aplikimit të masave afirmative në menaxhimin e burimeve njerëzore drejt pjesëmarrjes së barabartë të grave në shërbimin civil në të gjitha nivelet; dhe informimi i politikave dhe programeve që mund të përmirësojnë barazinë gjinore në administratën publike. Të sigurohet që çdo softuer i digjitalizuar në të ardhmen për punësimin dhe promovimin e burimeve njerëzore merr parasysh dhe adreson paragjykimet ekzistuese gjinore që mund të ndikojnë në algoritme, duke kontribuar kështu në pabarazitë e vazhdueshme.
- Të sqarohet se cila njësi organizative është përgjegjëse për procedurat e përgjithshme administrative, politikën më të gjerë të ofrimit të shërbimeve, monitorimin dhe vlerësimin në lidhje me RAP. Të sigurohet që të ketë përgjegjësi të qarta për politikëbërjen, monitorimin dhe vlerësimin e përgjegjshëm gjinor.

- Të përkufizohet më tej Udhëzimi për Menaxhimin dhe Përdorimin e Internetit në Institucionet e Kosovës për të rregulluar mbrojtjen e të dhënave, standardet etike, privatësinë dhe sigurinë kibernetike për nëpunësit publikë; të vendosen sanksionet; të krijohen subjekte dhe mekanizma të qarta për raportimin e shkeljeve; të krijohen mekanizma për menaxhim të sigurt elektronik të të dhënave të rasteve dhe raportim statistikor; dhe të sigurohet që të gjitha këto të jenë të përgjegjshme gjinore.
- Të ndryshohet Rregullorja për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil për të përfshirë mekanizmin mbrojtës të përmirësuar dhe procedurat disiplinore për shkeljet e të drejtave që ndërliken me aspektin gjinor e që ndodhin nëpërmjet mjeteve digjitale.
- Të rishikohet Udhëzimi Administrativ për Menaxhimin dhe Përdorimin e Internetit në Institucionet e Kosovës për të rregulluar qartë mbrojtjen e të dhënave, standardet etike, privatësinë dhe sigurinë kibernetike për nëpunësit publikë gjatë përdorimit të internetit, duke marrë parasysh çështjet që ndërliken me aspektin gjinor. Të përfshihen sanksione për zyrtarët që nuk respektojnë kufizimet. Të regjistrohen/listohen entitete dhe mekanizma përgjegjës për raportimin e keqpërdorimit të internetit. Të sigurohet që ekzistojnë mekanizma të qartë monitorimi ose zbatimi, duke përfshirë sistemet digjitale për përcjelljen/gjetjen e raporteve sipas gjinisë.
- Të bëhet vlerësimi ex-post i ndikimit gjinor të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike dhe ta përdorë atë për të informuar Planin e Veprimit për PARS-in e ri, të cilit i mungon fokusi ndaj pabarazive gjinore në disa reforma të planifikuara në lidhje me shërbimet publike digjitale.
- Të përfshihet në PRAB kërkesa që vlerësimet ex-ante të përfshijnë VN(B) GJ. Digjitalizimi i kësaj kërkesë si pjesë e sistemit PRAB mund të ndihmojë në institucionalizimin e analizave gjinore dhe planifikimit të programeve dhe reformave digjitale më të përgjegjshme gjinore.
- Të përfshihen tregues që lidhen me barazinë gjinore në krijimin e regjistrit qendror online të planifikuar të shërbimeve administrative për të lehtësuar analizën gjinore në monitorim dhe vlerësim, gjë që mund të informojë planifikimin e ardhshëm.
- Të kërkohet nga të gjithë nëpunësit publikë që t'i nënshtrohen trajnimeve bazë të detyrueshme për barazinë gjinore, ngacmimin dhe abuzimin seksual në vendin e punës dhe politikëbërjen, planifikimin e programeve, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përgjegjshëm gjinor, duke përdorur kurrikulat ekzistuese të IKAP-it. Zyrtarët mund ta përdorin këtë njohuri bazë në politikëbërjen për digjitalizimin. Të ofrohen trajnime të detyrueshme në aftësitë bazë digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë në internet, e-prokurimin të përgjegjshëm gjinor dhe adresimin e kërcënimeve në internet. Të alokohen mjete për këto trajnime.
- Të punohet ngushtë me ASHI për të zgjeruar disponueshmërinë dhe qasjen në shërbime publike online miqësore për përdoruesit, duke siguruar që gratë dhe burrat me nivele më të ulëta arsimore dhe aftësi të kufizuara të kenë qasje. Të sigurohet disponueshmëria e këtyre në gjuhët zyrtare. Të përcillen të dhënat e ndara sipas gjinisë mbi përdorimin, duke mundësuar analizën gjinore që mund të lehtësojë përditësimet për të përmbushur

nevojat e grave dhe burrave. Të harmonizohen përditësimet e ASHI me platformën eKosova, drejt arritjes së ndërveprueshmërisë.

- Të nisen fushata televizive dhe në media sociale që reklamojnë shërbime të reja publike online, si t'i përdorin ato dhe se si ato do ta bëjnë jetën e qytetarëve më të lehtë dhe detyrat e tyre më efikase sesa komunikimi ballë për ballë. Të synohen komunikimet me nevojat për informata nga gratë, burrat, vajzat dhe djemtë dhe të përdoren imazhe transformuese gjinore.
- Të ndahet buxheti për krijimin e qendrave të informacionit me kompjuterë falas, të sigurt dhe të qasshëm nga publiku në komuna, si në biblioteka dhe zyra publike, për të lehtësuar qasjen në shërbimet publike online. Të trajnohet stafi për të ndihmuar gra dhe burra të ndryshëm në përdorimin e softuerit online për t'u qasur në shërbimet publike. OShC-të ose bizneset e kualifikuara mund të kontraktohen për të ofruar këto shërbime, duke përfshirë kontaktin derë më derë për të mbështetur përdorimin e shërbimeve publike digjitale
- Të sigurohet që çdo vlerësim i Kornizës Strategjike të Kosovës për Reformën e Administratës Publike dhe strategjive të ndërlidhura përfshin vlerësimin ex-post të ndikimit gjinor për të parë nëse dhe si këto kanë ndikuar në barazinë gjinore duke përfshirë digjitalizimin, veçanërisht duke pasur parasysh vëmendjen e pamjaftueshme ndaj barazisë gjinore në strategji, objektivat dhe treguesit.

Për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit

- Të evidentohen të dhënat e ndara sipas gjinisë për përdoruesit e shërbimeve, bazuar në Ligjin për Barazinë Gjinore. Të përcillen, monitorohen dhe publikohen të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me platformën eKosova, si dhe të përdoren për të bërë analizën e ndikimit gjinor. Ky informacion mund të informojë më shumë fushata informimi dhe ndërhyrje të politikave për të siguruar që më shumë njerëz të kenë qasje në shërbimet online të përgjegjshme gjinore.
- Të lansohen fushata ndërgjegjësimi për platformën eKosova, shërbimet në dispozicion dhe mënyrën e qasjes në to, duke synuar komunikimin me gra dhe burra të ndryshëm, të moshave të ndryshme, në zonat rurale, me zotësi të kufizuar të shkrim-leximit dhe me aftësi të kufizuara. Të përdoren të dhëna për gjininë, moshën, vendndodhjen gjeografike, gjuhën dhe aftësinë e përdoruesve për të përmirësuar ndërgjegjësimin e qytetarëve në lidhje me shërbimet e platformës, duke përdorur qasjen ndërthurëse të përgjegjshme gjinore.
- Të sigurohet që infrastruktura harduerike dhe softuerike të ofrojë mbrojtje adekuate për sa i përket privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave, duke marrë parasysh në mënyrë adekuate nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm.

Për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, duke përfshirë Agjencinë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

- Të bëhet vlerësimi ex-post të ndikimit gjinor të Agjendës Digjitale për Kosovën 2013-2020 për të informuar planin e ri të veprimtimit të DPA-së, duke e rishikuar atë për të vendosur qëllime, indikatorë, pikënisje, objektiva, aktivitete dhe buxhet më të qartë, të përgjegjshëm gjinor. Të sigurohet që

secila DA e ardhshme të bazohet në VN(B)GJ, të përqendrojë vëmendjen ndaj barazisë gjinore, përpiqet të transformojë normat gjinore në lidhje me digitalizimin në përputhje me zotime e BE-së dhe Kosovës dhe të jetë e harmonizuar me kërkesat më të fundit të anëtarësimit në BE që lidhen me barazinë gjinore, Ligjit për Barazi Gjinore dhe PKBGJ.

- Të bëhen VN(B)GJ-të për të informuar ligjet dhe politikat e planifikuara për t'u miratuar në vitin 2023, sipas PRE 2023-2025: Programit të Politikave Tregtare; Kodit Doganor dhe i Akcizës; Ligjit për Tregtinë e Brendshme; Ligjit për Tregtinë e Jashtme; Ligjit për Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve; Rregullores për Themelimin e Qendrës Informative për Lehtësira Tregtare; Strategjisë për Zhvillimin Industrial dhe Mbështetje të Biznesit; dhe Ligjit për tregtinë elektronike. Të angazhohet ZBGJ dhe OSHCG-të e informuara në grupe punuese.
- Të mbështeten NMVM-të -të e udhëhequra nga gratë në zhvillimin e produkteve, marketingun digjital dhe rrjetëzimin digjital me shitësit globalë (online), si shitësit e produkteve të bëra nga gratë, duke krijuar një treg më të mirë për produktet e tyre dhe duke mbështetur gratë e cenueshme përmes ofrimit të mundësive të punës nga shtëpia në përputhje me aftësitë dhe mjediset sociale.
- Të përshtaten shpalljet për subvencionet që mbështesin planet e biznesit të sipërmarrësve të rinj dhe digitalizimin për të ofruar masa afirmative për gratë, personat nga grupet e pakicave etnike, gratë nga vendet rurale dhe personat me aftësi të kufizuara. Të rritet ndërgjegjësimi për masat afirmative, të cilat mund të inkurajojnë që më shumë gra të aplikojnë. Të ketë bashkëpunim me OShCG-të, veçanërisht ato që fokusohen në fuqizimin ekonomik të grave, për të përcjellë më mirë informacionin rreth subvencioneve në mënyrë që ai të arrijë tek gratë e ndryshme.
- Të ngritën më tej kapacitetet e KIESA-s për të hartuar programe të përgjegjshme gjinore për digjitalizimin e bizneseve, të cilat përfshijnë masa afirmative sipas Ligjit për Barazinë Gjinore, të tilla si përmirësimi i shtrirjes që synon gratë me informacion rreth mundësive dhe dizajnit të subvencioneve për blerjen e pajisjeve digjitale me kriteret e që synojnë gratë.
- Të ngritën më tej kapacitetet njerëzore dhe teknike të bizneseve me shërbime të shumta (one-stop shops) dhe shërbimeve të biznesit, për të ofruar masa afirmative për të inkurajuar gjininë e nënpërfaqësuar, sipas Ligjit për Barazinë Gjinore dhe objektivit të PKZMSA.
- Të publikohen të dhënat të ndara sipas gjinisë për të gjithë treguesit e raportuar nga ARBK si dhe të dhënat e tjera demografike. Sa për transparencë, të përfshihen në publikimet tremujore informata mbi subvencionet e shpërndara për gra dhe burra të ndryshëm. Të përmirësohet bashkëpunimi dhe ndërveprueshmëria e sistemeve me ATK-në dhe MPB-në për të ofruar informata më të sakta për bizneset.
- Të publikohen online të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit, përfshirë KIESA-n dhe përfituesit e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë, duke përfshirë shumatat e dhëna. Të përfshihen të dhëna të ndara sipas gjinisë sipas përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane dhe personave me aftësi të kufizuara, duke mundësuar kështu analizën gjinore në kohë reale.

- Të bëhet analiza ex-post e ndikimit gjinor të mbështetjes nga KIESA dhe Fondi Kosovar për Garançi Kreditore për të vlerësuar deri në çfarë mase kanë përfituar gra dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë edhe nga mbështetja për transformimin digjital. Të përdoret kjo për të informuar planifikimin e programeve më të targetuar në të ardhmen. Të bëhet analiza publike online.
- Të inkurajohen dhe të mbështeten bizneset në zgjerimin e disponueshmërisë së opsioneve të pagesave të drejtpërdrejta, të cilat mund të lehtësojnë biznesin, të rrisin llogaridhënien, të ulin korrupsionin dhe të ulin punën joformale.
- Të sigurohet që zhvillimi i infrastrukturës digjitale të mëtejshme për bizneset dhe tregtinë të bazohet në analizën gjinore që nga faza e projektimit, duke siguruar që infrastruktura digjitale e përshtatshme për përdoruesit dhe e përgjegjshme gjinore të jetë në dispozicion për gra dhe burra të ndryshëm.
- Të vazhdohet me organizimin e trajnimeve për të ngritur kapacitetet e biznesit në aftësitë digjitale, duke siguruar qasje në informacion rreth tyre dhe pjesëmarrje për gra dhe burra të ndryshëm.
- Të përdoret eKosova për të lidhur profilet e përdoruesve për bizneset e regjistruara në ARBK, në mënyrë që të dhënat e ndara sipas gjinisë të lidhura me profilet personale në e-Kosova të mund të përdoren për të monitoruar përdorimin e shërbimeve online të regjistrimit të bizneseve dhe për të ofruar në kohë reale të dhëna të ndara sipas gjinisë online me statistika mbi përdorimin dhe mbi bizneset në pronësi të grave dhe burrave.

Për Ministrinë e Drejtësisë

- Të ndiqen nga afër zhvillimet në BE në lidhje me krimin kibernetik me bazë gjinore dhe dhunën kibernetike, veçanërisht Direktiva e propozuar për luftimin e dhunës me bazë gjinore. Të merren parasysh në mënyrë proaktive këto forma të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës ndaj grave në kornizën ligjore të Kosovës, duke përfshirë Kodin Penal, ndryshimet e ardhshme të PSV-ve për trajtimin e dhunës me bazë gjinore dhe legjislacionin tjetër parësor dhe dytësor që lidhet me dhunën me bazë gjinore. Të sigurohet që gra dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë ekspertë të OShCG për barazinë gjinore, të angazhohen në përkufizimin e krimit kibernetik bazuar në përvojat e jetuara. Të përcaktohet dhe rregullohet qartë krimi kibernetik në Kodin Penal nga perspektiva gjinore, duke përfshirë lloje të ndryshme të krimit kibernetik si dhuna seksuale e bazuar në imazhe, ngacmimet seksuale në internet, ngacmimet kibernetike dhe shantazh seksual (nga anglishtja: sextortion).
- Të sigurohet që çdo Ligj i ardhshëm për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik të jetë i informuar nga një VN(B)GJ dhe të ketë fokus në mënyrat specifike se si krimi kibernetik dhe dhuna kibernetike mund të prekin gratë, burrat, vajzat, djemtë dhe personat LGBTIQ+. Të ndryshohet Ligji për të përfshirë një nen specifik që përcakton dhe rregullon dhunën kibernetike ndaj grave dhe personave LGBTIQ+ në përputhje me kërkesat e LMDhP, RrPMDh të BE-së dhe Konventës së Stambollit për një qasje të përqendruar te viktima. Të ndryshohet nenit 5 për fushatat e parandalimit, sigurisë dhe informimit për të specifikuar se cilat institucione janë

përgjegjëse për marrjen e masave specifike për parandalimin e krimit kibernetik, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit që synon gra dhe burra të ndryshëm.. Të përafrohet ky ligj me Kodin Penal, duke siguruar që Kodi të ketë përkufizime specifike për krimin kibernetik, duke u bazuar në VN(B)GJ.

- Të ndryshohet LMDhP në përputhje me RrPMDh për të ofruar mbrojtje më të qartë të të dhënave, përfshirë përcaktimin më të qartë të gjinisë, seksit dhe pëlqimit, veçanërisht në kuptimin e “mbrojtjes së të dhënave të ndjeshme” dhe “mbrojtjes së kategorive të veçanta” të të dhënave personale (neni 8)
- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve për të mbrojtur të dhënat personale të sinjalizuesve të grave dhe burrave, të qartësohen mekanizmat për mbrojtjen e tyre dhe të përcaktohen më mirë pasojat përkatëse gjinore.
- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre për të ripërcaktuar dhe zgjatur periudhën e luftës, duke siguruar qasje gjithëpërfshirëse në beneficione për të gjithë qytetarët e Kosovës të prekur; për të përmirësuar digjitalizimin e sigurt të regjistrave të përgjegjshme gjinore; dhe për të siguruar publikimin në kohë dhe transparent të statistikave përmbledhëse online.
- Të sigurohet që në PSV-të janë të vendosura përgjegjësi të qarta për të gjitha institucionet për menaxhim të sigurt të digjitalizuar të rasteve përmes sistemit të menaxhimit të rasteve të Ministrisë, si dhe për mbledhjen, evidentimin dhe raportimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë përmes Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL). Të përmirësohet i bazës së të dhënave ndërinstitucionale për menaxhimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në përputhje me rishikimet ligjore. Të përmirësohet ndërveprueshmëria e tij në mënyrë që rastet të menaxhohen më mirë nëpër institucione dhe komuna. Të sigurohen masa paraprake adekuate në mbrojtjen e të dhënave dhe dhënien e pëlqimit për ndarjen e të dhënave. Të ofrohen të dhëna përmbledhëse në kohë reale në mënyra miqësore vizuale, drejt arritjes së transparencës, duke mundësuar analizën gjinore, monitorimin dhe vlerësimin e performancës së institucioneve të sundimit të ligjit.
- Të merret parasysh përshtatja dhe miratimi i Protokollit të RrGK-së dhe strehimoreve për tele-këshillim për personat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore, duke përmirësuar kështu qasjen në shërbimet e këshillimit psikologjik për personat e izoluar, përmirësuar mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjen e privatësisë dhe mbrojtje të tjera të ofruara nga ky protokoll i zhvilluar në mënyrë profesionale.
- Të identifikohet qartë në strategjitë dhe planet e ardhshme të veprimit për sundimin e ligjit dhe dhunën me bazë gjinore se cili institucion është përgjegjës për buxhetimin dhe zbatimin e iniciativave. Të përdoret buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, duke treguar se si do të përdoren fondet për të mbështetur gratë, burrat, vajzat, djemtë dhe barazia gjinore. Të përfshihen objektiva më të qarta drejt përmirësimit të koordinimit institucional, kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës dhe ndërgjegjësimit për dhunën kibernetike me bazë gjinore.

- Të sigurohet që personeli të jetë i trajnuar për përdorimin e videove në intervista dhe në sallat e gjyqit në përputhje me Konventën e Stambollit, me qëllim të reduktimit të (ri)traumatizimit midis të mbijetuarve/ave të dhunës me bazë gjinore. Të sigurohet që mekanizmat koordinues, policia, prokuroria, MV-të, punëtorët socialë dhe gjykatat të koordinohen për të minimizuar numrin e marrjes së dëshmimeve duke përdorur video incizimin. Të ndahet buxheti në mënyrë adekuate për infrastrukturën e incizimit.
- Të bëhet vlerësimi i nevojave për të kuptuar nevojat e mekanizmave koordinues komunal në adresimin e dhunës me bazë gjinore lidhur me aftësitë e tyre digjitale, të kuptuarit e dhunës kibernetike me bazë gjinore dhe mënyrat për të përmirësuar koordinimin digjital me institucionet e tjera të nivelit komunal dhe qendror në trajtimin e rasteve. Të përdoret kjo për të informuar trajnimin e mëtejshëm
- Të vihet në dispozicion ndihma juridike falas për personat, të drejtat e të cilëve shkelen nga krimi kibernetik dhe IA. Të bëhet fushata për të rritur ndërgjegjësimin në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave nga IA, dhuna kibernetike, ngacmimet kibernetike dhe çfarë sjellin këto, duke arritur tek gratë dhe burrat e ndryshëm.
- Të sigurohet që reformat ligjore në lidhje me shërbimet sociale të përfshijnë dispozita për këshillim, këshillim ligjor, infrastrukturë të disponueshme në QPS dhe ngritje të aftësive digjitale dhe të tjera të punëtorëve socialë.
- Të ngriten kapacitetet e punëtorëve socialë për të ofruar këshillim, këshilla ligjore dhe burime për të ndihmuar gra dhe burra të ndryshëm që kanë përjetuar dhunë kibernetike për të naviguar sfidat ligjore, emocionale dhe praktike që vijnë nga abuzimi në internet dhe dhuna kibernetike me bazë gjinore.
- Të merret parasysh integrimin në eKosova aplikacionet për status si persona në nevojë për ndihmë personale, si dhe aplikacionet për t'u kualifikuar për të shërbyer si asistent personal pasi të përcaktohen kërkesat e kualifikimit në legjislacionin dytësor.
- Të vihen në dispozicion aplikacionet online për individët, OJQ-të dhe ofruesit privatë për të aplikuar për licenca për ofrimin e shërbimeve.

Për Agjencinë dhe Zyrat për Ndihmë Juridike Falas

- Të trajnohen zyrtarët e Ndihmës Juridike Falas për të përmirësuar të kuptuarit e tyre të IA-s, rreziqet e saj për gra dhe burra të ndryshëm dhe si të mbrohen njerëzit në raste të tilla. Të kërkohet përfundimi i suksesshëm i trajnimit për trajtimin e krimit kibernetik me bazë gjinore dhe dhunës kibernetike.
- Të digjitalizohen të dhënat e menaxhimit të rasteve, duke përfshirë edhe ato gjinore dhe të dhëna të tjera socio-ekonomike dhe demografike. Të përmirësohet mbledhja dhe evidentimi i të dhënave për krimin kibernetik dhe personat me aftësi të kufizuara

Për Institutin e Mjekësisë Ligjore

- Të përmirësohen bazat e të dhënave elektronike për të përcjellë/gjetur informacionin kryesor demografik, duke përfshirë gjininë e viktimave dhe kryesit të dyshuar të veprës.

- Të sigurohet mbështetje e sigurt financiare për avancimin e teknologjisë aktuale, duke mundësuar ruajtjen e të dhënave rezervë në një vendndodhje shtesë të sigurt jashtë objektit.

Për Ministrinë e Mbrojtjes

- Të përdoren masa afirmative për të punësuar dhe promovuar më shumë gra brenda Ministrisë dhe FSK-së.
- Të informohet zhvillimi i sistemeve të digjitalizuara të paralajmërimit të hershëm me analiza gjinore ex-ante, duke identifikuar masat e përgjegjshme gjinore të nevojshme si pjesë e zgjidhjeve të tilla digjitale për të parandaluar, mbrojtur dhe për t'iu përgjigjur konfliktit, në përputhje me Agjendën për Gra, Paqe dhe Siguri.
- Të sigurohet që trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve në lidhje me sigurinë kibernetike të kenë përmbajtje të përgjegjshme gjinore dhe përpiqet të rris numrin e grave që marrin pjesë.

Për Agjencinë kundër Korrupsionit

- Të publikohen të dhëna të ndara sipas gjinisë në raportet vjetore, duke mundësuar analizën gjinore se deri në çfarë mase zyrtarët dhe zyrtaret janë transparentë ose të përfshirë në korrupsion.
- Të ofrohen informacione që synojnë gra dhe burra të ndryshëm për mënyrën e raportimit të korrupsionit, duke i vënë në dispozicion videot e përgjegjshme gjinore në mediat sociale dhe në faqen e internetit të AKK-së.

Për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve

- Të sigurohet që Ligji për Financat Publike dhe Strategjia e ardhshme e Reformës për Menaxhimin e Financave Publike të bazohen në treguesit e OZHQ 5c1 dhe PEFA GRPFM për praktikën më të mira në buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, duke përfshirë ata në sistemet e menaxhimit të financave publike të digjitalizuara drejt Institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në të gjitha institucionet. Të sigurohet që Strategjia e re të përfshijë objektiva, tregues, veprime dhe buxhet të qartë drejt institucionalizimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore; ai duhet të bazohet në VN(B)GJ, duke përfshirë mësimet e nxjerra nga vlerësimi ex-post i ndikimit gjinor të Strategjisë 2016-2020. Të konsultohen OShCG-të me ekspertizë buxhetore të përgjegjshme gjinore, si RrGK, për të mbështetur procesin e hartimit.
- Të sigurohet që Ligji i ri për Financat e Qeverisjes Lokale është i informuar nga VN(B)GJ, kërkon konsultime publike që angazhojnë gra dhe burra të ndryshëm në përzgjedhjen e prioriteteve për financimin komunal, kërkon buxhetim të digjitalizuar të përgjegjshëm gjinor në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, dhe përfshin analizën gjinore në formulën e financimit të digjitalizuar në llogaritjen e nivelit të nevojave të komunave. Të konsultohen OShCG për të mbështetur procesin e hartimit.
- Të përmirësohen dhe specifikohen më tej masat në Ligjin për Prokurimin Publik për prokurimet e digjitalizuara të përgjegjshme gjinore dhe të përfshihen kërkesat për mbledhjen, përcjelljen dhe publikimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë.
- Të sigurohet që Ligji i Punës është i harmonizuar me Direktivën e BE-së për Balancimin e Punës dhe Jetës, duke përfshirë nenet që rregullojnë

punën fleksibël; vetëpunësimin; të drejtat e pushimit të lehonisë, të atësisë dhe atë prindëror; dhe pushimin e kujdestarëve. Të përafrohet ligji me Direktivën e propozuar të BE-së për përmirësimin e kushteve të punës në platformën e punës dhe Direktivën për trajtimin e barabartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar. Të bëhet i detyrueshëm menaxhimi i digjitalizuar i të dhënave dhe programeve, të ndara sipas gjinisë.

- Të sigurohet që Ligji i ri për Skemat e Ndihmës Sociale të bazohet në VN(B) GJ, duke marrë parasysh se si algoritmet SAS dhe IA mund të përfshijnë paragjykime gjinore si dhe duke parandaluar diskriminimin me bazë gjinore. Të merret parasysh përfshirja e viktimave të dhunës me bazë gjinore në përkufizimin e personave “të varur” për një periudhë derisa ata të bëhen financiarisht të qëndrueshëm dhe autonomë. Ligji duhet të kërkojë evidentimin, publikimin transparent dhe raportimin e rregullt të të dhënave në internet të ndara sipas gjinisë dhe informacioneve të tjera demografike (p.sh., përkatësia etnike, mosha, aftësia e kufizuar, vendndodhja) sipas Ligjit për Barazinë Gjinore.
- Të kërkohet dhe të monitorohet më mirë zbatimi i Ligjit për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara në sektorin privat dhe publik, duke përfshirë punën e TIK-ut, që mund të lehtësojë punësimin e personave me aftësi të kufizuara.
- Të përfshihen në programet e reja të SKZH-së për të lehtësuar qasjen e grave dhe vajzave në aftësitë digjitale, programet e AAP-së dhe punësimin duke përdorur këto aftësi, përfshirë, por pa u kufizuar në, sektorin e TIK-ut.
- Të përmirësohet ndërveprueshmëria e softuerit dhe sistemeve digjitale, duke mundësuar raportim automatik dhe të rregullt për punën, trajnimin, ndihmën sociale dhe programet e Qeverisë për ASK-në, të ndara sipas gjinisë dhe faktorëve të tjerë demografikë të mundshëm ndërthurës si mosha, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar dhe vendndodhja rurale/urbane, të cilat mund të kursejnë kohë dhe burime njerëzore teksa përmirëson saktësinë.

Për Departamentin e Fuqisë Punëtore

- Të përmirësohet sistemi i QAP-ve dhe Zyrës për Punësim për menaxhimin e burimeve njerëzore, duke evidentuar të dhëna dhe monitoruar kapacitetet e zyrtarëve, përfshirë trajnimin e ndjekur, kohën dhe certifikatat e marra, të gjitha të ndara sipas gjinisë. Të bëhet vlerësimi i nevojave për aftësi digjitale dhe të ofrohen trajnime dhe kualifikime të detyrueshme për stafin e APRK-së, QAP-it, Zyrës së Punësimit dhe Inspektoratit të Punës bazuar në gjetjet.
- Të monitorohen platformat e punës, përfshirë Portali i Punës i Kosovës dhe Superpuna, nga perspektiva gjinore për t’u siguruar që nuk ka paragjykime të paqëllimshme gjinore për shkak të algoritmeve dhe gjuhës.

APRK

Në bashkëpunim të ngushtë me MFPT-në:

- Të digjitalizohen më tej shërbimet e punësimit dhe përcillen të dhënat për përfitues të ndryshëm gra dhe burra. Të zhvillohen ndërfaqe miqësore për përdoruesit për shfaqjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë në internet, duke përfshirë ato për SMIA, Portalin e Punës dhe Superpuna, ndër të tjera.

Të vihet në dispozicion për publikun informacioni përmbledhës i ndarë sipas gjinisë mbi punën, punësimin dhe përfituesit e programit të qeverisë.

- Të bëhet lidhja më e mirë e nevojave e tregut të punës dhe masave e marra me zhvillimin e infrastrukturës së TIK-ut, duke përdorur tregues dhe objektiva të qartë e të matshëm për të adresuar më mirë se si masat do të ndikojnë tek gratë, vajzat, burrat dhe djemtë me qasje ndërthurëse.
- Të përshtaten programet dhe trajnimet e AAP-së në strategjitë e reja dhe dokumentet e anëtarësimit në BE (p.sh., PKZMSA, ARE, PRE) për nevojat e grave, duke rritur njohuritë e grave në TIK. Për shembull, të merret parasysh ofrimi kujdesit falas për fëmijët për gratë që ndjekin kurse që do t'u mundësojnë atyre të zhvillojnë aftësi digjitale për kryerjen e punës online nga shtëpia.
- Të vazhdohet me aplikimin e masave afirmative përmes softuerit për punësim, duke u dhënë përparësi grave të kualifikuara për mundësi punësimi, duke përfshirë edhe sektorin e TIK-ut. Të merret parasysh përdorimi i masave të tjera afirmative për të inkurajuar punëdhënësit që të punësojnë gra, të tilla si shtimi i subvencioneve për pagat për gratë e reja.
- Të përmirësohet Barometri i Fuqisë Punëtore i Kosovës, i menaxhuar nga APRK për të përfshirë statistikën e ndara sipas gjinisë në lidhje me regjistrimin e bizneseve dhe të dhënat e arsimit.
- Të pilotohet një program për të mbështetur zhvillimin e aftësive digjitale midis grave dhe burrave me aftësi të kufizuara, duke i pajisur ata për të punuar nga shtëpia, në koordinim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë.
- Të merren parasysh partneriteti me kompanitë e teknologjisë për të dizajnuar programe të zotësisë digjitale që përfshijnë aspektin gjinor.

Për Inspektoratin e Punës

- Të bëhet analiza ex-post e ndikimit gjinor e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin e Punës.
- Të analizohen aftësitë digjitale të inspektorëve të punës për të informuar nevojat e ardhshme për zhvillimin e kapaciteteve, duke përfshirë ato për digjitalizimin e të dhënave dhe shërbimeve të përgjegjshme gjinore.

Për Departamentin e Skemave Sociale

- Të integrohet analiza gjinore në vlerësimin e planifikuar të aftësive, njohurive dhe nevojave digjitale të punëtorëve socialë, duke përfshirë ato për menaxhimin e rasteve digjitale, mbrojtjen e të dhënave personale të përfituesve dhe menaxhimin e të dhënave, ndarjen e të dhënave sipas gjinisë, përkatësisë etnike, moshës, zonës gjeografike dhe aftësisë. Të vlerësohen kapacitetet e punëtorëve socialë për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi i mundshëm në internet dhe të dizajnohen trajnime të përshtatura për të përmirësuar aftësitë e tyre.
- Të bëhet analiza gjinore e moshës se si familjet përdorin SAS dhe se si gratë, burrat, vajzat dhe djemtë e ndryshëm brenda familjeve përfitojnë prej tij, duke përfshirë shkallën në të cilën ai përdoret për të përmbushur nevojat e tyre të ndryshme. Kjo mund të informojë ridizajnimin e planifikuar të PMT-së, përmirësimet në marrjen në konsideratë të aspektit gjinor tek treguesit bazuar në një analizë gjinore të varfërisë, programeve kompjuterike dhe çdo vendimmarrjeje të ardhshme të informuar nga IA për përfituesit. Të digjitalizohen proceset e aplikimit për të përshpejtuar

periudhën e aplikimit drejt mundësimit të punës afatshkurtër, adresimit të informalitetit dhe rritjes së të ardhurave tatimore.

- Të sigurohet që kriteret, treguesit dhe algoritmet e përdorura në zhvillimin e IA dhe zgjidhjeve të tjera digjitale drejt ofrimit të përmirësuar të ndihmës dhe shërbimeve sociale janë të bazuara në analizën e ndikimit gjinor ex-ante, në mënyrë që ato të marrin në konsideratë në mënyrë adekuate nevojat e grave të ndryshme dhe të mos diskriminojnë. burra, vajza dhe djem.
- Të krijohet udhëzimi administrativ ose protokollin që detajon proceset e punës nga mbledhja e të dhënave deri te raportimi, duke përfshirë të dhënat dhe analizat e ndara sipas gjinisë. Të ketë bashkëpunim me ASK-në, komunat dhe QPS-të për të përmirësuar ndërveprimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave duke mundësuar kështu raportimin automatik të të dhënave në ASK, të ndara sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes rurale/urbane dhe kategorive të tjera sociale dhe demografike. Të përdoren këto të dhëna për të informuar politikëbërjen e përgjegjshme gjinore.
- Të sigurohen kompjuterë me qasje publike në qendrat digjitale në komuna (p.sh. në QPS, shkolla dhe biblioteka), pa pagesë, ku personat e cenueshëm pa qasje në pajisje mund të përdorin shërbimet digjitale publike që lidhen me ndihmën dhe shërbimet sociale. Të sigurohet që stafi të jetë në dispozicion për të ndihmuar. Të vazhdohet të vizitohen grupet e cenueshme dhe të monitorohen rastet në shtëpi, duke siguruar qasje në shërbimet fizike sipas nevojës.
- Të lansohen fushata ndërgjegjësimi për të informuar njerëzit rreth shërbimeve sociale dhe asistencës digjitale të disponueshme në internet, si t'i qasen atyre dhe përfitimet e qasjes në to. Të përshtaten komunikimet për t'iu përgjigjur nevojave për informim nga gratë dhe burrat dhe mjeteve të komunikimit që ata përdorin. Siguria që personat me aftësitë e kufizuara dhe ato që flasin gjuhë të ndryshme të kenë qasje në informacion. Fushatat duhet të adresojnë çështjet e privatësisë dhe pëlqimit të informuar në ndarjen e të dhënave të përfituesve nëpër institucionet, duke zgjeruar njohuritë e tyre për mbrojtjen e të dhënave si dhe besimin në mbrojtjen e të dhënave të tyre nga ofruesit.

Për Administratën Tatimore të Kosovës

- Të rregullohen sistemet e menaxhimit të të dhënave për të mbledhur dhe evidentuar të dhëna të ndara sipas gjinisë. Të ngritën më tej kapacitetet për analizë gjinore, duke i shfrytëzuar këto të dhëna për të informuar punën e ATK-së.
- Të bëhet përpjekje për të siguruar një proces digjitalizimi të përgjegjshëm gjinor dhe të raportohet mbi progresin.
- Të bëhet përpjekje që në fushatat e informimit publik të përdoren imazhet transformuese gjinore drejt sfidimit të normave dhe roleve gjinore.

Për Ministrinë e Rinisë, Kulturës dhe Sporteve

- Të bëhet analiza gjinore ex-post gjatë vlerësimit të Strategjisë për Rininë 2019-2023, duke e përdorur atë për të informuar çdo strategji të ardhshme me analizën gjinore.

- Të miratohet legjislacioni dytësor për të lehtësuar zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve në institucionet arsimore, duke vendosur detyrimet e tyre për të adresuar dhunën kibernetike, ngacmimin online, abuzimin, përpunimin e sigurt të të dhënave personale dhe mirëqenien digjitale të vajzave dhe djemve. Të merret parasysh se si rolet gjinore, stereotipat dhe marrëdhëniet mund të ndikojnë në rreziqe të ndryshme për vajzat dhe djemtë, duke adresuar marrëdhëniet e pushtetit dhe kushtet sociale që parashikojnë dhunën e shkaktuar nga meshkujt ndaj grave dhe vajzave.
- Të sigurohet pjesëmarrja e barabartë e grave, burrave dhe ZBGJ në Grupin e Zbatimit të Strategjisë Arsimore. Të ketë koordinim për të siguruar zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e kësaj Strategjie të përgjegjshme gjinore, duke përfshirë analizën e ndikimit gjinor.
- Të bëhet vlerësimi gjithëpërfshirës, sistematik të nevojave për trajnime digjitale. Të institucionalizohen trajnimet e detyrueshme dhe të vazhdueshme për rolet, normat dhe marrëdhëniet gjinore për zyrtarët, mësimdhënësit dhe administratorët e shkollave, drejt transformimit të normave gjinore përmes edukimit. Të integrohet vëmendja ndaj roleve, normave dhe marrëdhënieve gjinore në trajnimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve në lidhje me digjitalizimin dhe në përdorimin e kurrikulave digjitale. Të krijohet baza e të dhënave ku përcillen aftësitë digjitale të mësimdhënësve, trajnimi formal i ofruar dhe nevojat për zhvillimin profesional në lidhje me digjitalizimin e përgjegjshëm gjinor.
- Të zgjerohen shërbimet publike digjitale për të mundësuar raportimin e ngacmimit seksual dhe dhunës kibernetike në internet, duke përfshirë formularët anonimë të raportimit dhe formularët online për raportimin e shkeljeve të privatësisë ose të drejtave të mbrojtjes së të dhënave personale.
- Të investohet në sigurimin e qasjes universale në kompjuter dhe internet në të gjitha shkollat dhe në sigurimin që aftësitë digjitale të jenë pjesë e kurrikulës së arsimit bazë; të zhvillohet ekosistemi i inovacionit në mënyrë që vajzat dhe djemtë të kenë qasje.
- Të vazhdohen masat afirmative si bursat për vajza për t'u përfshirë në fushat e TIK-ut ku ato historikisht kanë qenë të nënpërfaqësuar. Të synohen grupet etnike të nënpërfaqësuar, duke siguruar që materialet për masat afirmative të jenë në dispozicion në gjuhët e tyre dhe për personat me aftësi të kufizuara. Të sigurohen masa të ngjashme për djemtë që të bëhen edukatorë të qendrave parashkollore dhe të shkollave fillore, duke përfshirë rolin e tyre të rëndësishëm në edukimin transformues gjinor, duke adresuar dhunën e drejtuar kundër burrave dhe djemve dhe mbrojtjen e fëmijëve. Të ngritën më tej kapacitetet e tyre për të përdorur mjete mësimore digjitale dhe për të siguruar mbrojtjen e fëmijëve në përdorimin e TIK-ut për mësimdhënie.
- Të futet këshillimi akademik dhe ai për karrierë dhe panairë vjetore pune në të gjitha shkollat, veçanërisht në zonat rurale, që informojnë të rejtat për mundësitë e karrierës në TIK.
- Të merret parasysh institucionalizimi i zotësisë digjitale si pjesë e kurrikulave të ofruara në Qendrat Mësimore për nxënësit romë, ashkali

dhe egjiptianë, me qëllim të pajisjes së tyre me aftësi për të siguruar vende pune në TI.

- Të ofrohet kujdes falas për fëmijët gjatë mundësive të mësimit të vazhdueshëm në lidhje me aftësitë digjitale, duke u mundësuar më shumë grave të marrin pjesë.
- Të udhëhiqen reforma të kurrikulës dhe rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit që transformojnë rolet gjinore, duke përfshirë vijimin e shkollimit nga gratë në fushën e TIK-ut, bullizmin kibernetik dhe mënyrën e raportimit të shkeljeve të të drejtave. Të bëhet informimi që mbështet nxënësit në sfidimin e roleve dhe stereotipave gjinorë drejt një mjedisi më të sigurt në internet për vajzat dhe djemtë. Të angazhohen prindërit më shumë në përpjekjet për rritjen e ndërgjegjësimit.
- Të sigurohet që të gjitha statistikatat e arsimit të ndahen sipas gjinisë dhe moshës, përkatësisë etnike, vendndodhjes rurale/urbane dhe aftësisë së kufizuar. Të krijohet softueri i ndërveprueshëm në mënyrë që të dhënat të mblidhen automatikisht nga shkollat, t'u ofrohen DKA-ve dhe MASHT-it, të analizohen në nivel kombëtar dhe të dorëzohen në ASK përmes shkëmbimit të të dhënave digjitale, në mënyrë që ASK të publikojë të dhëna të tilla rregullisht, sipas Ligjit për Barazi Gjinore.
- Të publikohen rregullisht në faqet e internetit të MASHTI dhe DKA-së planet, raportet dhe buxhetet me informacione të ndara sipas gjinisë dhe analiza të ndikimit gjinor në përputhje me përgjegjësitë ligjore dhe drejt përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies.
- Të zbatohet buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, duke përdorur Buxhetimin për arsim si udhëzues, i prodhuar nga MASHTI në vitin 2016 në bashkëpunim të ngushtë me RrGK-në.
- Të shtohet në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm dhe DKA-së formularët e raportimit mbi dhunën në kategoritë e shkollave që lidhen me dhunën kibernetike me bazë gjinore me shembuj për të lehtësuar dhe inkurajuar raportimin.
- Të përmirësohen protokollat për mbrojtjen e fëmijëve, duke përfshirë edhe atë që lidhet me digjitalizimin.

Për Ministrinë e Ekonomisë

- Të formalizohet koordinimi i përmirësuar me MASHTO, MFPT dhe Ministrinë e Drejtësisë për të punuar së bashku drejt politikave dhe programeve të punësimit të përgjegjshëm gjinor.
- Të përdoren masa afirmative për të rritur pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje në Qeveri, ekonominë e gjelbër dhe qarkore dhe sektorin e energjisë në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore.
- Të bëhet vlerësimi ex-post i ndikimit gjinor për të analizuar ndikimin e KODE mbi gra dhe burra të ndryshëm, duke përfshirë përcjelljen e punësimit afatgjatë pas vendosjes në punë sipas gjinisë dhe treguesve të tjerë demografikë. Të përdoret vlerësimi për të informuar planifikimin e programeve.
- Të sigurohet që në çdo përsëritje të ardhshme të planeve të veprimit, programeve KODE, YOU, ose WOW që planet e veprimit dhe dokumentet e projektit të përfshijnë tregues të ndarë sipas gjinisë, pikënisjeve, objektivave dhe buxheteve të përgjegjshme gjinore. Kjo do të lehtësojë monitorimin e rezultateve të barazisë gjinore.

- Të bëhen VNBGJ-ve për të informuar të gjitha projektligjet, politikat, strategjitë dhe programet për bujqësinë dhe zhvillimin ekonomik rural. Të sigurohet që strategjitë dhe planet e veprimit të kenë tregues të qartë gjinor, pikënisje, objektiva dhe buxhete drejt matjes së ndryshimit (p.sh. PRE, SKZH, Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural dhe planet e saj të veprimit, dhe VIB për ndërtimin e digave).
- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji për Regjistrimin e Bujqësisë për të kërkuar pyetje të regjistrimit që kanë të bëjnë me masën në të cilën njësitë bujqësore kanë përdorur mjetet digjitale dhe digjitalizimin në punën e tyre, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë për pronësinë, përdorimin dhe qasjen. Të nxirren dhe përdoren gjetjet nga hulumtimet dhe rekomandimet e RrGK-së dhe FAO-s për të informuar formulimin e pyetjeve. Mes përpjekjeve aktuale për të digjitalizuar mbledhjen e të dhënave për Regjistrimin, të tilla si përdorimi i tabletave, të sigurohet qasje e përgjegjshme gjinore për të arritur tek gratë dhe burrat në familjet bujqësore
- Të bëhet analiza ex-post e ndikimit gjinor të programeve dhe politikave të MBPZHR për të informuar planifikimin e ardhshëm të programeve dhe buxhetimit e përgjegjshëm gjinor.
- Të zhvillohet strategjia dhe plani i veprimit për e-bujqësi të përgjegjshme gjinore.
- Të rritet pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në MBPZHR, drejtoritë komunale dhe në konsultimet publike sipas kërkesave të Ligjit për Barazi Gjinore, sepse kjo mund të rrisë angazhimin e tyre në planifikimin e politikave të bujqësisë dhe zhvillimit ekonomik dhe digjitalizimin e bujqësisë, drejt përmbytjes më të mirë të nevojave të grave dhe burrave.
- Të përfshihen ZBGJ-të dhe OShCG-të me ekspertizë gjinore në grupet e punuese që hartojnë ligje dhe politika, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin, drejt integritimit të perspektives së përmirësuar gjinore.
- Të sigurohet që ZBGJ-ja të ketë kohë dhe kapacitete të mjaftueshme për të marrë pjesë në përfshirjen e perspektivës gjinore në ligjet dhe politikat, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin.
- Të hartohen dhe të institucionalizohen trajnimet për stafin në fushën e digjitalizimit, aspektin gjinor dhe politikëbërjen e përgjegjshme gjinore në lidhje me bujqësinë dhe gjininë.
- Të zbatohet rregullisht buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në buxhetimin vjetor dhe KASH, duke përdorur si udhëzues raportin e RrGK-së *Buxhetimi për bujqësi dhe zhvillim rural më të mirë*, të shkruar në bashkëpunim të ngushtë me MBPZHR.
- Të sigurohet që infrastruktura e re softuerike që po zhvillohet nga MBPZHR të përfshijë të dhëna që kanë të bëjnë me gjininë, përkatësinë etnike, moshën, vendndodhjen dhe aftësinë e kufizuar, duke mundësuar analizën e ardhshme gjinore. Të përmirësohet infrastruktura digjitale për të mundësuar analizën gjinore me qëllim të informimit të politikëbërjes,
- Të mbështeten shërbimet e informimit, mentorimit, trajnimit dhe këshillimit si dhe zgjerimit rural për të rritur ndërgjegjësimin për teknologjitë digjitale, përfitimet e tyre dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Të synohen gratë nga vendet rurale që të adresojnë qasjen e tyre historikisht joproporcionale në shërbime dhe kufizimet arsimore. Më konkretisht, siç

i ka rekomanduar RrGK-ja MBPZHR-së në *Profilin e ardhshëm gjinor të Kosovës* nga FAO-s:

- Të përdoren masa afirmative për të rritur numrin dhe përqindjen e grave që ofrojnë shërbime këshillimore, gjë që mund t'i bëjë gratë fermere të ndihen më rehat në qasjen e këtyre shërbimeve.
- Të promovohen më mirë shërbimet këshillimore, duke siguruar që gratë nga vendet rurale të kenë qasje në informacionin rreth asaj që është në dispozicion.
- Të ngritet ndërgjegjësimi i zyrtarëve këshillues komunalë lidhur me çështjet me të cilat përballen gratë në qasjen dhe përdorimin e TIK-ve, së bashku me OShC-të, në mënyrë që ata të mund t'i mbështesin më mirë gratë në adresimin e këtyre çështjeve.
- Të futen trajnime në shërbimet këshillimore komunale dhe mentorimi vijues mbi arsimimin digjital, aftësitë dhe përdorimin e TIK-ut për aktivitetet bujqësore.
- Të merret në konsideratë pilotimi për të mbështetur gratë dhe burrat me aftësi të kufizuara që janë të interesuar të mbështesin familjet e tyre me transformimin digjital të bizneseve të tyre [ekzistuese bujqësore familjare].
- Të mbështeten gra dhe burra të ndryshëm në zhvillimin e marketingut dhe shitjes online të produkteve në përputhje me standardet e BE-së.

Për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

- Të sigurohet që Ligji i ri për Banimin Social të përmbajë referenca më specifike për digjitalizimin e shërbimeve sociale të banimit, mirëmbajtjes dhe raportimin transparent publik të të dhënave elektronike të konsoliduara, të ndara sipas gjinisë për përfituesit (përveç të dhënave të tjera demografike). Bazuar në VN(B)GJ, të jepet përparësi të drejtës për banim të mbijetuarve/ave të dhunës me bazë gjinore dhe të vartësve të tyre, si dhe personave të cenueshëm LGBTIQ+. Të kërkohet analiza gjinore për të informuar procesin e identifikimit të nevojave për banim dhe prioritizimin e përfituesve. Të sigurohen rregullore dhe udhëzime të mëtejshme për komunikimin digjital me përfituesit ekzistues ose potencial, standardet e privatësisë dhe mbrojtjen e të dhënave personale në bashkëpunim të ngushtë me MFPT dhe Ministrinë e Drejtësisë. Të sigurohen masa paraprake të sigurisë fizike të përgjegjshme gjinore në ndërtesa, së bashku me komunat, duke marrë parasysh rreziqet e mundshme për gratë beqare, për shembull.
- Të bëhet VN(B)GJ për të informuar projektligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, të konsultohen OShCG-të dhe ZBGJ-të dhe të rishikohet ai për të përfshirë analizën e ndikimit gjinor dhe për të adresuar stereotipat aktual gjinorë brenda projektligjit.
- Të sigurohet që VN(B)GJ dhe VNB që përmbajnë analiza gjinore të informojnë të gjitha projektligjet, politikat, strategjitë dhe programet, duke përfshirë edhe ato që lidhen me digjitalizimin. Të përfshihen ZBGJ-të dhe OShCG-të me ekspertizë në çështjet gjinore në grupet punuese për hartimin e ligjeve dhe politikave dhe në proceset e konsultimit publik për të integruar më mirë perspektivën gjinore
- Të përmirësohen kërkesat ligjore për përcjelljen/gjurmimin e të dhënave për përdoruesit e burimeve, të ndara sipas gjinisë, për të mbështetur

sistemin e përmirësuar e të digjitalizuar “ndotësi paguan”, si dhe ndërgjegjësimin më të synuar gjinor drejt reduktimit të konsumit.

- Të përfshihen në Këshillin Kombëtar për Ndryshime Klimatike më shumë ekspertë të ndryshëm, duke përfshirë OShCG dhe akademikë, të cilët mund të kontribuojnë me njohuri dhe rekomandime mbi ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij mbi gra dhe burra të ndryshëm.
- Të institucionalizohen trajnimet e detyrueshme për çështjet gjinore dhe digjitalizim për politikëbërësit dhe buxhetin për realizimin e tij.
- Të planifikohen konsultime fizike publike në kohë dhe vende ku mund të marrin pjesë gra dhe burra të ndryshëm, ose zyrtarët komunal të shkojnë të vizitojnë gratë për të mbështetur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje që ndikon në jetën e tyre.
- Të merret parasysh përdorimi i zgjidhjeve digjitale për të lehtësuar pjesëmarrjen e grave dhe burrave, të tilla si konsultimet dhe anketat online për të informuar politikën për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Të zhvillohen sisteme të paralajmërimit të hershëm në lidhje me krizat klimatike, duke shfrytëzuar analizën gjinore për të identifikuar nevojat e informacionit dhe mënyrat e sigurimit të informacionit që arrin tek gratë dhe burrat e ndryshëm.
- Të përdoren komunikimet digjitale, duke përfshirë TV dhe mediat sociale për të rritur ndërgjegjësimin për ndryshimet klimatike, strategjitë e zbutjes dhe mënyrën e raportimit të shkeljeve, duke synuar gra dhe burra të ndryshëm me informacione dhe imazhe që synojnë të transformojnë normat dhe rolet gjinore.
- Të merren parasysh standardet etike, mbrojtja e të dhënave, privatësia, besimi dhe siguria kibernetike, të përgjegjshme gjinore, në zhvillimin e softuerit të ri që digjitalizon shërbimet në lidhje me ujin, energjinë dhe raportimin online të shkeljeve mjedisore, duke përmirësuar kështu mirëqenien e grave dhe burrave.
- Të zbatohet rregullisht buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në buxhetimin vjetor dhe KASH, duke përdorur si udhëzues raportin e RrGK-së [Buxhetimi për një mjedis më të mirë](#), të shkruar në bashkëpunim të ngushtë me MMPH.

Për Ministrinë e Shëndetësisë

- Të sigurohet që VN(B)GJ të informojë të gjitha projektligjet dhe politikën, duke përfshirë qëllimet, treguesit, pikënisjet, objektivat dhe buxhetet në drejtim të avancimit të barazisë gjinore. Të bëhet analiza e ndikimit gjinor të sektorit shëndetësor për të informuar reformat drejt digjitalizimit të shërbimeve shëndetësore, veçanërisht Strategjisë së re Sektoriale të Shëndetësisë.
- Të bëhet instalimi i plotë i SISH dhe të sigurohet përdorimi i tij. Të digjitalizohen të dhënat shëndetësore në të gjitha institucionet shëndetësore, duke përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë dhe të dhëna të tjera kyçe sociale dhe demografike (p.sh., mosha, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, vendndodhja gjeografike). Të krijohet softueri i përmirësuar për ndërveprueshmërinë ndërmjet ofruesve të shërbimeve të kujdesit shëndetësor publik dhe privat, komunave, Ministrisë së Shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe ASK-së që mundëson mbledhjen dhe raportimin e drejtpërdrejtë në

kohë reale të të dhënave të ndara sipas gjinisë për njerëzit dhe shërbimet e përdorura, duke përfshirë edhe shërbimet online. Të publikohen në Statistikat e Shëndetësisë të ASK-së të dhëna të ndara sipas gjinisë për personat që përdorin shërbime të ndryshme, përfshirë edhe ato të shëndetit mendor.

- Të sigurohen kompjuterët dhe softueri i përditësuar për të mundësuar menaxhimin modern dhe të saktë të rasteve që mbron privatësinë e pacientëve, duke marrë parasysh qasjen e përgjegjshme gjinore.
- Të sigurohet që i gjithë stafi përgjegjës të jetë i trajnuar për përdorimin e sistemeve të tilla dhe të zbatohet përdorimi ityre.
- Të bëhet përcjellja dhe raportimi më i mirë i të dhënave ndërthurëse të ndara sipas gjinisë nga platforma eKosova; të dhëna të tilla mund të informojnë hartimin e politikave dhe masave më të përgjegjshme gjinore për qytetarë të ndryshëm, duke mundësuar gjithashtu zbulimin më të shpejtë të tendencave shëndetësore dhe krizave të afërta.
- Të përmirësohet faqja e internetit e Inspektoratit Shëndetësor për të përfshirë informacione për të drejtat shëndetësore, shkeljet dhe mënyrën e raportimit të shkeljeve. Të vendoset vegëza për të qasur formularin e raportimit në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe/ose të përfshihet formulari online për raportimin e shkeljeve të supozuara që përfshin gjininë si fushë të futjes së të dhënave dhe siguron mbrojtjen e të dhënave personale.
- Të konsiderohet pilotimi u shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor, veçanërisht duke u ofruar grave të moshuara, ato nga vendet rurale dhe me aftësi të kufizuara qasje më të mirë në disa forma të kujdesit shëndetësor bazë dhe trajtimin pasues. Të zhvillohen shërbime në shumë gjuhë dhe për njerëzit me aftësi të kufizuara të ndryshme.
- Të bëhet hulumtimi i mëtejshëm për të shqyrtuar deri në çfarë mase gra dhe burra të ndryshëm kanë njohuri të mjaftueshme dhe aftësi digjitale për gjetjen, qasjen dhe përdorimin e shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor. Gjatë zhvillimit të zgjidhjeve digjitale të kujdesit shëndetësor, të bëhet analiza ndërthurëse gjinore duke marrë parasysh moshën, përkatësinë etnike, aftësinë dhe tregues të tjerë sociodemografikë për të kuptuar më mirë nevojat e grave dhe burrave të ndryshëm dhe çdo sfidë të mundshme në qasje me të cilën mund të përballen ata, në mënyrë që shërbimet digjitale të mund të përshtaten sipas nevojave të tyre dhe zotësisë së tyre digjitale.
- Të merren parasysh normat dhe vlerat gjinore gjatë dizajnit të shërbimeve digjitale të kujdesit shëndetësor, si për shembull duke u siguruar që shërbimet mund t'u ofrohen grave nga gratë.
- Të merret parasysh përshtatja dhe miratimi i Protokollit të RrGK-së për tele-këshillim që mbron klientët bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare.

Komunat

- Të institucionalizohet, të ndahet buxheti dhe të sigurohen trajnime të detyrueshme për të gjithë zyrtarët e ardhshëm të qeverisë komunale dhe kuvendit në lidhje me barazinë gjinore, politikëbërjen dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, si dhe aftësitë digjitale.

- Të përdoren faqet zyrtare të internetit në vend të domeneve private, duke i përditësuar ato rregullisht dhe duke ofruar informacion të përshtatshëm dhe të qasshëm për përdoruesit, në mënyrë që qytetarët me njohuri digjitale të kufizuara të mund të qasen lehtë informacioneve.
- Të publikohen online buxhetet komunale, kornizat buxhetore afatmesme, anekset e buxheteve të përgjegjshme gjinore dhe deklaratat e buxhetit gjinor, duke i vënë ato në dispozicion për publikun.

Për Agjencinë për Informim dhe Privatësi

- Të përmirësohet qasja në të dhënat e ndara sipas gjinisë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe shkeljet e të drejtave duke përmirësuar mbledhjen, raportimin e automatizuar digjital në ASK dhe duke publikuar këto të dhëna.
- Të përdoren të dhënat për të informuar fushatat e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të dhënave dhe ku të raportohen shkeljet. Të merren parasysht nevojat e ndryshme për informim, duke targetuar më mirë gratë dhe burrat e ndryshëm. Të përfshihen të dhëna më specifike në lidhje me kërcënimet me të cilat mund të përballen gra dhe burra të ndryshëm lidhur me mbrojtjen e të dhënave dhe të merren parasysht aspektet gjinore të kërcënimeve për mbrojtjen e të dhënave.
- Të sigurohet që vlerësimet e ndikimit në mbrojtjen e të dhënave kërkojnë analiza gjinore, duke përfshirë mënyrat se si gratë dhe burrat e ndryshëm mund të ndikohen ndryshe nga shkeljet e të dhënave. Të nxirren gjetjet nga VN(B)GJ dhe të përfshihet ABGJ në Vlerësimet e Mbrojtjes së të Dhënave.
- Të përcillen të dhënat e ndara sipas gjinisë për rastet e raportuara.

Për Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

- Të përcillen të dhënat e ndara sipas gjinisë për ankesat, kërcënimet dhe incidentet në komunikimet elektronike.
- Të përdoret analiza gjinore, duke përfshirë moshën, gjuhën dhe aftësinë e kufizuar, në monitorimin e zbatimit të Ligjit për Komunikimet Elektronike.

Për Komisionin e Pavarur për Media

- Të zgjerohet Ligji për KPM për të përcaktuar dhunën me bazë gjinore dhe për të mbrojtur më mirë fëmijët dhe të miturit. Ligji duhet të specifikojë nevojën e transmetimit të programeve që kontribuojnë në eliminimin e stereotipave gjinorë dhe normave tradicionale. Me dispozitat e ligjit duhet të dënohet transmetimi i përmbajtjes që përforcon dinamikën jo të shëndetshme të pushtetit, siç është dhuna me bazë gjinore. Më tej, politika e transmetimit duhet të marrë parasysht se si gratë dhe vajzat portretizohen në media dhe çfarë përbën shkelje. Mediave duhet t'u kërkohe në mënyrë eksplicite të mos transmetojnë përmbajtje që denigrojnë dhe objektivizojnë gratë. "Respektimi i barazisë gjinore, identitetit gjinor dhe preferencave seksuale" duhet të përfshihet ndër parimet e renditura në këtë ligj. Të përafrohet neni 10 për përbërjen e KPM-së me Ligjin për Barazi Gjinore për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave, i përcaktuar

si 50%. Të rishikohet gjuha për t'iu referuar saktë grave (gjinisë) dhe seksit (femër) aty ku është relevante, në vend të terminologjisë aktualisht të ngatërruar.

- Të përfshihet në Ligjin për Komunikimet Elektronike parimi i barazisë gjinore, të merren parasysh karakteristikat dhe nocioni e gjinisë dhe seksit, si dhe nevojat e personave të moshave të ndryshme dhe me aftësi të kufizuara.
- Të definohet dhe të rregullohet në Ligjin për Shërbimet e Shoqërisë Informatike mjedisi i sigurt dhe i përshtatshëm për tregtinë elektronike, përdorimin e transaksioneve elektronike dhe nënshkrimin elektronik që merr parasysh kërcënimet specifike me të cilat mund të përballen gratë dhe burrat.
- Pas ndryshimeve dhe plotësimeve në ligj, përveç “Programeve me përmbajtje të dëmshme”, të përfshihet edhe një përkufizim i veçantë për të njohur se si dhuna prek vajzat dhe djemtë lidhurme gjininë e tyre. Rregullorja e KPM-së 2013/01 për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet e mediave audio-vizuale duhet të zgjerohet më tej nën 2 për të përkufizuar dhunën me bazë gjinore dhe për të mbrojtur fëmijët dhe të miturit nga ekspozimi ndaj shprehjeve të pushtetit, emocional ose fizik. Të shtohet përkufizimi i cili njeh se një dhunë e tillë prek vajzat veçanërisht për shkak të gjinisë së tyre.
- Të përfshihet perspektiva gjinore në dokumentet e punës së KPM-së dhe të ofrohen trajnime dhe mentorim të avancuar për anëtarët e KPM-së për të forcuar përpjekjet e tyre për politikëbërje, zbatim, monitorim dhe vlerësim të përgjegjshëm gjinor.
- Të konsultohen OShCG-të gjatë hartimit të dokumenteve që rregullojnë punën e KPM-së drejt një qasjeje më të përgjegjshme gjinore ndaj trajtimit të grave, vajzave, burrave dhe djemve në media dhe komunikim, duke u mundësuar OShC-ve të ndajnë ekspertizën e tyre.
- Të zbatohen reformat e planifikuara për digjitalizimin e shërbimeve publike, duke lehtësuar qasjen në ankesat online. Të sigurohet që informacioni që ka të bëjë me gjininë e ankuesit, dhe në mënyrë ideale, gjinia e dhunuesit të akuzuar, aty ku është relevante, të jetë pjesë e formularit online. Të krijohet sistemi për përcjelljen e ankesave, duke mundësuar kështu analizën gjinore. Informacioni i tillë mund të mbështesë përmirësime në fushatat e ndërgjegjësimit ndër politikat dhe programet e tjera. Sistemet gjithashtu duhet të përfshijnë informacion nëse ankesat përfshinin shkelje të lidhura me gjininë.

Për Institucionin e Avokatit të Popullit

- Të përfshihet një fushë për “të tjera” nën fushën e gjinisë në formularin e raportimit të rastit online, duke pasur parasysh mandatin e institucionit për të mbrojtur të drejtat e personave që identifikohen ndryshe. Të riformulohen ‘mashkulli’ dhe ‘femra’ si burrë dhe grua për të pasqyruar gjininë dhe jo seksin. Të shtohet një kategori për diskriminimin me bazë gjinore.
- Të përmirësohet sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave për përcjelljen e rasteve, duke përfshirë fushat për llojin e rastit të trajtuar, përfshirë krimet kibernetike, dhunën kibernetike dhe ngacmimet

kibernetike. Të sigurohen në mënyrë elektronike në kohë reale të dhëna të ndara sipas gjinisë për rastet e raportuara dhe të adresuara.

Për Zyrën Kombëtare të Auditimit

- Të monitorohet zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga organizatat buxhetore dhe të përfshihen në të gjitha raportet e auditimit informacion nëse ato i zbatuan kërkesat ligjore, si për shembull të bëhet analiza gjinore për të informuar shpenzimet e planifikuara buxhetore dhe vënia në dispozicion për publikun të aneksit të kërkuar nga MFPT në qarkoret buxhetore.
- Të jepen rekomandime në të gjitha raportet e auditimit që organizatat buxhetore të zbatojnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në praktikat e tyre financiare, sipas udhëzimeve të OKB-së për OZHQ 5.c.1 dhe PEFA GRPFM. Kjo mund të lehtësojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në lidhje me digjitalizimin në të gjithë sektorët.

Për Policinë e Kosovës

- Të definohen qartë përgjegjësitë e njësive të PK-së në trajtimin e dhunës kibernetike me bazë gjinore, duke eliminuar interpretimet subjektive të asaj që përbën krim kibernetik dhe konfuzionin rreth përgjegjësisë.
 - Të përdoren masa afirmative për të rekrutuar më shumë gra në Njësinë e Hetimit të Krimeve Kibernetike të PK-së.
 - Të sigurohen trajnime të detyrueshme për një qasje të përgjegjshme gjinore për trajtimin e krimit kibernetik dhe dhunës kibernetike si pjesë e trajnimit bazë për të gjithë zyrtarët e PK-së.
 - Të përmirësohet koordinimi ndërmjet zyrtarëve të PK-së të specializuar në sigurinë kibernetike dhe atyre të specializuar për dhunën me bazë gjinore në adresimin e rasteve të krimit kibernetik me bazë gjinore, duke u mbështetur nga ekspertiza e tyre përkatëse. Të përfshihen trajnime për shmangien e fajësimit të viktimës. Të edukohen zyrtarët për përdorimin e pajisjeve digjitale të incizimit gjatë intervistave në polici për të reduktuar ri-traumatizimin nga intervistat e shumta nga institucione të ndryshme.
 - Të përmirësohet qasja publike në kohë në statistikën përmbledhëse të krimeve të dyshuara të raportuara dhe trajtuara, duke përfshirë krimet kibernetike, të ndara sipas llojit të krimit, gjinisë së kryesit së veprës, gjinisë së viktimës dhe faktorëve të tjerë socio-ekonomikë dhe demografikë (p.sh., mosha, përkatësia etnike).
 - Të sigurohet që KASH i ka të përfshira qëllimet, treguesit, objektivat dhe shpenzimet e planifikuara të qarta drejt avancimit të barazisë gjinore. Të publikohet online analiza gjinore duke informuar shpenzimet e planifikuara buxhetore dhe anekset buxhetore në përputhje me praktikën më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Për shembull, të përdoren sisteme elektronike për të përcjellë rastet e asistuar dhe nevojat financiare të lidhura për trajtimin e rasteve për të informuar kërkesat buxhetore të bazuara në dëshmi.
- Të sigurohet që në të gjitha konkurset e vendeve të reja punës dhe e-prokurim të përdoret gjuha që inkurajon të aplikojnë gratë dhe burrat

e ndryshëm. Të përdoren masa afirmative për kompanitë që punojnë për të avancuar barazinë gjinore brenda tyre.

- Të përditësohet formulari online për raportimin e krimit kibernetik për të kërkuar gjininë e personit që raporton incidentin dhe të kryesit të supozuar të veprës. Të vihet në dispozicion në gjuhën serbe dhe angleze si dhe shqipe. Të shtohet një ndërfaqe interaktive që paraqet të dhëna të konsoliduara të ndara sipas gjinisë për rastet e raportuara dhe trajtuara. Të merret parasysh shtimi i informacionit se si PK-ja mbron të drejtat, të dhënat, konfidencialitetin dhe privatësinë e parashtruesve të kërkesave në mënyrë që të inkurajoj raportimin. Të konsiderohet shtimi i një opsioni për të raportuar në mënyrë anonime.

Për Këshillin Prokurorial të Kosovës, Prokurorinë dhe Mbrojtësit e Viktimave

- Të përdoren masa afirmative për të punësuar më shumë gra prokurore. Të sigurohet që çdo algoritëm i përdorur në procesin e digjitalizuar të punësimit të prokurorëve të rinj të mos diskriminojë pa dashje gratë.
- Të parashihen trajnime të detyrueshme për prokurorët për krimin kibernetik me bazë gjinore, dhunën kibernetike dhe ngacmimin në internet, si dhe mjekësinë ligjore digjitale.
- Të sigurohet që sistemet digjitale t'i japin përparësi rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe t'ua caktojnë ato në mënyrë të rastësishme prokurorëve të trajnuar, të certifikuar dhe me përvojë në trajtimin e dhunës me bazë gjinore, përfshirë krimin kibernetik.
- Të sigurohet që SMIL mbledhë të dhëna të ndara sipas gjinisë, duke mundësuar analiza bazuar në gjininë dhe moshën, përkatësinë etnike, vendndodhjen rurale/urbane dhe tregues të tjerë socio-ekonomikë dhe demografikë. Të mundësohet kërkimi i regjistrimeve të digjitalizuara me fjalë kyçe, duke përfshirë termat që lidhen me gjininë dhe seksin.
- Të publikohen të dhënat përmbledhëse të rasteve online, duke përfshirë informacionin lidhur me gjininë, duke mundësuar kështu monitorimin dhe përcjelljen e pavarur të rasteve përmes sistemit prokurorial.
- Të sigurohet që KASH ti ketë të përfshira qëllimet, treguesit, objektivat dhe shpenzimet e planifikuara të qarta me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Të publikohen analizat gjinore online duke informuar shpenzimet e planifikuara buxhetore dhe anekset buxhetore në përputhje me praktikat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor. Të sigurohet buxhet i mjaftueshëm për burimet njerëzore të MV-ve.
- Të sigurohet që në të gjitha konkurset e vendeve të reja punës dhe e-prokurim të përdoret gjuha që inkurajon të aplikojnë gratë dhe burrat e ndryshëm. Të përdoren masa afirmative për kompanitë që punojnë për të avancuar barazinë gjinore brenda tyre.
- Të përmirësohet menaxhimi i rasteve të MA-ve, duke përfshirë mundësinë e përdorimit të tabletave të kompjuterit gjatë asistimit të rasteve.

Për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatat dhe Akademinë e Drejtësisë

- Të përdoren masa afirmative për të punësuar më shumë gra në pozita vendimmarrëse dhe si gjyqtare.
- Të vendoset trajnimi i detyrueshëm për gjyqtarët për krimin kibernetik me bazë gjinore, dhunën kibernetike, ngacmimin në internet dhe masat e mbikëqyrjes elektronike, veçanërisht për urdhrat e mbrojtjes.
- Të ofrohen trajnime të mëtejshme për SMIL, duke inkurajuar stafin që të plotësojë të gjitha fushat, duke përfshirë motivin dhe nëse dyshohet për ndonjë motiv të lidhur me gjininë. Të sigurohet që sistemi të mbledhë të dhëna për gjininë, moshën dhe përkatësinë etnike të viktimës dhe kryesit të supozuar të veprës; nëse viktimja ka ndonjë aftësi të kufizuar; dhe llojin e krimit të supozuar, si dhe nëse përfshin dhunë kibernetike.
- Të përmirësohet më tej funksionaliteti dhe kërkimi i shërbimeve ekzistuese publike elektronike, duke siguruar që të dhënat e ndara sipas gjinisë, statistikave përmbledhëse dhe teksti i kërkueshëm të jenë në dispozicion në tri gjuhë. Të përfshihet gjinia e gjyqtarëve duke mundësuar kështu analizën gjinore të trendeve.
- Të sigurohet që KASH ti ketë të përfshira qëllimet, treguesit, objektivat dhe shpenzimet e planifikuara të qarta me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Të publikohen analizat gjinore online duke informuar shpenzimet e planifikuara buxhetore dhe anekset buxhetore në përputhje me praktikën më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Të sigurohet që në të gjitha konkurset e vendeve të reja punës dhe e-prokurim të përdoret gjuha që inkurajon të aplikojnë gratë dhe burrat e ndryshëm. Të përdoren masa afirmative për kompanitë që punojnë për të avancuar barazinë gjinore brenda tyre.
- Të sigurohet që dizajni dhe përditësimet e sistemeve digjitale të bazohen në analizën gjinore.
- Të përfshihen kritere shtesë në programin softuerik për caktimin e rastësishëm të gjyqtarëve në lëndë/raste, sipas të cilave certifikimi në fushën e dhunës me bazë gjinore figuron në algoritmin që përcakton lëndën/rastin e gjyqtarit.
- Të përfundohen përpjekjet e vazhdueshme për të pajisur të gjitha gjykatat me teknologji digjitale që mundësojnë dhënien e dëshmisë përmes videove, me qëllim të mbrojtjes së dëshmitarëve. Të sigurohen trajnime dhe udhëzime duke inkurajuar përdorimin e teknologjive të tilla.

Për donatorët, aktorët e zhvillimit dhe mbështetësit

- Të sigurohet që analiza gjinore të informojë të gjitha veprimet, duke përfshirë qëllimet, treguesit, pikënisjet, objektivat dhe buxhetet me qëllim të avancimit të barazisë gjinore. Të zbatohen masat e kontrollit të cilësisë për të siguruar që të gjitha veprimet të jenë të informuara nga analizat e ndikimit gjinor dhe përpiqen të avancojnë barazinë gjinore, duke përdorur udhëzimet e OBZHE-së; kjo do të lehtësojë monitorimin e rezultateve të barazisë gjinore.
- Të kërkohet që të gjitha vlerësimet e veprimeve të përfshijnë vlerësime të ndikimit gjinor ex-post ndërthurës.

- Të përmirësohet softueri dhe konsistenca në raportimin dhe shkëmbimin e të dhënave të financimit të planifikuar dhe të ofruar, duke paraqitur të dhënat sipas sektorëve dhe të ndara sipas gjinisë, midis treguesve të tjerë socialë dhe demografikë, për të lehtësuar koordinimin e donatorëve, si dhe transparencën në financim. Të përmirësohen kontributet e monitorimit dhe raportimit për barazinë gjinore dhe mbështetjen për OShCG.
- Gjithashtu, siç rekomandoi RrGK në Profilin Gjikor të shkruar për FAO:
 - Të pilotohet angazhimi i grave të reja dhe grave me aftësi të kufizuara në programet e TIK-ut, duke pasur parasysh përparësinë e tyre krahasuese të njohurive, qasjes dhe përdorimit të TIK-ut për komunikim dhe rrjetëzim, drejt rritjes së angazhimit të tyre brenda bizneseve familjare, si hulumtimi i zhvillimeve, shkëmbimi i informacionit, rrjetëzimi ,dhe marketingu i produkteve online.
 - Të investohet në teknologji që e bëjnë punën bujqësore më të lehtë dhe më pak të mundimshme fizikisht, përfshirë edhe përmes digjitalizimit.

- Abdyli, Fadil, Shefi i Njësisë për Krimet Kibernetike, PK, [deklaratë](#) e bërë gjatë programit televiziv “*Divers – ‘Mbrojtja e të dhënave personale në internet’*”, RTK, YouTube, 10 Shkurt 2023, aksesuar më 22 Nëntor 2023.
- Abi-Jaoude, E., Naylor, K.T., and Pignatiello, A., “Telefonat inteligjent, përdorimi i mediave sociale dhe shëndeti mendor i të rinjve”, *Revista e Shoqatës Mjekësore Kanadeze*, 192(6), 2020, ff. 136-141.
- Abraham, “[Ndikimi i mediave digjitale në shoqëri](#)”, *Gazeta Ndërkombëtare e Mendimeve të Kërkimit Kreativ*, 8, 5, 2020.
- Administrata e Tregtisë Ndërkombëtare, “[Kosovë - Udhëzues komercial i vendit](#)”, 2022, aksesuar më 11 dhjetor 2023.
- Agadzhanova, Inna, “[Roli i gjinisë në përfshirjen e bullizmit kibernetik](#)”, *Veprimet e fëmijëve*, 8 Mars 2022, aksesuar 7 Dhjetor 2023.
- Agjencia Kadastrale e Kosovës, [Reporti Vjetor 2021](#), 2022.
- Ahmeti, Gentiana, “[UP cakton një zyrtar për mbrojtje nga ngacimimet seksuale](#)”, *Kallxo.com*, 10 Shkurt 2022.
- AKSES/AKIN, *Biznesi Im*, 2023.
- Al-Alosi, H., “Luftimi i zjarrit me zjarr: Eksplorimi i potencialit të teknologjisë për të ndihmuar viktimat të luftojnë dhunën e partnerit intim”, *agresioni dhe sjellja e dhunshme*, 52, 2020.
- Aleanca Evropiane e NVM-ve Digjitale, “[Digjitalizimi i Qëndrueshëm: Forcimi i Sovranitetit Digjital të Evropës](#)”, 2020.
- Aleanca Ndërkombëtare e Inovacionit për Zhvillim, “[Çfarë është një ekosistem Inovacioni](#)”, aksesuar më 6 nëntor 2023.
- Alfred, G.C., Hammer, J.H., and Good, G.E., “[Studentët veteranë meshkuj: Qëndrueshmëria, mirëqenia psikologjike dhe normat mashkullore](#)” *Psikologjia e Burrave dhe Maskuliniteti*, 2013.
- Alihajdaraj, Donika, “[Gjuha e urrejtjes në media sociale, nxitëse e dhunës](#)”, *Evropa e Lirë*, 10 Gusht 2019, aksesuar më 29 Shtator 2023.
- Aliu, Jetë, Rraci, Ema, and Bajrami, Kushtrim, *Arsimi dhe Aftësimi Profesional në Kosovë: Sfidat dhe Mundësitë*, KEEN: 2019.
- ALLED² Kosovë, “[Zhvillimi i Sistemit të Inteligjencës Kosovare të Aftësive](#)”, YouTube, 2023, aksesuar më 5 Nëntor 2023.
- ALLED², “[E ardhmja është këtu!](#)”, YouTube, 2023, aksesuar më 6 Nëntor 2023.
- ALLED², “[PlaniAFP](#)”, YouTube, 2022, aksesuar më 6 Nëntor 2023.
- ALLED², [Barometri i aftësive kosovare 1.0](#), 2022.
- ALLED², [Planifikimi Financiar për Sistemin e AFP-së në Kosovë: Propozim për Përmirësim](#), 2020, aksesuar më 28 Gusht 2023.
- ALLED², [Raporti i Barometrit të AFP-së osovo 2021-2022](#), 2022, aksesuar më 28 Gusht 2023.
- Ambasada Britanike në Prishtinë, Axiom International, *Forcimi i Sistemit të Drejtësisë së Kosovës Vlerësimi Institucional Gjinor dhe Përfshirja Sociale i Shërbimit Prokurorial të Kosovës*, 2020.
- Ambasadorët e Rinj Evropian, [Gratë janë në krye të shërbimeve të TIK-ut në zhvillim të shpejtë në Kosovë](#),
- Anderson, C. A., et al., “Efektet e dhunshme të video lojërave në agresionin, ndjeshmërinë dhe sjelljen prosociale në vendet lindore dhe perëndimore”, *Buletini Psikologjik*, 136 (2), 2010, ff. 151-173.
- Ankit, et al., “[Mbetjet elektronike dhe rrjedhjet e tyre Ndikimi në shëndetin dhe mjedisin e njeriut: Kërcënimi dhe menaxhimi ekologjik global](#)”, *Teknologji dhe Inovacion Mjedisor*, 2021.
- [Aplikacioni Ec Lirshëm](#), aksesuar më 15 gusht 2023.
- Asociacioni i Grave në Sektorin e Energjisë së Kosovës, [Diversiteti gjinor në sektorin e energjisë në Kosovë](#), 2022.
- ASHBZHN, “[Avancimi i Barazisë Gjinore në Sektorin e Energjisë së Kosovës](#)”, 2021, aksesuar më 5 janar 2024.
- ASHBZHN, “[Bizneset në pronësi të grave: Sfidat dhe mundësitë](#)”, 2020.
- Bacaj, Hana dhe Krasniqi, Gëzim, “[Përgjigja ndaj pandemisë së Kosovës i la bizneset e grave në luftë](#)”, *Balkan Insight*, 12 korrik 2022.
- Bahtiri, L., “[Perceptimet e të rinjve kosovarë për gjendjen mjedisore në Kosovë](#)”, *Ndryshimet klimatike* 4, 2019.
- Bahtiri, Shegë dhe Selmani, Erza, [Shëndetësia Publike Digjitale në Kosovë: Një pasqyrë e situatës dhe sfidave](#), *Fondacioni Konrad Adenauer në Kosovë*, 2023.
- Bajrami, Kushtrim dhe Koci, Kujtim, “[Ndikimi i Qendrave Mësimore në përfshirjen e fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptianë në arsim](#)”, 2018.
- Bala, Nazlie, *Deklaratë në Tryezën Hibride të Këshillit të Evropës*, “*Dimensioni digjital i dhunës ndaj grave: njohja dhe luftimi i fenomenit*”, 11 maj 2022.
- Banka Botërore dhe OBT, [Gratë dhe Tregtia. Roli i Tregtisë në Promovimin e Barazisë Gjinore](#), 2020.

Banka Botërore, [“Forcimi i qeverisjes digjitale për ofrimin e shërbimeve”](#), “Dokumentet e Projektit”, aksesuar më 7 nëntor 2023.

Banka Botërore, [“Infrastruktura digjitale rrit elasticitetin dhe përmirëson jetën në Kosovën rurale”](#), 2023, aksesuar më 3 gusht 2023.

Banka Botërore, [Cenueshmëria gjatë Covid-19 në Ballkanin Perëndimor](#), 2020.

Banka Botërore, Njoftim për Media, [“Çdo fshat në Kosovë tani është i lidhur me internetin me brez të gjerë me shpejtësi të lartë, me mbështetjen e Bankës Botërore”](#), 2023, aksesuar më 5 dhjetor 2023.

Banka Botërore, Njoftim për Media, [“Kosova do të përmirësojë sistemin e saj të ndihmës sociale, me mbështetjen e Bankës Botërore”](#), 29 shtator 2021, aksesuar më 10 dhjetor 2023.

Banka Botërore, Përmbledhje, [“Gratë e Kosovës në Punë në internet - WOW Pilot”](#), 2017, aksesuar më 5 gusht 2023.

Banka Botërore, [Programet Aktive të Tregut të Punës \(PATP\) në Kosovë](#), 2019.

Banka Botërore, [Proxy nënkupton teste për synimin e programeve sociale: Simulimet dhe spekulimet](#), Autorët/Editorët: Margaret E. Grosh dhe Judy L. Baker, 2012.

Banka Botërore, [Studimi i Skemës së Ndihmës Sociale të Kosovës: Vlerësimi dhe Opsionet e Reformës](#), 2019.

Banka Botërore, [Të bësh biznes 2019: Trajnim për Reformë](#), Edicioni i 16-të, 2019.

Banka Botërore, Vlerësimi i Dokumentit të Projektit PEDK, 2018, dhënë RrGK nga Ministria e Ekonomisë, 2022.

BE, [“Prioritetet e BE-së”](#).

BE, Direktiva 2001/42/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 qershor 2001 [mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis](#), 2001.

BE, Direktiva 2010/41/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 [mbi zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë midis burrave dhe grave të angazhuar në një aktivitet në cilësinë e vetëpunësuar](#) dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 86/613/EEC, OJ L 180, 2010.

BE, Direktiva 2014/52/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 16 prill 2014, që ndryshon Direktivën 2011/92/BE [për vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis](#).

BE, Direktiva 2019/1158 [për balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët](#) dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 2010/18/BE, 2019.

BE, Direktiva 2022/2464 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 dhjetor 2022 për ndryshimin e Rregullores (BE) [Nr. raportimi i qëndrueshmërisë së korporatës](#), 2022.

BE, Eurobarometri, [“Qëndimet e evropianëve ndaj diversitetit”](#), 2019, aksesuar më 21 dhjetor 2023.

BE, faqe interneti, [“Prioritetet e BE-së”](#), aksesuar më 15 dhjetor 2023.

